

Shënim hyres!

78 artikuj, të ruajtura në arkivin tim, me shtrirje 226 faqe, përbëjnë bashkëpunimin më të gjatë në medjan e shkruar shqiptare. U nis në vitin 2009 dhe me disa ndërprerje të vogla, vijon ende.

Liria e botuesit të gazetës, dikur kundërshtar, për shkrimet e mia, krijuan terrenin e duhur për t'u shprehur lirshëm për çdo gjë sidomos për marrëdhëniet midis dy vendeve dhe trajtimi i Minoritetit Etnik Grek. E them me bindje se bëhet fjalë për një traditë botimesh, sidomos në trajtimin e problematikës së mprehtë në marrëdhëniet midis dy vendeve por edhe në qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj problemeve të MEG, që vështirë se mund të lëjohej e të krijohej.

Po ashtu, gazeta u bë shkak që të bëhesha gjithnjë e më i kërkuar dhe i pranishëm për emisionet televizive në vend pothuaj të të gjitha kanaleve serioze në vend. Siç do të shihet artikujt e mi në këtë gazetë ribotoheshin me shpejtësi në shumë faqe elektornike dhe gazeta të tjera duke provokuar shpesh reagime të ashpra deri në kërcenime me jetë. Do të ishte e vështirë të përpiqeshin për një përmbledhje ndryshe në lidhje me botimet në këtë gazetë, të cilën gjithsesi duhet falënderuar.

### **Εισαγωγή.**

**Τα 78** άρθρα γνώμης, όπως διατηρούνται στο αρχείο μου, που καλύπτουν 226 σελίδες, αποτελούν την μακροβιότερη συνεργασία με ένα έντυπο αλβανικό ΜΜΕ. Αρχίζει το 2009 και με μερικές διακοπές συνεχίζεται.

Η ελευθερία που μου παραχώρησε ο εκδότης της εφημερίδας, κάποτε άσπονδος αντίπαλος, στα δικά μου άρθρα, δημιούργησαν όλες τις προϋποθέσεις για να εκφράζομαι δημοσίως ελεύθερα για κάθε θέμα, ιδιαίτερα για τις διμερείς ελληνοαλβανικές σχέσεις και για τα προβλήματα που αντιμετωπίζει ο Ελληνισμός στην Αλβανία. Επισημαίνω με πλήρη πεποίθηση ότι πρόκειται για δημιουργία παράδοσης αρθρογραφίας, ειδικά σε ότι αφορά τα επίμαχα θέματα των διμερών σχέσεων αλλά και τη στάση του αλβανικού κράτους προς την Ε.Ε. Μειονότητα, που δύσκολα θα επιτρέπονταν.

Επίσης, η εφημερίδα έγινε η αιτία ώστε να γινόμεν περιζήτητος σε όλες τις εκπομπές των σοβαρότερων τηλεοπτικών καναλιών στη χώρα.

Όπως θα διαπιστώσει ο αναγνώστης, τα άρθρα μου σ'αυτή την εφημερίδα αναδημοσιεύονταν με ταχύτητα από πολλές ιστοσελίδες και άλλα έντυπα, προκαλώντας συχνά σκληρές αντιδράσεις μέχρι και απειλές για τη ζωή.

Θα ήταν ιδιαίτερα δύσκολο να επιδιώκαμε για μια διαφορετική περίληψη των δημοσιεύσεων στην εφημερίδα αυτή, την οποία υπάρχει λόγος να την ευχαριστήσουμε.

# PERMAJTJE

faq. 2

1. **Skandale në oborin e PBDNj-së kompromentojnë keq misionin e politik të lidhshpimit të tij.**  
02.02.2009/04.02.2009 faq. 8.
2. **Një artikull analizë stilistike për fjalimin e E Ramës**  
27.06.2009 faq. 10.
3. **Profili politik në Shqipëri pas zgjedhjeve të 28 qërshorit**  
21.07.2009/23.07.2009 faq. 12.
4. **Vjedhja e votës, strukturim i krimit**  
09.09.2009 faq. 16.
5. **Pushteti politik në Tiranë percakton krahun e fortë drejtues në OMONIA!**  
28.09.2009 faq. 19.
6. **Meta në pushtet: amoraliteti politik makjavelist**  
11.10.2009 faq. 22.
7. **Në Gjirokastër identiteti etnik percakton vendimet e një gjyqtari**  
26.11.2009 faq. 25.
8. **Kriza greke e pesuan me shume shqiptaret**  
**Intervistë tek JAVA dhe TEMA**  
20.06.2012/23-24.06.2012 faq. 28.
9. **Keqperdorimi patriotik i Laberise**  
29.07.2014 faq. 33
10. **Problemet e reformes per arsimin e larte**  
08.08.2014 faq. 35
11. **Pandëshkushmëria e krimit me kullaro!**  
16.08.2014 faq. 37.
12. **Dy fjalë për rrethuesit meskinë të dasmës së Ministrit Veliaj!**  
08.09.2014 faq. 39.
13. **Ndryshimet e thella të pritshme nuk mund t'i sjellin strukturat e korruptuara te shtetit dhe politikës**  
12.09.2014 faq. 41.
14. **Fullani, dhe fullanizimi i rendit tone shoqeror.**  
16.09.2014 faq. 44.
15. **“Gandizmi” qeverisës si domosdoshmëri për të mposhtur të keqën.**  
25.09.2014 faq. 47.

- 16. MAS dhe rishikimi i teksteve shkollore me Greqinë**  
05.10.2014 faq. 50.
- 17. “Dora e hekurt” e reformave dhe mungesa e vullnetit shoqror për to.**  
29.11.2014. faq. 53.
- 18. Nje fitore historike , nje hap larg humneres historike**  
25.01.2015 faq. 56.
- 19. Sa të interesuar jemi për reformën në Arsimin e Lartë Publik?**  
**20.03.2015** faq. 58.
- 20. Dekriminalizimi, një mision i vështirë!**  
28.03.2015 faq. 61.
- 21. Blushi ka një mision shumë më të rëndësishëm se shqipja e Janullatos.**  
14.04.2015 faq. 64.
- 22. A duhen toleruar deklaratat e fundit të Idrizit**  
22.05.2015 faq. 67.
- 23. Marrëveshja e Detit me Greqinë, një Casus Belli i ri artificial në marëdhëniet midis dy vendeve.**  
06.06.2015/08.06.2015 (print) faq. 70
- 24. Greqia po bëhet ifigjeni për t’i treguar evropës se nuk i duhet nje Troje e re.**  
22.06.2015 faq. 73.
- 25. Përkthim –Μετάφραση** faq. 74
- 26. “Vota e Zeusit” të dielën në Greqi dhe mentaliteti keqdashës në Shqipëri.**  
06.07.2015 faq. 76.
- 27. Greqia dhe rëndësia e samitit historik të Brukselit**  
14.07.2015 faq. 79.
- 28. Çfarë fsheh NILO Catalono dhe kush fshihet pas tij**  
26.08.2015 faq. 81.
- 29. Vatra e nxehte e tymnajës së debatit për kishën e Dhërmiut.**  
30.08.2015 faq. 84
- 30. Paralele: Nga proselitizimi katolik, tek prishja e shen Thanasit ortodoks.**  
02.09.2015 faq. 87.
- 31. Mesazhet e pjekurise greke**  
22.09.2015 faq. 92.

- 32. Arrestimi i Spiro Kserës, drejtësia e munguar dhe përkatesia etnike e tij**  
31.01.2016 faq. 94.
- 33. Përkthim-Μετάφραση** faq. 95
- 34. E keqja, kjo vlerë morale e kohës...**  
20.02.2016 faq. 99.
- 35. Mosperputhje konceptesh në interesa të përbashkëta në marrëdhëniet dypaleshe**  
27.03.2016 faq. 102
- 36. Përkthim-Μετάφραση** faq. 104.
- 37. Kapja e përfaqësuesve politikë të minoritetit grek dhe identiteti i tij etnik i rrezikuar.**  
08.05.2016 faq. 108
- 38. Përkthim-Μετάφραση** faq. 110.
- 39. N. Kotzias në Tiranë i bindur se për marrëdhëniet dypalëshe nuk ka kthim prapa.**  
04.06.2016 faq. 114
- 40. Përkthim-Μετάφραση** faq. 116.
- 41. Kongresi i PBDNj-së, që të përfitojë politikisht vetëm Dule.**  
04.07.2016 faq. 119
- 42. Lëximi ndryshe i axhendës shqiptare për marrëdhëniet me Greqinë**  
17.10.2016/18.10.2016 faq. 122.
- 43. Përkthim-Μετάφραση** faq. 124
- 44. Ligji për Minoritetet Kombëtare, -moment historik, apo propagandë sterile.**  
20.11.2016 faq. 128.
- 45. Rama dhe gjuha e kadifenjtë e Erdoganit te Merkel.**  
29.11.2016/30.11.2016 faq. 131.
- 46. Heqja e flamurit grek nga një mjedis familjar dhe domëthenia e trishtë politike.**  
05.12.2016 faq. 134.
- 47. Sulmi i ulët ndaj Kodhelit dhe nëvoja për më shumë maturi**  
09.12.2016 faq. 136.
- 48. Rra Shkullaku për më u pa, apo me pa?!**  
19.01.2017 faq. 138

- 49. Perse nuk duhet toleruar “shqiponja” e ushtareve ne emer te politikës se dites**  
27.01.2017 faq. 140.
- 50. Ballafaqimi Llalla –Lu, provokon fenomenin e Hidrës së Mitologjisë**  
02.04.2017 faq. 143.
- 51. Antinomia e shtetit sot:-krizë informale apo krizë institucionale.**  
10.04.2017 faq. 145.
- 52. A po perpiqet LSI t’u dal zot demokrateve, per t’u marr voten me 18 Qershor?**  
12 05. 2017 [\\_\\_\\_\\_\\_](#) faq. 148.
- 53. Pse ndodhin dhe tolerohen me kaq lëhtësi sakrilegje ndaj kishës ortodokse?**  
06.07.2017 faq. 150.
- 54. Loja e keqe e lidërshpirt të OMONOIA-PBDNj-së në kurriz të minoritetit dhe të marrëdhënies Shqipëri Greqi.**  
29.08.2017 faq. 152.
- 55. Miti “Helen”, si alibi për baterdinë me pronat në Himarë dhe Bregdet.**  
02.09.2017 faq.155.
- 56. Përkthim-Μετάφραση** faq.158
- 57. Himara e tradhetuar përjeton zhbërjen e vet.**  
03.10.2017 faq. 162.
- 58. Çfarë ndodhi në takimet e Ditmir Bushatit në Janinë, Dervician dhe Dropull**  
06.11.2017 faq. 165.
- 59. PostKreta si verifikim i antialogut që imponon pseudoegoizmi nacionalist.**  
16.11.2017 faq. 168.
- 60. Përkthim-Μετάφραση** faq. 170.
- 61. Shtetësia shqiptare e Kryepeshkopit Anastas dhe fundi i alibisë për kundërvënien e jo ortodokseve ndaj ortodoksisë në Shqipëri.**  
26.12.2017 faq. 175.
- 62. Sa i vertet është sinqeriteti i Tiranës ne dialogun me Athinën**  
02.02.2018 faq. 178.
- 63. Marrëveshja me Greqinë/ Gabimi i detyruar i Ilir Metës**  
22.02.2018 faq. 181.

- 64. Ku po ngecin negociatat për detin me Greqinë dhe pse nuk konfirmohet vizita e Tsipras në Shqipëri?!**  
23.03.2018 \_\_\_\_\_ faq. 184.
- 65. Kriza turke dhe rishfaqja e njëkohshme në Evropë të “Krizës Lindore” dhe të “Semurit të Bosforit”**  
31.08.2018 faq. 187.
- 66. Fontet e fshehta të huaja në Shqipëri dhe retorika antigreke e bërtitngrenësve të tyre.**  
22.10.2018 faq. 190
- 67. Vrasja e K. Kaçifës dhe domëthenia e rrateve të frikës në Minoritetin Etnik Grek**  
13.11.2018 faq. 193.
- 68. Moslëjimi i pengmarrjës së Minoriteti Etnik Grek, përbën obligim prioritar për perspektivën perendimore të Shqipërisë.**  
LETËR PUBLIKE PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, ZOTIT ILIR META.  
04.12.2018 faq. 196.
- 69. Përkthim-Μετάφραση** faq. 199.
- 70. Po bëhet e vështirë ulja e tensioneve midis dy vendeve**  
07.12.2018 faq. 203.
- 71. Ngërçi i shpresës.**  
18.12.2018 faq. 206
- 72. Zgjidhja e krizes reale arrihet me fundin e krizes së sistemit politik dypartiak në vend.**  
16.03.2019 faq. 209.
- 73. Vonesa e perendimoreve në Tirane dhe nervozizmi dhe frika e politikanëve tanë.**  
07.04.2019. faq. 212
- 74. Heqja e tabelave dygjuheshe në Bashkinë Finiq, akt paprecedent në 70 vjetorin e Këshillit të Evropës.**  
05.05.2019 faq. 214.
- 75. Vendimi i presidentit dhe qëndrimi i kryeministrit ndërlikojnë dhe tellojnë krizën në vend**  
09.06.2019 faq.216.
- 76. Cikli i ri “i rrezikut helen” për detin dhe zhvillimet e brendshme politike dhe në rajon**  
02.09.2020 faq. 218

**77. Cenimi nga shumica i kontratës historike të bashkëjetesës me pakicën.**

17.01.2021

faq. 221.

**78. Angazhimi i mangët intelektual në lidhje me marrëdhëniet greko-shqiptare në Epir shtrëmbërojnë historinë dhe vrasin të ardhmën.**

07.02.2021

faq. 224

FUND

faq. 226.

**Nga Panajot Barka**

**Skandale në oborrin e PBDNJ-së kompromentojnë keq misionin e politik të lidhshëm të tij.**

02.02.2009/04.02.2009

Para disa javësh në parlamentin shqiptar plasi skandali i korrupsionit qeveritar me fondin për botimin e teksteve shkollore për shkollat e minoritetit etnik grek në gjuhën amtare. Rezultonte që strukturat përgjegjëse të kishin zhdukur në xhepat e tyre mbi 500 milion lekë.

Përpos problemit për korrupsion financiar u evidentua qartë një problem i rendë politik. Nuk rendonte aq mbi PD-në si parti kryesore qeverisëse, se sa mbi PBDNJ-shin si parti në koalicionin qeverisës. Kjo pasi PBDNJ-shi, që mori “ekskluzivitetin” e përfaqësimit politik të Minoritetit Grek në Shqipëri dhe e lidh misionin e vet politik me luftën për garantimin dhe respektimin e të drejtave të njëriut në përgjithësi dhe të minoritetit grek në veçanti, u bë mjeti kryesor për shkeljen e këtyre të drejtave në emër të korrupsionit qeveritar. Ky abuzim politik bëhet më skandaloz po të kemi parasysh faktin se bëhet fjalë për të drejtat arsimore të Minoritetit Grek në Shqipëri si e drejta më e pretenduar dhe më e evidente nga ky komunitet.

Atëherë paralajmëruam se skandale të tjera do të plasnin në oborrin e kësaj partie. Nuk zgjati shumë dhe para disa ditësh, plasi një skandal edhe më monstruoze. Ai është totalisht i papajtueshëm jo vetëm me misionin politik të deklaruar të kësaj partie, por as me parimet me elementare të një shoqërie minimalisht të civilizuar. Po ashtu përmasat antihumane të këtij skandali janë totalisht të papajtueshme me çdo lloj penalizimi nga ana e drejtësisë të përfaqësuesve përgjegjës të kësaj partie.

Fjala është për skandalin në Qendren Kombëtare të Femijve të Ngujuar në Poliçan. A ka dramë njëzore më të madhe se ajo e atyre 22 femijëve të grumbulluar në atë Qendër? Sigurisht që jo. Por përfaqësuesit e kësaj partie që drejtojnë Ministrinë e Punës, të Çështjeve Sociale dhe të Shansëve të Barabarta, si ministri përgjegjës për menaxhimin e kësaj Qendre, dhe drejtuesit e pushtetit lokal në Poliçan, po ashtu, përfaqësues të kësaj partie, përgjegjës për administrimin e saj, dramën e tyre e kthyen në më shumë se tragjedi. Shpresa e këtyre femijëve për të shijuar jetën në liri larg ngujimit, për të pasur pak me shumë bukë, për të pasur lodra, libra, shokë, shpresa për të shijuar femijërinë edhe pse larg prindërve, shpresa e këtyre femijëve, që nuk guxojnë as fytyrën për të ekspozuar në ekran, për shkak se mund të bëhen objekt i gjakësit të familjeve të tyre, u vra. U vra nga korrupsionistët e kësaj partie. Këta femijë, u rikthyen në kullat e ngujimit më të urritur, më të braktisur dhe shpresëvrarë. Jeta për ta tani më u identifikua me qëllimin për të vrarë gjakësin. Por në shtjekëzën e pushkës së tyre do të shfaqet vazhdimisht një gjakës tjetër. Shoqëria dhe shteti që i përjashtuan përfundimisht nga radhet e tyre. Dhe ata rrjedhimisht do të kenë vetëm një kënaqësi, - hakmarrjen vrasëse.

Do të mjaftonte aq që drejtuesit e kësaj partie të mirrinin një vendim për ta shkrirë atë. Do të mjaftonte aq që ligji i lustracionit për krimet e komunizmit të çvlerësohej.

Por ende pa u mbyllur ky skandal, (në fakt akoma s’u hap), plasi një skandal tjetër. Raporti i Bankës Botërore për projektin turistik të Jugut dhe bllokimi i tij, na nxorri lakuriq misionin e Bollanos në krye të Bashkisë së Himarës. Zbuloi thelbin e “nacionalizmit grek” dhe vertetësinë e “antishqiptarizmit” të tij. Mjafton të qendrojmë tek fakti i Jalës, perlës turistike në mrekullinë e Bregdetit. Në fillimverën e 2007ës, në Jalë u prishen 13 objekte private, shumica e të cilave me leje dhe të ndërtuara mbi troje



private larg vijës së ndaluar të bregut të detit. U prishen në emer të masterplanit turistik të Bankës Botërore. Në fakt që të ndërtohej një objekt tjetër, që sipas deklaratave në parlament, i takon një të afërmi të kryeministrit dhe s' ka asnjë lidhje me projektin e kësaj Banke. Në atë kohë, zëri i Bollanos në mbrojtje të interesave të ligjshme të Himariotëve në Jalë, disa prej të cileve me kombësi të deklaruar greke, u bë tëpër i hollë deri në mekje. Mirëpo po, në këtë periudhë grabitjesh të trojeve turistike në Bregdet, zëri i Bollanos u bë i trashë, duke artikuluar “parulla antishqiptare”. Opinioni medjatikë dhe ai publik në vend u muarr për një kohë të gjatë me këto bollanisma. Kjo gjë krijoi hapësirën dhe qetësinë e duhur që qeveritarë, politikanë, mafiozë dhe të afërm të tyre, të rrembënin fileton turistik të bregdetit. Pasi ky proces eci suksesshëm, Bollano shpalli mik të Himarës Berishën, ndërkohë që shteti i të cilit bën sikur i hap gjyqe dhe e ndjek penalisht “antishqiptarin” Bollano.

Formula e përdorur synonte më shumë neutralizimin e reagimeve të mundshme të Greqisë interesat e së cilës presupozohet në Tiranë se janë shumëplanëshe. Sznonte gjithashtu mundësinë për mbijetësë politike të klanit të Dule-Bollanos, pasi tanimë janë specializuar dhe provuar si të aftë për këto “marifete të thjeshta”

E vertetë është se në Athinë është artikuluar dhe po krijohet bindja se parullat “antisghqiptare” të Bollanos porositen nga vet Tirana. Megjithatë, shteti “amë” i Bollanos edhe pse nuk u muarr hapur me mbrojtjen e tij nga “nacionalizmi shqiptar” i cili, “duke sulmuar” Bollanon, kërkon të mohojë përkatësinë “etnike greke të Himarës”, nuk e braktisi atë. Ky qëndrim vjen nga presioni i një opinioni, përpunuesit e të cilit në Athinë janë disa himarjotë. Ata, janë parë në Himarë, ta zemë në raste zgjedhjesh, kanë hedhur nga ndonjë shashkë nacionaliste greke dhe janë kthyer në Greqi. Ndërkohë strukturat kopetente të shtetit shqiptar i shpallin në kërkim pasi janë siguruar se e kanë kaluar kufirin shendoshë e mirë. Njëkohësisht japin sinjalin që të ndizen të gjitha motoret antigreke.

Po e mbyllim këtë shkrim duke perseritur të njëjtën deklaratë. Skandale të tjera edhe me të rënda e presin oborrin e PBDNJ-së. Askush të mos kujtojë se këto skandale lidhen me ligjin e lustracionit, zbatimi i të cilit mund të ngërthejë kupolen politike të kësaj partie.

Skandali politik i radhës lidhet me vendimin e pritshëm të Dulës për t'u larguar nga koalicioni i Berishës për të kaluar me atë të Ramës. Vonesa në shpalljen e një vendimi të tillë nuk lidhet me nevojën e thirrjes së kongresit për të marrë vendimin organi kolegjal. (Thirrja e Kongresit të PBDNJ-së aty nga marsi është një truk i Dulës për të shkarkuar përgjegjësinë e turpit nga vetja). Vonesa e thirrjes së Kongresit lidhet me kohën që u duhet disa segmenteve me etiketën e interesave greke (që kanë përfitime të majme se operojnë në emrin e minoritetit etnik grek në Shqipëri), për t'u bindur plotësisht se kush do t'i fitojë zgjedhjet. Nga kjo varret edhe qëndrimi i “kongresit” të Dulës. “Partinë përfaqësuese të minoritetit” segmentet e sipërpermendura e duan në qeveri se kështu i kanë krahët me të sigurta. Por kjo i intereson edhe Dulës, pasi pa qenë në qeveri, “partia e tij” bëhet shkumb e hi.

02.02.2009. Δημοσίευτηκε στη GAZETA Shqiptare και Tema στις 04.02.2009

## **Nga Panajot Barka**

### **Një artikull analizë stilistike për fjalimin e E Ramës**

27.06.2009

Nuk e di sesa mijrat e pjesëmarrësëve në mitingun përmbyllës të së premtës të socialistëve në Tiranë dhe ata qindra e mijra të tjerë dashamirës e kuriozë të liderit të PS-së Edi Rama nga ekrani i vogël, arritën të receptonin dhe të deshifronin fjalimin e tij në këtë miting. Gjithkush mund të priste që Edi Rama të fliste para pasuesve të tij me një frymë populiste dhe ndjellëse të entuziazmit tek “turma” dhe që në vijim të pranonte rrymën e saj ta terhiqte pas vetës në një dalldysje shpërthyesë pa kuptim.

Jo! Edi Rama nuk ndoqi këtë rrugë edhe pse të provuar kaq herë si rezultative nga kundërshtarë të tij politikë, apo paradržës politikë në partinë që udhëheq.

Edhe në këtë drejtim mendoj se ai solli risinë e tij. Së pari ai nuk i trajtoi pjesëmarrësit në miting si turmë impresionin politik. Së dyti. Në fjalimin e tij në një miting të supërpopulluar arriti të gërshetojë, retorikën, filozofinë politike, të programit politikë dhe opozitës ndaj kundërshtarit, populizmin elegant dhe bashkëbisedimin e thjeshtë, si dhe batutën shpotitese duke i prirë show-t. Gjithëçka mbi një shtrat letrar metonimik dhe të drejtpërdrejtë. Gjithëçka të vendosur në një arkitekturë të thjeshtë dhe të zgjedhur me kujdes brenda logjikës së mitingut që mbartte mesazhin e fitorës si fakt të kryer.

Edi Rama zgjodhi të fliste i vetëm mbi një skenë të stërmadhe me bashkëpunorë të vendosur mbrapa dhe në të dy krahët e saj. Nuk bëhet fjalë për mishërim të kultit personal, as të mbinjëriut, por të evidentimit të rolit të individit në përpjekje për të stigmatizuar një ndryshim historik. Kjo nuk është një shpikje e Edi Ramës por një rikonfirmim i përvojës qindravjeçare në kulturën popullore, në filozofi, në shkencë, politikë, arte, në strategji luftarake, në ndryshime sistemesh shoqërore, në reforma ekonomike, në farketime ideologjish e deri në sisteme teologjike etj.

Vet ai, për të eliminuar pikërisht këtë shije kultesh, theksoi duke iu referuar jo pa qellim një fjalëje të urtë popullore. “Nëse do të arrish shpejt diku, nisu vetëm. Nëse do të arrish larg, nisu së bashku me të tjerët”.

Kjo risi e Ramës ka një domethenie filozofike që përjashton absolutisht domosdoshmerinë e “unit” gjithëbërës. Në evidentimin e këtij përjashtimi peshën kryesore e zë vota. Rama i kërkon votuesit shqiptar ta përdorë votën “si një të drejtë për të nderuar faqen e historisë” dhe jo thjeshtë qeverinë. Në radhë të dytë, në konceptin e Ramës, vlera e votës nuk mund të shnderrohet në një detyrim të imponuar nga politika dhe në shërbim të saj, por në një e drejtë që nuk ezaurohet tek momenti i votimit, por në të gjithë kohëzgjatjen e ndryshimit. Në këtë kendveshtrim të Ramës “momenti i votës” së 28 qershorit 2009 u mbron fituesve të vertetë fitoren dhe nuk lëjon që ajo të kthehet në humbje për ta dhe në fitore për humbësit si deri më sot. Kjo është vota që lëjon votuesin të marrë politikën nga dora drejt qellimeve shoqërisht të përcaktuara dhe jo vota që lëjon politikën të shpërfill vullnetin e votuesit.

Kjo përcakton nga ana tjetër thelbin filozofik të projektit politik të Ramës. Ai është konceptuar që në fillim si një ndryshim gjithpërfshirës. Në aspektin politik u përvijua si ndryshim pertej së majtës dhe së djathtës. Në aspektin shoqëror si një e drejtë mirëqenjeje dhe mbrothesie për çdo shtetas shqiptar pa dallime ideologjie moshe e profesioni etnie. Kjo e drejtë sipas tij nuk fshihet pas aftësive personale të unit të tij apo të grupit udhëheqës, por buron nga begatia që perendia i fali këtij vendi dhe politika e deritanishme e shpërfytyron për interesa mesquine. Në aspektin individual konstatohet të aftësia e shqiptarit për të shpalosur vlera të barasvlefshme me fqinjët dhe evropianet

si arsimdashës e si punëtor, në zgjuarsia, intelekt etj. Në aspektin kombëtar fokusohet si një ndryshim historik në emer të së drejtës për t'u integruar në familjen natyrore evropiane.

Për ta bërë sa më qenësishëm mesazhin e tij filozofik të këtij ndryshimi historik, e mbivendos atë në struktura me elementë biblikë që mbartin besim dhe shpresë. Por në qendër të tyre nuk dallohet fryma e shenjtë, por atdheu dhe energjitë e njëzëzve të thjeshtë venë në shërbim të tij .

Një elementë tjetër është transmetimi i mesazhit të fitorës nëpërmjet lojës me kohën. Fjalimi i tij nis pa pershendetjet rutine, por me kohën që ndan momentin e fjalimit me momentin e arritjes së qellimit të ndryshimit, ditës së votimit. Këtë moment Rama e quan historik realizuar përmes votës. Po sipas tij, kjo do të ishte e pamjaftueshme për vertetimin e tezës së tij “të ndryshimit historik”. Në dy-tre paragrafet e para na thotë se nevoja për këtë ndryshim buron nga vet thelbi i realitetit dhe nevojës për egzistencë dinjitoze të secilit nga ne, të konstatuar për një kohë të gjatë para momentit zgjedhor. Në vijim e vendos të njëjtin “monent” –zgjedhjet e 28 qershorit, në kohën e shkuar, si fakt të kryer. E bën këtë duke folur në emër të votuesve, në vetën e parë njëzëz, por në kohën e shkuar. Është një mjet gjuhësor dhe stilistik shumë efikas që evidenton se votuesit me votën e tyre janë bërë pjesë e këtij ndryshimi, evidenton të drejtën e tyre për tu krenuar për kontributin me votën e ndryshimit. Njëkohësisht këtë e bën edhe për të shpalosur pikat thelbësore të programit politik të Partisë Socialiste që pritet të realizojë nga pozitat qeverisëse. Por edhe për ta ballafaquar këtë program me politikën e vjetër dhe për të treguar me gisht shkaktarët e mizerabilitetit ekonomik, shoqëror, politik, kulturor, arsimor në vend.

I ndergjegjshëm deri në fund se momenti i votimit përbën vetëm të drejtën e startit për të realizuar ndryshimin, në fjalimin e tij, “braktis” menjëherë metoniminë retorike të kohës së shkuar. Zgjedh në vijim kohën e tashme të së ardhmës (pas momentit të votimit). E bën këtë për të qenë më i drejtpërdrejtë në kumtimet e tij se ndryshimi historik i pretenduar nuk është gjë e thjeshtë që vjen në mënyrë magjike, por një “betejë”, “jo midis shqiptareve të majtë dhe të djathtë”, por e vet Shqipërisë me plagët e saj.

Elementi stilistik i perseritjës në numërimin e këtyre plagëve, nuk është thjeshtë një nevojë për të ruajtur ritmin nëpërmjet përdorimit të fjalive të shkurtëra që të garanton ky stil, por oratori e përdorë për të shkallëzuar mendimin në lidhje me gjerësinë e punëve në projektin e ndryshimit historik.

Vijimësia më këtë stil edhe në pjesën e fundit të fjalimit i jep oratorit mundësinë për të prezantuar peshën dhe rrezikun që paraqet faktori (i quajtur nga oratori kryeplak të politikës së vjetër) që ndërmjeteson në orët e mbetuara deri në hedhjen, sigurimin dhe numurimin e votës që garanton nga ana e vet të drejtën për të startuar në këtë vizion ndryshimi.

Do të ishte e logjikshme që oratori në këtë pjesë të fliste për shpresën dhe besimin për fitorën në zgjedhjet e 28 qershorit. Nuk e bën këtë por flet për një shpresën e një fitoreje tjetër. Atë të ndryshimit historik të pretenduar. Kështu fitorja e zgjedhjeve për oratorin i perket faktit të kryer, i përket së shkuarës.

Dhe për të mos e trembur votuesin e tij për punët e mëdha që e presin, e fton atë në ritmin e muzikës dhe të show-t të drejtuar nga ai vet. Edhe kjo ka vlerën e vet. Tregon se Ai posedon energjitë e duhura për arritjen e qellimit historik, se mjafton besimi dhe vullneti për të arritur të gjithë së bashku aq larg sa kërkon ndryshimi historik.

Dr. Panajot Barka

Për M. Bazën Gaz TEMA 27.06.2009

## **Nga Panajot Barka**

### **Profili politik në Shqipëri pas zgjedhjeve të 28 qërshorit**

23.07.2009

#### **a. Mesazhet e Perendimit dhe realiteti politik shqiptar.**

Mesazhet e fundit të përfaqësuesve të BE-së dhe SHBA-së në Shqipëri drejtuar Kolegjit Zgjedhor, treguan edhe një herë vendosmerinë e Perendimit për rendësinë e zgjedhjeve të 28 Qershorit. Vertetojnë se ato përshkohen nga deformime që duhen rregulluar dhe se procesi duhet përfunduar sa më shpejt që të përvijohet në vend një qeveri legjitime. Këto “direktaiva” duhen zbatuar konkretisht nese është e vertetë aspirata e deklaruar e politikës shqiptare për t’u bërë pjesë e Evropës. Faktori ndërkombëtar, tregon gjithashtu se në kërkesat e tij kërkon edhe aleatë të brendshëm, siç janë institucionet legjitime dhe votuesi shqiptar.

Realiteti politik shqiptar tregon tjetër gjë. Vendin kryesor e zë aplikimi i teorisë së faktit të kryer dhe spostimi i vemendjes nga testi bazë dhe elementar i Demokracisë që janë zgjedhjet, te ngjarje të dorës së dytë. Nuk bëhet fjalë për rastësi. Janë veprime të mirëprovuara të atij grupi njërezish që kontrollojnë paketën e jetës politike në vend në periudhën e tranzicionit. Hapësira që shfrytëzohet në mënyrë abuzive ose hipokrite fillon tek performanca civile e shoqërisë tonë dhe mbaron tek marrëdhëniet me faktorin ndërkombëtar. Qëllimi po aq i qartë, ruatja e paprekur e integritetit të këtij grupimi në raport me jetën politike në vend.

Teoria e faktit të kryer u vu re tek nxitimi për të shpallur kualicionin e ri qeverisës. (Këtij akti i parapriu mobilizimi i të gjitha mjetëve, sidomos i medjas për “të argumentuar” pse është i pamundur bashkëpunimi i LSI-së me Ramën dhe pse ishte e mundur shartesa me Berishën). Së dyti me funksionimin e qeverisë elektorale dhe post elektorale si një qeveri që ka marrë mandatin parlamentar. Së treti, me “nxjerrjen” e dhëmbëve në bazë ndaj kundërshtarëve humbës.

Ndërsa si ngjarje të dyta drejt të cilave po spostohet vemendja politike po përmendim përjashtimim nga e drejta për të lëvizur pa viza në Evropë, duhet apo nuk duhet të japë dorëheqjen Rama etj. Siç e thamë nuk bëhet fjalë për rastësi.

#### **b. Zgjedhjet, lehtësimi i vizave dhe performanca civile e shoqërisë tonë**

E para, vendimi i BE-së për të na lenë pas Serbisë në çështjen e lehtësimit të vizave përfshin brenda vetës aspiratën pragmatiste të shqiptarit të thjeshtë për integrimin e vendit në BE. Perendimi, i afërt ose i largët, në të gjitha nivelet e artikuloi qart. Rasti për liberalizimin e vizave u humb se në zgjedhjet edhe kësaj radhe u shkelen standartet. Dhe logjika vazhdon po me kaq thjeshtësi. Është e vertetë se votuesi i thjeshtë shqiptar e kreu misionin e vet. Votoi pa “eksese”. Por misioni i tij për Perendimin nuk mbaron këtu, pasi votuesi shqiptar lëjon administratorin e votës së tij t’i ndryshojë verdiktin. Është kjo arsyeja që kryeministri i zgjedhjeve Sali Berisha nxitoi të shkepus këtë vendim të BE-së, i cili cenon edhe shpresat apo interesat e votuesve dhe pasuesve të tij më të zjarrtë, nga standarti i zgjedhjeve.

Por, BE-ja bashkë me shuplakën që i jep politikës, i kumton edhe shoqërisë shqiptare se i duhen ato institucione dhe ajo infrastrukturë që të pengojë politikën të manipulojë deri edhe rezultatin e zgjedhjeve. Pra, Perendimi kërkon tek shoqëria shqiptare, aleatin e brendshëm për fatin e zgjedhjeve të tij (!!!)

Megjithatë, kjo, sado e rëndësishme që të jetë (dhe është jashtëzakonisht shumë), është me më pak rreziqe se sa përpjekja e kësaj pakete kontrolluese të jetës politike në vend për të eliminuar faktorin tjetër politik (në rolin e opozitës ose jo, në rastin tonë të PS-së) dhe determinizimin e pluralizmit shqiptar nga interesat e ca pokërxhinjve politikë.

Aq më keq pasi kodi i ri elektoral provokoi një sistem politik bipartiak në vend duke provuar atë që dihej se shumë parti të vogla politike ishin fiktive.

### **c. Dorëheqja e kërkuar e Ramës dhe institucionet e pluralizmit shqiptar**

E gjithë kjo lidhet me faktorin e dytë, me dorëheqjen e Ramës. Sipas analizës tonë, nuk është fjala për dorëheqjen e një politikani, por për një institucion me rendësi, nga i cili varen pasojat që do të riciklojnë krizën e tranzicionit për një kohë edhe më të gjatë se ajo që shkoi.

Ç' do të thotë kërkesa për dorëheqjen e Ramës ? Pse kjo kërkesë vjen më së shumti dhe më me intensitet nga faktorë jashtë PS-së? Pse kjo kërkesë ekclipsoi totalisht kërkesën për qartësi dhe transparencë të procesit zgjedhor? Përse, sipas perendimorëve, politika abuzon me pushtetin e vet për të penguar këtë transparencë? Përse kjo kërkesë nxiton dhe nuk pret të dalë rezultati përfundimtar i zgjedhjeve? Përse...???

Realizimi i kësaj kërkesë do të thotë: Institucionalizimin e rezultatit të dëshiruar dhe jo faktik zgjedhor. Detyrimin e faktorit ndërkombëtar të “vë re” parregullsi në standarte demokratike por t’i pranojë zgjedhjet. Për më shumë do të thotë riinstitucionalizimin, si të pazëvendësueshëm, të apo atyre faktorëve që përgjatë këtyre 20 vjetëve bënin sikur ziheshin në publik dhe për interesat e tyre të vogla mirreshin vesh në prapaskenë dhe në çdo rast e shpërbënin këtë vend, madje edhe kur ia kishin njëri- tjetrit me të ngesur. Pas dorëheqjes së Ramës, llogaritet që PS të mirret totalisht me veten. Kështu do të hynte në ciklin e shpërbërjes së vet të mëtejshëm, (të nisur nga Meta). Forca politike e PS-së në parlament do të reflektonte interesat dhe rymat të pushtetshme jashtë partisë, apo frymën e varësisë dhe “të meritës” politike nga persona konkretë. Pra, do të kemi eliminim të opozitës reale dhe një pakufi pushteti prej qeverisë se re, heqjen e mundësisë së PS-së për të marrë pushtetin edhe në të ardhmëm, kontrollin e PS-së nga e njëjta paketë kontrolluese e politikës në vend.

Në Shqipëri, janë të tepërtat analizat për këto fenomene. Kjo pasi si historia e largët partiake në vend, para monizmit dhe gjatë tij ashtu edhe ajo pluraliste post komuniste, është tepër pasur me eliminime politike dhe e dhimbshme për nga mënyra e realizimit. Këtë përvojë e përjetoi edhe PD-ja në periudhën 1996-1999. Mbijetoi se lideri i saj S. Berisha, me të mirat dhe të këqijat e veta, jo vetëm që e shpetoi atë nga shpërbërja, por shumë shpejt e ktheu serish në pushtet.

### **d. Berisha, Meta, Nano dhe dorëheqja e Ramës**

Nga ana tjetër secili nga ata që mund t’i quajmë tani për tani eksponentet e paketës kontrolluese të jetës politike në vend kanë arsyet e tyre personale për të kërkuar dhe dëshiruar dorëheqjen e Ramës.

Dihen arsyet përse e kërkon Berisha. Do të mund të formojë qeveri, do të qeverisë me duar të lira dhe këmbë të forta. Do të sigurojë qeverisjen edhe për një mandat tjetër, kësaj here pa Metën. (të cilën, nese Rama jep dorëheqjen mund ta detyrojë të largohet nga kualicioni. Mund të mos i duhet më se ka shokët e Nanos të mbetur në PS)

E do pa tjetër edhe Meta. Ai e di dhe praktika e ka provuar zvogëlimin deri në zhdukje të partive të vogla në kualicione të tilla qeverisese, aq me keq me ngjijtje të sforcuar e që pa filluar shkaktoi reagime të ashpra dhe përçarje në gjirin e vet dhe në të gjitha nivelet. Meta është i ndërgjegjshëm se perspektiva është akoma më e zymtë me një PS të fortë.

Pavarësisht se pa kujtesë votuesi i majtë shqiptar nuk harron se më 2005 ai ishte faktori determinant i dukshëm që i dha pushtetin Berishës. E rikuperoi imazhin politik me 2007. Bashkëpunimi me PS-në i dha të majtës fitorën në zgjedhje lokale. Por pa kaluar shumë kohë Meta e kaloi forcën e vet politike në pushtetin vendor në shërbim të PD-së. Tani i mashtroi serish. Por votuesi është si Perendia që fal kur duhet dhe mund të

vonojë por nuk harron (kur të denon). Dhe PS-ja me Ramën nuk mund të bëhet porti i strehimit të tij nga stuhitë e pritshme.

E do dhe Nanua. Vertet që ka shumë arsye politike personale të kërkojë tatëpjetën e Ramës. Por kërkesa e tij shikohet edhe si një shërbim i ri ndaj Berishës për ta bërë atë President. Nga ky pozicion të kontrollojë pastaj edhe PS-në. (Në Shqipëri ky model presidenti ka treguar se është personalisht më efektiv se modeli Moisiu apo i Topit). Pastaj Nanua e njeh mirë Berishën. Në të gjitha marrëveshjet politike që benë midis tyre që nga viti 1992 (dhe nuk janë pak) rallë ka përfituar prej tyre Nanua. Kështu që kjo kërkesë, veç arsyeve të përbashkëta, është një kusht, qoftë edhe i pathënë, për ambicjet e Nanos.

#### **e. Kryetari i PS-së E.Rama në raport me pluralizmin shqiptar.**

Në aspektin e politikës globale dhe pluraliste në vend pozicioni dhe roli institucional i Ramës si kryetar i Partisë më të madhe në vend, në këto momente është i pazëvendësueshëm dhe i patjetërsueshëm. Ai nuk mund të gjykohet tani për gabimet. Atij duhet t'i jipet mbështetja e duhur për të ruajtur baraspeshën e pluralizmit në vend. Në aspektin politik personal, pozicioni i tij është dramatik. Duhet të mbajë personalisht mbi vete betejën për të vertetën e zgjedhjeve. (Duket se edhe bashkëpunëtorë të tij në çeshtje taktike zgjedhore, po e lenë, ose se duan të shpetojnë kokën, ose shpresojnë se PS-së do t'i vijë një kokë e re). Atij po i ngarkojnë peshën e humbjës, (jo pa qellim dhe pa dashakeqje). Brenda partisë delfinët me nxitim të komanduar nga faktorë ekstra partiakë, hapen kacakët e pasionëve të fshehura për të marrë frenat e PS-së. (Ndoshta kështu mund të shpjegohet dhe gëzimi i heshtur i tyre për humbjen e mundshme të Ramës në zgjedhje, apo dhe rezultatet e tyre zgjedhore të ulta). Ka për të përballuar, faktorë të stërkonsumuar dhe të dalë mode në PS, të mënjeluar prej tij, ose të vetpërrjashtuar, të cilët shpresojnë se u erdhi serish ora. Ka për të përballuar, aleatët e koalicionit që humbjen e tyre duan t'ja faturojnë Ramës. Ka për të përballuar koalicionin qeverisës si pjesë e dukshme e paketës kontrolluese të politikës shqiptare dhe pjesën e skemës së tyre që nuk duket akoma por, po ndihet e përvijuar qartë dhe duket se mos dorëheqja e Ramës (kur pritej e shpejt) po e zbulon, e pengon dhe e prish atë. Ka për të përballuar zhgënjimin dhjetra mijra votuesve që e besuan atë me shpresën e ndryshimit dhe tani do të vuajnë edhe ekspozimin e peshës së tyre.

#### **f. Dorëheqja e Ramës e palejueshme edhe sikur vet ta kërkonte.**

Në këto rrethana, i mirë apo i keq, Ramës nuk i lëjohet dorëheqja. Nuk është e justifikueshme as në planin individual. (Në këtë aspekt dorëheqja për të do të ishte shumë komode). Dorëheqja vertet është një çeshtje e moralit të brendshëm të çdo faktori. Por gjithmonë në raport të drejtë me mënyrën e funksionimit të jetës politike në vend. Nuk mundet që kur gjithë rruga është me gropa, të fajësohet makina që s'ecen. Kjo ka vlerë edhe në rastet kur shprehet në mënyrë taksative rregullatori statutor i një forumi apo partie. Dihet vertet se në PS është i njohur institucioni i dorëheqjes, i "aplikuar me sukses" nga Nano. Po, por Nanua jipte dorëheqjen ose si një mundësi shlyerjeje të fajit për t'u rikthyer dhe për të bërë të njëjtin faj por me mënyra të tjera (rasti i shtatorit 1998) ose për të arritur personalisht një ambicje tjetër politike (Rasti i 2005-s që i dha mundësi Berishës për të marrë pushtetin në këmbim të postit të presidentit).

Nga ana tjetër një analizë më e gjerë dhe më gjakftohte na thotë se pavarësisht nga humbja e PS-së, (ende e pa vertetuar) e cila i faturohet Ramës për shkak të evidentimit të individualitetit të vet në zgjedhje, në këtë proces ai ka merita dhe vlera të cilat PS-ja i kishte të domosdoshme.

Së pari. Rama e nxorri PS-në nga makthi i ndërgegjës së vet politike se ajo nuk mund ta marrë pushtetin (veçanërisht kur e ka Berisha), pa ia dhenë të tjerët, por mund ta

dorëzojë edhe kur ia vjedhin edhe kur ia shesin për interesat të karrierës private. (PD-ja, përjashto 1992-shin, i humbi të gjitha zgjedhjet dhe e mbajti pushtetin me shumë se e majta, që i fitoi realisht ato)

Së dyti. Ai ndërmori një fushatë në të cilën u mëshoi idealeve. Nuk e di sa të qartë e kishte se kundërshtarë në këtë betejë do të kishte jo vetëm pushtetin e Berishës, por edhe mentalitetin e intersaxhinjve të politikës meskine dhe të ryshfexhinjve banalë që shesin interesat e forcës politike që përfaqësojnë për 100 Evro.

Së treti. Kjo ishte situata që garantonte një jumbje shumë të thellë. Flasin për këto dy fakte. Berisha, përdori për fitorën e tij të njëjtën taktikë si më 2005, por më të sofistikuar. P.sh. PD-ja, si më 2005, ashtu edhe në 2007 (zgjedhje lokale) “korri” fitore në fshat dhe humbi në qytete. Që do të thotë se fshatari shqiptar është i djathtë (!) dhe qytetari shqiptar i majtë (!). Realisht duhet lexuar se fshati ishte me pak i kontrolluar ndaj manipulimeve dhe se fshatari (praktik nga natyra) pranoi ato pesë para në dorë, (sa ishte çmimi i caktuar i votës së tij) se sa premtimin e Ramës për vezë të arta.

Po ashtu, në këto zgjedhje pati një rritje të pjesëmarrjes në votim në masën 8-10 %. Logjika elektorale kërkon që këto vota të shkojnë për opozitën dhe jo për qeverinë e cila sido që të jetë ka një konsum politik që sjell reagimin e kundërt, pra të mos pjesëmarrjes. Në këto zgjedhje ndodhi e kundërta. (!?)

#### **g. Një konkluzion**

Ajo që duhet të bëjë tani PS-ja është të mbrojë të vertetën e zgjedhjeve, të mbrojë zgjedhësit e vet nga abuzimi partiak i pushtetit qeverisës, të bëjë analizat e zgjedhjeve, të ngrejë strukturat partiake si një gërshtetim të jetës tradicionale të PS-së me frymën e re perednimore dhe të synojë marrjen e pushtetit. Ndryshe do të jetë një opozitë rakitike me apo pa Ramën.

P. Barka për gazeta shqiptare. 21.07.2009 (u botua tek TEMA me 23.07.2009)

## **Nga Panajot Barka**

### **Vjedhja e votës, strukturim i krimit**

09.09.2009

Medjat komentuan si “dorashkë e hedhur” ndaj Ramës deklaratën e Berishës në ditën e parë të legjislaturës së re të parlamentit, se “Opozita le ta zgjedh si të dojë ligjin elektoral...”

Në fakt kjo deklaratë nuk ka asnjë lidhje me Ramën. Se ai nuk kërkoi ndryshimin e ligjit elektoral. Atë e kërkoi Meta, i cili tanimë nuk është në Opozitë. Tezën se “fajin” për humbjen e zgjedhjeve e ka ligji elektoral, i cili u propozua nga PS-ja në Opozitë në mandatin e shkuar, e përdorën disa kundërshtarë të Ramës, satelitë të Nanos në PS, i cili beson se nëpërmjet Berishës do të plotësojë ambicjet e veta politike. As qëllimi i aksionit politik i Ramës nuk lidhet thjeshtë me pozicionin politik (në pozitë apo në opozitë) të Partisë së tij. Aq me keq me shpëtimin e avenirit personal politik. Ai ka të bëjë me verifikimin e së vertetës së institucionit të votës si themeli i demokracisë dhe i shtetit ligjor.

Nuk e mohojmë se deklarata e Berishës përbën sfidë. Por jo ndaj Ramës. Ajo është një sfidë për të gjithë:- individë votues të thjeshtë, institucione, faktorë të brendshëm e të jashtëm etj.

Në këtë kontekst Berisha tha: Bëni çfarë të doni, hartoni e aplikoni, cilindo infrastrukturë zgjedhore në Shqipëri. Votoni si të doni. Unë do t’i fitojë zgjedhjet sa herë të dua!!

Nisur tani nga ky kendveshtrim vetoja e PS-së për pjesëmarrje në punimet e Parlamentit pas realizimit të tetë kushteve të saj, fiton një domëthenie shumë të madhe për realitetin politik, historik e aktual në vend. Behet fjalë për një realitet të semurë rendë, i cili vuan dhe është kthyer në pre i mosrepektimit të parimeve elementare të formimit të një shoqërie civile dhe të një shteti, nga abuzimi deri në krim politik më të drejtën dhe të vertetën. Argumenti i mjaftueshëm për këtë realitet është sentenca “Luksi i tëpruar (i politikanëve tanë) përbën shprehjen më të pamohueshme të fajit”. Në këtë rast koha e maskarenjve po ligjerohet si e gjithëkohshme, me pasojë Shqipëria s’ka për t’u bërë kurrë e shqiptarëve

Kjo do të thotë se sfida e vertetë e Berishës ndaj Ramës do të qe: “Po, unë pranoj që të dalë e verteta e votës së sovranit në sallën e parlamentit”. Kjo për shkak se në 20 vjet pluralizëm u bën 12 palë zgjedhje dhe asnjëherë nuk u bënë të qeta, të pranuar nga të gjitha palët, nuk u bënë një palë zgjedhje pa imcidente e pa gjak. Nuk u numëruan një herë votat pa u vjedhur. Ndaj edhe vlerësimi i perendimorëve se nga një palë zgjedhje tek tjetra po bëhen përparime, e humbi masën e vlerës, madje edhe si stimul për të ecur vertetë përpara.

Lë të ndodhë precedenti. Të rinumërohen votat. Edhe në SHBA kur u desh e bënë. Ndoshta do t’i jipet fund këtij marifeti të vjedhjes së votës. Kush ka frikë nga një proces transparence të akuzuar?!

Përfundimisht, si për çdo gjë tjetër, duhet të ndodhë hera e parë që për këtë gjë kaq rëndësishëm. Të dalë e verteta e votës deri në fund dhe secili të mbajë përgjegjësitë e veta.

Ku mund të shkohet kështu. Cila shoqëri mund të jetojë (dhe sa mund të jetojë) me përbaltjen e fajit, me hijen e dyshimit dhe me pikëmbeshtetje pranimin kolektiv të krimit, ose lenien jetim të tij.

Fakti që Berisha nuk pranon sfidën e Ramës, tregon se ai nuk është i gatshëm të pranojë sfidën e së vertetës. Në këtë pikë kemi arritur nivelin e vitit 97’, që thirrem ushtritë e Evropës për të ngritur nga rrenoajat tona shtetin tonë.



Mbi këtë themel faji, po ngrihet dhe legjitimohet godina e superstrukturës së shtetit dhe të marrëdhënieve antishtet me qytetarin e thjeshtë. Kjo godinë kërkon njëriç që krimin, në të gjitha format e shfaqjes së tij, ta demonstrojnë si vlerë.

Lë të bejmë për këtë një paralelizëm të thjeshtë dhe disa konstatime. Ditën që Ministri i Turizmit në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dha dorëheqjen për shkak të aksidentit të rëndë me turistët bullgarë të ndodhur në Ohër, (pavarësisht se nuk kishte asnjë faj) Kryeministri shqiptar emëronte në detyrë ministri, një ish ministër të akuzuar drejtpërdrejt për krimin e Gerdecit me 26 viktima, qindra të plagosur e deme të pallogaritshme materiale....!!!

Vitet e fundit përherë e më shumë politika kërkon të legjitimojë mbeshtetjen e saj tek shkelësit e ligjit. Për këtë flet fakti i ligjit të legalizimit të ndërtimeve të paligjshme; provat për amnisti fiskale, ose zbatimi i heshtur për mbështetësit e mi politikë; thirrja e kryeministrit së fundmi në Himarë, për mbeshtetjen e turizmit elitare në Jon në inisiativën e turizmit familjar duke zgjeruar në mënyrë të (pa) ligjshme ndërtimet private. (Kjo pasi për shkaqe të abuzimeve të rrethit të tij u pezullua masterplani turistik i B.Botërore për këtë rajon. Kjo të kujton vitin 94-95, kur kryeministri ftonte veriorët drejt detit dhe shqiptarët të kultivonin bimë “industriale” me vlerë të madhe ekonomike.)

Flet shqetësimi i Perendimit se krimi i organizuar po kaplon politikën zyrtare; se parat e pista që rrjedhin nga veprimtaria e tij mbajnë në këmbë një ekonomi informale në vend, (që për këtë shkak kjo ekonomi nuk “do t’ja dijë për krizën botërore”); se në duart e krimit të organizuar po grumbullohet e gjithë pasuria kombëtare; se qytetarët e thjeshtë të këtij vendi e ndjejnë vetën të përjashtuar nga e drejta e të qenit pjesëmarrës dhe nënshtetas të shtetit.

Ky realitet e quan të drejtë të ligjshme vrasjen e votës. Ky realitet pra imponon në mënyrë urgjente rehabilitimin institucional të sovranitetit të votës në raport me pushtetin. Institucioni i votës, si baza e shtetit të së drejtës, tek ne nuk u instalua dhe në çdo palë ugjedhjesh, kërkohen forma më të sofistikuara për ta shkatërruar atë keq e mos më keq. Situata është më emergjente se sa thirrja unanime e politikës në 97’ drejtuar ushtrive Evropiane për të ndihmuar në ringritjen e shtetit.

Mirëpo, në vend që Rama të ishte komod në kërkesen e tij për rehabilitimin e sovranitetit të votës, ai po vuan shigjetimin e realitetit. Si aleatë të fortë ka të paktën heshtjen e Parendimorëve, të cilët, (me heshtjen e tyre), kësaj here nuk e panë si antidemokratike e as si bojkot të parlamentit veton e PS-së. Këtë aleancë e vuri re edhe Berisha, ndaj sulmoi me populizëm qendrimin e PS-së. (Do të pengojë për interesa personale liberalizimin e vizave, -tha zëdhënësja e PD-së)

Shigjetimi i Ramës nuk lidhet fare me gabimet e tij. (Në çdo kohë, kur një individ nga pozitë e liderit synon në qëllime dhe aspirata të larta shoqërore, politike, kulturore, shkencore, ekonomike, gabimet e tij sado të mëdha harrohen. Një shoqëri e civilizuar nuk pret që këtë ta bëjë historia).

Jo, ai ndodhen nën peshën e klimës së ligjerimit dhe institucionalizimit të së paligjshmës. Po provohet forca e saj reale. Brenda dhe jashtë PS-së po synohet që aspirata për institucionin e votës të çvlerësohet. (Drejtimin e PS-së mund ta bejnë, -tha njëri nga kundërshtarët e Ramës brenda partisë, mund ta bejnë njëmijë nga njëmijë e pesëqind delegatë të Kongresit të jashtëzakonshëm të fundgushtit të saj).

Jashtë partisë, në rrethe medjatiske apo dhe opinionbërëse, flitet për iracionalizëm dhe profanizëm në emër të shpëtimit politikë të vetës. Po evidentohet një ngutje e individeve të kësaj kategorie për t’i shërbyer pushtetit de fakto që të përfitojnë, personalisht prej tij. Shembull tipik Ilir Meta. Të tjerë pas tij nuk kanë arritur dot këtë nivel papaturpësie dhe nga që nuk mund të lavderojnë Berishën (se do të jenë shumë të pabesueshëm) po

kritikojnë Ramën. Kështu që peshën klimës të së paligjshmës e vuajnë zgjedhësit e thjeshtë që pas kësaj humbasin edhe të drejtën për të punuar e jetuar.

Po vihemi në pozitat e fisit që duhet ta kesh mirë me kryetarin e fisit për të arritur qellimin tend. Politikanë, gazetarë, intelektualë, njerëz të thjeshtë, po mblidhen kruspull me kurriz të kthyer andej nga fryn era e pushtetit. Po shnderohen në një shkallinë të gatshme për t'u shërbyer kryetarëve të fisit – shtet.

Dr. Panajot Barka 09 SHTATOR 2009

## **Nga Panajot Barka**

### **Pushteti politik në Tiranë percakton krahun e fortë drejtues në OMONIA!**

28.09.2009

Përplasjet e ditëve të fundit midis grupeve rivale në lidrëshipin e OMONIA-s vertetoi edhe një herë se kjo organizatë e përfaqësimit politik të minoritetit etnik grek në Shqipëri është kthyer në mjet përfitimi personal të grupeve të caktuara, përfitim ky që realizohet duke u shërbyer interesave të pushtetit politik në Tiranë. Pra, Ky lidrëship nuk ka më asnjë lidhje me minoritetin etnik grek dhe problemet reale të tij në raport me të drejtat etnike dhe të njeriut. Këto të drejta janë thjeshtë mjete të pazarit të tyre politik dhe ekonomik, duke shenuar në histori rastin më të keq të nxjerrjes së tyre në pazar me një çmim kaq banal.

Konvencioni është i thjeshtë. Tirana kërkon kontrollin e veprimit politik në minoritet për hesap shtetëror. (Shteti shqiptar, pavarësisht se në realitetin e përditshëm dhe në bibliografinë zyrtare dhe jo zyrtare ky minoritet paraqitet i vogël dhe i parendësishëm, njeh shumë mirë se përbën një çështje me historinë e vet në krijimin e hartës së Ballkanit që në fillim të shekullit të kaluar dhe si i tillë mund të fitojë terren politik dhe gjeostrategjik edhe në ditet e sotme me zhvillime politike e etnike në rajon).

Kontrollin mbi minoritetin etnik grek, Tirana e kërkon edhe si hesap shtetëror dhe politikë në marrëdhënie me Greqinë. Çdo forcë politike në Shqipëri, pavarësisht se e shpreh apo nuk e shpreh, e ka një sy dhe një vesh ballafaques të veprimeve të veta politike me shtetin helen. Minoriteti si i tillë, sipas Tiranës, përbën rregullatorin ose katalizatorin në këtë ballafaqim.

Përplasjet e fundit treguan pra, se krahu i lidrëshit në OMONIA që është i lidhur me pushtetin politik të Tiranës, bëhet automatikisht i fortë. Fiton të gjitha betejat elektorale në minoritet dhe revanshet për kontrollin e paketës udhëheqëse në OMONIA.

Përplasjet, treguan gjithashtu se që pas zgjedhjeve të 28 Qërshorit kemi kristalizimi i një krahu të ri politik në minoritet. Fjala është për krahun e djathtë, ose të Partisë në pushtet në vend. Dhe përplasjet erdhen nga që përfaqësuesit e këtij krahu tentojnë të kontrollojnë edhe paketën udhëheqëse të OMONIA-s. Kjo për ta përbën një domosdoshmëri mbijetese politike në PD. Përndryshe, po të mos kenë mbi vete etiketën e përfaqësuesit të minoritetit, misioni dhe aderimi i tyre në një forcë politike, qoftë edhe qeverisese, do të ishte i pavlerë. Dihet se këta edhe pse me integritet politik dhe intelektual që vlen shumë për të dëshiruar, gëzojnë një privilegj kaq të madh në tortën e pushtetit politik, vetëm se pretendojnë rolin e përfaqësuesit të këtij minoriteti.

Krijimi i këtij krahu solli një risi të re politike në minoritet dhe rigrupimin e forcave në të. Dallimi i parë lidhet me krahun egzistues të së majtës.

Krahu i majtë politik në Shqipëri në dhe jo në pushtet, kishte ndikimin e vet në minoritet. Kishte edhe përfaqësuesin politik të këtij minoriteti në parlament. Dallimi qendron në faktin se raportet me pushtetin e të majtëve minoriteti i realizonte nëpërmjet PBDNJ-së, duke lenë vazhdimisht përkrahësit e së majtës në të, në opozitë. Kjo situatë kishte rritur së tepërmi kondradiktat dhe përçarjet në minoritet. OMONIA dhe PBDNJ-shi, për të ruajtur peshën e vet politike këtu abuzuan me ekskluzivitetin e përfaqësimit etnik të minoritetit. Për këtë ratifikuan parimin e pashkruar se kushdo që i përkiste idelogjikisht një partie tjetër politike shqiptare, nuk mund të ishte anëtar i OMONIA-s. Dmth, i mohoj edhe përkatësia etnike. Nuk mund të ishte grek. Pra, deri para 28 Qërshorit në minoritet kishim grupimin e majtë që ishte jashtë radhëve të OMONIA-s

–PBDNJ-së dhe kundërshtar i egër i tyre. Egzistonte edhe grupimin e OMONIA-s-PBDNJ-së, që konsiderohej i djathtë.

Pas 28 Qërshorit kemi tre grupime midis anëtarëve të thjeshtë të minoriteti. Të majtë tradicional dhe të përcaktuar qartë. Grupimin e dytë e përbëjnë omonistët (dhe përkrahësit e PBDNJ-s). Grupimi i tretë është ai i krijuar rishtazi dhe përfshin votuesit ose përkrahësit e së djathtës ose më konkretisht të Partisë Demokratike. Në planin e përfaqësimit politik kemi dy grupime. Krahun e djathtë të krijuar nga Partia Demokratike dhe krahun e majtë. Në krahun e majtë kemi një afrim dhe një konvergim të kundërshtarëve tradicional në minoritet (bëhet fjalë për dyshen Dule-Tavo). Ky afrim mbahet i fshehtë për momentin. Arsyeja është se publikimi i tij mund të provokojë reagimin në të dy kampet kundërshtarë të përkrahësve të tyre. Krahu i Tavos nuk ftohet në OMONIA-n e kontrolluar formalisht nga Dulja-Bollano. Përveç arsyeve që sapo përmendem, kjo nuk ndodh edhe për një shkak tjetër. Do të shërbente si precedent edhe për krahun e djathtë. Që do të thotë se do të kërkonin të mos respektohej edhe për ta parimi i ratifikuar prej tyre, që kush aderon në një parti tjetër shqiptare, (veç PBDNJ-s) nuk mund të jetë në OMONIA.

Në qarqet e ndryshme në minoritet qarkullon lajmi se afrimin e Tavos me Dulen e kërkoi Rama. Me argument këtë aleancë Dulja të mos i bashkohet Berishës në qeveri. Kjo nuk është bindese, për arsye se lind pyetja. Po Dulen çfarë gjë e shyu që të kapërdijë gjithë atë lumë sharjesh e akuzash ndaj Tavos për tradhëti etnike e të gjej një gjuhë të përbashkët me të. Nga ana tjetër dihet se Dulja nuk shkon me Berishën jo se pret PASOK-un që të vij në pushtet, porse në qeverinë e PD-së nuk do të ndaj ai tortën e pushtetit politik që i përket minoritetit, por kundërshtarët e tij të rinj nga radhet e OMONIA-s dhe PBDNJ-së, (dikur grushti i hekurt kundër kundërshtarëve të vet në gjirin e minoritetit), që iu bashkëngjiten në mënyrë të pavarur PD-së. Pra Dulja nuk mund të pranojë një rol boshti në qeverinë e Berishës

Nëse Berisha do të kishte mundësi që edhe për Dulen të kishte një pjesë torte nga pushteti i vet, pa ngjallur reaksion në vet PD-në, Dulja do të ikë me sy mbyllur nga Rama e Tavo. (Në fakt ky është As-i që Berisha mban në mëngë, nëse Meta një ditë do të fillojë të hedh vickla.)

Pra edhe rasti i afrimit të Tavos me Dulen nuk lidhen me reformimin e klimës pajtuese dhe bashkëpunese në minoritet por me interesa politike klanore në të, që përcaktohen nga raportet me partitë e pushtetit në vend.

Nga ana tjetër vihet re edhe një fenomen që nuk mund të anashkalohej. Veshtirësitë në rritje të Tiranës për të ruajtur ekulibrat midis klanëve në lidhshpër përfaqësues në minoritet.

Dihe se të gjithë krahët politike në minoritet e kuptojnë vet dhe kanë të hapur dritën jeshile nga Tirana se para se të stabilizohet qeveria e re në Greqi, e cila nuk do të jetë e Demokracisë së re, ata duhet të kenë zgjidhur problemin e lidhshpër. Pra OMONIA të ketë një kokë të re të dalë nga një “proces zgjedhor”. Të aplikohet edhe një herë teoria e faktit të kryer me synim që politika e jashtme greke të vendos marrëdhënie me “lidhshpër që do të dalë fitues” nga ky proces. Mirëpo kjo do të rikrijojë një rreth të ri vicioz kontradiktash dhe përplasjesh se kush do të zë kreun. Psh. Grupi i njëzëve të Berishës në OMONIA, që u mblodhën në Sarandë, nuk paraqiten një platformë politike të OMONIA-s për të garantuar të drejtat e minoritetit, por iu referuan këtyre të drejtave për të hequr qafe Dule dhe Bollanon. Bollano-s iu kërkua dorëheqja. (faktikisht mandati i tij ka mbaruar dhe është i paligjshëm). Pozicioni i Bollanos është tregues i trandafililit të kontradiktave të reja në këtë lidhshpër. Bollano dihet që është njeriu i Berishës, por në këto momente mban anën e Dulës. Kështu që është një rast i mirë për ta hequr qafe, në emër të zëvendësisimit të tij nga një delfin i ri i djathtë Berishjan. Ky

ultimatum mund të jetë edhe një mjet presioni ndaj Bollanos që ai të saktësuar pozicionin e tij. Me këtë argument duhet të lidhet edhe thirrja ndaj Dulës për të dorëzuar mandatin e deputetit. Pra, rrethi vicioz i përplasjeve do të fitojë edhe një harkë me shumë me luftën midis grupimit të Berishës për të zenë kreun e OMONIA-s. Ky hark do të jetë i hapur edhe për grupet e tjera në minoritet që tani për tani rrinë larg këtij qerthulli. Nuk mund të priten gjera të tjera. Ata që gatuan për minoritetin një çorbë të prishur, nuk mund të jenë edhe garantët epaqës dhe të përparimit të tij. Pavarësisht nga aroganca e fituar dhe prepotenca kërcenuese ndaj anëtarëve të thjeshtë të minoriteti, ata kanë kohë që kanë nënshkruar fundin e tyre. Kjo situatë e fundme e karrierës së tyre, i bën më të egër e më të rrezikshëm.

P. Barka 28.09.2009

**Nga. P Barka**

## **Meta në pushtet: amoraliteti politik makjavelist**

11.10.2009

Kalimi i ditëve në pushtet nga ana e Ilir Metës evidenton më së miri se kompleksi i inferioritetit ndaj Ramës, (i shprehur si pamundësi për të qenë ai drejtues i partisë më të madhe politike në vend- i PS-së), po shndërrohet tek ai në kompleks faji që po e shkatërron moralisht e politikisht (i shprehur si vullnet për t'u hakmarrë ndaj Ramës nëpërmjet pushtetit politik duke sakrifikuar çdo gjë në emër të legjitimitimit të votës së vjedhur). Arritja në këtë stad i marrëdhënjeve Rama- Meta kaloi nga bashkëpunimi i Metës me Ramën, (bashkëpunimi që Meta e braktisi se pa që fuqizonte politikisht Ramën në krye të PS-së dhe e largonte nga endrra e tij për këtë post) në bashkëpunimin e Metës me Berishën për ta hequr Ramën nga kreu i PS-së. (Pasojë e parë për Metën ishte shkatërrimi i partisë së tij, në vijim po shkruhet falimentimi i tij politik).

Definicioni i tij politik si patericë e pushtetit të Berishës, jo thjesht po e depersonalizon, por edhe po e kthen në një mjet të lirë të përdorur nga kryeministri i tij. Kjo është fatkeqësia e tij e madhe. Ai iu bashkua në koalicionin qeveriformues të PD-së, në emër të një pakice kontrolluese të pushtetit të Berishës. Në fakt ka filluar të vjell pasojat e çorbës së prishur të pushtetit që i dha Berisha.

Në këtë kontekst duhet parë edhe dalja publike e Ilir Metës ditën e shtunë, pak orë para fillimit të mitingut popullor në kërkim të votës së vjedhur, organizuar nga PS-ja dhe aleatët e vet. U duk qartë se ishte në rolin e grevëthyesit të paguar. Në deklaratën e tij kundërshtar në këtë dalje ( “protestat provojnë egzistencën e demokracisë” dhe “protestat janë absurde dhe paradoksale”), tregoi se Meta ka marrë rolin e bishtit të Berishës, për të eliminuar demokracinë, ose për të fshehur dhe të paraqitur si demokratike krimin politik kundër themelit të demokracisë siç ishte vullneti i votës.

Nga i njëjti pozicion Meta tentoi t'i jap një vazhdimësi deklaratave të një dite më parë të shefit të tij, për pranimin gjoja, të kushteve të opozitës, por që na fakt ishin një joshje banale dhe sigurisht e papranueshme nga aleanca e PS-së. Të dy, si Berisha dhe Meta, e kuptuan se mitingu i opozitës në Tiranë dhe përmasat e tij madhështore do të ishin guri i provës për ndryshimin e qëndrimit edhe të Perendimit ndaj kësaj çështjeje. Pas këtij mitingu, është e sigurt që Perendimi nuk do të flas më me gjysëm zëri dhe nga pozita pritese, por do të shprehet më hapur në favor të kërkesave të PS-së dhe aleateve të saj. Pra Berisha, gjeti tek Meta figurën më bindese në mbrojtje të atyre që thotë ai. (Po provojnë se mids tyre ata janë një duet komplementar me shef Berishën). Nga ana tjetër ky është një tregues për njërezit e Berishës. Duket se nuk janë fort entusiast, si në lidhje me situatën e krijuar nga lloji i fitorës ashtu edhe me pjesën e pushtetit që Meta u hoqi nga hesapet e tyre.

Në deklaratat e tij të së shtunës Meta na serviri parimin e tij të ri, si pjesë të kompleksit të fajit që perjeton. Meta, i cili pretendonte se ndërtonte individualitetin e vet politik duke patur si themel konsekuencën dhe egzigjencën në moralin politik, vertetoi se thelbi i identitetit të tij politik është amoraliteti politik makjavelist. –arritja me çdo çmim e mjet i pushtetit personal politik.

Deklarata e tij e së shtunës ngjante si dy pika uji me humorin e njohur popullor të hajdutit. Sipas Metës pra, fajin nuk e ka hajduti që vodhi lopën (Berisha që vodhi votat), por i zoti që e lidhi lopën në livadh. (Lexo populli që votoi sipas një kodi zgjedhor të caktuar të propozuar nga Rama). Fajin e ka sistemi apo hajduti. Aq më keq kur po ky Meta tentoi të mbante edhe në këtë çështje flamurin e protestës kundër vjedhësve të

votës. Meta, para se t'i propozonin krevatin e pushtetit të Berishës, bënte be e rrufe për sakrificë sublimë në mbrojtje të votës së lirë. Tani na del në mbrojtje të hajdutit duke i thenë të zotit të votës fajin e ke vet.

Ky parim është tani pjesë integrale e parimit që lidhet me moralin politik të demonstruar nga Meta mënjherë pas zgjedhjeve. Ai ngriti figurën e tij politike në opozitë si një antiberishist në ekstrem që kishte lenë totalisht në hije vet Ramën. Fitoi votat e të majtëve duke u mbështetur pikërisht në demaskimin ekstrem të qeverisjes së keqe korruptive e kriminale të PD-së dhe në fund kur PD-ja nuk fitoi dot atë shumicë qeverisëse, u fut në shtratin e Berishës për t'i dhënë kenaqësinë e pjelljes së qeverisë që kemi edhe nuk kemi.

Meta kërkoi ta shiste lekurën shtrenjtë në favor të Berishës, por edhe në arritjen e eliminimit nga kreu i PS-së të Ramës. Ai ishte i bindur se prania e tij në koalicionin qeverisës të Berishës do t'i jipte fund çdo lloj dileme apo dyshimi për vertetësinë e rezultatit të zgjedhjeve. Nxitimi për konstituimin e rezultatit zgjedhur u pasua me mobilizim spektakolar për t'i zenë shtigjet e reagimit të partive fituese, por të mbetura në opozitë. Një kohësisht u shtuan përpjekjet për të krijuar bindjen se çdo gjë pas kësaj nuk ndryshon më. Institucione shtetërore, medja, elementë të faktorit ndërkombëtar u bënë pjesë e këtij inskenimi. Po krijohet një rrymë përshtatjeje me pushtetin e Berishës. Dhe kjo, bashkë me luftën e brendshme në PS , dukej se përbënte një garanci për mbylljen e ciklit politik të Ramës.

Rezistenca shumëplanëshe e nisur nga Rama me pikë referimi mbrojtjen e vertetësisë së votës, filloi të shkaktojë shqetësim tek poli i Berishës mbështetur nga Meta e Nano, ose poli anti-Rama. Po ashtu, rezistenca e Ramës filloi të çvlerësonte dalëngadalë kostot ekonomike në rritje të këtij poli për eliminimin politik të shefit të opozitës. Fjala është për përpjekje për të krijuar një ambient mbytës ndaj Ramës nga faktori i brendshëm medjatik dhe jo medjatik dhe për të shkëputur ndonjë deklaratë detyruese për Ramën për të marrë pjesë në parlament.

Mitingu i së shtunës ishte gongu që njoftoi fillimin e fundit të kësaj përpjekjeje. Shpresat duket se nuk mund të ushqehen as nga shkëputja e mundshme e ndonjë grupi deputetesh të PS-së për të hyrë në parlament. Në këto momente ata e kuptojnë se ky do të ishte një vetflijm për interesa të të tretëve dhe të Berishës.

Qëndresa aktive në rritje e PS-së dhe e aleatëve në mbrojtje të votës së lirë, përbën në fakt një investim politik shumëplanësh të udhëheqësit të saj, Ramës. Është shumëplanësh për arsye se nuk u lëjua shëmbja e pritshme e PS-së, me rrugë demokratike i rikonfirmua kreu i saj, po zgjohet shpirti i qendrës kolektive dhe i shoqërisë civile, po evidentohet roli i faktorit të brendshëm në raport me atë të jashtëm, po i jipet fund ciklit të pafund të zgjedhjeve të vjedhura, të manipuluar dhe të diskutueshme. Nga ana tjetër Rama po krijon bindje dhe dalëngadalë po ia del që këtë qendresë ta kthejë në pjesë integrale të shoqërisë së emancipuar shqiptare, si pjesë të ideologjisë së vet politike pertej së majtës dhe së djathtës.

Ky investim politik vjen pas investimeve të tjera politike të Ramës siç ishte sfida e kryeqytetit, krijimi i një profili të ri udhëheqësi politik me takime në çdo cep të vendit duke përcjellë mesazhe të çlirimit të shtetit dhe të pushtetit politik nga sklaveria e pushtetit partiak dhe të ndryshimit të raportit të individit me shtetin dhe pushtetin politik.

I gjithë ky realitet në planin e njëshave politikë është një sfidë e papranueshme, por edhe një evidentim të qartë të kompleksit të inferioritetit të polit anti-Rama.

Ilir Meta është më i ekspozuari në këtë pol. Për këtë arsye ai jo vetëm që e vuan më shumë por, siç e thamë, për të shpetuar nga ky kompleks, u bë pjesë e fajit politik për

legjitimimin e votës së vjedhur. Këtë situatë po e përjeton tani si një kompleks faji shpetimi nga i cili ka vetëm një rrugë, por që është pa krye. Të shkojë nga faji në faj.

Gaz. Tema 11.10.2009.



## **Nga Panajot Barka**

### **Në Gjirokastrë identiteti etnik përcakton vendimet e një gjyqtari**

26.11.2009

Ditët e fundit në Gjykatën e rrethit gjyqësor Gjirokastrë, gjyqtari GUXIM BOÇI, solli edhe një argument me bindës se ligji dhe drejtësia janë pronë e njerëzve që kanë për detyrë të mbrojnë ligjshmerinë dhe të egzekutojnë drejtësinë dhe se këto dy elementë të garantimit të barazisë së individeve në një shoqëri janë mjete këmbimi në favor të interesave private të gjyqtarëve të këtij kallepi. Nga ana tjetër vertetoi se rrethi i njerëzve të fuqishëm të urbanistikës që i shkaktuan edhe Gjirokastrës goditjen fatale në ndërtim, janë të paprekshëm. Po ashtu frika se mos çeshtje të tilla zbulojnë këtë makabritet në aktivitetin e personave konkretë që abuzojnë me detyrën e shtetit, është e evidente. Si të tilla ato po kthehen në vertetim të vlerësimit popullor se mbulimi i tyre ka një kosto të lartë ekonomike, ose kthehen në një formë të rishperndarjes në rrethin e drejtësisë të fitimit të paligjshëm dhe abuziv.

Me 17.11.2009 ky gjyqtar dha vendimin në lidhje me një çeshtje penale, në ngarkim të disa të pandehurve, punonjës në sektorin publik dhe privatë të sferës së urbanistikës, për falsifikim të dokumentave dhe shpërdorim detyre. Midis tyre pergjegjësi i zyrës Urbanistike të Bashkisë, Gjirokastrë, ish pergjegjësi i zyrës Urbanistike të Këshillit të Qarkur, ish Kryetari i policisë ndërtimore, dega Gjirokastrë, ish drejtori i hipotekës, po të Gjirokastrës etj.

Një pjesë prej tyre ishin të pandehur edhe për çeshtjen e pallatit të rrezuar në nëntorin e vitit 2008, ku humben jetën tre persona. Siç dihet gjykata i nxorri „të pafajshëm“.

Gjyqtari Guxim Boçi dha edhe në këtë çeshtje pafajësi si për ta ashtu edhe për bashkëtpandehur të tjerë. I vetmi që mori denim në këtë çeshtje nga gjyqtari Boçi ishte një minoritar grek.

Thelbi i çeshtjes për të cilën gjykoheshin të lartpërmendurit ka të bëjë me faktin se njëri nga të pandehurit ka ndërtuar në Gjirokastrë një objekt pa leje ndërtimi, pra të kundërligjshëm. Nëpërmjet fallsifikimit të dikumentave dhe shpërdorimit të detyrës nga personat publik i pandehuri ka arritur dhe ka hipotekuar një pjesë të objektit. Jo vetëm kaq por objektit iu dha leje shfrytëzimi kur ishte i papërfunduar dhe kur në të vazhduan edhe pas hipotekimit ndërtime të paligjshme. Vertetimi i kësaj shtetërore. Së pari nga institucioni i Avokatit të Popullit, i cili i rekomandoi prokurorisë Gjirokastrë fillimin e çeshtjes penale, së dyti nga policia ndërtimore në Tiranë, sot, Inspektoriati Kombëtar Urbanistik, së treti nga medja, (me çeshtjen u mor dy herë emisioni Fiks Fare) dhe së fundi nga prokuroria e rrethit Gjirokastrë e cila nisi çeshtjen penale dhe në fund të gjykimit kërkoi denimin e të pandehurve me burgim nga disa muaj deri në një vit si dhe gjoba të ndryshme.

Me çeshtjen tanimë të gjykuar janë njohur të gjitha nivelet administrative e politike në vend, Presidenti i Republikës, Kryeministri, ministrat përkatës, organizmat ndërkombëtare etj si e tillë përbënte një test për autoritetin e drejtësisë.

Por ndodhi totalisht e kundërta. Faji mbeti jetim

Gjatë gjykimit

1. U vu dukshëm re dhe mund të konstatohet lehtësisht se objektin e kësaj çeshtjeje e përbënte një ndërtim i kundraligjshëm, pa leje ndërtimi, i cili nuk u prish si i tillë, por u hipotekua pasnjë seri falsifikimesh e manipulimesh të dokumentave shtetërore. Ndërtimi i objektit të kundraligjshëm ishte pasojë e veprimit apo mosveprimit të

institucioneve publike e shtetërore në favor të shkelësve të ligjit. **Mëgjithatë në vendimin e saj gjykata nuk gjeti asnjë fajtor.**

2. Në procesin e gjykimit të çeshtjës, gjyqtari G. Boçi ka abuzuar me një nen të K.Pr.Penale dhe e ndau çeshtjen në dy pjesë, pa marrë parasysh faktin se nga ky veprim u demtua vertetimi i fakteve, pasi të pandehurit kanë vepruar në grup, si pjesë të një zinxiri.

Ndarrja e çeshtjes u bë me qellim nga gjykatesi. Ai nuk mund të mirrte përsipër çlirimin nga faji të të gjithë të pandehurve. Shpetimi nga faji i atyre në mbrojtje të tij mund të behej më lehtë duke demtuar pikërisht procesin e vertetimit të fakteve në gjykim. Kjo u arrit me përjashtimin nga procesi të një pjese të bashkëpunëtorëve në falsifikim dokumentash dhe në shpërdorim të detyrës shtetërore. Fakti që një apo disa të pandehur të një grupi të pandehurish të njëjës çeshtje, thirren si deshmitar në çeshtjen e dnarë prej saj dhe jo si të baraspandehur verteton më së miri këtë.

3. Gjyqtari G. Boçi për të marrë një vendim pafajësie për grupin e tij të të pandehurve abuzoi shumë rëndë me faktin nëse kishte apo jo leje ndërtimi objekti i ndërtuar dhe i hipotekuar. Kjo është një çeshtje tjetër manipulimi e falsifikimi ku vet gjyqtari G. Boçi është pjesëmarrës.

Në vitin 2001 pronari i objektit, i pandehur në këtë çeshtje, kishte ndërtuar pa leje ndërtimi dhe në bazë të një projekti totalisht të ndryshuar nga ai i parashikuar nga KRRt i Bashkisë për atë shesh ndërtimi, konstruktin e tre katëve të para. Në atë kohë, iu drejtua KRRt-së së bashkisë me kërkesën për shtesë kati. Në vendimin e KRRt-së çuditërisht shenohet leje ndërtimi (e re) për një pallat 5-kate+dyqane. (Projekti i ligjshëm parashikonte shtëpi banimi me dy kate.) Duke konstatuar këto shkelje dy kryetarë bashkish radhazi nuk pranuan zbardhjen e vendimit në fjalë të KRRt-së. Pra nga pikëpamja juridike vendimi nuk është i vlefshëm. (Kemi precedentin të cilit iu referua kryeministri Berisha për të prishur mbikalimin e Zogut të Zi në Kryeqytet). Pas pesë vjetesh, më 2006, gjyqtari G Boçi, në kundërshtim me ligjin merr një vendim gjyqësor për të detyruar Bashkinë të zbardh këtë vendim. Gjykata e Apelit e rrezoi vendimin e tij si të paligjshëm.

Me të njëjta pretendime dhe manipulime, të shprehura në vendimin e tij të datës 17.11.2009, gjyqtari Boçi mundohet t'i shpetojë nga faji të pandehurit në mbrojtje të tij.

Psh. Për të shmangur fajin e kolaudatoreve që e kryen atë pa dokumentin bazë, siç është leja e ndërtimit, gjyqtari “arsyeton” se ata kryen kolaudimin pasi de fakto pronari e kishte lejen e ndërtimit për objektin e tij. Dhe nuk merr parasysh faktin se në dosjen e kolaudimit, të Lej[ës së shfrytëzimit të objektit dhe në hipotekë është leja e falsifikuar e një objekti tjetër.

Në vijim, për të shpetuar nga përgjegjësia Përgjegjesin e Zyrës Urbanistike që ia përcolli dosjen KRRt – së për dhënien e lejës së Shfrytëzimit të objektit, Gjyqtari e merr të mirëqenë dhe të ligjshëm aktin e kolaudimit. KRRt shmanget nga përgjegjësia e mungesës së lejës së ndërtimit në dosje se kështu ia përcolli Zyra e Urbanistikës. Zyra e hipotekës, nuk mban përgjegjësi pasi dosja “ i erdhi e puthitur” nga Bashkia e kështu me radhë.

Ndërsa për të shpetuar një kategori tjetër të pandehurish siç është rasti i ish kryetarit të Policisë Ndërtimore të Gjirokastrës, gjyqtari nuk merr parasysh as rekomandimin e Avokatit të Popullit, as urdhëresat e eprorëve ndaj këtij të pandehuri e as ligjin, për mosveprim të dukshëm dhe të papërligjur në marrjen e vendimeve përfundimtare në lidhje me këtë objekt të paligjshëm. Mjaftohet thjesht në deklaratat e të pandehurit.

Evident mbetet fakti se dhënia e pafajësisë ndaj të pandehurve buron edhe nga fakti se kallzimin penal në prokurori për këtë çeshtje e bë nga ana ime, pas një investigimi të

gjatë dhe i motivuar nga fakti se nga ky ndërtim isha i demtuar i drejtpërdrejtë. Në këtë plan gjyqtari mësa duket u bë palë më e dukshme me të pandehurit të cilët në mënyrë provokative kërkonin të mos denoheshin ata se me denimin e tyre fitonte një minoritar grek, ose “një horofillaj grek” siç kishin qejf ata të me karakterizonin.

Për këtë flet edhe fakti se i vetmi nga të pandehurit që mori denim nga ky trup gjykues në këtë çështje, ishte po një minoritar grek.(!!)

Së fundi dua të theksoj se organet shtetërore që mbikqyrin drejtësinë, ishin paralajmeruar për një proces të kompromentuar sa pa filluar. Përgjigja e dhënë ishte se ligji nuk lëjon monitorimin e procesëve gjyqësore. Veçse në përfundim të procesit gjyqësor, palët osë të interesuarit mund të ankohen. Presim reagimine tyre  
Panajot Barka për gazetën TEMA. Nga. P Barka 26.11.2009

**Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2012/06/28/intervista-kriza-greke-e-pesuan-me-shume-shqiptaret/>

<https://www.shqiperia.com/Kriza-greke-e-pesuan-me-shume-shqiptaret.17054/>

## **Kriza greke e pesuan me shume shqiptaret**

### **Intervistë tek JAVA dhe TEMA**

20.06.2012/23-24.06.2012

#### **1-Zgjedhjet e fundit në Greqi kanë treguar se fqinjët tanë u treguan shumë të matur dhe të dëshiruar për të ardhmen evropiane. Mendoni se pjesa më e keqe e skenarit jashtë euros të Greqisë është kaluar?**

##### **Pergjigje**

Personalisht nuk kam besuar e as besoj se çështja “kriza greke” lidhet thjesht dhe vetëm me problemin e qëndrimit ose jo të saj në Eurozonë. Ajo është pjesa më e prekshme dhe me pasoja të dukshme në sektorin jetik të ekonomisë. Por nuk është thelbi. Thelbin e përbëjnë disa faktorë të tjerë që lidhen me Greqinë, por nuk janë thjeshtë greke. Pjesa greke lidhet me faktin se klasa politike e Greqisë së pas juntës ushtarake dobësoi shtetin në progresion aritmetik. E bëri këtë për interesa të ngushta partiake. Në shërbim të tyre pasuroi në mënyrë informale shtetasin grek. Në këtë pasurim pjesën e progresionit gjeometrik e kishte vet politikani dhe përfaqësuesi i shtetit. E gjithë kjo u arrit duke abuzuar maksimalisht me donacionet e Evropës, por me dijeninë e saj të qëllimshme. U arrit duke shmangur dhe mënjanuar shpirtin e shoqërisë civile greke, shtresën e intelektualeve. Fatkeqësisht, me shpërthimin e krizës, ky shtet gati në gjunjëzim tentoi të mirrte me vete qytetarin e thjeshtë, nëpunësin që shiti votën për një vend pune, bujkun që besoi në mrekullinë e pafund të donacioneve, (duke i besuar kësaj endrre ai preu mbi një milion ulla-qëllimi të fitojnë të tjerë t’i shesin vaj ulliri Greqisë), pronarin e vogël e të mesëm, por jo shtresën e pasur.

Përsa i perket pjesës jo greke nuk duhet harruar se brenda Bashkimit Evropian Gjermania, apo edhe ndonjë shtet tjetër, tenton një kontroll absolut ekonomik të vendeve të BE-s. Në rastin e Greqisë u shfaq si përpjekje për ta blerë atë pasi më parë t’i ketë çvlerësuar aksionet.

Por, pozicioni gjeostrategjik i Greqisë në raport me hartën politike të BE është i tillë që nuk lëjon ekuivoke se ajo mund të goditet nga vet Bashkimi Evropian. Largimi i Greqisë presupozon një zgjerim të vrimës gjeostrategjike në kufirin e Evropës së Bashkuar që do të thotë kercenim për vet atë. Greqia zotëron tri dete dhe zemren e Mesdheut. Më thjesht, kur BE-ja, në emer të zvogëlimit të kësaj vrimë gjeostrategjike në Ballkan kërkon të bëj pjesë të vet politike vende të tilla si Serbia, Shkupi, Mali i Zi, Kosova, kuptohet në krye të tyre Shqipërinë, nuk mund të leshojë në humnerë Greqinë. Aq me tepër kur ekulibret në rajon kanë ndryshuar. Fuqia e Ruisë është rritur dhe tregon praktikisht se rasti i Greqisë është një preferencë e dorës së parë. Nga ana tjetër Moska nuk mund të pranojë lehtësisht zgjerimin politik të Evropës dhe të NATO-s si sfidë të dyfishtë në oborrin e saj.

Dy dhjetëvjeçarët e fundit kanë treguar gjithashtu se brenda mirëkuptimit të shfaqur midis SHBA-s dhe BE-s, në këtë rajon, midis tyre kishte një rivalitet të fuqishëm.

Në këtë kendveshtrim, me këto zgjedhje, duket se loja greke arriti kulmin e vet dhe tani duhet të fillojë, zbatika, lëvizja në kahun e duhur. Greqia rezistoi dhe rezistoi perseri në emër të ekulibrave me të qenësishme të rajonit me të gjerë dhe të vet egzistencës politike të BE-së.

## **2. Pyetje: Duke e pranuar analizën tuaj, ju besoni se kjo është meritë e popullit grek apo e klasës s tij politike.**

Unë besoj se populli grek, i cili ra nga parajsja kallpe në një shtrengim rripi të paparë, më në fund u zgjua. Ngjarjet treguan se kishte nevojë për një orientim patriotik. Intuita e tij diakronike me burim të panderprerë që nga lashtësia e artë, kërkonte të bënte pjesë të patriotizmit të tij një ideologji të qartë e adekuate me nevojën e shpëtimit të Greqisë. Por, kur pas klapisë hapi sytë, u vu përballë me dritat verbuese të një nacionalizmi të rremë.

Një pjesë e konsiderueshme e tij u drejtua kah forcave që ose abuzojnë me patriotizmin grek, ose programi i tyre politik nuk shquhet për një ideologji që të shpreh patriotizmin e njohur grek nëpër shekuj dhe njëkohësisht t'u përgjigjej kushteve konkrete greke. Si.Ri.Za u përkrah pas premtimit se nuk do të njihte kushtet Evropiane që vertet cfiliten popullin grek. Por, deklaroi se kurrsesi nuk pranon të bëhej qeveri. Pra, se nuk kishte zgjidhje shpetimi qeverisese për popullin grek. U rrit mbi zemërimin e tij pa mundur ta bej rrjedh progresiste evropiane. Në thelb mbajti një qëndrim antigrek.

Agimi i Artë, poli tjetër që lojti me nacionalizmin ka shpesh trajta vulgare, por e ka të lehtë të fitojë mbeshtetes midis shtresës së provokuar e të zhgënjyer keqas nga politika zyrtare. Etikimi si parti naziste u bë thjeshtë për të minimizuar peshën politike. Ajo nuk është parti naziste se ka për simbol kryqin e thyer. Këtë kryq ideologët e Hitlerit e kishin huazuar nga kultura e Greqisë së lashtë, në mbështetje të epersisë së racës Ariane, të parin e së cilës e gjenin tek Akili).

Mos harrojmë se ndikuan në një qëndrim të tillë edhe indikacionet e trashëguara tek populli grek. Ai tregoi se nuk harron lehtë faktin që politikat evropiane nëpër shekuj, nuk treguan ndonjë dashuri apo mbështetje për Greqinë. Kjo për arsye se Evropa ndjehej e sfiduar nga realiteti i saj. Sa më shumë e krasisnin, aq më shumë Greqia lulëzonte. Aq me shumë Evropa gjente rrenjë të veta tek Greqia.

Nga ana tjetër klasa politike greke që zotëroi pushtetin gjysëmshkullin e fundit tregoi se nuk ishte e gatshme të shkeputej nga babezia që nështroi shtetin. Nga oxhaqet dhe trashëgimia politike familjare. Në këto zgjedhje këtë mëkat u mundua ta mbulonte duke manifestuar profil pro evropian, por pa fshehur frikën e peshës populiste të ekstremit të majtë

Megjithatë, ashtu si shprehej një gazetë gjermane pak para zgjedhjeve, është më mirë një Samara në krye të qeverisë me gjithë gabimet e bëra nga partia e tij. Ngushëllon fakti se qeveria e formuar prej tij u pagezua me frymën e përgjegjesisë kombëtare. Do të ishte e dhimbshme nese e mirrte pushtetin një forcë politike e cila mblodhi në një zemërimin popullor, por që politikisht ishte pa perspektivë dhe me kahje regresive.

Këtë unë e quaj meritë të popullit grek. Tani topi i mbeti serish politikës e cila duhet t'i mesojë vetës përgjegjesi jo politike por ptraiotike, ta mesojë popullin grek t'i rikthehet punës dhe të detyrojë të paguajnë detyrimet ndaj shtetit të gjithë ata që u shmangen atyre.

Pra, në aspektin e brendshëm, kaq e thjeshtë është zgjidhja e krizës greke.

## **3-Si e shikoni të ardhmen (theksi mbetet tek emigrantët tanë) e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve tona, kur duket se Greqia do të matet mirë në veprimet e saj me fqinjët e saj, që këtej e tutje?**

Më duhet të them që në fillim se është shumë e vertetë që në krizën greke goditjen e rëndë e pesuan emigrantët dhe në radhë të parë shqiptarët.

Integriteti politik i Greqisë me fqinjet besoj se nuk ka arsye pse të ndryshojë. Kursesi nuk duhet menduar se Greqia pesoi për shkak të krizës një rudhje që do ta imponojë të ridimensionojë raportet e saj me fqinjtë, apo të nxjerrë nga sirtari ndonjë kut tjetër marrëdhëniesh. Perkundrazi fqinjet humbën nga kriza e saj. Sido që të jetë, në planin politik, të stabilitetit në rajon, madje edhe në aspektin ekonomik, Greqia përbënte për Ballkanin një fuqi Evropiane, pavarësisht se politikanët e saj nuk arritën të justifikojnë kenaqshëm aspiratën e popujve të ballkanit.

Në këtë kontekst, besoj se Greqia nuk mund të ndryshojë qendrimin e vet me Shqipërinë. Do vazhdojë ta përkrahë të integrohet në Bashkimin Evropian, të vazhdojë të zhvillohet, të krijojë kushtet e një fqinjesie paradigmatiske.

Në këtë linjë duhet parë edhe qendrimi i Greqisë ndaj emigranteve shqiptarë atje. Nuk besoj kursesi se ky është problem i Greqisë se sa i vet emigranteve. Ata shkuan atje me dhunë e sakrificë për një jetë më të mirë. Greqia në një kohë që nuk donte t'i pranonte, kursesi nuk mundi t'i zbante. Tani më shumë do të vendosin vet emigrantet se çfarë do të bëjnë ata me Greqinë se sa Greqia me ta.

Kam përshtypjen se pjesa e emigranteve që u mbeshtet në krahun e vet të punës dhe kjo është pjesa dermuese, do të detyrohet të largohet duke importuar në Shqipëri një problem social. Kjo për arsye se vendi ynë nuk ka të ngritur një infrastrukturë pritese për ta e as aftësi thithese në mënyrë efektive të kapitalit të tyre financiar.

Në Greqi do të mbeten ata që janë integruar plotësisht nga ana ekonomike dhe pjesa kriminale. Për të parët rruga do të vazhdojë të jetë e shtruar. Të dytët do të kenë probleme se do të nxjerrin probleme.

#### **4-Pse është kaq i përçarë minoriteti i sotëm grek në Shqipëri. Arsyeja duhet të kërkohet në Greqi apo në Shqipëri?**

Arsyeja e parë duhet kërkuar tek vet minoritarët dhe më së shumti tek lidhshipi politik i PBDNJ-së dhe i OMONIA-s. Ky lidhship identifikoi të drejtat e minoritetit etnik grek me interesat e veta personale. Mandej identifikoi këto interesa me identitetin etnik të çdo pjesëtari të minoritetit grek, që sipas konceptit të këtij lidhshipi do të thotë se është grek vetëm ai që përkrah interesat e tij. Ky lidhship për interesat e veta i nënshtroi interesat e minoritetit etnik interesave të natyrave të ndryshme në Tiranë dhe Athinë. Për pasojë, po të shtojmë këtu edhe interesat që rrjedhin nga roli i minoritetit etnik grek në ruajtjen e ekuilibrit të ndryshme në marrëdhëniet ndërshtetërore e nderetnike, kuptohet qartë kush janë faktorët që e duan atë të jetë i përçarë dhe i pafuqishëm.

#### **5-A mendoni se edhe Shqipëria s'është treguar e drejtë në disa raste me Greqinë. Juve keni bërë një akuzë kur u hartua Enciklopedia shqiptare në lidhje me trajtimin që ajo i kishte bërë minoritetit grek në Shqipëri?**

Besoj se qendrimet të kësaj natyre janë evidente, por në fund të fundit ato i kanë bërë më shumë keq vet Shqipërisë se sa Greqisë. Vazhdoj të kembëngul se sa më shumë të vazhdohet që për interesa të caktuara politike, ose më sakt për përfitim politik të grupit apo të çastit, do të vazhdohet që marrëdhëniet me Greqinë të jenë të paragjykuara, demi më i madhë do të mbetet palës shqiptare. Kam shkruar edhe herë të tjera. Në Shqipëri për vite me radhë, për konsum të brendshëm politik e nacionalist, u bë zhurmë e madhe për korridorin 8. Flitej sikur Greqia po pengonte ndërtimin e tij në Shqipëri për interesat e veta. Kjo zhurmë bëhej kur korridori 8 me pikënisje Igumenicën dhe fundin në tokën greke kufirin me Turqinë, jo vetëm ishte aprovuar nga BE-ja, (pasi ishte nisur fillimisht nga vet Greqia në vitet 80'), por se ky korridor ishte dhe drejt përfundimit.

Nderkohë, Shqipëria humbiste kohë të artë për ndërtimin e korridorit Jug-Veri, që i siguronte asaj jo vetëm integritet ekonomik kombëtar por edhe rol të qenësishëm për integrimin me Evropën Qëndrore e Lindore.

Eshte e vertetë Greqia kurrë nuk ka bërë lojën e tjetër kujt në dem të Shqipërisë. Ajo historikisht, jo vetëm me Shqipërinë, por në përgjithësi ka treguar se është e çliruar nga paragjykimet. Kondaktet dhe bashkëpunimet me popujt i vendoste dhe i vendos me armën e vetme të saj, kulturën e vet, e cila i garanton epersi dhe nuk e lëjon të reshqas në arrogancë e as në nështrim. Këtë duhet ta ketë mirë parasysh edhe Shqipëria.

Po ashtu, politika zyrtare dhe opinioni publik në Shqipëri nuk ka pse të shikojnë me frikë, paragjykim dhe inferioritet marrëdhëniet me Greqinë. Këtu buron gjithë e keqja. Në këtë kendveshtrim duhet parë edhe qëndrimi im në lidhje me fjalorin enciklopedik. Vërrejtjet e mia lidhen me faktin se Akademia e Shkencave dhe çdo institucion tjetër, por aq me tepër ajo, kulturën historinë dhe realitetin e minoritetit etnik grek duhet ta trajtojnë si pjesë e terrësisë së realitetit shqiptar, pa e demotivuar apo shtrembëruar atë. Së dyti, duhet të çlirohen nga mentaliteti i historisë së fabrikuar nga sistemi komunist dhe të mbajë një qëndrim akademik në çështje historike në lidhje me këtë minoritet, apo edhe në marrëdhëniet me Greqinë.

#### **6-Juve pretendoni se minoriteti ka probleme me tekstet shkollore. E quani të qëllimshme këtë apo thjesht pamundësi të shtetit shqiptar të trajtimit të minoriteteve të tij?**

Për mua faji në radhë të parë është i strukturave politike përfaqësuese të minoritetit etnik grek. Unë nuk mund të akuzojë qeverinë shqiptare për një mangësi të tillë, kur ajo aprovon një buxhet për këtë qellim, kur strukturat politike të minoritetit, OMONIA nëpërmjet PBDNj-shit, janë në koalicion qeverisës dhe libra nuk ka. Nuk ka, për faktin se për vite me radhë këto para përfundonin në gropën e korupsionit. Sot ka probleme se prap po ky lidërsip politik i minoritetit etnik grek, në emër të interesave të individëve të caktuarë brenda saj pengojnë prodhimin e tyre. Nuk ka libra për shkak se ky lidërsip për arsye nga më të ndryshme kërkon të promovojë institucione shkollore private në dem të atyre publike.

Kjo nuk do të thotë se shteti shqiptar nuk ka përgjegjësitë e veta. Ka dhe shumë të mëdha. Por perseri do të duhet kërkesa dhe këmbëngulja e strukturave përfaqësuese politike të minoritetit që përgjegjësitë e shtetit të kthehen në realitet.

#### **7-Si studiues i njohur, a mendon se mes dy vendeve, në të ardhmen, do të ketë më shumë pika takimi apo pika ndarje?**

Të guxosh të vesh në dyshim të ardhmën e marrëdhënieve shqiptaro – greke do të thotë t'i kundërvihesh historisë së gjatë të marrëdhënive të tyre.

Në lashtësi civilizmi grek i trajtonte Ilirët pjesë të vet. Në mitologjinë greke themeluesi i ilirëve është i biri i fundit i Kadmos.

Me të njëjtën menyrë u trajtuan edhe zëvendusuesit e Ilirëve, shqiptarët. Rilindja Kombëtare Shqiptare në elementët bazë frymëzohet nga ideologjia re e Greqisë së revolucionit të 1821-shit. Shumë shqiptarë luftuan në këtë revolucion se e konsideronin Greqinë Atdheun e përbashkët. Shumë burra të shquar shqiptarë të kesaj periudhe ishin të gatshëm të krijonin shtetin federatë greko-shqiptare. Asnjë përplasje gjakosëse nuk ka midis katyre dy popujve dhe epersia kulturore e Greqisë nuk e kaprxente kurrë masën si ndaj shqiptarëve ashtu edhe ndaj fqinjëve të tjerë.

Dua të theksoj se në Shqipëri duhet të shkeputemi nga indokrinimi komunist ideologjia e unitetit kombëtar i të cilit kërkonte të realizohej nga ballafaqimi permanent i popullit

shqiptar me fqinjët. Po ashtu, është shumë i demshëm abuzimi që bëhet duke paraqitur në opinionin publik shqiptar, si politikë zyrtare greke, qëndrimet e shoqatave, artikujve të gazetave, individeve të veçantë etj.

Merreni me mend çmund të ndodhte nese në Greqi veprohej njësoj. Dmth, të mirreshin si politikë e Tiranës zyrtare qëndrimet antigreke të Kreshnik Spahisë, apo grupimeve të tjera ekstremiste nacionaliste shqiptare...

Po ashtu, në Shqipëri krijohet shpesh bindja se kriza e tanishme e çoi Greqinë në fund të rreshtit dhe pa nguruar ferkohen duart e dashakeqësisë. Nuk është hera e parë që Greqisë i ndodhin situata të tilla. Është ajo krasitja e domosdoshme që thamë, për ta sjellë në një komukim të drejtpër drejt me thlebin e kulturës së saj, të asaj kulture që i dha vitalitet botës dhe do ta mbaj gjallë Greqinë.

(Në parantezë, shpesh kërkojmë dhe themi që grekët e sotëm nuk kanë lidhje me grekët e lashtë se nuk mund të bejnë serish Parthenonën, Delfin, të nxjerrin Aleksandrin e madh, etj. Është njësoj sikur t'u kërkojmë egjyptianëve të ndërtojnë piramida. )

Pra, midis vendeve e popujve tanë në dhjetevjeçarët e fundit u shtuan me dhjetra fije të tjera lidhjesh të fuqishme. Mjafton që ne të mos humbasin pyllin pas pemës, mjafton që të shikojmë drejt historinë për të ecur me shpejt përpara. Çdo prapësi tjetër vetëm sa do të vonojë rigjetjen e rivendosjen e kontakteve të qenësishme bashkëpunuese e përparuese, por kursesi nuk do t'i pengojë

### **8-Si e keni parë insistimin e palës greke për kufirin detar të Jugut dhe reagimin gjysmak të qeverisë shqiptare?**

Brenda logjikës që përshkrova më lart. Prishja e marrëveshjes u konsiderua si fitore e Shqipërisë mbi Greqinë. Unë e quaj një humbje në radhë të parë të Shqipërisë dhe pastaj të Greqisë. Ajo marrëveshje perkon me një bashkëpunim dypalësh ekonomik dhe gjeostrategjik. Vini re. Gjykata kushtetuese nuk rrezoi thelbin dhe përmbajtjen e marrëveshjes, por vetëm procedurat. Faktin që komisioni negociues duhej aprovuar nga Presidenti i Republikës. Pra kërkohej një sebep dhe u gjet një problem teknik. Pastaj u fut ne veprim mitomania e mentelitetit komunist që fqinjët ndaj Shqipërisë kanë qëllim përmanent copëtimin e “Atdheut” dhe në rastin konkret “u gllaberuan nga Greqia 300 kilometra katrore det!!!”. U ngritën këngë, u shpallen heronj, u forcua antigreqizmi. Ishte aq i madh presioni saqë vertet qeveria nuk ishte në gjendje të mbronte atë që kishte bërë mirë. Dhe u harrua ajo që është e domosdoshme. Kjo marrëveshje përcaktonte bazat e përfitimit të përbashkët si rrugë kallimi strategjik ndërkombëtar dhe shfrytëzim të nëndetit.

Mendoj se Greqia dhe Shqipëria kanë shumë fusha të rëndësishme bashkëpunimi që bashkërisht dhe reciprokisht mund të përfitojnë, si në aspektin ekonomik dhe atë gjeostrategjik.

Në këtë kendveshtrim ngërçet e vjetra nacionaliste dhe loja për interesa të të treteve po kthehen në pengesë serioze.

### **8-Greqia do fillojë një proces rimëkëmbje të vështirë. A mendoni se Shqipëria mund ta ndihmojë në ndonjë fare mënyre Greqinë?**

Sigurisht që po. Ridimesionimi i klimës së bashkëpunimit në bazë të traditës historikës dhe të frymës Evropiane, larg paragjykimeve dhe nacionalizmave arkaike, që sapo pershkruam është kontributi më i mirë dypalësh.

Faleminderit

Ubotua te revista JAVA 23-24.06.2012



## **Nga Panajot Barka.**

<http://www.gazetatema.net/2014/07/29/keqperdorimi-patriotik-i-laberise/>

### **Keqperdorimi patriotik i Laberise**

29.07.2014

Rasti patriotik për të argumentuar “domosdoshmërinë” e bashkimit në një njësi territoriale Himarën me Vranishtin, risolli në skenë problematikën për qasjen dhe interpretimin e historisë dhe kulturës tradicionale, trajtuar në simpoziumin shkencor në dhjetor të 2006 në Vjenë të Austrisë, organizuar nga Instituti i Studimeve Shqiptare të Munihut dhe Institutit i Historisë së Evropës Lindore të Universitetit të Vjenës, mbështetur nga Komisioni Ballkanik i Akademisë së Shkencave të Austrisë. Në këtë vëprimtari shkencore u nënvizua nëvoja e çmitizimit të historiografisë shqiptare si dhe çlirimi i saj nga izolacionimi i imponuar komunist, i cili u mbart edhe në periudhën post komuniste si vetëizolim, por që në të dy rastet shoqëron një regjim që mbjell ksenofobi. Në rastin e tanishëm të raportëve të Himarës me Labërinë, historianë poltikanë, publicistë etj, të nisur nga realiteti i tanishëm apo edhe i shekujve të fundit në raportët midis tyre, me deklarime a priori, produkt i ideologjisë komuniste për njehsimin e thellësisë historike të Himarës me Labërinë, risollën në aktualitet (por për qëllime politike) përpjekjen për t’i dhenë Labërisë thellësinë historike të Himarës dhe Himarës identitetin e theksuar shqiptar të Labërisë. (flamurtari i shqiptarësisë në Jug, sipas ideologjisë komuniste).

E vërteta historike është se Labëria është pjesë e Himarës dhe jo e kundërta dhe se historia e Laberisë në Himarë është shumë e re në krahasim me lashtësinë e Himarës.

Në lidhje me këtë po u referohem në vijim disa fakteve nga fusha të ndryshme të cilat u përkasin korifenjeve të shkencës Shqiptare dhe të huaj.

Sipas Baron Nopca-s, të cilit i referohet Çabej në librin e tij “*Shqiptaret midis Perendimit e Lindjes*”, Tiranë 1994, faqe 12, emri i labëve lidhet me emrin e fisit ilir të Labeatet-ve –Lacus Labeatis që banonte afër Liqenit të shkodrës. Vet Çabej përforcon pikëpamjen e Nopcës, duke theksuar se Labëria hyri si pykë në Toskëri dhe ndau në mes një njësi të hershme”. (Çabej E., 1994, po aty, fq.49.)

Po ashtu, Nathalie Clayer, në librin e saj *Në fillimet e Nacionalizmit shqiptar, lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë, botime “Përpjekja”, Tiranë 2009, fq 26*, na thotë se familjet e mëdha patriarkale me 80 e me shumë veta i korrespondojnë në Jug, në Labëri. Ruajtja e konstitucionit të fisit në Labëri, sipas Çabej, nuk lidhet aq me natyrën se sa me origjinën e tyre Veriore dhe shton se, “Nga pikëpamja shoqërore Lëberit janë bartësit e armëve në Jug” (Çabej E., 1994, po aty, fq. 22)

Kjo trashëgimi i përgjigjej në fakt dhe realitetit të ri bujtës. “Në pikëpamje shoqërore labët janë bartësit e armëve në Jug...” thotë Çabej (Çabej E., 1994, poaty, fq 22)

E ndihmon këtë argumentim për qasja që i bën prof Çabej këngës polifonike në Labëri. Pasi sqaron se Toskeria është toka që janë ruajtur më mirë meloditë e moçme të vendit, na thotë se këngët e Veriut janë këngë solo, - simbol i shtëpisë së vetmuar, i ekzistencës së izoluar dhe i karakterit individualist të njeriut të malit, - të Toskërisë janë këngë polifone, korale. (Çabej E., 1994, *Shqiptarët midis Perendimit e Lindjes, Tiranë, fq.47*), Këngët polifonike të Labërisë ruajnë karakterin epik dhe heroik, shton ai. “Përshtypja që del prej këngës labe është malli i ashpër dhe shpirti heroik.... Se epike është fryma e këtij fisi, këngët më të dashura të tyre janë këngë trimash...” (Çabej E., 1994, *Shqiptarët midis Perendimit e Lindjes, Tiranë, fq.49*). Pra kjo do të thotë se Labëria për vetësoi këngën polifonike të Toskërisë-Epirit, për shkakun se nga pikëpamja e formës dhe e melodisë qëndronte më lartë se kënga solo e veriut, të origjinës, dhe sipas rregullave të njohura folklorike, i veshi kësaj forme polifonike përmbajtjen heroike të

karakterit të tij verior. Labëria, për shkak të karakterit të vet izolues, të trashëguar nga origjina, jo vetëm që e përvetësoi këtë formë të kënduari, por e ruajti me fanatizëm deri në kufinj identitar. Periudha komuniste e stimuloi atë më shumë duke e zëvendësuar emrin nga kënga polifonike në kënga labe. (në periudhën post-komuniste që edhe Labëria u hap, kënga labe u dorëzua para sazeve, duke ia lenë autoktoninë bartësve të vërtetë që janë himariotët.)

Argument shtesë në këtë arsyetim përbëjnë edhe përpjekjet e Ismet Elezit për të gjetur ngjashmëri midis kanunit të Lek Dukagjinit dhe të drejtës Zakonore në Labëri, në librin e tij me të njëjtin titull, botime TOENA, Tiranë 2002. Pra, e drejta zakonore në labëri përbën një mbetje nga mbartja e Kanunit të Lek Dukagjinit.

Për kohën e këtyre vendosjeve të Labërisë në Labërinë e sotme mund t'i referohemi asaj që thotë serish Çabej, se, "Osmanët sollën në kulm edhe përfunduan hovin shtegtues të shqiptarëve dhe kontribuan kështu në shpallimin e shpërndarjen e tyre, por jo krejt" (Çabej E., 1994, *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, Tiranë, fq 17*) Në zonën e Himarës ky lloj "ekspansioni" kishte filluar që në periudhën e pas Skendërbeut, me zbritjen e malësorëve të veriut, për të luftuar nën drejtimin e djalit të Skendërbeut dhe me përkrahjen e Venedikut, kundër Osmanëve. Bëhet fjalë për atë pjesë veriorësh të krishterë. Në këtë pikëpamje ata kishin një të drejtë shumë të pamohueshëm të quheshin "bijtë e Skendërbeut". Ndërsa pjesa tjetër që realisht zbriti më vonë, ishte orientuar në favor të Perandorisë Osmane. Në këtë linjë balkanologia franceze Nathalie Clayer shton një argument plotësues se nga Labëria u përfshinë në formacione të ndryshme luftarake të P. Otomane rreth 30000 burra. (Clayer N. 2007, *Aux origines du nationalisme albanais, La naissance d' une nation majoritairement musulmane en Europe, Paris, fq.105-106. (botimi shqip 2009)*)

Faktin e shtegtimeve nga veriu në Jug në këtë periudhë mund ta vërtetojë në mënyrë indirekte argumenti se ajo lidhet me së shumti edhe me krijimin e dy dialekteve të sotme të gjuhës Shqipe. Sipas Çabej, por edhe studjuesve të tjerë "Toskërishtja jugore e mbarimit të Mesjetës.... afrohet me gegërishtën veriore të shekullit XVI-XVII" (Çabej E., 1994, *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, Tiranë, fq 20*).

Jorgji Gjinarri vërteton se në Mesjetën e vonë në gjuhën e Labërisë "vihen re fenomene fonetike të ngjashme me dialektin geg" (Gjinari J., 1988, *Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Konferenca Kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij, Tiranë, σελ 222*)

I njëjti autor na thotë se "... dallimi në dialekte i gjuhës shqipe .... morën formën e sotme gjatë fundit të shek. XVIII fillimit të shekullit XIX, para lëvizjës tonë kombëtare" (Po aty) Ai vë re gjithashtu se karakteristika daluese midis dy dialekteve u shënuan në periudhën e gjysmës së parë të Perandorisë Osmane. (Po aty) Te njëjtin mendim ndajnë me Gjinarin edhe Alexander Rosetti, Gustav Mayer, Norbert Jokli etj.

Po ashtu, Shaban Sinani këmbëngul se Labëria ngushtoi kufijtë gjeografikë të Himarës jo më parë se shekulli XVIII. (Akademia e shkencave e Shqipërisë, 2004, *Himara në shekuj, Tiranë, fq.327.*)

Pra, të vërtetat historike, janë të vërteta historike dhe si të tilla të pamohueshme. Eshtë tjetër gjë që në karakterin e Toskërisë, më gjerësisht të Epirit, bashkëpunimi, bashkëjetesa, tolerenca etj ishin instrumentat e ruajtjes dhe zhvillimit të saj etnokulturor. Dhe është tjetër gjë që për interesa të caktuara, aq më keq politike, apo edhe nacionaliste, të lëjohet, apo të defaktorizohet historia dhe ky realitet.

Në këtë kendveshtrim askush nuk mund ta vë në dyshim rolin e madhë të Labërisë, në zhvillimin etnokulturor shqiptar, ashtu si askush nuk duhet të lejojë që Labëria të keqpërdoret në emër të këtij kontributi. Panajot Barka për gae TEMA 29/07/2014

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2014/08/08/problemet-e-reformes-per-arsimin-e-larte/>

### **Problemët e reformës për arsimin e lartë**

**08.08.2014**

Sipari i legjislaturës së parë parlamentare të qeverisjës socialiste ra me votimin e një tufe reformash të rendësishme, të cilat së bashku me disa arritje të tjera, sidomos në luftën kundër kultivimit të trafikëve të drogës, kundër paligjshmerisë në veprimtarinë e institucionëve shtetërore, korrupsionit etj, përvijuan praktikisht simiologjinë qeverisëse të Edi Ramës. Pikërisht, vendosmeria e qeverisë në këtë rrugë po ndryshon përditë edhe balancën e ekuilibrave në realitetin politik e shoqëror të vendit. Kjo evidentohet tek fakti se rezistenca e opozitës për të mbrojtur veprën e vet kompromentuese në zhbërjen e shtetit po demotivohet e dobësohet deri në eklips. Vet institucionët mëkatore të kapura ose jo politikisht, me në krye drejtësinë, japin shënja e tregojnë se janë të gatshme të kalojnë nga kundërshtimi i reformave tek bashkëpunimi me qeverinë për realizimin e tyre (duke patur brenda dhe hilenë e përfitimit apo shpëtimit të kokës). Mentaliteti i djeshëm edhe në qeverisjen e sotme për të shfrytëzuar pushtetin për përfitim personal, po e ndjen lakun në fyt. Opozita e brendshme në kampin mazhoritar humbet argumentat për opozitarizmin në emër “të traditës së nëpërkëmbur”, apo “meritave të pavlerësuar”. Zgjedhja e Kryeministrit për t’u besuar njerëzve të rinj frontet me gravitet të theksuar shoqëror e politik, po justifikojnë ambicjen e Rilindjes për të shënjuar një epokë dhe jo thjeshtë një mandat qeverisëse. Përditë, ndersa perëndimi po e sposton vemendjen nga faktorë të tjerë bashkëqeverisëse për tek Rama, po demotivohen edhe ato struktura apo individë në shpresën e tyre për një spostim të mundshëm të pushtetit tek këta faktorë dytësorë. Në përgjithësi trendi qeverisëse po u shpeton kurtheve të qëllimshme, ose pengesave të së kaluarës. Në këtë ecje ka plot gjera për të korrigjuar e për të kritikuar. Por, në këtë risi edhe vërrejtjet, pakënaqësitë, zhgënjimet etj, duhen parë si argumenta vlerësuese të ecjes përpara.

E përvalon këtë simiologji akti i parë në zbatimin praktik të reformës në Arsimin e Lartë. Bëhet fjalë për vendimin për mbylljen dhe pezullimin e disa IAL-eve-kërpudha pas shiut dhe premtimi se ky është vërtet akti i parë i kësaj reforme. Kjo sepse, si për çdo vend e popull, arsimit ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe thelbësore më të ardhmën e vet shoqërisë, cilësinë e saj dhe të vet kombit. Sepse, ndërgjegjja kolektive për një arsim cilësor, lidhet me përparimin dhe aspiratat e një populli. Sepse çeshtja a arsimit nuk është problem qeverie, apo pushteti politik, por është çeshtje orientimi historik i një populli.

Në këtë kuptim, jashtë kuadrit të vlerësimeve të njohura, nuk mund të mos nënvizohet se reforma në Arsimin e Lartë, zbulon së pari gropën e thellë e të zezë ku e kishin zhytur të ardhmën e shoqërisë shqiptare, ata që kishin guxuar të instalonin sistemin e piramidave, të klientelizmit dhe të aferave korruptive edhe në Arsimin e Lartë. Pra, zbulon shkallën e shpërfytyrimit të shtetit sot dhe fushën e minuar të destinuar për të ardhmën e shoqërisë. Zbulon njëkohësisht diapazonin e gjerë e larmishëm të objektivave që duhet të synojnë reformat në përgjithësi në Shqipëri. E parë në këtë kendveshtrim, reforma në arsim dhe sidomos në Arsimin e Lartë, përbën në fakt kazusin historik për revolucion të vërtet për të rilevuar cilësinë funksionale të armatës njerëzore në makinën shtetërore dhe të vet strukturës së shoqërisë.

Mirëpo, ajo që vihet re është se ky problem bazal i shoqërisë, po i lihet në dorë një institucioni politik, siç është Ministria e Arsimit. Njerëzit e letrave, “intelektualët”, armata e mësuesve dhe e pedagogëve, studentët që përbëjnë historikisht brezin ku mbështetet çdo revolucion shoqëror e politik, tregojnë se janë apatikë, indiferentë. Intiferenca e tyre ndoshta tregon mosbesim, ndoshta bashkëfajësi, ndoshta frikë.

Ndoshta shoqëria është pajtuar me këtë realitet vrapar dhe me fatalitetin e këtij pajtimi s'mund të kërkojë rrugë shpëtimi. Mund të ketë edhe shumë "ndoshta" të tjerë, por asnjë nuk përbën justifikim. Kjo për faktin se reforma në Arsimin e Lartë nuk është reformë që kërkon 84 vota në Parlament, por pjesëmarrjen 84 përqind të shoqërisë. Nuk ka shumë rendësi nëse Lindita Nikolla dhe stafi i saj me këtë reformë i krijojnë vetës një vend në histori. Rendësi ka që shoqëria ta shndërojë reformën në një ngjarje historike.

Fizikisht përballja e forcave në aksionin e reformës në Arsimin e Lartë ka rezultante negative. Kjo për faktin se në këtë përballje vlera e forcës së vektorit me emrin "shoqëri" është e barabartë me zero. Pra, nga njera anë qëndron realiteti i infektuar, ai i interesave okulte dhe korruptive në Arsimin e Lartë. Nga ana tjetër institucioni i Ministrisë. Kjo nuk mjafton se pavarësisht nga vendosmëria e Ministrisë për të bërë maksimumin, ajo në fund të fundit është një institucion politik dhe si i tillë mund të jipet para presionëve, qofshin këto edhe negative. Kjo do të thotë se forca e reagimit shoqëror, jo vetëm do të drejtpeshojë qëndrimin politik të Ministrisë, por do të neutralizojë çdo rezistencë të pjesës së kalbur të Arsimit të Lartë.

Fakti që universitetet që pesuan goditjen e parë nuk demonstuan rezistencë publike, fakti që inspiruesit e këtij sistemi ndjehen të demotivuar si politikisht ashtu edhe në aspektin shoqëror, vërteton fajësinë e thellë të këtij sistemi. Heshtja dhe pasiviteti i tyre mund të lidhet edhe me shpresën e shpëtimit të pjesës tjetër, të pazbuluar të fajit, ose të shpresën për përfitimin e pandëshkushmërisë. Por kjo nuk e përjashton përpjekjet e këtij sistemi për t'i shpetuar ose amortizuar goditjen e reformës. Përkundrazi! Pa zhurmë po zgjedh mjetet që lëjuan instalimin e tij. Ose, nëse Ministria në këtë reformë, me qëllim që të shmang çdo keqinterpretim, kërkon të zbatojë me përpikmeri ligjin dhe transparencën, faktorët e fajshëm për gropën e thellë në Arsimin e Lartë i referohen po ligjit dhe parimeve demokratike për të mbijetuar. Kështu, stafet drejtuese në universitetet publike, me qëllim riciklimin e tyre në drejtim iu referohen të drejtës demokratike për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Pra, kanë guximin të harrojnë se në demokraci ndëshkohet kushdo që ka faj dhe autoritetet drejtuese në universitete kanë përgjegjësinë morale e ligjore për zhbërjen, të paktën cilësore, të Arsimit të Lartë. Harrojnë gjithashtu se në demokraci ka kufizim të lirive demokratike kur këtë e kërkon interesi i lartë shoqëror dhe arsimit është një sektor i tillë. Dhe nëse ata nuk vedorhiqen, një sistem ligjor të paktën t'i nxjerr në breg, qoftë edhe për një mandat. Ashtu si bëri qeveria që për vete u mbështet në njerëz të rinj, me një kulturë dhe mentalitet perendimor, për të qenë e suksesshme, të njëjtën gjë duhet kërkuar edhe për drejtimin e universiteteve.

Nuk e di sa të drejtë kishte Znj Nikolla kur tha në një nga daljet e fundit të saj publike se me vonesën në fillimin e zbatimit të reformës në Arsimin e Lartë, ndoshta zhgënjyem dikë. Faktikisht, duhet thenë e kundërta. Me pasivitetin e vet në lidhje me domosdoshmërinë e reformës në Arsimin e Lartë shoqëria shqiptare po vetzhgënjehet. Ministrisë, këtij institucion politik, mund t'i besohet detyrimisht roli i koordinatorit dhe udhëheqësit të reformës, por jo gjithë bara e saj. Po nuk denoncoi studenti që korruptonte aktivisht pedagogun për të marrë një provim, po nuk foli prindi që shiti shtëpi e katandi për t'i blerë një diplomë femijës, po nuk reagoi drejtuesi i institucionit që ai që kishte para për të blerë një diplomë, kishte dhe aq të tjera për të zenë vendin më të mirë të punës në institucionin e tij, po nuk u zbuluan sekserët, punuesit e temave të diplomës për studentët, formaliteti i titujve akademik, reforma nuk mund të implementohet nga institucioni politik i Ministrisë, sado e vendosur të jetë Ministria dhe stafi i saj, sado mbështetje të ketë nga Kryeministri dhe faktori ndërkombëtar.

Pas kësaj, do të ishte e thjeshtë të kongludohet se shoqëria humbi moralin për t'i kërkuar hesap Ministrisë dhe Qeverisë për reformë të munguar në Arsimin e Lartë.

## **Nga Panajot Barka**

### **Pandëshkushmëria e krimit me kullaro!**

16.08.2014

Rasti Fullani po zbulon pa mëshirë në terë madhështinë e vet mekanizmin e pandëshkushmërisë të krimit me kravatë në piramidën shtetërore. Në një skandal financiar në Bankën Qëndrore të shtetit, (vjedhje parash në përmasa të mëdha, për një kohë të zgjatur dhe me mënyra të ngjashme me vjedhjen e thesarit me 1997-1999), mekanizmat e shtetit dhe të shoqërisë civile tregojnë pamundësi të spikatur për t'u marrë me fajtorët kryesorë, ose me përgjegjësit primarë.

Pandëshkushmëria e fajtorëve VIP në shtet sigurohet nga politikanët. Këta të fundit të rreshtuar në grupime politike, organizojnë sistemin mbrojtës të të parëve, të cilët pranojnë të shndërohen në vegla të interesave të këtij sistemi. Të dy palët hyjnë në relata përvetësimi të së drejtës mbi shtetin duke ia nënshtruar atë krimit.

Skandali Fullani po nxjerr gjithashtu në pah gjerësinë dhe thellësinë e sistemit të krimit me kravatë. Po ashtu, bëhet fjalë për një sistem mbrojtës të fajëve VIP të ngritur nga qeveria e djeshme. Vetmohimi më të cilin mbrohet ky sistem dhe paralelisht krimi me kravatë sjell identifikimin me krimin dhe fatkeqësisht misioni i opozitës së sotme. Gjithësesi, mekanizmi është i thjeshtë.

**Së pari**, Fajtorët VIP i shkelin ligjet me koshiencë se kanë siguruar nga politika një mbrojtje ligjore. Në këtë kuptim, mekatarët VIP, ose veprojnë në kendet e vdekura të legjislacionit, ose në kufirin e evazivitetit ligjor, ose në vakum ligjor, ose akoma edhe në garanci ligjore. Të gjitha rastet janë parashikuar enkas nga ligjvënësi politik. Edhe në rastin Fullani legjislacioni është ndërtuar i tillë që të mos keët institucion i cili të iniciojë të paktën shkarkimin e tij. Gjëja më e thjeshtë dhe e logjikshme do të ishte që ligji të parashikonte një paralele institucionale shkarkimi të kundërt me atë të zgjedhjes.

E njëjta situatë paraqitet edhe me drejtësinë. Në emër të pavarësisë së Gjyqësorit është ndërtuar një legjislacion që i ka garantuar një pavarësi absolute gjykatësve e cila pavarësi është e pacenueshme edhe kur gjyqtari i thjeshtë në dhënien e drejtësisë shkel zbatimin e ligjin me të dyja këmbët. Ai në emër të ligjit është i pandëshkueshëm.

**Së dyti**. Pandëshkushmëria e eksponenteve të lartë në piramidën shtetërore, pas mbrojtjes ligjore ka siguruar mbrojtjen e përfaqësuesve të politikës, ose të sistemit politik, por në emër të interesave personale ose të grupit politik. Në rastin Fullani nuk bëhet fjalë thjeshtë për mbrojtjen publike që ai ka siguruar nga rrethi i ngushtë i ish kryeministrit të vendit. Mbrojtja nga ky i fundit do të ishte shumë kompromentuese për guvernatorin e Bankës së Shqipërisë nëse ai nuk do të kishte mbështetjen provokuese të shumicës absolute të Këshillit Mbykqyrës të Bankës, i vetmi institucion që mund të iniciojë shkarkimin e tij. Anëtarët e këtij Këshilli janë përfaqësues të forcave të caktuara politike dhe faktet tregojnë se janë katapultuar aty për t'u shërbyer jo ligjit por interesave të këtyre forcave politike, apo edhe eksponenteve të tyre. Ky fakt vërtetohet edhe nga banaliteti i çvlerësimit të integritetit moral të njerëzve me tituj akademik në KM të Bankës. Ndërkohë, fije të ngjarjeve që tronditen të kaluarën e afërme politike në vend kalojnë nga oborri familjar i Fullanit gjë që më sa duket siguron heshtjen olimpikë të faktorëve të tjerë politikë në vend.

Janë pikërisht këto relata që në vijim bllokojnë edhe angazhimin institucional të ingranazheve të tjera të shtetit, siç është në rastin kongret prokuroria. (Në deklaratën e fundit të KM të Bankës lëxohet qartazi midis rreshtave se Guvernatori i Bankës do të jap dorëheqjen pasi të mbarojnë hetimet. (!). Normale do të qe të jipte dorëheqjen që t'u hapte rrugën hetimeve... !)

E njëjta skenë garanton pandeshkushmerinë në drejtësi dhe në çdo institucion tjetër publik duke filluar nga ministritë e duke mbaruar me universitetet, ku shkelja e ligjit është evidente, por deri më sot nuk kemi asnjë zyrtar të lartë të këtyre institucioneve prapa hekurave. Vini re, mund të përfundojë ndonjë syresh aty, vetëm nëse i kundërvihet sistemit që e mbron.

**Së treti.** Në aspektin e opinionit publik, mënyra e sigurimit të pandeshkushmerisë së zyrtarëve të lartë shtetërorë ndodh nëpërmjet spostimit të vemendjës publike dhe institucionale nga problemi kryesor.

Në rastin e Fullanit ky spostim vemendjeje konstatohet në disa forma. Më interesant është fakti që asnjë nga faktorët protestues ndaj Fullanit, nuk kërkon dorëzimin e tij para ligjit, por thjesht shkarkimin e tij. Kjo gjë vëhet re edhe tek kundërshtarët me të ashpër të Fullanit, qofshin politikanë, ose jo. Çfarë do të thotë kërkesa për shkarkimin ose dorëheqjen e tij dhe jo ballafaqimi me drejtësinë? Në aspektin shoqëror kjo kërkesë shpreh një motiv zilie për aktin e kryer, atë që e bëri Fullanin të pasur (!!). Në aspektin ligjor dhe politik kjo do të thotë pandeshkushmëri. Pra, dukshëm kemi një spostim të vemendjës nga ajo që është thelbësore dhe që lidhet me ndëshkimin e fajit, në atë që është dytësore e që lidhet në rastin më të keq me aspektin moral dhe në rastin më të mirë e që ndodh rëndom, me masën administrative të lëniës së karrigës, për t'u zëvendësuar me një pasardhës më të denjë se ai që iku pa i hyrë gjemb në këmbë.

Rast ekselent të spostimit të vemendjës nga problemi madhor, nga pylli tek pema, është në zhvillim edhe në një front tjetër të rëndësishëm siç është ai i Reformës në Arsimin e Lartë.

Dihet që vitet e fundit në vendin tonë u instaluan në formën e qoskave piramidat e univeristeteve private dhe u injektua shkatërrimi i sistemit universitar publik. Ato në funksionin e tyre të fitimit në të zi ose të larjës së parasë së pistë, sollën epideminë e diplomave të blera. Ky fiktivitet absolut arsimimi universitar infektoi në masë absolute shkollimin e rinisë. Spstoi në kohë, në mënyrë mekanike, papunësinë duke i dhënë natyrën e papunësisë me diploma, qoftë edhe formale. Njëkohësisht kënaqi, por në mënyrë fiktive edhe nëvojën e administratës publike për rritjen cilësore të nivelit të arsimimit. Fjala është për pyllin e kërpudhave të titujve akademikë. Në këto kushte në parim të gjithë janë dakort për nëvojën e reformës në arsimin e lartë. Madje fajtorët e situatës kriminale në këtë sektor, kanë edhe propozimet më të mira. Por, në praktikë, këta mëkatarë me përgjegjësi ligjore ekstreme e në vijim përgjegjësi morale, politike, shoqërore për situatat kërcenuese në arsimin e lartë, marrin inisiativën për të spostuar vëmendjen nga procesi i reformimit të nisur në arsimin e lartë. Ata harxhojnë energji të pafundme për të spostuar vëmendjen tek një individ në mekanizmin implementues të kësaj reforme, (një drejtor në MAS që u mor me inspektimin e IAL-ve në vend), duke vërtetuar kështu faktin që ajo që u intereson më shumë atyre, është mbrojtja e sistemit që prodhoi krimin e organizuar edhe në arsimin e lartë.

Mënyrat e tjera të spostimit të vemendjës nga krimi me kullaro i sistemit mbrojtës të tijjanë: Minimizimi i fajit, ose manipulimi i faktëve, ndërtimi i skenarëve se goditja e krimit me kullaro ka prapavijë politike etj. E gjithë kjo siguron zgjatje në kohë për të zbutur efektin goditës, për të arritur neutralizimin e akuzave në pjesën përmblylëse të sistemit mbrojtës të krimit me kullaro që është ai i drejtësisë.

Është fakt tradite që në vendin tonë të gjithë ata zyrtarë që shkelin ligjin, shperdorojnë postin dhe i shkaktojnë vendit dëme të mëdha ekonomike, financiare, politike e shoqërore, thjesht shkarkohen. Asnjëri prej tyre nuk i është dorëzuar drejtësisë për fajet e kryera kundër shtetit dhe shoqërisë. Edhe kur i dorëzohen drejtësisë, kjo e fundit Ose në rastin më të keq, në vend të tyre denohen disa fakirë që janë thirrur në rolin e levës së kryerjës së krimit dhe për lirinë e tyre duhet të heshtin. **FUND.**

**Nga Panajot Barka.**

**Dy fjalë për rrethuesit meskinë të dasmës së Ministrit Veliaj!**

08.09.2014

Erion Veliaj duket se në këmbënguljen e tij për t'i sjell risi të reja qytetit të Gjirokastrës, për të treguar se ky qytet nuk mund të lejohet që të shembet nën gri-në e mentaliteteve konservatore, por me themele traditën mund të vihet në ballë të zhvillimeve civilizuese, projektoi edhe dasmën e vet. Por e çuditshme është se ky mesazh, më shumë u përthye në prizmin e mentalitetit gatuan, nga njera anë me mentalitetin komunist dhe nga ana tjetër me meskinitetin politik të kohës me themel po demagogjinë komuniste, se sa arriti në destinacionin e vet shëqëror. Densiteti i veprimit negativ të këtij “prizmi” ishte i tillë sa që aktorët dhe faktorët më të rendësishëm të jetës opinionbërëse dhe kulturorpromovuese në vend, e përjetuan dasmën nga brenda, si dasmorë, por nuk guxuan të kapen pas mesazhëve të protagonistëve të saj, çiftit të ri Veliaj. (Nën presionin e këtij opinioni meskin natën e dasmës se E.Veliaj në kalanë e Gjirokastrës nuk u ndezen dritat dekorative .Nëse vërtet është ashtu kjo është e turpshme.!)

Përmbajtja e energjisë negative të këtij prizmi përvijohet në frazat: “Vetëm Zogu bëri dasëm të tillë” që konsumohej në publik me frymëzim nga demagogjia komuniste dhe, “Bëjnë dasëm me taksat e popullit”, - që frymëzohet e konsumohet nga politika e opozitës.

Bartësit e mentalitetit meskin dhe urrejtës për dasmën e Zogut, rrojnë akoma me opinionin socialist shqiptar manipuluar nga E. Hoxha për të mbjell urrejtjen popullore ndaj paraardhësit të tij. Këta edhe pas 25 vjetesh hapjeje dhe komunikim me botën nuk arrijnë të kuptojnë se dasmat mbretërore dhe në familjet mbretërore përbëjnë even historik, shoqëror, kulturor e politik, jo vetëm për atë mbretëri por edhe mbarë botën. Një ngjarje e tillë ka brenda trille, drita, modë, estetikë, dhurata, pjesëmarrje vip, prapavijë politike e deri edhe risi për dasma të thjeshta. Në vendin tonë nuk mund të vazhdohet me meskinitetin komunist se dasma e mbretit Zog, duhej të bëhej jo në pallatin mbretëror, por në një mjedis ahengjesh e sa më varfër, dhe se mënyra se si u bë përbën një turp kombëtar pasi ai ishte mbret i një populli të varfër që edhe me dasmën e tij e varfëroi edhe më shumë. (!!)

Aq me shumë nuk mund të pranohet që ky meskinitet të bartet për të gjykuar dasmën e një ministri të sotëm. Aq më keq kur këto mentalitete e paragjykime bëhen pjesë e arsenalit politik të opozitës.

Nga pikëpamja sociale, tradicionalisht dhe aq më shumë sot, dasma nuk përbën thjesht një ngjarje familjare që ka si qëllim në vetvete krijimin e familjës dhe të pasardhësve. Përveçse se ajo lidhet me konstituimin e ndryshimeve cilësore në jetën e dhendrit dhe të nusës, (që shprehet me gëzimin e dasmës, të urimeve dhe të “kodeve” që sigurojnë jetëgjatësi dhe lumturi), dasma është më shumë një even shoqëror. Protagonistët synojnë evidentimin brenda komunitetit të tyre të fisit dhe sidomos të shoqërisë. Në rastin e personazheve vip kjo bëhet edhe më evidente dhe atmosfera shoqërohet me përcjellje mesazhesh pozitive në shumë drejtime.

Ministri Erion Veliaj dhe e zgjedhura e tij e jetës Ajola Xoxa u kujdesën që të mos e kapërxënin këtë kuadër dhe ia arritën qëllimit. (I ndihmoi dhe zoti që ndaloi shiun në momentin e duhur).

Dhëndri pra, është një Ministër i qeverisë aktuale. (Rrallë ndodh që të kemi ministra kaq të rinj e për pasojë dasma ministrash). Rrethi i tij shoqëror ka komunikim të drejtpërdrejtë me ajkën e shoqërisë. Deputetë, ministra, njëri të botës së artit e

kulturës, të medjave, faktorë politikë e shoqërorë brenda e jashtë vendit. Pra nuk ka pse të duket e çuditshme pjesëmarrja VIP, e as sharmi i dasmës.

Si ministër dhendri ka gjithë të drejtën me vete që të ketë përkujdesjen e duhur të qeverisë dhe të shoqërisë. Ne, si shoqëri, duhet të mësohemi të investojmë për eksponentët tanë politikë, kulturorë e shoqërorë. Nëse nuk arrijmë të bejmë këtë atëherë tregojmë se kaplohem nga civilizim të mangët dhe vlerat shoqërore e kulturore kërkojmë t'i ngërthejmë në qerthullin e provincializmit, meskinitetit barazisë puritane e denigruese. (Dëgjohet shumë banale deklarata masovike e opozitës se bëri dasëm me taksat e popullit !)

Dihet gjithashtu se jeta personale e një personazhi VIP, kurrë nuk mund të shkëputet me thikë nga funksionët e tij shoqërore e politike. Këtë relatë opinionin publik ka treguar interes për ta parë vetëm në rastet negative, për të zbuluar e trajtuar skandale. Përpjekja për të parë edhe evenin në fjalë –dasmën në këtë prizëm, duke adoptuar madje edhe mentalitete të manipulimit komunist, është e denueshme. Më sakt duhet parë si frenuese të civilizimit.

Erion Veliaj zgjodhi për dasmën e vet Gjirokastrën, qytet me të cilin e lidhi ngusht përvoja e re politike. Pra, që në krye të herës even-i i dasmës ishte një martesë e privatësisë me funksionin politik. Kjo “martesë” ka një rrjedhim logjik e që vijon përkushtimin e tij për të kontribuar për Gjirokastrën. Po ashtu, vijon edhe mesazhin e krijimit të risive të reja kulturore për qytetin, i cili kishte vite që në këtë drejtim ishte paralizuar.

Brenda kësaj kornize duhet parë edhe raporti i dasmës me kalanë. Ishte një zgjedhje shumë sinjifikative, shkon përshtat me të qenit ministër dhe me përzgjedhjen për ta berë dasmën në Gjirokastrë. Dikush mund të thotë se u prek dinjiteti i kalasë nga ky even privat.(!!) Ka shumë përgjigje gojëmbyllëse edhe për këtë tezë.

Së pari. Mendoj se komuniteti ynë civil dhe politik asnjëherë nuk ka traguuar interes për integritetin historik, kulturor, estetik, turistik të kalasë së Gjirokastrës. Është parë e trajtuar si gjithçka tjetër që preferojmë të rrenohet se sa të jetë, pasi, mendojmë, se kapërren përmasat tona.

Së dyti. Në kalanë e Gjirokastrës kanë dhenë koncerte kengëtarë nga më të zakonshëm e medjokrë, apo janë organizuar aktivitete të tjera pa asnjë velrë.

Se treti. Në botën e civilizuar shteti jep falas tek privati monumente të tilla kulturore, mjaftë që ai, privati t'u jap jetë.

Me këtë logjik argumentimi, mund të vazhdojmë edhe për gjera të tjera, më të imta, por besoj se është e mjaftë thirrja: Edhe dasma kongrete është një rast i mirë për të ndihmuar vetëm të jemi më civilë, qoftë edhe në sensin me të thejstë që të arrijmë të shikojmë anët pozitive të një ngjarjeje që ndodh të paktën për herë të parë.

T'i japim të drejtën vetës që ta lidhim e ta angazhojmë më shumë ministrin, deputetin dhe njeriun Erion Veliaj më qytetin e të kontribuojë më shumë për të, pasi Gjirokastra ka më shumë nëvojë për njerëz të këtij rangi dhe jo ata për atë. (Lë të çlirohemi edhe nga arma e fundit kërcenuese –vota).

Së fundi edhe urimi im për çiftin e ri: -Fat të lumtur!!

Panajot Barka



**Nga Panajot Barka**  
**Ndryshimet e thella të pritshme nuk mund t'i sjellin strukturat e korrupsionit te shtetit dhe politikës**

12.09.2014

Në një koment të ditëve të fundit me objekt arrestimin e guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, avokati i njohur Spartak Ngjela nënvizonte idenë se: “Shoqëria shqiptare, ose është në prag të një ndryshimi të madh, ose në prag të një fundosjeje tërësore.”....

Precitimi i shpejtë i ngjarjeve në javën e fundit po e vërtetojnë Ngjelën, në planin se kemi të mbëjmë me një dilemë që prek thelbin e shoqërisë shqiptare. Nga informacioni që rrjedh në medja, sidomos nga persona me lidhje të ngushta me personazhin e arrestuar, vërtetohet se tek ai kalonin të gjitha fijet e krimit shtetëror të materializuar në para, ose e kundërta. E tregoi këtë më shumë hezitimi i politikës për t'u bashkuar me zemëratën popullore ndaj guvernatorit për skandalin në institucionin besuar atij. E tregoi gjithashtu mbrojtja pa takt e në panik nga kreu i qeverisjes së fundit 8-vjeçare dhe rrethi i tij.

Guri i provës për dilemën e Ngjelës nuk lidhet thjeshtë me arrestimin në fjalë, por me vendosmërinë e hallkave të shtetit të kapura nga krimi dhe politika, për t'i shpetuar këtij zinxhiri e për të hetuar e denuar atë. Realiteti thotë se “... ndryshimi i madh”, nuk mund të ndodh se brendshmi, nga vet strukturat e inkriminuara, nuk mund ta imponojë politika, pjesë e madhe e së cilës fle me krimin. Duhet një ballafaqim me protagonizëm të shoqërisë civile kur ka mirëkuptimin e politikës, ose kur i imponohet asaj.

Zhvillimet tregojnë se arrestimi i kreut të Bankës së Shqipërisë (me zbatimin e pjesës së dytë të skenarit për lirim të tij), është pjesë e planit për të neutralizuar e paralizuar atë pjesë të shtetit, përfaqësuar nga kryeministri Rama, që tregon vendosmëri për të shpërbërë krimin në Shqipëri në të gjitha format e tij dhe për pasojë pjesë e planit për të ruajtur të paprekur kupolën e krimit dhe për të penguar Kryeministrin në bindjen e tij për të bërë Shqipërinë shtet të vërtet ligjor.

Me këtë objektiv, rasti i guvernatorit të Bankës së Shqipërisë së kësaj vere përbën një paralele me verën e vitit 1998. Nga fundi i gushtit të 98-s, kur PD-ja sapo kishte mbushur vitin që kishte renë nga pushteti, policia arrestoi 6 kuadro të lartë të saj me akuza jo fortë bindese, ose lehtësisht të cënueshme. Kryeministri Nano u befasua në padijeninë e tij për këto arësime, por politikisht ishte i detyruar të pajohet me realitetin. Nga ana e tij Berisha deklaroi pak a shumë se tani na duhet një arkivol për t'i rezuar socialistët nga pushteti. Pas tre javësh arkivoli i erdhi dhe grushti i shtetit thjesht sa nuk u implementua.

Berisha, taktikën e tij të njohur që anonçon vet ato që ai ka “njohuri paraprake” se do të ndodhin, në rastin e skandalit të Bankës “paralajmeroi” se bëhet fjalë për një përpjekje të qeverisë për të kapur edhe institucionin e pavarur të Bankës së Shqipërisë, gjë që vë në rrezik stabilitetin financiar në vend.

Priste që Rama dhe mazhoranca të binin viktimë e këtyre insinuatave. Rama, edhe pse i ndodhur përballë zemëratës popullore në kërkesën për shkarkimin e guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, edhe pse kishte një përvojë jo të mirë për imazhin e tij nga këto protesta, u distanca me referencë respektimin e ligjit dhe të institucionëve. Berisha nuk mund të pranonte këtë sfidë dhe shpesh për ta nxjerrë Ramën në fushën e vet të betejës, shkonte shumë larg në punët e errëta të bankës, por bënte mprapsht me nxitim sapo konstatonte se shkelte në zona shumë të rrezikshme.

Në këto kushte erdhi arëstimi i guvernatorit. Më optimistët thanë se prokuroria dhe shënjat e para se u shkeput nga kapja. Të tjerë thanë se u imponua nga presioni popullor. Disa skeptikë thanë se u vu në mënyrë vullnetare në shërbim të politikës. Të tjerë më skeptikë akoma thanë se e arrestuan për të mos u bërë objekt asgjësimi fizik duke vendosur kështu paralele dhe lidhje me vrasjen e Santos.

Klani i opozitës së Berishës është shumë i qartë dhe i unifikuar. Prokuroria, sipas tyre, vëproi nën presionin e Ramës, i cili vetëm me arëstimin e guvernatorit ia arriti ta shkarkonte atë me qëllim kapjen e Bankës Shtetërore. (Me logjikën e tyre ithtarët e kësaj opozite zbulojnë vetën si inspiruesit e qëndrimit të guvernatorit për të mos dhenë dorëheqjen dhe të anëtarëve të tjerë të KM për të mbrojtur atë nga shkarkimi. Gjithashtu, duke gjykuar me përvojën e tyre për përdorimin e Bankës së Shqipërisë për interesat e tyre private, gjykojnë edhe pozitën e sotme se do të bëjë të njëjtën gjë).

Sido që të jetë, arëstimi krijoi një imazh pozitiv për prokurorinë (disa madje zbuluan edhe heronj brenda saj vetem e vetëm se ushtruan detyrën). Fatkikisht kët imazh pozitiv e “kori” shumica qeverisëse dhe personalisht Kryeministri Rama. Problemi është shumë shqetësues për kastën e vjetër politike që e shëmbën këtë shtet duke ia dorëzuar krimit. Dhe nuk është shqetësues se Rama, pavarësisht pengesave, rezistencës dhe propangandës frenuese të opozitës ia del pak nga pak në arritjen e objektivave të shpallura, por është shqetësues së pas kësaj pete zbulohen gatuesit e lakrorit të zi në dem të shtetit dhe shoqërisë.

Këtu në fakt qëndron problemi. Duhet penguar që të dyja. Edhe avancimi i staturës politike reformuese të Ramës, i cili përpos kësaj ka dukshëm dhe vetëm ai, gjithë përkrahjen e mundshme ndërkombëtare, edhe pengimi i ndëshkimit të krimit shtetëror.

Kjo, sipas tyre, arrihet fare lehtë. Me lirim të guvernatorit dhe mos ndëshkimin e tij. Dhe këtë aksion e ka në dorë gjykata e kontrolluar nga opozita dhe e “përkrahur” moralisht nga ithtarët e opozitës.

Në këtë kontekst, askush nuk mund ta besojë se gjykatësi Gjini Gjoni përbën një rastësi shorti që koncidoi me dhjetëditëshin e së drejtës për apelim të masës së arrestit me burg të guvernatorit. (Sigurisht që avokati i tij do t’ja paraqes apelimin gjykatës në momentin e fundit të skadimit të afatit me qellim që e drejta e gjyqimit në apel të jetë ekskluzivitet e gjykatësit Gjini.

Personalisht gjykatësi Gjini ka interes për ta liruar guvernatorin. Është një rast i mirë për ta përdorur nëse si mbrojtje ndaj vetës, dmth për të thenë se sulmohet politikisht për shkak se zbatoi drejtësinë në lirim të guvernatorit. Në përkrahje të këtij vendimi të pritshëm po bëhet një fushatë maramendëse në medja pro opozitës, ndërkohë që pjesa tjetër e medjas është rudhur. (Rudhje në këtë rast quhet dhe objektiviteti).

Kjo fushatë ka për qëllim që të denigrojë prokurorinë në vendimin e saj, ta akuzojë organin e akuzës së po përdorët politikisht dhe për këtë po bëhet qesharake, se po shkel ligjin, procedurat duke bërë një padrejtësi të madhe, të arrestojë guvernatorin e vendit me akuza të pabaza e të pajustificuara. (Në pathosin e tyre në këtë fushatë tregojnë se dinë shumë nga mekatët e guvernatorit, ose janë edhe vetë bashkëmekatarë, por për momentin për ta kjo nuk ka fare rendësi).

Këtë shans përkrahësve dhe përdoruesve të guvernatorit dhe fatit të tij njerëzor e institucional, e çvlerëson me qëndrimin dhe taktikën e vet kryeministri Rama. Ai nuk mirret me një guvernator të shkarkuar ligjërisht, por me veprime institucionale që kanë të bëjnë me forcimin e institucionit të Bankës së Shtetit. Kryeministri e kupton se do të ishte gabim dhe masovizëm, dhe me keq akoma do të luante në fushën e opozitës, nëse do të investohej politikisht në lidhje me fatin e guvernatorit, me mekatët e tij apo qoftë edhe me fjetet dhe kavot që e përshkojnë atë. Këtë Kryeministri ia la në dorë drejtësisë,

e cila ka radhën e reformimit. Në parim dhe taktikisht kjo do të thotë se rrjeta po ngrihet edhe për peshkaqenët e mëdhënj, pasi një sulm frontal ndaj krimit të organizuar, kur dihen përmasat e tij dhe forca e tij, do të provokonte një reagim me kosto ndoshta të papërballueshëm. Këtë ndoshta donte opozita, por një fajalë e urtë thotë: “ Trimi i mirë di dhe monopate të tjera”. Eshhtë rast të bëhet dhe “me shokë shumë”. Për gazetën TEMA 12.09.2014.

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2014/09/16/rasti-fullani-dhe-fullanizimi-i-rendit-tone-shoqeror/>

### **Fullani, dhe fullanizimi i rendit tone shoqeror.**

16.09.2014

Rasti Fullani po zbulon pa mëshirë në terë madhështinë e vet mekanizmin e pandëshkushmërisë të krimit me kravatë në piramidën shtetërore. Në një skandal financiar në Bankën Qëndrore të shtetit, (vjedhje parash në përmasa të mëdha, për një kohë të zgjatur dhe me mënyra të ngjashme me vjedhjen e thesarit me 1997-1999), mekanizmat e shtetit dhe të shoqërisë civile tregojnë pamundësi të spikatur për t'u marrë me fajtorët kryesorë, ose me përgjegjësit primarë.

Pandëshkushmëria e fajtorëve VIP në shtet sigurohet nga politikanët. Këta të fundit të rreshtuar në grupime politike, organizojnë sistemin mbrojtës të të parëve, të cilët pranojnë të shndërohen në vegla të interesave të këtij sistemi. Të dy palët hyjnë në relata përvetësimi të së drejtës mbi shtetin duke ia nënshtruar atë krimit.

Skandali Fullani po nxjerr gjithashtu në pah gjerësinë dhe thellësinë e sistemit të krimit me kravatë. Po ashtu, bëhet fjalë për një sistem mbrojtës të fajëve VIP të ngritur nga qeveria e djeshme. Vetmohimi më të cilin mbrohet ky sistem dhe paralelisht krimi me kravatë sjell identifikimin me krimin dhe fatkeqësisht misioni i opozitës së sotme. Gjithësesi, mekanizmi është i thjeshtë.

**Së pari**, Fajtorët VIP i shkelin ligjet me koshiencë se kanë siguruar nga politika një mbrojtje ligjore. Në këtë kuptim, mekatarët VIP, ose veprojnë në kendet e vdekura të legjislacionit, ose në kufirin e evazivitetit ligjor, ose në vakum ligjor, ose akoma edhe në garanci ligjore. Të gjitha rastet janë parashikuar enkas nga ligjvënësi politik. Edhe në rastin Fullani legjislacioni është ndërtuar i tillë që të mos keët institucion i cili të iniciojë të paktën shkarkimin e tij. Gjëja më e thjeshtë dhe e logjikshme do të ishte që ligji të parashikonte një paralele institucionale shkarkimi të kundërt me atë të zgjedhjes. (!!)

E njëjta situatë paraqitet edhe me drejtësinë. Në emër të pavarësisë së Gjyqësorit është ndërtuar një legjislacion që i ka garantuar një pavarësi absolute gjykatësve e cila pavarësi është e pacenueshme edhe kur gjyqtari i thjeshtë në dhënien e drejtësisë shkel zbatimin e ligjin me të dyja këmbët. Ai në emër të ligjit është i pandëshkueshëm.

**Së dyti**. Pandëshkushmëria e eksponenteve të lartë në piramidën shtetërore, pas mbrojtjes ligjore ka siguruar mbrojtjen e përfaqësuesve të politikës, ose të sistemit politik, por në emër të interesave personale ose të grupit politik. Në rastin Fullani nuk bëhet fjalë thjeshtë për mbrojtjen publike që ai ka siguruar nga rrethi i ngushtë i ish kryeministrit të vendit. Mbrojtja nga ky i fundit do të ishte shumë kompromentuese për guvernatorin e Bankës së Shqipërisë nëse ai nuk do të kishte mbështetjen provokuese të shumicës absolute të Këshillit Mbykqyrës të Bankës, i vetmi institucion që mund të iniciojë shkarkimin e tij. Anëtarët e këtij Këshilli janë përfaqësues të forcave të caktuara politike dhe faktet tregojnë se janë katapultuar aty për t'u shërbyer jo ligjit por interesave të këtyre forcave politike, apo edhe eksponenteve të tyre. Ky fakt vërtetohet edhe nga banaliteti i çvlerësimit të integritetit moral të njerëzve me tituj akademik në KM të Bankës. Ndërkohë, fije të ngjarjeve që tronditen të kaluarën e afërme politike në vend kalojnë nga oborri familjar i Fullanit gjë që më sa duket siguron heshtjen olimpikë të faktorëve të tjerë politikë në vend.

Janë pikërisht këto relata që në vijim bllokojnë edhe angazhimin institucional të ingranazheve të tjera të shtetit, siç është në rastin kongret prokuroria. (Në deklaratën e fundit të KM të Bankës lëxohet qartazi midis rreshtave se Guvernatori i Bankës do të

jap dorëheqjen pasi të mbarojnë hetimet. (!). Normale do të qe të jipte dorheqjen që t'u hapte rrugën hetimeve... !)

E njëjta skenë garanton pandeshkushmerinë në drejtësi dhe në çdo institucion tjetër publik duke filluar nga ministrinë e duke mbaruar me universitetet, ku shkelja e ligjit është e evidente, por deri më sot nuk kemi asnjë zyrtar të lartë të këtyre institucioneve prapa hekurave. Vini re, mund të përfundojë ndonjë syresh aty, vetëm nëse i kundërvihet sistemit që e mbron.

**Së treti.** Në aspektin e opinionit publik, mënyra e sigurimit të pandeshkushmerisë së zyrtarëve të lartë shtetërorë ndodh nëpërmjet spostimit të vëmendjes publike dhe institucionale nga problemi kryesor.

Në rastin e Fullanit ky spostim vëmendjeje konstatohet në disa forma. Më interesant është fakti që asnjë nga faktorët protestues ndaj Fullanit, nuk kërkon dorëzimin e tij para ligjit, por thjesht shkarkimin e tij. Kjo gjë vëhet re edhe tek kundërshtarët me të ashpër të Fullanit, qofshin politikanë, ose jo. Çfarë do të thotë kërkesa për shkarkimin ose dorëheqjen e tij dhe jo ballafaqimi me drejtësinë? Në aspektin shoqëror kjo kërkesë shpreh një motiv zillie për aktin e kryer, atë që e bëri Fullanin të pasur (!!). Në aspektin ligjor dhe politik kjo do të thotë pandeshkushmëri. Pra, dukshëm kemi një spostim të vëmendjes nga ajo që është thelbësore dhe që lidhet me ndëshkimin e fajit, në atë që është dytësore e që lidhet në rastin më të keq me aspektin moral dhe në rastin më të mirë e që ndodh rëndom, me masën administrative të lëniës së karrigës, për t'u zëvendësuar me një pasardhës më të denjë se ai që iku pa i hyrë gjemb në këmbë.

Rast ekselent të spostimit të vëmendjes nga problemi madhor, nga pylli tek pema, është në zhvillim edhe në një front tjetër të rëndësishëm siç është ai i Reformës në Arsimin e Lartë.

Dihet që vitet e fundit në vendin tonë u instaluan në formën e qoskave piramidat e univeristeteve private dhe u injektua shkatërrimi i sistemit universitar publik. Ato në funksionin e tyre të fitimit në të zi ose të larjës së parasë së pistë, sollën epideminë e diplomave të blera. Ky fiktivitet absolut arsimimi universitar infektoi në masë absolute shkollimin e rinisë. Spstoi në kohë, në mënyrë mekanike, papunësinë duke i dhënë natyrën e papunësisë me diploma, qoftë edhe formale. Njëkohësisht kënaqi, por në mënyrë fiktive edhe nëvojën e administratës publike për rritjen cilësore të nivelit të arsimimit. Fjala është për pyllin e kërpudhave të titujve akademikë. Në këto kushte në parim të gjithë janë dakort për nëvojën e reformës në arsimin e lartë. Madje fajtorët e situatës kriminale në këtë sektor, kanë edhe propozimet më të mira. Por, në praktikë, këta mëkatarë me përgjegjësi ligjore ekstreme e në vijim përgjegjësi morale, politike, shoqërore për situatat kërcenuese në arsimin e lartë, marrin inisiativën për të spostuar vëmendjen nga procesi i reformimit të nisur në arsimin e lartë. Ata harxhojnë energji të pafundme për të spostuar vëmendjen tek një individ në mekanizmin implementues të kësaj reforme, (një drejtor në MAS që u mor me inspektimin e IAL-ve në vend), duke vërtetuar kështu faktin që ajo që u intereson më shumë atyre, është mbrojtja e sistemit që prodhoi krimin e organizuar edhe në arsimin e lartë.

Mënyrat e tjera të spostimit të vëmendjes nga krimi me kullaro i sistemit mbrojtës të tijjanë: Minimizimi i fajit, ose manipulimi i faktëve, ndërtimi i skenarëve se goditja e krimin me kullaro ka prapavijë politike etj. E gjithë kjo siguron zgjatje në kohë për të zbutur efektin goditës, për të arritur neutralizimin e akuzave në pjesën përmbyllëse të sistemit mbrojtës të krimin me kullaro që është ai i drejtësisë.

Është fakt tradite që në vendin tonë të gjithë ata zyrtarë që shkelin ligjin, shpërdorjnë postin dhe i shkaktojnë vendit dëme të mëdha ekonomike, financiare, politike e shoqërore, thjesht shkarkohen. Asnjëri prej tyre nuk i është dorëzuar

drejtësisë për fajet e kryera kundër shtetit dhe shoqërisë. Edhe kur i dorëzohen drejtësisë, kjo e fundit Ose në rastin më të keq, në vend të tyre denohen disa fakirë që janë thirrur në rolin e levës së kryerjës së krimit dhe për lirinë e tyre duhet të heshtin.  
FUND.

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2014/09/25/gandizmi-qeverises-si-domosdoshmeri-per-te-mposhtur-te-keqen/>

### **“Gandizmi” qeverisë si domosdoshmëri për të mposhtur të keqën.**

25.09.2014

Vizita e Papës nga një realitet i dëshiruar njëditor, u kthye me nxitim në një moment historik, të cilin po e shpërfiton realiteti politik i përditësuar shqiptar. Drita e vizitës së Papës, epranuar si një motiv rezistentë për ndryshim mentaliteti politik e shoqëror, po ndriçon më shumë errësirën tonë. Në këtë kuptim ditët që e pasojnë këtë vizitë historike po u kundërvihen mesazhëve të Papës, saqë mund të thuhet se shqyrr që vizita zgjati aq orë saqë realiteti ynë nuk pati kohë dhe energji që t’i kundërvihet dritës së Papës. Kjo e vërtetë përvijohet kryesisht tek përndezja e etheve të opozitarizmit ndaj qeverisë, qeverisjes dhe përpjekjeve të saj për reforma. Përndezja lidhet me faktin se suksesi i vizitës së Papës dhe rëndësia e saj historike për mesazhe të karakterit ekumenik që përcolli, iu dedikua qeverisë dhe personalisht Kryeministrit. Në llogaritë e opozitës kjo përkthehet si rritje të kredibilitetit të tij ndërkombëtar. Për pasojë rritet rrezikshmeria e Ramës për shkatërrimin e antishtetit. Ndaj edhe të gjitha shigjetimet, pavarësisht nga nisen dhe kë kapin, kanë për objekt final Kryeministrin. Synimi kryesor nuk lidhet aq me mos lëjimin “e kapitalizimit” nga Rama të suksesit të vizitës së Papës, por me nxitjen ndaj tij të reagimeve negative në nivele të ndryshme dhe mundësisht popullore. Veçimi i Ramës nga çdo gjë e tija dhe sidomos nga objektivat e tij politike, është kthyer në qëndër të aksionit politik opozitar. Në këtë këndvështrim këto struktura opozitariste nuk pyesin për mesazhet e Papës, as për dëmtimin e pasaportës ndërkombëtare që i dhanë këto mesazhe Shqipërisë. Pra, e keqja tek ne ka potenciale në përpjestim të zhdrejtë me të mirën që përfaqësojnë mesazhet e Papës.

Kështu, të nësërmën e kësaj vizite historike, ish kreu i qeverisë, jo vetëm që publikoi një foto të tij përkrah Papa Gjon Palit II në vizitën e tij në Shqipëri me 1993, (për të treguar se edhe ai kishte sjellë një Papë në Shqipëri), por në një intervistë në një kanal televiziv që i bën fresk me takt atij, u përpoq me gjithçka munda të fliste kundër kryeministrit të vendit, kur në fakt u pyet për rëndësinë e vizitës së Papës një ditë me parë. Tre ditë me vonë, gazeta partiake e drejtuar de fakto po prej tij, hapej me okelion me shkronjat më të mëdha të mundshme, ku thuhej “Ta futim bishën në kafaz”. “Bisha”, sipas gazetës, identifikohet me kryeministrin e vendit, i cili mbajti peshën kryesore në shkelqimin e vizitës së Papës në Shqipëri, duke i krijuar Atit të shenjtë dhe popullit shqiptar gjithë komfortin e mundshëm për një impresion historik.

Dy ditë pas largimit të Papës nga Tirana, prokuroria e përgjithshme i përktheu mesazhet e Papës, për paqe, drejtësi, bashkëhetesë, tolerancë e mirëkuptim me marrjen si të pandehur të dy deputeteve të mazhorancës për rrahje për shkak të detyrës dhe të një deputeti të opozitës për ndërtime pa leje. (!!) Kjo i dha shkas opozitës të shpërthejë në klithma patetike ndaj kryeministrit duke e akuzuar atë për drejtues “fallangash krimi”. (Pak i intereson akti i dhunës si i tillë) Askush nuk i zë dorën prokurorisë për të zbatuar ligjin. Por ligji ka në thelbin e tij moralin civil, metrin e arsyes dhe dimensionin politik. Po, është e denueshme dhuna fizike midis deputetesh dhe në mjediset e parlamentit. Por, vendimi i prokurorisë demotivohet kur hesht për ata që kanë vrarë njerëz me koshiençë politike, apo me ata politikanë që kanë vrarë njerëz për interesat e tyre ekonomike. Aq me keq mund të shfrytëzohet një moment i tillë nga padronët e vërtetë të krimit për të fituar të drejtën morale për të akuzur për kriminalizim Kryeministrin. (Pa çuar asnjë fakt në prokurori)

Duket sheshazi se thelbi i kësaj kundërvenieje të qëllimeshme ndaj mesazheve të Papës ecën në dy shina. E para lidhet me përpjekjen për të qemtuar çdo detaj, sado të vogël, të gabimeve të qeverisjes e për ta zumuar atë në ekstrem. P.sh analistë të spikatur opozitarë, ata që i qëndruan Papës në krah më shumë se vet Rama, apo edhe të tjerë, u munduan të minimizojnë deri në eklips kontributin e Kryeministrit në këtë vizitë (apo dhe ta nxjerrin dhe sabotator) duke abuzuar me deklaratën emotive të Ramës për bekimin e djalit të tij nga Papa. (qëmtuan protokolle dhe parime, raporte prind - kryeministër, zyrtare dhe njërezore etj) Ose, në deklaratën e Ramës për vendimin e fundit të prokurorisë, nuk i kushtuan vemendje asaj që është esenciale,-distancimin e Kryeministrit nga vendimet e veprimet e këtij institucioni, por vunë lupën për të zumuar idenë e tyre se kryeministri është i zenë peng nga interesa e nga krimi dhe se deklarata në fjalë shpreh dëshirën për të qenë ai që nuk mund të bëhet kurrë!

Qëllimi mbetet i dukshëm dhe synon minimizimin e çdo sukcesi qeverisës, paralizimin e energjive pozitive, ngadalësimin e reformave, ruajtjen e antishtetit dhe interesave okulte që mbrohen nga krimi. Shina e dytë lidhet me përmbysjen e realitetit moral të opozitarizmit. Që do të thotë se opozita kërkon të fsheh dhe të harrohen përgjegjësitë dhe fajet që i shkaktuan asaj mungesën totale të moralit civil e politik, për të justifikuar të drejtën për luftë politike opozitare dhe për të motivuar një kauzë politike brenda radjëve të saj, por që në fakt gjenerron energji destruktive ndaj mazhorancës.

Reformat e inicuar nga Mazhoranca, ajo kundër trafikëve, e ndarjës administrative, reforma në zhvillim në arsim, ajo e nisur në drejtësi, lufta ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar etj, hasin përditë në një rezistencë të opozitarizmit i cili është edhe fajtoiri kryesor në ngritjen e këtyre sistemeve të kriminalizuara. Ajo që vihet re është fakti që ky opozitarizëm përpiqet të shrytëzojë çdo mjet që të përfshijë në skemat e veta sa më shumë njerëz e popull. Psoi fiasko në përpjekjen për rritjen artificiale të kriminalitetit dhe të pasigurisë në vend. Dështoi në “aksionin” e vonuar të saj kundër trafikëve të drogës. Nuk pati asnjë jehonë në përpjekjen për kundërshtimin e reformës administrative. Tani, tek po e sheh të pamundur të bëj pjesë të komunitetit dhe opinionit publik përpjekjen e vet për sabotimin e reformës në drejtësi, nxit e manipulon peshtjellim në reformën për Arsimin e Lartë. (Mijrat e studenteve të universitare private, nuk atakojnë këto piramida të ngritura nga kjo opozitë, nuk ngrihen kundra tyre për shrytëzimin që u bëhej nëpërmjet mashtrimit për vite me radhë, por kërkojnë zgjidhje nga Ministria e Arsimit. !!)

Pra është fakt që opozita në aksionin e vet nuk gjen jehonë në opinionin publik dhe sa më shumë qeveria esën përpara në rrugën tëpër të veshtirë të realizimit të objektivave të veta politike, aq më shumë rritet dhe ambicja e opozitës për ta penguar këtë rrugëtim. Boshllëkun e mbështetjës popullore në këtë antikauzë, opozita përpiqet ta plotësojë me një opozitarizëm virtual.

Tregues për këtë është shkrimi i një gazete të djeshme që thoshte se nuk rezohet Rama me Fb. Kjo do të thotë se qëllimi i opozitës është rrezimi i kësaj mazhorance. “Lufta në Fb” apo rrjetet e tjera sociale, ka të bejë me atë që opozita duket se ka angazhuar një numër të caktuar konsumatorësh të këtyre rrjeteve të cilët sapo ndonjë eksponentë i qeverisë publikon ndonjë veprimtari të tij, ata sulën me frymën opozitariste e denigruese të skajshme. (Një lexim i vemenshëm i reagimeve të tyre vërteton se i përkasin së njëjtës bashkësi)

Mëgjithatë, e keqja në përgjithësi është tmerrsisht e madhe. Kësaj të keqeje i shtohet varfëria dhe në përgjithësi vështirësitë ekonomike për shtresat e gjera, por edhe mentaliteti korruptiv i opozitës së djeshme që spikat në shumë drejtues të mazhorancës së re. Përballë këtij realiteti qeveria e tanishme duket se iu përshtat një “gandizmi”, por qeverisës, që presupozon drejtimin e vendit, nëpërmjet ecjes, qëndresës, rezistencës,



reformimit, vetkorrigjimit të njëkohshëm. Pa renë në grackën e destruktivitetit opozitar, por duke i hapur opzites kanalet e bashkëpunimit. Pa bërë kompromis me krimin e strukturat e kriminalizuara, por duke u prerë atyre fijet. Ky gandizëm qëverisës është ndoshta më i përshtatshmi për të mposhtur të keqën dhe më i identifikueshëm për mësazhët e Papës për realitetin politik shqiptar.

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2014/10/05/mas-dhe-rishikimi-i-teksteve-shkollore-me-greqine/>

### **MAS dhe rishikimi i teksteve shkollore me Greqinë**

05.10.2014

Kohët e fundit, marrëdhëniet Shqipëri – Greqi duket se po dalin nga stanjacioni i diktuar më shumë nga mentaliteti historik, i cili, për palën shqiptare prodhon antihelenizmin si formë nacionalizmi veprues deri në vetëpërcaktimin etnik. Për palën greke prodhon një rezervim dhe mosbesim ndaj seriozitetit të faktorit shqiptar e që ushqen një nacionalizëm, por në izolim dhe pa asnjë përkrahje nga politika zyrtare dhe opinioni i shëndoshë grek.

Fundin e këtij “stanjacioni” e stigmatizojnë së fundi dy akte që shkojnë në mënyrë pingule kundër mentalitetit të mësipërm. Së pari bëhet fjalë për nënshkrimin e marrëveshjes dypalëshe për korrigjimin e toponimeve të vendeve respektive në dokumentat zyrtare të shtetasve të të dy vendeve. Së dyti, një hap më përpara shënon njoftimi i fundit i MAS për funksionimit praktik të komisionit dypalësh për lirimin e teksteve shkollore nga termat, të pavërteta historike, konceptet, pretendimet dhe interpretimet jo objektive e antihistorike, e që cenojnë interesat e secilit vend dhe të të dyve së bashku.

Marrëveshja e toponimeve, përveç se zgjidh një problem praktik për mijra shqiptarë të lindur në Greqi, për të lëvizur lirshëm në shtetin helenë apo edhe në vendet e tjera të Shengenit, ka një interes të padiskutueshëm në fushën e respektimit reciprok të toponomastikës së çdo vendi, nga ku shpesh burojnë pretendime nacionaliste.

Më shumë rëndësi në këtë drejtim ka akti i dytë, ai i funksionimit të komisionit dypalësh për tekstet shkollore. Në planin diplomatik nënvizon predispozitën që komisioni konkret nuk u ngrit për të neglizhuar në infinit objektin për të cilin u ra dakort, siç ndodh rëndom, por për ta zgjidhur atë. Evidentohet qartazi se faktori politik i të dy vendeve, vëçanërisht ai shqiptar, tregon vendosmeri për t’ju kundërvënë mentalitetit mbi një shekullor, i cili, të paktën sot, prodhon konfliktualitet e armiqësi virtuale. Ose që qemton momentet rastësore e në minorancë të papërfillshme në marrëdhëniet shekullore midis dy popujve, për të përgjithësuar e shkruar një histori konfliktuale.

Pa dashur të merrem me detaje objekt diskutimi e vandimarrjeje të këtij komisioni dypalësh, si njohës i dyanshëm i problemit më takon të perseris, se ajo që i përshkon marrëdhëniet e dy popujve tanë në shekuj, karakterizohet nga bashkëjetesa, toleranca, bashkëpunimi, madje edhe në ato raste kur pushteti politik prodhonte disbalanca shoqërore, fetare, politike dhe ekonomike. Të perseris, por në një plan tjetër, përceptimin e Çabej dhe Kadaresë se Greqia ishte pjesë e Shqipërisë, në kuptimin se kishte një ndikim kulturor në formësimin e shqiptarësisë. Është fakt historik se në pjesën më të madhe të shekullit XIX Greqia përbënte aspiratën e përbashkët për liri nga perandoria otomane. Është kjo arsyeja që kaq shumë shqiptarë, të krishterë e myslimanë, iu bashkuan aksionit politik e luftarak për lirinë e Greqisë. Këtu e ka burimin ideja jetëgjatë e ajkës intelektuale shqiptare e greke të kohës për konfederatë shtetërore shqiptaro-greke. Modelin e ideologjisë kombëtare greke, i cili kishte dhënë frytet e veta konkrete në revolucionin grek të 1821, adoptuan ideologët e Rilindjes Kombëtare shqiptare etj.

Por, besoj, se deduksionet romantike të ideologëve të Rilindjes Kombëtare për historinë dhe kombin, aq të domosdoshme për atë moment historik të kultivimit të ndërgjegjës kombëtare shqiptare, të ripërtpura nga makina ideologjike komuniste dhe të servirua popullit shqiptar si të vërteta të paverifikueshme për qëllimet e veta ideologjike, është

e palëjueshme të përdorën edhe sot si fakte historike po të padiskutueshme, bile pa lëjuar as ballafaqimin me historiografinë botërore.

Është e patolerueshme të përdorën, edhe në formë zyrtare, për të ushqyer midis shqiptarëve një nacionalizëm me tipar dallues antihellenizmin. Aq më shumë ka kaluar koha, që pretendime të atëhershme të perandorisë otomane në territore greko-shqiptare, të konsiderohen edhe në librat shkollorë si trashëgimi shqiptarë për shkak të bashkëpunimit me këtë perandori dhe ofrimit të shërbimeve në këmbim të ofiqëve, pasurive pushtetit etj.

Ky realitet e bën imediatë që të diferencohen faktet historike si të tilla, nga të vërtetat e paverifikueshme, nga interpretimet e shtrembërimet historike pa baza shkencore, apo nga përvetësimet e realiteteve historike e kulturore të tjetrit. Pas rilevimit të historisë në këtë kendvështrim është i domosdoshëm të diferencohen faktet nga jo faktet historike. Të diferencohen faktet që mësojnë histori, nga faktet që edukojnë perspektivën historike, - paqën, stabilitetin, bashkëpunimin, tolerancën mirkuptimin. Besoj se duhet dhenë fund një herë e mirë atij realiteti edukues i femijëve dhe brezit të ri që prodhon armiqësi midis fqinjëve dhe vëçanërisht me Greqinë. Shqipërisë i duhen marrëdhënie miqësie me fqinjët dhe fqinjëve po ashtu.

Këtë aksiomë na edukon edhe tradita shekulore midis shqiptarëve e grekëve në rajonin që sot gëlojnë mentalitete nacionaliste. Madje mund të thuhet se idenë e bashkëjetësës globale, që Evropa e Bashkuar e provon në dekadat e fundit, në këtë rajon tonin, ka egzistuar shekuj me parë, fillimisht si realitet dhe në vijim si ideologji.

Këtij modeli i shërbëjnë marrëdhëniet midis dy popujve që vendosën, pa pyetur politikën dhe nacionalizmin, mijrat e emigrantëve shqiptarë në Greqi, por edhe marrëdhënjet e shumëfishta të të dy popujve të cilat, bëjnë shpesh që kufiri shtetëror të mos jetë i mjaftueshëm për të përcaktuar kufirin e vërtet etnik, realitet që shpesh bëhet ushqim për dyshime dhe inferioritet të nacionalizmit ekstrem, në vend që të ndodhë kundërta.

Ndjekja e kësaj rruge imponohet dhe nga realitetet juridiko-politike të shtetëve me kufij të dhena dhe të pandryshueshme. Aq më shumë kur dihet se në kësi rastesh nuk ka të drejtë ai që bërtet më shumë. Imponohet gjithashtu, nga realitete juridiko-politike globale. Të dy vendet janë anëtarë të NATOS, të Këshillit të Evropës, OSBE-së, OKB-së dhe Shqipëria aspiron të njuhsojë statusin e vet me Greqinë në kuadër të BE-së. Ky realitet global është produkt i gati 50-60 vjetëve të fundit, ndërsa konceptet nacionaliste në shërbim të ideologjisë dhe politikës së brendshme izolacioniste e etnonacionaliste kanë rrenjë mbi një shekullorë. Kjo do të thotë se edhe në këtë drejtim po krijojmë një deficiet të konsiderueshme me botën e qytetëruar.

Fakt është që ky deficiet po kultivon një nacionalizëm të dyanshëm, i cili, megjithatë, ka një dallim krahasimor. Nacionalizmi shqiptar është ofensiv dhe ka siguruar një mbështetje shoqërore me ndikim në pushtetin zyrtar me argument antihellenizmin. Nacionalizmi grek, deri te forma e tij antishqiptarë, nuk gëzon një mbështetje të tillë. Shoqëria dhe strukturat shtetërore zyrtare përpiqen ta izolojnë dhe ta jashtëqitin. Zyrtarisht Greqia në raport me Shqipërinë ka provuar me fakte se konsumon energji në favor të integritetit të Shqipërisë në strukturat euroatlandike.

Prandaj, duhet pershendetur dhe inkurajuar, jo thjesht inisiativa e MAS, por vendimi i qeverisë për të ndërmarrë këtë hap. Ai duhet konsideruar si një sfidë ndaj mentaliteteve të një nacionalizmi vërtet dalë boje, por, që mbahet gjallë nga faktorë që provojnë egzistencën e tyre me streha nacionaliste të kësaj natyre, që në fund të fundit ushqejnë një kompleks inferioriteti kolektiv. Kuptohet që ka një kosto, por qeveria sot tregon se aspiratën Evropiane të popullit shqiptar, nuk mund të mbajë peng i një mentaliteti të tejkaluar, sado i fortë qoftë ai.

Zërat që dëgjohen se nuk do të lejojnë që ky komision dypalësh të funksionojë, tregojnë se këta faktorë kanë frikë nga e vërteta tradicionale dhe e ardhmja e aspiruar. Kanë frikë se u zbulohet e vërteta ku ata kanë mbështetur aksionin e tyre politik, për interesa të ngushta vetjake, ose të grupit.

Parimi është i qartë, unifikues dhe determinant. Koncepti i Evropës së Bashkuar mund të arrihet me një brez të ri të edukuar me frymën e fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit, tolerancës, miqësisë, multikulturës që të gjitha se bashku garantojnë prosperitet.

## **Nga Panajot Barka**

### **“Dora e hekurt” e reformave dhe mungesa e vullnetit shoqror për to.**

29.11.2014.

Lëximi i qartë i protestës së fundit të opozitës sjell në vëmendje rrugën antishtet të një pjese të shoqërisë shqiptare dhe nëvojën e saj për një dorë të hekurt për ta udhëhequr në këtë “kauzë”. Me këtë rrugë formon udhëkryq udha e heshtjes së një pjese tjetër të shoqërisë, madje e cilësuar si më përgjegjeshme për fatet e çdo vendi, ndaj dhe me heshtjen e saj bëhet edhe më fajtores se e para.

Nga ana tjetër është në veprim ndërmarrja e reformave në emër të shtetit ligjor nga ana e qeverisë së majtë. Është pikërisht kjo ndërmarrje e cila vuri në pah një kompleks fenomenesh që kanë futur në krizë të përgjithshëm shoqërinë shqiptare.

Zbuloi së pari, thellësinë dhe gjerësinë e gjunjëzimit të shtetit nga ana e opozitës dhe në qeveri, nëpërmjet inkriminimit të shoqërisë. (Mjaft që të provoje se i shtohesh vathës elektorale të saj, të ngrije dy gishtat lart dhe automatikisht të lejohej të hapje një vrimë në çisternën e shtetit për të jetuar e u pasuruar.)

Tregoi se ky fenomen u kthye në vlerë shoqërore, pasi kush dinte të përvetësonte më shumë nga shteti dhe nëpërmjet shtetit, ishte i suksesshëm në shoqëri.

Vërtetoi se administrimi i kësaj situatë gangrenizuese të shtetit realizohej nga një dorë e hekurt.

Zbuloi gjithashtu mungesën e vullnetit nga ana e vet shoqërisë për t’ju kundërvënë këtij realiteti. Ajo, në pamundësi për të projektuar bindshëm të ardhmën dhe e pa shpresë për të sfiduar realitetin, priret drejt rehabilitimit të antivlerave të së kaluarës nëpërmjet gërryerjës së shtetit. Shfaqet si kërkesë për t’u vetsunduar nga një dorë e hekurt, si mënyrë mbrojtjeje nga mëkati, si për të provuar egzistencën e vet, si mjet për të justifikuar paaftësinë për të reaguar, për të vepruar, jetuar e aspiruar në mënyrë civile.

Në këtë kendveshtrim, protesta e opozitës evidentoi nëvojën e ruajtjes së kësaj statukuojë, parimeve dhe “vlerave”. Mbrojtjen e inkriminimit masiv nga një dorë e hekurt dhe anasjelltas. Mbrojtjen e dorës së hekurt të inkriminuar. Kësaj tabloje i shtohet edhe nëvoja për të evokuar në formë nderimi ekstremitete të dorës së hekurt të diktaturës si Enver Hoxha, Feçor Shehu etj.

Duke kërkuar tek e kaluara paralelën tjetër të kësaj situatë do të arrinim në fillimet e shekullit njëzet. Atëherë kur një pjesë e shqiptarëve u shkante nga pas atyre që prinin me parullën “Duam babën” (perandorinë otomane të perënduar). Një pjesë tjetër u shkante nga pas atyre që vrisnin njeri tjetrin me shpresë se do të shpetonin nga hija e krimit ndaj vendit dhe kombit, kur dinin se pasuesit do t’i glorifikonin.

Diktatura komuniste e ngriti në sistem kundërvënien e shtetit ideologjik ndaj qytetarit të thjeshtë dhe sundimin absolut të tij deri tek nëvoja për vetsundim. E vërtetoi këtë fakti që tek ne antikomunizmi u shpreh me shkatërimin e gjithçkaje të e çdo vlere materiale dhe shpirtërore të krijuar nga po ata shqiptarë për gjysëm shekulli. Në gjendje mungese të ndërgjegjës për vlerat e veta dhe të trashguara, shoqëria po kthehej në turmë pas berihajt të ri, i cili tinëzisht, identifikoi të ardhmën me luftën ndaj të kaluarës. Në këtë betejë ftoi gjithë shqiptarët duke i joshur me trofe therrimet nga sofra e pasur e shtetit ku nuk mbaronte së ngreni padroni i ri teksa shndërohej në dorë të hekurt. Kjo kënaqësi shkatëruese u bë shtrati i ngrohtë i krimit të organizuar pa ngjyrë politike, që sundoi shtetin pluralist. Gjithçka po ndodhte me frymëzimin dhe nën garancinë e kësaj dore të hekurt. Në fakt bëhet fjalë për një të kundërt që ngjan si dy pika uji me të djeshmën, por që shumëfishoi pasojat e krizës të së kaluarës së afërme.

Në kësi kushtesh vendosmeria e qeverisë për të bërë reforma në emër të ngritjes së shtetit ligjor, detyrimisht do të marrë formën e një dore të hekurt.

Por, sa i suksesshëm, sa i rrezikuar dhe sa i rrezikshëm mund të jetë kjo dorë.

Së pari. Kjo “dorë e hekurt” duket se të çon tek dora e hekurt e Getes. Fatkeqësisht për ne, dorën e hekurt të qeverisë për reforma e bashkon me idenë e Getës vetëm qëllimi. Drasati i Gëtës është një thirrje e brendshme e vet shoqërisë gjermane të kohës, shek XVIII-XIX. Një kërkesë e saj për të mohuar të kaluarën, (anarkinë feudale) dhe sfiduar realitetin në emër të një perspektive me argument kryesor komb-shtetin e vërtetë ligjor, (i cilësuar organik, qoftë edhe si produkt i frymës së shenjtë). Që respektimi i ligjit të kthehej në ndërgjegje absolute, kolektive e individuale. Pra, dora e hekurt në rastin e Getës është personifikim i nevojës emancipuese të ndërgjegjës kolektive në koherencë të plotë me vullnetin e brendshëm të çdo gjermani të thjeshtë.

Tek ne ndodh e kundërta. “Dora e hekurt” nuk është produkt i brendshëm shoqëror për reforma të thella dhe imediate, por shfaqet si vullnetit elitari mbi një shoqëri të pavullnetshme për to dhe të ndikuar nga një dorë tjetër antireformë.

Nga ana tjetër, koncepti i dorës së hekurt tek ne është sundues në traditën tponë dhe shfaqet si arketip fiks, rrugëtimi i të cilit në diakroninë e kohës lidhet me krimin. Ndryshon nga shëmbujt e historisë botërore. Historia botërore njihë shëmbujt njerëzish të shquar që kanë pjesë të biografisë së tyre mëkatit, fajin, krimin. Por, ky fakt u shërbeu atyre si shtysë për vëpra sublime në shërbim të shoqërisë dhe të kombit të tyre. Dhe vetëm pas kësaj “shlyerjeje” të fajit kujtesa popullore dhe zyrtare u krijoi atyre një vend nderi në historinë kombëtare, ose botërore.

Në traditën shqiptare, fajtorë shoqërorë deri edhe kriminelë dalin në skenë, ose u hapet rruga për të ardhur në pushtet për të fshehur krimin pas postit civil a politik, për ta shfrytëzuar atë për tu shndëruar në dorë të hekurt, (makbethër shqiptarë). Tragjiciteti i kësaj sjelljeje lidhet me faktin se këta po kthehen në arketipa dhe glorifikohen, ndërsa ata që përpiqen për të kundërtën, kthehen në minorancë dhe u rezervohet një fat tragjik. Në këtë kontekst “dora e hekurt” e reformave të qeverisë ka për të përballuar dhe sfida të tjera të vet aktualitetit.

Thamë se ndodhemi në kushtet e mungesës së gadishmërisë shoqërore për reforma. Ajo vazhdon të jetë nën efektin e infeksionit të kompromentimit me krimin si mënyrë efektive jetese. Këtë mungesë vullneti e ndih edhe fakti se burimet formale për sigurimin në jetesë nuk po i zëvendësojnë ato informale. Bashkimin me opozitën (fajtorën bazë për këtë gjendje) si rrugë për të shprehur pakënaqësinë, tregon se pagadishmëria e njerëzve të thjeshtë për reforma po kthehet në rrezik antireformë.

Strukturat e shtetit që duhet të përbejnë mekanizmat efektive të këtyre reformave janë përgjithësisht në shërbim të dorës së hekurt antireformë. Qeveria ngeci në ndëshkimin e përgjegjësve shtetërorë për krimin ndaj shtetit e shoqërisë, pasi këto struktura të kapura i morën ata nën mbrojtje. Tani dora e hekurt e qeverisë po zbaton ligjin ndaj të inkriminuarve të thjeshtë, por pa mbrojtje. (ndaj vjedhësve masivë të energjisë që vidhnin me dijeninë dhe garancinë e shtetarëve) Drejtësia ndaj tyre do të jetë e pamëshirë, pasi, nga njera anë nuk do të gëzojnë mbrojtje politike (siç ndodh me fajtorët shtetërorë) dhe vështirë nëse të gjithë do të kenë mundësinë e mbrojtjes materiale, (se vidhnin për të jetuar). Nga ana tjetër një ndëshkim i tillë i diferencuar, gjithsesi, rrit pakënaqësinë e atyre që përbejnë shtresat e varfëra, -popullin. Krijon idenë e shtetit policor, që aq për shtat i shkon opozitës.

Po ashtu, qeveria për të ardhur në pushtet iu desh në mënyrë objektive, të përdorte edhe mjete e metoda të pushtetmbajtësve të atëhershme. Sot, këta “aktivist” kërkojnë shpërblim sipas të njejtave kontrata si me pushtetarët e djeshëm. Për qeverinë kjo përkthehet në haraç me kosto shumë të lartë politik. Aq me keq, kur dihet se ka edhe eksponentë qeverisës të cilët nuk mund të shpëtojnë nga mentaliteti i qeverisjës së

djeshme dhe klientelizmit në kurriz të shtetit e të shoqërisë. Kjo mund të rris partishmerinë, por zbeh meritokracinë.

Së fundi, në opinionin publik po përkthehet si mungesë kohëzioni i brendshëm politik në kampin qeverisës, dialogu dhe debati aq i domosdoshëm dhe aq karakteristik për koalicionin qeverisës.

Te gjithë këta faktorë janë sfida, të cilat qofte edhe me heshtjen e tyre, duket se janë në pritje, e cila fatkeqësisht po anon, nga pritja për të parë se çfarë do të bëhet, në pritje për të parë dorën e hekurt të reformave të dështojë...!

FUND

Për gaz TEMA, 29.11.2014.

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetama.net/2015/01/25/nje-fitore-historike-nje-hap-larg-humneres-historike/>

### **Nje fitore historike , nje hap larg humneres historike**

25.01.2015

Zgjedhjet historike në Greqi përfunduan me fitorën e SYRIZA-s. Por perse ato ishin historike?! Në aspektin ndërkombëtar shumëkush mund të kërkojë anën historike të këtyre zgjedhjeve në retorikën në lidhje me raportet e Greqisë me BE-në dhe Euro-n. Në aspektin e brendshëm me faktin se për herë të parë pushteti qeverisës i kalon së majtës së konsideruar radikale. Po ashtu mund të konsiderohen historike edhe për faktin se Greqia përjeton një krizë të rëndë dhe zgjedhjet u duk sikur po ndërprisnin një rrugë që po e nxirrte Greqinë nga recesioni.

Një analizë më e thellë dhe më e ftohtë provon se ana historike e zgjedhjeve në Greqi ngrihet mbi këtë diskurs. Thelbi i tyre paraelektoral u fiksua tek disa parametra më fundamentale për një shoqëri vërtet demokratike: Së pari, u evidentua dinjiteti i individit dhe i shumicës së popullit grek që frymëzohej nga shpresa dhe vullneti për të lenë prapa zhgënjimin. Së dyti, imponimi i votës nëpërmjet frikës së paraqitur si shkatërrim i endrës evropiane dhe si çvlerësim i sakrificave popullore për të dalë nga kriza nëpërmjet recetave evropiane. (por pa angazhimin e duhur të brendshëm) Së treti, u edidentua vota e protestës shumëplaneshë ku tërheq vemendjen vota për Agimin e Artë. (Vota e protestës në një fushë tjetër të rëndësishëm ishte vota për të mos lëjuar formimin e qeverisë njëpartiake.)

Zgjedhjet në Greqi provuan edhe një herë pjekurinë demokratike të popullit grek. Ai provoi se nje thellë se rruga për të ndryshuar gjërat në vend nuk janë protestat, reaksioni popullor dhe destruktiviteti, por ndryshimi i kursit politik nëpërmjet zgjedhjeve demokratike.

Në këtë kuptim ana historike e tyre lidhet pikërisht me këtë linjë. Populli grek me votën e tij dhe brenda pothuaj dy viteve po ndryshon skenën politike në vend. Pas goditjes që i dha bipartizmit në zgjedhjet e 2012, me zgjedhjet e 2015, vota popullore nxorri jashtë loje edhe partinë tjetër të madhe që sundoi për dekada skenën politike greke. Në fillim PASOK-u dhe tani Demokracia e RE humbën rolin e primatit në politikën greke. Bashkëqeverisja e tyre e shkurtër provoi se për zgjedhësin grek nuk ishte një risi historike bashkëpunimi i dy armiqve politikë për vdekje në emër të interesave të Greqisë, por një përpjekje e dështuar për të mbijetuar kundër vullnetit popullor, pra për të shpetuar vetën.

Zgjedhjet në Greqi, provuan se klasa politike greke ishte venë me shpatulla prej muri nga vullneti politik popullor, dhe se ky vullnet politik nuk shprehej nga skema tradicionale politike, por nga vullneti i intelektualëve grekë.

Zgjedhjet në Greqi shprehnin vullnetin e vet Greqisë për t'i dhenë fund shtetit klientelist, në të cilin, në këmbim të votës për partinë shteti gërruhej, varfërohej e zhytej në borxhe. Dhe ky këmbim konvertohej në pasuri të skajshëm për një përqindje shumë të vogël dhe mbijetesë abuzive për një pjesë tjetër të popullit grek. Por që të dy drejtimet së bashku varfëronin shtetin dhe prodhoinin grekë që fitonin ose mbijetonin pa të drejtë e pa hak. Këto zgjedhje shprehnin gjithashtu vullnetin për t'u dhenë fund interesave okulte të partive politike me grupe oligarkesh që përfitonin nga evazioni fiskal, korrupsioni dhe abuzimi masiv.

Mishërimi i këtij vullneti u bë partia e një 41 vjeçari. SYRIZA e Aleks Tsiprës. Ideologjia e saj e majtë nuk është monolite, por përfshin një spekter shumë të gjerë fryme të majtë. Është fjala për atë frymë që është shquar në Greqi për ndryshime të



thella social politike, sidomos këto 70 vitet e fundit dhe në fund të fundit e shndërruan Greqinë në një shtet modern. Po ashtu kjo forcë politike nuk mbështet vitalitetin e saj demokratik vetëm tek realiteti i vet. Vitaliteti politik i kësaj partie qëndron tek pesha që zë tek kjo parti-lëvizje, mendimi i pavarur intelektual, e që përbën vazhdimin e traditës së ndryshimeve epokale.

E provoi këtë realitet edhe përpjekja e partive në pushtet për t'u imponuar votuesit grek me frikën e një SYRIZA anti-BE.

Në fakt e vërteta duket se është krejt ndryshe. Po të vihet re, një nga arsyet përse dështoi politika monetare e BE-së në krizën greke, përbën fakti se qeveria dypartiake e dy kundërshtarëve tradicionale politikë, nuk arriti të implementojë reforma që kishin në themel ndërtimin e shtetit grek sidomos në aspektin ekonomik. Klientelizmi dhe interesat okulte të politikanëve me atë pakice që krijon edhe defiçitin galopant shtetëror, mbeti e paprekur. Ndërsa asfiksioni ekonomik nëpërmjet taksave i shtresave të gjera nuk përbënte zgjidhje. Kjo bëri që borxhi i Greqisë në këtë dy vjet të shtohet edhe me mbi 50%.

Pikërisht ky realitet përbën treguesin se përse BE-ja “e braktisi” qeverinë Samara-Venizello dhe i dha “OK” Tsipras. Para gati tre vjetesh të njejta angazhime ndaj perendimit sollën në pushtet koalicionin qeverisës Demokraci e Re-PASOK. Por mësa duket mbeten shumë larg angazhimeve të dhena. Interesat okulte nuk mund të rezoheshin nga po ata politikanë që i kishin ngritur, ose ishin pjesë e tyre. Ndaj dhe BE-ja e humbi besimin tek ata. Në kancelaritë vendimarrëse të BE-së dhe të perendimit në përgjithësi Tsipras ishte më bindës në angazhimin e tij për funksionimin e shtetit grek, me ligjesi dhe mentalitet Evropian.

Pikërisht këtë sfidë të shumëfishtë historike ka për të përballuar Tsipras duke filluar nga e hëna 26 Janar 2015. Nëse edhe ai dështon humnera për Greqinë bëhet historike

PANAJO BARKA 25/01/2015 për gazetën TEMA

**Nga Panajot Barka.**

**Sa të interesuar jemi për reformën në Arsimin e Lartë Publik?**

20.03.2015

Sipas njoftimit të Ministrës së Arsimit dhe Sportit Zonjës Lindita Nikolla, këto ditë pritet që Parlamenti të votojë ligjin e ri për Arsimin e Lartë. Bëhet fjalë për ligjin që lidhet me një nga reformat më të rëndësishme, jo thjeshtë të premtuara nga qeveria aktuale, por të imponuar nga realiteti kritik në arsimin e lartë. Në fakt realiteti që i parapriu këtij ligji është shumë domëthenëse për realitetin gri të vendit.

Së pari. Bëhet fjalë për një projekt ligj që pati një transparencë të gjerë ndaj publikut dhe faktorëve të interesuar. E renditëm të parin këtë anë pasi dihet që ka shumë ligje që votohen pa u bërë të njohura nga vet deputetet. Por më shumë tregon nivelin e përgjegjësisë së udhëheqjes politike të Ministrisë së Arsimit ndaj një problemi fontamental për terësinë e shoqërisë.

Së dyti. Pavarësisht kësaj u vu re se opinionioni publik, politika, faktorët e interesit etj, në reagimet e tyre ishin nga apatik, të vakët dhe konfuz, deri në abuzues dhe mbrojtës interesash meskine. Në përgjithësi, politika e rendomtë e ditës dhe situata e provokuar prej saj, eklipsuan diskutimin e shëndosh në lidhje me këtë instrument juridik që merr përsipër rregullimin e njerës prej kollonave bazë të ardhmerisë së vendit, shoqërisë dhe kombit.

Së treti. Kategoritë e reagimeve mund t'i klasifikojmë në dy grupe kryesore. Nga njera anë janë reagimet që i kundërvihet rolit të shtetit në mbështetjen dhe përparimin e arsimit të lartë. Në ketegorinë e dytë përfshihen gjithë reagimet e llojeve të tjera.

Në këtë reagim dy planesh më këmbëngulës ishin të gjithë ata faktorë dhe aktorë që kishin dhe kanë interesa të ngushta me Arsimin e Lartë. Konstatimi mund të evidentohet qartazi në sulmet “parimore” ndaj rolit të shtetit në mbarëvajtjen e arsimit të lartë (publik). Në fakt bëhet fjalë për përpjekje për të minimizuar deri në eliminim rolin e shtetit në këtë fushë. Por, në emër të parimit zhurmëmadhë të pavarësisë universitare, synohet legalizimi i plotë i sistemit të deritanishëm të shthurjës së arsimit të lartë, sidomos atij publik. Për këtë qellim ata bëjnë se nuk kuptojnë se Arsimi i Lartë dhe vëçanërisht ai publik është një aset i pazevëndësuashëm këmbëtar. E vërteton këtë përvoja e gjatë historike e shoqërisë njerëzore dhe realiteti i sotëm i shoqërive të civilizuar. Vende si Shqipëria në stade të tilla zhvillimi, ku çdo ind i shoqërisë dhe i shtetit ka renë pre e korrupsionit, arrogancës dhe krimin, e kanë shumë më të domosdoshëm investimin në asetin kombëtar të arsimit e sidomos në atë të arsimit të lartë. Nëse pranojmë se situata e krijuar në arsimin e lartë dhe arsimin në përgjithësi, sidomos në djetëvjeçarin e fundit, do të ketë pasojat e veta të rënda të paktën për dy brezat e ardhshëm (po që se tatëpjetës i vihet fre sot), nëse pranojmë që shteti ka për detyrë parësore manaxhimin e vlerave që krijon shoqëria si trashëgimi dhe si realitet për t'i siguruar asaj të ardhmën, atëherë shteti duhet t'i njohim përparësinë primare në administrimin e vlerave universitare. Kjo domosdoshmëri tek ne buron nga fakti se, shoqëria jonë e asfiksuar nga një politikë që nuk duket se e ka të lehtë të fitojë betejën me krimin e organizuar, ka humbur drejtpeshimin dhe sensin e perspektivës.

Thamë se lufta që i bëhet rolit të shtetit në arsimin e lartë nisur duke abuzuar me parimin e lirisë Universitare. Këtu ngatërrohen dy koncepte. I pari ka të bëjë me pavarësinë akademike dhe i dyti me pavarësinë administrative universitare. Në themel ato janë në funksion të njera tjetrës. Por, sado e drejtë që të duket kërkesa për pavarësi akademike, duhet të dihet se kjo pavarësi ka vlerë për një shoqëri në të cilën janë kristalizuar vlerat civile dhe demokratike dhe shteti ligjor, ku korrupsioni dhe abuzimi

janë koncepte të papranueshme, sidomos në arsimin e lartë dhe ndërgjegja akademike nuk pranon asnjë lloj kompromisi në dem të vlerave universitare, ku pavarësia akademike ka si pikë referimi të funksionit të vet kërkesat themelore të shoqërisë për zgjidhje të problemeve që garantojnë ecjen e saj përpara.

Por për univeristetet tona ku konsiston liria akademike? Cilat janë sektorët e kërkimit shkencor? Cilat janë fushat e studimit që lidhen me zgjidhje të problemeve të ruajtjes së vlerave të familjës, të shoqërisë, të mjedisit? Cilat janë kontributet universitare për perspektivën e zhvillimit ekonomik? Cila është pesha e Universiteteve në jetën politike e në interesat strategjike të vendit? A nuk jemi në kushtet që liria akademike tek ne është kthyer në qëllim në vetevete, në prodhim të pakontrolluar të diplomuarish fiktiv, që s'kanë asnjë lidhje me kërkesat reale akademike e konkruese me Evropën, të cilët mbushin parlamentin dhe administratën shtetërore si gjak perteritës të kurrupsionit, paditurisë dhe injorancës?

Kjo është fatkeqësi, për arsye se pikëtishtë duke abuzuar me këtë parim themelor akademik, kërkohet të fshihet ajo që u intereson më shumë këtyre faktorëve,- liria administrative. Që do të thotë kthimin e universiteteve (publike) në pronë të disa “të zgjedhurve” dhe pastaj, në emër të pavarësisë së universiteteve të abuzojnë me fondet e shtetit, me vendet e punës, me titujt akademikë. E shprehur në mënyrë të thjeshtuar, kjo logjikë kërkon nga shteti financimin e universiteteve pa e lëjuar atë të kontrollojë hesap për efektivitetin e këtij financimi.

Shembull më të keq në këtë drejtim përbën rasti i fundit me rektorin e Universitetit të Durrësit. Polemizuesit kundër rolit të shtetit në mbarëvajtjen e universiteteve publike akuzuan ministren e Arsimit dhe Sportit se shkeli pavarësinë akademike universitare, sepse ajo ndërhyri, me kompetencën që i jep ligji si garante e zbatimit të ligjshmerisë në arsimin e lartë, për shkeljet e renda e flagrante administrative të autoritetit drejtues të këtij Universiteti (!!!) Ata u bezdisen nga operativiteti i ministrës, (do të kishin të drejtë nese thoshin qe këtë veprim ajo duhet ta bëjë me shpesh), ndërkohë që nuk vunë re arrogancën shqetesuese të rektorit ndaj ministres dhe njëkohësisht harruan se ishte po ky rektor që syrgjinosi 20 pedagogë të këtij universiteti të shpallur kundërshtarë të tij se nuk e votuan...

Sulmi që po i bëhet rolit të shtetit në mbarëvajtjen e universiteteve ka të bëjë shumë me përpjekjet, që po bëhen për të eliminuar konkurrencën e universiteteve publike ndaj atyre private, që privatët të sigurojnë rolin absolut në tregun universitar dhe universitetet publike të kthehen totalisht në funksion e në shërbim të tyre. Kjo do të thotë që Arsimi i Lartë (Publik) të shndërrohet nga garant i interesave kombëtare arsimore, në garantë të fitimit që përfaqësojnë universitetet private. Kjo do të thotë se bëhet fjalë për një kërkesë që shoqëria dhe shteti të heqin dorë nga arsimi i lartë dhe ta lenë edhe këtë vlerë kombëtare në duart e qarqeve që mundësojnë fitimin e tyre pikërisht në shfrytëzimin e privatizuar të vlerave shtetërore e kombëtare.

Dhe është fakt që në këtë amulli të krijuar enkas po përfitojnë faktorë të tillë, ashtu siç është fakt që shteti tregon se jipet para këtyre presionëve. Flet për këtë qoftë edhe një fakt i vetëm. Politikbërja për arsimin e lartë përqendrohet tek Universitetet e Tiranës apo dhe të qyteteve të tjera me interesa të njëjta. Ndërkohë që shumë shtete evropiane, si Franca, Italia, Greqia etj stimulojnë dhe mundësojnë fuqizimin e universiteteve periferikë, pasi i shikojnë si një mundësi zhvillimi e përparimi të vendit në terrësi. Edhe për shpërndarjen e studenteve nëpër universitete shteti atje ka përcaktuar kritere që përshtasin nivelin akademik të universitetit me kërkesat e studenteve. Dhe kjo shpërndarje siguron mbijetesën dhe të universiteteve periferikë edhe konkurrencën akademike. Ndërsa tek ne studenti është kthyer në subjekt primar

dhe me këtë privilegj ai zgjedh jo universitetin që i shkon përshtsat, por jetën e natës, detin, kushtet e jetesës.

Përfundimisht duhet thenë që te ne as shoqëria, as politika, as vet universitetet, as studentet nuk janë fortë të interesuar për një reformë reale e të thellë në Arsimin e Lartë. Në këtë realitet duhet pershendetur këmbëngulja e Ministrisë si përfaqësuese e shtetit, për t'i siguruar shtetit, qoftë edhe ligjerisht, rolin e garantuesit të reformimit e të zhvillimit të Arsimit të Lartë.

Panajot Barka (për gazetën tema 20 mars 2015)

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2015/03/28/dekriminalizimi-nje-mision-i-veshtire/>

<https://balkanweb.com/dekriminalizimi-nje-mision-i-pamundur/>

### **Dekriminalizimi, një mision i vështirë!**

28.03.2015

Prokuroria, në mbështetje të K.Pr.Penale, zgjeroi akuzën ndaj deputetit të ndaluar Froku, duke e renduar së tepërmi pozitën e tij. Në një plan të parë fakti i arrestimit të dy deputeteve nga kualicioni qeverises; të ndaluar tanimë me urdhër të prokurorisë, me lejën e parlamentit që ka vulën e votës së kolegëve të shumicës qeverisëse dhe me sensibilitetet e partnereve strategjikë ndërkomëbtarë; krijon idenë se ka të bëjë me strategjinë reale të dekiriminalizimit e jetës së vendit nga të gjitha llojet e krimit me parësor atë të organizuar dhe korrupsionin.

Mënyra se si operohet dhe reagimet e faktorëve të rendësishëm në të gjitha nivelet (deri tani) tregojnë se kjo strategji është e imponuar nga faktori ndërkombëtar. Për partner ka zgjedhur Kryeministrin dhe qeverinë e tij. Pa thenë publikisht, e ka lidhur këtë çështje me rrjedhjen e financimeve të qeverisë nga jashtë dhe, e thenë publikisht, e ka lidhur me procesin integruar të vendit në strukturat euroatlandike. Momenti i zgjedhur ka të bëjë me faktin se në kushtet e destabilizimit global që provokon terrorizmi, sidomos me zhvillimet në Mesdheun Lindor dhe situata në ish Bashkimin Sovietik, por edhe kriza ekonomike globale ende në zhvillim, si SHBA-as, ashtu edhe BE-së, u duhet një Shqipëri e stabilizuar, e cila pas Greqisë, të shërbëjë si një faktor në shërbim të stabilitetit e të paqës globale. Ka të bëjë me faktin se kësaj “nisme” të tyre i paraprinë veprime dhe deklarata se Shqipëria rrezikohet nga terrorizmi islamik, mbështetja kryesore e të cilit mbëtet krimi i organizuar, ose inkriminimi i segmenteve të caktuara në shoqëri e shtet. Por, ky moment lidhet edhe me faktorë të brendshëm. Përbën një rast të mirë që kandidaturat për drejtuesit e bashkive të jenë jashtë ndikimit dhe marrëdhënieve me krimin dhe krimin e organizuar.

Marrë në konsideratë këtë analizë faktori ndërkombëtar që inicoi këtë hap, më sa duket tregohet shumë i kujdesshëm në taktikat e zgjedhura. Është kjo arsyeja që deri tani, pavarësisht dëshirës së shprehur për rezultatin, ajo është pak e lëxueshme. Do të ndiqet taktika e paradigmës, apo demikriminalizimi do të ketë shtrirje në gjerësi e thellësi. E para duket se nuk siguron efektivitet. E dyta përbën një mision të vështirë. Të vështirë, se pesha e krimit në formën e tij më të lartë, atë të krimit të organizuar, në jetën politike, në makinën e shtetit, në ekonomi e në jetën civile, është shumë e madhe dhe i kontrollon këta sektorë deri në asfiksi. Të vështirë se faktori i brendshëm nuk është në unison vëprimi dhe as me gadishmëri të plotë e të vendosur vëprimi. Të vështirë se përvoja ka treguar se drejtësia në vend nuk mund të shndërrohet nga pjesë e problemit në pjesë të zgjidhjes së tij. Të vështirë se interesat e vet krimit të organizuar kanë mundësi të pafundme rezistence, por edhe faktorë të jashtëm që shpesh fshihen pas tij nuk kanë interesa komplementare, por të kundërta e deri në antagoniste në Shqipëri. Të vështirë se opinioni publik nuk ka besim se strukturat e politikës dhe të shtetit i kanë duart të lira për të realizuar dekiriminalizimin, ndaj edhe nuk i mbështet ata dhe është objektivisht intiferentë.

Në një situatë të vështirë dhe komplekse ndodhet vet Kryeministri. Vëprimet e tij të tanishme vërtetojnë ndërgjegjshmerinë e tij se për marrjen e pushteti nga Berisha duhej të pranonte përdorimin në luftën elektorale të mjeteve e formave të ngjashme me ato që Berisha posedonte për ruajtjen e tij. Faktet treguan që këto fenomene të mbartura ndikuan shumë në gërryerjen e platformës së tij politike të Rilindjes. Kjo do të thotë se tani që momenti kërkon distancimin prej tyre dhe dorëzimin para drejtësisë, kjo nuk

është aspak datyrë dhe mision i lehtë. Nuk ka lidhje me parime morale, por me vet realitetin. Problemi shtrohet deri ku mund të arrijë dhe a mund të arrijë. Faktorët bashkëveprues për dekriminalizimin janë në unison me të, apo do ta kthejnë këtë aksion në mjete për larje hesapësh, pastrim të vetvetës dhe konsolidim pozitivash. Rama, qoftë në emër të dekriminalizimit, qoftë të çlirimit të ambjentit të tij nga element të kriminalizuar, pranoi sfidën ta fillojë luftën me të vetët. Kjo i jep çdo të drejtë për të mos nguruar të veprojë ndaj kujtdo tjetër. Në këtë drejtim, është e vërtetë se Rama ka arritur një konsensus të heshtur, me referencë ligjin, të paktën me Prokurorinë. Por, ajo, (si edhe gjykata) tregon se, aq sa është e gatshme të jetë aktive për të goditur njerëzit pranë Ramës, si në rastin e fundit, aq tregohet e zëllshme për të mbrojtur nga goditjet e veta njerëzit e opozitës. Në këtë kuptim, një vendosmeri e Ramës për të çuar deri në fund dekriminalizimin (qoftë edhe në segmentin e parlamentit), ka rrezik të sjellë krijimin e një klani të ri kundërshtarësh në gjirin e tij (krahas grupit të senatorëve të vjetër) ndoshta edhe më të egër. (Por edhe mos veprimi ndaj tyre do të penalizojë figurën e Ramës në projeksion e tij të Rilindjes)

Por akoma më real është rreziku që aksioni i dekriminalizimit të shndërrohet në një instrument për të mbrojtur krimin. Deputeti Froku u bëri thirrje kolegëve deputetë që të mos e votojnë kërkesën e Prokurorisë për arrestimin e tij dhe të Doshit me argumentin se nesër u vjen radha e tyre. (!) Kjo mund të interpretohet se Froku i njeh përmasat e krimit në Parlament dhe kërkoi për mbrojtje, aleancë (me mosvotim të kërkesës së prokurorisë) dhe jo mohimin e tij me votimin e saj.

Ndërsa deputeti tjetër i arrestuar Doshi dhe opozita thanë se arrestimi bëhet për motive politike, për të mbrojtur një pjesë tjetër të inkriminuar. Por, ajo që vihet re është se kjo linjë akuzash dhe kundërakuzash me doza të forta polemike edhe pse pritej që të sillte hapjen e kutisë së Pandorës, derivoi në shmangjen e akuzave nominale drejt atyre të përgjithshme, që do të thotë se uniteti i krimit mund të tregohet më i aftë se luftetarët ndaj tij.

Qëndrimi i opozitës e bën më të dukshëm fenomenin deformues të strategjisë së dekriminalizimit dhe mbrojtës të krimit.

Opozita e artikuloi e para termin “dekriminalizimin të parlamentit”. Por, u nis nga një akt banal mes deputetesh që nuk ka asgjë të përbashkët me dekriminalizimin e politikës nga krimin i organizuar. Kështu nisi edhe rruga e arëstimit të Doshit. Në një konflikt entopartiak Doshi akuzoi segmente të qeverisë për korrupsion. Përrjashtimi i tij, për këtë shkak nga grupi parlamentar i PS-së, hapi konfliktin e njohur me kreun e Parlamentit që përfundoi me arrëstimin e tij. Pra në të dy rastet nuk kemi një nismë të mirëfilltë dekriminlaizimi të parlamentit në ato parametra që caktojnë partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë.

Opozita nga ana e vet kërkon njëkohësisht një përfitim të dyfishtë. Të shfrytëzojë arëstimin e dy deputetëve qeverisës për t’u paraqitur e larë nga kësi mekatesh. Mbrenda kësaj logjike kërkon ta vëndos krimin e organizuar në një marrëdhënie ekskluzive me pushtetin ekzekutiv. Me këtë arsenal zhvillon betejën e tanishme politike opozita, me pasojë të mbjellë më shumë mosbesim ndaj vetës, të bëhet e pabesueshme edhe kur ka të drejtë, të shpërndajë më shumë mjegull dyshimi për mundësinë e realizimit të dekriminalizimit të pretenduar dhe t’i krijojë një barierë mbrojtëse këtij krimi. “Suksesi” i vetëm qëndron tek krijimi i idesë se politikanët e çdo krahu janë të pistë dhe bëhen më të pistë kur janë në pushtet.

Për përpjekjen e opozitës për të krijuar një barierë mbrojtëse për pengimin e dekriminalizimit, flet edhe demarshi i saj për të paraqitur një platformë institucionale dekriminalizimi, e cila, sipas opozitës, do të prekë akoma edhe kushtetën. Thelbi i kësaj platforme kërkon spastrimin e politikës nga ata politikanë që janë të denuar penalisht.

Pas kësaj formule opozita në fakt kërkon të ofrojë një instrument ligjor mbrojtës këtij krimi për arsye se asnjë politikan deri me sot (me përjashtime shumë të ralla) është denuar nga drejtësia shqiptare.

Pra, për këto, dhe për shumë arsye të tjera dekriminalizimi qoftë edhe i parlamentit , është një mision shumë i vështirë.

P. Barka, për gazetën TEMA , 28.03.2015.

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2015/04/14/dekriminalizimi-nje-mision-i-veshtire-2/>

### **Blushi ka një mision shumë më të rendësishmë se shqipja e Janullatos.**

14.04.2015

Realiteti që po jetojmë më imponoi sivjet t'i përceptoj Pashkët brenda persiatjes se perse njerëzit nuk e perjetojnë ngjalljen e Krishtit sipas mesazhit thelbësor të saj. Si një moment kalimi cilësor, nga një situatë e mbarsur me veshtirësi dhe të këqia, drejt një stinë të mbushur me mirësi e shpresë. Pra shoqëria njerëzore me mesazhin e ritit të ngjalljes, t'i përqaset natyrës, -triumfit të pranverës mbi dimrin, moment që feja e ka zgjedhur për të vendosur ngjalljen e Krishtit... Kuptohet, që vret shumë realiteti në të cilin mesazhi fontamental i ngjalljes së Krishtit ka fituar trajtën e një rutine me urime formale, me perseritjen standarte të riteve popullore e fetare me garën e tavolinave sa më të pasura...

Por ajo gjë që më detyroi për këtë shkrim ishte një artikull i mikut tim Ben Blushi në Gazetën "Panorama" të së enës pas Pashkëve me titull: "Kur do të flas Anastasi shqip?"

Nuk dua kursesi të bej replikë, aq me tëpër me mikun tim. Madje nuk më shqetësuan aq faktet që Blushi servir në artikullin e tij. Por, logjikën dhe mentalitetin që fsheh apo manifeston artikulli i Blushit dua të shikoj në kuadrin e persiatjes time për Pashkët. Dhe ja pse.

Unë e konsideroj mik Ben Blushin jo thjesht se kemi një histori bashkëudhëtimit të gjatë në gazetari e në bindje politike. E konsideroj mik për arsye se guxoi që me krijimtarinë e tij letrare, qofte edhe kështu, të thyej disa tabu në lidhje me islamizimin e një pjese të popullit shqiptar, me marrëdhëniet ndërjetare e nderetnike që solli ky proces e që çoi në shkatërrimin dhe djegjen e qëndrës së iluminizmit ballkanik, siç ishte Voskopoja, duke u hequr kështu pjedestalet e heronjve që në fakt ishin zjarrëvënës të saj. E konsideroj mik se shikoj tek Blushi përpjekjen e politikanit për të gjeneruar standarte evropiane në politikën shqiptare, qoftë edhe pse deri tani si vlerë stoike. (Dhe besoj shumë se konstatimi im përbën investimin ardhmerimtar për politikën shqiptare të shumë faktorëve, brenda dhe jasht vendit).

Për këto arsye mua më erdhi shumë keq kur para do kohësh miku im Blushi u gjet para sulmeve pa fre kur guxoi të këshillonte nga Tirana Albin Kurtin e Prishtinës. Nuk ndërhyra në debat për arsye se epersia e argumentit në favor të Kurtit lidhej me nacionalizmin politik veprues të këtij të fundit dhe përkatësia ime etnike e bënte të pavlefshme çdo ndërhyrje.

Por, po ndërhyj tani, se shikoj se përpjekjeve të tij për gjenerim vlerash perendimore në politikën shqiptare nuk u jep hapësirën, terrenin dhe perspektivën e duhur. (Disa deklarata të tij kundër realitetit politik shqiptar, disa qëndrime kundërshtuese ndaj liderit të Partisë së tij, apo dhe disa mendime në favor të shtresave të gjera popullore, nuk përbëjnë dot realitetin e aspiruar)

Ndërhyj tani se, në raport me këtë perspektivë, artikulli i mikut tim Blushi tek Panorama më duket një ogur akoma më i keq. Duket se ai, për të fituar këtë terren të munguar, rreshqet tek streha e njohur e nacionalizmit, i cili kohët e fundit po rishfaqet po aq provokues ndaj perendimit si në rastin e 100-vjetorit të pavarësisë. (Që të mos keqkuptohem, nuk e konsideroj nacionalizmin [e çdo populli] si një të keqe. Përkundrazi, nacionalizmi përbën një shtysë universale dhe çlirues energjish mbarë popullore kur i shërbën konsolidimit të identitetit e vlerave kombëtare, mirëqenjes dhe begatisë së popullit të vet. Por, ai kthehet në të kundërtën e vet kur i shërbën politikës



së ditës dhe nacionalizmave të sëmura në dem të popujve të tjerë. Të parit është vështirë për t'i shërbyer. I dyti dihet se përbën strehën e maskarënjve).

Pa dashur ta paragjykoj mikun tim Blushi, (përkundrazi i flas me gjithë dashamirësinë e mundshme për ta ndihmuar nëse mundem), me këtë artikull ai bën flirt pikërisht me këtë variant të dytë nacionalizmi. Dihet se në periudhën e tranzicionit në Shqipëri u ruajt në mjete më agresive dhe më të pakontrolluara, shablloni nationalist i sistemit totalitarist, dmth, i antihelenizmit si formë me efikase për vetpercaktimin etnik shqiptar.

Këtij shablloni i ngjan se i shërbën artikulli i Blushit, “Kur do të flas Anastasi shqip?” në gazetën “Panorama” Dhe me vjen keq pasi shet formatin e tij kaq të lartë për ide të konsumit të përditshëm në një treg nationalist dal mode edhe pse duket se fiton popullaritet.

Dua t'i them mikut tim Blushi se meshen Pashkëve në Katedralen e Ngjalljes të Tiranës të celebruar nga Kryepeshkopi i Kishës Autoqefale të Shqipërisë Anastas, e ndoqa edhe unë. E ndoqa se doja të shmangja pikërisht ato formalitet që thash në fillim të shkrimit të ritit fetar në provincë, por edhe për arsye të tjera. E vërteta është se mesha e Ngjalljes me një solemnitë të jashtëzakonshëm, u bë terësisht në gjuhën shqipe. Pjesët në gjuhën greke ishin shumë, shumë pak dhe perserisni, ose para ose prapa, pjesët e meshës në gjuhën shqipe. Ishin aq pak sa mund të themi se nuk justifikonin aspak praninë e komunitetit grek në meshën hyjnore të ngjalljes. Ky fakt i marrë si argument i kundërt nga miku im Blushi është shumë kompromentues për kalibrin e tij intelektual.

Miku im Blushi ngul këmbë se Kryepeshkopi Anastas duhet të kishte mësuar shqipen. Çuditërisht ai nuk konstaton se “Anastasi” (Blushi e përmend Kryepeshkopin e ortodoksëve shqiptarë pa titullin e ierarikisë fetare. Kuptohet është një mënyrë çvlerësimi) e di fare mirë shqipen dhe e përdorë atë po aq mirë në misionin e vet apostolik në Shqipëri.

Në këtë kendveshtrim miku im Blushi harron të protestojë ndaj të gjithë presidenteve shqiptarë që i mohuan kryepeshkopit të drejtën për të marrë shtetërinë shqiptare. Përse? Pak javë më parë të gjithë duartrokitem vendimin e presidentit Nishani që i dha trajnerit të kombëtarës tonë De Biasit shtetësinë shqiptare. Jam i sigurt se edhe miku im Blushi nuk ka argumenta perse ky diferencim i dyshimtë.

Por ajo që e ul Blushin në nivelin e ulët të promovimit të nacionalizmit shqiptar nëpërmjet antihelenizmit është fakti që për të Kryepeshkopi Anastas mund të përdorë në meshë çdo lloj gjuhe tjetër, vetëm greqisht jo. (!!!) Këtë e përforcon fakti se miku im Blushi, ashtu si shumë të tjerë (jo ateistë si ai, por të besimeve të tjera, kryesisht muslimanë) që e mbrojnë ortodoksinë nga helenizmi i Janullatos, nuk shqetesohen fare për faktin se besimet e tjera në Shqipëri, muslimanët, bektashinjtë, katolikët, protestantët etj përdorin gjuhë nga më të ndryshme: -arabisht, turqisht, italisht (apo latinisht), anglisht etj, shpesh pa thenë asnjë fjalë shqip. Vetëm greqishtja për ta përbën problem dhe vë në rrezik nacionalizmin shqiptar. (!!!)

Në një rast të tillë ai bashkohet me atë klan shqiptarësh të tjerë që ushqejnë nacionalizmin e tyre me antihelenizëm, që ndërmorën ofensive për çmitizimin e shën Kozmait, për të krijuar idenë sikur ortodoksia shqiptare nën drejtimin e Janullatos po bën aleanca me islamikët kundër krishterimit perendimor. (Kjo u theksua në medja veçanërisht pak para vitit të Papës në Tiranë). Pra i dedikojnë Janullatos formulat e marrëdhënieve të krishterimit lindor dhe perendimor të kohës së Kryqëzatave, dhe fshehin tinezisht faktin se Kryepeshkopi Janullatos është sot një nga bashkëbiseduesit më të afërt të Papës.

Blushi pranon se egziston paragjykimi i shqiptarëve të tjerë ndaj ortodokseve po shqiptarë dhe fton kryepeshkopin të kontibuojë për heqjen e këtij paragjykimi. Do

ta ftoja mikun tim Blushi që këtë rol më mirë se çdokush tjetër mund ta kryejë ai dhe intelektualët e tjerë shqiptarë pa lenë vetëm në këtë betejë Kryepeshkopin Anastas. Blushi mund të fliste për publikisht për faktin se sipas censusit të fundit zyrtar ortodoksët shqiptarë në të gjithë vendin janë të barabartë me numrin real të ortodoksëve të Korçës.

Po ashtu me duket i kot evaziviteti i Blushit në lidhje me identitetin e besimtarëve ortodoksë Korçarë. Ata kanë në krye një peshkop shqiptar, celebrosin mesha për të gjitha festat kombëtare shqiptare, organizojnë ceremonitë fetare me të bukura në rajon dhe me një unitet të admirueshëm. Ata kanë përgjigjen e tyre ndaj çdo provokimi në lidhje me besimin e tyre. Dhe këtë besoj se miku im Blushi e di, ashtu siç e di që ata nuk interesohen fare se çfarë mendojnë të tjerët për ta. Atëherë kujt i intereson që të vë në dyshim identitetin e ortodoksëve Korçarë dhe përse?!

Si përfundim dua të them se miku im Blushi me tezën e shqipës së kryepeshkopit Anastas, konsumoi në mënyrë abuzive integritetin e tij intelektual, për të përfituar nga nacionalizmi i ditës.

Mendosj se është ekuivalent i kalibrit të Blushit dhe në nderin e tij që, dryshe nga të gjithë kritizierë “objektiv” të Janullatos që pranojnë veprën e tij në shërbim të kishës ortodokse shqiptare, por duke mohuar atë, Blushi të ishte realisht objektiv pa renë pre e diferencimeve të kësaj natyre. Deri më sot asnjë udhëheqës “kombëtar” i kësaj kisha e as të gjithë se bashku nuk ndërtuan aq shumë vepra kulturi për kryerjen e misionit të saj.

Ashtu si është në nderin e tij intelektual e politikanë me peshë që të ngrinte zërin etij të protestës e të denoncimit ndaj makuterisë së shkatërrimit, vjedhjes dhe grabitjes të vlerave të trashëgimisë kulturore të fesë ortodokse. Për të kuptuar vlerën e dëmit mund të themi se gjithçka i ngjan rrënimit të Voskopojes, e një Voskopojeje të shtrirë kryq e terthorë në Shqipëri. Shqipëria nuk ka sot trashëgimi tjetër kulturore më të lashtë dhe njëkohësisht funksionale se objektet e kultit të fesë ortodokse. Edhe diktatori Hoxha kur donte të promovonte identitetin evropian të Shqipërisë, mburej me objektet e fesë ortodokse.

Nëse sot lëjohet kjo kasaphanë dhe miku im Blushi mirret me shqipen e kryepeshkopit dhe nuk e ngre zërin për ta ndaluar këtë vandalizëm të paprecedentë duke u nisur nga fakti se dikush mund të thotë se ato kanë vullë helene, atëherë përse mbrojmë me aq fanatizëm Butrintin, Finiqin, Orikumin, Apoloninë, Durrësin e lashtë, Amandjem, Antigonene, Adrianopolin dhe shumë site të tjera arkeologjike. Dhe ato kanë vullë dhe origjinë helene.

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetama.net/2015/05/22/a-duhen-toleruar-deklaratat-e-fundit-te-idrizit/>

### **A duhen toleruar deklaratat e fundit të Idrizit**

22.05.2015

Deklaratat e Shpetim Idrizit pas zgjedhjes së tij si nënkryetar i Kuventit të Shqipërisë dhe sidomos ato pas doreheqjes që pasoi të Vangjel Dulës nga i njejtë post, kompromentuan keqas institucionin me garand të demokracisë në vend. Kjo për faktin se Idrizi identifikoi besimin e parlamentit për postin e nënkryetarit të tij si legalizim të retorikës së tij nacionaliste antihelene në formën më ekstreme. Fjalori ndaj Dulës nuk ka asnjë lidhje me kulturën politike dhe civile të një parlamentari dhe është totalisht në kundërshtim me postin e drejtuesit të kuventit të Shqipërisë.

Do të ishte ngushëlluese nëse qëndrimi i Idrizit do t'i përkiste vetëm asaj politike në vend që prodhohet për konsum ditor, apo si joshje të sedimentit nationalist pa objektiv. Pra, ky dimension në deklaratat e Idrizit egziston, por që shkon për t'u bashkuar me zhvillimet e tjera të karakterit nationalist të kohëve të fundit. Tregon se Idrizi kërkonte sepse për t'u evidentuar në frontin nationalist kundër Greqisë, i cili për shumë dekada është provuar se gjeneron nacionalizmin më konfuz, më abstrakt dhe më bajat për disa kategori të popullit shqiptar. Është pikërisht ky fakt, i cili, gjithnjë e më shumë po evidentohet nga faktorë të ndryshëm në të dy vendet, si shkak që ka çuar marrëdhëniet midis dy popujve në nivele shumë më të ulëta se mesi i shekullit 19<sup>të</sup>.

Idrizi i bindur më shumë se të tjerët, se kauza e pretenduar prej tij i shërbën interesave që ushqen politika e ditës, nuk mirret drejtpërdrejtë me të, por kërkon antipodë grekë me shpresë se do t'i terheq në hullinë e vet, në një polemikë më shumë shterpe, nga ku ai mund të përfitojë aksione nacionaliste. (Pretendimi i zgjidhjes politike të “kauzës” së Idrizit, ka penguar edhe zgjidhjen personale me mjete juridike të problemeve ekonomike, të shtetësisë etj, nga qytetarë shqiptarë të kesaj kategorie e që i meritojnë ligjerisht.)

Si një antipodë greke Idrizit i ka shërbyer për shumë kohë Vangjel Dule, aq sa me të drejtë në minoritetin etnik grek është etiketuar si paterica e Idrizit.

Në kushtet kur në Greqi askush nuk po e ngrinte dorashkën “e kauzës” që Idrizi nuk linte rast pa ia hedhur palës greke, ai gjeti për këtë rol Dulën. Madje për të qenë më bindës e etiketonte me të madhe si “përfaqësuesin politik të Greqisë në Tiranë”. E bënte këtë edhe për një arsye tjetër. Se e dinte shumë mirë qëndrimin e minoritetit etnik grek në Shqipëri, i cili në asnjë mënyrë nuk donte të mirrte rolin e përfaqësuesit të Greqisë për një problem që i takon ekskluzivisht asaj. Ky qëndrim i pjekur i minoritetin lidhet me përvojën e tij se në kushtet kur Greqisë nuk do t'i hyj gjemb në këmbë “nga kauza Idrizi”, çdo përzjerje në të e minoritetit do të krijonte terrenin që të paguante ai çdo lloj haraçi. (Është jo arsyeja që Idrizi e karakterizon minoritetin “popull vëlla”)

Dulja, të cilit, ashtu si Idrizit, i interesonte vetëm avëni personal politik, në kushtet kur aksionet politike në minoritet i kishte afër zeros, i intersonte shumë marrja e rolit “të mbrojtësit të interesave kombëtare” të Greqisë. Edhe pse Athina zyrtare, as i besoi një rol të tillë, as e përkrahu inkursionin “mbrojtës” disa vjeçar të Dulës, prap se prap pati zëra dhe qarqe, që për interesa të tjera i hidhnin një spreit heroik dhe e përkrahnin atë politkisht.

Por Dulja, duke mos patur mundësi të tjera evidentimi politik, kishte shkuar shumë larg në rrugën e të qenit patericë e Idrizit Kaq larg sa nuk lëjonte me asnjë mjet bashkëjetesën e mundshme politike me të.

Mëgjithatë, dorëheqja e Dulës nga posti i nënkryetarit nuk lidhet as me pamundësinë e bashkëjetesës me Idrizin, as me deklaratën e bërë se nuk mund të

idintefikohet me situata që i kthejnë institucionet shtetërore “në plaçkë këmbimi në tregun e aleancave fluide”. Kjo për faktin se vet Dulja kur është fjala për interesa personale politike ka pranuar si plaçkë këmbimi, si interesat jetike të minoritetit etnik grek, ashtu edhe interesat politike të partisë që përfaqëson apo dhe të vendit në terësi.

Shkaku i vërtet i dorheqjës së Dulës është se ai, i tmeruar nga dështimi i pritshëm në të gjitha nivelet në këto zgjedhje lokale, (lojrat dhe piruetat e njohura vite më parë kësaj here ishin të pavlefshme), i hutuar nga anonçimi zyrtar i Athinës se ai nuk është i përkedheluri i saj dhe se ajo nuk ndërhyr në favor të asnjë faktori politik në minoritetin etnik grek, si dhe duke parë se, as nga Tirana e as nga Athina, nuk i krijohet terren për krijimin e situatave konfliktuale me prapavijë nacionaliste që ai të mund të përfitonte politikisht, shrytëzoi rastin e zgjedhjes së Idrizit si nënkryetar parlamenti për një “dalje heroike”, me shpresë se do ta detyronte Athinën të kthente projektorët dhe kamerat mbi të.

Siç pritej, Idrizi me deklaratat e tij provokuese dhe të patolerueshme për vet parlamentin shqiptar, për shoqërinë civile dhe vet komunitetin çam, i krijoi Dulës gjithë salltanetin e duhur që ai të përfitojë spreit-in heroik të ardhur nga Greqia. Por Athina (të paktën ajo zyrtare) tregon se nuk ka ndërmend të shkojë pas berihajt të Dulës. Aq me keq kur tregon se nuk ka ndërmend të mirret as me deklaratat provokative të nënkryetarit të ri të parlamentit.

I pari që e kuptoi se e humbiste partneritetin antipod të Dulës ishte vet Idrizi. Ndaj edhe ai kërkoi me nxitim të tërhiqte në strofullën e vet Agimin e Artë grek. Është e njohur se Agimi i Artë e pranoi kohë më parë (qoftë edhe për interesat e veta) sfidën e shoqatës së Aleancës Kuq e Zi. Por e kuptoi pse i ra në stomak si qull i nxehtë. Kështu që tani do t’i fryjë edhe kosit.

E gjithë kjo histori që analizuam kuptohet se është shumë më pak e rendësishme se zhvillimet e tjera në vend e në rajon brenda të cilave do të evidentohen Idrizi apo edhe faktorë të tjerë që për barkë politike kanë nacionalizmin.

Midis Greqisë dhe Shqipërisë, po rihapet rishtazi një cikël i ri përkeqësimi marrëdhëniesh. Edhe këtë herë, po të lemë mënjanë ndonjë deklaratë apo notë zyrtare në lidhje me marrëveshjen e detit (një problem i ri ndërshtetëror që po merr trajtat e pelhurës së Penelopës), që kësaj here u duk me qartë edhe ndonjë gisht i huaj, përkeqësimi i marrëdhënieve amplifikohet nga Medjat në të dy anët, të cilat, me keq se politikanët, nuk duan të shikojnë se interesat praktike dhe strategjike për të dy vendet, që prodhon bashkëpunimi, janë shumë më të mëdha se përplasjet që ushqen nacionalizmi i semurë dhe interesat e të tjereve.

Vizita e Erdoganit në Tiranë i futi një fashë ngrice vendit në raportet me Perendimin. (Kuptohet se kjo nuk lidhet aspak me takimin me Idrizin, me të cilin “diskutuan programin e PDIU-s” (!!), por me faktin se Erdogani sfidoi bashkejtesën ndërfetare, si vlerë të identitetit shqiptar në perendim të mburur dhe nga Papa, në përkrahje të myslimanizmit. Madje duke caktuar bregun shqiptar të Adriatikut si kufirin e tij perendimor.

Zhvillimet në republikën e Shkupit, ku për ngjarjet në Kumanovë duket se askush nuk do transparencën, kanë detyruar kryeministrin Rama të paralajmërojë me veto Shkupin për anëtarësimin e tij në NATO, nëse nuk zbatohet marrëveshja e Ohrit. Që përkthehet se marrëdhëniet janë të ngrira.

Me Beogradin, vizita e pritshme e Vuçiç ka ndezur që tani motorat për risjelljen e klimës së përplasjes verbale nacionaliste.

Pra Shqipëria, me të gjithë fqinjët kufitarë tokësorë ka për momentin marrëdhënie aspak të mira që të kujtojnë politikën e rrethimit të Enver Hoxhës në vitet 70-80’.

Në këtë tablo, duket qartë se Greqia, duke mos patur asnjë problem të nxehtë ndërshtetëror me Shqipërinë, duke konfiguruar politikën e saj rajonale në receta strikte të politikës së BE-së dhe NATOS, bashkë me asetit e disa qindra mijëve emigrantëve shqiptarë atje, përbën realisht fqinjin me garanci dhe standarte Evropiane Por, marrëdhënie të tilla po i pengojnë paragjykimet e së kaluarës, rudimenti i regjimit komunist se nacionalizmi rrit unitetin e brendshëm dhe tërheq vëmendjen nga problemet serioze sociale dhe ekonomike dhe po tradicionalisht, e pengojnë interesat e të tjerëve.

Dhe kjo përbën një arsye më shumë për të penguar “idrizat” në rrugën e tyre.

**Nga Panajot Barka.**

<http://www.gazetatema.net/2015/06/07/marreveshja-e-detit-me-greqine-nje-casus-belli-i-ri-artificial-ne-marredheniet-midis-dy-vendeve/>

## **Marrëveshja e Detit me Greqinë, një Casus Belli i ri artificial në marëdhëniet midis dy vendeve.**

06.06.2015/08.06.2015 (print)

Ndërsa vitet po kalojnë Marrëveshja e Detit midis Shqipërisë dhe Greqisë nga një strategji bashkëpunimi, mirëkuptimi e përfitimi reciprok, gjithnjë e më shumë po kthehet në Shqipëri në një instrument për të tensionuar marrëdhëniet me Greqinë sa herë i duhet një shock “patriotik” për të “nxjerrë” tymb të bardhë për “X” situatë të brendshme. Në fakt bëhet fjalë për një “Casus belli” artificial ndaj Greqisë, që lidhet me pretendimin se gjoja kjo marrëveshje lëjon “aneksimin grek të 300 e ca km<sup>2</sup> deti shqiptar”.

Dihet se marrëveshja është firmosur në nivel qeveritar, por nuk u ratifikua nga parlamenti ynë (as ai grek), për shkak të vendimit nr. 15, datë 15 prill 2010 të Gjykatës tonë Kushtetuese që e shpall atë të papajtueshme me Kushtetutën. Por, ndërkohë që Marrëveshja u bë inaktive, pretendimi për “aneksimin e detit shqiptar nga Greqia”, është aktiv. Përbën një qëndrim, dhe zyrtar, dhe medjatik, dhe popullor, por edhe kauzën e atyre që përditë dhe në mes të diellit kthejnë në pronë private bregdetin dhe detin e Shqipërisë.

Përdorët njëkohësisht si alibi për të neutralizuar çdo demarsh për të zgjidhur ngërçin në favor të një marrëveshjeje efektive. Kërkesave të palës greke në këtë drejtim u jipet pergjigja “patriotike” se nuk negociohen interesat kombëtare. Pra, Shqipëria tregon se më shumë është e interesuar për ngërçin. Ta përdorë si një “argument modern” në forcimin e bindjes populiste “për pandryshshmerinë e politikave keqdashëse greke” ndaj Shqipërisë. Dhe e bën këtë, pavarësisht nëse është i vërtetë apo jo problemi, pavarësisht nga humbjet e natyrës ekonomike dhe bashkëpunuese, pavarësisht se, nëse ai është i vërtetë, kush mban përgjegjësinë etj.

Vendimi unanim i Gjykatës Kushtetuese, trajtohet nga të gjithë si vendimi i vetëm i pacenë i drejtësisë shqiptare. Pavarësisht se vendimi zbardh deficiencën e funksionimit të shtetit tonë, ai u kthye në fetih për t’u përdorur në arsenalin antigrek. Dhe e gjithë kjo pa ia lexuar përmbajtjen. Por, një impenjim qoftë edhe i përciptë mbi arsyetimin e këtij vendimi zbulon se bëhet fjalë për një tabu të rrëmë.

Sipas vendimit të Gjykatës papajtueshmëria e Marrëveshjes me Kushtetutën, është e lidhur me përgjegjësi të palës shqiptare, (më shumë institucionale se sa individuale). Mirëpo, në këtë drejtim, edhe pas 5 vjetesh nga shpallja e vendimit, nuk veprohet. Që do të thotë se interesimi kishte dimensionin e vetëm, atë të anulimit të Marrëveshjes. Kongluzioni përforcohet nga fakti se së fundmi, disa nga aktorët negocuesë deklaruan publikisht se në thelb Marrëveshja nuk i prek asnjë metër det Shqipërisë. (Këto deklarata shkaktuan termet midis mbrojtësve të papajtueshmërisë së Marrëveshjes me Kushtetutën. Por me përgjigjet e tyre, vetëm me “klas” polemizues filologjik por pa argumenta, tradhetuan motivet nga u udhëhoqën në fushatën anti-Marrëveshje).

Nga ana tjetër, arsyetimi i vendimit pranon se në arritjen e Marrëveshjes grupi negociator ndoqi një rrugë ligjore, në respekt të akteve nderkombëtare. (baraslargësinë strikte, ose të vijës së mesit strikt). Por, Gjykata, gjykon antikushtetueshmërinë e Marrëveshjes me kërkesën e zbatimit të parimeve të tjera, “më të leverdishme” për vendin tonë, (atë të Ekitesë). Por, nuk i hyn fare logjikës se cili do të qe në këtë rast

qëndrimi i palës greke. Aq me tepër kur vet Gjykata pranon se parimi i Ekitesë pothuaj në të gjitha rastet e zbatimit është produkt i vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare dhe aspak produkt negociimi dhe marrëveshjeje.

Siç u tha edhe më lart, po ta marrim të mirëqenë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ai provon se përgjegjësia dhe fajti “për grabitjen” e detit shqiptar, bie mbi palën Shqiptare. Pra, kemi të bëjmë me një problem të brendshëm shqiptar. Derivimi i tij si greko-shqiptar, apo më keq, fajësimi i Greqisë në lidhje me pretendimin për “aneksimin e detit shqiptar” është absolutisht subjektiv dhe i pavërtetë. Pra, fajësimi i Greqisë bëhet në emër të populizmit që siguron kredo patriotike në kuadrin e njohur të antihelenizmit, si vijimësi e linjës së ndryshkur të ideologjisë komuniste. Elementi shtesë për këtë “Casus belli” të ri ndaj Greqisë duket se lidhet me përpjekjen për t’u shërbyer interesave të të tretëve, interesa që në fund të fundit bien ndesh, qoftë me interesat e vet Shqipërisë, ashtu dhe të marrëdhënieve greko-shqiptare.

Nga ana tjetër, bën shumë përshtypje fakti që mbrojtësit e papajtushmerisë së Marrëveshjes me Kushtetutën u kujtuan për të reaguar dhe vepruar pas më shumë se tre vjetesh, tek sa Marrëveshja po shkonte për ratifikim në Parlament me vendim qeveritar nr. 7159, datë 02 qershor 2009. (Procesi i negociimit filloi me 2006. Me 23 gusht 2007, me urdher nr 135 të Kryeministrit u ngrit grupi negociator i palës tonë. Pas dy vitesh negociimesh, Marrëveshja u nënshkrua në Tiranë nga Ministrat respektiv të Jashtëm me 22 prill 2009.) Pra pati një heshtje trevjeçare për të vijuar me një reagim ekstrem. Pse? Gjykatës Kushtetuese iu drejtuan jo një, por gjashtë subjekte politike (parti) dhe Gjykata, në shqyrtim paraprak të kërkesës (26.11.2009), vendosi kalimin në seancë të çeshtjës, vetëm për PS-në. Tërheq vemendjen fakti se vendimi për kalimin në seancë të kërkesës së PS-së u muar vetëm me një votë diferencë (5 me 4). Ndërkohë që vendimi për papajtushmerinë e Marrëveshjes me Kushtetutën u muar me unanimitet të plotë. Çfarë ndikoi në ndryshimin e qëndrimit të 4 votave? Kuptohet që ndryshim juridik të çeshtjës nuk pati.

Një nga pikat e forta të kërkesës për antikushtetutshmeri të Marrëveshjes ishte mungesa e “plotfuqisë së grupit shqiptar të negociimit”, pasi kishte autorizim nga kryetari i qeverisë dhe jo nga Presidenti i Republikës. Ky diferencim bëhet për arsye se Marrëveshja konsiderohet, sipas Gjykatës, e natyrës politike. Për t’i dhënë autorizimit të “plotfuqisë” nga Presidenti, vlerën e leves së Arkimentit në rrezimin si antikushtetuese të Marrëveshjes, Gjykata konfondon procesin e negociimit, si nivel teknik, me lidhjen e Marrëveshjes si akt politik. E bën këtë kur pranon se kompetenca e grupit negociator arrin deri tek hartimi i tekstit të Marrëveshjes, kur njëj se Marrëveshja do të ratifikohet nga Parlamenti dhe se Presidenti mund të ushtrojë të drejtën e tij kushtetuese me aprovimin e saj. Pra, nuk bëhet fjalë se Marrëveshja konkrete përbën një akord politik që duhet medoemos të arrihet nga Presidenti. Dhe as se mungesa e plotfuqisë së grupit negociator i heq Presidentit mundësinë e ushtrimit të së drejtës së tij kushtetuese.

Në argumentimin e vet Gjykata u referohet instrumentave juridike të brendshme dhe ndërkombëtare (Konventa e Vjenës). Ndërkohë pranon se “Konventa e Vjenës një mundësinë që palët të mos paraqesin plotfuqi, nëse është e qartë nga praktika e tyre ose me rrethana të tjera që këta përsone janë përfaqësues të shtetit.”

Gjykata pranon gjithashtu egzistencën e një praktike të vazhdueshme të zhvillimit të bisedimeve dhe nënshkrimit të marrëveshjeve me palë shtetin shqiptar ku “delegacioni shqiptar të mos ketë qenë i pajisur me plotfuqi nga Presidenti i Republikës.” Tregon se vet Presidenti me shkresën nr.1976/1, dt.3.12.2009 drejtuar Gjykatës, nuk e pretendon këtë të drejtë, ashtu si edhe të drejtën për t’u shprehur për kushtetutshmerinë e Marrëveshjes.

Një moment interesant përbën fakti se teksti i arsytimit të vendimit të Gjykatës i ngjan si dy pika uji me shkrimet publike të dy “avokatëve” të kërkesës së PS-së, Pashaj dhe Krisafit.

Mëgjithatë, po për efekte populiste abuzohet me qëndrimet e palës greke. Kërkesat e saj për një zgjidhje me mirëkuptim, duke shmangur ndërmjetësinë e drejtësisë ndërkombëtare, ose mirren si dobësi, ose si fajësi.

Për Gazetën Tema datë 06/06/2015. U botua me, 08/06/2015



## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2015/06/22/greqia-po-behet-ifigjeni-per-ti-treguar-evropes-se-nuk-i-duhet-nje-troje-e-re/>

**Greqia po bëhet ifigjeni për t'i treguar Evropës se nuk i duhet nje Troje e re.**  
22.06.2015

Këtë të henë në kryeqytetin Evropian e Bruksel, Greqia negocionte për vetë për të shpetuar Evropën. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Greqia thirri vetën në rolin që historia i ka taksur.

Studiuesja e njohur franceze Jacqueline de Romilly, e cila u bë anëtare e Akademisë Franceze në sajë të rezultateve të arritura në lidhje në studimin e kulturës greke, në një nga 20 librat shkencore të saj me këtë objekt, jep përgjigjen se perse Greqia përbën djepin kulturës diakronike të perendimit dhe si e tillë u paraprin zhvillimeve në çdo stad kalimtar të historisë njerëzore. Njëkohësisht, jep dhe një përgjigje aktuale në lidhje me qëndrimin “e bashkuar” të Evropës, “për të izoluar” vendin e ekumenizmit. Thotë akademikja franceze, e cila iku nga kjo botë 5 vjet më parë: “Akoma edhe kur arrijmë sot të ndërpresim kontaktet me këtë moment të privilegjuar të historisë së Njerëzimit, nuk do të arrijmë të ndërpresim këtë plotmeri pjekurie në kohë, përgjatë së cilës kjo kulturë dha frytet e veta brenda nesh”.

Në këtë optikë, Greqia edhe në historinë më të re dhe pavarësisht faktit se kishte përballë Evropën të bashkuar, arriti t’u paraprijë zhvillimeve dhe të orientojë rrugën e Evropës drejt pjekurisë moderne të saj. Për këtë na vjen në ndihmë momenti kalimtar i fillimit të shekullit të 19<sup>te</sup>. Atëherë përballë intiferencës dhe mohimit të Evropës e cila ishte pajtuar me sfidën Otomane në zemrën e vet, Greqia e kuptoi e para se ishin pjekur kushtet që kontinenti i iluminizmit duhej zgjuar nga letargjia e stanjacionit kritik. E para ajo rrembeu pishtarin e ndryshimeve rrenjësore që do të çonin Evropën në vizionin e saj të ri. Greqia, nëpërmjet revolucionit të 1921, vendosi të shëmbë zgedhën otomane për t’i dhënë në vijim Evropës mundësinë të mendojë e të vendosë për fatet e popujve të krishterë evropian nën sundimin Otoman, për të përpunuar hartën dhe strukturën e vet që kemi edhe sot.

Në fillimet e Luftës së dytë botërore, kur të gjithë popujt e Evropës e botës tregonin se përballë murtajës fashiste pajtoheshin me rrugën e vetme të nështrimit, Greqia tha “JO-në” e saj të nohur që u shoqërua me fitorën e parë ndaj makinës me të egër luftarake të kohës, për të frymëzuar kështu shpresën e fitorës së popujve mbi fashizmin, që nuk vonoi të vinte.

Kështu duhet parë dhe qëndrimi i sotëm i Greqisë i anatemuar kolektivisht si faji i denueshëm i mosmirënjohjes. Logjika e fakteve nuk bindin argumentin e atyre që kanë në dorë të tyre edhe pjeprin edhe thikën. Dypërqindshi i ekonomisë greke nuk përbën shkakun e zëmeratës akiliane të evropianëve ndaj Greqisë, ashtu si edhe kriza në përgjithësi nuk lidhet me “mosmirënjohjen” greke. Arsyeja duhet kërkuar tek fakti se qëndrimi i Greqisë zbulon, bashkë me fytyrën e krizës edhe shkaktarët e vërtetë të saj. Në këtë sens qëndrimi i sotëm grek duhet gjykuar si një ngacmim i civilizuar i situatës që mbarset rrezikshëm, që Evropa të kuptojë se kriza e stërgjatur që fshikullon grehinën e pakonsoliduar të saj, nuk zgjidhet me masa shtrenguese dhe denuese... që rrenojnë varfërojnë dhe gjymtojnë!! Qëndrimi grek duhet parë si kontibut që Evropianët duhet të zgjohen nga burokratizimi i sistemit të neokolonializimit të oligarkëve brenda vet organizmit të saj.

Greqia, edhe pse e vendosur nga Evropa në altarin e Ifigjenisë, kërkon t’i thotë Evropës se kriza e vet nuk kapërxehet duke ia faturuar me të varfërve dhe me të dobëtve, se kriza globale nuk sfidohet pa supet e të gjithëve, se duhet të zgjohet para se të

detyrohet të përballojë neootomanizmin si realitet gjeografik në hapësirën e saj, kur ballkani nuk ka më Kastriotë të rinj. Greqia me sakrifikimin që Evropa i impononte duke e paraqitur si vet zgjedhje, (dihet që ceremonjali i sakrificës kërkon vetndergjegjësimin e të flijuarit) kërkonte t'i thoshte se me këtë akt vrimat gjeostrategjike në harkun me të ndjeshëm të gjeografisë së vet rriteshin dhe bashkë me to edhe rreziqet, për të dhe rajonin me të gjerë të ekulibrave gjeopolitike

Në këtë logjikë Evropa tregoi se nuk kishte argumente kundërshtuese. Se nuk përbën argument fakti se Evropa edhe një herë në historinë e saj tregon se është ngujuar në mentalitetin e vet egoist të pagabushmerisë, i cili po vret fleksibilitetin që i duhet një supërshteti bazat e të cilit ngrihen mbi demokracinë e konsoliduar e të përparuar. Deri këtë të henë pra tregoi se po bëhej gati që për të kënaqur, qoftë edhe për pak kohë akoma sovranitetin e të fuqishmit po bëhej gati të sakrifikonte edhe vendin që e lindi demokracinë. Se nuk kapuam tjetër fakti se për dy miliard evro po bëhej gati të humbiste triliarda evro dhe vet ngrehinën e saj ende të pakonsoliduar.

Udhëhëqja politike e Bashkimit Evropian provoi se sa më shumë po i afrohej këtij vendimi, aq më shumë ndeshej me murin e popujve evropianë nën emrin e të cilëve ajo deklaronte se mirrte vendimin e sakrifikimit të Greqisë. Greqia pra provoi se mund ta pranonte rolin e Ifigjenisë dhe bashkë me të edhe flijimin. Dhe gjithcka që Evropa të ripyeste veten në ishte e gatshme të pranonte për vete një Trojë të re në kushte e globalizmit.

Kuptohet që në radhë të parë Greqia ,bajti një qëndrim të tillë për të treguar se në Evropën e Bashkuar nuk mund të mirren nëpër këmbë sovraniteti i shtetëve të saj dhe diniteti i popujve. Në rastin kongret i popullit grek. Se këto janë vlera që kanë më shumë rëndësi se vlera e miliona evrove. Dhe Greqia duket se ia doli qëllimit të dyfishtë të negociojë për vete për të shpetuar Evropën.

Dhe në këtë qëndrim Greqia nuk ishte vetëm.

Panajot Barka për gazetën TEMA 22.06.2015

### **Η ΕΛΛΑΔΑ ΓΙΝΕΤΑΙ ΙΦΙΓΕΝΕΙΑ ΓΙΑ ΝΑ ΚΑΤΑΛΑΒΕΙ Η ΕΥΡΩΠΗ ΟΤΙ ΔΕΝ ΧΡΕΙΑΖΕΤΑΙ ΜΙΑ ΝΕΑ ΤΡΟΙΑ.**

Η γνωστή Jacqueline de Romilly, η οποία έγινε μέλος της Ακαδημίας της Γαλλίας μελετώντας τον ελληνικό πολιτισμό, σε ένα από τα 20 επιστημονικά βιβλία που έγραψε, δίνοντας την απάντηση γιατί η Ελλάδα αποτελεί το λίκνο του διαχρονικού δυτικού πολιτισμού και ως τέτοια προηγείται των εξελίξεων σε κάθε μεταβατικό στάδιο της ανθρώπινης ιστορίας. Δίνει και μια επίκαιρη απάντηση σχετικά με τη σημερινή «ενωμένη» στάση της Ευρώπης, προς απομόνωση της χώρας του οικουμενισμού. Λέει η Γαλλίδα ακαδημαϊκός, η οποία έφυγε από τη ζωή μόλις 5 χρόνια πριν: «Ακόμη κι αν φθάνουμε σήμερα να κόψουμε την επαφή με την προνομιούχα αυτή στιγμή της ιστορίας της Ανθρωπότητας (τον αρχαίο ελληνικό πολιτισμό), δε θα διακόψουμε αυτή την μακρά ωρίμανση, κατά τη διάρκεια της οποίας εκαρποφόρησε μέσα μας».

Υπό αυτή την οπτική γωνία και στους σύγχρονους καιρούς η Ελλάδα, παρά το γεγονός ότι είχε την Ευρώπη ενωμένη εναντίον της, προηγούνταν και χάραζε την πορεία της Ευρώπης προς τη σύγχρονη ωρίμανσή της.

Ας μη θυμίσουμε τον Ηπειρώτη πρίγκιπα που τον 15<sup>ο</sup> αιώνα την έσωσε από τις οσμανικές ορδές. Να θυμίσουμε το άλλο μεταβατικό ιστορικό στάδιο, αυτό στο ξεκίνημα του 19<sup>ο</sup> αιώνα. Μέσα στην άρνηση της Ευρώπης η Ελλάδα διανοήθηκε πρώτη ότι είχαν ωριμάσει οι συνθήκες ώστε η γηραιά Ήπειρος να βγει από τον λήθαργο της

κρίσιμης στασιμότητας. Άδραξε τη δάδα των μεγάλων και ριζικών αλλαγών που θα οδηγούσαν την Ευρώπη στο σύγχρονο όραμά της. Αποφάσισε να ανατινάξει τον οθωμανικό ζυγό για να σκεφτεί στη συνέχεια η Ευρώπη τις τύχες των υπολοίπων χριστιανικών λαών της Οθωμανικής Ευρώπης για να φτιάξει το σημερινό δυτικό της χάρτη.

Στις αρχές του Δευτέρου Παγκοσμίου Πολέμου, όταν όλοι οι λαοί της Ευρώπης και του κόσμου έδειχναν ότι μπροστά στη φασιστική λαίλαπα μονόδρομος ήταν η υποταγή, οι Έλληνες είπαν το δικό τους «ΟΧΙ» για να εμπνεύσουν με την πρώτη τους νίκη κατά της φασιστικής μηχανής, την ελπίδα της νίκης, που δεν έργησε να έρθει.

Μήπως η σημερινή αντίσταση δεν είναι ένα πολιτισμένο άγγιγμα να καταλάβει η Ευρώπη ότι η μακρόχρονη κρίση που διέπει τον ήδη ανολοκλήρωτο οικοδόμημά της, δεν λύνεται με μέτρα λιτότητας και τιμωρίας...;!! Μήπως δεν συνδράμει να ξυπνήσουν οι Ευρωπαίοι από τον γραφειοκρατισμό του κατεστημένου του νεοαποικισμού των ολιγαρχών. Μήπως η Ελλάδα δεν λέει στην Ευρώπη, έστω και υποβληθείσα απ' αυτή σε θέση Ιφιγένειας, ότι θα πρέπει να ξυπνήσει πριν κληθεί να αντιμετωπίσει το νεοοθωμανικό τόξο που χτυπάει τις πόρτες ακριβώς στη δική της καρδιά. Μήπως δεν λέει στην Ευρώπη ότι με τη θυσία της οι γεωστρατηγικές τρύπες στο πιο ευάλωτο κομμάτι του οικοδομήματός της μεγαλώνουν και γίνονται πιο επικίνδυνες για εκείνη και τις ευρύτερες γεωπολιτικές ισοροπίες...?!!

Και η Ευρώπη δεν έχει επιχειρήματα εναντίον, πέρα από το ο, τι για μια ακόμη φορά στην ιστορία της έχει καθηλωθεί στην εγωιστική νοοτροπία, η οποία της έχει στραγγαλίσει την κάθε ευελιξία και την οδηγεί τυφλά στο γκρέμισμα όλου του οικοδομήματός της. Για να ικανοποιήσει έστω και για λίγο χρόνο ακόμα την κυριαρχία του ισχυρού είναι έτοιμη να θυσιάσει και την ίδια τη δημοκρατία, για δύο δισεκατομμύρια να χάσει ολόκληρα τρισεκατομμύρια.

Μπορεί η Ελλάδα να γίνει η Ιφιγένεια και να αποδεχτεί τη θυσία. Πριν όμως η Ευρώπη θα πρέπει να διερωτηθεί αν θέλει για λόγο της μια νέα Τροία...!!! Fb 22/06/2015

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2015/07/06/vota-e-zeusit-te-dielen-ne-greqi-dhe-mentaliteti-keqdashes-ne-shqiperi/>

### **“Vota e Zeusit” të dielën në Greqi dhe mentaliteti keqdashës në Shqipëri.**

06.07.2015

Një javë para se qeveria Greke të mirrte vendimin sfidues për zhvillimin e referendumit të 5 korrikut, në gazetën TemA kisha botuar një shkrim që mbështetej tek ideja se Greqia “negocion për vete, për të shpëtuar Evropën”. Shkrimi u pasua nga komente tmerrësisht denigruese dhe poshtëruese për vendin dhe popullin fqinj. Nuk ishte ndonjë e re. Madje, duhet thenë se ne hapësirën publike shqiptare, (mjete informimi publik, politikë, njerëz të letrave etj) u përvijua një dashakeqësi që gjunjëzimi i popullit grek dhe Greqisë përkathej në një gjendje plotërie shqiptare. Kulmi u arrit me “humorin” e akademikut profesor Artan Fuga që shpreh dëshirën për skenare me myslimanizim shqiptar të Greqisë e të grekërve dhe shndërrimin e këtyre të fundit në lypës e shërbëtorë të akademikut – afendiko. (!)

Nejse! Ngjarjet deri pak pas përfundimit të referendumit vërtetuan katërcipërisht idenë e shkrimit tim në TemA. Zbuluan njëkohësisht distancën e këtij mentaliteti shqiptar, jo vetëm nga fqinji Greqia, me të cilën Shqipëria lidhet me shumë fije marrëdhëniesh, varësie e ndërvarësie, por edhe nga fontamente të tilla siç janë demokracia e solidariteti. Përpjekja e këtij mentaliteti për t’u mbështetur në asosacione historike të aleancave me më të fortët kundër fqinjëve, po lë një shije forcërisht të keqe.

Lë të përpiqemi të bëjmë një përjasje sa më konkrete. Në lidhje me referendumin mentaliteti shqiptar për të cilin flasim u rreshtua në mënyrë vullnetare me ato zëra (edhe evropiane, edhe greke të paguar) që e keqinterpretuan qëllimin e tij, si një përpjekje e qeverisë greke për t’u larguar nga BE, për t’u bashkuar (sipas logjikës së luftës së ftohtë) me armikun e ri të shqiptarëve, Rusinë. (Në mentalitetin shqiptar për të cilin flasim, ideja e mikut të ri kërkon mëdoemos një kundërvënie me një “armik”, i cili mund të ishte edhe miku i vet).

Dilema faktike e referendumit ishte e thjeshtë. Populli grek ftohej:- Ose t’u thoshte “PO” politikave shtrenguese të propozuara me imponim nga instutcionet e BE-së, (të cilat do t’i përballonin shtresat e mesme dhe të ulta, që do të thotë se në kushtet e një borxhi të pamanaxhueshëm varfërimi i tyre do të ishte i skajshëm dhe në infinit), - ose t’u thoshte atyre “JO” me qëllim arritjen e një marrëveshjeje brenda BE-së dhe evrop-s, por me kushte me lehtësuese, në kuadrin e reformave që premtojnë zhvillimin dhe manaxhimin e borxhit.

Vetë vendimi për referendumin shkaktoi termet në kampin e atyre faktorëve në BE që i kanë rrembyer realitetit themelues të saj, “edhe pjeprin edhe thikën”. Në pamje të parë reagimi i BE-së kundër referendumit grek dukej se lidhej me vullnetin politik për të eliminuar një qeveri të majtë të votuar nga populli grek. Arsyeja nuk lidhet aq me prishjen e balancës së qeverive konservatore deri dhe liberale të vendeve të BE-së. As me faktin e pretenduar se në zgjedhjet në vijim, në shumë vende të BE-së mund të perhapet “semundja” e majtizmit, apo ekstremit të djathtë.

Lidhej më shumë me faktin se qëndrimi “rebel” i qeverisë greke të krymenistrit 40-vjeçar Tsipras, po zbulonte se parimet e vyera në themelet e BE-së, të demokracisë, të barazisë së shtetëve anëtare pavarësisht peshës së tyre specifike, të ndërshterisë dhe drejtësisë, të solidaritetit dhe të humanizmit, nuk janë më funksionale. Po zbulonte se

pesha e vërtetë e rendit të ri botëror që po ndërtohet, po kalon në duart e një oligarkie shtetërore dhe grupeve bankare, financiare e politike me veprim global.

Ultimatumi nga strukturat e BE-së që qeveria greke të nëshkruante një marrëveshje të re, e cila, të paktën për 5 vjet, u provua se kishte dështuar; shantazhi për të interpretuar referendumin si antidemokratik, si dilemë që i shtrohej popullit grek nga qeveria e tij për të qendruar apo jo në euro dhe në Evropën e Bashkuar; shantazhi me bllokimin e sistemit bankar; vënien në lëvizje të sistemit medjatik privat për të mbjellë panik në popull dhe për të votuar “pro” një marrëveshjeje që do të rendonte mbi kurrizin e tij; angazhimi i opozitës për fitorën e variantit të BE-së (me shpresë rrëzimin e qeverisë Tsipra) dhe aktivizimi i gjithë asaj shtrese, e cila nga zbatimi i politikës së dështuar ekonomike të BE-së në Greqi këto vitet e fundit u pasurua jashtë zakonisht shumë; janë tregues të qartë se perse qeveria e zgjedhur e Greqisë duhej sakrifikuar. Flet për këtë edhe fakti se përfaqësues dhe struktura zyrtare të BE-së nuk e kishin për gjë të ndërhyenin direkt apo indirekt në vendimarrjen e tij. Të gjitha janë tregues që vërtetojnë se BE-ja ka probleme serioze me parimet e veta demokratike dhe me përballimin real të krizës. Strukturat e BE-së e dinë shumë mirë se një GREXIT, i kushton BE-së dhe botës në terësi një dëm financiar njëqindfish më shumë se borxhi grek. (Vetëm humbjet financiare që u shkaktuan javën e referendimit grek janë disa herë më shumë se vet borxhi i Greqisë) Por, ky qëndrim i saj ndaj Greqisë po provon se interesi politik ka më shumë rëndësi se dëmi ekonomik.

Populli grek në mbrojtje të votës së tij në favor të kësaj qeverie, pati guximin të thotë, po me votë plebishitare, “JO” e tij ndaj gjithë këtij realiteti, për të pohuar me këtë mënyrë një “PO” të fortë për familjen Evropiane të parimeve demokratike e të solidaritetit.

Përveç kësaj sfide, nëpërmjet referendimit populli grek duhet të sfidonte realitetin e vet të brendshëm, që lidhet me kohën e shkurter, me opozitën dhe qëndrimet e saj terrorizuese, shantazhi, frike dhe makinacione për përçarje popullore. Lidhen me situatën e vështirë ekonomike dhe me imponimin e kushteve zvetenuese jetese që asnjë lidhje nuk kishin me një vend të Bashkimit Evropian.

Por Greqia e zhvilloi referendumin duke sfiduar të gjitha pengesat. (Votë e Zeusit” e cilësoi votimin e popullit grek revista franceze Liberation). Populli grek demonstroi vetpërmbajtje, pjekuri civile, demokratike e politike. Asnjë incident elektoral, asnjë mangësi teknike edhe pse koha ishte vetëm 5 ditë. Kryetari i opozitës dha menjëherë dorëheqjen duke pranuar kështu përgjegjësitë e qëndrimeve të opozitës. Porcat politike greke pranuan rezultatin dhe jo vetëm u deklaruan pro qeverisë në negociatat e reja, por vetëm disa orë pas referendimit u ulën bashkë me qeverinë rreth një tavolinë nën drejtimin e presidentit të republikës, për të gjetur zgjidhjen e mundshme më të mirë për popullin dhe shtetin grek.... Uniteti popullor mbeti i pacenuar e plotë rezultate të tjera që vet tejkalojnë shumë çdo kulturë demokratike e marrëdhënje luajale të përditësuar.

Është pikërisht ky realitet që e bën sot Greqinë të jetë në qëndër të vemendjes botërore dhe të fitojë simpatinë dhe respektin edhe të atyre që deshën sakrifikim e saj. Në krahë të Greqisë dhe popullit grek rritet solidariteti i popujve në të gjithë ruzullin.

E pakuptueshme perse populli shqiptar lihet i përjashtuar nga kjo përpjekje e popullit grek, e cila në fund të fundit përveç fatit të vet po ve në kandar edhe fatin kritik të krizës evropiane. Sa vlerë kanë leksionet demokratike dhe evropianiste në panele teevizive shqiptare kur ato “skanojnë” vetëm fundin e Greqisë dhe nuk shikojnë distancën me demokracinë brenda vendit. Sa vlerë ka dashakeqësia për Greqinë kur nuk shikohet se me fatin e saj janë të lidhura fatet e mijra familjeve shqiptare në Greqi. Një solidaritet ndaj Greqisë në këto momente është solidaritet ndaj emigrantëve shqiptarë

atje. A kanë menduar vallë gjithë këta papagaj të keqdashjës për fqinjin se a i ka Shqipëria parametrat e Greqisë për të absorbuar pasojat e një krize sociale për shkak të ndonjë eksodi të mundshëm shqiptar nga Greqia. A kanë menduar ata se Greqia është realisht vendi i parë për sa u përket investimeve të huaja dhe partneri kryesor tregtar e bankar. Kujt i shërbën mentaliteti i “evropianistëve” shqiptarë se vlera e vetme për Shqipërinë në këto momente është të rrënia e Greqisë.

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2015/07/14/greqia-dhe-rendesia-e-samitit-historik-te-brukselit/>

### **Greqia dhe rendësia e samitit historik të Brukselit**

14.07.2015

Pas samitit të nivelit të lartë të vendeve të Eurozonës të BE-së, të së dielës, i cili për nga kohëzgjatja do të mbetet në histori, Greqia arriti një marrëveshje me kreditorët e vet, për një paketë të re ndihme trevjeçare për të dalë nga kriza.

Në fakt, këtë samit nuk e bën historik kohëzgjatja prej 17 orësh pa ndërprerje. As “vështirësia” e zgjidhjes së krizës greke. Ajo që e bën historik këtë samit është fakti se qëndrimi i kreut qeverisës greke në negociatat 5 mujore me institucionët ekonomikë dhe politikë të BE-së, ridimesionoi parimet themeluese dhe rishikimin e standarteve në marrëdhëniet midis partnerëve dhe të vet objektivave të saj.

Franca dhe Italia bashkë me partnerë të tjerë shtetesh apo dhe drejtues institucionesh të BE-së, Junker, Moskovisi, Tusk etj, arritën t’i venë fre hegjemonizmit gjerman brenda Unionit. Duke kërkuar zgjidhjen e problemit grek nën objeksionit e parimit të dolidaritetit dhe jo të ndihmës si marrëdhënie vasaliteti midis një vendi anëtar të Eurozonës dhe vet BE-së, Holland dhe Renci krijuan, nga njëra anë, një trase sigurie për nëvojën e mundshme të ristrukturimit të ekonomive të vendeve të tyre. Nga ana tjetër rikthyen pozitat e baraspeshës me kancelarën gjermane Merkel. (Lajmet nga samiti bëjnë të ditur se ishte hera e parë që marrëdhëniet e partneritetit midis Holland dhe Merkel kishin një kondradiktë të shprehur kaq hapur.) Po ashtu marrëveshja e arritur me Greqinë, parë si arritje komplementare e qëndrimit të Tsiprës dhe mbështetjes së fuqishme të Francës, Italisë dhe faktorëve të tjerë, ishte një prapësim i revanshit të modelit ekonomik të liberaleve të ekstremit të djathtë i shprehur politikisht në asfiksionë e imponuar qeverive të majta. (Një ditë para samitit historik të së dielës, ministri i financave të Gjermanisë Soible, edhe pse në karrocë gati sa nuk u zu me duar me drejtuesin e Bankës Qëndrore Evropiane Draghi, për shkak se ky i fundit lejonte akoma oksigjen financiar për bankat greke. Sipas kryeministrit grek egzistonte një plan i mirëdetajuar që nëpërmjet këtij instrumenti të arrihej rrezimi i qeverisë greke. Vet kushtet e marrëveshjes së bashku me kërkesa e drejta për reforma në Greqi fshehin dhe një serë kushtesh që kanë si pikënisje mllefën ndaj sfidës së Tsiprës).

Nga ana tjetër, në rastin e Greqisë, rrezimi i Tsiprës nga pushteti, nuk lidhet aq me krijimin e precedentit negativ të një qeverie pastërtisht të majtë në BE, (që do të shërbente si mësim për spanjollët, portugëzet, italianët apo edhe fancezët). Kishte të bënte me faktin se qeveria e profesorëve universitarë dhe akademikëve të Tsiprës, nuk janë pjesë të sistemit të qeverisjes përmes fijeve të padukshme të oligarkisë financiare që ushqen hegjemoninë politike dhe gjeopolitike, kryesisht gjermane. (Edhe në Shqipëri këto fije po thurin politikën e vendit me praninë bile të krimin të organizuar)

Në lidhje me Greqinë kjo lëxohet me faktin se ekonomia e saj prej dekadash po elimonohej nga aftësitë konkurruese, qoftë edhe në lëmin e turizmit dhe se drejtimi i saj po u lihej në dorë një klani njerëzish të penalizuar prej kësaj oligarkie përmes korrupsionit, me pasojë nënshtrimin dhe bindjen pa kushte. Kjo çonte në minimizimin absolut të rolit gjeopolitik të Greqisë në Ballkan dhe Mesdhe që në politikën e brendshme greke shprehet hapur si humbje e sovranitetit kombëtar. (Alarmi ndërkombëtar arriti kulmin kur në trekendëshin gjeostrategjik Mesdhe – Lindje e Mesme, - Ukrainë, Siri, Ballkan,- Greqia si vend me stabilitet të garantuar euroatlandik, anëtar o NATO-s dhe i BE-s, po i dorëzohej destabilitetit).

Historia tregon se pas vitit 1990 kur ndodhi bashkimi i gjermanive, Gjermania, si aleate kryesore e SHBA-ve në Evropë dhe me përkrahjen e hapur tyre, inspiroi një serë ndryshimesh të hartës politike të Evropës Juglindore, qofshin këto të dhunshme apo paqësore. Pas kësaj ishte po ashtu frymëzim i interesave gjermane zgjerimi i vrullëshëm i hartës gjeopolitike të BE-së drej lindjes, verilindjës e juglindjës evropiane. (Njolla murme mbeten vetëm në Ballkan). Kjo tregon se Gjermania nuk sillet më, as si mëkembese e SHBA-s në Evropë e as si aleat i tyre. Insituti Amerikan i Studimeve Gjeopolitike Stratfor që në mars të 2010 shprehej se kishte venë re “rrezikun e kthimit të Mitteleuropa-s”, që do të thotë kthim të hegjemonisë Gjermane në Evropë si në fillimet e shekullit 20-të.

Ky qëndrim gjerman çoi në përvijimin e dy standarteve, në atë të BE-së nën hegjemoninë gjermane dhe të NATO-s nën rendësen amerikane. Në konsumin publik, të dy strukturat, servivreshin si njesi plotësuese, ndërkohë që NATO zotëron një fuqi botërore.

Ky diferencim evidentohet qartazi edhe nga qëndrimi rus. Moska kurrë nuk shfaqti ndonjë reagim që duhet marrë në konsideratë për shtrirjen gjeogrtafike të BE-së drejt kufijeve të saj, ashtu siç ndodh (krejt e kundërta) me të njëjtën kahje të NATO-s.

Diferencimi që ushqen kondradiktë të heshtur por më të mbrehtë midis Gjermanisë dhe SHBA-së përbën Ballkani. SHBA ka treguar se e konsideron Ballkanin hapësirë të një rendësie jetike për interesat e veta. (Në rastin e Greqisë SHBA nuk la pa u venë re se që me qeverisjen e Simitis Gjermania fitoi privilegjin e saj në blerjen e armeve nga Greqia. Amerikanët u pezmatuan edhe nga përgjigja e Soible-s dhenë gjatë negociatave ministrit amerikan të Financave Liou, që nëse e doni vërtet Greqinë i jipni asaj një kredi prej 50 mild evrosh)

Ajo që tërheq vemendjen është fakti se këto ditë të krizës së madhe greke Tirana dhe kryeqytetet e tjera ballkanike (të rrafshit me popullsi myslimane) u shndërruan në stacione vizitash të politikanëve të lartë të vendeve të BE-së, vet BE-së dhe SHBA-së (rrallëherë është shënuar një dendësi kaq e madhe vizitash, madje me një itenerar kaq të ngjashëm), ku nuk mund të mos vihet re rivaliteti midis SHBA-s dhe Gjermanisë. (Veçohet vizita rrufe e kancelarës Merkel.)

Nuk ka dyshim se denduria e këtyre vizitave lidhej me mundësinë e destabilitetit në Greqi, të cilën SHBA e konsideron argjaturën penguese për luftetarët islamikë ndaj Evropës. Ky argument (rreziku islamik për Evropën) u përdor në fakt nga Greqia dhe Shqipëria për t'i bërë presion BE-së. (Secili vend për hesap të vet.) Në rastin e Greqisë argumenti u klasifikua si bllof. Në rastin e Shqipërisë argumenti i kryeministrit i cili tha pak a shumë se nëse Shqipëria nuk anëtarësohet në BE do të kthehet në vend të islamikëve, u injorua nga vet Merkel e cila tha se edhe në Gjermani ka shumë myslimanë.

Por a duhet anashkaluar ky faktor në gjeopolitikën Ballkanike dhe Evropiane dhe në balancat e interesave të të medhenjve? Është fakt që rreziku i harkut islamik në Ballkan me synim Evropën Qëndrore bën shfaqjen e tij ciklike që me 1990-91 (atëherë nuk egzistonte diferencimi midis termit mysliman dhe islamik me kuptimin e sotëm, pasi islamizmi radikal nuk ishte shfaqur me intensitetin e sotëm politik). Po të heqim rastin e dogmën turke të Davutogllos (kryeministrit të sotëm të Turqisë) për frymëzimin e neotomanizmit edhe në Ballkan, egzistojnë edhe shumë përpjekje të tjera për t'u mbështetur tek elementi islamik me qëllim ushtrimin e presionit, qoftë ekonomik, qoftë gjeopolitik në rajon. Mungesa e pranisë ruse në këtë gjeopolitikë, nuk e cvlerëson aspak problemin. Thjesht e kalon atë në plan “aleatesh” Në një krahasim përserites të fenomeneve situata të kujton shekullin e 15-të kur të njëjta rrethana (në krishterimin evropian) kërkonin si faktor determinant praninë e faktorit otoman në rritje.

Kuptohet që ky përbën vetëm një plan të rendësisë që fiton stabiliteti i Greqisë dhe pas kësaj i të gjithë Ballkanit.



## Nga Panajot Barka

<https://albanianorthodox.wordpress.com/2015/08/27/nje-tjeter-kendveshtrim-per-misionarin-nilo-catalono-gazeta-tema/>

<http://www.gazetatema.net/author/mbaze/page/956/?pid=95312069>

<http://fax.al/read/news/1063554/10135371/a-eshte-himara-greke-apo-djep-i-shqiperise>

### Çfarë fsheh NILO Catalono dhe kush fshihet pas tij

26.08.2015

Pebesia me të cilën shteti rrezoi natën e kësaj të marteje kishën ortodokse të Dhërmiut, tregon vendosmerinë tinëzore të strukturave të caktuara për të realizuar qëllimin e vërtetë dhe gjysëm të maskuar të një veprimi të tillë. Vërteton njëkohësisht edhe papërgjeshmerinë, që në emër të mashtrimit për korrigjimin e historisë së patriotizmit shqiptar, të abuzojnë më të dhe të provokojnë çeshtje të tilla fundamentale siç janë raportet historike midis fesë së krishtere ortodokse dhe asaj katolike. Fakti që frymëzuesit e skenarëve të tillë shkelin me aq lehtësi dhe brutalitet të drejtën fundamentale të njeriut, atë të ushtrimit të besimit, nuk flet se kemi të bëjmë me shkallë të lartë sundimi të mentaëitetit komunist mbi strukturat e shtetit. Por flet për interesa shumë të mëdha meskine që nënshtojnë dhe parimet e laicitetit të shtetit.

Nxitimi i skajshëm për shëmbjen e kishës, nxorri shpejt në pah qëllimin e vërtetë që fshihej pas këtij akti. Ai vend i shenjtëruar nga prania e një kishe ortodokse që prej shekullit VI, po u duhet këtyre qarqëve për të memoralizuar kujtimin e një misionari katolik i fundit të shekullit XVII. Ai nuk pati mundësinë të ndryshonte identitetin e kishës ortodokse e cila jetoi si e tillë gjersa u shmeb nga komunistët me 1972. Këto struktura duan tani me dhunë t'i japin atij vendi të shënjtë identitetin e fesë që misionari katolik përfaqëson.

Këto qarqe “shqiptare” nxitojnë ta paraqesin këtë misionar, si arberësh, si vellaun e një gjaku, si pararendësin e hërshëm të shqiptarizmit. I mveshin atij merita si hapës “ndoshta” shkollash shqipe, si “ndoshta” shkrues i letërsisë shqipe, si “ndoshta” shkruesin e fjalorëve shqip etj. Që të jenë më bindës dhe më imponues në teorinë e tyre populiste nacionaliste, i ballafaqojnë këto “merita” me synimet e hellenizmit dhe i përdorin si fakte bindese të shqiptarësisë së Himarës (!!??) Njëkohësisht kjo teori me konsum të gjerë publik, përdorët si alibi efikase për të fshehur qëllimin e strukturave të vërtetë të këtyre skenarëve, që çojnë sipas të gjitha gjasave, në nëvojën e rigjallërimit të strukturave të Propagandës Fide, misioni i së cilës për gjatë 135 viteve (1628-1763) për katolicizimin e Himarës kishte dështuar. (Misionari i fundit i këtij inkursioni katolik në Himarë Silvestro Sladhi i raportonte me 1760 Vatikanit se “midis Himarioteve nuk egziston asnjë katolik. Të gjithë janë armiq të Papës dhe përndjekës të pamëshirshëm të tij...” ) Pra një histori dështimi për frymëzuesit e këtij misioni, Propagandës Fide, përdorët si histori suksesi nga pasardhësit 350 vjeçarë që e çuan këtë mision në dështim.

Nyja e këtij strumbullulari është misionari katolik bazilian i Propagandës Fide Nilo Catalano. Mirëpo, sipas gjithë të dhenave të studiuesve arbereshë, Catalano nuk i bie të jetë arberesh, por me origjinë spanjolle. Me të hapet në Himarë faza e tretë (1693) e misionit për katolicizimin e Himarës të Propagandës Fide. (Faza e parë 1628-1642, faza e dytë 1643-1693, faza e tretë 1693-1763.) Pjesëmarrësit e fazës së tretë, ndryshe nga ata të fazës së parë dhe të dytë që ishin me origjinë greko-bizantine, ishin latinë dhe arbereshë por po të ritit bizantin. Ky proces në Himarë synohej të arrihej nëpërmjet aplikimit të ritit bazilian, i njohur ndryshe edhe si UNIA. Arritja e këtij qëllimi bazohej në shfrytëzimin e nëvojës që kishin himariotët për ndihmë ushtarake nga Vatikanit për të ruajtur privilegjet e tyre ndaj Portës së Lartë.

Përveç se Catalano nuk ishte arberësh, edhe misioni i tij fetar nuk kishte asnjë lidhje me shqiptarizmin. Në atë periudhë njesia komb dhe nocioni kombësi nuk përbënin koncepte të përcaktuara. Kështu që misionarët katolikë bazilianë në Himarë, aq më tepër ata, i shërbënin me besnikëri misionit për të cilin kishin ardhur, që ishte përhapja e fesë së tyre. Edhe hapja e shkollave i shërbënin këtij qëllimi.

Nga ana tjetër realiteti bazilian e tyre, siç i përcakton professori arberesh Matteo Mandala, nuk krijon asnjë lidhje me shqiptarësinë. (Libri i parë në gjuhën “italo-shqiptar” në Itali, u shtyp me 1762, dmth, një vit para se të mbaronte misioni i Propagandës Fide në Himarë). Feja që arbereshët aplikonin dhe aplikojnë në Itali, është ajo UNIAS, dmth se nga pikëpamja hierarkike njohin autoritetin e Papës, ndërsa në funksionin praktik fetar, aplikojnë ritin bizantin në gjuhën greke. Nathalie Clayer na thotë për këtë se “riti greko-bizantin kishte qenë një element qëndror që karakterizonte italo-shqiptarët dhe, në veçanti, institucionet e tyre specifike (kishat, kolegjet, seminarët) cilësoheshin zakonisht si greco-albanese ose dei Greci (“e grekëve”). Clayer na njofton gjithashtu se në fillim të shekullit të XVIII, egzistonte urdhëri monastik grek, i bazilianëve të cilët arritën të kishin edhe seminarët e tyre “të destinuar për formimin e klerit të ritit grek, që dhanë po ashtu ndihmesën e tyre për formimin e një elite laike greko-shqiptare”. Për këtë u quajtën Unitarë-bazilianë.

Realiteti ortodoks i Himarës dhe qëllimi i përhapjes së katolicizmit nëpërmjet Unias e bënte më të domosdoshëm, ruajtjen e ritit bizantin, atij grek. Pra, në aspektin misionar fetar, asgjekundi nuk egzistonin premisa për nëvojën e shqiptarizmit.

Nga ana tjetër, peshkopët arbereshë që vizituan Tiranën në prillin e 2014, deklaruan zyrtarisht se KOASH, “për ne arbëreshët me ritin bizantin në Itali ish dhe qendron si një pikë rrëferimi i përditshëm. Ne nuk kemi asnjë interes material ose territorial dhe fetar këtu në Shqipëri, ku Kishta Orthodokse e bën shumë mirë e me nderë e shëjtërimin e popullit. ...”

Atëherë me të drejtë shtrohet pyetja: Kush është i interesuar për promovimin e një projekti të tillë të rievidentimit të Propagandës Fide në Himarë. Një përgjigje besoj se jipet dhe lidhet me struktura që duan përhapjen e katolicizmit në Jug të vendit atje ku ortodoksia është më shumë vitale dhe e qëndrueshme. Dhe problemi nuk shtrohet për revansh, por influencë fetare gjeopolitike në një rajon gjeostrategjik.

Nga ana tjetër një skenar i tillë nuk mund të jetë i momentit. As i përmasave të vogla siç kemi parë vite me parë, pavarësisht se dështuan. Fjala është për projektin në lidhje me objektin “kishë –xhami” në kalanë e Shkodrës dhe atë me qëndrën kulturore për intelektualët myslimanë në kishën-teqe të Melanit në Gjirokastrë. (Një nga protagonistët e skenarit që po flasim, A. Shkreli është i njohur si implementues të tyre)

At Foti Fico nga Bregdeti, mbrenda mekateve të tij kishte tërhequr vemendjen Kryepeshkopit Anastas për tolerimet që ishte detyruar të bënte ndaj strukturave katolike, protestande, ungjillore e të tjerë në territorin e Mitropolisë së Gjirokastrës, veçanërisht në zonën e Bregdetit. Një pasiojë e parë e këtij tolerimi është fshati i Shen Ilisë përballë Butrintit me banorë katolikë e myslimanë nga Veriu i vendit. U ngrit nga struktura katolike fil pas ngjarjeve të 1997. Në majën e kodrës ku u ngrit ky fshat ishte një kryq i madhë ortodoks i cili u rezua paraprakisht me dhunë.

Pak para vizitës së Papës në Shqipëri, shtator 2014, nga “analistë” politikë shumë afër grupit të skenarit të tanishëm, pati analiza në medja ku ortodoksia shqiptare identifikohet me strukturat ortodokse të shekullit XIV-XV që bënin aleanca me otomanët për të përballuar katolikët, ose shpallë më e rrezikshme se xhihadistët.

Ky demonizimi i kishës ortodokse shqiptare dhe identifikimi i qëllimshëm i saj me helenizmin, përdorët nga skenaristët për “moralizimin” e Catalanos, po aq sa në favor të idesë për të krijuar pjedastele për simbole fiktive të një krenarie virtuale

kombëtare, se sa për ta shkëputur Propagandën e re “Fide” nga kuadri strikt fetar, drejt një horizonti “laik” me perspektivë të qartë politike dhe gjeopolitike. Për institucionalizimin e këtyre zhvillimeve, skenaristët po abuzojnë me pushtetin (politik dhe monetar) që i motivon dhe, me po të njejtën metodologji të përdorur për të rrezuar kishën, përgatiten të venë në rresht strukturat “shkencore”, për të thenë “me kopetencë” fjalën e tyre. Ata janë në origjinë ortodoksë, katolikë, muslimanë, që e harrojnë origjinën për të “vepruar” në emër të interesave të atdheut, interesa që në fakt i përcaktojnë interesa mesquine të të tretëve. **FUND**

Për gazetën TEMA datë 26.08.2015

## Nga Panajot Barka

<https://www.pressreader.com/>

<https://www.pressreader.com/albania/gazeta-shqiptare/20150830>

<https://balkanweb.com/te-pathenat-e-kishes-se-dhermiut/>

### Vatra e nxehte e tymnajës së debatit për kishën e Dhërmiut.

30.08.2015

Debati i dukshëm rreth kishës ortodokse të Shen Thanasit në Dhërmi, është kërpuhja e sajuar që tenton të fsheh vatrën e nxëhtë të një problemi fontamental në raportet historike midis fesë së krishtere ortodokse dhe asaj katolike Si i tillë tejkalon Himarën, Epirin, Greqinë apo Shqipërinë. Duke u përpjekur për të lexuar skenarin e debatit kupton se ai synon të fshehë rinisjen e një misioni të dështuar 135 vjeçar, (1628-1763) të ngritur nga kongregata e Propagandës Fide për të mbjellë katolicizmin në zonët e Himarës, (dhe të Pargës) qoftë edhe në formën e Unias (Baziliane). (Në një raport të misionarit Silvestro Sladhi drejtuar Vatikanit me 1760 midis të tjerash theksohet se “midis Himarioteve nuk egziston asnjë katolik. Të gjithë janë armiq të Papës dhe përndjekës të pamëshirshëm të tij...”)

Tërheq vemendjen fakti që një rinisje të misionit me qëllime të vjetra e të reja, zë fill pas 350 vjetëve. Debati nisi pikërisht në përvjetorin e vdekjes së shen Kozmait që konsiderohet një nga dy shkaktarët kryesorë të dështimit të katolizimit të Himarës. Arsyeja e parë lidhet me shfaqjen në skenën gjeopolitike të kohës të Rusisë, që i dha fund krahut ushtarak e ekonomik të Vatikanit në Ballkanin Perëndimor, - Republikës së Venedikut. (Eshte koha që Himariotet nuk i shkruajnë me letra Papës për ndihmë ushtarake kundër Turqisë, por shen Petërburgut).

Kuptohet që sot ata morën përsipër një nismë të tillë nuk janë, as të vetëm, as aq të thjeshtë, as se ky skenar është i momentit. Prapa tyre ka projekte të kushtueshme, por jo të panjohura. Aplikimi i tyre kësaj here bëhet sipas fjalës së urtë, “gjetkë pula kakaris e gjetkë e bën vezën” (për të humbur gjurmët) Një nga protagonistët e këtij debati, A. Shkreli është i njohur në implementimin e dy projekteve të tjera me po këto ngjyrimë, por të dështuara. Bëhet fjalë për projektin në lidhje me objektin “kishë – xhami” në kalanë e Shkodrës dhe ai me qëndrën kulturore për intelektualët myslimanë në kishën-teqe të Melanit në Gjirokastrë. Nga ana tjetër debati i nisur duket se kërkon të lehtësojë punën e institucionëve që do të thonë fjalën “shkencore” më pas, duke hapur shtegun publik për teza të manipuluar. (Pak a shumë kjo histori i ngjan heroizimit të shkurtë palvata-ve nga regjimi komunist)

Ky manipulim ngërthen deformime në një serë drejtimeshe dhe nivelesh ku mbizotëron ai patriotik si më i afti për të mbuluar çdo prapësi.

#### **Deformimi më i thjeshtë. Ai i realitetit të objektivit të kultit sot.**

Dihet se nje objekt kulturi percaktohet nga raporti qe vendosin besimtarët me të, pavarësisht nga parametrat dhe natyra arkitekturore. Besimtarët ortodoksë në Dhërmi e pranuan atë ndërtim, ngritur në vendin e shënjtëruar nga një kishë e shkek. VI, si kishen e tyre. Fakti që ata falen atje me përkushtim prej 23 vjetësh dhe janë gati për çdo sacrificë në mbrojtje të saj, nuk lëjon asnjë ekuivok dhe nuk pranon asnjë ndërhyrje. Çdo qëndrim i kundërt përbën provokim dhe shkelje të së drejtës fontamentale të njeriut, të drejtës së besimit.

Se dyti. Në një vend ku masa e legalizimit të objekteve të paligjshme përbën suksesin politik të çdo qeverie, nuk mund të pranohet arsyetimi se duhet prishur një objekt kulturi në emër të zbatimit të ligjit.

Se treti. Vet strukturat përgjegjëse të shtetit deklarohen se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me vlerë aktive dhe të regjistruar kulturore, për arsyen e thjeshtë së është shëmbur përfundimisht që me 1972.

Duket se synohet personalizimi i vendit të shenjtë nga figura e një misionari të katolicizmit, për ta glotifikuar sa më bindshëm atë. (Edhe perendoria otomane, adoptonte kishat në xhami me shpresë se tradita e besimit do të bënte më të lehtë ndërimin e fesë) Por e vërteta historike nuk pranon identifikimin e kësaj kishe, jo me një murg, por as me fenë katolike e as me hallkën e saj kalimtare të UNIA-s. Themëlimi i saj daton në shek VI si kishë ortodokse. Misionari Catalano erdhi këtu pas mbi 10 shekujsh. Kisha e Shen Thanasit vazhdoi egzistencën e saj si kishë ortodokse deri me 1972

Së katërti. Dhe arsyetimi i shëmbjes së kishës për gjetjen e varrit të misionarit të Propagandës Fide, Nilo Catalano, përbën një abuzim. Të dhenat që fshihen, flasin se eshtrat e tij janë tërhequr nga italianët në luftën italo-greke me 1940. Pra, në menyrë shumë abuzive dhe për të mbjellë meri publike thuhet se varri ndodhet nën murët e këtij objekti semblast kultit që forca madhore e shtetit e shëmbi me pabësi.

### **Abuzimi me Nilo Catalanon dhe me historinë e misionit 135 vjeçar për përhapjen e katolicizmit në Himarë.**

Pas etikimit të Catalanos si arberesh, (Prof Matteo Mandala na thotë se është me origjinë spanjolle), harrohet se ai ishte një misionar fetar për të ndërtuar midis himariotëve urën për në fenë katolike dhe në mënyrë apriori i mvishet manteli i pionerit të shqiptarisë dhe të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Faktet historike janë shumë kokëfortë për të kundërtën. Pas kryengritjes së dështuar të Dhionisios Filosofos me 1611 në Epir, u intensifikua myslimanizimi i dhunshëm e popullsisë së krishterë. Në këtë situatë nga Himara e lidhjeve të kahershme me Venedikun u shpëstuan kërkesat drejtuara Papës për ndihmë ushtarake. Shpresa e himarioteve për ndihmë ushtarake, bashkë me krizën që përjetonte kisha ortodokse, u përdorën nga Vatikani, nëpërmjet Propagandës Fide, si mundësi për të ngritur në Himarë sistemin e misionarëve të katolicizimit të rajonit. Si bazë egzistonte letra e famshme e himariotëve e 1581, sipas të cilës, ata, në këmbim të ndihmës ushtarake pranorin njohjen e autoritetit të Papës dhe besimin e tij. (Një vit më vonë Papa iu përgjigj me ironi të shënjtë. “Ne do t’ju kujtojmë në lutjet tona”).

Ndihmë ushtarake nuk arriti kurrë në Himarë. Misionët fetare vazhduan deri me 1763. I pari misionar, me 1628-1643, ishte qiprioti Neofitos Rodhinos, i cili kishte braktisur ë braktisi fenë ortodokse. Atij i takon merita e hapjes së shkollave fetare në Vuno, Himarë dhe Nivicë.

Periudha e pranisë së tij në Himarë përcakton dhe fazën e parë të Misioni mbi njëshëkullor i Propagandës Fide në Himarë. Faza e dytë shkon deri me 1693 dhe e treta deri në fundin e misionit, me 1763. Përcaktimi i fazave lidhet më shumë me përbërjen e misionarëve. Kështu edhe misionarët e fazes së dytë vazhdojnë të jenë me prejardhje greko-ortodokse.

Nilo Catalano, me prejardhjen spanjolle shënon fillimin e fazës së tretë, që do të pasohet nga Filoteo Zaosi, Bazilio Matranga, Xhuzepe Skivo dhe Ioani Strati (1733) nga Dhërmiu. Kontributi i secilit misionar në favor të katolicizmit nuk kishte me pak vlera se ai i Catalanos. Ndryshimi i vetëm është se ai u varos në Dhërmi.

**Abuzimi i radhës është ai në lidhje me kontributin “kombëtar fetar shqiptar” të Catalanos dhe të misionarëve të tjerë paraardhës dhe pasardhës të tij.** Ne radhë të parë në atë periudhë asnjë mision fetar nuk kishte lidhje me kombin dhe kombësinë. Kështu që misionarët katolikë, ose bazilianë në Himarë, aq më tepër ata, i

shërbënin me besnikëri misionit për të cilin kishin ardhur, që ishte përhapja e fesë së tyre. Edhe hapja e shkollave i shërbënin këtij qëllimi.

Historia dhe prof. Matteo Mandala na thonë se këta misionarë ishin Bazilian. Nathalie Clayer na njofton se në fillim të shekullit të XVIII, egzistonte urdhëri monastik grek, i bazilianëve të cilët arritën të kishin edhe seminarët e tyre “të destinuar për formimin e klerit të ritit grek, që dhanë po ashtu ndihmesën e tyre për formimin e një elite laike greko-shqiptare” Kjo do të thotë se nga pikëpamja hierarkike ky komunitet njezh autoritetin e Papës, ndërsa në funksionin praktik fetar, aplikonin ritin bizantin në gjuhën greke, i cili zbatohet ende midis arberëshëve të Italisë. Për këtë u quajtën Unitarë-bazilianë. Nathalie Clayer na thotë për këtë se “riti greko-bizantin kishte qenë një element qëndror që karakterizonte italo-shqiptarët dhe, në veçanti, institucionet e tyre specifike (kishat, kolegjet, seminarët) cilësoheshin zakonisht si greco-albanese ose dei Greci (“e grekëve”).

Realiteti ortodoks i Himarës dhe qëllimi i përhapjes së katolicizmit nëpërmjet Unias e bënte më të domosdoshëm, ruajtjen e ritit bizantin, pra atij grek. Kjo do të thotë se edhe shkollat e hapura këtu ishin të karakterit fetar dhe i shërbënin këtij qëllimi edukimit në gjuhën e fesë. Skenaristët e këtushëm dhe të tanishëm, përpiqen me disa “ndoshta”, për fjalor të shqipës, dorëshkrime të humbura etj ta identifikojnë Catalanon me kombëtaristin shqiptar me të hërshëm edhe në lëmin e kishës

Por i këto pretendime i rrezojnë pa mëshirë peshkopët arbereshë që vizituan Tiranën në prillin e 2014. Ata deklaruan zyrtarisht se KOASH, “për ne arbëreshët me ritin bizantin në Itali ish dhe qendron si një pikë rrëferimi i përditshëm. Ne nuk kemi asnjë interes material ose territorial dhe fetar këtu në Shqipëri, ku Kishta Orthodhokse e bën shumë mirë e me nderë e shëjtërimin e popullit. ...”

Raportët historike dhe aktuale greko-arbereshe- në sferën fetare e laike - dhe fetare midis arberesheve dhe KOASH-it e bën të pavlerë demonizimin e faktorit grek në debat. Fatkeqësisht e riaktivizuan rishtazi skemën e njohur të antihelenizmit për të forcuar shqiptarizmin, deklaratat e OMONIAS dhe PBDNJ-së. Këto subjekte politike, për rritjen e kredibilitetit të tyre, arritën, që nëpërmjet disa qarqeve të caktuara greke me interesa në minoritetin etnik grek në Shqipëri, të futin në hullinë e tyre Ministrinë e Jashtme Greke. Ky ishte një As në duart e skenaristeve për “moralizimin” e Catalanos, jo aq në favor të idesë për të krijuar pjedastele për simbole fiktive të një krenarie virtuale kombëtare. Por edhe për ta shkëputur Propagandën e re Fide nga kuadri strikt fetar, drejt një horizonti “laik” me perspektivë të qartë politike dhe gjeopolitike.

### **Për skenarin ka kohë që punohet**

Nga ana tjetër skenari nuk është i momentit. At Foti Fico nga Bregdeti, mbrenda mekateve të tij kishte tërhequr vemendjen Kryepeshkopit Anastas për tolërimet që ishte detyruar të bënte ndaj strukturave katolike, protestande, ungjillore e të tjerë në territorin e Mitropolisë së Gjirokastrës. Fshati i Shen Ilisë përballë Butrintit me banorë katolikë e myslimanë nga Veriu i vendit (nga ku më pare ishte rrezuar me dhunë një kryq ortodoks), u ngrit nga këto strukturat katolike fil pas ngjarjeve të 1997 dhepërbën ndoshta treguesin e parë praktikë i realitetit të pritshëm.

Nuk duhet harruar se censusi i 2011 i nxorri katolikët gati sa dyfish të ortodokseve dhe strukturat ortodokse e kaluan thuaj në heshtje këtë abuzim historik.

Pak para vizitës së Papës së në Shqipëri, shtator 2014, nga “analistë” politikë shumë afër grupit të skenarit të tanishëm pati botime dhe analiza në medja ku ortodoksia shqiptare identifikohet me strukturat ortodokse të shekullit XIV-XV që bënë aleanca me otomanët për të përballuar katolikët. Protokollin e vizitës së Papës kishte parashikuar kreun e ortodoksëve shqiptarë të rreshtuar midis krerëve myslimanë që rrinin vazhdimisht përballë grupit katolik. Një skemë e tillë çuditi dhe vet Papën, i cili tha se “ç’është ky rreshtim sikur jemi në ndeshje!”

Vet apostrofat e Papës për “shqiponjën që duhet t’i kthehet folesë” u interpretua gjithashtu si nxitje për të përqafuar besimin katolik, atë që po bën vet kryeministri apo figura të tjera laike shqiptare.

Nga Dr. Panajot Barka

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2015/09/02/paralele-nga-proselitizimi-katolik-tek-prishja-e-shen-thanasit-ortodoks/>

<http://time.ikub.al/Lajme/97b9d2d8f9/.aspx>

<http://fax.al/read/news/1119959/10167493/paralele-nga-proselitizimi-katolik-tek-prishja-e-shen-thanasit-ortodoks>

**Paralele: Nga proselitizimi katolik, tek prishja e shen Thanasit ortodoks.**

02.09.2015

Ngjarjet në terren dhe të dhënat e debatit rreth kishës ortodokse të Shen Thanasit në Dhërmi çojnë në kongluzionin se përbëjnë një paralele me kahje të kundërt me ngjarjet e shekujve të largët, 16-18. E para kishte karakter të dukshëm fetar dhe synonte proselitizimin katolik të elementit ortodoks. E dyta përdor argumentin nacional për të fshehur atë fetar katólik. Të dyja vendosin përballë ortodoksinë. Në këtë kendveshtrim, Dhërmiu nuk është thjesht vendi ku një memorial pa krena po përdoret si enë komunikuese midis paraleleve, por një segment gjeopolitik që po krijon pllaka sizmike.

### **Paralelja e historike.**

Aftësia për t'u paraprirë ngjarjeve historike në shekuj, këshilloi ortodoksët e Epirit të shek 17të që, për t'i shpëtuar presionit myslimanizues otoman, të linin pas konfliktin ekstrem fetar me kishën katolike të vulosur me rrenien e Konstandinopojës me 1204 nga Kryqezata IV latine dhe të kërkonin në mënyrë të perseritur ndihmë ushtarake nga kisha katolike dhe fuqitë perendimore katolike të kohës. Madje e pranoin ndihmën për liri me koncesionin e rendë të ndërrimit të fesë. Por Papatë dhe diplomacia e këtyre shteteve, treguan se, në kushtet që nuk rrezikoheshin më nga invazioni osman, u lëvendiste ruajtja e statuskuos në Epir. Çlirimi i tij nga osmanët i siguronte ortodoksisë fuqi politike në një zonë gjeopolitike.

Pak më vonë, kur u rriten së tepërmi masat represive myslimanizuese në Epir, Vatikanë gjykoi se kjo situatë, bashkë me shpresën epirotase për ndihmë ushtarake, mund të shfrytëzohej për proselitizimin katolik të ortodokseve përgjatë bregdetit të Epirit nga Himara në Pargë. (Pas 135 vjetesh përpjekjesh në Himarë nuk kishte asnjë katolik.)

Pra, aksioni katolik në Epir, nuk qe bashkëpunues me epirotasit, por synonte asimilimin e ortodoksisë. Në këtë kuptim, ortodoksia në Epir mbëti për shumë kohë midis dy kundërshtarëve të fuqishëm, - Peradnorisë Otomane dhe Vatikanit. Mbijetesa ortodokse u arrit me sakrificatë të mëdha.

Proselitizimi i synuar nga Vatikanë në Epir (Himarë –Pargë) ishte katolik (në gjuhë latine) dhe jo unit apo bazilian. Për arsye të kuptueshme Vatikanë përdori në këto misione renegatë ortodoksë, shumica grekë të konvertuar në katolikë. Mobilizonte edhe misionarë bazilianë, dmth unitë. Në listën e gjatë të misionarëve Fide, arberëshët përbënin një pakicë. Riti fetar i këtyre të fundit ishte ai ortodoks (lindor-grek). Ky realitet i heq bazën pretendimit të sotëm për kontribut identitar etnik shqiptar të misionarëve katolikë e unitë, qofshin arberesh. Aq më shumë kur në atë kohë nocioni “etnik” nuk egzistonte

### **Paralelja e sotme dhe antiortodoksizmi**

Sot konflikti për kishën ortodokse të Shën Thanasit në Dhërmi përbën aktin e dukshëm të paralelës së dytë edhe pse në largësi kohore. Ai nuk i korrespondon klimës së mirëkuptimit që shpallin në publik Vatikanë dhe Konstandinopoja. (Kryepeshkopi Anastas është pjesë e negociatave)



Kjo do të thotë se, pa përjashtuar ndonjë koncesion jashtë parimeve fetare, përplasja e Dhërmiut ka për autorë struktura shtetërore të mirëkuptuara nga komunitetet fetare. (Në gjithë këtë zallamahi, nuk ka një njoftim me kongluzione shteruese midis qeverisë dhe kreut të KOASH-it në lidhje me këtë çështje).

Në aspektin krahasues, në paralelen e sotme kemi zëvendësimin e strukturave shtetërore të Vatikanit, (Propaganda Fide) me struktura jo fortë të përcaktuara të shtetit shqiptar. Këto struktura, duke mobilizuar edhe shtresa intelektuale, kërkojnë të promovojnë katolicizmin si identitet perendimor shqiptar.

(Pak vite më parë u përvijua e njëjta tablo me Nënë Terezën. Statujat e saj pushtuan aerodromë, sheshe, spitale, shkolla. U konsiderua pasaporta shqiptare për në perendim. Por reagime të segmeneteve të caktuara fetare shqiptare detyruan zbehjen e misionit të ri dhenë Nënë Terezës pa dijeninë e saj. E njëjta gjë dhe nga të njëjta segmente ndodhi edhe me monumentin e Skëndërbeut. Ky është një tregues se ortodoksia nuk ka aleatë të brendshëm për ruajtjen e integritetit të vet)

Pra, në këtë nismë kemi shtetin që jo vetëm përvalon strukturat fetare por është edhe i njëanshëm, pasi cenon njërën palë-ortodoksinë. Për t'ja arritur kësaj, bashkë me përhapjen e fesë "identitare", (në censusin e 2011 katolikët u shpallen gati sa dyfishi i ortodokseve, rezultat i paparë në historinë e shteti shqiptar), kërkohet edhe siguri i një tradite historike. Kësaj tradite të munguar mundohen t'i sigurojnë të drejtën e qytetarisë, duke trajtuar proselitizimin e atëhershëm katolik të ortodoksëve si rezervatin e vlerave kombëtare shqiptare, si dhe duke anashkaluar sakrificat historike kundërshtuese të fesë ortodokse për të ruajtur identitetin e vet fetar. Priviligji apriori që gëzon në mentalitetin nacionalist shqiptar çdo kontribut perendimor, qoftë edhe si mit, shërbën si mjet për të fshehur pikësynimin për rudhjen e ortodoksisë dhe marginalizimin e saj. Për këtë vjen në ndihmë identifikimi i armës mbrojtëse të ortodokseve në këtë betejë, - ekuminizmi helen si mbartje kulturore nga Greqia e lashtë në fenë e krishterë lindore, "me thikat pas shpine ndaj shqiptarësisë".

Në këtë kuptim nuk tentohet vetëm që, ortodokset shqiptarë të privohen nga e drejta bazale e besimit të tyre, por të privohen edhe nga kontributi i jashtëzakonshëm në favor të ideologjisë kombëtare shqiptare, (përpunuar kryesisht nga ortodoksët epirotas) dhe nga fakti se dijet dhe kultura e tyre mëkembën shtetin shqiptar. Ortodokset paguajnë kështu haraçin për promovimin "e vlerave kombëtare" të cilat u dedikohen misionarëve katolikë të Propagantës Fide, përmes mitizimit fals.

Në këtë përplasje, KOASH, vjen pas një fushate denigruese të udhëhequr nga një grup intelektualësh myslimanë dhe ateistë. Vjen kur ajo po humbet njërin pas tjetrit monumentet e trashëgimisë së vet, të cilët përbëjnë dhe fondin e fundit aktiv të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar. Në kushtet e rudhjes së skajshme demografike. Në kushtet kur asaj i imponohet me dhunë verbale izolimi nga aleatë të saj të të njëjtit besim. Vjen kur presioni në emër të nacionalizmit shqiptar, i identifikuar si antihelenizëm, ka prodhuar një autocensurë të fortë të ortodokset.

Këto zhvillim në thelb përbëjnë rrezik të shumëfishtë. Shkelen parimet e laicitetit të shtetit. Shteti bëhet palë me një besim kundër një tjetri. Nga garantues i ekulibrave ndërfaqetare, kthehet në prishës të tyre. Imponon heshtjen dhe fiton përkrahjen publike duke e vendosur këtë komunitet në raporte faji nacional me terrësinë e vendit duke shkaktuar njëkohësisht probleme ndëretnike. Për këtë, jo më kot për këtë u zgjodh Dhërmiu dhe Himara.

#### **Aksioni përmban veprime që tejkallon paralelën e proselitizimit katolik**

Në Dhërmi, objekti i kultit ortodoks u shkatërua në emër të vlerave "kombëtare" shqiptare të ofruara nga misionet katolike. Po në emër të tyre Shën Thanasi ortodoks do të spostohet nga vendi i tij i shënjtë shekullor për t'ja lenë vendin Shën Thanasit

katolik me pronar shtetin. (Misionarët e Papës nuk guxuan të mohojnë e aq më shumë të shkatërrojnë objektet e kultit ortodoks. Përkundrazi.) Në retorikën zyrtare të Tiranës thuhet hapur se ky veprim synon respektimin e historisë së përbashkët (katoliko-shqiptare), duke përjashtuar traditën ortodokse. Objektiviteti historik kërkon ringritjen e kishës ortodokse të Shen Thanasit në vendin e vet të shënjtë dhe bashkë me të edhe të memorialit të Nilo Catalanos, nëse vlerësohet se e meriton, ashtu si ndodhi për mbi 300 vjet. Thuhet madje që Shen Thanasi ortodoks vazhdon të jetë monument kulture dhe në bazë të ligjit në fuqi për trashëgiminë kulturore, “Lejohet ndërtimi ... duke respektuar kategorinë dhe llojin e monumentit të dëmtuar” Perse pra shteti përgatitet për të shkelur ligjin e vet dhe në vend të kishës ortodokse monument kulture të kategorisë së parë, do të ndërtojë një “memorial kulturor-fetar kombëtar” ?!

Artan Shkreli interpreton se si monument kulture kisha e Shen Thanasit nuk u shpall për vlerat e saj historike, “por nga prania e atyshme e varrit të një prej figurave me emblematike të shkrimit e mësimi shqip në Himarë e gjetkë.” Por harron se Catalano, “arbërësh” për Shkrelin jetoi atje disa muaj, pra në pamundësi kohore absolute për të kryer atë vëllim pune që i dedikohet. Se shkollat i gjeti të hapura nga misionarë katolikë me origjinë greke, por të cilësuar katolike (jo greke) dhe është i vetmi që vdiq në Dhërmi dhe pranoi të varrosej në një kishë ortodokse. Nuk përjashtohet që ai të ketë shfaqur interes për traditat dhe gjuhën e folur në atë zonë, por kursesi nuk mund të klasifikohet si “gur i çmuar i një historie të mrekullueshme”

Nga ana tjetër për të bërë skondo vlerave të kishës ortodokse, Shkreli thotë se ajo është ndërtuar pas pushtimit otoman. Në ligjerimin e tij ai përdor thjesht termin “kishë”, pa e përcaktuar si kishë ortodokse. Ndërkohë studjuesit, të cilëve Shkreli u referohet kanë deklaruar publikisht se kisha është ortodokse. Njëkohësisht, vet ai na thotë se ikonostasi i kishës është prej guri që na çon tek arkitektura fetare ortodokse e shekullit VI. Si ortodokse kisha jetoi edhe pas tërheqjes së eshtrave të Catalanos nga italianët me 1940, dhe deri me 1972.

**Cilët janë misionarët e paralelës së re.** Janë ata që vectorientohen, ose mobilozohen nga politika për t’i dhenë një pamje shkencore mitit që duhet gatuar. Përsa i përket seriozitetit dhe egzigjencës nuk mund të krahasohen me misionarët e vjetër katolikë. I karakterizon abuzimi. P.sh teksta afrohet data e kongresit shkencor në Vlorë, misionarët e rinj nuk e kanë zgjidhur akoma problemin e origjinës së Nilo Catalanos, të personazhit kryesor në misionin e ri katolik.

Shtrembërojnë qëllimin e misionit të Propagandës Fide në Himarë. Nga mision proselitizues katolik, e paraqesin në mision shpëtimtar kristian me vlera kombëtare dhe nga mision katolik të mirëfilltë si bazilianë apo unit. Kjo u duhet për ta përdorur në vijim si argument për të thenë se “Misionarët arbërëshë ....Ishin të parët që vendosën urat e bashkimit ndërshqiptar përmbi Adriatik dhe veprimtarë të denjë për një kishë kombëtare .... Ata u bënë protagonistë të ideologjisë shqiptare...”

Në një asnjë citim nga dokumentet arkivore që u dedikohen misionarëve të katolicizmit, nuk përdoret fjala "shqip", si "shkolla shqipe", "gjuha shqipe" etj. Mbiemri “shqip/e” u prapangjitet emrave “shokllë” , "gjuhë" nga misionarët e sotëm. Termi "shqip" në atë kohë nuk kishte fituar të drejtën e qytetarisë. Sipas Çabej emri i ri "shqiptar", filoi të përdorej nga mesi i shekullit XVIII duke bashkëjetuar me emri arbër, ose alban.

Një tjetër misionar i ri nuk nguron të fabrikojë tezën që i duhet politikës,-praninë e spikatur të katolicizmit si pjesë e realitetit “ndërkulturor, e ndërftar” të Himarës, për të shpallur solemnisht pretendimin se “kisha e Shën Thanasit në Dhërmi është objektivistisht sot një monument kulture për arbereshet dhe shqiptarët”. Ndërsa ky misionar i ri pretendon këtë rol, institucioni përgjegjës për kësi deklaratash, peshkopët

arbereshë të ritit bizantin deklarojnë “Ne nuk kemi asnjë interes material ose territorial dhe fetar këtu në Shqipëri, ku Kishta Orthodhokse e bën shumë mirë e me nderë e shëjtërimit e popullit. ...”

Për t’i dhënë qëndrueshmeri këtij miti, mitbërësit e rinj nuk harrojnë të promovojnë antihelenizmin e tyre në të gjitha format dhe nivelet. **FUND.**

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2015/09/22/mesazhet-e-pjekurise-greke/>

### **Mesazhet e pjekurise greke**

22.09.2015

Zgjedhjet e së dielës në Greqi konfirmuan vendosmerinë e popullit grek për të hapur një faqe të re politike në vendin e tij. Ky mesazh artikullohet nëpërmjet një tufë risish të tjera shumë të rendësishme që u përvijuan në harkun kohor të nëntë muajve të fundit në Greqi. Brenda kësaj periudhe populli grek rikonformoi vendosmerinë e rrugës së tij Evropiane. Ridimensionoi vullnetin e tij për të lenë pas realitetin politik 40 vjeçar të abuzimit shtetëror, të shtetit klientelist, të sistemit korruptiv, të evazionit fiskal, të shndërrimit të përfaqësuesve politikë të tij në mekanizma të interesave të oligarqisë finaciare Evropiane e botërore. Në këtë sens zgjedhjet në Greqi përbëjnë një mesazh të përditshëm për ndryshimin të raportit të forcave politike në Evropën e Bashkuar. Njëkohësisht rikonfirmuan se pavarësisht krizës së rendë ekonomiko-sociale, demokracia në vend është e konsoliduar dhe bëri hapa të reja përpara.

Ky realitet e shndërroi Greqinë në qëndër të vemendjes të zhvillimeve politike paqësore në botë. E vërteton këtë edhe fakti që liderët e vendeve më në zë të botës dhe organizmave kryesore Evropiane e përshendeten këtë proces në Greqi dhe shprehen gadishmerinë e tyre për të mbështetur qeverinë e re të saj.

Për konfigurimin e kësaj tabloje Greqisë i është dashur të kalojë një 9 muaj ballafaqimesh historike duke gjetur si mjet efikas procesin demokratik të zgjedhjeve.

Në janar fitorja e “konfederatës” së majtë provokoi reagime të brendshme dhe të jashtme për shndërrimin e kësaj fitoreje në një parantezë që do të vërtetonte se pushteti politik për të majtën ishte mollë e ndaluar. Përpjekjet për eliminimin e kësaj force politike të majtë u shoqëruan me një periudhë të vështirë negociatash të Greqisë me BE-në për të arritur një marrëveshje për një paketë të re ndihmash. Ishte një përplasje që zgjati plot 6 muaj, në të cilën Greqia pranonte sfidën e rrënimit ekonomik, për t’i thenë Evropës së masat shtrenguese në kurriz kryesisht të shtresave të gjera, nuk përbënin zgjidhje për të dalë nga kriza. Dhe në këtë këmbëngulje greke nuk është se evidentohet kundërvenia e BE-së me parimet bazale të saj që janë barazia dhe solidariteti, porse vazhdimi i kësaj rruge mund të çonte në shpërbërjen e vet unionit të Evros dhe të vet BE-së. Në këtë kontekst, Greqia pranoi rolin e Ifigjenisë për t’i treguar Evropës se nuk i duhet një Trojë e re, (me kuptimin se lufta e Trojës shënon edhe luftën e parë të njohur botërore).

Referendumi i 5 korrikut u shndërrua në një instrument politik përmes së cilit populli grek konfirmonte në mënyrë plebishitare rrugën e tij evropiane, dhe njëkohësisht, kërkesën për një paketë ndihmash sa më humane. Ky moment solli samitin e nivelit të lartë të BE-së të 12 Korrikur. Ai tanimë përbën vlerë historike, jo për kohëzgjatjen e tij maratonë prej 17 orësh dhe dramacitetin e negociatave, porse në përfundim të tij, Evropa pa e kuptuar u gdhi me një fytyrë tjetër, që evidentonte hapur kërkesën për ndryshim dhe rikuperim të kursit të vet.

Në zgjedhjet e 20 shtatorit pjekuria politike dhe demokratike e popullit grek ishte mëse domëthenëse.

Me votën e tij populli grek la jashtë parlamentit 43 deputet që përkrahin kursin e Greqisë jashtë Evro-s dhe rikthimin tek monedha kombëtare. Tregoi se përkrahu përshtatjen fleksible të Aleks Ciprës me realitetin Evropian dhe përpjekjen e tij për ta përshtatur këtë realitet interesva të popullit të vet.

Duke i dhenë mundësi SYRIZES të krijojë qeveri, u transmetoi forcave politike të opozitës mesazhin e përgjegjësive 40-vjeçare ndaj fateve të Greqisë dhe të rolit të dyshimtë të tyre përgjatë negociatave të qeverisë me BE. Populli me votën e tij e

interpretoi kërkesën e forcave politike përfaqësuese të së shkuarës politike, për pjesëmarrje në një qeveri me bazë të gjerë, si mundësi për të fshehur mekatët e së shkuarës që futën Greqinë në kolaps. U thanë atyre se faktori nuk mund të bëhet njëkohësisht dhe shpetimtar i kësaj situatë.

Pjekuria politike e popullit grek lidhet edhe me faktin se vlerësoi tek qeveria e SYRIZES, qëndrimin dinjitoz, transparencën publike dhe nëvojën e mbështetjes popullore në vendimarrjen e saj dhe, pavarësisht përkeqësimit ekonomik e social, i dha SYRIZES një mundësi të dytë për bërë realitet deklaratimet programore që pajtohen plotësisht me interesat dhe aspiratat popullore.

Këto mesazhe të votës së popullit grek qeveria e Ciprës duhet t'i kthejë që tani në realitet. Përveç kapërcimit të situatës së rëndë ekonomike, ai duhet të kthejë në realitet luftën ndaj sistemit të kalbur politik të së shkuarës, korrupsionit, evazionit fiskal, krimin shtetëror. Një mision shumë i vështirë kur dihet pesha dhe konsolidimi i tij i gjatë në kohë dhe me shtrirje të gjerë në shoqëri dhe strukturat shtetërore. Aq me keq kur në shumë nivele të aspektit ekonomik e politik ky sistem është lidhur me faktorë të fuqishëm të jashtëm, madje edhe brenda BE-së.

Qeveria e Ciprës duhet të ndërmarrë reforma shtetkonsoliduese, ndërkohë që klientelizmi partiak dhe burokracia e pafund përbëjnë një gurë më të rëndë se ai i Sifizit.

Qeveria duhet të arrijë objektivat e marrëveshjes së re me BE, por edhe duhet t'i përmiresojë kushtet e saj në favor të popullit. Duhet gjithashtu të tregojë se është në gjendje të implementojë me rentabilitet resurset që krijon paketa e re e ndihmës pa lejuar që ato të kthehen në pre të korrupsionit dhe të grabitjes të kravatëmbajtësve shtetërorë.

Pikërisht këtu qëndron dilema. Midis vullnetit të shprehur popullor dhe misionit të qeverisë Cipra do të krijohet një aleancë organike apo do të formohet një vijë e re demarkacioni!?

Por zgjedhjet në Greqi duhet parë edhe nga këndvështrimi krahasues dhe mesazhsjellës në realitetin shqiptar. Besoj se duhet të na shqetesojë pozitivisht se në Greqi zhvillohen tre palë zgjedhje në disa muaj. Nuk ndodh as incidenti më i vogël, (askujt nuk i shkon mendja për manipulim, blerje apo vjedhje votash), rezultati del në orën e parë pas mbylljes së kutive, pranohet nga të gjitha palët dhe humbësit urrojnë fituesin. Brenda disa orëve formohet qeveria dhe fillohet nga puna.

Mesazhi tjetër ka të bëjë me ndërgjegjen politike të votuesve. Në Greqi janë ata që shmangin votën klienteliste dhe vendosin të përkrahin atë forcë politike që i garanton më mirë të ardhmën. Pra, votojnë pozitivisht, për më të mirën, pa u detyruar të zgjedhin të keqën më të vogël.

Po ashtu, kjo ndërgjegje politike lidhet më së shumti me angazhimin maksimalist të intelektualëve me fatet politike të vendit. Dhe ky konstatim nuk lidhet thjesht me faktin se qeveria e Ciprës në shumicën e vet përbëhet nga profesorë universiteti dhe akademikë, por me faktin se janë intelektualët ata që gjenerojnë orientimin politik të votuesve.

Ka një moment më të rëndësishëm që duhet vlerësuar në Shqipëri, sidomos nga shoqëria civile sado e pazhvilluar qoftë ajo. Fenomenet 40-vjeçare që e çuan Greqinë në këtë pikë të vështirë, po përsëriten me një shpejtesi maramendëse në Shqipëri dhe ato duhen frenuar dhe eliminuar. Por fakti se në Shqipëri, synohet për një demonizim antishqiptar të Greqisë, tregon se dikush është i interesuar të mbaj fshehur realitetin shqiptar që ushqen një perspektivë të zymtë, por edhe nacionalizëm.

Rëndësia e mesazheve zgjedhore greke për Shqipërinë nuk kanë të bëjnë aq me diferencën demokratike midis dy vendeve, se sa me marrëdhëniet e shumëfishta diakronike e të së tashmës midis dy vendeve. Për gazetën TEMA, 22/09/2015

**Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2016/01/31/arrestimi-i-spiro-kseres-drejtësia-e-munguar-dhe-perkatesia-etnike-e-tij/>

## **Arrestimi i Spiro Kserës, drejtësia e munguar dhe përkatesia etnike e tij**

31 01. 2016

Posted on 31 Janar, 2016 [16:49](#) by [TemA Online](#) in [Aktualitet](#), [Blogu TemA](#) with [25 Comments](#)

Pardje u arrestua Spiro Kserën, me shtetësi shqiptare e greke dhe kombësi greke, ish deputet i PD-së dhe ish ministër i qeverisë së fundit të kryeministrit Sali Berisha. Sot gjykata e Tiranës pranoi kërkesën e prokurorisë dhe vendosi masën e sigurisë arrest me burg.

Po, është e vërtetë se arrestimi i Kserës bëri shumë bujë dhe është mëse e logjikshme. Pas 23 vjetesh, kur u arrestua Fatos Nano, (pa zenë në gojë ish Byroistët), është zyrtari i dytë i lartë i nomenklaturës shtetërore që përfundon në pranga. Në pamje të parë ky akt duket se i shërbën maksimalisht kauzës së deklaruar të luftës kundër korrupsionit shtetëror. Mesazhet që vijnë nga përvoja e deritanishme flet se kauza synohet të ushqehet me koka turku dhe me hallka që nuk janë pjesë të sistemit të vërtetë kupolar, (pra, të ushqehet me hallka që nuk mund të prodhojnë efekte domino, apo fondanë) por tagente të këtij sistemi dhe që nuk mund të prodhojnë rezistencë për shkak edhe të origjinës së tij. Dy momente që rrjedhin nga procesi i vendimarrjes së gjykatës për masën e sigurisë, – ajo që për më shumë se një vit hetimesh Ksera nuk u thirr nga prokuroria asnjëherë për t’u pyetur dhe fakti se ai i kishte të gjitha mundësitë të largohej jashtë shtetit si shumë shtetarë të tjerë, por e arrestuan jashtë shtepisë dhe i sapo kthyer nga Greqia, krijuan handikapun edhe në aspektin procedural të procesit të sapo nisur gjyqësor.

Në lidhje me këtë konstatim të fundit u vërtetua edhe një herë se fati i të qenit minoritar grek dhe në pozita të larta shtetërore është me një risk të lartë se paguan për të tjerët dhe për atë që je, më shumë se për atë që bën. Në historinë e vet, duke filluar nga qeveritë e Zogut, sidomos përgjatë diktaturës komuniste, por edhe në atë post komuniste, minoriteti grek ka provuar me dhjetra raste ku shërbimi i ofruar në strukturat shtetërore përbente një risk flijimi në shërbim të sundimit politik. Në vëmendje vijnë Lefter Tallio, Manol Konomi, Mihal Jorgji, Miltiadh Papa e të tjerë emra të kalibrit të lartë nga minoriteti etnik grek. Kuptohet që nga pikëpamja e kalibrit, nuk mund të krahasohet Spiro Ksera, ta zemë me Manol Konomin, por funksionët e njejta, deputet e ministër, i barazojnë ata në aspektin historik. Edhe shkaku i denimit i diferencon. Diktatori Hoxha e rasi në burg për 20 vjet Manol Konomin se ai, si ministër i drejtësisë shqiptare, nuk pranoi politizimin e saj. Spiro Ksera akuzohet për korrupsion nga një drejtësi për të cilën të gjitha palët kërkojnë të dekriminalizohet dhe të pastrohet nga korrupsioni.

Nuk dua kursesi të bëhem mbrojtës i fajit të Kserës nëse ai egziston. Por nga ana tjetër, të gjithë e kuptojnë se, edhe nëse akuza është e vërtetë, tenderi apo tenderat që përbëjnë objekt akuze ndaj tij u zhvillua(n) me shkelje të ligjit me urdhër të tjetërkujt dhe për llogari të fushatës elektorale të PD-së. Në këtë kendvështrim Ksera është viktimë dhe fajtor moral, por me përgjegjesi penale. Pra të kthehet në kokë turku, ku PD-ja mund të ofrojë edhe sininë. Reagimi i PD-së vërteton analizën e mësipërme. Asnjë mbrojtje politike institucionale për Kserën nga partia e tij edhe pse ai u arrestua si person politik. Dhe këtu nuk shtrohet çështja e shfajësimit nga ana e PD-së, se në kushtet kur nga faktorët ndërkombëtarë kërkohet dënimi i funksionarëve të lartë të korruptuar, PD-ja

nuk mund të kompromentojë vetën me mbrojtjen e Kserës. (Në fakt PD-ja nëpërmjet deklaratës së vet e pranoi fajin e tij dhe kërkoi hetim dhe gjykim të drejtë ?!! Dhe e kërkon këtë nga një drejtësi që e akuzon për padrejtësi ose drejtësi të paguar. E gjithë kjo duket si një formulë kompromisi që denimi i Kserës të shërbëjë si një mundësi që të mos preken përgjegjesit kryesorë të sistemit të korrupsionit shtetëror. Qëndrimi ndryshe, ose në linjën e vet, i mbajtur nga ish kryeministri Sali Berisha nuk ndryshon asgjë në arsyetimin për një konsensus me hapje te gjerë në mbrojtje të sistemit )

Eshte fare e lehtë të kuptohet kjo, pasi dihet, se korrupsioni dhe vjedhja shtërore, si në të shkuarën dhe në të tashmën është galopan. Në këtë sens, shifrat e artikuluara në ngarkim të Kserës janë qesharake para atyre të zyrtarëve të tjerë të lartë. Është gjithashtu e ditur se padi dhe akuza në organe shtetërore të drejtësisë, apo edhe në medja janë bërë për shumë syresh... por ftohtësinë e byzilikëve të policisë e të drejtësisë po i provon i pari, minoritari grek Spiro Ksera. Mjafonte vetem kjo, që edhe nëse është e vërtetë akuza për Kserën, apo e vërtetë se do të ketë dhe arrestime të tjera funksionarësh të lartë, ky proces të mos fillohej me Kseren.

Pikërisht këto fakte bashkë me përvojën e hidhur të afërme dhe të largët të drejtësisë politike neutralizon lergjitimitetin e ashpërsisë së kësaj drejtësie ndaj Kserës. Aq me i rendë do të jetë imazhi për drejtësinë nëse në të ardhmen nuk do ketë arrëtime të tjera zyrtarësh të lartë me korrupsion shumë më drastik e të shumëfishtë. (!) Atëherë çeshtja Ksera do të përbëjë një rast selektiviteti që do të përcjellë shumë mesazhe negative dhe që do të provokonte situata të tjera).

Ky kongluzion nuk mbështetet vetëm te përvoja e deri tanishme, por edhe te detaji i ditës së premtë të zgjedhur nga prokuroria për zbatimin e urdhër arëstit të ish ministrit. Në rastin e Kserës zgjedhja e së premtës nuk shkon paralelisht me rastet e tjera, që pushimet e fund javës që pasojnë të premtën të shfrytëzohen për të mënjeluar reagimet e ndryshme. Ksera duhet ta ketë kuptuar tanimë se beteja me drejtësinë do të jetë personale. ("Gabimi" i tij qendron tek fakti se e dinte padinë e dyfishtë ndaj tij shumë kohë para vendimit të arëstit dhe as u arratis dhe as u përpoq të blinte pushimin e çeshtjës penale.) Mos prononcimi i Dulës ishte një ogur i keq për të. Dulja është kryetar i partisës së të drejtave të njeriut në Shqipëri, është deputet dhe me origjinë të përbashkët nga një fshat ngjitur me Kserën. (Kush njeh pak nga historia e minoritetit një qëndrim i tillë të kujton rastet kur diktatori komunist përdorte minoriatrët për të eliminuar kundërshtarët e tij minoritarë grekë. Mosprononcimi i Dulës e ngarkon me një rol të tillë. Por që e ndërmer për arsye banale e personale dhe aspak parimore)

Në një pikë të fundit, duket se është menduar se edhe vet minoriteti do të tregohet intiferent ndaj këtij akti, (prania e shtuar e policisë gjatë arëstit tregoi të kundërtën), se minoriteti di të distancohet nga korrupsioni dhe nga shkelësit e ligjit, qofshin këta dhe njerez të tij. E vërteta është se përfaqësuesit politikë të minoritetit, si rasti i Dulës, kanë arsyet e tyre për të mos reaguuar. Por është e sigurt se minoriteti ndjehet sot i marginalizuar. Dhe ky marginalizim nuk është se shprehet me rritjen e aksioneve të Kserës, porse me vendosjen nga ana e minoritarëve të urave me të kaluarën diskriminuese për shkak të kombësisë.

### **Η φυλάκιση του Σπύρο Ξέρα, η απούσα δικαιοσύνη και η εθνική καταγωγή του.**

Του Παναγιώτη Μπάρκα, δημοσιεύτηκε στην εφημερίδα ΤΕΜΑ 01.02.2016

Προχθές συνελήφθη ο Σπύρος Ξέρας αλβανικής και ελληνικής υπηκοότητας και ελληνικής εθνικότητας, τέως βουλευτής του Δημοκρατικού Κόμματος και πρώην

Υπουργός στην τελευταία κυβέρνηση του Σαλί Μπερίσια. Σήμερα, (δλδ χθές) το πρωτοδικείο Τιράνων δέχτηκε την πρόταση της εισαγγελίας και αποφάσισε η εκδίκαση του Ξέρα να γίνει όντας εκείνος κρατούμενος στη φυλακή.

Ναι, αληθεύει, ότι η φυλάκισή του είχε έντονο απόηχο και είναι πολύ λογικό. Μετά από 23 χρόνια, όταν φυλακίστηκε ο Φάτος Νάνο, (χωρίς να αναφερθούμε στα πρώην μέλη του Πολίτ Μπυρό), είναι το δεύτερο υψηλόβαθμο κρατικό στέλεχος που καταλήγει πίσω από τα κάγκελα. Εκ' πρώτης όψεως η πράξη αυτή φαίνεται ότι εξυπηρετεί στο μέγιστο τη δηλωμένη υπόθεση για την πάταξη της κρατικής διαφθοράς. Τα μηνύματα που φέρει η μέχρι τώρα εμπειρία μνηύουν ότι επιδιώκεται ώστε η υπόθεση να τραφεί με θύματα και με κρίκους που δεν αποτελούν μέρος του πραγματικού εγκεφάλου στο σύστημα διαφθοράς, (δηλαδή, να τραφεί με κρίκους που δεν μπορούν να προκαλέσουν το φαινόμενο ντόμινο, ή έκρηξη), με φαπτόμενες με το σύστημα αυτό και που δεν μπορεί να παράγουν αντίσταση λόγω της καταγωγής. Δύο στιγμές που απορρέουν από τη διαδικασία στην απόφαση του πρωτοδικείου Τιράνων για τη φυλάκιση του Ξέρα μέχρι την εκδίκαση της υπόθεσης, - το γεγονός ότι για περισσότερο από ένα χρόνο ανακρίσεων ο Ξέρας δεν εκλήθη στην εισαγγελέα για να καταθέσει ούτε μια φορά και ότι εκείνος είχε όλες τις δυνατότητες να απομακρύνονταν εκτός χώρας για να απόφυγε τη δυσμενή αυτή θέση, όπως έχουν πράξει πολλοί άλλοι κρατικοί λειτουργοί, αλλά τον συλλάβανε έξω από το σπίτι του όταν μόλις είχε επιστρέψει από την Ελλάδα, -δημιούργησαν προηγούμενο που προδικάζει και την έκβαση της δίκης, που μόλις άρχισε.

Σε σχέση με την τελευταία διαπίστωση επιβεβαιώθηκε και μια φορά ότι το να είσαι Έλληνας μειονοτικός και σε υψηλές κρατικές θέσεις αποτελεί μεγάλο ρίσκο, διότι πληρώνεις για άλλους και για εκείνο που είσαι, περισσότερο απ' αυτό που κάνεις. Στην ιστορία του, αρχίζοντας από τις κυβερνήσεις του Ζώγκου, ιδιαίτερα κατά την κομμουνιστική περίοδο, αλλά και κατά την μεταπολίτευση, η ελληνική μειονότητα έχει δοκιμάσει σε δεκάδες περιπτώσεις, ότι οι υπηρεσίες των Ελλήνων στον κρατικό μηχανισμό αποτέλεσε ρίσκο θυσίας στην υπηρεσία της πολιτικής κυριαρχίας. Στη σκέψη έρχεται ο Λευτέρης Τάλλιος, ο Μανόλης Κονόμης, ο Μιχάλης Γιώργης, Ο Μιλτιάδης Παπάς και άλλα ονόματα υψηλού βεληνεκούς από την ελληνική μειονότητα. Εννοείται, από άποψη βεληνεκούς δεν μπορεί να συγκριθεί ο Σπύρος Ξέρας, λόγω χάρη με τον Μανόλη Κονόμη, αλλά οι ίδιες θέσεις του βουλευτή και υπουργούν τους εξισώνουν ιστορικά. Ασφαλώς, και η αιτία τιμωρίας τους διαφοροποιεί. Ο δικτάτορας Χότζα φυλάκισε 20 χρόνια τον Μανόλη Κονόμη, διότι εκείνος ως Υπουργός Δικαιοσύνης της Αλβανίας δεν παραδέχτηκε την πολιτικοποίηση της δικαιοσύνης. Ο Σπύρος Ξέρας κατηγορείται για διαφθορά από μια δικαιοσύνη για την οποία οι πάντες ζητούν την απαλλαγή από το έγκλημα και τη διαφθορά.

Δεν επιδιώκω με τίποτε να είμαι ο υπερασπιστής της ενοχής του Ξέρα, αν υπάρχει. Αλλά από την άλλη πλευρά, όλοι καταλαβαίνουν ότι, και στην περίπτωση που η κατηγορία επιβεβαιωθεί, τις δημοπρασίες που αποτελούν το αντικείμενο κατηγορίας εις βάρος του έγιναν παράνομες με εντολή άλλων και για λογαριασμό της προεκλογικής εκστρατείας του Δημοκρατικού Κόμματος. Από την οπτική αυτή γωνία ο Ξέρας είναι θύμα και ηθικός αυτουργός αλλά με ποινικές ευθύνες. Δηλαδή θα του τεθεί το κεφάλι στο σινί, όπου το Δ. Κόμμα μπορεί να προσφέρει και το σινί. Η αντίδραση του Δ. Κόμματος βεβαιώνει την λογική αυτή. Καμιά θεσμική πολιτική υπεράσπιση από το κόμματος ανεξαρτήτως, που αυτός συνελήφθη ως πολιτικό πρόσωπο. Στην προκειμένη περίπτωση δεν τίθεται θέμα δικαιολογίας από μέρος του Δ. Κόμματος, ότι από τη στιγμή που οι διεθνείς φορείς ζητούν επίμονα την καταδίκη διεφθαρμένων υψηλόβαθμων κρατικών στελεχών, το Δ. Κόμμα δεν μπορεί να ενοχοποιηθεί υπερασπιζόμενο τον Ξέρα. (Στην ουσία το Δ. Κόμμα μέσω της επίσημης



δήλωσής του δέχτηκε την ενοχή του Ξέρα και ζητάει δίκαιη ανάκριση και εκδίκαση της υπόθεσης;;;!!! Και το απαιτεί αυτό από μια δικαιοσύνη την οποία κατηγορεί για έλλειψη ή πληρωμένης δικαιοσύνης. Όλο αυτό το σκηνικό μοιάζει με φόρμουλα συμβιβασμού όπου η καταδίκη του Ξέρα να εξυπηρετήσει τη δυνατότητα να μη θιχτούν οι βασικοί ένοχοι της κρατικής διαφθοράς. Η διαφορετική στάση, ή στη δική του γραμμή, που τήρησε ο πρώην πρωθυπουργός Σαλί Μπερίσια, δεν αλλάζει τίποτε στη λογική της ευρείας συνεννόησης σε υπεράσπιση του πραγματικού συστήματος διαφθοράς.)

Είναι πολύ εύκολο να κατανοηθεί, διότι είναι γνωστό, ότι η κρατική διαφθορά και κλοπή, τόσο στο παρελθόν όσο και στο παρόν είναι σε ασύλληπτα μεγέθη. Στο σκεπτικό αυτό, τα στοιχεία που αναφέρονται εις βάρος του Ξέρα είναι γελοία συγκριτικά με εκείνα των άλλων υψηλών κρατικών λειτουργών. Είναι επίσης, γνωστό ότι μηνύσεις και κατηγορίες στα κρατικά όργανα δικαιοσύνης και στα ΜΜΕ, έχουν γίνει για πολλά υψηλόβαθμα τέτοια στελέχη .... όμως το ψύχος των χειροπεδών της αστυνομίας δοκίμασε πρώτος ο έλληνας μειονοτικός Σπύρος Ξέρας. Αρκεί έστω και μόνο αυτό το στοιχείο ώστε και σάμπως πραγματική να είναι η κατηγορία εις βάρος του Ξέρα, ή αληθές το γεγονός ότι θα ακολουθήσουν συλλήψεις και άλλων υψηλόβαθμων στελεχών, η διαδικασία αυτή δεν μπορεί να άρχιζε με τον Ξέρα.

Τα στοιχεία αυτά από κοινού με την πικρή εμπειρία της πολιτικής δικαιοσύνης στη χώρα, εξουδετερώνει την νομιμότητα της αγριότητας αυτής της δικαιοσύνης κατά του Ξέρα. Μουντότερη θα είναι η εικόνα της δικαιοσύνης, σε περίπτωση που δε θα ακολουθήσουν συλλήψεις άλλων ανώτατων στελεχών με πιο δραστική και πολλαπλή διαφθορά. (!) Τότε η υπόθεση Ξέρα θα αποτελεί μια επιλεκτική περίπτωση που θα μεταφέρει πολλά αρνητικά μηνύματα και θα προκαλέσει άλλες καταστάσεις.

Το συμπέρασμα αυτό δεν στηρίζεται μόνο στη μέχρι τώρα εμπειρία, αλλά και στο στοιχείο «της Παρασκευής» που επέλεξε η εισαγγελία για την εφαρμογή από την αστυνομία του εντάλματος συλλήψεως του πρώην υπουργού. Στην περίπτωση του Ξέρα η επιλογή της Παρασκευής δε συμβαδίζει με τις άλλες περιπτώσεις, όπου η επιλογή της ημέρας αυτής για μια όποια θορυβώδη σύλληψη γινόταν με σκοπό να μεσολαβούσαν οι μέρες ανάπαυσης που ακολουθούν, για να αποφθεχτούν οι όποιες αντιδράσεις. (Δηλαδή δεν είχε σημασία η ταχτική αυτή, διότι για το Ξέρα δεν υπήρξαν αντιδράσεις) Ο Ξέρας πρέπει πλέον να έχει αντιληφτεί ότι η μάχη με τη δικαιοσύνη θα είναι μια προσωπική υπόθεση. (Το «λάθος» του Ξέρα έγκειται στο γεγονός ότι ενώ γνώριζε πως υπήρχε προ πολλού ανοιχτή μια ποινική υπόθεση εις βάρος του, ούτε τόσκασε, ούτε εξαγόρασε το κλείσιμό της) Η άρνηση του Ντούλε να τοποθετηθεί σχετικά, μάλιστα και όταν ρωτήθηκε από τους δημοσιογράφους είναι ένας επιπλέον κακός οϊωνός για τον Ξέρα. Ο Ντούλες είναι πρόεδρος του Κόμματος για τα Ανθρώπινα Δικαιώματα στην Αλβανία, είναι βουλευτής με κοινή καταγωγή από ένα γειτονικό χωριό με τον Ξέρα. (Όποιος γνωρίζει έστω και λίγο την ιστορία της εθνικής ελληνικής μειονότητας μια τέτοια στάση θυμίζει τις περιπτώσεις όταν ο κομμουνιστής δικτάτορας χρησιμοποιούσε έλληνες μειονοτικούς για να εξουδετερώσει τους αντιπάλους του επίσης έλληνες. Η μη τοποθέτηση του Ντούλε τον καθιστά υπεύθυνο σε έναν τέτοιο ρόλο, τον οποίο όμως αυτός τον αναλαμβάνει για χυδαίους και προσωπικούς λόγους και διόλου ξεκινώντας από κάποιες αρχές.)

Σε ένα τελευταίο σημείο της ανάλυσης, φαίνεται ότι κάποιος έχουν υπολογίσει ότι η ίδια η ελληνική μειονότητα δε θα αντιδράσει, θα αδιαφορήσει προς την πράξη αυτή (η αυξημένη παρουσία της αστυνομίας κατά τη σύλληψη Ξέρα, μιλάει περί του αντιθέτου), ότι η ελληνική μειονότητα ξέρει να αποστασιοποιείται από τη διαφθορά και τους παραβάτες του νόμου, και όταν αυτοί είναι δικοί της άνθρωποι. Αληθές είναι ότι οι πολιτικοί εκπρόσωποι της ε. μειονότητας, περίπτωση Ντούλε, έχουν τους δικούς

τους λόγους να μη αντιδράσουν. Αληθές είναι όμως και το γεγονός ότι στην προκειμένη περίπτωση η ελληνική μειονότητα αισθάνεται περιθωριοποιημένη. Και η περιθωριοποίηση αυτή δεν εκδηλώνεται με την αύξηση των μετοχών του Ξέρα μεταξύ τους, αλλά με την επανάκληση από τους έλληνες μειονοτικούς των δυσφημιστικών εμπειριών του παρελθόντος, λόγω εθνικότητας.

Τέλος Αργυρόκαστρο 31.01.2016

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2016/02/20/e-keqja-kjo-vlere-morale-e-kohes/>

**E keqja, kjo vlerë morale e kohës...**

20.02.2016 Posted on [20 Shkurt, 2016 18:01](#) by [TemA Online](#) in [Blogu TemA](#) with [2 Comments](#)

Në vendin tonë më shumë se kriza politike apo ekonomike është prezente kriza sociale dhe e shtetit ligjor. Rruga që mund ta nxjerrë shoqërinë dhe shtetin nga kjo krizë pa të shkuar është bllokuar nga politika, e cila në këto 25 vjet tranzicioni u interesua të instalohen në vend anët me negative të sistemit demokratik, të ekonomisë së tregut, zbatimit të ligjit dhe respektimit të vlerave. Kjo ka bërë që në këtë bllokim deri në asfiksi, shoqëria të mos reagojë. Në aspektin filozofik “tranzicioini” përbën konceptin e kalimit nga një stad më i ulët në një stad më të përparuar. Tek ne tranzicioni, edhe pse i stërgjatur, po vërteton të kundërtën. Kështu që shoqëria jonë nuk është në atë tranzicion që në përvojën popullore përcaktohet sipas proverbit “bëj durim në stuhi, në kohë të mirë bëj para”. Por, duke qenë se ka humbur shpresën “e kohës së mirë”, po vepron sipas parimit, “ose kërrusu, ose ik”. (Ndoshta jemi për në librin gines pasi, në këto 25 vjet gati 2/3 e popullsisë ka provuar ikjen dhe emigracionin si shpëtim nga kjo e keqe që prodhojmë po vetë.)

Kjo krizë e shoqërisë është e pashpresë se tek ne u shemb i pari institucion, ai i fjalës. Në bibel thuhet se “në fillim qe fjala”. Edhe për filozofinë, si edhe për shkencën e antropologjisë sociale “fjala” lidhet me zanafillën, me zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë njerëzore. Ky perceptim i shenjtë, shkencor e filozofik në lidhjen me “fjalën” në përvojën e popullit shqiptar gjen shprehjen tek proverbi “Burri kapet nga fjala, dashi nga brirët”. Pra, nuk kemi të bëjmë me “fjalën” si materie gjuhësore që shënjon objekte e nocione, por me “fjalën” që na identifikon si qenje shoqërore, që materializon parimet, ligjesitë, rregullat, moralin dhe qëllimet e jetës në shoqëri dhe vet përparimin e saj. Por çfarë materializon tek ne “fjala”? Përgjigja është tepër e thjeshtë. Materializon në ekstrem rrethin e interesave të individit, apo të një grupi, kundër individit dhe grupit jashtë këtij rrethi interesash dhe sidomos kundër interesit shoqëror. Vet politika është ngritur dhe funksionon me këtë filozofi. Mirëpo, dihet nga të gjithë se realiteti i kësaj filozofie presupozon degradimin e shoqërisë përmes zevëndësimit të vlerave të saj dhe konkurrencës së tyre, me një vlerë të vetme, interesin individual pa kufi, i cili për t’u realizuar ka si definicion të pashmangshëm krimin.

Ky realitet i rrenojave të institucionit të “fjalës” tek ne konstatohet kudo.

Për shoqërinë tonë dhe për më shumë në strukturën e shtetit nuk ka asnjë vlerë fjala akademike. Ajo, ose është shpallur armike, ose është nëpërkëmbur, ose përdoret për qëllime të rëndomta të politikanëve të politikës, ose shërbën thjeshtë për dekor. Fjala akademike është përjashtuar nga të gjitha “strategjitë” ekonomike, sociale, kombëtare të politikës. Fjala e akademikeve në punët e shtetit dhe të politikës së shtetit është zevëndësuar nga fjala e të diplomuarve informalë që kacaviren në politikë, ose nëpërmjet parasë së krimit, ose nëpërmjet devocionit pa kufi dhe pa skrupull ndaj udhëheqësit. Pjesa e ndërshtme e saj është e marginalizuar.

Fjala e politikës më shumë i ngjan një njolle që nxin e përbalt çdo gjë. U pa edhe së fundmi në trajtimin e vizitës së Sekretarit Amerikëan të Shtetit, Kerry. Me të njëjtin destinacion zuri vend këmbëkryq në parlament. Në tembullin e fjalës së lirë dhe të demokracisë misioni “i fjalës” është baltosja sa me shumë të vlerave. Është kthyer në tregues të përmasave të krimit dhe njëkohësisht në mjet për të treguar se sa i mbrojtur, i fuqishëm, i patrembur, sfidues, i pushtetshëm dhe detyrimisht i respektuar nga pjesa tjetër është ai. Lë të thotë sa të drejta të dojë opozita, ajo nuk gëzon moralin për të qenë

bindese. Lë të thotë sa të dojë premtime pozita, realiteti e ka bërë fjalën e saj të pa shpresë. Këtu e ka burimin kongluzioni i perendimorëve se “shqiptari (politikan dhe jo vetëm) të tjera thotë, të tjera mendon dhe të tjera bën”.

“Fjala” në shkollë nuk i shërbën aq dijës sa u shërbën interesave të ulëta kundër dijës. Në familje shërbën për të treguar se mirëqenia dhe lumturia kanë nevojë për para. Në marrëdhëniet intime për të treguar se nuk ka ndjenja por kenaqësi utile që paguhet, ose këmbëhet me privilegje.

Të vetmin dedikim pozitiv që ka fjala në këtë situatë është se i jipet mundësia të prodhojë humor politik, shumë humor politik. Por edhe në këtë rast joshja e monentit thellon në kohë gropën e zhgënjimit. Ndërsa ata që bëhen objekt i këtij humori përfitojnë nga ky “denim” më shumë imunitet, përfitojnë konfirmimin publik të statusit e të fortit, të faktorit të paprekshëm, statusin e vlerës së duhur për të ecur përpara në rrugën e tyre.

Në përgjithësi institucioni “i fjalës” është ftuar tanimë për të shprehur dhe njëkohësisht për të zbutur sadopak intervecionin masiv të së keqës mbi të mirën. Në këtë operacion e keqja nuk fitoi thjeshtë të drejtën e qytetarisë por u shnderua në vlerë morale të kohës, duke nxjerrë në minorancë dhe si të tëpërt e qesharake drejtësinë, ndërshmerinë, përkushtimin për punën, respektimin e ligjit etj. Kemi gati gjysmën e periudhës së tranzicionit që qeveritë e djathta dhe të majta shënojnë si vlerë pozitive politike fushatën për legalizimin e ndërtimeve pa leje, që do të thotë se në emër të votës legalizon shkeljen e ligjit. Por kur shifrën e tyre kupton se përmasat e shkelësve të ligjit, pra, të së keqës, sipas parimeve demokratike dhe të shtetit ligjor, ka bërë të pushtetshëm antiligjin. Në çdo zgjedhje për pushtetin egzekutiv qëndror apo lokal, votuesi ftohet për të votuar jo më të mirën e mundshme, por mundësisht të keqën më të vogël. Me 2005 votuesi shqiptar votoi partinë që shtatë vjet më parë dogji vendin. Dhe e bëri këtë jo se harroi këtë fakt, por se e keqja qeverisese që pasoi 1997 shkoi me larg se e keqja e këtij viti të mprapshtë. Me 2013 u votua kundër qeverisjes 8-vjeçare pasi ajo e çoi të keqën me tutje se ç’ e gjeti atë me 2005. Mbëtet i hidhur dhe domëthenës fakti i pohuar se me 2013, për të mundur të keqën në pushtet duheshin afruar struktura të të njëjtit nivel të keqeje, por të veshura me shpresë rilindjeje.

Shkalla më e lartë e kësaj të keqeje është shitblerja e çdo vlere dhe shitja e atdheut për interesa të ulëta.

Shteti thotë se kërkon të prodhojë bariera për ndalimin e kësaj të keqeje. Por po provohet se ato gjithmonë e më shumë po ushqejnë sistemin e së keqës. Nga njera anë këto “bariera” institucionale injorojnë dhe deligjitojnë institucione të tjera shterore, nga ana tjetër ato shfrytëzohen nga përfaqësuesit e shtetit për përfitime personale, ose për të bërë politikë, apo fushatë elektorale. Marrim si shëmbull “testet” e punësimit. Nga njera anë ato shpesh mohojnë diplomata universitare (shpesh me të drejtë pasi ato janë produkt i një të keqeje tjetër), nga ana tjetër testet shndërohen në mundësi përfitimi, për shkak të manipulimit, nga individë përgjegjës për zhvillimin e tyre, apo shndërrohen në mundësi për efekte elektorale.

Një biznes sado i vogël ka aq shumë detyrime e rregulla për të zbatuar, sa vështirë se mund të përballohen dhe nuk mund të përballohen. Kjo është njera anë, ajo më e vogla. Ka edhe një anë akoma më të rendë dhe nuk lidhet aq me faktin se shteti nuk është në gjendje për të përmbushur detyrimet e veta të parashikuara në ligj ndaj këtij biznesi, apo edhe qytetarit, por më shumë për shkak se përfaqësuesit për përmbushjen e tyre e shikojnë detyrimin e tyre ligjor si mjet përfitimi për vete. Pra, ligji është në dorë të Maliqit dhe Maliqin e cakton në atë post qeveria, shpesh jo për shkak të meritave, por të aftësisë për të grumbulluar vota.

Eshtë këtu lehtësisht e kuptueshme që në këtë të keqe të madhe vjen një e keqe më e madhe që është krimi i drejtësisë dhe i korrupsionit. Nga ana tjetër, këto rrathë viciozë të ngarkuar me të keqe kanë vrarë konkurrencën, konkurrencën e vlerave, të aftësive, të dijeve, të fitimit sipas rregullave të lojës dhe të ligjit. Konkurrencën që shteti kërkon të organizojë në bazë sistemi ligjor, përbën mënyrën institucionale për lulëzimin e korrupsionit aktiv dhe pasiv. Nuk ka as konkurrencë demokratike në politikë. Ka vetëm një konkurrencë në dukje të lirë. Eshtë bota e krimi, por vlera matese e konkurrencës atje, është gjaku. **FUND**

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2016/03/27/mosperputhje-konceptesh-ne-interesa-te-perbashketa-ne-marredheniet-dypaleshe/>  
<http://www.gazetatema.net/author/mbaze/page/829/>

### **Mosperputhje konceptesh në interesa të përbashkëta në marrëdhëniet dypaleshe**

27.03.2016

Posted on [27 Mars, 2016 19:57](#) by [TemA Online](#) in [Blogu TemA](#) with [5 Comments](#)

Në javën që lamë pas ministri i jashtëm Ditmir Bushati realizoi një vizitë zyrtare në Greqi. Duke u nisur nga raporti i marrëdhënieve midis dy vendeve dhe nga sfidat e kohës, vizita mirrte një rendësi të veçantë. Mirëpo rendësia e pritur derivoi në një rendësi të llojit të veçantë. Kjo për faktin se nga njëra anë ajo tentoi të provokonte statuskron tradicionale në marrëdhëniet dypaleshe, me kusht distancimin nga e kaluara. Në anën tjetër, palët nuk ishin në sinkron drejt këtij synimi.

Fakt është se, në qarqet politikbërese të strategjisë kombëtare të Greqisë në kuadër të BE-së, ka kohë që punohet për ndryshim kursi të saj, për të trajtuar fqinjët dhe nevojat e popujve respektiv të Ballkanit me sistem referues qytetërimin evropian. Athina ka kohë që e ka kuptuar se roli i saj në Ballkan nuk mund të fitojë parametrat e aspiruara, pa hequr nga këmbët peshat e së kaluarës, pa rivlerësuar e ridimensionuar aleancat e vjetra në Ballkan, të cilat, pavarësisht konveconeve homogjene, qofshin këto edhe fetare, nuk inspirojnë frymë evropiane dhe as i shërbëjnë drejtpërdrejt interesave të saj. Në këtë frymë kjo platformë e politikës së jashtme greke trajton edhe faktorin shqiptar. Madje edhe çeshtjen e Kosovës.

Në këtë kuptim, vizita e Bushatit në Athinë ishte një test. Ministria e Jashtme Greke kishte menduar për këtë edhe elementë të suksesit diplomatik tradicional, siç ishte p.sh fakti i shkollimit në Greqi të çiftit Bushati. Por përpjekja mbeti në kufijtë e testit. Pala greke nuk guxoi të hapte qartazi letrat e veta. Ajo, përveç rezervimit që kishte në lidhje me reagimin e pritshëm të segmenteve të politikës dhe jo politikës që kanë mbetur të ankorruar në shabllonet e një politike të jashtme të së kaluarës së ngurtë, (situatë që mund të mbarojë me të gjitha pakënaqësitë që prodhon kriza greke) hasi edhe në mungesën totale të gadishmerisë së palës shqiptare për të ecur sëbashku në këtë shteg. Madje, kryediplomati shqiptar përveç se e kuptonte homologun grek pa përkthyes, reflektoi një qëndrim që i përshtatet vetëm së shkuarës.

Si në asnjë rast tjetër, në këtë vizitë nuk u fol për arritje dhe nivel shumë të mirë marrëdhëniesh dypaleshe, por për dakortësi në lidhje me egzistencën e problemeve midis dy vendeve, por pa i adresuar ato kongretisht. Për këtë shkak ministrat respektiv folën me të njëjta terma “për gjetjen e mekanizmave për zgjidhjen e problemeve” duke iu referuar kongretisht parimit të së drejtës ndërkombëtare dhe frymës evropiane. Por të dy palët treguan se kishin pikamje përjashtuese në referencat e tyre në këto parime. Ndërsa ministri Koxhias i mëshoi parimit të së drejtës ndërkombëtare si shprehje të frymës evropiane në marrëdhëniet midis dy vendeve, ministri Bushati revijëzoi idenë e interesit shqiptar që mund të rrjedh nga vënia në lëvizje të instrumentave të së drejtës ndërkombëtare në zgjidhjen e problemeve midis dy vendeve. (Përshtypja në lidhje me ndërkombëtarizimin e problemeve midis dy vendeve vjen edhe nga klima e krijuar në opinionin publik shqiptar nga forca politike apo edhe nga medjat)

Diferencim esencial, kishte midis paleve edhe përsa i përket raportit të këtyre problemeve me të tashmën dhe të ardhmën e marrëdhënieve dypaleshe. Për palën greke zgjidhja e këtyre problemeve ka të bëjë me çlirimin prej tyre të së tashmës dhe sidomos të së ardhmës në marrëdhëniet midis dy vendeve dhe popujve tanë. Për homologun e tij

Shqiptar, ato janë çeshtje që vijnë nga e shkuara madje “me rendësi e peshë”, por janë edhe “probleme të aktualitetit dhe të së ardhmës së përbashkët”. Pra kumtoi qartë se bëhet fjalë për një vijimësi problemesh nga e shkuara në të tashmën duke lenë të kuptohet se fajin për këto e ka Greqia. Flet për këtë edhe fakti se z. Bushati, për çdo pretendim të palës greke kishte gati një reciprocitet, herë pa lidhje dhe herë abuziv.

Kështu në kërkesën e palës greke për implementimin e marrëveshjes për varrëzat e ushtarëve grekë renë në tokën shqiptare në luftën kundër fashizmit me 1940-41, Bushati e kondicionoi me pretendimin e abrogimit të ligjit të luftës nga pala greke. Pra, bëhet fjalë për dy gjera krejt të ndryshme. I pari ka të bëjë me detyrimin e palës shqiptare që rrjedh nga zbatimi i së drejtës ndërkombëtare për të renët e ushtrive në vende të huaja, sanksionuar në marrëveshjen dypalëshe të 2009. I dyti, në rast se nuk do të pranohet praktikisht inegzistent, që rrjedh nga realiteti paqësor 76 vjeçar midis dy vendeve; nga fakti se ai ligj nuk kishte asnjë pasojë ndaj Shqipërisë dhe qytetarëve të saj, nga fakti se sot mijrat e emigrantëve shqiptarë në Greqi kanë pasuritë e tyre të njohura ligjerisht nga shteti grek, (qëllimisht ky ligj u lidh me pretendimet e çameve, të cilët aso kohe ishin qytetarë grekë); nga fakti se midis dy vendeve tona është në fuqi një traktat miqësie dhe nga fakti i të qenit bashkërisht vende anëtarë të NATO-s; në rast se juridikisht problemi nuk do të konsiderohet i ezauruar nga vendimi i qeverisë greke me 1987, atëherë do t’i duhet Greqisë të ngrëjë pretendimin se Shqipëria ende edhe sot e kësaj dite nuk ka në dorë asnjë dokument juridik abrogues të ligjit të parlamentit shqiptar të 1939, sipas të cilit Shqipëria i shpallte luftë çdo vendi me të cilin ishte në luftime dhe Italia, (në rastin kongret Greqia) ligj që u bë shkak i dekretit të mbretit të Greqisë sipas të cilit Greqia ishte në luftë me Italinë dhe Shqipërinë pas sulmit ndaj saj me 28 tetor 1940. (Italia pati guximin dhe abrogoi ligjin ngjashëm të luftës ndaj Greqisë).

Po ashtu zoti Bushati, kërkesës së Presidentit grek për respektimin e të drejtave të minoritetit etnik grek në Shqipëri iu përgjigj me kërkesat për të drejta që i sigurojnë identitetin etnik e kulturor të emigrantëve shqiptarë në Greqi. Së pari, pavarësisht të drejtës për këto kërkesa, z. Bushati duhet të dijë se Minoriteti Etnik Grek në Shqipëri dhe emigrantët shqiptarë në Greqi mund të jenë faktorë që ndikojnë në marrëdhëniet midis dy vendeve, por në statusin e tyre juridik dhe etnik nuk ka asgjë të barabartë që të mund të krijojë bazë reciprociteti dhe as ka praktikë të tillë në botë. Së dyti, ai pohoi indirekt se në lidhje me Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri, shteti shqiptar që nga themelimi i tij, nuk ka ratifikuar asnjë dokument të plotë juridik, (me përjashtim të protokollit të Korfuzit) që t’i njohë dhe t’i garantojë këtij minoriteti statusin etnik dhe të drejtat e tij në shtetin shqiptar. (Statusi i këtij minoriteti në Shqipëri është një formalitet praktik që buron nga një realitet i caktuar apriori nga forcat pushtuese italiane të Jugut të vendit me 1916-1920).

Tregues që kreu i diplomacisë shqiptare nuk dha asnjë garanci për ridimensionimin e marrëdhënieve midis dy vendeve është edhe fakti që në takimet e tij me përfaqësuesit e shoqatave të emigrantëve shqiptarë në Greqi më shumë ishte i interesuar t’u tregonte se si i kishte kërkuar palës greke abrogimin e ligjit të luftës, se sa t’u fliste për përpjekjet për përmirësimin e marrëdhënieve midis dy vendeve që do të çojë në përmirësimin e kushteve të tyre të punës e jetesës në Greqi (Pra ai kondicionoi këto marrëdhënie me abrogimin e një ligji faktikisht dhe juridikisht inegzistent dhe rrjedhimisht pa asnjë pasojë mbi ta dhe popullin shqiptar)

Në këtë kuptim falenderimet e përsëritura të Bushatit për ndihmën e Greqisë në rrugën euroatlandike të Shqipërisë, nuk kanë asnjë vlerë kur të paktën nuk përbejnë shkak për përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe krijimin e një klime besimi reciprok. Aq më keq kur Shqipëria nuk ka bërë asgjë në favor të Greqisë, siç ndodh me vendet e tjera të cilësuar nga Shqipëria si aleatë strategjikë. (Merre me mend çfarë do të ndodhte në

rast se Greqia do të sillej si Çekia, e cila u bë gati të bllokonte MSA të Shqipërisë me BE për të mbrojtur interesat e një firme private çeke në Shqipëri)

Si përfundim vizita e zotit Bushati në Athinë konfirmoi edhe një herë se në raport me Greqinë, Tiranës, më shumë se përmirësimi i marrëdhënieve dypalëshe i intereson egzistenca e problemeve me synim të pahequr për të etiketuar në sytë e shqiptarëve Greqinë si fajtoreshë permanente, situatë që shërbën për të ushqyer nacionalizmin e trashëguar antihelen në segmente të caktuara të shoqërisë shqiptare, për ta përdorur në vijim si valvul shkarkimi të problematikës serioze e gjithëplanëshe të brendshme. Një manipulim i tillë e bën gjithashtu, më të lehtë lojën e politikës shqiptare në favor të tretëve, interesat e të cileve janë historikisht kundër interesave të bashkëpunimit shqiptaro-grek, si i vetmi bashkëpunimi që u garanton, si Greqisë edhe Shqipërisë një rol strategjik në Ballkan dhe me gjerë në Evropën qendrore e juglindore. (Aktivizimi së fundmi i interesave të Austrisë në rajon e përfron shumë tabllo e fillim shekullit të kaluar.) Në lidhje me këtë, vet Tirana tregon mosmirënjohje praktike për faktin se në Greqi jetojnë më shumë shqiptarë, emigrantë të brezit të ri, se në çdo vend tjetër të botës, se Greqia, që nga 1990 u bë pjesa kryesore e zgjidhjes së krizave të perseritura në Shqipëri, se Greqia është partneri ekonomik i saj më i rëndësishëm në rajon, se në spitalet e Greqisë gjeten shërim falas me dhjetra mijra shqiptarë, se kultura greke përbën pjesën më aktive të atraksionit kulturor e turistik shqiptar etj.

Po ashtu, rezultatet e vizitës Bushati në Athinë tregojnë se po nuk ndërmjetësuan zhvillimet të tjera korrigjuese e pozitive, do të jetë i vështirë rinovimi i traktatit të miqësisë midis dy vendeve, i cili këto 20 vjet edhe pse ishte më shumë në pozita inaktive, luajti një rol primar në garantimin e një niveli të mirë marrëdhëniesh midis dy vendeve.

### **Për gazetën TEMA 27/03/2016**

Η επίσκεψη του Μπουσάτι στην Αθήνα  
και ορισμένες αποκλίνουσες αντιλήψεις

Του Παναγιώτη Μάρκα 27.03.2016

Την περασμένη εβδομάδα ο Υπουργός Εξωτερικών Ντιμίτρη Μπουσάτι πραγματοποίησε επίσημη επίσκεψη στην Ελλάδα. Έχοντας υπόψη την αναλογία των σχέσεων μεταξύ των δύο χωρών και τις προκλήσεις της επικαιρότητας, η επίσκεψη είχε ιδιαίτερη σημασία. Όμως η αναμενόμενη σημασία εξελίχθηκε σε σημασία ιδιαίτερου είδους. Αυτό επειδή, αφενός μεν, επιχείρησε να προκαλέσει το παραδοσιακό statusquo στις διμερείς σχέσεις υπό τον όρο της αποστασιοποίησης από το παρελθόν, αφετέρου δε, οι πλευρές δεν ήταν συγχρονισμένα προς το σκοπό αυτό.

Είναι γεγονός πως οι παράγοντες που χαράζουν την εθνική στρατηγική της Ελλάδος στα πλαίσια της ΕΕ, επί μακρό χρονικό διάστημα εργάζονται για την αλλαγή της πορείας της για την αντιμετώπιση των γειτόνων και των αναγκών των λαών των Βαλκανίων με σημείο αναφοράς τον ευρωπαϊκό πολιτισμό. Η Αθήνα προ πολλού έχει αντιληφθεί πως δεν μπορεί να πετύχει τους προσδοκώμενους στόχους χωρίς να αποβάλει τα βαρίδια του παρελθόντος, χωρίς την αξιολόγηση και επαναθεώρηση των παλιών συμμαχιών στα Βαλκάνια, οι οποίες, παρά τις ομοιογενείς συμβατότητες, όντας ακόμα και θρησκευτικές, δεν εκπέμπουν ευρωπαϊκό πνεύμα και δεν εξυπηρετούν



άμεσα τα συμφέροντά της. Με αυτό το πνεύμα η ελληνική εξωτερική πολιτική χειρίζεται και τον αλβανικό παράγοντα. Εξάλλου και την υπόθεση του Κοσσόβου.

Υπό την έννοια αυτή η επίσκεψη του Μπουσάτι στην Ελλάδα αποτέλεσε ένα τεστ. Το Υπουργείο Εξωτερικών της Ελλάδος είχε υπολογίσει προς τούτο και το στοιχείο της παραδοσιακής διπλωματικής επιτυχίας, όπως, π.χ., το γεγονός φοίτησης στην Ελλάδα του ζεύγους Μπουσάτι. Η προσπάθεια όμως παρέμεινε στα όρια του τεστ. Η ελληνική πλευρά δεν τόλμησε να ανοίξει καθαρά τα χαρτιά της. Εκτός από την επιφύλαξη σχετικά με την αναμενόμενη αντίδραση των πολιτικών και μη παραγόντων που επιμένουν στα πρότυπα μιας ξεπερασμένης και ανελαστικής εξωτερικής πολιτικής (κατάσταση που ήταν πιθανόν να κομίσει όλες τις δυσარέσκειες που παράγει η ελληνική κρίση), πρόσκρουσε και στην παντελή έλλειψη της πρόθεσης της αλβανικής πλευράς για κοινή πορεία στην κατεύθυνση αυτή. Εξάλλου, ο αρχηγός της αλβανικής διπλωματίας, πέραν του ότι καταλάβαινε τον Έλληνα ομόλογό του χωρίς μεταφραστή, επέδειξε στάση που παραπέμπει μόνο στο παρελθόν.

Όπως ποτέ άλλοτε, κατά την επίσκεψη αυτή δεν έγινε λόγος για επιτυχίες και διμερείς σχέσεις υψηλού επιπέδου, αλλά για το ότι συμφωνούν σχετικά με την ύπαρξη προβλημάτων μεταξύ των δύο χωρών, χωρίς όμως να γίνεται συγκεκριμένη αναφορά στα προβλήματα αυτά. Γι' αυτό οι δύο υπουργοί αντίστοιχα μίλησαν με την ίδια ορολογία «για την εύρεση των μηχανισμών λύσεως των προβλημάτων», αναφερόμενοι συγκεκριμένα στην αρχή του διεθνούς δικαίου και του ευρωπαϊκού πνεύματος. Όμως οι δύο πλευρές έδειξαν ότι είχαν αποκλίνουσες αναφορές σχετικά με τις αρχές αυτές. Ενώ ο Υπουργός Κοτζιάς εστίασε στην αρχή του διεθνούς δικαίου ως έκφραση της ευρωπαϊκής πνοής στις σχέσεις μεταξύ των δύο χωρών, ο Υπουργός Μπουσάτι επαναδιατύπωσε την ιδέα των αλβανικών συμφερόντων που δύναται να προκύψουν από την κινητοποίηση των θεσμών του διεθνούς δικαίου για την επίλυση των προβλημάτων μεταξύ των δύο χωρών. (Η εντύπωση σχετικά με τη διεθνοποίηση των προβλημάτων μεταξύ των δύο χωρών προκύπτει και από το κλίμα που δημιουργήθηκε στην αλβανική κοινή γνώμη, στις πολιτικές δυνάμεις ή και στα ΜΜΕ.)

Ουσιαστική διάσταση μεταξύ των πλευρών υπήρξε και σχετικά με τον συσχετισμό των εν λόγω προβλημάτων με το παρόν και το μέλλον των διμερών σχέσεων. *Για την ελληνική πλευρά η λύση των προβλημάτων αυτών σχετίζεται με την απαλλαγή από αυτά χάριν του παρόντος και κυρίως του μέλλοντος των σχέσεων μεταξύ των δύο χωρών και λαών μας.* Για τον Αλβανό ομόλογό του πρόκειται για προβλήματα που προέρχονται από το παρελθόν, εξάλλου «με σημασία και βαρύτητα», αλλά είναι και επίκαιρα «προβλήματα του σήμερα και του κοινού μέλλοντος». Επομένως ανέφερε καθαρά ότι γίνεται λόγος για προβλήματα με συνέχεια από το παρελθόν στο μέλλον υπονοώντας πως υπαίτιος γι' αυτά είναι η Ελλάδα. Γι' αυτό μαρτυρεί και το γεγονός ότι ο κ. Μπουσάτι για οποιονδήποτε ισχυρισμό της ελληνικής πλευράς είχε να αντιτάξει μία αμοιβαιότητα, τότε ασυνάρτητα και τότε καταχρηστικώς.

Συγκεκριμένα στο αίτημα της ελληνικής πλευράς για την εφαρμογή της συμφωνίας για τα νεκροταφεία των ελλήνων στρατιωτών που έπεσαν στην αλβανική γη στο έπος του 1940-41 κατά του φασισμού, ο Μπουσάτι αντέταξε την απαίτηση της κατάργησης από την ελληνική πλευρά του νόμου της εμπόλεμης κατάστασης. Επομένως, γίνεται λόγος για δύο τελείως διαφορετικά πράγματα. Το πρώτο σχετίζεται με την υποχρέωση της αλβανικής πλευράς που απορρέει από την εφαρμογή του διεθνούς δικαίου για τους πεσόντες των στρατών σε χώρες της αλλοδαπής, που κυρώθηκε με τη διμερή συμφωνία του 2009. Το δεύτερο, αν δε θεωρηθεί πρακτικά ανύπαρκτο, λόγω της ειρηνικής συνύπαρξης μεταξύ των δύο χωρών επί 76 έτη, λόγω του ότι ο νόμος αυτός δεν επέφερε καμιά συνέπεια για την Αλβανία και τους υπηκόους της, λόγω του ότι σήμερα χιλιάδες αλβανοί μετανάστες στην Ελλάδα έχουν τις περιουσίες τους αναγνωρισμένες νόμιμα

από το Ελληνικό Κράτος (σκόπιμα ο εν λόγω νόμος συσχετίστηκε με τους ισχυρισμούς των Τσάμηδων, οι οποίοι τότε ήταν έλληνες πολίτες), λόγω του ότι μεταξύ των δύο χωρών μας είναι σε ισχύ σύμφωνο φιλίας και λόγω του ότι οι δύο χώρες είναι μέλη του ΝΑΤΟ· εάν το πρόβλημα νομικά δεν θεωρείται λήξαν με την απόφαση του έτους 1987 της Ελληνικής Κυβέρνησης, τότε θα πρέπει η Ελλάδα να εγείρει την απαίτηση ότι η Αλβανία ακόμα και σήμερα δεν διαθέτει **κανένα νομικό έγγραφο** κατάργησης του νόμου του έτους 1939 της Αλβανικής Βουλής σύμφωνα με τον οποίο η Αλβανία κήρυττε πόλεμο οποιασδήποτε χώρας με την οποία η Ιταλία ήταν σε εμπόλεμη κατάσταση (στην προκειμένη περίπτωση η Ελλάδα), νόμος που αποτέλεσε την αφετηρία για το Βασιλικό Διάταγμα με το οποίο η Ελλάδα ήταν σε πόλεμο με την Ιταλία και την Αλβανία μετά την επίθεση εναντίον της στις 28 Οκτώβρη 1940. (Η Ιταλία είχε το θάρρος να καταργήσει το νόμο εμπόλεμης κατάστασης με την Ελλάδα.) Επίσης, ο κ. Μπουσάτι στο αίτημα του Προέδρου της Ελληνικής Δημοκρατίας για το σεβασμό των δικαιωμάτων της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας στην Αλβανία απάντησε με αιτήματα για δικαιώματα που διασφαλίζουν την εθνική και πολιτιστική ταυτότητα των αλβανών μεταναστών στην Ελλάδα. Πρώτο, ανεξάρτητα εάν το αίτημα αυτό είναι δίκαιο, ο κ. Μπουσάτι πρέπει να γνωρίζει ότι η Εθνική Ελληνική Μειονότητα στην Αλβανία και οι αλβανοί μετανάστες στην Ελλάδα μπορεί να είναι παράγοντες που επηρεάζουν τις σχέσεις μεταξύ των δύο χωρών, αλλά στο νομικό και εθνικό τους καθεστώς δεν έχουν τίποτε κοινό που να δημιουργεί βάση αμοιβαιότητας, ούτε και διεθνώς υπάρχει τέτοια πρακτική. Δεύτερο, εκείνος έμμεσα αποδέχτηκε ότι σχετικά με την Εθνική Ελληνική Μειονότητα στην Αλβανία το Αλβανικό Κράτος από την ίδρυσή του δεν έχει κυρώσει κανένα ολοκληρωμένο νομικό κείμενο (με εξαίρεση του Πρωτοκόλλου της Κέρκυρας) που να αναγνωρίζει και να διασφαλίζει στην εν λόγω μειονότητα το εθνικό καθεστώς και τα δικαιώματά της στο Αλβανικό Κράτος. (Το στάτους της μειονότητας αυτής στην Αλβανία αποτελεί τυπική πρακτική που απορρέει από μια πραγματικότητα καθορισμένη αυθαίρετα από τις ιταλικές δυνάμεις κατοχής του Νότου της χώρας την περίοδο 1916-1920.)

Ένδειξη ότι ο αρχηγός της αλβανικής διπλωματίας δεν παρείχε ουδεμία εγγύηση για νέα διάσταση των σχέσεων μεταξύ των δύο χωρών αποτελεί και το γεγονός ότι στις συναντήσεις του με εκπροσώπους των συλλόγων των αλβανών μεταναστών στην Ελλάδα μεγαλύτερο ενδιαφέρον έδωσε στο ότι ζήτησε από την ελληνική πλευρά την κατάργηση του νόμου της εμπόλεμης κατάστασης, παρά στις προσπάθειες για τη βελτίωση των σχέσεων μεταξύ των δυο χωρών, γεγονός που θα οδηγήσει και στη βελτίωση των συνθηκών εργασίας και διαμονής τους στην Ελλάδα. (Λοιπόν, εκείνος συσχέτισε τις διμερείς σχέσεις με την κατάργηση ενός νόμου πρακτικά και νομικά ανύπαρκτου, επομένως χωρίς συνέπειες γι' αυτούς και τον αλβανικό λαό.)

Υπό το πρίσμα αυτό οι επανειλημμένες ευχαριστίες του Μπουσάτι για τη βοήθεια της Ελλάδας στην ευρωατλαντική πορεία ένταξης της Αλβανίας δεν έχουν καμιά αξία, εφόσον δεν συμβάλλουν στη βελτίωση των διμερών σχέσεων και στη δημιουργία κλίματος αμοιβαίας εμπιστοσύνης. Τόσο το χειρότερο που η Αλβανία ουδέν έπραξε υπέρ της Ελλάδας, όπως συμβαίνει με τις λοιπές χώρες που αποκαλούνται από την Αλβανία ως στρατηγικοί εταίροι. (Φαντάσου τι θα συνέβαινε εάν η Ελλάδα συμπεριφερόταν όπως η Τσεχία, η οποία ήταν έτοιμη να μπλοκάρει το σύμφωνο σταθερότητας της Αλβανίας με την ΕΕ για να υπερασπιστεί τα συμφέροντα ιδιωτικής τσέχικης εταιρείας στην Αλβανία.)

Συμπερασματικά, η επίσκεψη του κ. Μπουσάτι στην Αθήνα επιβεβαίωσε άλλη μια φορά πως, σχετικά με την Ελλάδα, τα Τίρανα περισσότερο από τη βελτίωση των διμερών σχέσεων τα ενδιαφέρει η ύπαρξη προβλημάτων που παραμένουν για να αναδείξουν στους Αλβανούς την Ελλάδα ως μόνιμο υπαίτιο, κατάσταση που

εξυπηρετεί την τροφοδότηση του κληρονομημένου ανθελληνικού εθνικισμού σε συγκεκριμένες απολήξεις της αλβανικής κοινωνίας και στη συνέχεια να τον χρησιμοποιήσει ως βαλβίδα αποσυμφόρησης της δυσχερούς εσωτερικής κατάστασης σε όλους τους τομείς. Ο χειρισμός αυτός καθιστά ευνοϊκότερο το παιχνίδι της αλβανικής πολιτικής υπέρ τρίτων, τα συμφέροντα των οποίων ιστορικά αντιτίθενται της αλβανο-ελληνικής συνεργασίας, ως μοναδική συνεργασία που διασφαλίζει στην Ελλάδα και στην Αλβανία στρατηγικό ρόλο στα Βαλκάνια και ευρύτερα στην Κεντρική και Νοτιοανατολική Ευρώπη. (Η ενεργοποίηση τελευταία των συμφερόντων της Αυστρίας στην περιοχή θυμίζει την κατάσταση των αρχών του περασμένου αιώνα.) Σχετικά με αυτό τα ίδια τα Τίρανα αποδεικνύουν στην πράξη αγνωμοσύνη για το ότι στην Ελλάδα ζουν περισσότεροι Αλβανοί, μετανάστες νέας γενιάς, απ' ό, τι σε οποιαδήποτε άλλη χώρα στον κόσμο, για το ότι η Ελλάδα είναι ο σημαντικότερός της οικονομικός εταίρος στην περιοχή, για το ότι στα νοσοκομεία της Ελλάδας νοσηλεύτηκαν δωρεάν δεκάδες χιλιάδες Αλβανοί, για το ότι ο ελληνικός πολιτισμός αποτελεί τον πιο σημαντικό πόλο πολιτιστικής και τουριστικής έλξης για την Αλβανία κ.ά.

Επίσης, τα αποτελέσματα της επίσκεψης του Μπουσάτι στην Αθήνα αποδεικνύουν πως, αν δεν μεσολαβήσουν άλλες διορθωτικές, θετικές εξελίξεις, θα καταστεί δύσκολη η ανανέωση του συμφώνου φιλίας μεταξύ των δύο χωρών, το οποίο μολονότι τα τελευταία 20 χρόνια περισσότερο βρισκόταν σε αδρανή κατάσταση παρά λειτουργούσε, διαδραμάτισε πρωτεύοντα ρόλο στη διασφάλιση ικανού επιπέδου στις σχέσεις μεταξύ των δύο χωρών.

## **Nga Panajot Barka.**

<https://www.newsbomb.al/kapja-e-perfaqesuesve-politike-te-minorititet-grek-dhe-identiteti-i-tij-etnik-i-rrezikuar-39843>

<http://smarkos.blogspot.com/2016/05/kapja-e-perfaqesuesve-politike-te.html>

### **Kapja e përfaqësuesve politikë të minoritetit grek dhe identiteti i tij etnik i rrezikuar.**

08.05.2016

Para do kohësh drejtuesi i opozitës sllavomaqedonase akuzoi nominalisht, politikanë të rendësishëm shqiptarë në Ish Republikën Jugosllave të Maqenonisë për bashkëpunim me struktura shtetërore sekrete dhe publike të shtetit fqinj për interesa personale, politike dhe ekonomike.

Kjo akuzë nxiti analizën për një kapje të ngjashme nder vite të përfaqësuesve politikë të minoritetit etnik grek në Shqipëri, por në dëm të interesave të këtij minoriteti. Për vërtetimin e kapjes së përfaqësuesve të minoritetit nuk do të sjellim të njehta mjete (përgjime), por një qasje tjetër. Do të ballafaqojmë nga njera anë realitetin diskriminues shumeplanesh të minoritetit etnik grek, zhbërjen e tij demografike dhe ekonomike dhe në zonat me popullsi kompakte, fragmentarizimin dhe përjashtimin i këtij minoriteti nga vemendja politike, ekonomike e shtetit dhe e organizmave ndërkombëtare. Nga ana tjetër qëndron, mbijetesa politike e përfaqësuesve politikë të minoritetit etnik grek, jo me votat e tij por si “dëshirë” e strukturave politike shqiptare, shtimi pa fre i pasurisë së tyre dhe sfumimi në progresion gjeometrik i përpjekjeve të tyre për mbrojtjen e të drejtave të minoritetit. Ky realitet përbën treguesin më kokëfort të kapjes së tyre.

Shëmbujt në vijim nuk janë thjeshtë vërtetues të kësaj kapjeje, i përmasave dhe kohëzgjatjes së saj, por edhe të arsyeve dhe synimeve pse ajo ndodh.

Një grup të rinjsh nga minoriteti, zotërojnë dokumente që vërtetojnë se vetem në zonat me popullsi kompakte minoritare në rrethet Sarandë e Delvinë janë tjetërsuar me dokumente të falsifikuara, me vendime gjyqësore të manipuluar dhe në shkelje të ligjit, apo me vendime të ngjashme të strukturave të tjera të shtetit, 220 mijë dynimë tokë në përkatësi të këtij komuniteti. Me këtë mekanizëm këto sipërfaqe iu kthyen gjasëm ish pronarëve pa asnjë lloj lidhjeje me minoritetin grek. (Për 120 mijë dynim posedohen dosjet kongrete të shkeljeve dhe abuzimeve ligjore dhe për 100 mijë të tjera procesi është në vijim.) Në aspektin social, politik e historik fenomeni duhet konsideruar si neootomanizim i këtyre krahinave minoritare greke. Kjo pasi dokumentat, të fallsifikuara ose jo, ku mbështetet tjetërsimi i pronësisë, e kanë origjinën në perandorinë otomane. Bëhet fjalë për pretendime që zenë fill të paktën që pas shekullit të 16<sup>të</sup>, atëherë kur pushteti islamik i perandorisë u rrembënte me dhunë tokën të krishterëve që nuk pranonin të ndërronin fenë, për të shpërblyer ata që myslimanizoheshin dhe viheshin në shërbim të perandorisë. Neootomanizimi po ndodh pa zhurmë dhe me një tolerim civil dhe institucional në të gjithë Shqipërinë, por në rastin e minoritetit grek fenomeni lidhet esencialisht me ruajtjen e identitetit etnik të tij. Aq me keq kur faktet vërtetojnë se nuk kemi të bëjmë me “trashëgimtarë” të drejtpërdrejtë të ardhur nga shekujt (gjë që s’mund të ndodh), por me individë që zotërojnë sot pushtet politik, ose kanë suport politik për të abuzuar dhe shkelur ligjin.

Nga ana tjetër evidentohet fakti drithërues se këtë proces tjetërsues pronash të minoritetit e toleroi dhe e favorizoi që me 1998-99 kryetari i tanishëm i PBDNJ-së, atëherë i OMONOIA-s Vangjel Dule dhe ata që e pasuan, si V. Bollano e deri me sot. Dule sabotoi atëherë protestën masive dhe politike të komunitetit të minoritetit etnik

grek kundër këtij fenomeni e që ishte në fillimet e veta. Protesta kërkonte në thelb ndalimin e procesit të neootomanizimit të këtij minoriteti por edhe të të gjithë vendit.

Në aspektin juridik dihet se asnjë titull pronësie e kësaj kategorie nuk mund të fitohet pa miratimin e përfaqësuesve të pushtetit vendor. Drejtuesit e pushtetit vendor në zonat e minoritetit, përgjithësisht përfaqësues të PBDNJ-së dhe OMONIA-s, jo vetëm që nuk bënë rezistencë, jo vetëm që hodhën firmat e tyre aprovuese për këto tjetërsime, por ka raste që dolën edhe dëshimitarë të rremë në favor të këtyre grabitqarëve.

Po ashtu, për aq kohë sa ishin drejtues lokal këta përfaqësues, askush nga gjasëm ish pronarët nuk pretendonte njohjen faktike “të pronës”. Sapo ata u larguan nga drejtimi i pushtetit vendor, “ish pronarët” nxituan për të venë hunjtë “e pronës” së tyre. Madje, në Livadhja, në Kulluricë, në Kostar, në Radat e gjetkë po bëhen të dhunshëm. U kërkohet minoritarëve të largohen dhe nga shtëpitë e tyre, pasi, sipas pretendimeve të tyre, i kanë ndërtuar në “pronën” e tyre. Në Kostar të Delvinës disa individë, me tolerimin e drejtuesve vendorë të minoritetit dhe organëve shtetërorë, rrethuan me dhunë 120 hektarë tokë pronë të fshatit. Tani kërcenojnë banorët e tij se do t’i përdhunojnë nëse nuk heqin dorë nga kërkesa për zbatimin e ligjit. Në Radat këta tipa pronarësh u kërkohet vendasve minoritarë gratë në këmbim të lejës për të kullotur bagëtitë në tokat që me ligj janë të tyre.

Për kapjen e përfaqësuesve të minoritetit flet edhe fakti që për mëse 20 vjet PBDNJ, është pjasëmarrëse në qeveritë alternative të vendit, por nuk ka bërë asnjë përpjekje për ndalimin e këtyre shkeljeve të drejtash kapitale të minoritetit grek. Nga ana tjetër drejtuesit e pushtetit vendor të minoritetit, bashkëfajtorë për këtë situatë, elaburohen nga udhëheqja e kësaj partie. Po ashtu, udhëheqja e re e OMONIA-s është produkt i mbështetjes nga të gjithë këta drejtues në komunat e bashkitë e minoritetit. Fakti që edhe ajo nuk denoncon asnjë nga këto vendime abuzive të organëve shtetërore ndaj qindra mijë dynim tokash të grabitura minoritetit dhe asnjë nga këta drejtues e kompromonton keqas edhe atë.

Në periudhën që Shqipëria ratifikonte konvendën kuadër të KiE për mbrojtjen e minoriteteve, (1999-2001), e cila i jep një rendësi të madhe njësive territoriale me popullsi kompakte minoritare, OMONIA dhe PBDNJ, dolën me vendimin e heqjes dorë nga zonat me popullsi kompakte minoritare greke. E bënë këtë në emër gjasëm të realitetit të ri të mbrojtjes individuale të të drejtave të njeriut dhe jo si komunitet. (E kundërta duhej të ndodhte.) Argumenti tjetër i liderit politik të minoritetit për këtë vendim, lidhet me krijimin e një klime të favorshme për të drejtat e himarjoteve që pranonin kombësinë greke. Por çfarë ndodhi realisht?! Ky vendim i hapi rrugën e regjistrimit në zonat me popullsi homogjene minoritare greke gati një mijë familjeve me kombësi shqiptare. Këto regjistrime u kryen me ndërjegje nga drejtuesit lokal të minoritetit etnik grek, gjë që në kushtet e emigrimit masiv të minoritarëve, përbën një tjetërsim të frikshëm demografik në këto zona. Aliko, Vrioni, Çuka, Finiqi, Mesopotami, Livadhja dhe vendbanime të tjera ndryshuan totalisht strukturën demografike. Përpos kësaj fenomeni u shoqërua me dhënien e lejeve për blerje tokash dhe investime nga firma e kompani me pronarë shqiptarë. (Fenomeni është me intensiv në pjesët më jetike të kompaktësisë së minoritetit!)) Po ashtu, në këto zona, por më shumë në Himarë u zbatua një mekanizëm i ri tjetërsimi të pronës. U projektuan vendime për kthim pronash që favorizonin gjasëm minoritarët grekë. Në fakt këto prona (toka) u jipeshin minoritarëve grekë me kusht që ato t’u shiteshin më vonë (me çmim të paracaktuar) personave konkretë me kombësi shqiptare dhe shumë afër politikaneve të lartë. Skema zbatohet në dijeninë dhe me vullnetin e përfaqësuesve të minoritetit. Në

denoncimin e kryeministrit Rama se janë tjetërsuar mbi 50 mijë hektarë tokë në zonën e Bregdetit nga qeveria e Sali Berishës, përmbahet edhe kjo skemë.

Të njëjtit qëllim i shërbeu prishja selektive (sipas perkatesisë etnike dhe politike) të objekteve pa leje në zonën e Himarës. Por asnjë reagim serioz nuk erdhi nga drejtuesit politikë minoritarë grek, ashtu siç po ndodh tani me shpronësimin në kundërshtim me ligjin në Dhermi të mbi 120 banorëve të atjeshëm.

Politikanët minoritarë grekë nuk reagojnë as ndaj situatës energjitike në zonat e minoritetit. Minoritarët grekë janë paguesit me të rregullt të energjisë, por kanë sistemin më të keq të mundshëm furnezimi me energji elektrike në vend. (Zhyten në errësirë veçanërisht në ditë festash) Nuk reagojnë as për faktin se bizneset në minoritetin grek punojnë në kushtet e konkurrencës së pandërshme, pasi atyre u kërkohet korrektesi farmacie ndaj detyrimeve në shtet, ndërkohë që biznese të ngjashme në zona të tjera nuk paguajnë pothuaj fare detyrime ndaj shtetit. As për faktin se minoritarët janë objekt i të gjitha llojeve të gjobave pasi vetëm ata mund t'i paguajnë. Buxheti i shtetit parashikon kuota diskriminuese për bashkitë e minoritetit dhe asete zero për mbarëvajtjen ekonomike të tyre etj. Dhe prap nuk ka asnjë reagim politik nga përfaqësuesit e këtij minoriteti.

Pra, kapja e përfaqësuesve politikë të minoritetit etnik grek nga struktura të ndryshme shtetërore, apo dhe strukturave të tjera që shkulin ligjin, është e evidente. Në minoritet qarkullon shprehja domëthenëse se dëmi që i shkaktuan atij përfaqësuesit e vet politikë në aspektin e identitetit etnik ia kalon shumë dhe dashakeqit e nacionalistit më të flaktë. Në këtë pikë lind edhe një pyetje tjetër esenciale (në fakt retorike). Përse këto struktura shteti mbajnë këtë qëndrim ndaj minoritetit etnik grek? Përse kërkojnë, qoftë edhe me bashkëpunimin me përfaqësuesit e tij politikë, apo nëpërmjet tyre, ta dobësojnë, ta diskriminojnë, ta marginalizojnë, apo ta zhbëjnë atë?

Për Gazetën TemA, datë 08/05/2016

<http://www.newsbomb.al/aktualitet/item/39843-kapja-e-perfaqesuesve-politike-te-minorititet-grek-dhe-identiteti-i-tij-etnik-i-rrezikuar>

<http://www.gazetatema.net/web/2016/05/08/kapja-e-perfaqesuesve-politike-te-minorititet-grek-dhe-identiteti-i-tij-etnik-i-rrezikuar/>

## **Η εξαγορά και ενοχοποίηση των εκπροσώπων της ελληνικής μειονότητας και η απειλούμενη εθνική της ταυτότητα Του Παναγιώτη Μπάρκα**

Πρόσφατα ο ηγέτης της σλαβομακεδονικής αντιπολίτευσης κατηγόρησε δημόσια (νόμιμα) σημαίνοντες αλβανούς πολιτικούς στην Πρώην Γιουγκοσλαβική Δημοκρατία της Μακεδονίας για συνεργασία με μυστικές και δημόσιες κρατικές δομές της γείτονος χώρας για ίδια πολιτικά και οικονομικά οφέλη.

Η κατηγορία αυτή αποτέλεσε το έναυσμα για την ανάλυση παρόμοιας χειραγώγησης διαχρονικά πολιτικών εκπροσώπων της εθνικής ελληνικής μειονότητας στην Αλβανία, αλλά εις βάρος των συμφερόντων της ίδιας μειονότητας. Για την επιβεβαίωση της εξαγοράς και ενοχοποίησης των ιθυνόντων της μειονότητας δε θα χρησιμοποιήσουμε τα ίδια μέσα (τηλ. υποκλοπές), αλλά διαφορετική προσέγγιση. Θα αντιπαραθέσουμε αφενός μεν την πραγματικότητα πολλαπλών διακρίσεων εις βάρος της εθνικής ελληνικής μειονότητας, τη δημογραφική αλλοίωσή της, τον οικονομικό αφανισμό ακόμα και στις περιοχές με συμπαγή πληθυσμό, τον περιορισμό και αποκλεισμό της εν λόγω μειονότητας από το πολιτικό και

οικονομικό ενδιαφέρον του κράτους και των διεθνών οργανισμών. Αφετέρου δε, τίθεται το θέμα της πολιτικής επιβίωσης των πολιτικών εκπροσώπων της εθνικής ελληνικής μειονότητας, όχι με τις δικές της ψήφους, αλλά ως «επιθυμία» των αλβανικών πολιτικών δομών, της ξέφρενης αύξησης των περιουσιακών τους στοιχείων, την καθήλωση με γεωμετρική πρόοδο των προσπαθειών τους για την προστασία των δικαιωμάτων της μειονότητας. Το γεγονός αυτό αποτελεί το πιο αδιάσειστο στοιχείο της εξαγοράς και της ενοχοποίησης αυτών των πολιτικών εκπροσώπων.

Τα παραδείγματα που ακολουθούν δεν αποδεικνύουν απλά την εν λόγω εξαγορά και χειραγώγηση, τις διαστάσεις και τη διάρκεια της, αλλά αποδεικνύουν και τους λόγους και τη σκοπιμότητά τους.

Ομάδα νέων της μειονότητας κατέχει έγγραφα που αποδεικνύουν ότι μόνο σε περιοχές με συμπαγή μειονοτικό πληθυσμό στους νομούς Αγίων Σαράντα και Δελβίνου με πλαστά έγγραφα, με στημένες δικαστικές αποφάσεις κατά παράβαση του νόμου, είτε με παρεμφερείς αποφάσεις άλλων κρατικών δομών, έχει αλλάξει η κυριότητα σε 220 χιλιάδες στρέμματα γης της εν λόγω κοινότητας. Με τους μηχανισμούς αυτούς οι παραπάνω εκτάσεις επέστρεψαν στους δήθεν πρώην ιδιοκτήτες, οι οποίοι δεν έχουν καμιά σχέση με την ελληνική μειονότητα. (Για τις 120 χιλιάδες στρέμματα υπάρχουν οι συγκεκριμένοι φάκελοι με τις νομικές παραβιάσεις και καταχρήσεις, ενώ για τις υπόλοιπες 100 χιλιάδες η διαδικασία συνεχίζεται.) Κοινωνικά, πολιτικά και ιστορικά το φαινόμενο αυτό πρέπει να θεωρηθεί ως νεοοθωμανοποίηση του χώρου της ελληνικής μειονότητας, επειδή τα έγγραφα, πλαστά ή μη, βάσει των οποίων γίνεται η αλλαγή κυριότητας των περιουσιών ανάγονται στην Οθωμανική Αυτοκρατορία. Γίνεται λόγος για διεκδικήσεις που ανάγονται τουλάχιστον μετά τον 16ο αιώνα, τότε που το ισλαμικό καθεστώς της αυτοκρατορίας υφάρπαξε δια της βίας τη γη των χριστιανών που δεν αλλαξοπιστούσαν για να ανταμείψει όσους εξισλαμιζόταν και ετίθεντο στην υπηρεσία της αυτοκρατορίας. Ο νεοοθωμανισμός εξελίσσεται αθόρυβα, με κοινωνική και θεσμική ανοχή σε ολόκληρη την Αλβανία, πλην όμως στην περίπτωση της ελληνικής μειονότητας το φαινόμενο σχετίζεται ουσιαστικά με τη διατήρηση της εθνικής της ταυτότητας. Τόσο το χειρότερο που τα στοιχεία αποδεικνύουν ότι δε γίνεται λόγος για άμεσους «κληρονόμους» ανά τους αιώνες (αδύνατο να συμβεί), αλλά για άτομα που σήμερα κατέχουν πολιτική εξουσία ή πολιτικό μέσο για κατάχρηση και παράβαση του νόμου.

Αφετέρου, διαπιστώνεται το συγκλονιστικό γεγονός πως το εν λόγω φαινόμενο παράνομης ιδιοποίησης περιουσιών της μειονότητας το ανέχτηκε και το ενθάρρυνε την περίοδο 1998-1999 ο νύν Πρόεδρος του ΚΕΑΔ και τότε Πρόεδρος της Ομόνοιας Βαγγέλης Ντούλες και οι διάδοχοί του όπως ο Β. Μπολάνος, φαινόμενο που συνεχίζεται έως και σήμερα. Ο Ντούλες υπονόμωσε τότε τη μαζική πολιτική διαμαρτυρία της εθνικής ελληνικής μειονότητας κατά του φαινομένου αυτού που πρωτοεμφανιζόταν. Η διαμαρτυρία απαιτούσε ουσιαστικά την αποτροπή της διαδικασίας νεοοθωμανοποίησης της εν λόγω μειονότητας, αλλά και ολόκληρης της χώρας.

Νομικά κανένας τίτλος ιδιοκτησίας αυτής της κατηγορίας δεν δύναται να νομιμοποιηθεί χωρίς την έγκριση των ιθυνόκων της τοπικής αυτοδιοίκησης. Οι ιθύνοντες της τοπικής αυτοδιοίκησης στις μειονοτικές περιοχές, ως επί το πλείστον εκπρόσωποι του ΚΕΑΔ και της Ομόνοιας, όχι μόνο δεν αντιστάθηκαν, όχι μόνο υπέγραψαν για τις ιδιοποιήσεις αυτές, αλλά σε ορισμένες υποθέσεις έγιναν ψευτομάρτυρες υπέρ των αρπακτικών αυτών.

Επίσης, για όσο διάστημα οι εν λόγω τοπικοί άρχοντες ασκούσαν ακόμα τα καθήκοντά τους, ουδείς εκ των δήθεν πρώην ιδιοκτητών δεν διεκδικούσε την πραγματική αναγνώριση της «περιουσίας». Αμέσως μετά τη λήξη της θητείας τους στην τοπική αυτοδιοίκηση, «οι πρώην ιδιοκτήτες» έσπευδαν να τοποθετήσουν πασσάλους στην «περιουσία» τους. Εξάλλου στη Λιβαδειά, στην Κουλουρίτσα, στο Κώσταρι, στο Ραντάτι και αλλού, γίνονται βίαιοι. Ζητούν από τους μειονοτικούς να εγκαταλείψουν και τα σπίτια τους, επειδή, κατά τους ισχυρισμούς τους, τα έχουν κτίσει στις «περιουσίες» τους. Στο Κώσταρι του Δελβίνου ορισμένα άτομα με την ανοχή των ηγετών της τοπικής αυτοδιοίκησης της μειονότητας και των κρατικών οργάνων, περιέφραξαν δια της βίας περισσότερα από 120 εκτάρια γη ιδιοκτησία της κοινότητας. Σήμερα απειλούν τους κατοίκους της κοινότητας με ποταπούς εκβιασμούς για να παραιτηθούν από το αίτημά τους για την αποκατάσταση του νόμου. Στο χωριό Ραντάτι Αργυροκάστρου, αυτοί οι τραμπούκοι-ιδιοκτήτες, ζητούν από τους ντόπιους Έλληνες Μειονοτικούς να τους δώσουν τις

γυναίκες τους, με αντάλλαγμα την άδεια να βοσκήσουν τα ζώα τους στα εδάφη τα οποία με νόμο είναι των Ελλήνων.

Για την εξαγορά και ενοχοποίηση των εκπροσώπων της μειονότητας μαρτυρεί και το γεγονός όπου πλέον των 20 ετών το ΚΕΑΔ συμμετέχει εναλλάξ στις κυβερνήσεις της χώρας, πλην όμως δεν προέβη σε καμιά ενέργεια για την αποτροπή των εν λόγω παράφορων παραβιάσεων εις βάρος της ελληνικής μειονότητας. Εξάλλου οι τοπικοί άρχοντες της μειονότητας, συναυτουργοί στη δημιουργηθείσα κατάσταση, θωπεύονται από την ηγεσία του κόμματος αυτού. Επίσης, η νέα ηγεσία της Ομόνοιας είναι προϊόν στήριξης των ιθυνόντων των επαρχιών και των δήμων της μειονότητας. Το γεγονός που και εκείνη δεν καταγγέλλει καμιά από τις κατασκευασμένες αποφάσεις των κρατικών οργάνων που αφορούν εκατοντάδες χιλιάδες στρέμματα γης μειονοτικών παράνομα ιδιοποιημένης, αλλά και κανέναν εκ των ηγετών αυτών, ενοχοποιεί επικίνδυνα και την Ομόνοια.

Την περίοδο που η Αλβανία επικύρωσε τη Σύμβαση Πλαίσιο της ΣΕ για την Προστασία των Μειονοτήτων (1999-2001) η οποία παρέχει ιδιαίτερο βάρος στις περιοχές με συμπαγή μειονοτικό πληθυσμό, η Ομόνοια και το ΚΕΑΔ, αποφάσισαν να παραιτηθούν από τις περιοχές με συμπαγή ελληνικό μειονοτικό πληθυσμό. Προέβησαν στην ενέργεια αυτή με πρόσχημα τη δήθεν νέα κατάσταση ατομικής προστασίας των δικαιωμάτων του ανθρώπου και όχι συλλογικά. (Το αντίθετο έπρεπε να συμβεί.) Ένα δεύτερο επιχείρημα του πολιτικού ηγέτη της μειονότητας για την απόφαση αυτή σχετίζεται με τη δημιουργία ευνοϊκού κλίματος για τα δικαιώματα των Χιμαραίων που αποδεχόταν την ελληνική εθνικότητα. Όμως, τι συνέβη στην πράξη; Η απόφαση αυτή άνοιξε το δρόμο πολιτογράφησης στις περιοχές με συμπαγή ελληνικό πληθυσμό περίπου χιλίων οικογενειών αλβανικής εθνικότητας. Οι πολιτογραφήσεις αυτές έγιναν συνειδητά από τους τοπικούς άρχοντες της εθνικής ελληνικής μειονότητας, γεγονός που, δεδομένου του φαινομένου μαζικής μετανάστευσης των μειονοτικών, αποτελεί επικίνδυνη δημογραφική αλλοίωση στις περιοχές αυτές. Το Αλύκο, το Βρυώνι, η Τσούκα, η Φοινίκη, το Μεσοπόταμο, η Λιβαδειά και άλλες κοινότητες έχουν αλλάξει εξ ολοκλήρου τη δημογραφική τους σύνθεση. Συν τοις άλλοις το φαινόμενο αυτό συνοδεύτηκε με την παροχή αδειών αγοράς γης και επενδύσεων σε αλβανούς επιχειρηματίες. (Το φαινόμενο είναι πιο έντονο στις πιο ζωτικές και συμπαγείς περιοχές της μειονότητας.) Επίσης, στις περιοχές αυτές, και προπάντων στη Χιμάρα, εφαρμόστηκε νέος μηχανισμός αλλοίωσης της κυριότητας των περιουσιών. Κατασκευάστηκαν αποφάσεις επιστροφής περιουσιών οι οποίες δήθεν ωφελούσαν τους Έλληνες μειονοτικούς. Στην πραγματικότητα οι περιουσίες (εκτάσεις γης) δίδονταν τυπικά σε Έλληνες μειονοτικούς υπό την προϋπόθεση στη συνέχεια να πωλούνταν (έναντι προκαθορισμένης τιμής) σε συγκεκριμένα άτομα αλβανικής εθνικότητας στενά συνδεδεμένα με ανώτερους πολιτικούς. Το σχήμα εφαρμοζόταν εν γνώσει και με τη βούληση των εκπροσώπων της μειονότητας. Στην καταγγελία του Πρωθυπουργού Έντι Ράμα στην οποία αναφέρεται ότι έχουν ιδιοποιηθεί παράνομα 50 χιλιάδες εκτάρια γη στην περιοχή του Μπρεγκντέτ (παραλίας Ιονίου, Χιμάρας-Αγίων Σαράντα) από την Κυβέρνηση Μπερίσα, αναφέρεται και στο μηχανισμό αυτό.

Τον ίδιο σκοπό εξυπηρετούσε και η επιλεκτική κατεδάφιση (βάσει εθνικής και πολιτικής ταυτότητας) αυθαιρέτων στην περιοχή της Χιμάρας. Και όμως ουδεμία σοβαρή αντίδραση υπήρξε από την πολιτική ηγεσία της ελληνικής μειονότητας, όπως συμβαίνει και σήμερα με την απαλλοτρίωση κατά παράβαση του νόμου στους Δρυμάδες εις βάρος 120 κατοίκων.

Οι πολιτικοί της ελληνικής μειονότητας δεν αντιδρούν ούτε για την ενεργειακή κατάσταση στις περιοχές της μειονότητας. Οι Έλληνες μειονοτικοί είναι οι πιο συνεπείς πληρωτές ηλεκτρικής ενέργειας, και όμως έχουν το χειρότερο δυνατό δίκτυο παροχής ηλεκτροδότησης στη χώρα. (Βυθίζονται στο σκοτάδι ειδικά κατά τη διάρκεια εορτών.) Δεν αντιδρούν ούτε για το γεγονός όπου οι μειονοτικοί επιχειρηματίες λειτουργούν σε συνθήκες αθέμιτου ανταγωνισμού, επειδή απ' εκείνους απαιτείται απόλυτη συνέπεια έναντι των υποχρεώσεων προς το δημόσιο, ενώ επιχειρηματίες του ίδιου κλάδου σε άλλες περιοχές σχεδόν δεν καταβάλλουν τις υποχρεώσεις τους προς το δημόσιο. Δεν αντιδρούν ούτε κατά του φαινομένου όπου οι μειονοτικοί αποτελούν συχνά αντικείμενο επιβολής πάσης φύσεως προστίμων, επειδή μόνο εκείνοι τα καταβάλλουν. Ο κρατικός προϋπολογισμός προβλέπει πενιχρά κονδύλια για τους δήμους της μειονότητας και μηδενικές επιδοτήσεις για την οικονομική τους ευρωστία. Και όμως ξανά δεν υπάρχει καμιά πολιτική αντίδραση από τους εκπροσώπους της εν λόγω μειονότητας.



Λοιπόν, η εξαγορά και ενοχοποίηση των εκπροσώπων της εθνικής ελληνικής μειονότητας από διάφορες κρατικές δομές ή άλλες δομές που παραβιάζουν το νόμο είναι υπαρκτή. Στη μειονότητα ψιθυρίζεται με νόημα πως η ζημιά που προκάλεσαν στη μειονότητα οι πολιτικοί της εκπρόσωποι όσον αφορά την εθνική ταυτότητα ξεπερνάει κατά πολύ και τους πολέμιους αυτής αλλά και τους ένθερμους Αλβανούς εθνικιστές. Στο σημείο αυτό τίθενται και κάποια άλλα ουσιώδη ερωτήματα (ρητορικά). Γιατί οι συγκεκριμένες κρατικές δομές τηρούν τη στάση αυτή έναντι της ελληνικής εθνικής μειονότητας; Γιατί ζητούν, έστω και σε συνεργασία με τους πολιτικούς της εκπροσώπους, ή μέσω αυτών, να την εξασθενίσουν, να τη διαβάλλουν, να την περιθωριοποιήσουν ή να την αλλοιώσουν;

## **Nga Prof. asoc. Panajot Barka.**

<https://www.newsbomb.al/kotzias-ne-tirane-i-bindur-se-per-marredheniet-dypaleshe-s-ka-kthim-prapa-42404>

<http://www.respublica.al/2016/06/04/mbi-vizit%C3%ABn-pritshme-t%C3%AB-ministrit-t%C3%AB-jasht%C3%ABm-grek-n%C3%AB-tiran%C3%AB>

### **N. Kotzias në Tiranë i bindur se për marrëdhëniet dypalëshe nuk ka kthim prapa.**

04.06.2016

Ministri i Jashtëm i Greqisë Nikos Kotzias vjen të henën në Tiranë. Është vizita e dytë e tij në Shqipëri në harkun kohor të 11 muajve dhe në përgjigje të shpejtë të vizitës së Ministrit të Jashtëm të Shqipërisë në Greqi D. Bushati, në mars të këtij viti. Përpos tyre, dy ministrat kanë takime të shpeshta në veprimtari ndërkombëtare. Kjo denduri takimesh lidhet me vlerësimin e rendësisë dhe perspektivës së marrëdhënieve të mira mes dy vendeve. Vetëm kështu mund të interpretohet “nxitimi” i Kotzias për kthimin e vizitës së Bushatit në Athinë. Por nga ana tjetër, në më pak se tre muaj nuk është se u gjeten “mekanizmat për zgjidhjen e problemeve” siç u shprehen të dy ministrat në Athinë. Më shumë përvijohet fakti i qëndrimeve aspak konverguese nga politikat e të dy vendeve për sa u përket faktorëve përcaktuese të perspektivës së marrëdhënieve dypalëshe.

Ministri Kotzias me slloganin e kësaj vizite “Marrëdhëniet e Greqisë me Shqipërinë dhe e ardhmja e evropiane e rajonit” e ka përcaktuar shumë qartë konceptin grek të perspektivës së marrëdhënieve greko-shqiptare. Për palën greke ato duhet të zhvillohen në frymën evropiane të ridimensionimit të marrëdhënieve të saj me vendet e rajonit. Ndërsa për homologun e tij shqiptar koncepti i së ardhmës së tyre duket se stacionohet te dialektika me të shkuarën.

Një politikë e tillë nga njera anë neutralizon këmbënguljen e palës greke për një frymë evropiane në marrëdhëniet midis dy vendeve dhe popujve tanë, pa patur me vete dhe vullnetin e palës shqiptare. Nga ana tjetër i heq Greqisë të drejtën e tolerimit historik në emër të fqinjësisë së mirë, fakt që vërteton si historia 45-vjeçare e rivendosjes së marrëdhënieve greko-shqiptare, ashtu edhe historia më e gjatë e marrëdhënieve midis dy popujve, vendeve dhe shteteve tona. Për palën greke konstandja që i pershkon këto marrëdhënie është këmbëngulja e vazhdueshme në sens pozitiv për marrëdhënie vëllazërie, miqësie e bashkëpunimi. Por rezultandja e kësaj rruge tregon se çdo herë që midis popujve tanë arrihej afrimi i natyrshëm dhe marrëdhëniet e partneriteti vëlazëror, interesat e të treteve i çonin ato në zgrip. Ndodhte kështu se këto interesa realizoheshin më mirë nëse pengohej afrimi shqiptaro-grek. Po ashtu, është e vërtetë se historikisht, pala që merr iniciativën për të ringritur marrëdhëniet midis dy vendeve në nivele dhe realitete adekuate me zhvillimet historike, është ajo greke dhe parimi nga i cili udhëhiqet në to është parimi i sotëm evropian. Mënjanimin e momenteve të këqia të së shkuarës, (që në historinë e përbashkët janë të pakta dhe të parendësishme) dhe adresimin e të ardhmës në ato pika që historia dhe perspektiva na bashkon dhe janë të shumta. (Para disa ditësh, Franca dhe Gjermania, nëpërmjet figurave më të larta shtetërore, Merkel e Holland, përkujtuan 100 vjetorin e betejës së Verdenit, ku u vranë 300 mijë ushtarë nga të dy palët. Më këtë rast inaguruan dhe nderuan një varrezë të përbashkët me po aq kryqe, si shenjë forcimi të miqësisë frankogjermane. Turqia ka vite që varrezat e përbashkëta të saj me ato të ushtarëve armiq, i ka kthyer në vend kurioziteti historik për miliona turistë të botës).

Fakt karakteristik përbën momenti historik i rivendosjes së marrëdhënieve midis dy vendeve në majin e largët të 1971. Qeveria e gjeneraleve në Greqi që iniciatorja për këtë hap edhe pse në thelb i papajtueshëm për një juntë ushtarake. (Kishte

ndodhur edhe me Diktatorin Pangallos në vitet 1926-30) I parapriu këtij veprimi deklarata e Greqisë në OKB, sipas të cilës Greqia parashkruante realitetin e marrëdhënieve midis dy vendeve të krijuar në konferencën e Paqës me 1946. Në emër të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë Greqia anashkalonte edhe realitetin e zymtë të minoritetit të saj në Shqipëri. Propaganda e shtetit të atëhershëm shqiptar, e konsideroi këtë hap të Greqisë si dobësi saj dhe si vërtetim të tezave të Tiranës.

Me 1985, Karollos Papulias, i cili do të evidentohet në vijim si arkitekt i marrëdhënieve të mira midis dy vendeve, mori iniciativën për hapjen e portës së ndryshkur prej 40 vjetesh të Kakavisë. 12 vjet më vonë, 1996, kur marrëdhëniet greko-shqiptare ishin futur në zgripin e rendë të radhës, Papulias dhe Stefanopullos bënë hapin e radhës duke i kulmuar juridikisht marrëdhëniet midis dy vendeve me nënshkrimin në Tiranë të Traktatit të Miqësisë dhe Bashkëpunimit.

Nga pala shqiptare mbetet karakteristikë fakti që në kujtesën e saj aktive në lidhje me historinë e marrëdhënieve të saj me Greqinë, mbëten momentet e pakta negative, negativitetin e të cilave e zhvlerëson vet historia. Edhe pse të shtrira në kohën e gjatë historike, ato mbledhen për efekt të çdo momenti të së tashmës aktuale politike dhe përdorën si për të eklipsuar momentet dhe zhvillimet e shumta që na bashkojnë, ashtu edhe për të penguar marrëdhëniet tona të fqinjësisë së mirë dhe në frymë evropiane të së ardhmës. Aq më keq kur për t'i aktualizuar këto momente të parendësishme negative dhe për t'i kthyer në shërbim të politikës aktive shtetërore, nuk u referohet qëndrimeve zyrtare të shtetit grek, por faktorëve të dorës së dytë dhe të tretë jashtë politikës zyrtare greke. Injektohen me mjete të ndryshme në opinionin publik dhe pastaj politika zyrtare u referohet si vullnet politik popullor. Nga ana tjetër, çdo përpjekje që bën Greqia dhe çdo iniciativë që merr Athina si vijim të qëndrimeve të veta konstante për politikën të fqinjësisë së mirë, konsiderohen si dobësi të shtetit grek, ose si vërtetim të pretendimeve të mësipërme të palës shqiptare.

Gjatë gjithë periudhës së tranzicionit të stërgjatur shqiptar dhe pavarësisht uljengritjeve të marrëdhënieve dypalëshe, Greqia ruajti një konstante në ngritje pozitive në qëndrimet e saj ndaj Shqipërisë. Është partneri parësor i Shqipërisë në kontribute ekonomike, investuese, tregtare, shoqërore e kulturore. Por, parësor mbetet sidomos kontributi i Athinës për anëtarësimin e Shqipërisë në struktura dhe në organizma euroatlandike, (OSBE, KiE, NATO, inicim dhe institucionalizim të procesit për anëtarësimin në BE etj), në një kohë që nga ana e vet Shqipëria ka pothuaj një bilanc nul në kontributet e saj në marrëdhëniet me Greqinë.

Reflektimin historik e bënë më evident në vizitën e pritshme të zotit Kotzias fakti se gjendemi para momentit kohor që argumenti juridik i marrëdhënieve “shumë të mira”, Traktati i Miqësisë, duhet juridikisht dhe praktikisht rinovuar. Ministri i Jashtëm Grek, pavarësisht se nuk e deklaroi këtë qëllim e nënkuptoi atë në formulimin e ri të marrëdhënieve dypalëshe, -si realitet për evropianizimin e rajonit, projektuar kjo në një paketë komplekse për zgjidhjen fillimisht të problemeve midis dy vendeve. Por në misionin e tij duket se Kotzias do të has edhe në vështirësi të tjera. Vitet e fundit pala shqiptare ka bilancin më negativ në respektimin e marrëveshjeve midis dy vendeve. (Ajo e kufirit detar, e varrëzave të ushtarëve grekë renë në luftën kundër pushtuesve fashistë, funksionimi i komisionit të përbashkët për përmbajtjen e teksteve shkollore etj). Një fakt i tillë nuk mund të tolerohet nga opinioni publik e politik grek. Fryma nacionaliste kundër Greqisë në vend po bëhet pjesë e politikës zyrtare.

Nga ana tjetër ndërsa pala greke vjen me shqetësimin që këtë rrugë të ngushtuar të marrëdhënieve dypalëshe ta kthejë në një hapësirë bashkëpunimi me frymë Evropiane, të mishëruar në vazhdimësinë e Traktatit të Miqësisë, duket se pala shqiptare është e interesuar t'u jap këtyre marrëdhënieve një gravitet të kundërt.

Moment ristartimi i këtyre marrëdhënieve për vet ministrin Bushati është abrogimi i ligjit inegzistent të luftës të 1940. Për këtë flet fakti që vetëm disa ditë para vizitës së homologut të tij grek, D. Bushati shprehej në një television të madhë të vendit me gjuhën e një analisti të kohës së monizmit, se “Nëse flasin për shfuqizimin e ligjit të luftës nga ana e Greqisë, ka lidhje me rishikimin e teksteve të historisë, ka lidhje me çështjen e pronave të shtetasve shqiptarë dhe shtetit shqiptar në Greqi. Ka lidhje gjithashtu me nderimin për të rënë grekë në territorin shqiptar, sepse duhet që të përfundojë lufta, në mënyrë që të fillojnë të gjitha proceset e tjera. Shfuqizimi ka vlera të drejtpërdrejta politike dhe ligjore, apo adresimi i çështjes çame, ...”, deklaroi ministri Bushati.

Dhe kjo kur dihet se, po t’i referohemi logjikës së pretendimit të mësipërm, shteti që i shpalli i pari luftë Greqisë nuk e ka abroguar juridikisht këtë ligj, por fshihet pas argumentit aspak juridik, që votuesit e tij nuk ishin përfaqësues legjitim të popullit shqiptar !. Mëgjithatë, Kotzias vjen në Tiranë i bindur se nuk ka hapësirë për kthim prapa dhe se ky qëndrim është në të mirën e të dy vendeve, por në radhë të parë në të mirën e Shqipërisë. **FUND** Për gazetn TemA, 04/06/2016

Άρθρο του Παναγιώτη Μπάγκα

Δημοσιευμένο στην αλβανική εφημερίδα TEMA και στην ιστοσελίδα NEWSBOMB.AI

### **Ο Κοτζιάς στα Τίρανα, πεπεισμένος πως στις διμερείς σχέσεις δεν υπάρχει παλινδρόμηση**

Ο Υπουργός Εξωτερικών της Ελλάδας Νίκος Κοτζιάς τη Δευτέρα επισκέπτεται τα Τίρανα. Είναι η δεύτερη επίσκεψή του στην Αλβανία τους τελευταίους 11 μήνες και σε εспеυσμένη ως ανταπόδοση της επίσκεψης του Υπουργού Εξωτερικών της Αλβανίας στην Ελλάδα Ντιμίρ Μπουσάτι το Μάρτιο του τρέχοντος έτους. Πέραν τούτου οι δύο υπουργοί συναντιούνται συχνά σε διεθνείς δραστηριότητες. Οι συχνές συναντήσεις τους συνδέονται με τη σημασία και την προοπτική των καλών σχέσεων μεταξύ των δύο χωρών. Μόνο σ’ αυτό το πλαίσιο δύναται να ερμηνευτεί η «βιασύνη» του Κοτζιά για την ανταπόδοση της επίσκεψης που πραγματοποίησε ο Μπουσάτι στην Αθήνα. Όμως σε χρονικό διάστημα μικρότερο των τριών μηνών δεν έχουν βρεθεί «τα μέσα για τη λύση των προβλημάτων» όπως ανέφεραν οι δύο υπουργοί στην Αθήνα. Περισσότερο διαπιστώνεται η μη συγκλίνουσα συμπεριφορά των πολιτικών των δύο χωρών σχετικά με τους καθοριστικούς παράγοντες της προοπτικής των διμερών σχέσεων.

Ο Υπουργός Κοτζιάς με το σλόγκαν της εν λόγω επίσκεψης «Οι σχέσεις της Ελλάδας με την Αλβανία και το ευρωπαϊκό μέλλον της περιοχής» έχει καθορίσει σαφώς την ελληνική αντίληψη σχετικά με την προοπτική των ελληνοαλβανικών σχέσεων. Για την ελληνική πλευρά οι σχέσεις αυτές πρέπει να αναπτυχτούν σύμφωνα με τον επαναπροσδιορισμό των σχέσεών της με τις χώρες της περιοχής και στο Ευρωπαϊκό Πνεύμα. Ενώ για τον Αλβανό ομολόγό του η αντίληψη για το μέλλον των σχέσεων αυτών εστιάζεται στη διαλεκτική του παρελθόντος.

Μια τέτοια πολιτική, αφενός μεν, αδρανοποιεί την επιμονή της ελληνικής πλευράς για ευρωπαϊκή πνοή στις σχέσεις μεταξύ των δύο χωρών και λαών μας, χωρίς να έχει σύμμαχο τη βούληση της αλβανικής πλευράς. Αφετέρου δε, στερεί από την Ελλάδα το δικαίωμα της ιστορικής ανεκτικότητας εν ονόματι της καλής γειτονίας, γεγονός που επιβεβαιώνεται τόσο κατά την 45-χρονη περίοδο της αποκατάστασης των

ελληνοαλβανικών σχέσεων, όσο και από τη μακράιωνη ιστορία των σχέσεων μεταξύ των δύο λαών, χωρών και κρατών. Για την ελληνική πλευρά η συνισταμένη των εν λόγω σχέσεων είναι η συνεχής επιμονή με θετικό προσανατολισμό για σχέσεις αδερφικές, φιλικές και πνεύμα συνεργασίας.

Όμως η συνισταμένη της οδού αυτής μαρτυρεί πως κάθε φορά που μεταξύ των δύο φίλων λαών μας έχει επιτευχθεί φυσιολογική προσέγγιση και αδερφική εταιρικότητα στις σχέσεις, συμφέροντα τρίτων τις οδηγούσαν στο γκρεμό. Συνέβαινε αυτό επειδή τα συμφέροντά τους εκπληρωνόταν καλύτερα με την παρακώλυση της αλβανοελληνικής προσέγγισης.

Ιστορικά εκείνη που αναλαμβάνει την πρωτοβουλία για την ανύψωση των σχέσεων σε επίπεδο και πνεύμα συμβατό με τις ιστορικές εξελίξεις είναι η ελληνική πλευρά, ενώ η αρχή στην οποία βασίζεται είναι η σύγχρονη ευρωπαϊκή ιδέα. Στόχος είναι η αποφυγή των δυσάρεστων στιγμών του παρελθόντος (στην κοινή ιστορία είναι ελάχιστες και ασήμαντες) και ο προσανατολισμός στο μέλλον σε σημεία όπου η ιστορία και η προοπτική μας ενώνουν και είναι πολλά. (Προ λίγων ημερών η Γαλλία και η Γερμανία δια των ύψιστων κρατικών εκπροσώπων τους, Μέρκελ και Ολλάντ, μνημόνευσαν τα 100 χρόνια από τη μάχη του Βέρντεν, όπου σκοτώθηκαν εκατέρωθεν 300 χιλιάδες στρατιώτες. Επί της ευκαιρίας εγκαινίασαν και υποκλίθηκαν σε έναν κοινό τάφο με ισάριθμους σταυρούς ως νεύμα σύσφιξης των γαλλογερμανικών σχέσεων. Η Τουρκία προ πολλού τους κοινούς τάφους με εκείνους των εχθρικών στρατευμάτων τους έχει μετατρέψει σε επισκέψιμο ιστορικό χώρο για εκατομμύρια τουρίστες της οικουμένης.) Χαρακτηριστικό παράδειγμα αποτελεί η ιστορική στιγμή της αποκατάστασης των σχέσεων μεταξύ των δύο χωρών εκείνον τον μακρινό Μάιο του 1971. Η Κυβέρνηση των Συνταγματαρχών στην Ελλάδα έλαβε την πρωτοβουλία για την εξέλιξη αυτή, κίνηση ουσιαστικά μη συμβατή με στρατιωτική χούντα. (Είχε συμβεί και με τον δικτάτορα Πάγκαλο την περίοδο 1926-1930.) Προπομπός της κίνησης αυτής ήταν η δήλωση της Ελλάδας στον ΟΗΕ πως οι σχέσεις μεταξύ των δύο χωρών θα εξελίσσονταν παραμερίζοντας την πραγματικότητα της Συνδιάσκεψης της Ειρήνης του 1946. Στο όνομα των σχέσεων της καλής γειτονίας η Ελλάδα προσπερνούσε ακόμα και την άθλια κατάσταση της ελληνικής μειονότητας στην Αλβανία. Η προπαγάνδα του τότε αλβανικού κράτους θεώρησε το βήμα αυτό της Ελλάδας ως αδυναμία της και ως επιβεβαίωση των θέσεων των Τιράνων.

Το 1985 ο Κάρολος Παπούλιας, ο οποίος στη συνέχεια θα αναχθεί ως ο αρχιτέκτονας των καλών σχέσεων μεταξύ των δύο χωρών, ανέλαβε την πρωτοβουλία να ανοίξει την επί 40 χρόνια σκουριασμένη πόρτα της Κακαβιάς. 12 χρόνια αργότερα, το έτος 1996, όπου οι ελληνοαλβανικές σχέσεις είχαν εισέλθει σε νέο ναυάγιο, ο Παπούλιας και ο Στεφανόπουλος προέβησαν σε νέα πρωτοβουλία απογειώνοντας νομικά τις σχέσεις μεταξύ των δύο χωρών με την υπογραφή στα Τίρανα του Συμφώνου Φιλίας και Συνεργασίας.

Για την αλβανική πλευρά είναι χαρακτηριστικό το γεγονός ότι στην ενεργό μνήμη της σχετικά με το ιστορικό των σχέσεών της με την Ελλάδα μένουν οι λίγες αρνητικές στιγμές, την αρνητικότητα των οποίων απαξιώνει η ίδια η ιστορία. Μολονότι διάσπαρτες ιστορικά, η αλβανική πλευρά τις επικαλείται κάθε φορά για την πρόσκαιρη άσκηση της πολιτικής της, για τη συσκότιση των σημείων και των εξελίξεων που μας ενώνουν, καθώς επίσης για την παρεμπόδιση των σχέσεων καλής γειτονίας με ευρωπαϊκό προσανατολισμό. Χειρότερο όλων είναι πως, για να φέρει στο προσκήνιο αυτές τις ασήμαντες αρνητικές στιγμές και να τις θέσει στην υπηρεσία της ενεργής κρατικής πολιτικής, δεν αναφέρεται στην επίσημη στάση του ελληνικού κράτους, αλλά σε δευτερεύοντες και τριτεύοντες παράγοντες άσχετους με την επίσημη ελληνική πολιτική. Διαχέονται με διάφορα μέσα στην κοινή γνώμη και στη συνέχεια η επίσημη

πολιτική αναφέρεται σ' αυτή ως πολιτική βούληση του λαού. Από την άλλη πλευρά, οποιαδήποτε προσπάθεια της Ελλάδας και πρωτοβουλία της Αθήνας ως συνέχεια της σταθερής πολιτικής της καλής γειτονίας, εκλαμβάνονται ως αδυναμία του ελληνικού κράτους ή ως επιβεβαίωση των ως άνω ισχυρισμών της αλβανικής πλευράς.

Καθ' όλη τη διάρκεια της παρατεταμένης αλβανικής μεταβατικής περιόδου και παρά των διακυμάνσεων των διμερών σχέσεων η Ελλάδα τήρησε θετική, σταθερή ανοδική πορεία στις στάσεις της έναντι της Αλβανίας. Είναι ο βασικός εταίρος της Αλβανίας στον οικονομικό, επενδυτικό, εμπορικό, κοινωνικό και πολιτιστικό τομέα. Ενώ η συνδρομή της Αθήνας για την ένταξη της Αλβανίας στους ευρωπαϊκούς οργανισμούς (ΟΑΣΕ, ΣτΕ, ΝΑΤΟ, στήριξη της υποψηφιότητας χώρας προς ένταξη στην ΕΕ κ.ά.) ήταν καθοριστική, η προσφορά της Αλβανίας στις σχέσεις με την Ελλάδα είναι μηδέν.

Είναι ιστορική η στιγμή ώστε με την επικείμενη επίσκεψη του κυρίου Κοτζιά το Σύμφωνο Φιλίας να ανανεωθεί νομικά και πρακτικά. Ο Έλληνας Υπουργός των Εξωτερικών ανεξάρτητα που δεν αναφέρεται σ' αυτό το υπονοεί δια της νέας διατύπωσης των διμερών σχέσεων – ως πραγματικότητα για τον ευρωπαϊκό προσανατολισμό της περιοχής – όραμα που εντάσσεται σε ένα συνολικό σχέδιο που αρχίζει με τη λύση των προβλημάτων μεταξύ των δύο χωρών.

Όμως στην αποστολή του ο Κοτζιάς θα αντιμετωπίσει και άλλες δυσκολίες. Τα τελευταία χρόνια η αλβανική πλευρά έχει τον πιο αρνητικό απολογισμό στην τήρηση των διμερών συμφωνιών. (θαλασσίων συνόρων, κοιμητήρια των ελλήνων φαντάρων που έπεσαν πολεμώντας κατά των φασιστών κατακτητών, λειτουργία της μεικτής επιτροπής για το περιεχόμενο των σχολικών βιβλίων κ.ά.). Τα γεγονότα αυτά είναι αδύνατο να γίνουν ανεκτά από την ελληνική κοινή γνώμη και πολιτική. Οι εθνικιστικές εξάρσεις κατά της Ελλάδας στη χώρα καθίστανται μέρος της επίσημης πολιτικής.

Ενώ η ελληνική πλευρά επισκέπτεται τη χώρα προσβλέποντας τη στενωπό των διμερών σχέσεων να την μετατρέψει σε λεωφόρο συνεργασίας ευρωπαϊκού προσανατολισμού και ως συνέχεια του Συμφώνου Φιλίας, η αλβανική πλευρά φαίνεται πως ενδιαφέρεται να δώσει στις σχέσεις αυτές αντίθετη κατεύθυνση. Σημείο εκκίνησης των εν λόγω σχέσεων για τον ίδιο τον υπουργό Μπουσάτι είναι η κατάργηση του ανύπαρκτου νόμου της εμπόλεμης κατάστασης του '40. Μόνο λίγες μέρες πριν την επίσκεψη του Έλληνα ομολόγου του ο Ντιμίρ Μπουσάτι μιλούσε σε μεγάλο τηλεοπτικό σταθμό της χώρας, επικαλούμενος τις θέσεις αναλυτή του ολοκληρωτικού καθεστώτος, δηλώνοντας πως *«όταν μιλούμε για κατάργηση του νόμου της εμπόλεμης κατάστασης από την Ελλάδα, αυτό σχετίζεται με την αναθεώρηση των βιβλίων της ιστορίας, σχετίζεται με τις περιουσίες αλβανών υπηκόων και του αλβανικού κράτους στην Ελλάδα. Σχετίζεται επίσης με την τιμή προς τους Έλληνες πεσόντες στην Αλβανική Επικράτεια, γι' αυτό πρέπει να λήξει ο πόλεμος για να αρχίσουν όλες οι άλλες διαδικασίες. Η κατάργηση έχει άμεση πολιτική και νομική σημασία ή η δρομολόγηση του τσάμικου ...»*, δήλωσε ο υπουργός Μπουσάτι.

Και όλα αυτά δηλώνονται ενώ είναι γνωστό πως το κράτος που κήρυξε πρώτο τον πόλεμο στην Ελλάδα δεν έχει καταργήσει νόμιμα το νόμο αυτό, αλλά κρύβεται πίσω από το μη νομικό επιχείρημα ότι *«εκείνοι που ψήφισαν το νόμο αυτό δεν ήταν νόμιμοι εκπρόσωποι του αλβανικού λαού!»*.

Και όμως ο Κοτζιάς έρχεται στα Τίρανα πεπεισμένος πως δεν υπάρχουν περιθώρια για παλινδρόμηση και η στάση αυτή είναι προς όφελος των δύο χωρών, αλλά πρωτίστως προς όφελος της Αλβανίας. Παναγιώτης Μπάρκας

## **Nga Panajot Barka**

<https://www.newsbomb.al/kongresi-i-pbdnj-se-qe-te-perfitoje-politikisht-vetem-dule-45556>

### **Kongresi i PBDNj-së, që të përfitojë politikisht vetëm Dule.**

04.07.2016

Më 2 korrik, kryetari prej 13 vjetesh i PBDNj-së Vangjel Dule, thirri në Tiranë kongresin e partisë së tij. Në aparençë dhe nga menyra si u përcollë në publik, kongresi përbën një ngjarje rutinore politike të një partie me një fushë veprimi me shumë rendësi siç janë të drejtat e njeriut, por me aksione të rëna. Në thelb kongresi i PBDNj-së përbën një tregues shqetësues i realiteve të brendshme në këtë parti, por, edhe i relatave ndërpartiake në rrethanat aktuale politike në vend, edhe të raporteve të kësaj partie dhe të shtetit me minoritetin etnik grek, edhe të marrëdhënieve Shqipëri- Greqi sidomos pas vizites së fundit të ministrit të jashtëm Grek në Tiranë, Nikos Kotzias etj.

Kongresi u thirr me nxitim nga kryetari i vet Dule. U thirr si kongres programor, por qëllimi imediat dhe i pashpallur i tij ishte rikonfirmimi i Dulës në krye të Partisë së vet për një mandat të paparashikuar në statut. Ky fakt provokon me të drejtë një shqetësim serioz. Nuk mundet që kryetari i një partie me mision politik mbrojtjen e të drejtave të njeriut të kthehet në kampion i shkëlqës së parimeve demokratike në funksionimin e vet kësaj Partie. Mbledh kongresin. Nga programor të deklaruar, e kthen në zgjedhor personalisht të dëshiruar. Delegatët që u ftuan të votojnë nuk ishin të paktën produkt i zgjedhjeve në bazë që përbën “alfen” e demokracisë së brendshme. Ishin miq e shokë të mbetur në rradhët e partisë së personalizuar të Dulës. Ndryshon me ta statutin e partisë për të fituar të drejtën e rizgjedhjes kryetar dhe sa hap e mbyll sytë ai rizgjidhet pa asnjë kandidat rival. Pranon publikisht se e gjithë përgjegjësia për tkurrjen e Partisë është personalisht e tija. Por me një propagandë gebeliste, i fton ata që zoi të kthehen “në shtëpinë e tij”, kur ai e ka rizenë me formën më antidemokratike kreun e partisë.

Kongresi i Dules, pavaresisht deklaratave të bëra, se në drejtim të respektimit të të drejtave të minoritetit etnik grek janë bërë hapa prapa, asnjë gjë konkrete nuk denoncoi. Ai doli në pozitë e njohura se “qeveria duhet të bëjë ligje dhe të marrë masa për respektimin e të drejtave të minoritetit”. Ndërkohë që harroi se për 15 vjet ishte në qeverisje, ai kujtohet për minoritetin dhe të drejtat e tij sa herë i duhet të forcojë pozitë dhe përfitimet e veta politike. Edhe në këtë kongres, Dule, në emër të minoritetit, mori rolin e viktimës. Në fund kongresi i tij i mbylli punimet pa asnjë dokument, notë proteste, rezolutë kongresi për të drejtat e minoritetit etnik grek, të minoriteteve të tjera në vend apo të të drejtave të njeriut në përgjithësi. Në këtë kuadër mbetet pa përgjigje pyetja që i shtrohet vazhdimisht Dulës. Cilën çështje të minoritetit grek ka marrë në mbrojtje ai dhe partia e tij. Për cilën çështje të këtij minoriteti ai kishte një platformë, një propozim, një zgjidhje?! Përse ai është krenar që është minoritar kur në katër mandate deputet nuk u votua nga ky minoritet?!

Eshtë e vërtetë se Kongresi i Dulës i thirr kur problemet e minoritetit në terrësi dhe anërrëve të tij me drejtesinë, qeverinë, apo privatët u shpeshuan së fundmi, madje në çështje fontamentale. P.sh Dule thirri Kongresin kur në Himarë, bastioni i patriotizmit të Dulës që kur erdhi në krye të PBDNj, ndodhën incidente të rënda. Dule në kongres nuk u prononcua, por u fsheh pas gishtit, ose pas ligjerimit të paadresuar.

Por, vërtet çfarë po ndodh në Himarë? Kush janë ata trimosha dhe në emër të kujt kanë dalë për të ndaluar të flitet greqisht në Himarë? Pa tjetër që me këtë ngjarje vendoset një lidhje me deklaratën e Ministrisë tonë të Jashtme se nuk ka minoritet grek në Himarë. Megjithatë Dule nuk dënjon as t’u kujtojë se çështja e ndërjegjës kombëtare është çështje vetëdeklarimit personal dhe jo çështje vendimi apriori e shtetit, e përfaqësuesve të tij apo veglave të tij. Nëse ka apo jo minoritet etnik grek në Himarë,

apo anëtarë të tij, duhen pyetur vetë himariotët në kushte normale, pa ndikime, pa presione. Të flasësh në emër të tyre, aq më tepër kundër vullnetit të tyre dhe për një çeshtje kaq madhore, kjo është shkelje e rendë e kushtetutës dhe e akteve ndërkombëtare që mbrojnë lirinë e shprehjës dhe të vetdeklarimit të identitetit.

Së dyti, Dule nuk guxon të thotë se kush i autorizoi këta pesona që t'i ndalojnë Himariotët të kërkojnë të drejtat e tyre pronësore? Kryeministri i vendit na zbuloi para do kohësh se me makinacione nga më të ndryshme u grabiten në Himarë dhe në gjithë Bregdetin nga 15 -50 mijë hektarë tokë me të cilën fle deti. U grabiten nga njerez që deri sa u bënë pronarë të kësaj toke nuk e kishin parë detin me sy. (Himarën në atë kohë e drejtonte krahu i djathtë i Dules). Por sot Himariotet janë prapë në këmbë në mbrojtje të të drejtave të tyre pronësore. Akuzojnë qeverinë dhe kreun e ri të Bashkisë. Por nuk kanë me vete as Dulën e as strukturat e tij. Kjo për faktin se zyrtarisht nuk është parë asnjë qëndrim politik, asnjë denoncim ndaj qeverisë, në strukturat përgjegjëse apo në organizma ndërkombëtare. Në këto rrethana, të furnizosh me lajme Ministrinë e Jashtme Greke për të bërë ajo deklarata shtypi, kjo e ka emrin hipokrizi dhe deheroizëm. Ky qëndrim i Dulës i jep të drejtë qëndrimit kolektiv në Shqipëri se minoriteti grek i gëzon të gjitha të drejtat deri në diskriminim pozitiv. Lëjon mbështetësit e këtyre qëndrimeve të bëjnë sikur harrojnë faktin se Greqia ka tanimë në Shqipëri edhe anëtarë të minoritetit etnik grek, edhe nënshtetas grek, gjë që askush nuk mund t'i mohojë të drejtën e mbrojtjes së interesave të tyre në Shqipëri, dhe se ky fakt kursesi nuk përbën ndërhyrje në punë të brendshme.

Nga ana tjetër, kryetari i Bashkisë së Himarës ka versionin e tij mbrojtës. Perse Dule dhe strukturat e e tij nuk ulën me të për të biseduar, por i kanë shpallur apriori luftë. Eshte vërtetuar se kurdoherë që është ulur me kryetarin e bashkisë Himarë, është gjetur dhe zgjidhja e duhur. Ndoshta edhe ai ndodhet nën presionin qeveritar, apo dhe të strukturave të tjera. Por perse nuk i ofrohet mbështetje politike atij, por i shpallet luftë?! Mos vallë edhe në këtë rast Dulës i shkon përshtat egzistenca e problemeve dhe jo zgjidhja e tyre? Mos vallë kjo është një mënyrë për të mbuluar ato vrima të zëza që njerëzit e tij politikë i shkaktuan Himarës në kohën e pushtetit të tyre?

Por Dule, në Kongres nuk i doli në krah as homologut të tij në OMONIA që akuzoi me fakte se si grabiten me mijra hektarë tokë në minoritet me ndihmën e organëve shtetërore e të drejtësisë dhe dhunës. Dule heshti, ndoshta për të shmangur edhe përgjegjësitë e strukturave të tij për këtë baterdi. Por, një situatë e tillë i dha dorë Kryeministrit i pranishëm dhe aktor në Kongresin e Dulës, të atakojë rendë sistemin e drejtësisë. Dhe e bëri këtë për të dalë atje ku ai donte, te sigurimi i votave për votimin e reformës në drejtësi. Kryeministri foli gjatë për këtë çeshtje, por në lidhje me problemin e rendë që ka minoriteti, Rama harroi argumentin e tij themelor kundër drejtësisë. Ai akuzon drejtësinë si të kapur nga politika. Por në rastin e grabitjeve pasurore në minoritetit del, sipas tij, se kjo drejtësi nuk eshte e kapur nga politika?!

Me këtë kongres Dule, përveç se garantoj pa asnjë rezistencë dhe me manipulime postin e lidërshiptit në Partinë e vet, arriti edhe një sukses tjetër. Maksimalizoi votën e vetme të partisë së tij në Parlament. Rama, Basha, Meta treguan hapur interes, jo për partinë e Dulës, por për votën e tij për reformën. U duk qartë se kjo e detyroi Dulën të ndryshonte edhe konceptin e fjalimit të tij në këtë kongres. Të bënte barkë shpetimi që mund ta heq nga bregu i vetmisë politike, fjalën e magjishme "konsensus"... Por fillimisht të ishte sa më fluidë për problemet e minoritetit etnik grek. Në thelb, një pazar politik në kurriz të interesave të minoritetit grek me përfitues Dulën.

Së fundi, si veprim anësor i këtij pazari ishte edhe evidentimi në kongresin e Dulës (dhe aspak në programin politik të kongresit të Dulës) i nëvojës për zbatim në pretendimet shqiptare në marrëdhëniet me Greqinë. (Në fakt Dule, për të qenë i



mirëpritur në palën shqiptare, bëri me faj të dy qeveritë aktuale). Situata të kujton gjithashtu edhe periudhën fill pas festimeve të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Antihelenizmi në atë kohë ishte bërë i vetmi mjet që siguronte lavdinë e përvjetorit në të gjitha nivelet. Por sapo ranë telat nga Evropa dhe SHBA-ja, retorika nacionaliste shterroi me thikë. Diçka e ngjashme duket se pasoi pas së njëjtës retorikë që i parapriu vizitës së Ministrit të Jashtëm Grek në javën e parë të muajit që kaloi. Në Kongresin e Dulës kjo u reflektua, por Dule nuk ishte as shkaku, as pasoja e kësaj krthese, e aq më pak katalizatori dhe faktori për shtytje pozitive në këto marrëdhënie. Dule edhe në këtë rast doli në pozita perfituesi.....

Nga Panajot Barka

Për gazetën TEMA 04.07.2016

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2016/10/18/leximi-ndryshe-i-axhendes-shqiptare-per-marredheniet-me-greqine/>

<http://www.pelagoskoritsas.gr/2016/10/leximi-ndryshe-i-axhendes-shqiptare-per.html>

### **Lëximi ndryshe i axhendës shqiptare për marrëdhëniet me Greqinë**

17.10.2016/18.10.2016

Në përpjekjet e mundimshme që po bëhen në Shqipëri nga faktorë politikë dhe medjatikë pranë tyre për virtualizimin e realitetit shqiptar, sa diakronik aq dhe aktual dhe për ta venë atë në shërbim të interesave të tyre të ngushta, u rikthye se fundmi serishmi në skenë dhe antigreqizmi. Si asnjëherë tjetër, ka një pikënisje zyrtare. Së dyti Nuk artikullohet si alternativë ballafaqimi për të vetpërcaktuar më mirë identitetin etnik shqiptar. Ka si fabul “problemin çam”, për të cilin kultivon pa argumenta një shtrat problemesh virtuale, të paqena dhe të pamundura, por gjithmonë duke i dhënë një frymë antigreke. Me këtë ambalazh, problemi parashtrohet politikisht dhe medjatikisht si çeshtje kombëtare. Së treti, problemet, të cilat ose janë tejkaluar, ose kanë një zgjidhje të thjeshtë, ose për to është përgjegjëse dhe pala shqiptare, kërkon tia faturojë palës greke. Së katërti qasja antihelene e tanishme konfirmoi më së miri se ajo që u intereson instrumentuesve të brendshëm të antigreqizmit është që me çdo mjet dhe mundësi, të frymëzojnë opinionin e brendshëm me këtë ndjenjë. Së pesti, u konfirmua se pas kësaj sjelljeje, e paraqitur si kombëtare, qëndron një apo disa faktorë të tretë.

Ministri i jashtëm i vendit e vendos pikënisjen e këtij kthimi prapa në marrëdhëniet midis dy vendeve dhe kushtezon të ardhmën e tyre me ligjin e luftës ndaj Shqipërinë që sipas tij Greqia e mban akoma në këmbë. Ky problem nëse nuk do të pranohet si i zgjidhur dhe i tejkaluar, duhet pranuar se përgjigjesinë më të madhe e ka pala shqiptare.

Së pari, Ministri dhe të gjithë sa e përkrahin, duhet të pranojnë faktin se nuk bëhet fjalë për ligj lufte të votuar në Parlamentin Grek, por bëhet fjalë për dekret mbretëror të kundërfirmosur nga kryeministri i atëhershëm i Greqisë. Së dyti dekreti i mbretit grek nr. 2623, datë 10 nëntor 1940, përbënte aktin juridik të shtetit grek për të përballuar luftën e provokuar nga Italia fashiste me të cilën juridikisht ishte e bashkuar edhe Shqipëria. Së treti, ky dekret doli si kundërpeshë i vendimit të parlamentit shqiptar (të zgjedhur para pushtimit) të 15 qershorit 1940, i cili me brohoritje (dhe jo i imponuar) ktheu në ligj një dekret të Viktor Emanuelit, sipas të cilit Shqipëria ishte në luftë me cilindo shtet që do të ishte në lufte edhe Italia(!). Së katërti lufta me 28/10/1940, iu shpall Greqisë nga territori shqiptar dhe sipas Jakomonit, me këmbësit të Viktor Emanuelit në Shqipëri, filloi me preteksin se Greqia krijoi lehtësira luftarake nga toka e deti forcave angleze, se kishte vazhduar politiken provokative ndaj çameve dhe kishte shkaktuar trazira në kufijtë e mbretërisë Italo-shqiptare. Në planin e brendshëm lufta sipas kryeministrit kusling të shqiptarve Sh. Verlaci bëhej për zgjerimin e territorëve të mbretërisë duke i shkëputur Greqisë Çamerinë dhe Epirin e Jugut. Kjo ishte arsyeja, sipas Jakomonit që të rreshtohen në krah të ushrisë Italiane edhe 19.039 ushtarë shqiptarë, nga të cilët dëzertuan që në kontaktin e parë me frontin e luftës 3114 shqiptarë. (Edhe sot, qarqe medjatike dhe politike artikulojnë se pasuria e shpitarëve në Thesproti i kalon të 12 miliard dollarë. (!!!)) Së pesti, po ashtu, në gusht të 1940 Jakomoni njoftonte me gëzim Çanon se veprimtaria provokative e shqiptareve në Çameri, krijonte terrenin e duhur për të justifikuar shpalljen e luftës ndaj Greqisë. Për të gjitha këto e shumë të tjera, a ka kërkuar ndonjë herë të paktën ndjesë pala shqiptare. (!!)

Por, lë t'i kthehemi rrjedhës së kundërt, atë të heqjes së këtij ligji nga të dy palët, ose tri palët duke përfshirë edhe Italinë. Së pari, nga pala shqiptare nuk ka asnjë akt juridik të mirëfilltë, të marrë nga një institucion analog (Parlamenti Shqiptar) që ta ketë abroguar ligjin e parlamentit shqiptar të 15/06/1940.

Persa i përket dekretit mbretëror grek, siç e thamë, ai kishte për objekt luftime mbretërinë e bashkuar Italo-Shqiptare dhe jo vetëm Shqipërinë. Realiteti i luftës midis dy mbretërive, greke nga njera anë dhe italo-shqiptare nga ana tjetër, mori praktikisht fund me 1943 me kapitullimin e Italisë fashiste. Pra edhe dokumentet në lidhje me këtë objekt humbën vlerën e tyre që më 1943. Në këtë kuptim, mund të pranohet se humbi vlerën e vet edhe akti juridik i parlamentit shqiptar të 15 qershorit 1940.

Po ashtu me 1947, Greqia nënshkroi Traktatin e Paqës me Italinë. Ky akt shenoi fundin juridik dhe praktik të realitetit të luftës midis Italisë dhe Greqisë dhe që atëherë të dy shtetet janë aleatë në një serë organizmash dhe strukturash euroatlandike, pa asnjë pretendim ndaj njera tjetrës. Ky realitet midis Shqipërisë dhe Greqisë u arriti me 1996 kur të dy vendet neshkruan te njëjtin traktat miqësie e bashkëpunimi. Së treti. Dekreti i luftës së Greqisë doli nga Mbreti dhe u kundërfirmos nga Kryeministri pa u ratifikuar asnjëherë nga parlamenti grek. Dihet se në Greqi institucioni i mbretit u abrogua. Pra, dekreti mbretëror i 1940 mbeti vetëm me firmën e Kryeministrit të Greqisë, (ose maksimalisht dhe me atë të Presidentit të Republikës). Me 1987 kryeministri i Greqisë e abrogoi edhe zyrtarisht këtë dekret. Atëherë, ku mbështeten pretendimet e palësë shqiptare. (!) Përse ministri i jashtëm shqiptar shpejtoi për ta hedhur posht propozimin kryeministrit të sotëm grek që në fund të fundit t'i kërkohet presidentit të Republikës greke të nxjerrë edhe ai një dekret abrogues të atij dekreti të vitit të largët të 1940. Pse pala shqiptare këmbëngul që atë vendim duhet ta marrë parlamenti grek, kur e di se praktikisht është e pamundur dhe juridikisht e papranueshme? Pra, akti i ligjit të luftës, pretenduar nga pala shqiptare se është në fuqi nga pala greke, është thjeshtë e vetëm propagandë që ka vlerë vetëm për opinionin antigrek shqiptar. Ndërkohë që faktet bëjnë më shumë përgjegjëse palën shqiptare.

Propagandë përbën edhe pretendimi se ky ligj, inegzistentë pra, lidhet me pronat e çameve në Greqi. Në shtetin grek, është e vërtetë se në mbështetje të dekretit në fjalë u ndërmorën një serë aktesh që vendosnin në sekuestro pasuritë e qytetarëve të vendeve të huaja armike ndaj Greqisë. Por çamët në atë periudhë ishin qytetarë grekë. Pra, këto akte, si nga pikëpamja juridike dhe praktike nuk kishin si të vepronin mbi qytetarët grekë të Çamerisë. Pra, në Shqipëri abuzohet keq kur duan të ndërlidhin këto dy objekte midis tyre. Në fakt duan duan të fshehin arsyet e tjera objektive dhe me të qenësishme në lidhje me arsyet e vërteta përse u sekuestruan pasuritë e tyre atje. Bëhet fjalë për vendime gjyqësore për vëpra penale në kohë lufte.

Ky fakt rezon pretendimin tjetër të ministrit tonë të jashtëm Ditmir Bushati që lidh ligjin inegzistent të luftës me ndërtimin e varrëzave greke. Ndërtimi i tyre rregullohet sipas akteve ndërkombëtare për të rrenët në vende të treta të ushtrive të huaja. Pra, nuk mund të lidhet egzistenca ose jo e ligjit të luftës me mos respektimin e akteve ndërkombëtare për këtë çështje dhe të marrëveshjes së 2009.

Në këtë plan shteti shqiptar duhet zyrtarisht të vendos se si e konsideron fitorën e parë të popujve të botës mbi fashizmin të arritur në tokën shqiptare, si fitore mbi fashizmin apo si pushtuese të tokës shqiptare. Ky sqarim është i domosdoshëm se në rastin e dytë, pra nëse ushtria e popullit grek do të konsiderohet pushtuese dhe jo çliruese, atëherë indirekt i bie që ende edhe sot në Shqipëri të pranohet se në luftën italo-greke Shqipëria ishte me Italinë fashiste.

Ky argument rezon njëkohësisht reciprocitetin e pretenduar mbi asnjë bazë të ngritur nga Shpetim Idrizi, i cili thotë një të vërtetë që nuk e thonë të tjerët. Pra, pengesa

e respektimit të marrëveshjes për varrëzat e ushtarëve grekë lidhet edhe me këto pretendime të Idrizit për varre analoge në Greqi për çamët. Këtu lindin disa pyetje. Çfarë ushtrie përbënin çamët në luftën e dytë botërore në Thesproti, aleatë të kujt ishin dhe kundër kujt luftonin?! (Këtu nuk duhen ngatërruar, siç po ngatërrohen njesitë luftarake të çameve që jetonin në territorin shqiptar me çamët e Greqisë)

Thellimi i këtij argumenti zbulon anën e vërtetë të promovimit së fundmi në këto nivele të “problemit çam” tregon në fakt se ai po përdoret ca për të rritur antigreqizmin midis shqiptarëve si ushqim për ta për të harruar varfërinë, papunësinë, kriminalitetin, ca për t’i shërbyer politikës së zgjedhjeve të cilës i ka mbetur tanimë nacionalizmi si alternativë e vetme e ca disa “faktorëve të tretë”.

Ministri i jashtëm i vendit e paraqet atë si problem të të drejtave të njeriut, por nuk artikulon asnjë argument se çfarë nënkupton. Ndërsa Shpetim Idrizi ushqen për vete idenë se një ditë do të importojë në Greqi minoritetin shqiptar të Çamerisë. Këtë e bën pasi e di se politikisht për vete nuk i ofron asgjë e vërteta se kush nga komuniteti çam ka prona në Greqi dhe nuk ka pengesa ligjore në shtetin grek, ose nuk shfaq tendenca dhe ide irredentiste, mund t’i fitojë ato.

Po ashtu, nuk është se unë nxjerrë ndonjë sekret po të them se një grup profesorësh grekë do të qarkullojnë së shpejti dokumenta nga arkivat ushtarake gjermane, nga ato angleze dhe dëshmi greke të cilat do të thonë të gjithë të vërtetën. Do të zbulojnë se që në fillim të shekullit të kaluar faktorë të tretë dhe për interesa e tyre e të cilët nuk kanë ndryshuar ende, provokonin këtë çështje, me pasojë ta paguajnë shtrenjtë shqiptarët dhe grekët e Çamerisë dhe marrëdhëniet e mira midis tyre dhe sot dy vendet.

Po ashtu, Ministri i jashtëm na pohon se problemi i marrëveshjes për shelfin detar, ishte një gabim i palës shqiptare që edhe ai do t’ja faturojë palës greke. Ndërkohë që doli në dritë, madje edhe me pohimin e tij, se faktorë të tretë e shtynë forcën e tij politike në vendimin për ta prishur atë marrëveshje dhe për ta paraqitur si vepër kombëtare. Fund

17/10/2016

### *Μία διαφορετική ανάγνωση της αλβανικής ατζέντας για τις σχέσεις με την Ελλάδα*

Στις επίπονες προσπάθειες που καταβάλλουν στην Αλβανία πολιτικοί παράγοντες και τα Μ.Μ.Ε τους, για την εικονική παρουσίαση της αλβανικής πραγματικότητας, διαχρονικής και σύγχρονης, προς εξυπηρέτηση των στενών συμφερόντων τους, επανήλθε τελευταία στο προσκήνιο και ο ανθελληνισμός. Όπως στο παρελθόν, η εμφάνιση αυτή έχει και σήμερα επίσημη αφετηρία. Δεύτερον, δεν αναφέρεται ως εναλλακτική λύση η αντιπαραβολή απόψεων για τον καλύτερο αυτό-προσδιορισμό της αλβανικής εθνικής ταυτότητας. Σαν μύθο, χρησιμοποιείται το “τσάμικο πρόβλημα”, το οποίο καλλιεργεί, χωρίς επιχειρήματα, ένα κλίμα εικονικών, ανύπαρκτων και ανέφικτων προβλημάτων, προσδίδοντάς τους, όμως, πάντα ανθελληνικό χαρακτήρα. Μ’ αυτού του είδους το περίβλημα, το πρόβλημα παρουσιάζεται, πολιτικά και μιντιακά, ως εθνικό ζήτημα. Τρίτον, τα προβλήματα, τα οποία είτε έχουν ξεπεραστεί, είτε έχουν μια απλή λύση, είτε γι’ αυτά την ευθύνη φέρει και η αλβανική πλευρά, επιδιώκουν να τα φορτώσουν στην ελληνική πλευρά. Τέταρτον, η σημερινή ανθελληνική προσέγγιση επιβεβαίωσε κατά τον καλύτερο τρόπο ότι εκείνο που ενδιαφέρει τους εσωτερικούς χειραγωγείς του ανθελληνισμού είναι να καλλιεργήσουν στην εσωτερική κοινή γνώμη, με κάθε μέσο και τρόπο, ανθελληνικά

αισθήματα. Πέμπτο, αποδείχθηκε ότι πίσω από αυτή την πολιτική συμπεριφορά, που την παρουσιάζουν ως εθνική, κρύβονται ένας ή περισσότεροι τρίτοι παράγοντες.

Ο Αλβανός ΥΠΕΞ τοποθετεί την αφετηρία αυτή της παλινδρόμησης στις σχέσεις ανάμεσα στις δύο χώρες και συνδέει το μέλλον τους με το νόμο του Εμπολέμου κατά της Αλβανίας, τον οποίο, σύμφωνα με τον ίδιο, η Ελλάδα διατηρεί ακόμα. Για το πρόβλημα αυτό, σε περίπτωση που δεν αποδεχθούμε ότι έχει επιλυθεί και ότι είναι παρωχημένο, θα πρέπει να αναγνωρίσουμε ότι τη μεγαλύτερη ευθύνη φέρει η αλβανική πλευρά.

Πρώτον, (1) ο Υπουργός και όσοι τον σιγοντάρουν, θα πρέπει να αποδεχθούν το γεγονός ότι δεν πρόκειται για νόμο Εμπολέμου που ψηφίστηκε από το Ελληνικό Κοινοβούλιο, αλλά πρόκειται για βασιλικό Διάταγμα που μονογραφήθηκε από τον τότε Π/Θ της Ελλάδος. Δεύτερον, (2) το ελληνικό βασιλικό Διάταγμα, αρ. 2623, ημερ. 10 Νοεμβρίου 1940, αποτελούσε νομική πράξη του ελληνικού κράτους για την αντιμετώπιση του πολέμου που κήρυξε η φασιστική Ιταλία με την οποία νομικά είχε ενωθεί και η Αλβανία. Τρίτον, (3) το Διάταγμα αυτό ήταν ανταπάντηση της απόφασης του Αλβανικού Κοινοβουλίου (που εκλέχθηκε πριν την ιταλική κατοχή) της 15<sup>ης</sup> Ιουνίου 1940, το οποίο με χειροκροτήματα (και όχι δια της επιβολής), μετέτρεψε σε νόμο το Διάταγμα του Βίκτωρα Εμμανουήλ, σύμφωνα με τον οποίο η Αλβανία θα έμπαινε σε πόλεμο με οποιοδήποτε κράτος ήταν σε πόλεμο η Ιταλία (!). Τέταρτον, (4) η επίθεση της 28<sup>ης</sup> Οκτωβρίου 1940 κατά της Ελλάδος, ξεκίνησε από αλβανικό έδαφος και σύμφωνα με τον Jakomoni, τοποτηρητή του Βίκτωρα Εμμανουήλ στην Αλβανία, ξεκίνησε με το πρόσχημα ότι η Ελλάδα παραχώρησε διευκολύνσεις, από ξηράς και θαλάσσης, στις βρετανικές δυνάμεις, ότι συνέχιζε την προκλητική πολιτική σε βάρος των Τσάμηδων και ότι είχε προκαλέσει επεισόδια στη μεθόριο με το Ιταλο-Αλβανικό βασίλειο. Στο εσωτερικό πλαίσιο, ο πόλεμος, σύμφωνα με το δοσίλογο Π/Θ των Αλβανών Σεφκέτ Βεράτσι, γινόταν για την επέκταση των εδαφών του Βασιλείου, αποσπώντας από την Ελλάδα την Τσαμουριά και τη Νότιο Ήπειρο. Αυτός ήταν ο λόγος, σύμφωνα με τον Jakomoni, που στο πλευρό του ιταλικού στρατού, παρατάχθηκαν και 19.039 Αλβανοί στρατιώτες, από τους οποίους οι 3.114 Αλβανοί αυτομόλησαν με την πρώτη επαφή με το μέτωπο. Πέμπτον, (5) τον Αύγουστο του 1940, ο Jakomoni ενημέρωνε χαρούμενος τον κόμη Ciano ότι οι προκλητικές ενέργειες των Αλβανών στην Τσαμουριά δημιουργούσαν το κατάλληλο έδαφος για να δικαιολογήσουν την κήρυξη του πολέμου εναντίον της Ελλάδος. Για όλα αυτά και πολλά άλλα, ζήτησε τουλάχιστον συγγνώμη καμιά φορά η αλβανική πλευρά; (!!).

Ας πάρουμε όμως τα πράγματα από την αντίθετη πλευρά, την άρση δηλαδή του νόμου του Εμπολέμου από τις δύο πλευρές, ή και από τις τρεις πλευρές, αν λάβουμε υπόψη και την Ιταλία. Πρώτον, (1) δεν υπάρχει από την αλβανική πλευρά καμία καθαρά νομική πράξη από ομόλογο θεσμό, που να ακυρώνει το νόμο της 15/06/1940 του Αλβανικού Κοινοβουλίου.

Όσον αφορά στο ελληνικό βασιλικό Διάταγμα, όπως προαναφέραμε, αυτό είχε ως αντικείμενο πόλεμο το ενωμένο Ιταλο-Αλβανικό βασίλειο και όχι μόνο την Αλβανία. Η εμπόλεμη κατάσταση ανάμεσα στα δύο βασίλεια, του ελληνικού από τη μία και του ιταλο-αλβανικού από την άλλη, τερματίστηκε στην πράξη το 1943 με τη συνθηκολόγηση της φασιστικής Ιταλίας. Συνεπώς, και οι νομικές πράξεις που έχουν σχέση με το συγκεκριμένο αντικείμενο έχασαν την αξία τους από το 1943. Με αυτή την έννοια, μπορεί να γίνει αποδεκτό ότι απώλεσε την αξία της και η νομική πράξη του Αλβανικού Κοινοβουλίου της 15<sup>ης</sup> Ιουνίου 1940.

Το 1947, η Ελλάδα υπέγραψε Σύμφωνο Ειρήνης με την Ιταλία. Η πράξη αυτή σήμανε το νομικό και πρακτικό τέλος της εμπόλεμης κατάστασης ανάμεσα στην Ιταλία και την Ελλάδα. Από τότε τα δύο κράτη, είναι σύμμαχοι σε σειρά ευρω-ατλαντικών

οργανισμών και δομών, χωρίς να διεκδικούν κάτι το ένα από το άλλο. Η πραγματικότητα αυτή ανάμεσα σε Ελλάδα και Αλβανία, επετεύχθη το 1996, όταν οι δύο χώρες υπέγραψαν το ίδιο Σύμφωνο Φιλίας και Συνεργασίας. Τρίτον, (3) το ελληνικό διάταγμα του Εμπολέμου, ήταν του Βασιλιά και μονογραφήθηκε από τον Π/Θ, χωρίς ποτέ να έχει επικυρωθεί από το Ελληνικό Κοινοβούλιο. Στην Ελλάδα ο θεσμός του Βασιλιά έχει καταργηθεί. Συνεπώς το βασιλικό διάταγμα του 1940 απέμεινε μόνο με την υπογραφή του Π/Θ της Ελλάδας (είτε το πολύ και με την υπογραφή του Προέδρου της Δημοκρατίας). Το 1987, ο Π/Θ της Ελλάδος κατήργησε και επίσημα αυτό το Διάταγμα. Επομένως, που στηρίζονται οι διεκδικήσεις της αλβανικής πλευράς; (!!!). Γιατί ο Αλβανός ΥΠΕΞ βιάστηκε να απορρίψει την πρόταση του σημερινού Έλληνα Π/Θ, που σε τελευταία ανάλυση, συνιστούσε να ζητηθεί από τον Πρόεδρο της Ελληνικής Δημοκρατίας να καταργήσει με διάταγμα το Διάταγμα του μακρινού έτους 1940. Γιατί η αλβανική πλευρά επιμένει να λάβει την απόφαση η Ελληνική Βουλή, όταν γνωρίζει ότι πρακτικά είναι ανέφικτο και νομικά απαράδεκτο; Συνεπώς, ο νόμος του εμπολέμου, για τον οποίο η αλβανική πλευρά ισχυρίζεται ότι η ελληνική πλευρά διατηρεί ακόμα, είναι απλώς και μόνο προπαγάνδα που προορίζεται μόνο για την καλλιέργεια μίας ανθελληνικής αλβανικής κοινής γνώμης. Τα πραγματικά στοιχεία ωστόσο, καταλογίζουν μεγαλύτερη ευθύνη στην αλβανική πλευρά.

Προπαγάνδα είναι και ο ισχυρισμός ότι ο ανύπαρκτος πλέον αυτός νόμος έχει σχέση με τις περιουσίες των Τσάμηδων στην Ελλάδα. Πράγματι, στην Ελλάδα, βάσει του προαναφερόμενου Διατάγματος, υποβλήθηκαν στο καθεστώς κατάσχεσης των περιουσιών τους πολίτες χωρών εχθρικές προς την Ελλάδα. Οι Τσάμηδες όμως, την περίοδο εκείνη ήταν Έλληνες πολίτες. Συνεπώς, το καθεστώς κατάσχεσης, τόσο από νομικής όσο και από πρακτικής άποψης, δεν μπορούσε να ισχύσει σε βάρος των Ελλήνων πολιτών της Τσαμουριάς. Στην Αλβανία γίνεται κατάχρηση, σε μια προσπάθεια να συνδέσουν τα δύο αυτά θέματα. Στην πραγματικότητα όμως, επιδιώκουν να κρύψουν άλλους, αντικειμενικούς και ουσιώδεις λόγους, να αποκρύψουν τα πραγματικά αίτια του γιατί κατασχέθηκαν οι περιουσίες των Τσάμηδων. Κατασχέθηκαν με δικαστικές αποφάσεις για ποινικά αδικήματα που διαπράχθηκαν εν καιρώ πολέμου.

Το στοιχείο αυτό ακυρώνει και τον άλλο ισχυρισμό του ΥΠΕΞ Μπουσάτι, που συνδέει τον ανύπαρκτη νόμο του Εμπολέμου με την ανέγερση των ελληνικών κοιμητηρίων. Η ανέγερσή τους διευθετείται από διεθνείς πράξεις για τους πεσόντες ξένων στρατευμάτων σε τρίτες χώρες. Συνεπώς, δεν μπορεί να υπάρξει κάποια σχέση ανάμεσα στην ύπαρξη ή όχι του νόμου του Εμπολέμου, και το μη σεβασμό των διεθνών πράξεων και της Συμφωνίας του 2009 για αυτό το θέμα.

Σε αυτό το πλαίσιο, το αλβανικό κράτος θα πρέπει να τοποθετηθεί επίσημα: Πως τη θεωρεί την πρώτη νίκη των λαών του κόσμου εναντίον του φασισμού, που σημειώθηκε στην αλβανική επικράτεια, τη θεωρεί ως νίκη κατά του φασισμού, ή θεωρεί τον Ελληνικό Στρατό ως κατακτητή επί αλβανικών εδαφών; Η διευκρίνιση αυτή είναι απαραίτητη, διότι στη δεύτερη περίπτωση, εάν δηλαδή ο στρατός του ελληνικού λαού θα θεωρείτο κατακτητικός και όχι απελευθερωτικός στρατός, τότε έμμεσα θα πρέπει ακόμα και σήμερα στην Αλβανία να παραδεχθούν ότι στον Ε – Ι πόλεμο, η Αλβανία ήταν στο πλευρό της φασιστικής Ιταλίας.

Το επιχείρημα αυτό, ταυτόχρονα απορρίπτει και την ισχυριζόμενη και αβάσιμη αμοιβαιότητα που έχει ζητήσει ο Shpetim Idrizi - Σπετίμ Ιντρίζι, ο οποίος μας λέει μια αλήθεια που δεν την λένε οι άλλοι. Το εμπόδιο δηλαδή, που η Συμφωνία του 2009 για τα κοιμητήρια των Ελλήνων στρατιωτών δεν γίνεται σεβαστή, έχει σχέση με τις διεκδικήσεις του Ιντρίζι για ανάλογα νεκροταφεία των Τσάμηδων στην Ελλάδα. Εδώ όμως προκύπτουν ορισμένα ερωτηματικά. Τι στρατό είχαν συγκροτήσει οι Τσάμηδες

στον Β΄ Παγκόσμιο Πόλεμο στη Θεσπρωτία, σύμμαχοι ποιανού ήταν και εναντίον ποιανού πολεμούσαν;! Εδώ δεν θα πρέπει να γίνει σύγχυση, όπως γίνεται σήμερα, ανάμεσα στις μαχητικές μονάδες των Τσάμηδων που ζούσαν στην Αλβανία με των Τσάμηδων που ζούσαν στην Ελλάδα.

Εάν ψάξουμε πιο βαθιά αυτό το επιχείρημα, θα ανακαλύψουμε τους πραγματικούς λόγους της προβολής σε τέτοια επίπεδα του "τσάμικου προβλήματος". Η προβολή αποδεικνύει στην πραγματικότητα, ότι το θέμα αυτό χρησιμοποιείται τόσο για την καλλιέργεια του ανθελληνισμού στην αλβανική κοινωνία, ως τροφή στους Αλβανούς, προκειμένου να ξεχάσουν την φτώχεια, την ανεργία, την εγκληματικότητα, όσο και για ψηφοθηρία, για την οποία μοναδικός δρόμος πλέον έχει απομείνει η εθνικιστική έξαρση, αλλά και προς συμφέρον "τρίτων παραγόντων".

Ο Υπουργός Εξωτερικών της χώρας, παρουσιάζει το "Τσάμικο" ως πρόβλημα ανθρωπίνων δικαιωμάτων, δεν φέρνει όμως κανένα επιχείρημα ως προς τι εννοεί με αυτό. Ενώ ο ShpetimIdrizi από πλευράς του, προωθεί την ιδέα ότι μια μέρα, θα εισάγει στην Ελλάδα την αλβανική μειονότητα της Τσαμουριάς. Αυτό το κάνει διότι γνωρίζει ότι για λογαριασμό του, δεν έχει πολιτικά οφέλη από την αλήθεια. Και η αλήθεια είναι ότι τα μέλη της τσάμικης κοινότητας που έχουν περιουσίες στην Ελλάδα, και που δεν έχουν νομικά κολλήματα στην χώρα αυτή ή που δεν έχουν εκδηλώσει αλυτρωτικές τάσεις ή ιδέες, μπορεί να τις κερδίσουν.

Δεν βγάζω κάποιο μυστικό στη φόρα ενημερώνοντας ότι σύντομα, ομάδα Ελλήνων καθηγητών θα δώσουν στη δημοσιότητα, έγγραφα και ντοκουμέντα από γερμανικά και βρετανικά αρχεία και μαρτυρίες Ελλήνων, που θα αποκαλύψουν όλη την αλήθεια. Θα αποκαλύψουν ότι από τις αρχές του περασμένου αιώνα, τρίτοι παράγοντες και για δικά τους συμφέροντα, οι οποίοι παραμένουν οι ίδιοι, υπέθαλπαν αυτό το ζήτημα, με αποτέλεσμα να το πληρώσουν ακριβά οι Αλβανοί και οι Έλληνες της Τσαμουριάς και οι καλές σχέσεις ανάμεσά τους, και σήμερα να το πληρώνουν οι δύο χώρες.

Ο Υπουργός Εξωτερικών μας λέει επίσης ότι η Συμφωνία για την υφαλοκρηπίδα ήταν ένα λάθος της αλβανικής πλευράς και επιδιώκει να το φορτώσει στην ελληνική πλευρά. Στο μεταξύ όμως προέκυψε, και από τις δηλώσεις του μάλιστα, ότι τρίτοι παράγοντες ώθησαν το κόμμα του, να λάβει την απόφαση για την ακύρωση της Συμφωνίας και να παρουσιάσει αυτή την απόφαση ως πράξη υπέρ των εθνικών συμφερόντων .

ΠΑΝΑΓΙΩΤΗΣ ΜΠΑΡΚΑΣ

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2016/11/20/ligji-per-minoritetet-kombetare-moment-historik-apo-propagande-sterile/>

### **Ligji për Minoritetet Kombëtare, -moment historik, apo propagandë sterile.**

20.11.2016

Raporti i fundit rekomandues i Komisioni Evropian për hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në, në plan të parë është pozitiv. Mirëpo, kapja pas kësaj ane, nga ana e qeverisë, tregon se raporti ofrohet për shumë për konsum politik të brendshëm dhe për kthimin e tij në një kartë elektorale të fuqishme. Flet për këtë fakti i fshehtë së detyrave që ky raport i lë Shqipërisë, ose i reduktimit të tyre vetëm në një, atë të reformës në drejtësi. Këtë qasje qeveria e trajton si komfort të hesapeve të veta në luftën ndaj opozitës. I faturon që tani asaj fajin e moshapjes se negociatave në dhjetor, pasi opozita, sipas retorikës së kryeministrit, pengon implementimin juridik dhe praktik të reformës në drejtësi. Në këtë kendveshtrim, argumenti i mësipërm, i ka krijuar deri tani qeverisë avantazhin, në fakt abuzimin e radhës, për të fshehur detyrat e tjera të këtij raporti “pozitiv” për të fituar të drejtën e hapjes së negociatave.

Në spektrin e këtyre detyrave një rendësi të dorës së parë zë respektimi i të drejtave të njeriut dhe në veçanti të minoriteteve. Graviteti i këtij kushti të BE-së kapërcen recetat tradicionale a priori për respektimin e këtyre të drejtave, pasi BE-ja e kongretizon këtë kusht me nevojën e miratimit të një ligji të posaçëm atë për respektimin e të drejtave të minoriteteve kombëtare. Kjo vërteton, nga njera anë, se realiteti i respektimit të këtyre të drejtave paraqet probleme serioze. Nga ana tjetër, përbën përpjekjen e parë në historinë e shtetit shqiptar për të patur një ligj të posaçëm për minoritetet, i cili të sanksionojë natyrën, hartën, peshën, rolin dhe të drejtat e minoriteteve në vend. Hapi i metejshëm mbëtet implementimi praktik i këtyre të drejtave. Pra, po të flasim në frymën e reformave, ky akt përbën një reformë bazale në fushën e të drejtave të minoriteteve dhe lidhet me nivelin e emancipimit të shoqërisë tonë në terësi dhe të politikës shtetërore në veçanti.

Një tregues që vërteton boshllëkun e madhë në këtë drejtim përbën kontradikta midis parimeve të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve ratifikuar nga vendi ynë me 1999 dhe mentalitetit politik shtetëror të trajtimit të këtyre minoriteteve. Parimi bazë i kësaj Konvente mbëtet e drejta e vetpërcaktimit etnik apo kulturor i individit në përbërje ose jo në komunitetin e një minoriteti të caktuar dhe e drejta e tij për t’u mos u diskriminuar për shkak të kësaj zgjedhjeje. Shteti tek ne aplikon standartin e njohjës paraprake prej tij të këtij identiteti të individit dhe të minoritetit në të gjitha nivelet dhe dimensionet e tij. Aq me keq kur niset nga praktika e sistemit komunist. Rastin më ekstrem përbën rasti i fundit, ai i Himarës ku shteti me kryeministrin të parin dhe me korin me të gjerë, medjatic, politik dhe intelektual në vijim, deklarojnë pa asnjë medyshje se shteti në Himarë nuk njeh minoritet grek. Pra, flasin në emër dhe për llogari të tjetër kujt dhe e diskriminojnë atë pa e pyetur, duke shkelur kështu në mënyre flagrante Konventën Kuadër.

Një realitetet i tillë vë në dyshim serioz predispozicionin e shtetit, si për një ligj konform standarteve evropiane për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve kombëtare, apo kulturore, ashtu edhe për respektimin praktik të të drejtave të tyre.

Dyshimin se jemi në kufinj të një propagandë sterile e përforcon fakti se Kryeministri, sipas deklaratave të tij, e konsideron të kryer këtë detyrë shtëpie të BE-së, madje sipas standarteve më të avancuara evropiane! E vërteta flet për një realitet të kundërt. E vërteton produkti i grupit të punës të ngritur në Ministrinë e Jashtme për këtë qëllim. Ky grup pune ka muaj që punon për përgatitjen e draftit të këtij ligji, por pa



praninë reale dhe praktike të grupeve të interesit. Ishte kjo arsyeja që Konferenca Ndërkombëtare e organizuar prej kësaj Ministrie për këtë qëllim në fund të tetorit, provokoi, nga njera anë reagimin e ashpër të përfaqësuesve të minoriteteve dhe të organizatave që mirren me këto të drejta në vend, por, nga ana tjetër edhe vërrejtjet esenciale të eksperteve të Këshillit të Evropës, OSBE-së dhe organizmave të tjerë ndërkombëtare të pranishme në punimet e kësaj konference.

Duket hapur se qeveria, si instrument përgjegjës i shtetit për rregullimin e një ligji të tillë, nuk e kapërcen dot parametrin dyshues të tij ndaj lirive dhe të drejtave të minoriteteve dhe mbëtët peng i së drejtës së vet abuzive për kontrollin e tyre. Një mendësi e tillë i vë kryqin parimit se minoritetet përbëjnë vlerë në larminë e vlerave kulturore në vend.

Kjo nga ana e vet forcon më shumë ndjenjën e shpërfilljes nga ana e shtetit që manifestojnë minoritetet e që kultivon tek ata kompleksin e inferioritetit. Pra, më shumë se momenti historik i aprovimit të një ligji për minoritetet, jemi në kushtet kur më e rëndësishmja mbëtët kapërcimi i momentit të mangësisë psikonacionale nga ana e minoriteteve.

Ligji për të drejtat e minoritetëve kombëtare, në thelb ndryshon totalisht nga çdo lloj ligj tjetër. Ndryshe nga ligjet e tjera që ndërtohen mbi parimin “e ndalimit”, ai ka në thelb garantimin e të drejtave të minoriteteve kombëtare të saksionuara në Konventën Kuadër apo dhe në dokumenta të tjera të organizmave ndërkombëtare. Nisur nga ky fakt, do të ishte në nderin e kësaj qeverie që të hiqte dorë nga praktika e njohur e të bërit projektligje vet e t’i aprovojë shumica e vet në parlament. Në këtë rast emancipimi evropian kërkon që qeveria të lëjojë vet minoritetet të kongludojnë në një ligj që do t’i shprehte interesat e tyre dhe qeveria thjeshtë të manaxhonte vullnetin e tyre, vullnet i cili, kuptohet nuk do të mund të kapërcente vijat e kuqe të vendosura nga aktet ndërkombëtare. Një vëprim i tillë do të çlironte minoritetet nga persekucioni i frikës dhe mosbesimit ndaj shtetit.

Projekt ligji i paraqitur nga ky grup qeveritar pune, i përbërë prej jo më shumë se 16-17 nene, jo vetëm nuk është hartuar sipas parimeve të mësimpërme, por nuk ka marrë parasysh as vullnetin e drejtpërdrejtë të grupeve minoritare të shprehur në propozimet e tyre enkas për këtë projekt ligj dhe ligj.

Drafti i përgatitur dhe i shpërndarë në monetet e fundit, përbën në fakt një kopje me deformime serioze të disa prej neneve të Konventës Kuadër për minoritetet kombëtare. Në këtë kuptim ky ligj është i pavlefshëm dhe i panevojshëm pasi Konventa Kuadër që nga momenti i ratifikimit në Parlamentin shqiptar ka fituar statusin e legjislacionit vendas dhe e tejkalon shumë këtë ligj kuadër që po përgatitet të kthehet së shpejti në ligj.

Në draftin e paraqitur, me të drejtë kryetari i ish komisionit këshillues për hartimin e Konventës Kuadër zoti Hofman vuri në dukje kopetencat e shtuara së tepërmi të ekzekutivit në kontrollin dhe implementimin e të drejtave të minoriteteve. Sipas këtij drafti të drejtat e minoriteteve përmbliidhen në konceptin qeveritar të konsumimit të atyre të drejtave dhe në atë nivel që përcakton vullneti i ekzekutivit. (Pas çdo neni thuhet se për këtë, ose për atë vendos kryeministri, ose ministri i linjës).

Vullnetin e kontrollit të ekezekutivit mbi këto të drejta e vërteton edhe një fakt tjetër. Dihet që implementimi i një ligji të tillë, apo i vet Konventës Kuadër, kërkon domeos prejken dhe amendimin e një numri të madhë ligjesh të tjera të natyrës civile. Qeveria, sipas këtij drafti e ka zgjidhur këtë domosdoshmëri ligjore me përqëndrimin e kopetencave operacionale në zbatim të tij, në duart e veta.

Në këtë plan, del si domosdoshmeri që qeveria të heq dorë nga një ligj me parametra përgjithësuese dhe me kopetenca të shtuara në duart e ekzekutivit për

implementimin e tij. Ajo, ose duhet të synojë një ligj të gjerë me specifikime sa më të qarta dhe detajime sa më të plota, në kuptimin e garantimit prej tij (dhe jo prej vullnetit të ekzekutivit) të të drejtave të minoriteteve, ose paketa përgjithësuese të shoqërohet me amendimet e duhura të ligjeve të tjera që të garantojnë këto të drejta. Drafti i deritanishëm i qeverisë, sipas referimeve të përfaqësuesve ndërkombëtar pjesëmarrës në konferencën e sipërcituar, bën që Shqipëria të mbetet shumë prapa të gjitha vendeve Ballkanike, duke përfshirë edhe Kosovën.

Së fundmi, drafti nuk parashikon asnjë përkufizim për natyrën, përbërjen, shtrirjen, rolin e minoriteve në vend. Argumenti se për kësi rastesh kemi një traditë dhe një realitet të dhenë, nuk përbën asnjë garanci në përcaktimin sa me real të natyrës së minoriteteve dhe peshës së tyre. Ndërkohë që projekt ligji bën fjalë për minoritetet kombëtare, Ministria e Jashtme e quan të arsyeshme të nënkuptojë nëpërmjet këtij ligji të gjitha minoritetet e shfaqura në vend, qofshin këta kombëtarë, apo jo këmbëtarë, kulturore apo gjuhësore.

Pra në një analizë finale, projektligji për minoritetet kombëtare, i cili pritet që shumë shpejt të shndërrohet në ligj, nuk përmbush asnjë parametër për të qenë një ligj i standarteve evropiane. Ai synon të ketë vlerën e një formaliteti që mund të ndihmojë në konsideratën e plotësimit të njërit prej kushteve të BE-së për hapjen e negociatave me BE-në, por aspak nuk mund të përbëjë një ligj që garanton në realitet të drejtat e minoriteteve. Aq me pak mund të konsiderohet ai si një akt ligjor me vlera historike. Parë në këtë kendveshtrim, kjo “detyrë” me gravitetin e njohur në sensibilitetet perendimore, e paraqitur si “e lehtë” dhe “e kryeme” prej kryeministrit, mund të shndërrohet, nëse nuk është kthyer, në gur Sifizi me të rendë se vet reforma në drejtësi pretenduar nga qeveria si kushti i vetëm për të fituar hapjen e negociatave e vendit kandidatat për në BE.

Panajot Barka per gaz TEMA 20.11.2016

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2016/11/30/rama-dhe-gjuha-e-kadifenjte-e-erdoganit-te-merkeli/>

<https://www.faxweb.al/rama-dhe-gjuha-e-kadifenjte-e-erdoganit-te-merkeli/>

### **Rama dhe gjuha e kadifenjtë e Erdoganit te Merkeli.**

30.11.2016

Vizita e Kryeministrit Rama në Berlin, midis të tjerash, përbën një mesazh të qartë në lidhje me seriozitetin politik të Tiranës në raport me partnerët perendimorë.

Në deklaratën e tij në konferencën përbashkët për shtyp me zonjën Merkel, kryeministri kishte një dyzim (ose një gjuhë me kulaç dhe kërbaç) që nuk vërteton thjesht se kjo vizitë ishte larg rezultateve të aspiruara prej tij në lidhje me hapjen e procesit integruar të vendit në BE, por që vë në dyshim seriozitetin e Tiranës për orientimin e vet politik. Në deklaratën e tij, Rama u përpoq të riaktivizonte të gjithë arsenalin e argumenteve të tij në lidhje me interesin e dyanshëm, të BE-së nga njera anë dhe Shqipërisë e Ballkanit Perendimor nga ana tjetër.

Njëkohësisht ai i kujtoi zonjës së parë të Evropës, të cilën kish arritur t'i fliste dhe në njëjës dhe në emër, se “në këtë situatë shumë pozitive, as ne dhe as partnerët evropianë nuk duhet ta marrin si të mirëqenë njëherë e përgjithmonë atë që kemi arritur, sepse në rajonin tonë veprojnë edhe aktorë të tretë që synojnë të shfrytëzojnë çdo lëkundje, paqartësi apo vakum që mund të krijohet në marrëdhënien tonë me BE-në”

Kjo diplomaci ka një interpretim fare të thjeshtë. - Shiko, thotë, po qe se ju nuk na hapni derën, ne na presin edhe të tjerë. (!!)

Dhe në këtë artikulum, kuptohet që Rama nuk e ka fjalën për Rusinë të cilës i ka mbyllur portën në surrat për të treguar devotshmerinë e tij perendimore. Ai ka parasysh Turqinë dhe faktorë të tjerë të spektrit islamik që veprojnë në Shqipëri dhe rajon.

Në këtë sens, gjuha e Ramës ishte ana e kadifenjtë e gjuhës kërcenuese që përdori Erdogani ndaj Perendimit dhe BE-së pak ditë me parë, kur kjo e fundit, kuptohet me vullnetin parësor të Gjermanisë, ngriu procesin e bisedimeve integruar për në BE të Turqisë.

Në fakt, kjo gjuhë e Erdoganit nuk lidhet aq me këtë vendim të BE-së, por me zhvillimet në Siri dhe në rajonin me të gjerë në Juglindje të Turqisë. Lidhet veçanërisht me frikën e saj për krijimin e shtetit Kurd dhe humbjen e rendësisë së vet gjeostrategjike. Në këtë kuptim, Turqia nuk kërcenon vetëm me prishjen e njëanshme të marrëveshjes së refugjatëve me BE-në (flitet se një arsenal i ri i fuqishëm transportues refugjatesh drejt ishujve grekë dhe vendeve të tjera evropiane është instaluar në Azinë e Vogël) gjë që do të sillte një këkëçarje të mëdha për Evropën. Si kundrapeshë e këtyre zhvillimeve të munshme, ajo kërcenon edhe me shkelje të njëanshme dhe të dhunshme të akteve ndërkombëtare të vendosjes se rendit egzistues kufitar në këtë pjesë të Evropës, marrëveshjen e Lozanës, që në fund të fundit ato janë edhe kufijtë e BE-së.

Gjuha e Ramës tregon se ai nuk mund të jetë një Erdogan tjetër ndaj Evropës, por një shtesë e tij në Ballkan, apo një instrument i tij për aq sa interesat kombëtare të shqiptarëve, përputhen me ambicjet neotomane të Erdoganit në rajon. Në gjuhën evropiane ky nënkuptim i deklaratës së Ramës, artikulohejt krejt ndryshe. Artikulohejt si “Shqipëri Evropiane”, pra si një bashkim i të gjitha trojeve shqiptare në një Evropë të Bashkuar. (!!)

Faktin e një partneriteti të tillë me Turqinë e shpreh hapur edhe Presidenti i Republikës. Në një emision të ditëve të fundit televiz, Nishani, as me shumë e as më

pak, tha se Turqia përbën një faktor ekulibrues i stabilitetit në Shqipëri, (për të cilën flitej në emision) dhe në rajon. Presidenti Nishani nuk përmendi se cilët janë faktorët që e kërcenojnë këtë stabilitet dhe as faktin që pse në kuadrin e NATO-s Turqia zë për Shqipërinë faktorin kyç të ruajtjes së këtyre ekulibrave dhe stabilitetit.

Ky kendveshtrim na lëjon të interpretojmë ndër të tjera arsyet perse Tirana në raport me Greqinë zgjodhi si përcaktuese të së ardhmës së marrëdhënieve midis të dy vendeve ato probleme të së kaluarës që derivojnë te interesat e së shkuarës dhe të tashmës të Turqisë në rajon, sidomos ndaj Greqisë, të ricikluara sot nga Erdogani.

Po ashtu, Turqia ka kohë që interesat e veta në Shqipëri i ka avancuar edhe pse jo në nivelin që ndoshta ajo do të dëshironte. Madje në këtë anë peshon edhe balanaca e ndihmës së saj për Shqipërinë. Lë të mos harrojmë se në vizitën e tij të largët Turgut Ozal kërkoi heqjen e bustit të Skendërbeut nga selia jonë presidenciale. Me 1998 Ankaraja kondicionoi ndihmën për ushtrinë shqiptare me garanci marrjen e bazës ushtarake të Pashalimanit dhe me vonë edhe të aeroportit të Kucovës. (Në të njejta rrethana Italia mori ishullin e Sazanit dhe Greqia kërkoi ndërtimin e një spitali multifunksional në Gjirokastrë i cili për gati dhjetë vjet u shërbeu mbi 30 mijë shqiptarëve). Sipas presidentit Nishani, Turqia zotëron pjesët më stragjike të ekonomisë së vendit, të telekomunikacioneve, industrisë së metaleve dhe mineraleve, të energjitikës etj. Por mendoj, se arritja më e madhe është mentaliteti i krijuar në sferat kontrolluese të opinionit publik. Se Turqia nuk është thjeshtë një aleat strategjik, por një vend mik dhe vëlla. Dhe është i tillë jo për shkak të historisë, por, siç thotë edhe Presidenti Nishani, tek Turqia shihet partneri ekulibrues ndaj faktorëve të tjerë që trajtohen herë hapur e herë mfshehtas si armiq të Shqipërisë. Madje, në emër të këtij qëllimi harrohet edhe historia e vërtetë e raportëve të Perandorisë Otomane, trashëgimtare e së cilës është Turqia, me popullin shqiptar. Derivat i këtij partneriteti, është rikrijimi, pavarësisht nga format e shfaqjes, të konfliktit të mileteve fetare përgjatë fundit të Perandorisë Otomane e që shërbeu si shtysë kryesore për formimin e kombsheteve në Ballkan, me përjashtim të Shqipërisë.

Aq e vërtetë është kjo sa që edhe sot në Shqipëri, anashkalohet si zyrtarisht edhe publikisht fakti se nga kush Shqipëria fitoi pavarësinë dhe si e fitoi atë. Madje shkohet deri atje sa në ditën e Pavarësisë shfaqen bashkërisht flamuri kombëtar i Shqipërisë me atë të Turqisë. Ndërsa katër vjet më parë, në 100 vjetorin e këtij eventi, kryefjala që i jipte tempin festës, ishte nacionalizmi ndaj fqinjit jugor, se sa vet eventi i pavarësisë si e tillë. (Dhe atëherë këto daulle pushuan pasi Perendimi i hoqi fort veshin Tiranës zyrtare).

Ndoshta Rama ka të drejtë në artikullimin e tij për atë punën “e të treteve”. Se Perendimi i shkaktoi aq shumë dilema në marrëdhëniet e tij me Erdoganin. Më të ardhur në pushtet Rama shpalli se me qeverinë e Erdoganit do të bënte mbledhje të përbashkëta, por kjo nuk ndodhi edhe përse si praktikë nuk është e denueshme. Eshte e vërtetë se Rama lëjoi aplikimin kulturor të neotomanizmit në Shqipëri, ngritjen e xhamive të shumta saqë sot Shqipëria e parë nga lart ngjan një vend krejtesisht mysliman. Por njëkohësisht Rama hoqi vallen e krishtërit katolik të shqiptarëve. Pritja e Papës në Tiranë në njëvjetorin e qeverisjes së tij, ku mbisundoi thirrja e kthimit në origjinën fetare, flet njëqindfish më shumë se akti i tij i vetpërcaktimit si katolik. Kjo, megjithatë nuk e pengoi Erdoganin, disa muaj me vonë si i ftuar i ramës në Tiranë, të përcaktonte kufirin adriatik të Shqipërisë si kufirin e perandorisë së zemrës së Erdoganit dhe Erdoganin të përjetonte me lotë thirrjet në vargje të një të reje që të mos i braktiste shqiptarët. Po gjithashtu, Rama nuk pati fuqi të plotësonte asnjë nga kërkesat e Erdoganit ndaj kundërshtarit të tij më të egër, Gjylenit.

Të gjitha këto Perendimi i ndiqte me kujdes të padukshëm, ashtu si edhe thirrjen se fundmi me zë të lartë, “Falimenderit Erdogan” për uniformën e re të policisë, ndërkohë që nuk e kishin dëgjuar të bënte të njëjtën gjë për ndihmat dhe më të mëdha të Perendimit. Në këtë aspekt duket se Perendimi ishte gati të toleronte situatën në Shqipëri përsa i përket drogës, krimit të organizuar, korupsionit, reformave gjysmake, të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, proceseve të çala demokratike. Por jo të gjitha së bashku. Fund 29/11/2016

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2016/12/05/heqja-e-flamurit-grek-nga-nje-mjedis-familjar-dhe-domethenia-e-trishte-politike/>

### **Heqja e flamurit grek nga një mjedis familjar dhe domëthënia e trishtë politike.**

05.12.2016

Të dielën duke u gdhire e henë, me 4 dhjetor, tre veta ne Himarë kryen nje akt te paprecedentë persa i përket lirisë së të drejtave të njeriut dhe cenimit të pronës private. Ata, në mes të errësirës, dhunuan shtëpinë e një qytetari, banues në qytetin e Himarës, me qëllim heqjen nga taraca e saj simbolin e identifikimit të tij etnik, të cilin ky banor konkret dhe familëja e tij duan ta demonstrojë në këtë formë brenda territorit të shtëpisë së tij.

Me aktin e tyre ata, përveç se konsumuan plotësisht veprën penale të cenimit dhe dhunimit të pronës private dhe të lirisë së shprehjës së individit, krijuan edhe një precedent të rëndë politik. Aktin e mori përsipër një organizatë politike që vepron, sipas deklaratave të veta, në emër të Shqipërisë së madhe.

Kjo është njera anë e problemit. Ana tjetër dhe më e rënda lidhet me faktin se për këtë akt tëpër të rëndë dhe të paprecedentë, nuk ka asnjë protestë dhe asnjë veprim të ligjit dhe të personave dhe strukturave që përfaqësojnë ligjin. Asnjë organ policie, asnjë prokuror, apo organ tjetër i mbrojtjes së individit, i të drejtave dhe pasurisë së tij nuk ndërmoi asnjë hap dhe veprim për denimin e tyre.

Aq me keq kur fenomene të njejta janë përseritur edhe në të shkuarën dhe përseri organet kopetente heshtën. Rastin më flagrant e përbën ai i djegjes së flamurit grek në zyrat qendrore të OMONIAS në Sarandë para pak më shumë se një viti dhe deri me sot nuk ka asnjë informacion për qautorët e kësaj vepre.

Në paralel dhe me pozicionim më provokues e abuzues është qëndrimi i opinionit publik dhe sidomos ai mediatik. Medjat tona, jo vetëm nuk mbajtën qëndrim, por mashtruan kur thanë se flamuri grek ishte ngritur në një mjedis publik siç ishte kalaja e vjetër e Himarës. Po ashtu ata mashtruan kur thanë se ai flamur ishte ngritur dy ditë me parë, ose menjëherë pas veprimtarisë së OMONOIAS dhe PBDNj-së në Tiranë për problemet e pronësisë së Himarës. Ndërkohë, dihet nga të gjithë se ai flamur qëndronte në cepin e asaj shtëpie i pahequr të paktën dy vitet e fundit dhe nuk kishte asnjë lidhje me kalanë. Po ashtu, disa medja për të krijuar bindjen se po bëhet fjalë për një “fushatë ekspansioniste nacionaliste greke që zë fill pas kësaj veprimtarie, (e cila, sipas medjave shqiptare, edhe ajo vet u zhvillua në logjikën e klimës së kohëve të fundit në marrëdhëniet Greqi-Shqipëri), zbuluan se edhe parulla “me përmbajtje nacionaliste greke” të shkruara në një mbetje tarace diku anës rrugës në jug të vendit që para 10 apo 15 vjetesh, ishin shkruar pikërisht këto ditë dhe me këto qëllime (!!!). Për “një fakt” shtesë shërbeu bjë artikull i gazetës greke “Stohos”. Madje, duke iu referuar kësaj gazete që e lexojnë vetëm ata që e shkruajnë, u tha në medjat shqiptare se ky është qëndrimi i mbarë shtypit grek. (!!!)

Në këtë gjykim, veprimi prej cubash nate dhe në konsum të veprës penale i tre personave në emër të një organizate ekstremiste nacionaliste, u përcollë opinionit publik nga medja shqiptare si një akt trimerie dhe heroizmi kombëtar shqiptar, i pavenë nga askush në dyshim!

Pra, në këto rrethana lëxohen qartë disa mesazhe. Së pari kemi nxitjen e nacionalizmit shqiptar në formën e antihelenizmit, me bazë, kësaj here, praninë e një organizate që lufton për një Shqipëri të madhe. E tregon këtë fakti se në Shqipëri nuk

digjet, nuk perdhoset, nuk anatemohet asnjë flamur, apo simbol kombëtar i ndonjë vendi tjetër, përveç ai i Greqisë. Në Shqipëri nuk prodhon reaksion nacionalist, as flamuri turk, as flamuri amerikan, as flamuri anglez, skocez, madje as ai i ISIS, por vetëm flamuri grek! Së dyti, në Shqipëri vetëm të drejtat e njeriut dhe të drejtat etnike që lidhen me qytetarët shqiptarë me kombësi greke konceptohen si të drejta që duhet të jenë nën kontrollin e rreptë të çdo strukture nacionaliste shqiptare dhe se duhet të jipen ato me pelqimin e tyre. Heshtja e strukturave shtetërore dhe qëndrimet analoge të tyre me to, vërteton se kemi të bëjmë me një klimë unike që duhet pranuar pa kundërvenie, ose çdo kundërvenie është e padobishme. Së treti, në Shqipëri, klima e të drejtave të njeriut në lidhje me minoritetin etnik grek nuk duhet të kapërxëjë standartin e vendosur, jo prej akteve ndërkombëtare dhe kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, po prej mjedisit nacionalist shqiptar, që në jetën e përditshme përkthehet se që të jesh një minoritar grek i pranuar nga ky mjedis duhet të mohosh identitetin etnik grek, ose të paktën të mos e deklarosh atë, ose ta manifestosh në mënyrë formale dhe pa vlera.

Pra, akti i heqjes me dhunë të një simboli etnik nga mjedis familjar privat, përbën mbi të gjitha treguesin e një shkalle shumë të lartë të presionit mbi komunitetin e minoritetit etnik grek për shkak të kësaj perkatesie edhe brenda në familje.

Fakti që as për këtë akt të paprecedentë nuk kemi asnjë protestë dhe asnjë reagim nga strukturat e përfaqësimit politik të këtij minoriteti, përbën një argument edhe më bindës në favor të këtij kongluzioni. Pra, vet këto struktura me mandat politik tregojnë frikë, një frikë që nuk mund të justifikohet kësaj here as me faktin se ato i përdorin shpesh fatet e minoritetit për interesat e tyre të ngushta politike.

Një situatë e tillë u vjen përshtat edhe instancave zyrtare të shtetit, pasi mund t'i përdorin dhe t'i manipulojnë ato sipas rastit dhe interesave të tyre. Por në fund të fundit ky akt i ndodhur dhe akti i mosreagimit denues dhe krijimi i një klime mituzuese heroike kombëtare, tregon se është zhbërë dhe çdo deklaratë e respektimit të të drejtave të minoritetit etnik grek në Shqipëri, se ai mund të mirret peng i çdo situatë në marrëdhëniet shqiptarogreke, se ky minoritet mund të keqpërdoret si kundërvenie për çdo synim nacionalist të pretenduar dhe të pamundur nga pala shqiptare.

Panajot Barka

Për gazetën TEMA 05.12.2016

## **Nga Panajot Barka**

<https://www.cna.al/2016/12/09/nga-panajot-barkasulmi-i-ulet-ndaj-kodhelit-dhe-nevoja-per-me-shume-maturi/>

<http://time.ikub.al/Lajme/16-12-10-Sulmi-i-ulet-ndaj-Kodhelit-dhe-nevoja-per-me-shume-maturi.aspx>

<https://www.cna.al/tag/panajot-barka/>

### **Sulmi i ulët ndaj Kodhelit dhe nëvoja për më shumë maturi**

09.12.2016

Sulmi medjatik pa asnjë kriter moral ndaj Mimi Kodhelit është një ngjarje thellësisht e denueshme që provokon neveri dhe të detyron minimalisht të bertasesh me zë të fortë dhe publikisht “MJAFT më!!”.

Për një mendje të arsyeshme dhe te ftohtë publikimi i një materiali të tillë është i denueshëm. Sido që të jetë, përbën shpifje dhe tregon gremisjen në batac të mjedisit publik. Ne aspektin civil dhe etik ky sulm poshterues përbën një kercenim për vlerat humane dhe për moralin e çdo shoqërie të emancipuar dhe të hapur.

Aq më tepër është i denueshëm për faktin se ky sulm i ulët për një person publik po përdoret nga grupe medjatiske nga të dy anët për të provokuar më shumë një klimë që po mbart një temperaturë relativisht të lartë ballafaqimi. Duke mos përbërë në asnjë rast dhe për asnjë moment apo situatë argument dhe duke u nisur nga ndjeshmeria dhe vlerat femerore dhe intelektuale që imponon vet Mimi Kodheli, ky sulm, mbart rrezikun e madhë të provokimit të një orteku të pakontrolluar reagimesh e kundërreagimesh dhe të imponimit dhe mënjanimit të arsyes më të ftohtë dhe më të fortë. Pra, po kthehet në mjet për të degjeneruar faktorin shoqëror në turmë, pa lenë asfare hapësisë për të parë e menduar nëse shoqëria e ka të nevojshme një zgjidhje të tillë (gjë që normalisht është e papranueshme) apo i imponohet dhe ajo s’ ka forca për të reaguar (gjë që është tepër e rrezikshme).

Nuk besoj se mund të gjendet ndonjë argument për të justifikuar medjat greke që u morën me këtë akt të ulët. Nuk besoj se mund të tolerohet as fakti se ato u perkasin spektrit të një ekstremi të caktuar, as fakti se gazetarët që ndërmorën këtë akt janë periferikë dhe pa peshë në medjat greke dhe në opinionin publik grek. Nuk përbën justifikim fakti se për shoqërinë greke ngjarje të tilla, të karakterit të verdhë, kalojnë pa u venë re dhe pa i bërë kujt përshtypje dhe mbi këtë bazë injorimi i tyre arrihet nëpërmjet intiferentizmit. (Siç edhe u veprua) Ngjarja nuk është e rendë edhe për faktin se përbën shpifje. Është më shumë e rendë se u gjet një mënyrë e ulët vulgare, por tepër efikase për t’u rimarrë e ricikluar në anën shqiptare për t’u bërë pjesë aktive dhe argument për të motivuar në unison medjat dhe opinionin publik shqiptar në revanshin e tyre antihelen, por edhe për të venë në pozitë qeverinë greke e cila ka kohë që me gjithfarë formash i kërkon Tiranës uljen e dyanshme të toneve të retorikës nacionaliste. Rezultati u dha plotësisht të drejtë!

Në anën shqiptare u manifestua në përgjithësi një zell për faktin se u erdhi në dorë një shfaqje e tillë e shëmtuar dhe e denueshme për të mbështetur dhe adresuar gjithë mllefin antigrek pa dallime dhe diferencime. (Në këtë sens mund të thuhet pa frike se autorët e njihnin ose e kishin të shkelur këtë terren.) Kështu, medjat shqiptare vrapuan për të promovuar ato pamje të renda, fyese dhe poshtëruese për një zonjë të respektuar dhe njëkohësisht deputete e ministre. Perse e bënë kur në pamje të parë tregonin “përkushtimin” absolut për ta marrë atë në mbrojtje!? Perse e bënë kur dihet se matura dhe mençuria në raste të tilla përzgjedh heshtjen! E bënë për t’ua hedhur atë si ushqim turmës nacionaliste dhe nacionalizmit të semurë. Edhe pse medjat shqiptare evidentuan se bëhet fjalë për një grup të vogël medjash të krahut ekstrem dhe fare pa peshë në Greqi, në Shqipëri u fol për të gjithë medjat greke dhe shtypin grek (!!). Edhe



pse e dihet fort mirë (dhe nga medjat shqiptare) se shoqëria greke as që vuri re një postim të tillë dhe e kaloi totalisht në heshtje dhe pa me të voglin rendësi, në shtypin shqiptar u gjet menyra për të evidentuar dhe identifikuar me këtë akt të ulët gjithë shoqërinë greke pa përjashtim, për të përcjellë në vijim mesazhin e gabuar dhe të paqenë se shoqëria greke ushqen një antishqiptarizëm të skajshëm, ndaj është i justifikuar antihelenizmi shqiptar.(!!) Në këtë sens, në medjat shqiptare u vu re ngutja e pafre për të mpleksur këtë akt me qeverinë greke dhe qëndrimet politike të dyasëshme të kohëve të fundit, duke treguar me këtë rast një diletantizëm profesional, ose me sakt peshën masovike që i ka kapluar ato. Akti aq i denueshëm u përdor përpos të tjerash si një mundësi për opinionin publik shqiptar për të manifestuar faktin se Minoriteti Etnik Grek në Shqipëri i gezon deri në diskriminim pozitiv të drejtat e tij etnike etj. (!!)

Këto konkluzione i bën më të prekshme fakti se në një formë apo në një tjetër janë parë edhe në të kaluarën me efekte të përhershme të rënda për marrëdhëniet midis dy vendeve. Po kujtoj njerin prej tyre, ndoshta të parin. Në fund të vitit 1991 një kuadër i OMONIA-s bëri një deklaratë personale në një nga gazetatat lokale më të humbura të Greqisë, sikur OMONIA përpiket për bashkimin e Vorio Epirit me Greqinë...(!!!) Gazetën, pavarësisht se ne nuk e gjetem asnjëherë, “e gjeti” ambasada jonë në Athinë. Lajmi u përhap si rrufe në Tiranë dhe po shkaktonte termet dhe në ambasadat e huaja. Ambasada amerikane na kërkoi të distancohemi dhe distancimi u bë menjëherë në parlament, por askush nuk e besonte. Deklarata e këtij kuadri të OMONIAS, të cilën askush nuk e pa, u përdor si argument për ta përjashtuar OMONIAN nga e drejta për të qenë subjekt elektoral. Marrëdhëniet shqiptaro-greke u futën në zgrip. Ngjarjet u pasuruan me fshesat greke kundër emigrantëve të paligjshëm atëherë shqiptarë në Greqi. Erdhi dëbimi i një arkimandriti grek me argumentin se shpërndante harta iredentiste në dem të Shqipërisë. Pasuan 6 kushtet e Micotakit, për të mbritur të ngjarja e Peshkopisë, arrestimet masive në minoritet, burgosja e pesë të OMONIAS etj.

Po të analizohet me kujdes, kohët e fundit kemi të pranishme dhe po konsumohen të gjitha elementët e asaj periudhe të largët, pavarësisht nga krahu nga vijnë, por me një dallim, se faktorët ndërvepruesë dhe përmasat e tyre janë shumfishë më me peshë. Shtojmë këtu faktin se në rastin e përpjekjes denigruese nga të dy anët të Znj Kodheli, u nënvizua më shumë realiteti ballafaques pozitive – opozitive në vend, por edhe përpjekja për të hequr qafe në emër të patriotizmit antihelen disa figura publike që guxuan të nxjerrin në pah disa probleme e temeta që e bejnë të vuaj shoqërinë shqiptare.

Te gjitha këto së bashku pra, e kthejnë në domosdoshmëri absolute jo vetëm thirrjen publike “MJAFT më !”, por edhe nevojën për të venë në veprim arsyen e ftohtë dhe të matur , për të parë ato shumë gjera që i bashkon të dy popujt dhe jo ato pak që i ndajnë, për të parë të ardhmën dhe jo të shkuarën, për të parë paqën dhe jo luftën e ballafaqimin.

**Panajot Barka**

Për gazetën TEMA 08.12.2016

## **Nga Panajot Barka**

### **Rra Shkullaku për më u pa, apo me pa?!**

19.01.2017

Pavarësisht nga kostoja, do të ishte një arritje madhe demokracie nëse vërtet çeshtja Shkullaku do të krijonte premisa “për më u pa”, dmth për të mundësuar medjat të gjenin rrugën e humbur. Fatkeqësisht, çeshtja Shkullaku vetëm sa na lëjon për të parë pak më thjellë nga sa duket, seç ndodh në pushtetin e katërt në vendin tonë, me atë pushtet që përbën garantin e funksionimit të parimeve të një jete civile dhe demokratike dhe kontrolluesin e tre pushteteve të tjera në terë shtrirjen e tyre. Më sakt u bë shkak që të dalë në shesh shkalla e kalbjes dhe e kapjes së pushtetit me mision real të vërtetën, krizën e tij të thellë dhe të gjithanshme.

Rasti i Mandit dhe i shumë të tjerëve me emër apo pa emër në publik, që i njohëm këto ditë, kanë fatin e njeriut, gazetarit, të tëpërt në një komunitet medjatik të marrë peng nga pronarët e medjave dhe në një shoqëri dhe shtet të mbërthyer nga kriza.

Në një kendvështrim më integral tregon realisht shkallën e degradimit të shtetit dhe kollonave që e mbajnë atë. Pra, pushteti i katërt, medjat, është kthyer me kohë, jo thjeshtë në pjesë e ingranazheve të kësaj kalbjeje, por në katalizator të këtij procesi dhe njëkohësisht në mbrojtës të tij, ose në instrument për të krijuar iluzionin optik të gabuar për shkallën e madhe të informalitetit të të gjitha strukturave të shtetit, deri të indi më i skajshëm i tij.

Sot shikojme një ballafaqim medjatik më intensiv për krizën brenda vet llojit të medjave, - krahasimisht me shpërthimet e krizave të tjera, si në sistemin e drejtësisë, të ekzekutivit, të legjislativit, të krimit të organizuar, të partive politike etj. E bën më të dukshmen dhe më tronditese fakti se të gjitha shpërthimet e tjera shfaqen nëpërmjet medjave. (Vetëm ama sa shfaqen, nuk është se zbulohen apo luftohen prej medjave). Medjat, ndryshe nga të gjithë faktorëve të tjerë kalbezuesë të shtetit, nuk kanë një sistem të brendshëm të vetin, të unifikuar dhe të imunizuar.

Po ashtu, në pjesën më të prekshme të këtij ballafaqimi publik të medjave evidentohen përplasjet eksponentesh medjatik, që tregon se ajo që njëkohësisht i bashkon dhe i ndan deri në përplasje krokodilesh, janë interesat okulte, pazaret kompromentuese, niveli i thellë i përlulës shërbyese, meskiniteti dhe imoraliteti ndaj parimeve, egoizmi dhe arbitrariteti, që kanë si definicion abuzimin e thellë me misionin e gazetarisë dhe publicistikës. Tregon në fund të fundit se kultura civile dhe ajo demokratike është akoma larg edhe nga shtresa më publike dhe opinionbërese të shoqërisë

Mungesa e një solidariteti të brendshëm medjatik, ndodh edhe për faktin se medjat janë kthyer me kohë në pjesë të kapur, nga sistemet e tjera që zotërojnë para, kuptohet të pista, ose duke i kaluar në kanalet e medjave i shndërrojnë ato në të pista, në këmbim të shërbimeve për të mbrojtur këto sisteme dhe interesa, të cilat nuk mund të mbijetojnë pa shtimin e pisllekut, abuzimit, korrupsionit. Aq nënshtruese dhe tragjike janë këto marrëdhënie të personazheve medjatike, saqë përpjekja më e vogël për t’iu kthyer lirisë së tyre, u kushton shumë shtrenjtë. Pra, ata janë kthyer në skllever me kullaro, me shumë para dhe luks, por pa lirinë e gazetarit në shërbim të së vërtetës.

Padroni më i madh i tyre është pushteti politik i shfaqur kryesisht nëpërmjet ekzekutivit, pasi ky pushtet ka arritur të kontrollojë, nëpërmjet parasë, të gjitha pushtetet dhe sistemet e tjera, po në emër të parasë.

Kriza në fakt vjen pikërisht nga kjo prishje e thellë e ekuilibrave që rregullojnë marrëdhëniet midis pushteteve dhe midis shtetit dhe shoqërisë e individit. Mbulesat dhe strehat që medjat i krijojnë në fakt realiteti për të fshehur deformimin e tyre të thellë dhe

antivlerat e mprehta nuk janë më rentabël. Aq e thellë është kriza e tyre sa që edhe streha e nacionalizimit nuk funksionoi.

Nga ana tjetër, frika e ekzekutivit për humbjen e pushtetit, të cilin e shikon si burim privilegjesh por edhe si mbrojtje efektive e atyre të fituar, është e lidhur pazgjedhshmerisht me nevojën për të kontrolluar gjithëçka që siguron ruajtjen e tij. Objektivisht, një situatë e tillë krijon premisa diktature dhe kjo rrugë bëhet më e lehtë kur kontrollon së pari medjat. Kjo tek ne po bëhet më e rrezikshme se duke qenë se medjat janë të lidhura me interesa okulte të ronarëve të tyre me pushtetin politik, shfaqin në maksimum një zell pa kufi për t'u kthyer në shërbetorë të pushtetit cilidoqoftë ai. Kjo shoqërohet me autocensurë që presupozon menjanimin e çdo elementi që me sjelljen e tij vë në dyshim këtë vasalitet.

Pra, edhe rasti i Armand Shkullakut, që në vende të tjera do të prodhonte një zinxhirë reaksionesh dhe reagimesh në favor të lirisë së humbur të shtypit, do të provokonte një lumë iniciativash për krijimin e shoqatave të gazetarëve vërtetë të pavarur, do të krijonte një përrua të rrembyeshëm për të thyer vargonjtë e politikës dhe të kimit të organizuar nga medjat, tregon se hapësirat e lirisë dhe të pavarësisë së shtypit tek ne, mbeten të kufizuara dhe pa përkrahje! Mbeten pjesë e terësisë së shoqërisë edhe pse në rastin e shtypit nuk ka vend risia që çdo popull meriton shtypin e vet.

FUND për gazetën TemA P. Barka date 19.01.2017

## **Nga Panajot Barka**

<https://www.faxweb.al/shqiponja-nje-akt-qe-nuk-duhet-toleruar-ne-emer-te-politikes/>

<https://www.facebook.com/gazetatema/posts/1248534398528058>

<http://www.gazetatema.net/2017/01/27/opinionperse-nuk-duhet-toleruar-shqiponja-e-ushtareve-ne-emer-te-politikes-se-dites/>

### **Perse nuk duhet toleruar “shqiponja” e ushtareve ne emer te politikës se dites**

27.01.2017

Akti i shtatë rekruteve në repartin ushtarak të Mesollongjit të ushtrisë greke, të cilët rezultuan se ishin shqiptarë e që me vullnetin e tyre të lirë kërkuan të bëhen shtetas grekë, provokuan perseri klimë konfrontuese në mjediset publike dhe politike të të dy vendeve. Në palën greke, edhe pse në menyrë të përmbajtur, vihen re qendrimet denoncuese ndaj këtij akti si të tillë me kërkesa për denimin e autoreve. Në palën shqiptare shpaloset masiviteti për të denuar qendrimin grek duke e paraqitur Greqinë si shtet me kulturë raciste, nacionaliste, shkelese të të drejtave të njeriut. Njëkohësisht bashkë me përpjekjet për të heroizuar të rinjtë në aktin e tyre kërkohet të ushqehet nacionalizmi shqiptar në dimesionin e tij antihelen.

Në palën greke, duke përsfshirë institucionet shtetërore me në krye Ministrin e Mbrojtjes Kamenon, kërkohet që akti të mos tolerohet dhe të veprojë ligji. Nga ana tjetër, është e dukshme tendenca, civile dhe shtetërore, medjatiske dhe intelektuale, që të mos i fryhet zjarrit që mund të përdeh një urejtje kolektive, sidomos ndaj emigranteve shqiptarë në Greqi.

Ajo që ngatërrohet në Shqipëri është fakti se manifestimi i simbolit etnik shqiptar nga të rinjtë rekrut ndodhi në një repart ushtarak dhe jo në jetën civile. Në një repart ushtarak, qoftë të Greqisë, të Shqipërisë, të Amerikës, të Kanadas etj rekruti ushtarak betohet para flamurit kombëtar të atij shteti për të mbrojtur dhe me jetën e vet interesat kombëtare të atij shteti. Madje edhe betimi civil për të fituar nenshtetësinë të njëjtë formulë ka, -përkushtimin i ndërgjegjshëm ndaj ineteresave kombëtare të atij shteti. Akti deheroik përm këta të rinj, që do të thotë se ata formalisht betohen ushtarakisht para flamurit grek si nënshtetas grek, por në fakt betohen para flamurit shqiptar, përbën një akt të paktën moralisht pse jo dhe juridikisht të denueshëm. Nga ana tjetër përpjekja për t'i trajtuar këta të rinj si viktime të nacionalizmit grek, pra si kandidatë për t'i shpallur heronj, u heq atyre, por edhe mjedisit publik të drejtën për ta toleruar rastin.

Por kur në Shqipëri shpallet hero një i ri që rrembën një autobus me nënshtetas grekë me pasojë vdekjen e dy prej tyre, apo të burgosur në Greqi për vepra të rënda penale, ashtu si heroin e preferuar të dronit në Beograd, klima e debatit të nisur tregon se pret një denim të tyre të mundshëm, larg qoftë, për t'i shpallur heronj dhe për të nisur një fushatë tjetër antihelene.

Këtu nuk bëhet fjalë për pjesëmarrje individesh në ekipe sportive, grupe kulturore etj, ku kërkohet thjesht kontributi individual nëpërmjet talentit personal për ngjyrat e një klubi apo të grupit artistik privat. Por për ushtrinë si një instrument shtetëror garant i sigurisë kombëtare dhe shtetërore, funksionimi i të cilit kërkon mbi të gjitha një shkallë të lartë ndërgjegjeje kombëtare, besnikerie dhe përkushtimi ndaj idealeve të atdheut dhe kombit të cilit i shërbën.

Nuk bëhet fjalë as për jetën civile. Në Greqi, toleranca në këtë drejtim është e njohur deri në kufijt e të qenit e kritikueshme. Dihet p.sh që në orkestren simfonike të Radiotelevizionit Publik Grek ERT, ka instrumentistë shqiptarë të cilët kur ekzekutohej himni kombëtar grek apo pjesë të tjera të këtij karakteri, ata nuk i interpretonin dhe askush nuk u thoshte një gjysem fjale. Dihet psh, që në shumë shkolla greke nxënësit

nuk duan të dëgjojnë mësimin për historinë e Greqisë dhe nuk mirret asnjë masë. Ose janë evidentuar raste, si në Korinth, që nxënës shqiptarë duke marr mesazhe nëpërmjet telefonit iu imponuan me dhunë mësuesës që te ndryshojë përmbajtjen e mësimin të historisë. Ose që opinionin publik grek iu imponua mentalitetit që nuk lejonte nxënësit shqiptarë të mbanin flamurin grek në veprimtari të karakterit kombëtar grek. Ose, dihet toleranca e institucioneve greke ndaj arogancës së bibliografisë shqiptare që pretendon gjithë arsenalin kulturor të lashtësisë greke për të ngritur një mit kombëtar shqiptar. Dihet që organët shtetërore greke kanë fshehur shpesh shifrat e veprave penale të shqiptarëve në Greqi vetëm për të mos lëjuar shpërthimin e antishqiptarizmit.

Por në fund të fundit një milion shqiptar që kaluan në Greqi, me një shifër konstante permanente prej më shumë se 600 mijë, nuk vajtën aty me ftesën greke. Dhe ishte e para shoqëria dhe më pas shteti grek që i priten, u dhanë strehë, punë, qytetari, kulturë. Dhe askush nga emigrantët nuk u pengua që të demonstrojë identitetin e vet etnik në çdo formë qoftë ai. (Tjetër gjë është karakteristika e përshtatjes shqiptare për të perfituar sa më shumë). Kuptohet, se në gjithë këtë shpërngulje dhe lëvizje paqësore të kësaj popullate nga Shqipëria për në Greqi, do të ketë edhe qëndrime të padenja nga populli pritës. Por këto rastësi në një akt me përmasa dhe vlera historike, kur shumëzohen me zero, ose nxihet, kjo besoj se nuk mund të tolerohet. Në këtë kendveshtrim, çfarë niveli tolerance kërkohet nga një shoqëri dhe një shtet për të qenë e pranueshme nga mentaliteti shqiptar, aq me tepër kur kjo mirret si dobësi dhe si tregues për të rritur dozat nacionaliste të antihelenizmit shqiptar.

Merret me mend se çfarë mund të ndodh nëse në një repart të ushtrisë shqiptare një nënshtetas rekrut qoftë ose jo grek, do të kishte guxuar të demonstronte publikisht simbolet kombëtare greke, apo të një shteti tjetër ndaj të cilit dozat nacionaliste dhe të armiqësisë janë në rritje. Lë të mos harrojmë se shteti shqiptar hoqi nga ushtria shqiptare gati 400 oficerë ushtarakë me origjinë greke, nuk la pothuaj asnjë oficerë policie dhe as mund të bëhet fjalë për pjesëmarrje të tyre në shërbime sekrete. Dhe bëhet fjalë për qytetarë me kombësi greke që kanë luftuar për lirinë e Shqipërisë, që kanë treguar devotshmeri të shkallës më të lartë për shtetin shqiptar, që kontribuan në të gjitha drejtimit për shtetin shqiptar.

Por pozat civilizuese në Shqipëri, nuk mund të kenë vlerë kur paraqesin si vepra patriotike apo kombëtariste shqiptare, rastet e heqjes së flamurit këmbëtar grek nga shtëpia private e minoritarëve grekë, kur heshtin për rastet e ekstremistëve të ndryshëm që futen natën në shtëpitë e minoritarëve, i kthejnë ato përmbys pa vjedhur asgjë, (pra e bëjnë për të ngjallur panik) por kur gjejnë simbolet e tyre kombëtare i marrin dhe i djegin pa patur frikë se do zbulohen ndonjëherë. Kur flamuri grek, edhe pse midis flamurit shqiptar dhe atij të BE-së hiqet nga një biznes privat mu në zemër të Dropullit, apo nga zyrat qëndrore të OMONIAS. Kur u bëhet jehonë thirrjeve që të debohen minoritarët nga shtëpitë e tyre, ose kur minoritarët nuk lejohen të shprehen për të drejtat e tyre pasi këtë rol përfaqësues të tyre e marrin në dorë zedhënësit e nacionalizmit shqiptar. Kur këtij minoriteti me menyra nga më monstruozet, që i tejkalojnë ato të perandorisë Otomane, i rrembëhen padrejtësisht mijra hektarë tokë. Kur ky minoritet viktimizohet apo mirret peng në emër të reciprociteteve të paqena dhe të shfrytjes së pezmit antihelen.

Së fundi, nuk është as e ndershme e as dinjitoze, përpjekja që bëhet, që për të minimizuar efektet e gjestit të të rinjve rekrutë shqiptarë në ushtrinë greke thuhet se nuk përbën një provokim apo fyerje për ushtrinë greke se Shqipëria dhe Greqia nuk janë vende në gjendje lufte, se jemi vende anëtarë të NATO-s, kemi nënshkruar traktatin e miqësisë etj, etj. Harrohet tymnaja e Ligjit të Luftës midis dy vendeve që mbahet gjallë dhe ushqehet dhe nga politika zyrtare. Po ashtu fakti që shqiptarët e pëllembave shfaqet

në ushtrinë Greke, nuk është çeshtje simboli shekullor i shqiptarëve, për arsye se Kastriotët e trashëguan nga krushqit e tyre Muzakët (me origjinë mollose) që e kishin fituar si nderim nga perandori bizantin për shkak të shërbimeve ndaj tij kundër bullgarëve. Pra ai shfaqet, aq me tepër në ushtri, si simbol etnik i një vendi që e shton retorikën nacionaliste në dëm të Greqisë dhe harta me Shqipërinë e madhe është vendosur dhe në instancione shtetërore nga më të rëndësishme në vend.

Mëgjithatë, për mendimin tim personal harxhimi i kaq shumë energjive për të gjetur armiq, ose për të kthyer në armiq popuj me të cilët të lidh thjesht miqësia, popujt me të cilët historia ka provuar se bashkëpunimi me ta (dhe flas këtu për popullin grek) të ka sjellë përparim dhe mbrothësi, ose akoma me keq te harxhosh kaq shumë energji për të mbajtur në kemb një realitet të kaluar, por të shtrembëruar në funksion të armiqësisë që i duhet për konsum politikës së ditës, kur popuj të tjerë për hir të së ardhmës së tyre harrojnë dhe plagë nga më të rënda historike, kjo mendoj tregon se civilizimi dhe kultura perendimore që pretendojmë në Shqipëri është akoma e mangët, dhe në vend që të vihet në funksion të emancipimit të vulgut, kridhet në të se ndihet komode nga përfitimet e momentit.

Nga Panajot Barka Për gazetën TEMA 26.01.2017

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetama.net/2017/02/04/ballafaqimi-llalla-lu-provokon-fenomenin-e-hidres-se-mitologjise/>

<http://fax.mk/read/news/7990066/13856166/ballafaqimi-llalla-lu-provokon-fenomenin-e-hidres-se-mitologjise>

<http://www.koha.tv/2017/02/04/ballafaqimi-llalla-lu-provokon-fenomenin-e-hidres-se-mitologjise/>

### **Ballafaqimi Llalla –Lu, provokon fenomenin e Hidrës së Mitologjisë 02.04.2017**

Java që lam pas shënjoi ballafaqimin e paprecedentë në këto 26 vjet tranjicioni, atë midis Kryeprokurorit A. Llalla dhe ambasadorit të SHBA në Tiranë D. Lu. Pesha e këtij ballafaqimi është e tillë, saqë sfumoi shkarkimin e beftë të ministrit Maniani dhe deklaratat e tij të bujshme kundër qeverisjes në vend, mbledhjen e KS së Shqipërisë me objekt rrezikimin e shtetit nga krimi i organizuar etj. Njëkohësisht nuk arriti ta sfumojë këtë ngjarje as vdekja e Driteroit.

Kohët e fundit ishim ambjentuar me serinë e ballafaqimeve, përplasjeve dhe konflikteve:- në radhet e krimit të organizuar e të korrupsionit, në drejtësi, në medja, në kualicionin qeverisës, midis pozitës dhe opozitës etj. Të gjitha këto përplasje kanë si shkak prekjen e interesave të paleve, veprimi i të cilave është në shkëlqje dhe në abuzim të ligjit, apo të parimeve demokratike. Por, ato kishin edhe “meritën” e mbylljes së shpejt të tyre në emër të ruajtjes së ekuilibrave që u sigurojnë ruajtjen e interesve të tyre okulte. Ndërkohë kurrë nuk kanë arritur, (kjo është e pamundur për ta) të eliminojnë shkakun e vërtetë të përplasjes.

Ballafaqimi i tanishëm ka ngjashmeritë dhe dallimet me ato të tjerat. Edhe ky ka kohë që ziente brenda strukturave me peshë në funksionimin e shtetit dhe të politikës si edhe në marrëdhëniet e tyre me aktorët ndërkombëtarë. Dallimi qëndron tek fakti se personazhet që u përfshin në ballafaqim prekin struktura të një rendësie të veçantë, siç është Ambasadori Amerikan dhe Kryeprokurori i vendit. Pra, në këtë rast kemi të paktën një diplomat me shumë peshë, i cili u kthye nga faktor në aktor të përplasjeve. Pikërisht për këtë shkak ballafaqimi nuk pritej të dilte në publik. Mëgjithatë, faktet në publik vërtetuan se aktorët e këtij ballafaqimi të ri veprojnë në marrëdhënie me të njëjtë faktorë kundër të cilave deklarojnë se janë angazhuar në emër të reformës për drejtësi.

Në këtë pikëpamje reagimi i Kryeprokurorit Llalla deklasifikoi në fakt asimetrinë e pozicionit të ambasadorit amerikan në Shqipëri. Pavarësisht saksionimeve të fundit kushtetuese reagimi i Llalës tregon se kemi të bëjmë me një tejkalim të rolit të tij nga ai diplomatik në atë të një primati të mirëfillt shtetëror, ose me keq, në mbrojtës të interesave që demtojnë vendin, apo të dosjeve penale që paraqesin interes për të. Problemi bëhet më serioz pasi ky rol, dhe jo vetëm i ambasadorit amerikan, u njehsua me formulën e nevojës për implementimin e reformës në drejtësi dhe reformave të tjera, të cilat në menyrë të qenësishme lidhen me shpëtimin e shtetit nga rrenimi fatal i tij dhe imponohet nga realiteti se strukturat e vet shtetit nuk kanë një apo disa shtylla dhe pika referimi ku të mund të mbështesin vetkurimin.

Pavarësisht se reforma në drejtësi u deklarua si premtim i një aleati strategjik ndaj popullit shqiptar, rezulton (nga deklaratat publike të Kryeprokurorit) se përfaqësuesi i këtij aleati në këtë mision të deklaruar, ose ka njolla të errëta që nuk lidhen me drejtësinë e premtuar, ose është i detyruar të mbështetet në segmentë të penalizuar për të luftuar elementë të tjerë mekatarë, ose të mbështetet në një krahë politik, i cili akuzohet nga pala tjetër se nëpërmjet kësaj reforme kërkon të kap ajo sistemin e drejtësisë, të kapur deri tani nga vet ajo, ose akuzohet se reforma e shpallur

dhe e përkrahur nga perendimorët do të përdoret për të eliminuar kundërshtarët politikë brenda apo jashtë palës ku mbështetet ambasadori amerikan.

Nëse vërtetohen akuzat e Lllallës ndaj ambasadorit amerikan, atëherë procesi i reformës në drejtësi do të rezultojë i kompromentuar. Ndërkohë, Prokurori i përgjithshëm, i cili është edhe vet një mekatarë me grada, siguroi përkrahjen e eksponenteve të lartë të shtetit ndaj akuzave të ambasadorit amerikan. Një akt që në fakt provokoi evidentimin kriminalizimit të faktorëve politikë në vend, por edhe të divergjencave të thella në kualicionet politike po për këtë shkak.

Kjo do të thotë se ballafaqimi i radhës nuk do të jetë i ashpër për shkak të antinomisë së rolit të ambasadorit amerikan, por për faktin se ai, si garant i një reforme simetrike dhe të drejtë drejtësie në vend, akuzohet se kontributi i tij mbështetet në logjikën e ekulibrave të vendosura nga faktorë thellësisht të kompromentuar nga krimi.

Pra guximi i Lllallës për të denoncuar ambasadorin Lu, nuk është se u aktivizua në mbrojtje të kushtetshmerisë për mos lëjimin e tij të përzihet në punët e brendshme të shtetit. Por motivet lidhen me kërcenimin dhe rrezikimin e statukvos së palëve në raport me krimin. Prishja e heshtjes nga Lllalla, do të thotë se dorashkat janë hedhur mbi tapet, se tanimë nuk ka kthim prapa, se potenciali i krimit ka rrenjë të thella dhe peshë të rëndë pushteti në punët e shtetit.

Kjo do të thotë se ky ballafaqim nuk pritët që të mbyllet si të tjerët, por me siguri do të sjellë zhvillime, të cilat për momentin nuk duken fort të parashikueshme. Reagimet e para po provojnë se nuk do të jenë aspak të lehta funksionimi i kualicionëve politikë, se palët e kërcenuara do të unifikohen dhe rezistenca e tyre do të jetë sulmi për të provuar kompromentimin me krimin edhe të palës tjetër. Pra, jemi në kufinj të ku Hidra e mitologjisë grumbullon energji për të reaguar me manyrën e saj.

Konstatimin e bën më të prekshëm fakti se realiteti i krimit në formë ose jo të organizuar, si pjesë thelbësore e politikës në ushtrimin e pushtetit nga pozitat e qeverisjes ose të opozitës, ka fituar të drejtën e qytetarisë dhe brenda parlamentit. Në seancën plenare të së enjtës, deputeti i mazorancës E. Braçe, mori fjalën për t'i thenë ish presidentit të Republikës dhe njëkohësisht ish Kryeministrit Sali Berisha, se ai nuk legjitimohet të flasë për inkrimimin e shumicës së tanishme, për arsye se ai në kohën e tij e ushtronte pushtetin në emër dhe së bashku me krimin. Kjo do të thotë se Braçe pranon inkrimimin e shumicës së tij, por që Berisha nuk ka të drejtën morale ta denoncojë.

Nga ana tjetër, duhet kuptuar se krimi në të gjitha format e tij, si instrumenta konkrete apo si mentalitet, nuk është se ka kapur pushtetin politik apo ekzekutiv, por ka kriminalizuar dhe vetë menyrën e funksionimit të shoqërisë dhe të opinionit publik. Krimi i organizuar pasi eliminoi në emër të qëllimeve të veta klasën e mesme në Shqipëri, forcoi pozitat e veta si klasa e lartë e politikës që zotëron gjithë ekonominë formale dhe informale dhe që ka marrë peng shtresën e ulët, e cila mbijetesën e vet e shikon tek therrimet që do të teprojnë nga sofra e pasur e të pangishmeve të kësaj shtrese (fenomen i shtrirë deri tek influenza dhe blerja e votës). Ka paralizuar instrumentat dhe mekanizmat e veprimit të shoqërisë civile dhe ka shtënë në kontrollin e vet sistemin që garanton ndryshime dhe reforma në funksionimin e shtetit. Është kjo arsyeja se reforma në drejtësi mund të pres disa koka, por nuk do të mjaftojnë as si shëmbull për të tjerët, pasi ajo nuk ka mundësi të prek sistemin që prodhon padrejtësi shtetërore dhe individuale. Dhe në këtë drejtim rasti Lllalla pohon se garanti Lu e ka të vështirë të implementojë atë sistem drejtësie që vërtet i duhet popullit shqiptar. Ndoshta kjo një ditë mund të arrihet, por jo në mandatin Lu. Lu mund të jetë dhe viktimë e ardhjes së kësaj reforme.

Për gazetën Tema nga P. Barka 04/02/2017



## **Nga Panajot Barka**

<https://www.javanews.al/antinomia-e-shtetit-sot-krize-informale-apo-krize-institucionale/>

<http://time.ikub.al/Lajme/17-04-10-Antinomia-e-shtetit-sot-Krize-informale-apo-krize-institucionale.aspx>

<http://www.gazetatema.net/.../antinomia-e-shtetit-sot-krize-.../>

<http://shuplaka.com/meta-kerkon-nje-qeveri-besimi-te-kriju.../>

### **Antinomia e shtetit sot:-krizë informale apo krizë institucionale.**

10.04.2017

Republika e re apo Republikë e rrugës? Struktura e shtetit shqiptar jeton kohët e fundit një antinomi paradoksale. Ligjerimet ekstra institucionale propagandistike, krijuan imazhin e rrëmë, të një realiteti demokratik të ri, të hapur, pa kufi. Ky imazh, përveçse është informal është dhe i rrezikshëm. Tregon, së pari, pushtetin pa kufi të politikës dhe të politikanëve dhe dobësimin pa limit të shtetit dhe strukturave të tij. Së dyti zhvillohet jashtë institucionëve demokratike të shtetit. Së treti, nëpërmjet ballafaqimit jashtinstitucional dhe me kritika ekstreme (opozita flet për kriminalizimin e shtetit nga ana e qeverisë aq sa zgjedhjet janë të pakumtimta dhe pozita flet për frikën e opozitës nga dekriminalizimi aq sa pengon zgjedhjet), kërkojnë të shmangin realitetin për peshën e krimit të organizuar në jetën e shtetit dhe të vendit dhe të rilegjitomohen udhëheqësit politik përgjegjes në dhënien e aksesit të krimit për të zënë shtetin dhe për të kthyer politikën në derivat të tij. Këtë vërteton kërkesa për dialog si argument për të zgjidhur një krizë që nuk ka asnjë dimesion kushtetues. Në këtë kuptim del në plan të parë jo kushtetuta dhe shteti ligjor, por vullneti “politik” i politikanëve që përvalon ligjin dhe shtetin. Aq me keq kur ky realitet imponohet nga të gjitha palët për të fshehur të vërtetën e paralizimit të shtetit dhe të demokracisë.

Së pari. Është abandonuar parlamenti. Po të kishim një krizë të vërtet institucionale do të kërkohej zgjidhja në këtë insticion. Por bëhet fjalë për krizë informale, krizë të vetës dhe të ambicjeve të veta politike. Ndaj kanë paralizuar parlamentin për ta zevendësuar me rrugën, me çadrën, me ekranet e televizionëve me mitingjet. Abandonimi i insticionit kryesor të shtetit demokratik, nuk lidhet aq me frikën e vetingut dhe reformës në drejtësi, se sa me ndërgjegjësimin dhe të politikës për domosdoshmerinë e ndarjës së krimit nga politika e nga shteti dhe pamundësinë absolute për realizimin e kësaj ndarjeje nga kjo klasë politike. Edhe beteja politike në rrugë bëhet sipas këtij formati.

Kjo determinon në mënyrë me të theksuar braktisjen e institucioneve dhe kultivimin e kaosit.

Së dyti po braktiset institucioni bazë i demokracisë, ai i zgjedhjeve. Kjo është një fakt që provohet se po ndodh edhe zyrtarisht. Dhe nuk ndodh vetëm nga opozita që e deklaron publikisht mospjesëmarrjen në zgjedhje, por edhe nga pozita e cila është dhe përgjegjese për mbarëvajtjen e tyre. Opozita po ndërmerr kështu një akt parimisht antikushtetues. Kërkon qeveri teknike pa kryeministrin aktual, gjithsesi kushtetues, Ajo edhe pse ka në dorë instrumenta kushtetuese për të goditur krimin e organizuar, është venë në rolin e publikut që e përjeton situatën e krimit, por nuk ka instrumenta për ta goditur atë. Në këto 50 ditë të çadrës “së republikës së re”, opozita nuk ka promovuar asnjë argument kushtetues për të justifikuar kërkesën e saj. Asnjë dosje nuk po dërgon në insitucionet e shtetit për të vërtetuar akuzat publike për kapjen e qeverisë nga krimi dhe rrezikimin e zgjedhjeve nga ky krim. Ndërkohë që i jep të drejtën qeverisë të distancohet nga krimi dhe situata e krimit.

Por ky qëndrim i opozitës lë pa pjesëmarrje reale dhe institucionale në procesin zgjedhor dhe pozitën. Këtu nuk bëhet fjalë për paralizimin e strukturave të administrimit zgjedhor, por për ngerç të vërtet elektoral. Në fushatën e vet elektorale qeveria më shumë kërkon të bind vetën dhe elektoratin se opozita nuk ka të drejtë. Pra, as ajo nuk shpalo programin e vet elektoral. Në një analizë më të thellë, pozitës i lëvdis një situatë e tillë. Kjo i siguron fitorën e zgjedhjeve pa obligime ndaj elektoratis dhe, madje, duke tejkalluar shumë ambicjet e veta në numra. Një gjë e tillë do të krijonte mundësi për të hequr nga kurrizi aletët që e bezdisin për interesat e ambicjet e tyre, por do të shtonte rrezikun e thellimit të autotarizmit në mandatin e ri.

Së treti. Këto zhvillime defaktorizuan dhe rolin balancues në dukje të aleatëve të PS-së, sidomos të Metës. Qëndrimet e LSI-së, nga njera anë sjellin paralizimin e veprimtarisë dhe të pushtetit ekzekutiv, (kur pushteti tjetër, ai i drejtësisë, i kapur, nën peshën e korrupsionit dhe të kërkesave për reformim, është me kohë i paralizuar dhe mosbesues në garantimin e funksionimit të shtetit). Nga ana tjetër vërtetojnë praktikisht informalitetin e krizës në vend. Meta kërkon një qeveri besimi të krijuar në tavolina bisedimi, kur vet bën pjesë në një qeveri kushtetuese. Qëndrimi i tij në pamje të parë duket se çel një dritare për zgjidhjen e krizës, por në fakt ndodh e kundërta. Meta, po të jetë se është korrekt në kërkesën e tij, mund t'i drejtohet parlamentit. Ta rrezojë qeverinë ku ben pjesë dhe në vijim të krijojë institucionalisht një “qeveri besimi” për zgjedhjet apo deri në zgjedhje, me Ramën apo pa Ramën kryeministër. Por, duket se edhe ai i bën llogaritë në logjikën e demokracisë informale. Lëvizja e Metës dhe insinuatat ndaj qeverisjes ku bën pjesë, nga njera anë u duk si shkelje syri për Bashën, (për më tepër kur derivon pjesëmarrjen e LSI në zgjedhje me atë të opozitës), nga ana tjetër u kuptua si presion ndaj Ramës për të përfutuar maksimumin në ndarjen e pushtetit të ardhshëm. Por qëndrimi i Ramës në referencë të kushtetutës, i imponuar mësa duket, nga krahu anti Meta në PS, jo vetëm që e dafaktorizon Metën, por krijon një situatë të re gjithsesi më të ndërlikuar dhe në krizën informale të politikës.

Së katërti. Është ndoshta hera e parë që faktori ndërkombëtar nuk dënjon të mirret me “krizën” në vend. Arsyet mund të jenë të shumta, por tri me duket se janë më kryesore. Lodhja dhe zhgënjimi që pesoi me angazhimin e tij të gjatë me politikën shqiptare. Së dyti kuptimi prej faktorit të huaj se në thelb egziston një krizë e thellë në vend që është kriza e politikës së kapur nga krimi dhe se çdo zgjidhje e ofruar brenda këtij sistemi politikanësh nuk e zgjidh problemin. Arsyeja e tretë lidhet me faktin se përfaqësuesit politikë të faktorit shqiptar në rajon e humbën aftësinë për të qenë si faktor stabiliteti ashtu edhe faktor destabilitetit në këtë rajon.

Pra nuk gjendemi në një situatë krize institucionale, por në një situatë që i ngjan asaj të para 9 marsit të vitit 1997 me disa ndryshime të vogla. Atëherë rrenja totale e shtetit ishte mëse e dukshme. Ishte shkaktuar nga revolta popullore pasi shteti i kapur nga pushteti ekzekutiv ishte kundërvënë totalisht popullit. Tani kemi një shtet të cilin nxiton ta shpërbëjë me çdo kusht politika se, ose është kapur prej përfaqësuesve të saj dhe kimit, ose se shteti mund të hakmerret ndaj tyre.

Me 1997 pikëmbështetja e vetme e shtetit ishte institucioni i një presidenti të paligjshëm. Sot, presidenti është i pandjeshëm dhe në ditët e fundit të mandatit të tij. Presidenti i paligjshëm 1997 realizoi një tavolinë informale ku prodhoi një qeveri të votuar në një parlament të paligjshëm dhe pa asnjë pushtet real. Sot kemi një parlament të ligjshëm dhe kërkojmë të deligitimojmë rolin e tij, në emër të një tavoline informale të faktorëve politikë përgjegjës për situatën kritike.

Atëherë roli i ndërkombëtarëve ishte ai i protektorit qeverisës, sot faktori ndërkombëtar, është thjeshtë në rolin vezhgues.

Pas kësaj, drejtpeshimi i shtetit do të jetë shumë i vështirë. Çdo hap i tij do të ketë nga prapa frymën e dyshimit, të kundërshtimit, të mos pranimit. Kjo do të jetë shprehje e kërkesës së palëve politike për të përfituar nga shteti sigurimin e integritetit të tyre. Ky do të jetë dhe etalioni i ekulibrave, i cili do të imponohet në errësirë edhe nga pesha e ekulibrave të kriminit të organizuar. **Fund për gazetën Tema 09.04.2017**

**Nga Panajot Barka**

<https://www.lajme.al/po-perpiqet-lsi-tu-dal-zot-demokrateve-per-tu-marr-voten-18-qershor/>

**A po perpiqet LSI t'u dal zot demokrateve, per t'u marr voten me 18 Qershor?**

[12.05.2017](#)

Sa seriozisht duhet marrë ambicja e deklaruar e LSI-së për te qenë forcë e pare ne zgjedhjet e mundshme te 18 Qershorit?!

Një analizë e kujdesshme jep përgjigje pozitive për këtë ambicje. Njëkohësisht zbulon relievin e vërtetë të kondradiktave dhe interesave të kundërta apo dhe të përputhura midis paleve, Ps-së, LSI-së, PD-së, të aleancave zyrtare apo te fshehta të përcaktuara nga arritja e qëllimeve politike dhe personale të liderve politikë të tyre etj, por edhe perspektivën e errët të krizës politike në vend.

Nyja ku ngërthehet e gjithë kjo persiatje lidhet kongretisht me lëvizjen “e detyruar” të Metës për në Presidencë. Mes serisë pa fund të arsyeve të blatuara publikisht për këtë lëvizje, më shumë zuri vend arsyeja e heshtur se ajo është shprehje e synimit të vjetër të Ramës, për eliminimin politik të LSI-së dhe të vetë I. Metës, si strategji për të garantuar supremacinë politike e të qenit forcë e pavarur nga koalicionet për të qeverisur. Ky synim nuk u mënjanua as në këtë katërvjeçar bashkëqeverisjeje të “armiqve vëllezër”. Përkundrazi, përveç kahun të përshkruar më lartë, u evidentua edhe kahu i kundërt. Ai i përpjekjes së Metës, e shprehur në formën e ambicjës së tij për të “shpetuar partinë dhe Shqipërinë”, për të hequr Ramën nga posti i Kryeministrit. (!)

Në këtë analizë, pra, Meta në Presidencë përkthehet si “dalje në pension” të tij në aspektin politik dhe mundësi për minimizimin e forcës politike të LSI-së.

E njëjta analizë mund të përshtatet dhe në raportet e Ramës me PD-në. Pavarësisht qëndrimit të papajtueshëm të PD-së me rregullat e lojës demokratike, për të mos marrë pjesë në zgjedhje, qoftë si mënyrë faktorizimi, qoftë si alibi për humbjen, apo dhe qoftë edhe si frikë nga reforma në drejtësi, Rama me qëndrimet e tij “refrektare” ndihmoi në refraktarizimin e qëndrimit të Bashës. Vetëpërrjashtimi apo përjashtimi i PD-së nga procesi zgjedhor shumë lehtë mund të shikohet edhe si një mundësi shkërmoqjeje të saj. Çdo logjikë e lojës politike e pranon këtë analizë. Aq më shumë është e pranushme për rastin e PD-së, e cila, jo vetëm ka mekatet e veta në spektrin e krimin të organizuar, korrupsionit e shpërfytyrimit të shtetit, por edhe si forcë politike po shfaq dëndur cilesi të theksuara centrifugale.

Një zhvillim i tillë mund të përforcohet edhe nga “interesimi” për të eliminuar forcat e vjetra politike që po e mbërthejnë vendin nga kriza në krizë dhe kanë gjuhëzuar shtetin dhe shoqërinë.

Kjo është njëra anë e analizës dhe është në favor të qëllimit, qoftë edhe të supozuar të Ramës, për të dobësuar deri në eliminim, të forcave kundërshtarë politike.

Por, kjo më sa duket ka krijuar edhe kahun e kundërt. Është e vërtetë se Berisha bashkëpunoi me Ramën me 2008 në një formulë kushtetuese dhe elektorale që mirrte peng partitë e vogla në përgjithësi dhe I. Metën në vëçanti. Meta tani mburet për sfidën e tij ndaj të mëdhenjve që nuk ia dolën për ta eliminuar atëherë politikisht, por të dy njeri pas tjetrit u kthyen dhe i puthen dorën.

Në këtë zhvillim ka edhe një diferencim. PD-ja, pas koalicionit me LSI-në duket se i futi në dollapin e së shkuarës këtë histori me Metën. Po ashtu duket se PD-ja është ndërgjegjësuar se vetëm me aleancën me LSI-n mund të rikthehet në pushtet dhe për

këtë është gati t'i bëjë Metës çdo lëshim. Për këtë është i ndërgjegjshëm dhe Meta edhe LSI-ja dhe kjo i shkon shumë përshtat praktikitetit të vet ekstrem.

Madje ishte kjo frymë që lejonte një komunikim të vazhdueshëm, qoftë edhe me uljengritje, midis PD-së dhe LSI-së gjatë gjithë kësaj periudhe krizeje, gjë që e ka bërë Ramën të jetë së fundmi më i prerë ndaj Metës.

Pra, kahu i kundërveprues ndaj ambicjeve të Ramës, në kushtet e mospjesëmarrjes së PD-së në zgjedhje, mund të sjellë, (në fakt kjo po lëxohet dita ditës), një votim masiv të elektoratit të opozitës në favor të LSI-së. Dhe po të llogarisim këtu edhe faktin se ka shumë njerëz të pakënaqur ndaj PS-së, ose indiferentë ndaj saj dhe procesit zgjedhor që humbi vlerat e tij reale e të vërteta, atëherë rezulton se PS-ja mund të tkurret në vetvete dhe pa mundësi për t'u ndihmuar nga gati 10 parti të tjera të vogla. Nga ana tjetër, sa më shumë kalojnë ditët, aq më shumë vihet re një distancim i faktorit ndërkombëtar nga kriza në vend, distancim nga i cili, më shumë duket se përfiton opozita dhe I. Meta se sa PS-ja.

LSI-ja me ambicjen e deklaruar për te qenë forca e parë, e ndihmuar nga praktikiteti i saj në raport me votat dhe duke patur nga prapa rrjedhën e fshehur të votave të PD-së, ka një mundësi reale për te qenë forcë e parë. Pra, LSI-ja po manifeston realisht sjellje opozitare që pretendon pushtetin nga aleati i vet i madh siç është PS-ja

Këtë gjë e ka kuptuar më sa duket edhe PS-ja, e cila në fushatën e vet elektorale nuk duket aspak e shpenguar, por shumë e mobilizuar dhe pa hequr asnjë presje nga programi i saj elektoral të llogaritur me pjesëmarrjen në zgjedhje edhe të PD-së.

Një zhvillim i tillë kuptohet që nuk e zgjidh krizën politike në vend. Vetëm sa pengon thellimin e saj. Nëse skenari i mësipërm bëhet realitet me siguri që do të ndërmerren hapa "për zgjidhjen" e krizës në vend. Dmth, presidenti Meta, edhe pse forca e tij politike mund të jetë në pushtet me pasardhësin e tij Vasilin kryeministër dhe Ramën në opozitë, është e sigurt që do të kërkojë zgjedhje të reja të partakohshme në një kohë të përshtatshme. Kështu, ai do të evidentojë rolin e tij të përkushtimit për normalitet demokraci dhe shtet. Kalimi i disa muajve me një qeveri të dalë nga zgjedhjet e 18 qershorit do të ulë tonët dhe gjakrat. Zgjedhjet e parakohshme do të përfshijnë edhe opozitën e tanishme e cila do të ketë harruar problemin e krimit të organizuar, drogës dhe korrupsionit dhe po të fitojë zgjedhjet do t'ia lëshojë vendin e primatit LSI-së. Me këtë formë do të deklarohet se "Republika e re" do të startojë me pardsitë e kthyer të partive të vjetra, me një rotacion në pushtet, dhe me arsyet e vërteta të krizës të fshehura nën pardsitë.

## **Nga Prof.asoc. Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2017/07/06/pse-ndodhin-dhe-tolerohen-me-kaq-lehtesi-sakrilegje-ndaj-kishes-ortodokse/>

<https://www.faxweb.al/pse-ndodhin-dhe-tolerohen-me-kaq-lehtesi-sakrilegje-ndaj-kishes-ortodokse-rasti-i-eda-zarit/>

<http://time.ikub.al/Lajme/ad0dca0f16459cff11b230849a6ec6ea/.aspx>

### **Pse ndodhin dhe tolerohen me kaq lëhtësi sakrilegje ndaj kishës ortodokse?**

06.07.2017

Këngëtarja Eda Zari e muzikës Jazz, organizon me datë 7 dhe 8 korrik një festival ndërkombëtar Jazz & Wine në Palermo të Himarës dhe është ky festival i dytë i organizuar prej saj. Deri këtu nuk ka asnjë gjë të keqe. Madje është një lajm i mirë.

Problemi është se këngëtarja me origjinë nga Permeti, për të promovuar sa më “shndritshëm” suksesin e saj të pritshëm i servirit publikut një video kushtuar performacës së repertorit të saj, regjistruar në një kishë ortodokse. Pamjet tregojnë se bëhet fjalë për një kishë monument kulture në Berat, atje që kjo këngëtare organizoi edhe festivalin e saj të parë Jazz në Shqipëri. Po ashtu ajo që vihet re është popullariteti që i jipet në medja “eventit” të “Jazz-it në një kishë ortokse. (Foto egzistojne dhe në profilin e saj në fb)

Ajo që dua të them unë që në fillim, është se kjo ngjarje përbën një incident shumë të rëndë dhe nuk mund të përmblihet thjesht me termin e njohur, “provokim”, i cili fatkeqësisht nuk përbën më, as lajm.

Po, është një sakrileg, por shumë dimesional. Përbën një provokim për dinjitetin fetar të çdo njeriu. Ndodh akti i patolerueshëm si nga pikëpamja institucionale edhe morale, siç është ai i poshtërimit të një objekti kulturi fetar, për më tej, i shpallur monument kulture. Përbën një provokim për vet identitetin kulturor e civilizues të çdo individi. Ku është parë që në mjediset e një objekti kulturi fetar, i shpallur monument kulture, të luhet muzikë dhe aq më keq, muzikë Jazz-i, muzikë provokuese për natyrën e fesë ortodokse. Pak kohë më parë “stilistët” e bukurisë femërore në mënyrën më të patolerueshme të mundshme, sfiduan po prap institucionin e kishës ortodokse duke futur Miss-et të pozojnë gjysëm lakuriq në vendet më të shënjta të objekteve të kultit ortodoks.

Rasti i fundit përbën një akt tjetër, më kulmor, që vërteton se bashkëjetesa fetare në Shqipëri, një realitet aq shumë i referuar si vlerë sfiduese me karakter ndërkombëtar, ngrihet me baze ateizmin dhe me vlere në ngritje përçmimin dhe poshtërimit, të paktën e fese ortodokse.

Nuk vërtetohet asnjë rast që të këtë ndodhur ndonjë akt i tillë me objektet fetare të ndonjë komuniteti tjetër fetar në vend, aq më tepër nga njëherë e besimit ortodoks. Përkundrazi! Ka me dhjetra raste që vërtetojnë se feja ortodokse në Shqipëri edhe pas 30 vjet tranzicioni, po vuan kalvarin e saj të rehabilitimit, i shprehur në formën e vet më të keq, atë të përndjekjes. Ajo së pari, është kthyer në objekt sulmi (pretenduar si marrje në mbrojtje nga synimet e vendeve ortodokse fqinje). Ky zell tregohet nga individë të përkatesive fetare jo ortodokse ose dhe ateiste dhe zhvillohet në emër të forcimit të nacionalizmit shqiptar, të venë sipas tyre, në rrezik nga fqinjët, duke përdorur për këtë kishën ortodokse. Kishat dhe objektet e tjera të kultit ortodoks, si të asnjë komuniteti tjetër fetar në vend, janë pre e perdhosjes, grabitja e vlerave kulturore të trashëgimisë fetare ortodokse përbën një monolog pa fund. Shkatërrimi i këtyre objekteve apo dhe vlerave të tjera kulturore fetare, afreskët, ikonat është kthyer në një sakrileg identifikues të antivlerave. Përpjekjet për të devijuar identitetin e vet (ngjarjet

në kishën e Dhermiut), përdorimi i dhunës nga segmentë privatë në emër të ligjit, (ngjarjet në kishën e Permetit), tendencioziteti minimizues në regjistrimin e popullsisë, statusi i dyshimtë në marrëdhëniet shtet - KOASH përse u përket objekteve të kultit monumente kulture të fesë ortodokse e plotë akte të tjera, tregojnë për një presion në vijimësi mbi ortodoksët në Shqipëri, saqë ata preferojnë të heshtin, të distancohen nga kisha e tyre që të mos i identifikojnë me armiqtë e Shqipërisë etj. Kështu shpjegohet edhe heshtja fajësuese ndaj ngjarjës së fundit ierosilite, si të KOAH-it zyrtar, të shtetit si garant i mbrojtjes dhe respektimit të së drejtës fetare, të autoriteteve të tjera me besimin ortodoks, “të intelektualeve” apo dhe të përfaqësuesve të besimeve të tjera. Unë besoj shumë se nëse një diçka e ngjashme do të ndodhte me ndonjë besim tjetër fetar në Shqipëri, do të ishte bërë nami dhe politikanët dhe medjat do të kishin harruar edhe vet zgjedhjet.(!)

Në Shqipëri duhet kuptuar qartë se nëse sot vendi ka një vlerë diakronike dhe njëkohësisht të gjallë, një vlerë që vjen nga e shkuara dhe ruan aftësinë funksionale për të tashmën dhe të ardhmën, ajo është kultura fetare ortodokse. Por kjo kulturë mund të rrezatojë vlerë dhe për çdo fushë tjetër të spektrit shoqëror, vetëm brenda funksionit të vet shpirtëror që është misioni fetar, ai i fesë ortodokse. Çdo përpjekje tjetër, promovuese (turistike, muzeale, artistike), apo shkatërruese (pasojë e identifikimit me vend armik), përbën antivlerë. Përbën mungesë kulture civile, (si respekt për vlerat e tjetrit), madje në një segment shumë delikat siç është feja. Përpjekja për të përdorur një objekti kulti të fesë ortodokse për të promovuar “vlerat” muzikore të një këngëtareje, cilado qoftë ajo, aq më keq kur akuzohet se ka dhunuar edhe nenën e vet, tejkalon edhe nivelin kulturor më të zakonshëm. Tejkalon madje edhe qëndrimet e sistemit komunist ndaj fesë në përgjithësi dhe asaj ortodokse në vëçanti.... Vetëm sistemi komunist kishte guxuar t’i kthente kishat në vatra culture....

Ose, akte të kësaj natyre në dëm të ndjeshmerive publike sublime, tregon se në Shqipëri nuk tentohet për të krijuar një model të ri vlerash. Rimirret modeli i vlerave të sistemit komunist që kërkonte evidentimin “e vlerave” të veta duke shkatërruar, mohuar e përdhosur vlerat që kishin krijuar breza të tëra në shekuj. Nëndrkohë që përse i përket marrëdhënieve me fenë ortodokse, tejkaluam për nga guximi edhe perandorinë Otomane **FUND.**

## **Nga Panajot Barka**

<https://www.faxweb.al/loja-e-keqe-e-lidershipit-te-omonia-pbdnj-se-ne-kurriz-te-minorititet-dhe-te-marredhenieve-shqiperi-greqi/>

<http://time.ikub.al/Lajme/17-08-29-Loja-e-keqe-ne-kurriz-te-minorititet-e-te-marredhenieve-Shqiperi-Greqi.aspx>

<http://time.ikub.al/Lajme/17-08-28-Loja-e-keqe-e-lidershipit-te-OMONIA-PBDNJ-se-ne-kurriz-te-minorititet-e-te-marredhenieve-Sh.aspx>

<http://www.pelasgokoritsas.gr/2017/08/loja-e-keqe-e-lidershipit-te-omonia.html>

<http://www.gazetatema.net/2017/08/28/loja-e-keqe-e-lidershipit-te-omonia-pbdnj-se-ne-kurriz-te-minorititet-e-te-marredhenieve-shqiperi-greqi/?fbclid=IwAR2aXW4oFFt8jt3wYHxveoJIHT2aO98um7B1aluheJB5M3QYACipXbDapVg>

### **Loja e keqe e lidrshpit të OMONIA-PBDNJ-së në kurriz të minoritetit dhe të marrëdhënieve Shqipëri Greqi.**

27.08.2017/29.08.2017

Në gjysmën e dytë të gushtit në Himarë, midis të tjerësh, drejtues të OMONIA - PBDNJ-së organizuan protesta me pikë referimi problemet e pronësisë dhe të pasurive të patundshme të himarioteve. Nuk dua kursesi të vë në dyshim se këto probleme në Himarë janë më shumë evidente se në çdo pjesë tjetër të vendit. Ato kanë prekur sidomos himariotet autoktonë, me kuptimin gjeografik më të gjerë se qyteti i Himarës. Po ashtu, shkeljet e të drejtave pronësore fitojnë një sensibilitet më të madhë kur bëhet fjalë për banorët me përkatësi etnike greke.

Nuk ka dyshim se nuk mund t'i mohohet askujt e drejta e protestës, si një mjet demokratik për zgjidhjen e problemit. Përkundrazi!

Por, protestat dhe qëndrimet në to mund të gjykohen, madje edhe të denohen, kur ato nisen nga një e drejtë bazike dhe, ose përdoren për të shprehur qendrimet që bien ndesh me vullnetin e minoritetit etnik grek, integritetin e vet moral, civil, kulturor e politike, (siç qe deklarata e këtij lidrshipi se Greqia dhe Qipro nuk do të lëjojnë hyrjen e Shqipërisë në BE, apo edhe aplikimi i dhunës së vërbër për të prishur së fundmi mbledhjen e këshillit bashkiak të Himarës)

Ose për të fshehur shkaktarët e vërtetë të batërdisë së shkeljeve pronësore në Himarë, ose për të krijuar korelacione çorientuese për të mbajtur të gjallë dhe në efektivitet klimën e abuzimeve dhe shkeljeve edhe në të ardhmën, (flet për këtë edhe fakti që kryebashkiaku Goro, edhe pse i ndodhur nën ofensivën e sulmeve të OMONIA-PBDNJ-së, nuk denoncon shkeljet e renda të paraardhësve të vet!!),

Ose për qëllime politike, që do të thotë përprjekje për rritje të kredibilitetit të renë të faktorit politik të OMONIA-PBDNJ-së.

Pra e theksojmë, do të ishte gabim të mendoje se në Himarë nuk ka probleme të kësaj natyre, madje dhe me prapamendime e prapaveprime më të thella e më të renda se aq. Aq me keq do të ishte gabim të pranoje se në këto prapaveprime interesat e grupeve kriminale e të parave të pista nuk mbështetn nga politika e segmentë të shtetit. Do të ishte miopi nëse nuk do të shikoje se këto veprime publikisht ose jo, legjitimohen në emër të nacionalizmit antihelen.

Por, në rastin konkret bëhet fjalë për një veprim për mbijetësë politike të lidrshpit të OMONIA-PBDNJ-së. Gjithçka duket se e ka zanafillën tek një zemëratë politike e këtij lidrshipi ndaj kryeministrit Rama, i cili, presioneve të njohura të tij për të rritur pa arsye përqindjen e pjesëmarrjes në tepsinë e pushtetit, iu përgjigj me përjashtimin e tij total nga kjo tepsi. (Për të qenë sa më objektiv, përveç kësaj Rama e mori këtë vendim edhe për të treguar forcë ndaj Athinës duke lidhur gabimisht këto dy



gjera). Sidoqoftë, për këtë lidërsnip ky dëbim, pas 15 vjetësh në tepsinë e pushtetit, është si kafshata e Migjenit.

Përzgjedhja e Himarës si instrument për arritjen e këtij qëllimi lidhet me abuzimin e sensibiliteve historike dhe aktuale të Himarës në Greqi dhe më gjerë. Pra, me tërheqjen pas vetës të qarqeve të ndryshme helene dhe pse jo edhe të politikës zyrtare greke. (Është fakt që komuniteti i minoritetit etnik grek në bashkitë Finiq dhe Dropull, apo në Delvinë e Sarandë, ka probleme pronësore dhe shpërbërjeje të homogjenitetit demografik dhe ekonomik shumë herë më të theksuara se në Himarë. Por, lidërsnipi i OMONIA-PBDNj-së e anashkalon këtë fakt se nuk prodhon nacionalitet helen aq sa Himara)

Në këtë kuptim lidërsnipi i OMONIA-PBDNj-së duhet të protestojë ndaj vetës për faktin se Bollano për tetë vjet kryetar i Bashkisë së Himarës dhe Kryetar i OMONIA-s nuk bëri asgjë për kthimin e pronave himarioteve. Ky lidërsnip, para se të akuzojë Ramën për politikë zhbërjeje të Himarës, duhet të tregojë të vërtetën që e njëj mirë, lidhur me deklaratën e kryeministrit se në kohën e Berishës skifterët e tij rrembyen në Bregdet, mbi 50 mijë hektarë tokë, pjesa dermuese në Himarë.

Gjithashtu besoj se nuk është thjeshtë ky iligjimitet i lidërsnipit të OMONIA-PBDNj-së, në kërkim të vendosjes së drejtësisë për pronarët e ligjshëm në Himarë, që e paracakton që në embrion dështimin e “kauzës” së tij të deklaruar. Ka edhe një arsye tjetër. Personazhet politikë në krye të kësaj “kauze” kanë një të shkuar të dyshimtë që shteti shqiptar (dhe ai grek) e njëj mirë. Prej tyre vijohet të konsumohen vepra penale në masë të ndryshme, por ligji nuk vepron. (Në prishjen e mbledhjes së kësh. Bashkiak të Himarës, u duk qartë se nga pala tjetër pritej në agoni që të kishte arrestime, për t’i shpallur “të arrestuarit” heronj, por nuk ndodhi!!!) Por, edhe pronat e tyre në Himarë apo gjetkë nuk i cenon njeri (dhe mirë bën), por edhe çuditërisht shtohen e lulezojnë ndërkohë që ata flasin për raprezalje shtetërore ndaj Himarioteve

Në këtë kendveshtrim ishte fyese për kredibilitetin kulturor e civil të komunitetit himariot dhe të minoritetit etnik grek sjellja e këtij lidërsnipi dhe pasuesve të tij të paktë ndaj mbledhjes së këshillit bashkiak të javës së kaluar. Nëse drejtuesit e këshillit bashkiak nuk lëjuan pjesëmarrjen e lirë të komunitetit në takim është e gabuar. Por, është e pafalshme ushtrimi i dhunës fizike dhe verbale për ta penguar e prishur një mbledhje institucionale.

Nga ana tjetër bëhet fjalë për studimin urbanistik të të gjithë bashkisë së Himarës të përberë prej 25 njesish dhe jo për pjesën e pretenduar nga komuniteti grek në Himarë. Ky plan dihet se përbën instrumentin bazë për një zhvillim të rregulluar të bashkisë dhe jo një studim pjesor urbanistik që mund të prek interesa të caktuara. Plani urbanistik kurresesi nuk mohon dhe nuk pengon zgjidhjen e problemeve pronësore, por e kundërta, pengon realisht zhvillimin e bashkisë dhe lëjon hapësira për abuzime.

Po ashtu, studimin urbanistik të bashkisë së Himarës e kishte marrë përsipër një studjo greke dhe, as në procesin e studimit, as pasi ky studim u publikua dhe iu komunikua paleve të interesuara, nuk u paraqiten ankesa, propozime e vërrejtje. Përse atëherë, u prit dita e aprovimit për të reaguar në këtë mënyrë, aspak civile, aspak të kulturuar, por shumë provokuese?!

Në këtë kuadër interesah duhet gjykuar qëndrimi i këtij lidërsnipi se do të ndikojë te Greqia dhe Qiproja që të pengojnë anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Ky nuk është aspak qëndrim që shpreh vullnetin politik të minoritetit etnik grek në Shqipëri dhe besoj as të Athinës apo të Nikosias. Minoriteti etnik grek, edhe kur i vriteshin anëtarët e vet në kufi, edhe kur prekeshin dhunshëm të drejtat e tij arsimore e fetare, edhe kur shkelëshin të drejtat e tij pronësore e civile, kurrë nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kundër integritimit euroatlandik të vendit e të shtetit ku jeton. Madje historia e fakteve dhe

dokumentave tregon të kundërtën. Se që nga 1991 ishte aspiranti i parë i kësaj rruge për Shqipërinë dhe këtë qëndrim minoritetit grek ia dikton kultura e tij perendimore dhe bindja se vetëm në familjen evropiane, (pjesë e të cilës është realisht minoriteti etnik grek, si pararojë e gjithë shoqërisë shqiptare) ai do të gezojë në mënyrë të plotë e me dinitet të gjitha të drejtat. Ky lidërsip duhet ta kuptojë se, tjetër gjë është detyrimi prej institucioneve të BE-së i shtetit shqiptar për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve si kusht për anatemësimin e Shqipërisë në BE, dhe krejt tjetër gjë është deklarimi i vet minoritetit për t'u kthyer në pengësë të këtij procesi në emër të të drejtave të tij.

Po aq e denueshme është përpjekja e këtij lidërsipi, i cili, për mbijetesën e vet politike, bën të kundërtën e misionit të vet të natyrshëm. Ky lidërsip duke humbur çdo lloj mbështetje të elektorati i vet kërkon tani t'i imponohet atij me kredibilitet të importuar, që kërkon ta fitojë duke tentuar të marrë përsipër rolin e mbrojtësit të interesave të Greqisë në Shqipëri. (Abuzoi mjaft me qëndrimet antihelene dhe pro turke të Ramës, si edhe me të ashtuquajturin problemin çam). Ky rol është dyfish i dëmshëm si për marrëdhëniet greko shqiptare, ashtu edhe për vetë minoritetin. Roli i minoritetit nuk është ai i ndikimit negativ në këto marrëdhënie, por i ndikimit pozitiv, i marrëdhënieve paqësore, bashkëpunuese e në frymë evropiane.

Nga ana tjetër, përpjekja e këtij lidërsipi, i cili për të justifikuar klimën konfrontuese midis dy vendeve kërkon të armiqësojë marrëdhëniet e minoritetit etnik grek me qeverinë e vendit të tij, është sa e gabuar aq edhe e demshme. Minoriteti, pavarësisht identitetit të tij etnik grek, përbën në vetvete një individualitet me vete, që jeton në Shqipëri dhe ka marrëdhënie të caktuara etnike me kombin am. Në këtë kendveshtrim marrëdhëniet e tij me shtetin ku jeton kanë një përmasë të dyfishtë por kurrsesi të identifikuar plotësisht me kombin am, sidomos kur bëhet fjalë për marrëdhënie negative midis tyre. Fund

Nga Panajot Barka

Per gazeten TEMA 27/08/2017

## **Nga Panajot Barka**

<http://shuplaka.com/miti-helen-si-alibi-per-baterdine-me-pronat-ne-himare-dhe-bregdet/>  
<http://time.ikub.al/Lajme/17-09-02-Miti-Helen-si-alibi-per-baterdine-me-pronat-ne-Himare-dhe-Bregdet.aspx>  
<http://time.ikub.al/17-09-03-Miti-Helen-si-alibi-per-baterdine-me-pronat-ne-Himare-dhe-Bregdet/Miti-Helen-si-alibi-per-baterdine-me-pronat-ne-Himare-dhe-Bregdet378623.aspx>  
<http://www.gazetatema.net/2017/09/02/miti-helen-si-alibi-per-baterdine-me-pronat-ne-himare-dhe-bregdet/>  
<http://www.pelasgokoritsas.gr/2017/09/miti-helen-si-alibi-per-baterdine-me.html>  
<https://www.faxweb.al/miti-helen-si-alibi-per-baterdine-me-pronat-ne-himare-dhe-bregdet/>  
[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=1573717952650101&id=666997616655477](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1573717952650101&id=666997616655477)

### **Miti “Helen”, si alibi për baterdinë me pronat në Himarë dhe Bregdet.**

02.09.2017

Zgjedhja e Kuçit malor për aprovimin nga këshilli bashkiak i Himarës të masterplanit urbanistik të kësaj bashkie dhe përdorimi deri edhe i forcave speciale për garantimin e zhvillimit të mbledhjes së tij, nuk duhet interpretuar si frikë e shtetit ndaj reagimeve kundërshtuese ndaj tij nga disa përfaqësues lokalë të OMONIA-PBDNJ-së. Më shumë duhet parë në serinë e përpjekjeve për të krijuar një mit, me vlerë polivalente në shërbim të paleve me interesa të kundërta në zonën turistike të Himarës; interesa të përshkuara nga fije jo vetëm ekonomike dhe politike e që implementimi i masterplani do të sjell përplasjen frontale midis tyre. Më thjeshtë. Qëllimi i mitit është të fsheh thelbin e përplases që ka emrin ritjetërsim të pasurive të himarioteve, si ndërim duarsh nga grabitesit e parë të klanit Berisha, tek “investuesit strategjik” të Ramës, me pasojë eliminim përfundimtar të së drejtës së himariotëve mbi pronat e tyre të ligjshme.

Polivalenca e mitit (dallon nga polisimia e fabulave të zakonshme) duhet t’i shërbëjë njëkobjesisht: a. mbrojtjes së interesave të krijuara rishtazi të njëres palë duke abuzuar dhe tjetërsuar pronat në Himarë, b. fshehjes së mekatëve ndaj së drejtës himariote dhe rehabilitimit politik nga një palë tjetër, c. realizimit të interesave aktuale të synuara të palës tjetër, duke ritjetërsuar “në emër të ligjit” të njëjta prona dhe d. eliminimit të së drejtës së himariotëve për t’u referuar atij (jo si mit, por si faktor real) në mbrojtje të të drejtave të tij.

Ky mit kodifikohet me një fjalë të vetme “Helenizëm”. Në një interpretim të parë të fabrikimit dhe përdorimit të tij mund të thuhet se dy të parët do ta shfrytëzojnë atë si sistem mbrojtës. (Duke abuzuar në nivele të ndryshme me interesat legjitime të himarioteve, me kombësi shqiptare apo greke.) Pala e tretë do ta përdorë mitin si ushqim për antihelenizmin e nacionalizmit shqiptar, për të çliruar duart për veprime nga më të ndryshme, deri edhe më antiligjorët.

Viktimitë e kësaj logjike po bie edhe Athina, pavarësisht se kjo ndodh në kushtet e mungesës së informacionit të plotë, të detyrimit për të qenë korrekte me aksiomën e respektimit të të drejtave të minoritetit, por sipas formulës së ballafaqimit me palën shqiptare, që i serviret asaj nga faktorë “helenë” por për të mbrojtur interesat e tyre. Analiza tregon se kjo formulë i intereson edhe Tiranës dhe e ushqen atë.

Kjo do të thotë se problemi është kompleks dhe i komplikuar. Si të tillë nuk mund ta zgjidh as brutaliteti, qoftë ky dhe në emër të ligjit dhe, aq me keq, as kapja pas produkteve folklorike të antihelenizmit.

**Në lëmshin e palëve duhet veçuar së pari Qeveria**, “përgjegjëse” për aktivizimin e reagimeve. Ajo, me argumentin e “turizmit elitar” “me plan dhe perspektivë” “nga investitorë strategjikë” etj, kërkon të zhbejë një realitet gati 20 vjeçar të krijuar më së shumti nga kundërshtarët e vet politikë. Në mbështetje të këtij synimi ajo krijoi struktura, kuadër ligjor dhe pa tjetër një mjedis opinionbërës dhe propagandues. Ky mjedis në publik ka dy shfaqje. E para, si luftë kundër grabitjes pa din e imam të filetove turistike, shumica pronë e banorëve të zonës më të gjerë të Himarës dhe e dyta, që nuk shfaqet por ndjehet kudo, janë referencat antihelene, që ushqejnë në mënyrë permanente nacionalizmin populist, por që krijojnë një mjedis për të justifikuar çdo zullum antiligjor, pastrimin e parave të pista e të krimin etj.

**Pala e dytë identifikohet me opoziten**, të asaj opozite që përfaqëson rrethi i Sali Berishës në sundimin e tij të parë e të dytë. Sipas kryeministrit Rama, për afëra politike dhe jo vetëm, njerëz që nuk kishin parë det me sy gjersa u bënë pronarë tokash në bregdet, grabiten e dhjetra mijra ha tokë turistike. Në bashkinë e Himarës, tokat e grabitura, me bashkëpunimin e autoritetit lokal, që i përkiste OMONIA-PBDNj-së, u përkasin më së shumti pronarëve autoktonë himariotë. Me para që justifikohen vetëm me burime të pista, këta “pronarë të rinj” investuan shuma marramendëse në ndërtime, ndërsa sipërfaqe edhe më të mëdha posedohen në dokumente me vulë shteti të fituara me ryshfet, korrupsion e falsifikim. Hovi i tyre grabitës ishte i tillë sa që detyroi dy organizma ndërkombëtare të tërhiqen nga përpjekja për të venë rregull në pronat në Bregdet. (Fjala është për Bankën Botërore dhe OSBE-n). Pra, ata krijuan këtu interesa shumë të fuqishme, të cilat nuk do të lëjojnë kursesi të vihen në rrezik nga planet e Ramës. Por, në kushtet e paligjshmerisë, mbrojtja e këtyre interesave kërkon një instrument që tejkalon forcën e ligjit dhe ambicjet e Ramës.

Mjeti më efikas mbrojtjeje për ta është të vihen nën çadrën mbrojtëse të OMONIA-PBDNj-së me sistem referimi ”Helenizmin”. Në analizën tonë **ky faktor politik përbën palën e tretë**, por jo për nga rëndësia e autorësisë së problemit të krijuar në Himarë. Kauza e kësaj pale aspiron suportin e helenizmit duke i mëshuar argumentit të rrezikut nga pushteti i Ramës të interesave pronësore të himarioteve. Nga pikëpamja politike, ky identifikim qëndrimesh, tanimë është i deklaruar dhe materializuar. Mirëpo, këtë definicion identifikimi e përcakton ndër të tjera, bashkëveprimi i tyre, sidomos në Himarë, në krijimin e shtresës së të importuarve dhe të interesave të tyre nëpërmjet grabitjes së pasurive të himarioteve. Faktet janë kokëforta dhe neutralizuese për rolin mbrojtës nga ana e këtij lidhshipi të të drejtave të komunitetit himariot. (Për tetë vjet rresht baterdia e Berishës në Himarë ndodhte sipas skemave që implementoheshin në bashkëpunim me këtë lidhship në krye të pushtetit vendor. Sa herë që Berishës i duhej me shumë entuziazëm populist për veprën e tij, ky lidhship hidhte në tregun e opinionit publik ndonjë tezë “helene” dhe aq mjaftonte për të nderur nacionalizmin antihelen të materializuar në grabitjen e trojeve të himarioteve. Në tjetërsimin e trojeve të familjeve Nina, Ruci, Bifsha, Duni, Lati etj në Dhermi e Palasë, ku sot ngrihen dy resortet e para të investimeve strategjike turistike, aq shumë të kritikuara nga ky lidhship dhe opozita, ka dorë krahu i djathtë i këtij lidhshipi dhe njerëzit e ngushtë të klanit Berisha. Në 73 lejet e paligjshme të ndërtimit, vepër penale nën hetim nga prokuroria Vlorë, dhenë njerëzve të këtyre interesave, protagonist është prap po ky lidhship, po ashtu zhvillimet në manastirin e profit Ilias në Palasë e plot raste të tjera. Është kjo arsyeja që në fushatën e tanishme të akuzave anti Rama si kërcenim për komunitetin himariot me kombësi greke, ky lidhship nuk demonstroi asnjë fakt konkret.)

Në këto kushte fajësie të rendë, retorika e tij në mbrojtje të të drejtave të himarioteve, dëmton besushmerinë dhe minimizon angazhimin edhe të faktorëve të tjerë, sidomos ndërkombëtarëve, si SHBA, B.E etj, duke i sjellë një dëm të pariparueshme çeshtjës në fjalë.

Nga ana tjetër me veprimet e veta që ushqejnë antihelenizmin populist shqiptar, ky lidhshmëri pengon edhe orientimin e drejtë të Greqisë në këtë çeshtje. Por më shumë krijon presione dhe efekte që pengojnë himariotet t'i drejtohen shtetit grek, nënshketas e të cilit dhe të BE-s janë, apo dhe faktorëve të tjerë ndërkombëtar që lidhen me Greqinë. Këtij realiteti i shërbën dhe fushata e fundit e këtij lidhshmëri për t'u hequr himarioteve, kundërshtarëve të vet politikë, nënshketas greke. (Kjo ndodh edhe në mënyrë të qëllimshme për shkak të lidhjeve me faktorë shqiptar që nëpërmjet mitit të antihelenizmit të nxisin aksionin e zhbërbjes së faktorit himariot gjë që s'e ka arritur as Turqia, as Zogu e as Enveri). Kjo do të thotë se pala më e demtuar në këtë histori, himariotët, janë të margjinalizuar dhe të zhveshur nga mundësitë për mbrojtjen e të drejtave të tyre. (Kemi këtu parasysh edhe veprimet dhe mosveprimet në dëm të tyre dhe të shtetit shqiptar)

### **Por, a është e justifikuar frika nga “strategjia turistike” e Ramës në Himarë? Faktet nuk e lënë vend për dyshime.**

Eshtë e vërtetë se nën drejtimin e tij Rama vuri në veprim Task-Forcën për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajtshme shtetërore dhe private në zonën e Bregdetit, me angazhimin publik të vendosjes së drejtësisë mbi shkeljet dhe shkelësit. E vërtetë është gjithashtu se Task-Forca zbuloi bindshëm përmasat e përbindshme të krimit. Por drejtësia u harrua. Mësa duket Kryeministrit studimi dhe njohja i realitetit i duhej për qëllimet e veta.

Gati gjashtë muaj pas ardhjes në pushtet Rama dha dy leje për resortët turistike në zonën Dhermi Palasë, (“Green Coast” të grupit Balfin dhe grupin e vilave Eurocol sh.pk). Të dy këto leje u dhanë për në troje që Task-Forca kishte konstatuar se ishin tjetërsuar nga pronarë të ligjshëm, të përmendur më lart, nëpërmjet falsifikimit dhe në kohën kur këto troje ishin objekt hetimi i prokurorisë së Vlorës. Ndërkohë që njeri nga pronarët nëpërmjet tjetërsimit të truallit të resortit “Green Coast” rezulton të jetë, sipas Task-Forcës, një shtetas nën hetim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, për falsifikimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme në bregdetin e Vlorës dhe të Himarës. (!)

Një vit më vonë Rama siguroi bazën juridike për investimet strategjike në sektorë ku përfshihet edhe turizmi. Përveç përcaktimeve evazive dhe me hapësira abuzuese, ky legjislacion i jep të drejtë shtetit të ndërhyjë në favor të investuesit privat për shpronësimin e tokës private si në kushtet për interes publik. Kjo, bashkë me lehtësirat e tjera që merr përsipër shteti në favor “të investimit strategjik”, përbëjnë faktorë të padiskutueshëm përjashtues të faktorit vendas nga struktura turistike.

Dyshim ngjall edhe fakti se dy projektet “strategjike” në implementim në Himarë paraqesin kapacitete pritese shumë herë më të mëdha se mundësitë përballuese të detit dhe mjedisit në përgjithësi. Pra me një risk të madh për rimbursimin e investimit si strukturë turistike. E përforcon këtë edhe praktika e njejtë turistike në rajonin më të gjerë të Jonit. Atëherë, mos vallë një infrastrukturë e tillë pritese dhe e privilegjuar, kanalet e parave të pista dhe adresimi turistik i shtuar, lëjon kongluzionin se duhet parë si një aksion për ndryshime demografike, por ndryshe nga periudha kaotike e Berishës së parë, tanimë më me një organizim më të strukturuar dhe më efektiv!?

A nuk flet për këtë edhe cenimi i pronave të kishës, por edhe i identitetit të saj!?

FUND Për Gazetën Tema 02.09.2017

Ο μύθος «Ελληνισμός», ως άλλοθι στην καταστροφή του περιουσιακού στη Χειμάρα και το Μπρεγκντέτι (Αλβανική παραλία του Ιονίου)

του Παναγιώτη Μπάρκα

Η επιλογή του ορεινού χωριού Κούτσι για την έγκριση από το δημοτικό συμβούλιο της Χειμάρρας, του πολεοδομικού σχεδίου αυτού του δήμου και η χρήση μέχρι και των ειδικών δυνάμεων για την διασφάλιση της συνεδρίασης του δε θα πρέπει να ερμηνευτεί ως φόβος του κράτους στις αντιδράσεις προς το σχέδιο αυτό κάποιων τοπικών εκπροσώπων της ΟΜΟΝΟΙΑΣ-ΚΕΑΔ. Περισσότερο πρέπει να αντιληφθεί στο πλαίσιο των προσπαθειών δημιουργίας ενός πολυσύνθετου μύθου, στην εξυπηρέτηση των πλευρών με αντικρουόμενα συμφέροντα στην τουριστική περιοχή της Χειμάρρας, συμφέροντα που διέπουν όχι μόνο οικονομικά και πολιτικά νήματα, τα οποία, η εφαρμογή του πολεοδομικού σχεδίου θα οδηγήσει σε μετωπική σύγκρουση.

Πιο απλά. Σκοπός του μύθου είναι να αποκρύψει την ουσία της σύγκρουσης που ακούει στο όνομα **εκ νέου** αλλοίωση των περιουσιών των Χειμαρριωτών, ως αλλαγή χεριών, από τους πρώτους υφαρπακτές της συμμορίας Μπερίσα, στους «στρατηγικούς επενδυτές» του Ράμα, με συνέπεια την τελική εξάλειψη του δικαιώματος των Χειμαρριωτών επί των νόμιμων περιουσιών τους.

Το πολυσύνθετο του μύθου (διαφέρει από την πολυσημία των συνηθισμένων μύθων) θα πρέπει να εξυπηρετήσει ταυτόχρονα:

- Α. Την υπεράσπιση των συμφερόντων της μίας πλευράς, που δημιουργήθηκαν πρόσφατα καταχράζοντας και αλλοιώνοντας τις περιουσίες στην Χειμάρρα,
- β. Την απόκρυψη των αμαρτιών έναντι των δικαιωμάτων των Χειμαρριωτών και την πολιτική αποκατάσταση μιας άλλης πλευράς,
- γ. Την υλοποίηση των επιδιωκόμενων συμφερόντων μιας τρίτης πλευράς, αλλοιώνοντας εκ νέου «εξ ονόματος του νόμου» τις ίδιες περιουσίες και
- δ. Τον αποκλεισμό των Χειμαρριωτών για να επικαλεστούν αυτόν (όχι ως μύθο, αλλά ως πραγματικό θεσμό), για την υπεράσπιση των δικαιωμάτων του

Ο μύθος αυτός κωδικοποιείται με μια μόνο λέξη «Ελληνισμός». Σε μια πρώτη ερμηνεία της καλλιέργειας και χρήσης του, μπορεί να αναφερθεί ότι οι δύο πρώτοι τον αξιοποιούν αυτόν ως αμυντικό σύστημα. (Καταχράζοντας σε διάφορα επίπεδα τα νόμιμα δικαιώματα των Χειμαρριωτών ελληνικής και αλβανικής ιθαγένειας). Η τρίτη πλευρά χρησιμοποιεί το μύθο ως τροφή για τον ανθελληνισμό του αλβανικού εθνικισμού, για να απαλλαγεί από κάθε εμπόδιο για οποιαδήποτε πράξη, μέχρι και την πιο παράνομη.

Θύμα αυτής της λογικής γίνεται και η Αθήνα, ανεξαρτήτως ότι αυτό συμβαίνει στις συνθήκες έλλειψης πλήρους ενημέρωσης, των υποχρεώσεων όσον αφορά της συνέπειας με την αρχή σεβασμού των μειονοτικών δικαιωμάτων, αλλά κατά τη φόρμουλα που θέλει την αντιπαράθεση με την αλβανική πλευρά, που σερβίρεται στην Αθήνα από «Ελληνες» παράγοντες, που αποβλέπουν στην ικανοποίηση των συμφερόντων τους. Τα στοιχεία της ανάλυσης δείχνουν ότι η φόρμουλα αυτή συμφέρει και τα Τίρανα και την υποθάλπει.

Αυτό σημαίνει ότι το πρόβλημα είναι σύνθετο και περίπλοκο. Ως εκ τούτου, δεν μπορεί να το λύσει ούτε η βιαιότητα **και** στο όνομα του νόμου και, ακόμη χειρότερα, είτε να προσελκύσει λαογραφικά προϊόντα του ανθελληνισμού.

Στο κουβάρι των πλευρών θα πρέπει πρώτα να ξεχωρίσουμε την Κυβέρνηση, ως «υπεύθυνη» για την δραστηριοποίηση των αντιδράσεων. Εκείνη, με το επιχείρημα του «υψηλού επιπέδου τουρισμού» «με σχέδιο και προοπτική» «από στρατηγικούς επενδυτές» κλπ, επιδιώκει να αντιταχτεί σε μια 20χρονη πραγματικότητα δημιουργημένη επί το πλείστο από τους πολιτικούς τους αντιπάλους.

Η δεύτερη πλευρά ταυτίζεται με την αντιπολίτευση, αυτής της αντιπολίτευσης που αντιπροσωπεύει τον κύκλο του Σαλί Μπερίσα στην πρώτη και τη δεύτερη διακυβέρνησή του. Σύμφωνα με τον Π/Θ Ράμα, για πολιτικές διαφθορές και όχι μόνο, άνθρωποι που δεν είχαν δει την θάλασσα με τα μάτια τους, έγιναν ιδιοκτήτες οικοπέδων στην ακτή, υφαρπάζοντας δεκάδες χιλιάδες εκτάρια τουριστικής γης. Στον δήμο Χειμάρρας, τα υφαρπαγμένα εδάφη, με τη συνεργασία της Τοπικής Αυτοδιοίκησης, που ανήκε στην ΟΜΟΝΟΙΑ-ΚΕΑΔ, ανήκουν κυρίως στους αυτόχθονες Χειμαρριώτες ιδιοκτήτες. Με χρήματα που δικαιολογούνται μόνο από βρώμικες πηγές, αυτοί οι "νέοι ιδιοκτήτες" επένδυσαν τεράστια ποσά σε κατασκευές, ενώ οι μεγαλύτερες εκτάσεις κατέχονται με κρατικά έγγραφα που έχουν ληφθεί με μίζες, δωροδοκία και παραποίηση.

Η υφαρπακτική ορμή τους ήταν τέτοια που ανάγκασε δύο διεθνείς οργανισμούς να παραιτηθούν από την προσπάθειά τους να βάλουν τάξη στα ακίνητα στην παραθαλάσσια περιοχή. (Πρόκειται για την Παγκόσμια Τράπεζα και τον ΟΑΣΕ). Δηλαδή εκείνοι δημιούργησαν πολύ ισχυρά συμφέροντα, τα οποία δεν θα επέτρεπαν να τεθούν σε κίνδυνο από τα σχέδια του Ράμα. Αλλά, υπό τις συνθήκες παρανομίας, η προστασία αυτών των συμφερόντων απαιτεί ένα μέσο που υπερβαίνει την ισχύ του Νόμου και τις φιλοδοξίες του Ράμα.

Το πιο αποτελεσματικό μέσο προστασίας για αυτούς είναι να μουν υπό την προστατευτική ομπρέλα της ΟΜΟΝΟΙΑΣ-ΚΕΑΔ με σύστημα αναφοράς τον "Ελληνισμό". Στην ανάλυσή μας, ο πολιτικός αυτός παράγοντας αποτελεί την τρίτη πλευρά, αλλά όχι σε ότι αφορά στο ρόλο του αυτουργού στο πρόβλημα στη Χειμάρρα. Η πλευρά αυτή επιδιώκει τη στήριξη του Ελληνισμού επιμένοντας στο επιχείρημα του κινδύνου που αποτελεί η εξουσία Ράμα έναντι των περιουσιακών δικαιωμάτων των Χειμαρριωτών. Από πολιτικής πλευράς, αυτή η ταύτιση θέσεων με την αντιπολίτευση (Δημοκρατικό Κόμμα) είναι πλέον δηλωμένη και υλοποιημένη. Όμως, μια τέτοια ταύτιση, προσδιόρισε, μεταξύ των άλλων και η συνεργασία τους, ιδιαίτερα στη Χειμάρρα, στην αποκατάσταση των εποίκων και των συμφερόντων τους μέσω της υφαρπαγής των περιουσιών των Χειμαρριωτών. Τα στοιχεία είναι τρανταχτά και εξουδετερώνουν τη διεκδίκηση ρόλου προστάτη, από μέρους της ηγετικής αυτής ομάδας, των δικαιωμάτων της κοινότητας των Χειμαρριωτών.

(Επί οχτώ χρονιά στη σειρά οι αυθαιρεσίες του Μπερίσα στην υφαρπαγή των περιουσιών στη Χειμάρρα, πραγματοποιούνταν με σχέδια που εφαρμόζονταν σε συνεργασία με την ηγετική αυτή ομάδα, επικεφαλής στην Τοπική Αυτοδιοίκηση. Όσες φορές χρειάζονταν στο Μπερίσα περισσότερος λαϊκίστικος ενθουσιασμός για καλύτερη απόδοση στο έργο του, η ηγεσία αυτή πέταγε στην αγορά της κοινής γνώμης κάποια «ελληνική» θέση και τόσο αρκούσε για την πυρπόληση του ανθελληνικού εθνικισμού, ο οποίος υλοποιούνταν στην υφαρπαγή των οικοπέδων των Χειμαρριωτών. Στην αλλοίωση των οικοπέδων των οικογενειών Νίνα, Ρούτση, Μπίφσα, Ντούνι, Λάτη κλπ. στους Δρυμάδες και Παλάσα, όπου σήμερα είναι υπό κατασκευή τα δύο πρώτα τουριστικά συγκροτήματα στρατηγικών επενδύσεων, τα οποία προκάλεσαν τις έντονες αντιδράσεις της ηγεσίας αυτής και της αντιπολίτευσης, έχουν δάκτυλο άνθρωποι δεξί χέρι αυτής της ηγεσίας και άνθρωποι του στενού περιβάλλοντος του Σαλί Μπερίσα. Στις 73 παράνομες άδειες δόμησης, πράξη ποινικού

δικαίου υπό εξέταση στην εισαγγελική αρχή του Αυλώνα, τις οποίες επωφελήθηκαν άνθρωποι των ανωτέρω συμφερόντων, πρωταγωνιστές ήταν ξανά η ίδια ηγεσία. Το ίδιο μπορεί να ειπωθεί και για τις εξελίξεις στη Μονή του Προφήτη Ηλία στην Παλάσα και για πολλές άλλες περιπτώσεις. Είναι αυτός ο λόγος, που στην τωρινή εκστρατεία κατηγοριών κατά του Ράμα, ως η απειλή για την Χειμαρριώτικη κοινότητα ελληνικής ιθαγένειας, η ηγεσία αυτή δε φέρει και δεν παρουσιάζει κανένα συγκεκριμένο επιχείρημα.)

Υπό αυτές τις συνθήκες βαρύτατων ενοχών, η ρητορική της σε υπεράσπιση των δικαιωμάτων των Χειμαρριωτών, βλάπτει την αξιοπιστία και ελαχιστοποιεί τη δέσμευση και των υπολοίπων παραγόντων, ιδιαίτερα του διεθνή, όπως των ΗΠΑ, της Ε.Ε κλπ, επιφέροντας έτσι ανεπανόρθωτη ζημιά στην εν λόγω υπόθεση.

Από την άλλη πλευρά, με τις πράξεις που τροφοδοτούν τον ανθελληνισμό μεταξύ του αλβανικού λαού, η ηγετική αυτή ομάδα εμποδίζει τον σωστό προσανατολισμό της Ελλάδας στην υπόθεση αυτή. Περισσότερο, προκαλεί πιέσεις και καταστάσεις που εμποδίζουν τους Χειμαρριώτες να αποταθούν στο ελληνικό κράτος, υπήκοοι του οποίου και της Ε.Ε, είναι, ή σε άλλους διεθνείς παράγοντες που συνδέονται με την Ελλάδα. Αυτή την πραγματικότητα εξυπηρετεί και η πρόσφατη εκστρατεία της ηγετικής αυτής ομάδας, για να αφαιρέσει στους Χειμαρριώτες, τους πολιτικούς της αντιπάλους, την ελληνική ιθαγένεια. (Αυτό συμβαίνει και εσκεμμένα, λόγω των διασυνδέσεων με αλβανικούς παράγοντες, ώστε μέσω του μύθου του ανθελληνισμού να υποθάλψουν την επιχείρηση αλλοίωσης του Χειμαρριώτικου παράγοντα, πράγμα το οποίο δεν έχει καταφέρει ούτε η Τουρκία, ούτε ο Ζόγου και ούτε ο Ενβέρ). Αυτό σημαίνει ότι η ιδιαίτερα θιγομένη πλευρά σ' αυτή την ιστορία, οι Χειμαρριώτες, είναι εγκλωβισμένοι και απαλλαγμένοι των δυνατοτήτων υπεράσπισης των δικαιωμάτων τους. (Εχουμε εδώ υπόψη και τις πράξεις και μη πράξεις του αλβανικού κράτους εις βάρος τους)

Όμως, είναι δικαιολογημένος ο φόβος από την «τουριστική στρατηγική» του Ράμα στη Χειμάρρα; Τα στοιχεία δεν επιτρέπουν αμφισβήτηση.

Είναι αληθές ότι υπό την ευθύνη του ο Ράμα έθεσε σε λειτουργία την Task-Force για την διαπίστωση της νομιμότητας και του τρόπου αλλοίωσης των ακίνητων περιουσιών, κρατικών και ιδιωτικών στην παραθαλάσσια περιοχή με τη δημόσια δέσμευση για την αποκατάσταση της δικαιοσύνης όσον αφορά στις παραβιάσεις και τους παραβάτες. Αληθές είναι επίσης ότι η Task-Force αποκάλυψε πειστικά τις γιγάντιες διαστάσεις του εγκλήματος. Αλλά η δικαιοσύνη λησμονήθηκε. Όπως φαίνεται η μελέτη και γνώση της πραγματικότητας αφορούσε προσωπικούς σκοπούς του Πρωθυπουργού.

Περίπου 6 μήνες μετά την ανάληψη των πρωθυπουργικών καθηκόντων, ο Ράμα παραχώρησε τις άδειες για τα δύο πρώτα τουριστικά συγκροτήματα στην περιοχή Δρυμάδων - Παλάσας, ("Green Coast" του ομίλου Balfin και Eurocol sh.p.k). Οι δύο άδειες παραχωρήθηκαν σε οικοπέδα για τα οποία η Task-Force είχε αποφανθεί ότι ήταν προϊόν αλλοίωσης μέσω πλαστογράφησης και ότι ανήκαν στους νόμιμους ιδιοκτήτες που πιο πάνω αναφέρουμε και επιπλέον, παραχωρήθηκαν όταν η υπόθεση ήταν υπό εξέταση από την εισαγγελία Αυλώνα. Ταυτόχρονα, κατά την Task-Force, ένας από τους ιδιοκτήτες μέσω πλαστογράφησης του οικοπέδου του συγκροτήματος "Green Coast" προκύπτει ότι διώκεται ποινικά από την Εισαγγελία Κακουρηγημάτων των Τυράνων για πλαστογραφίες για την απόκτηση τίτλων ιδιοκτησίας (στο υποθηκοφυλακείο) στην περιοχή Αυλώνα - Χειμάρρας (!)



Ένα χρόνο αργότερα ο Ράμα εξασφάλισε τη νομική βάση για τις στρατηγικές επενδύσεις όπου συμπεριλαμβάνεται και ο τουρισμός. Εκτός από τις ελλείψεις διατυπώσεις και διαφορούμενες νομικές ρυθμίσεις που επιτρέπουν καταχρήσεις, η νομοθεσία αυτή επιτρέπει στο κράτος να επέμβει σε όφελος του ιδιώτη επενδυτή για την απαλλοτρίωση της ιδιωτικής περιουσίας, όπως στην περίπτωση δημοσίου οφέλους. Το γεγονός, από κοινού με τις άλλες διευκολύνσεις που το κράτος αναλαμβάνει σε όφελος της «στρατηγικής επένδυσης», αποτελούν αδιαμφισβήτητους παράγοντες αποκλεισμού του ντόπιου παράγοντα στις τουριστικές υποδομές και δομές.

Υποψίες προκαλεί και το γεγονός ότι τα δύο «στρατηγικά» σχέδια υπό εξέλιξη στη Χειμάρρα, παρουσιάζουν δυνατότητες υποδοχής τουριστών πολλές φορές μεγαλύτερες από τις πραγματικές δυνατότητες που παρέχει η θαλάσσια περιοχή και γενικότερα το περιβάλλον. Που σημαίνει ότι επρόκειτο για μεγάλο ρίσκο όσον αφορά την απόκτηση κέρδους ως τουριστική υποδομή. Ενισχύει την άποψη αυτή και η παρόμοια πρακτική στην ευρύτερη περιοχή του Ιονίου. Τότε, μήπως μια τέτοια υποδομή στέγασης, μάλιστα με ευνοούμενες συνθήκες, οι πόροι του βρόμικου χρήματος και ο αυξημένος τουριστικός προσανατολισμός, επιτρέπει το συμπέρασμα ότι θα πρέπει να εξεταστεί ως μια προσπάθεια δημογραφικών αλλοιώσεων, αλλά διαφορετικά από τη χαώδη περίοδο του Μπερίσα, τώρα πια μια περισσότερο δομημένη και αποτελεσματική οργάνωση!;

Μήπως δε μιλάει γι' αυτό και η αλλοίωση της εκκλησιαστικής περιουσίας, αλλά και η προσπάθεια αλλοίωσης της ταυτότητάς της στην περιοχή!;

Δημοσιεύτηκε στην εφημερίδα ΤΕΜΑ ημερ. 03.09.2017

Και σε αρκετές ηλεκτρονικές ιστοσελίδες

<http://time.ikub.al/Lajme/17-09-02-Miti-Helen-si-alibi-per-baterdine-me-pronat-ne-Himare-dhe-Bregdet.aspx>

<http://time.ikub.al/17-09-03-Miti-Helen-si-alibi-per-baterdine-me-pronat-ne-Himare-dhe-Bregdet/Miti-Helen-si-alibi-per-baterdine-me-pronat-ne-Himare-dhe-Bregdet378623.aspx>

<http://www.gazetatema.net/2017/09/02/miti-helen-si-alibi-per-baterdine-me-pronat-ne-himare-dhe-bregdet/>

## **Nga Panajot Barka**

<https://www.faxweb.al/himara-e-tradhetuar-perjeton-zhberjen-e-vet-2/>

<https://www.facebook.com/gazetatema/posts/1493375210710641/>

<http://time.ikub.al/17-10-03-Himara-e-tradhetuar-perjeton-zhberjen-e-vet/Himara-e-tradhetuar-perjeton-zhberjen-e-vet.aspx>

### **Himara e tradhetuar përjeton zhbërjen e vet.**

03.10.2017

Nuk ka mbetur më asnjë mundësi për të fshehur faktin se ajo që po ndodh në zonën e Himarës, të Bregut dhe më gjerë, të Jugut, përbën një krim të rëndë, të organizuar dhe shumëplanesh me pjesëmarrjen e shtetit.

Tani mund të thuhet pa frikë se si “plani zhvillimor” anarkik i projektuar fillimisht prej Berishës, ashtu dhe ky “strategjik”, apo “ i zhvillimit urban” i Ramës, kanë të njëjtin destinacion. Zhbërjen e Himarës dhe të të gjithë Bregdetit në identitetin e tyre diakronik dhjetra shekullor, etnokulturor, antropologjik, social, si vijë e drejtë autoktonie, apo si bashkegjistence. Mund të duket se shteti, nën presionin e krimit të organizuar ka renë, por e vërteta thotë se shteti është në aleancë të dukshme me të në realizimin e krimit shekullor.

Himara ka një histori, një kulturë, një arkitekturë dhe infrastrukturë, një identitet që shkon deri te krijimi i miteve të para. Aty haset gjuha e dorikeve dhe udhëtimet e Odisesë. Fanepset Cezari dhe intrigat e para të një perandorie moderne, bastion i pasardhësve të Skenderbeut dhe rezistenca me jetëgjatë kundër perandorisë Otomane, djepi i polifonisë së sotme popullore, bashkegjistence e indentiteve e formësuar në këtë realitet dhe në kozmopolitizmin e njohur himariot. Te gjitha këto cilësi, por edhe të tjera, janë të mishëruara në një natyrë magjepsese, ku deti i dorëzohet malit dhe mali qiellit. Komuniteti himariot u bë bartës, administrator dhe krijues i këtyre vlerave.

Nëse sot dikush do të donte të ngrinte këtu një vlerë të re, turizim elitare, kishte vetëm një rrugë, të respektonte këtë realitet tradicional himariot e bregdetas deri në Ksamil e Butrint. Të gjitha vendet me kulturë të zhvilluar në botë, që kanë dashur një turizëm elitare ndryshe dhe me vlera të larmishme, e endërojnë një rast si Himara dhe Bregu. Tek ne po ndodh totalisht e kundërta. Kjo perlë i është dorëzohet krimit, produkt i logjikës së të cilit është një krim me i rëndë. Shteti pasi toleroi krimin e organizuar të grumbullonte shuma marramendëse parash të zëza, e adresoi dhe e joshi atë për tek gjahu, perlën e Bregut. Dhe nuk e bëri këtë, as se nuk përballonte peshën e tij, as më keq, për të krijuar një vlerë të re turistike. Krimi i organizuar u bë mjete më efikas dhe më i fuqishëm për të zhbërë Himarën dhe Bregun. Në të u mobilizuan si falanga drejtuese medjat, drejtësia, ligjvënësit, egzekutivi. Në këmbim të këtij angazhimi u bë përvetësimi i një pjesë sado të vogël Himareje. (!)

Shteti mund të mirrte masa për të mbrojtur natyrën dhe mjedisin himariot e të bregut, por bëri të kundërtën. Mund të mirrte në mbrojtje arkitekturën tradicionale dhe identetare të Himarës, por ua dorëzoi fadromave, betonierave, mamutheve. Në vend që të mirrte në mbrojtje dhe të restauronte godina 400-500 vjeçare, shteti, në emër “të interesit publik” i prish ato, për të ndërtuar parkingje, hotele gjigjante, apo plazhe sipas projekteve të huaja.

Detyrë e shtetit është të mbrojtë vlerat që krijon shoqëria e individit dhe t’i vejë në shërbim të komunitetit dhe të shoqërisë, pikësëpari, t’i mbrojtë qytetarit pronën e vet.

Në rastin e komunitetit himariot shteti u rreshtua hapur me palën e krimit, toleroi dhe inkurajoi strukturat grabitëse të pronës së anëtarëve të këtij komuniteti, për të ndërtuar godina mamuthe që vrasin kulturën shekullore.

Detyrë e shtetit është të mbrojtë interesat e komunitetit himariot, pavarësisht nga përbërja e tij etnike. Ky së është detyrim në respekt të ligjit, por që rrjedh prej faktit se

Himara dhe Bregu nuk mund të egzistojnë pa komunitetin e tyre. Bëhet fjalë për atë komunitet i cili në shekuj, përmes djersës e gjakut, luftës dhe paqës, urisë dhe skamjës krijoi harmoninë midis natyrës dhe njeriut himariot, atë që ne sot i themi perla e Jonit. Shteti nëse donte të zhvillonte këtu turizmin elitare, ose nëse thjeshtë donte të zhvillonte këtu turizmin, rruga e vetme ishte të mbështeste komunitetin vendas.

Ata që zbresin rishtas në Himarë, me një torbë me para dhe me një ferman pronari, ata, që, nuk dinë ç'është deti, por ndërtojnë në gjiret e vogla të Himarës, atje që flenë mitet, dhe traditat shekullore, mamuthet e betonta, ata janë në të vërtetë "pushtues" të Himarës dhe Bregut. Si çdo pushtues do të përcjellë këtu kulturën e vet që në rastin tonë është kultura e krimi dhe e parasë së pistë. Kërkon eliminimin e banorëve autoktonë. Menyra është sa e thjeshtë aq dhe e njohur. Mënjanimi nga jeta vitale e Himarës, duke i hequr pronën, duke i tjetërsuar identitetin.

Kjo lëxohet edhe në investimin shtetëror për krijimin e zonave historike dhe në rikonstruksionin e rreth 500 objekteve me vlera kulturore. Kjo pasi, mamuthet e betonta që kontrollojnë zonën e bregut të detit nuk kanë asnjë lidhje dhe interes për këto vlera. Kështu që pjesa e traditës do të izolohet nga kontaktet me detin jetëdhënës dhe deti i kontrolluar nga mamuthet nuk do të ketë nevojë për përvojën shekullore e komunitetit himariot. Që do të thotë se harmonia e vlerave midis njeriut dhe mjedisit, midis vet natyrës, apo midis vet komunitetit, fragmentarizohen dhe përballen me të humburin fatal komunitetin himariot. Që do të thotë se merr fund identifikimi i himariotit vetëm me lirinë dhe Himara ndjehet për herë të parë e pushtuar, nga krimi i organizuar dhe shtetëror. Pas kaq shekujsh zhvillimi të identitetit të vet etnokulturor ngjizur me natyrën dhe mjedisin, shteti i vet hakmerret me zhbërje të tij.

Për shkak të dorës së zgjatur të shtetit të tij, është hera e parë në historinë e vet që komuniteti himariot nuk mund të lë mënjanë mosmarrveshjet e keqkuptimet e vogla midis veti për të përballuar këtë "pushtim" joshës.

Dihet se faktori i vetëm që mund të pengojë këtë baterdi është faktori ndërkombëtar. Ashtu siç dihet se ky faktor tregon sensibilitet maksimal kur konstaton se preken të drejtat e një minoriteti etnik (jo thjeshtë të drejtat e njeriut).

Në rastin kongret shteti dhe mjetet e komunikimit publik u interesuan me kohë që komunitetit grek të Himarës t'i mohojë egzistenca, me qëllim defaktorizimin e tij në terrësi. Pavarësisht se shumica shqiptare nuk iu kundërvu hapur faktorit minoritar grek në Himarë në kërkesat e tij për mbrojtjen e pronës së vet, është fakt i dhimbshëm se kjo shumicë, nën presionin e akuzës së "mbron" grekun, nuk guxoi as të artikulonte të njëjtën kërkesë dhe as të bashkohet me kërkesat e pjesës greke të komunitetit himariot.

Nga ana tjetër shteti ka arritur të penalizojë drejtuesit dhe përfaqësues të këtij komuniteti dhe këta në vijim ose u benë mjet për përçarjen e tij, ose u shndërruan në faktorë për grabitjen dhe tjetërsimin e pronës së pjesëtarëve të tij.

Shumë mirë ata mund të identifikohen si ana tjetër e medaljës në bashkëpunimin me krimin, madje pse jo dhe me doza me të rrezikshme. Nuk bëhet fjalë vetëm për ata që dje u benë mashë për tjetërsimin e pronës himarioteve dhe sot morën flamurin për mbrojtjen e tyre, por edhe për ata që për shkak të fajit të tyre sot nuk "kanë mundësi" të venë pikat mbi "i" dhe ngrënë zërin me forcë për të zbuluar në themel thelbin e krimi të organizuar e shtetëror në Himarë e në Bregdet.

Ditët e fundit iu dha publicitet disa takimeve të zyrtareve të qeverisë, duke përfshirë edhe kryeministrin, me "përfaqësues" të komunitetit grek në Himarë. Këto "evente" u klasifikuan si kulmim i presionit të gjithanshëm mbi qeverinë për zgjidhjen e problemit të Himarës. Në fakt aty nuk bëhej fare fjalë për terësinë e problemit në Himarë, por për një pjesë fare të vogël të tij. Për dëshmipërblimin e plotë, apo të

pjesëshëm, me dokumenta apo padokumenta të 19 objekteve, apo edhe e disa trojeve, që parashikohen të shëmbën nga zbatimi i projektit rehabilitues të Himarës së vjetër. Pra, nga mbarsja e malit po na pillet një mi! Dhe kjo pjellë shkon në interes të krimit të organizuar në Himarë, pasi bëhet fjalë për një zhvendosje të vemendjes nga plaga e madhe përgjegës për të cilën është krimi i organizuar, tek një puçer, për të cilin fajin (që pronarët nuk kanë dokumenta që të mund të demshpërblehen e kanë ata që bërtasin për shkelje të drejtash). Probemi bëhet më i rëndë, kur po të njëjtë personazh arrijnë dhe mashtrojnë edhe faktorin ndërkombëtar.

Eshtë pikërisht ky realitet përfaqësimi i komunitetit grekohimariot (por edhe rendesa e krimit të organizuar) që ka detyruar shumë personalitete himariote në Himarë dhe mbarë Shqipërinë, ta kenë lenë përfaqësimin e tyre dhe luftën për të drejtat e tyre dhe të ardhmën e Himarës, disa hidraulikeve, elektricistëve dhe çirakeve të tyre.

Po ashtu i dyshimtë mbetet fakti, që ndersa ky krim i organizuar është përhapur në të gjithë Bregun nga Himara në Butrint, çeshtja, madje në formë të deformuar, fokusohet vetëm tek Himara. Kjo përbën një arsye tjetër për të lëjuar dorën e lirë të krimit të organizuar e shtetëror të veprjës me më lehtësi në pjesët e tjera të bregdetit të Jugut. FUND 02.10.2017 TEMA, Shuplaka etj

## **Nga Panajot Barka**

<https://www.faxweb.al/cfare-ndodhi-ne-takimet-e-ditmir-bushatit-ne-janine-dervician-dhe-dropull/>

<https://www.javanews.al/bushati-ne-dervician-kakavije-dhe-janine-dhe-marredheniet-greqine/>

### **Çfarë ndodhi në takimet e Ditmir Bushatit në Janinë, Dervician dhe Dropull**

06.11.2017

Fundjaven që shkoi Ministri për Evropën dhe Punë të Jashtme Ditmir Bushati, i shoqëruar nga Ministria e Kulturës Mirela Kumbaro përshkuan një intenerar nga Gjirokastra në Janinë ku patën tre qëndrime për vizita e takime: në Dervician (në minoritetin etnik grek), në pikën e kalimit kufitar me Greqinë, të Kakavijës (midis emigranteve të bllokuar) dhe në Janinë (me emigrantët nga Shqipëria në këtë qytet).

Në kompleksitetin e tyre këto tre stacione, as më shumë e as me pak, shërbyen si një pasqyrë reale të klimës në marrëdhëniet midis dy vendeve, Greqisë e Shqipërisë, nisur fillimisht nga raporti i qeverisë me minoritetin etnik grek.

Bëhet fjalë për një klimë të renduar, që shpaloset në prag të një takimi të Ministrit Bushati me Homologun grek N. Koxhas në Greqi, me pritshmeri të lartë për marrëdhëniet midis dy vendeve, të paktën sipas Bushatit dhe në momentin kohor që lidhet me nevojën e rinovimit të Traktatit të Miqësisë dhe Bashkëpunimit midis dy vendeve. Pra bëhet fjalë për një cikël të ri përkeqësimi të adresuar kryesisht nga pala shqiptare me inkubator dhe amplifikator medjat dhe si zakonisht me dimesionin antihelenë. E reja tek ky cikël përkeqësimi nuk qëndron vetëm tek fakti se tenton të injektohet tek dimesioni i marrëdhënieve njerëzore midis dy popujve, deri tani të cenuar pak ose aspak, por, për herë të parë po provokon një reagim vertikal dhe horizontal edhe në palën greke, me pikë goditjeje qeverinë shqiptare.

Por lë të analizojmë këtë situatë me pikë referimi tri stacionet e Bushatit në këtë fund jave.

Në Janinë numri i emigrantëve shqiptarë (disa ishin minoritarë grekë) më të cilët u takua Ministri numëroheshin me gishta, kur dihet se në Janinë jetojnë me qindra emigrantë shqiptarë. Ky bojkotimi masiv i Ministrit më shprehës për interesat e emigranteve nuk ka aq lidhje me humbjen e besimit të tyre ndaj politikanëve dhe qeverisjes në Shqipëri. Më shumë është tregues i kundërshtisë së tyre ndaj politikës që ndiqet nga Tirana ndaj Greqisë. Shkurt, një politikë e tillë atyre u prish shumë punë. U prish qetësinë, harmoninë, bashkëpunimin, integrimin, raportet evropiane të shumicës dërmuese të tyre të vendosura me shtetin rezidentë të tyre, Greqinë, gjë për të cilën shumë pak mendohet në Shqipëri.

Aq më e veshitirë bëhet jeta e tyre në Greqi nga çfryrjet nëpër medjat të patriotizmit, anakronik, vulgar e nacionalist antihelenë manipuluar e servitur prej politikës si një alkimi për të tërhequr vemendjen nga problemet e përditshme e të lidhura me gjënë më të thjeshtë, mbijetesën. Pra kemi një dyzim, ose një përthyerje në qëndrimet shqiptare ndaj Greqisë. Ato qindra mijrat e shqiptarëve që jetojnë në Greqi kërkojnë nga Tirana të zbatojë një politikë miqësie, mirëkuptimi e bashkëpunimi, ndërsa, në kundërshtim frontal me ta, një pjesë e mirë e shqiptarëve në Shqipëri, sidomos opinionbërësit publik, kujtojnë se do të zgjidhin probelet e brendshme të tyre duke prodhuar e konsumuar antihelenizëm.

Kjo gjë u evidentua me qartë në stacionin e dytë të Ministrit, atë në Kakavi. Të ndodhur midis shqiptarëve të bllokuar për orë të tëra në kufi tek po udhëtonin për në Greqi, të dy ministrat, Bushati dhe Kumbaro, provuan reagimin e tyre të ashpër.

Qytetarët shqiptarë të çliruar nga tutela politike dhe të revoltuar nga bllokimi shumëorësh në kufi, bënë fajtorë qeverinë e tyre për ato orë të mundimshme.

Atyre nuk u interesonte njoftimi zyrtar i palës greke se kufiri u mbyll për shkaqe teknike. Medjat e Tiranës kishin injektuar tek veshi i tyre i revoltës lajmin se vuajtjet e tyre ishin një hakmarrje greke për ngjarjet në Himarë !!! Dhe megjithatë ata kishin një përgjigje. Fajin ia ngarkonin Tiranës. Dhe këtë ia thoshin drejtpërdrejt dhe në sy Ministrin më kompetentë për punët e tyre. Kështu që medjat në Tiranë me hamendesimet e tyre se prapa bllokimit të kufirit nga pala greke kishte arsye politike, nuk bënë gjë tjetër veçse nxisnin nga njëra anë, revoltën ndaj qeverisë së Tiranës tek pjesa e shqiptarëve që kanë lidhur jeten e tyre reale me Greqinë, dhe nga ana tjetër antihelenizmin tek shqiptarët që duan të jetojnë me nacionalizmin e semurë.

Në këtë kendveshtrim, më i vështirë dhe më i komplikuar ishte për Bushatin dhe Kumbaron takimin në fshatin e njohur të minoritetit grek, në Dervician të Gjirokastrës. Ishte mëse e qartë që Bushatit, në prag të takimit informal ose formal me homologun e tij grek, Nikos Koxhas, i duhej një takim i tillë, madje më sa më shumë minoritarë grek të pranishëm dhe sa më shumë entusiast.

Dihet se në bisedimet e pritshme midis tyre çeshtjet e minoritetit dhe të drejtave të tij, ligjit i sapo aprovuar për minoritetet, problemi i pronave në terësi (jo vetëm në Himarë) etj, do të jenë shumë lartë në axhentën e Ministrin të Jashtëm Grek, pasi edhe sikur ai të dojë t'i anashkalojë, nuk mund të injorojë presionin politik opozitar e të opinionit publik grek.

Nga ana tjetër, lideri politik i minoritetit etnik grek në Shqipëri ka kohë që i ka hedhur urat e komunikimit me qeverinë. Ky fakt do të kishte pak rëndësi nëse komuniteti i minoritetit etnik grek do të manifestonte një qëndrim ndryshe nga liderri i tij. (Ky në fakt përbënte edhe një nga synimet e Ministrin Bushati në Dervician). Fatkeqësisht, u provua se në minoritet po kthehet në fenomen pa precedent në të shkuarën klima refraktare ndaj qeverisjes.

Dhe nuk është thjeshtë produkt i lojës së kryeministrit që përplaset me Dulen për të rritur kredibilitetin e vet antihelen në mjedisin shqiptar dhe i Dules që përplaset me Ramën për të rritur aksionet e tij të rena përtokë në minoritet (kur mbetet politikani minoritar me i pavotuar nga ky komunitet). Takimin e bojkotuan të gjithë përfaqësuesit e tjerë të Minoritetit me përjashtim të atyre të PS-së në bashkinë Dropull. Organizatorët, njerëz nga minoriteti grek pranë PS-së e patën të vështirë t'i bindnin ata për pjesëmarrje. Aq më keq kur vet ata tentuan ta shfrytëzonin situatën për të treguar forcën e tyre politike në këtë bashki, (të pranishëm në takim ishin thjeshtë anëtarë të PS-së në bashkinë e Dropullit) duke e shndërruar kështu praninë e dy ministrave në pjesë të luftës politike në homogjenitetin etnik në Dropull.

Zërat e atyre (midis tyre dhe unë) që kërkojnë që përfaqësuesit e minoritetit duhet t'i kthehen dialogut konstruktiv me qeverinë dhe qeveria, ashtu si shumica, nuk ka pse manifeston se ka frikë nga një minoritet dhe për këtë duhet ta vendos nën kontroll, po kthehen në minorancë.

Pikënisja për një situatë të tillë duket se kësaj here është problemi i krijuar në Himarë dhe aprovimi i ligjit për minoritetet. Problemi i promovuar në Himarë është real, por, fatkeqësisht në qasjen e tij u kap pas majës së aisbergut dhe qëllimshëm në menyrë të njëanshme. Trajtimi i problemit në Himarë si raport i një grupi himariotesh, të deklaruar të etnisë greke dhe i pasurive të tyre me ligjin në kushtet e zbatimit të një pjese të planit rregullues të qendrës historike të Himarës, nuk ka të bëjë aspak me problemin real dhe thelbin e tij këtu.

Po provohet se konflikti për zbatimin e planit rehabilitues në qendrën historike të Himarës, po merr një zgjidhje administrative shpërblimesh për efekte të interesit publik. Palët politike e përformuan nga pozita nacionaliste, si një përplasje për interesa ernike. Kërkuan nga njëra anë të spostojnë vemendjen dhe të fshehin krimin e madhë, që nën përgjegjësinë e tyre direkte ka ndodhur dhe po ndodh në Himarë për vite më radhë. (Vihet lehtësisht re se faktorët e lartë politikë të mpleksur në problemin e Himarës tregojnë se kanë nxjerrë shpatat kundër njeri tjetrit.

Deklarojnë se kanë dokumenta shumë të rënda faji ndaj njeri tjetrit, por kërcenimet arrijnë deri në vijat e kuqe të kompromisit për të ruajtur njëri tjetrin nga përgjegjësitë penale) Nga ana tjetër, promovimi i problemit si antihelenizëm nga palët politike, në llogore pro dhe kundra, synon, marginalizimin e elementit grek në Himarë, sfumimin në emër të patriotizmit të reagimit të komunitetit më të gjerë himariot dhe shoqëror për aq sa ndodhin në Himarë, për të krijuar kështu terrenin e duhur parasë së pistë dhe krimin të organizuar për ta kryer “këtë mision” me fanelë patriotike.

Pra, shihet qartë se në përkeqësimin e marrëdhënieve me Greqinë po shkohet larg dhe pak mendohet për normalizimin e tyre. Dhe me keq, një situatë e tillë pengon dhe ngushton përditë mundësitë e kthimit pas. **FUND U Botua tek JAVA dhe SHUPLAKA**  
me date 06.11.2017

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.javanews.al/postkreta-si-verifikim-antialogut-qe-imponon-pseudoegoizmi-nacionalist/>

<https://faxweb.al/post-kreta-si-verifikim-antialogut-qe-imponon-pseudoegoizmi-nacionalist/>

<http://www.gazetatema.net/2017/11/16/postkreta-si-verifikim-i-antialogut-qe-imponon-pseudoegoizmi-nacionalist/>

### **PostKreta si verifikim i antialogut që imponon pseudoegoizmi nacionalist.**

16.11.2017

Pavarësisht nga përpjekjet për të fshehur të vërtetën, ditët e post Kretës ofrojnë realitetin e problemit në marrëdhëniet e Shqipërisë me Greqinë. Nuk ka të bëjë me ligjerimin që konsumojnë përditë medjat, opinionbërësit, politika dhe segmentë të tjerë. Ky ligjerim është shprehje e mentalitetit dhe epersisë që ai ka krijuar mbi problemet reale dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre, i marrjës peng të këtij reraliteti, në atë shkallë sa që në çdo ballafaqim me të vërtetën prodhon frikshëm energji negative dhe reaksion. Thelbi i tij lidhet me mbajtjen gjallë të ideve romantike që i shërbyen egos nacionaliste të shek. XIX. Kuptohet që tek çdo popull, qoftë ballkanas apo evropian, pavarësisht vokalitetit dhe peshës politike, janë evidente linja shprehëse të egos etnike. Në rastin e Shqipërisë, qoftë si pasojë e traditës komuniste, apo i krizave të brendshme dhe nëvojës për të tërhequr vemendjen e publikut nga ato, qoftë në kushtet e mungesës së ideve alternative që promovojnë vizion evropian, apo edhe të investimeve të të tretëve në këtë drejtim, realiteti i egoizmit etnik iu injektua dhe iu imponua si misherim vital, politikës dhe diplomacisë zyrtare dhe opinionit publik.

Flet për këtë përpjekja për ta paraqitur takimin e Kretës si historik, në emër gjoja të asaj se diplomacia shqiptare për herë të parë i mblodhi në një paketë problemet e historisë dhe të së tashmës dhe ia la mbi tavolinën palës greke, pa bërë lëshime, apo edhe kultivimi para takimit i iluzioneve për pritshmëri triumfale.

Kjo është logjika e pashmangshme i këtij mentaliteti, e adresuar nga teoritë banale se në themel të Greqisë, të kombit grek dhe të arritjeve të tij historike e kulturore janë shqiptarët; nga promovimi i hartave me “troje shqiptare” deri në Pelopenez, (kufiri i fundit i Perandorisë Otomane në Greqi, por që mban gjallë centrifugalizmin shqiptar të kohës të Perandorisë Otomane); nga pretendimi si truall kombëtar shqiptar të gjeografisë së mitologjisë dhe të kulturës së lashtë greke; nga teoritë e dështuara Fallmerayerane, që mohojnë vazhdimësinë e grekëve të sotëm nga grekët e lashtë dhe atribuimi i kësaj trashëgimie shqiptarëve; nga paraqitja e Greqisë dhe grekëve si armiq përmanent që synojnë copëtimin e Shqipërisë dhe për pasojë, helmojnë raporte miqësore midis popujve, sidomos të rinisë.

Por, ky ligjerim masiv dhe shumëplanesh i cili ka fituar një status publik paprekshmerie që i shkon përshtat tabuve, bie ndesh me çdo lloj parimi të fqinjësisë së mirë në frymë Evropiane. Me këtë status iu imponua bisedimeve në Kretë, duke përjashtuar çdo pritshmeri jashtë këtij kuadri. (Të mendohet për një çast se çfarë do të ndodh nëse pala shqiptare do të pranojë të heq nga literatura zyrtare shkollore “trojet shqiptare” të Çamerisë dhe të gjithë Epirit të Jugut). Problemi, me fajtor primar politikën, e cila për konsum të brendshëm politik e stimuloi atë, bëhet më i vështirë, se është lëjuar të shkojë shumë larg pa lëjuar hapësira për kthim prapa.

Kuptohet që edhe pala greke, në kushtet e njohura ekonomike, politike dhe sociale nuk mund të anashkalojë faktorët e egos nacionaliste greke, pavarësisht nga



mungesa e peshës në qeverisje, por me ndjeshmëri të lartë, sidomos pas ngjarjeve në Himarë. (Në Shqipëri qëllimisht është ngatërruar vazhdimisht faktori jo zyrtarë me qëndrimet zyrtare të shteti grek ndaj Shqipërisë) Nga ana tjetër, argumenti “i Shqipërisë së madhe”, artikuluar në mënyrë formale dhe informale, i cili nuk lë jashtë Greqinë, i bën sensibilitetet dhe shqetësimet greke, të tilla që të kenë mirëkuptimin edhe të faktorit ndërkombëtar. Në këtë prizëm Ministrit Grek Kotzias, i duhej të ishte i kujdesshëm në Kretë. E kondiciononte këtë edhe propozimi i tij në vizitën në Shqipëri, qershor 2016, i mohuar nga Tirana, për një aleancë me faktorin shqiptar në Ballkan me horizont njohjen e Kosovës, që atij i kushtoi jo pak.

Gjasat tregojnë se Athinës i duhej të bëhej në këtë takim pak Çeki, që për interesat e një firme private të saj në Shqipëri, kërcenoi me veto në BE. Të bëhej pak Bullgari, e cila me disa mesazhe bllokuese për hapjen e negociatave integruese të Shqipërisë në BE, fitoi një minoritet kombëtar në Shqipëri, të bëhej pakëz Itali e cila, si “shpërblim” që hedh në det qindra shqiptarë, merr falinderimet e Tiranës zyrtare, për arsye se nxjerr nga fundi i detit një pjesë të truapve të tyre, .. ose pak Turqi etj. Pra, të dalë nga praktika e deritashme të përkrahjes pa kushte të integritetit të Shqipërisë në organizmat Euroatlantike, pa marrë kurrë ndonjë falenderim .

Pra, në këtë logjik takimi i Kretës konfirmoi jo aq egzistencën e problematikës në marrëdhëniet midis dy vendeve, se sa mentalitetin e njëanshëm që provokon “problematikë të komplikuar” duke e ricikluar çështje të tejshkuara dhe për interesa, shpesh të të treteve, që të kthejnë historikisht pas. Fakti i pajtimit të të gjithë të interesuarve me vendimin për të mbajtur sekret përmbajtjen e bisedimeve, është i mjaftueshëm për të mbështetur këtë tezë.

Pas kësaj shqetësimi po bëhet përditë dhe më i dukshëm. Nxitoi ta shprehte i pari kryeministri Rama, i cili e karakterizoi Kretën si sukses për faktin se palët pas vitesh replikash në distancë, u ulën në tavolinën e bisedimeve. (!!)

Paralelisht, faktorë potentë që shquhen në kultivimin e mentalitetit shqiptar antihelenë, nxituan të zbusnin efektet në lidhje me iluzionet e krijuara po prej tyre për rezultate spektakolare në favor të palës shqiptare. Avancimi i bisedimeve me zgjidhje në favor të të dy vendeve do të vinte në dyshim “drejtësinë” e klanit antihelenë, ndërkohë që justifikimi se “ishte takimi i parë dhe nuk priteshin rezultate” nuk bind, se takimit i paraprinë bisedime teknike dypaleshe që zgjaten dy vjet.

Shëmbulli më të spikatur vjen kolonel Pashaj. Ai që gati u shpall hero se përndezi “patriotizmin” për “tradhëtinë” në marrëveshjen e detit, para ca ditësh, në një të përditshme të Tiranës deklaroi se, “faktori për këtë marrëveshje është pala shqiptare”. Pranon se marrëveshja “nuk ka qenë kundër Shqipërisë”. Ngarkon me teknikientet shqiptarë pasi demi që i shkaktuan vendit është se “prishja e marrëdhënieve midis dy vendeve” dhe porosit “të mos shkohet në arbitrazh”(!!). Në fakt zoti Pashaj, iu kundërvu Gjykatës Kushtetuese, e cila në thelbin e argumentimit të vet pranon se negociatorët e marrëveshjes ndoqën një rrugë ligjore, në respekt të akteve nderkombëtare. Ajo kërkon antikushitetshmerinë e marrëveshjes me kërkesën për zbatim të parimeve të tjera, “më të leverdishme” për vendin, të cilat, po sipas Kushtetuesës, në të gjitha rastet janë produkt i vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare dhe aspak produkt negociimi dhe marrëveshjeje dypaleshe. (Arbitrazhi është forma më e thjeshtë e këtyre vendimeve.) Këtu ka edhe momente të tjera të dyshimta. Pse nuk u dënua asnjë nga negociatorët e marrëveshjes, “për tradhëti të lartë” por disa prej tyre u ngriten në përgjegjesi dhe perse qeveria do një marrëveshje “të rrezuar”?

Po ashtu, edhe problemet e tjera të paketës shqiptare në Kretë ishin paragjykuar paraprakisht nga mentaliteti i egos antihelene nacionaliste, kuptohet pa argumente. P.sh. në të ishte përfshirë dhe “çështja çame”.

Nuk duam t'i referohemi vendimit të panegociueshëm të palës greke për këtë problem, por asaj se çfarë do thotë pala shqiptare nëse do të kishte në tavolinë dokumentin britanik PRO/FO 371/48094 R 18138, sipas të cilit shefi i misionit të aleatëve në Epir, Cris Woodhouse, pranon se Zervës iu dha urdhër për të pastruar Epirin nga Çamët. Çfarë do të thotë nëse do t'i vihen përpara vendimet e gjykatave greke që i akuzojnë çamet edhe për përpjekje të armatosur për cënim të tërësisë territoriale të Greqisë, për përmbysje të dhunshme të pushtetit lokal në Thesproti, të cilën edhe vet pushtuesit nuk e prekën, për vrasje dhe reprezalje kundër popullsisë civile greke? Në Thesproti është themeluar se fundmi një shoqatë e viktimave të çameve bashkëpunëtorë të pushtuesve. Doli në qarkullim edhe libri me dokumenta nga arkivat gjermanë mbi veprimtarinë bashkëpunuese me armë në dorë me nazistët të mbi 3 200 çameve. Në arkivat greke, egzistojnë dokumente italiane, turke apëo dhe austrohungareze, që vërtetojnë se elementi çam në Thesproti u përdor që me 1913 nga këto fuqi për të krijuar destabilitet në Epir. Me 1940 lufta italogreke kishte si pretext provokimet çame dhe si kasus bashkimin e Çamerisë me Shqipërinë.

Përsa u përket të reneve grekë të cilët janë të renët e fitorës së parë lundër makinëns fashiste, janë dhe të vetëm të vrrarë të luftës së dytë botërore që janë ende pa një varë. Pala shqiptare, para se të zbatojë një marrëveshje dypaleshe dhe një detyrim ligjor ndërkombëtar, duhet të sqarojë, a janë këta të renë fashizmit çlirimtarë të grekëve dhe shqiptarëve prej ketyre pushtuesve!? E them këtë pasi dhe qëndrimi zyrtar duket se pajtohet me qëndrimin që i quan të renët grekë pushtues. Nëse është kështu atëherë rezulton i dhenë dhe praktikisht fakti se Shqipëria ishte pjesë e perandorisë fashiste të Viktor Emanuelit III.

Atëherë, nëse pala Shqiptare nuk pranon si të abroguar ligjin e luftës me Greqinë të paktën sipas praktikës së ndjekur nga Athina me Italinë, duhet fillimisht ajo të abrogojë vendimin e parlamentit shqiptar (të zgjedhur para pushtimit) të 15 qershorit 1940, i cili me brohoritje (dhe jo i imponuar) ktheu në ligj një dekret të Viktor Emanuelit, sipas të cilit Shqipëria ishte në luftë me cilindo shtet që do të ishte në lufte edhe Italia.(!) Por dihet se është shumë e vështirë që ego-ja nacionaliste e Shqipërisë të pranojë një diçka të tillë, edhe sikur Greqia t'ja kërkojë me ngulm! Por, në emër të po kësaj ego-je nacionaliste, ka guximin t'ja kërkojë Greqisë deri në imponim.

Së fundmi, për mendimin tim rezultati poziv në Kretë qëndron tek fakti se rezistoi sprova e diplomacisë së dialogut me aleat kohën për një ditë më të mirë, me shpresë së mentaliteti i egos nacionaliste të shek XIX mund t'i hapin rrugën vullnetit pozitiv për fqinjësi të mirë fhe të perspektivës evropinae të të dy popujve. **FUND!**

Për Gazetën TemA 16.11.2017

### **Η μετά την Κρήτη περίοδος ως διαπίστωση του κλίματος αντιδιαλόγου που επιβάλλει ο ψευδής εθνικιστικός εγωισμός**

**Του Παναγιώτη Μπάγκα**

Ανεξαρτήτως από τις προσπάθειες για την κάλυψη της πραγματικότητας, οι μέρες μετά την Κρήτη, προβάλλουν τον πραγματικό προβληματισμό στις Ελληνοαλβανικές σχέσεις. Σχετίζεται με τον καθημερινό λόγο που καταναλώνουν τα ΜΜΕ, οι διαμορφωτές της κοινής γνώμης και λοιποί παράγοντες. Ο λόγος αυτός αποτελεί την εκδήλωση της νοοτροπίας και της υπεροχής που αυτή η νοοτροπία κατάφερε να αποκτήσει επί των πραγματικών προβλημάτων και των δυνατοτήτων για την επίλυσή τους, παίρνοντάς τα όμηρους, σε εκείνο το βαθμό που η κάθε

αντιπαραβολή με την πραγματικότητα παράγει κατά φρικτό τρόπο αρνητική ενέργεια και αντιδράσεις.

Η ουσία της νοοτροπίας αυτής αφορά την τήρηση ζωντανών των ρομαντικών ιδεών που εξυπηρέτησαν τον εθνικιστικό εγωισμό του XIX αι. Εννοείται ότι σε κάθε λαό, είτε βαλκανικό, είτε ευρωπαϊό, ανεξαρτήτως της απήχησης και του πολιτικού βάρους, δίνουν το παρόν τους οι φορείς του εθνικού εγωισμού.

Στην περίπτωση της Αλβανίας, είτε ως συνέπεια της κομμουνιστικής παράδοσης, ή των διαδεχόμενων κρίσεων και της ανάγκης για την εκτροπή της κοινής γνώμης από αυτές, είτε λόγω έλλειψης εναλλακτικών ιδεών που προσεγγίζουν την ευρωπαϊκή προοπτική, ή και της επένδυσης τρίτων προς την ίδια κατεύθυνση, η νοοτροπία του εθνικιστικού εγωισμού μεταγγίστηκε και επιβλήθηκε ως ζωτικό βίωμα στην επίσημη πολιτική και διπλωματία, όπως και στην κοινή γνώμη.

Μιλάει γι' αυτό η προσπάθεια για να παρουσιαστεί η συνάντηση της Κρήτης ως ιστορική, εξ ονόματος δήθεν του γεγονότος ότι η αλβανική διπλωματία για πρώτη φορά συγκέντρωσε σε ένα πακέτο τα προβλήματα της ιστορίας και του παρόντος και τα έθεσε επί τάπητος στην ελληνική πλευρά, χωρίς παραχωρήσεις, ή και λόγω της καλλιέργειας πριν από τη συνάντηση των αυταπατών για θριαμβευτικά αναμενόμενα αποτελέσματα σε όφελος της Αλβανίας.

Αυτό αποτελεί την αναπόφευκτη λογική της συγκεκριμένης νοοτροπίας, που τροφοδοτούν οι χυδαίες θεωρίες ότι στα θεμέλια της Ελλάδας, του ελληνικού έθνους και των ιστορικών και πολιτιστικών επιτευγμάτων του, στέκουν οι Αλβανοί, η ανάρτηση χαρτών με «αλβανικά εδάφη» μέχρι την Πελοπόννησο, (τελευταία σύνορα της Οθωμανικής Αυτοκρατορίας στην Ελλάδα, που συντηρεί όμως ζωντανή την αλβανική κεντρόφυγη ισχύ της περιόδου της Οθωμανικής Αυτοκρατορίας), η διεκδίκηση ως αλβανικά εθνικά εδάφη της γεωγραφίας της αρχαίας ελληνικής μυθολογίας και πολιτισμού, οι αποτυχημένες Φαλμεραυερικές θεωρίες, που αρνούνται την συνέχεια των σύγχρονων Ελλήνων από τους αρχαίους Έλληνες, αποδίδοντας την κληρονομιά αυτή στους Αλβανούς, η παρουσίαση των Ελλήνων ως μόνιμους εχθρούς που αποσκοπούν στο διαμελισμό της Αλβανίας, δηλητηριάζοντας ως συνέπεια τις φιλικές σχέσεις μεταξύ των λαών και ιδιαίτερα την νέα γενιά.

Όμως αυτός ο μαζικός και πολυδιάστατος λόγος, ο οποίος κατάφερε να πετύχει δημόσιο καθεστώς, που δεν μπορεί να τον αγγίξεις και που αρμόζει πλήρως στα ταμπού, αντιτίθεται σε κάθε αρχή καλής γειτονίας και στο ευρωπαϊκό πνεύμα.

Ακριβώς με το καθεστώς αυτό η συγκεκριμένη νοοτροπία επιβλήθηκε στις συνομιλίες της Κρήτης, αποτρέποντας κάθε αναμενόμενο αποτέλεσμα εκτός του πλαισίου λογικής της συγκεκριμένης νοοτροπίας.

(Ας τολμήσει να σκεφτεί κανείς για μια στιγμή τι πρόκειται να συμβεί σε περίπτωση που η αλβανική πλευρά θα δεχτεί να αφαιρεθούν από τα επίσημα σχολικά εγχειρίδια οι ισχυρισμοί για τα «αλβανικά εδάφη» της Τσαμουριάς και όλης της Νότιας Ηπείρου) Το πρόβλημα, με βασικό υπαίτιο την πολιτική η οποία για εσωτερική κατανάλωση υπόθαλψε τη ρητορική αυτή, γίνεται ιδιαίτερα δύσκολο, διότι έχει φθάσει πολύ μακριά, χωρίς να αφεθούν περιθώρια για επιστροφή.

Εννοείται ότι και η Ελληνική πλευρά, στις γνωστές οικονομικές, πολιτικές και κοινωνικές καταστάσεις, δεν μπορεί να παρακάμψει τους φορείς του ελληνικού εθνικού εγωισμού, ανεξαρτήτως από την έλλειψη βαρύτητας στη διακυβέρνηση, αλλά με ιδιαίτερα υψηλές ευαισθησίες, ειδικά μετά τα γεγονότα στη Χιμάρα. (Στην Αλβανία εσκεμμένα συγχέονται οι ανεπίσημοι φορείς με τις επίσημες θέσεις του ελληνικού κράτους προς την Αλβανία)

Από την άλλη πλευρά, το επιχείρημα της «Μεγάλης Αλβανίας» που αρθρώνεται επίσημα ή ανεπίσημα, αλλά που θίγει και την Ελλάδα, μετατρέπει τις ελληνικές

ευαισθησίες και ανησυχίες τέτοιες που αποχτούν την κατανόηση του διεθνή παράγοντα. Υπό το σκεπτικό αυτό ο Έλληνας Υπουργός Κοτζιάς, έπρεπε να ήταν προσεχτικός στην Κρήτη. Υπαγόρευε μια τέτοια στάση και η πρότασή του, κατά την επίσκεψη στην Αλβανία τον Ιούνιο του 2016, την οποία απέρριψαν τα Τίρανα, για μια συμμαχία με τον αλβανικό παράγοντα στην Βαλκανική με την προοπτική την αναγνώριση του Κοσσυφοπεδίου στο μέλλον, γεγονός που στον ίδιο στοίχισε πολύ.

Οι εξελίξεις αποδεικνύουν ότι η Αθήνα στη συνάντηση αυτή θα έπρεπε να γίνει ολίγο Τσεχία, η οποία για μια ιδιωτική επιχείρηση δικών της συμφερόντων στην Αλβανία, απείλησε με βέτο στην Ε. Ένωση. Να γίνονταν ολίγο Βουλγαρία, η οποία μόνο μέσω μερικών μηνυμάτων αποκλεισμού της Αλβανίας στην ενδεχόμενη έναρξη των ενταξιακών διαπραγματεύσεων της Αλβανίας με την Ε. Ε, πέτυχε την αναγνώριση εθνικής μειονότητας στην Αλβανία. Να γίνονταν λίγο Ιταλία, η οποία «ως ανταμοιβή» για το εσκεμμένο πνίζιμο στη θάλασσα μερικών εκατοντάδων Αλβανών, αποσπά τις ευχαριστίες των επίσημων Τιράνων επειδή η ίδια η Ιταλία αποφάσισε να βγάλει από το βυθό μέρος των θυμάτων της, ...ή ολίγο Τουρκία κλπ. Να ξεφύγει λοιπόν, από την μέχρι τώρα πραχτική υποστήριξης της Αλβανίας για την ένταξή της στους Ευρωπαϊκούς οργανισμούς, χωρίς όρους και ανταλλάγματα και χωρίς ποτέ να λάβει ένα ευχαριστώ.

Υπό αυτή την οπτική γωνία η συνάντηση της Κρήτης επιβεβαίωσε όχι τόσο την ύπαρξη του προβληματισμού στις σχέσεις μεταξύ των δύο χωρών, όσο την μονομερή νοοτροπία που προκαλεί «περίπλοκο προβληματισμό» στις σχέσεις αυτές ανακυκλώνοντας ξεπερασμένα θέματα και συχνά προς όφελος τρίτων, που σε οδηγούν ιστορικά προς τα πίσω. Το γεγονός ότι όλοι οι ενδιαφερόμενοι συμφώνησαν με την τήρηση της μυστικότητας όσον αφορά το περιεχόμενο των συνομιλιών, είναι αρκετό για την υποστήριξη της θέσης αυτής.

Όμως, μετά από την εξέλιξη αυτή στην Κρήτη, η ανησυχία κορυφώνεται καθημερινά. Έσπευσε να τη δηλώσει πρώτος ο Πρωθυπουργός Ράμα, ο οποίος εντόπισε την επιτυχία της συνάντησης στο γεγονός ότι οι πλευρές μετά από χρόνια εκτόξευσης εξ αποστάσεως δηλώσεων, κάθισαν στην τράπεζα των συνομιλιών. (!!). Παράλληλα, ισχυροί παράγοντες που διακρίνονται στην καλλιέργεια της αλβανικής ανθελληνικής νοοτροπίας, έσπευσαν να καταπραΰνουν τις εντυπώσεις που οι ίδιοι είχαν καλλιεργήσει για εντυπωσιακά αποτελέσματα σε όφελος της αλβανικής πλευράς. Από την άλλη η προώθηση των συνομιλιών προς λύσεις σε διμερές όφελος θέτει υπό αμφισβήτηση «τις θέσεις» της ανθελληνικής φατριάς, την στιγμή που η δικαιολογία ότι «ήταν η πρώτη συνάντηση και δεν αναμενότανε αποτελέσματα» δεν πείθει, διότι της συνάντησης της Κρήτης προηγήθηκαν οι διαβουλεύσεις εμπειρογνομόνων που διήρκησαν δύο χρόνια.

Το πιο χτυπητό παράδειγμα αποτελεί ο συνταγματάρχης Πασάι. Εκείνος όπου λίγο έλειψε να ανακηρυχτεί ήρωας διότι ανάφλεξε «τον πατριωτισμό» λόγω «της προδοσίας που διαπράχτηκε» με τη συμφωνία για τα χωρικά ύδατα, πριν λίγες ημέρες, σε μια ημερήσια εφημερίδα των Τιράνων δήλωσε ότι «ο ένοχος για τη συμφωνία αυτή είναι η αλβανική πλευρά». Δέχεται ότι η συμφωνία «δεν ήταν κατά της Αλβανίας». Επιρρίπτει ευθύνες στους Αλβανούς εμπειρογνώμονες, διότι έβλαψαν τις διμερείς σχέσεις και παραγγέλλει «να αποφευχθεί η διεθνής διαιτησία» (!!). Στην ουσία ο κύριος Πασάι αντιτάχτηκε στο Συνταγματικό Δικαστήριο της χώρας, την απόφαση του οποίου ο ίδιος συμμερίστηκε και στήριξε. Η απόφαση αποδέχεται ότι οι διαπραγματευτές της αλβανικής πλευράς ακολούθησαν μια νομική οδό, προβλεπόμενη από τις σχετικές διεθνείς συμβάσεις. Το Δικαστήριο υποστηρίζει την αντισυνταγματικότητα της συμφωνίας με το αίτημα για εφαρμογή άλλων αρχών, «πιο

συμφερούσων» για την Αλβανία, οι οποίες αρχές, πάντα σύμφωνα με το Συνταγματικό Δικαστήριο, σε κάθε περίπτωση είναι αποτέλεσμα αποφάσεων διεθνών δικαστηρίων και όχι διμερών διαβουλεύσεων. (Η διεθνής διαιτησία είναι η απλούστερη μορφή των αποφάσεων αυτών). Εδώ εντοπίζονται και μερικά άλλα ύποπτα σημεία. Γιατί δεν τιμωρήθηκε κανείς από την ομάδα των Αλβανών εμπειρογνομόνων στη συμφωνία, «για εσχάτη προδοσία», αλλά μερικοί εξ αυτών προηγήθηκαν σε σημαντικότερες θέσεις!; Μετά, γιατί η κυβέρνηση θέλει μια «παραλυμένη» συμφωνία;

Επίσης, και τ άλλα θέματα του αλβανικού πακέτου στην Κρήτη, αποσκοπούσαν στο αντίθετο των λύσεων και ήταν προκατειλημμένα από την νοοτροπία του εθνικιστικού ανθελληνικού εγωισμού. Λ.χ στο πακέτο περιλαμβάνονταν και το «τσάμικο θέμα».

Δε θέλουμε να αναφερθούμε στην αδιαπραγμάτευτη ελληνική θέση για το θέμα αυτό, αλλά θα διεκδικούσαμε την απάντηση της αλβανικής πλευράς όταν για το θέμα αυτό θα είχε στο τραπέζι των συνομιλιών το βρετανικό έγγραφο PRO/FO 371/48094 R 18138, κατά το οποίο ο αρχηγός της αποστολή των συμμάχων στην Ήπειρο, Cris Woodhouse, δέχεται ότι στο Ζέρβα δόθηκε εντολή για την εκκαθάριση της Ηπείρου από τους Τσάμηδες. Τι θα πουν σε περίπτωση που θα έχουν μπροστά τους τις αποφάσεις των ελληνικών δικαστηρίων που κατηγορούν τους Τσάμηδες και για τις ένοπλες ενέργειες με στόχο την προσβολή της εδαφικής ακεραιότητας της Ελλάδας, για βίαιη ανατροπή της τοπικής αυτοδιοίκησης στη Θεσπρωτία, την οποία ούτε οι κατακτητές δεν άγγιξαν, για σκοτωμούς και διωγμούς κατά των άμαχων Ελλήνων πολιτών; Στη Θεσπρωτία ιδρύθηκε πρόσφατα ο Σύλλογος των Θυμάτων των Τσάμηδων συνεργατών των κατακτητών. Κυκλοφόρησε το βιβλίο με τα έγγραφα από τα γερμανικά αρχεία σχετικά με τη ένοπλη συνεργασία με τους ναζίστες των περισσότερων από 3 200 Τσάμηδων. Στα ελληνικά αρχεία υπάρχουν ιταλικά, τουρκικά ή και αυστρουγγρικά έγγραφα που επιβεβαιώνουν ότι το τσάμικο στοιχείο στην Θεσπρωτία χρησιμοποιήθηκε από το 1913 από τις δυνάμεις αυτές για την αποσταθεροποίηση της Ηπείρου. Το 1940 ο Ελληνο-ιταλικός πόλεμος είχε ως πρόσχημα τις προβοκάτσιες των Τσάμηδων και ως προϋπόθεση της ένωση της Τσαμουριάς με την Αλβανία.

Όσον αφορά τους Έλληνες πεσόντες, οι οποίοι είναι πεσόντες της πρώτης νίκης κατά της φασιστικής μηχανής και είναι οι μόνοι νεκροί του Δεύτερου Παγκοσμίου Πολέμου που δεν έχουν ακόμα έναν τάφο. Ωστόσο, η αλβανική πλευρά, πριν εφαρμόσει μια διμερή συμφωνία και ένα διεθνές νομικό πλαίσιο, πρέπει να αποφανθεί, αν οι πεσόντες αυτοί κατά του φασισμού είναι απελευθερωτές των Ελλήνων και Αλβανών στα εδάφη αυτά από αυτούς τους κατακτητές. Το σημειώνω αυτό διότι και η επίσημη θέση φαίνεται ότι ταυτίζεται με τη θέση εκείνη που θέλει τους Έλληνες πεσόντες να είναι κατακτητές. Σε περίπτωση που αυτό ισχύει, τότε προκύπτει και πραχτικά ότι η Αλβανία ήταν μέρος της φασιστικής αυτοκρατορίας του Β. Εμμανουήλ ΙΙΙ.

Τότε, σε περίπτωση που η Αλβανική πλευρά δεν αποδέχεται την κατάργηση του εμπολέμου, τουλάχιστον κατά την πραχτική που ακολουθήθηκε από την Αθήνα με την Ιταλία, τότε πρέπει εκείνη πρώτα να καταργήσει την απόφαση της αλβανικής Βουλής (εκλεγμένης πριν από την ιταλική κατοχή), της 15<sup>ης</sup> Ιουνίου 1940, απόφαση η οποία αναδεικνύει σε νόμο (με επευφημίες και όχι με τη βία) ένα διάταγμα του Β. Εμμανουήλ, κατά το οποίο η Αλβανία θα είναι σε πόλεμο με οποιοδήποτε κράτος θα είναι σε πόλεμο και η Ιταλία. (!)

Είναι όμως πολύ δύσκολο ώστε ο εθνικιστικός εγωισμός της Αλβανίας να αποδεχτεί κάτι τέτοιο και σε περίπτωση που η Ελλάδα επιμείνει σθεναρά! Όμως, εξ

ονόματος του εθνικιστικού αυτού εγωισμού, τολμάει να ζητήσει από την Ελλάδα την κατάργηση της ίδιας αλλά μεταγενέστερης απόφασης, μέχρι επιβολής.

Τέλος, κατά εμού το θετικό αποτέλεσμα στην Κρήτη θα πρέπει να αναζητηθεί στο γεγονός ότι επικράτησε η διδαχή της διπλωματίας του διαλόγου με σύμμαχο το χρόνο για μια καλύτερη ημέρα, με την ελπίδα ότι η νοοτροπία του εθνικιστικού εγωισμού του XIX αιώνα θα επιτρέψει να πρωτανεύσει η θετική θέληση για καλή γειτονία στο πνεύμα της ευρωπαϊκής προοπτικής για τους δύο λαούς. ΤΕΛΟΣ !

16.11.2017

Δημοσιεύτηκε την 16<sup>η</sup> Νομβρίου 2017 στις Ιστοσελίδες

<http://www.javanews.al/postkreta-si-verifikim-antialogut-qe-imponon-pseudoegoizmi-nacionalist/>

<https://faxweb.al/post-kreta-si-verifikim-antialogut-qe-imponon-pseudoegoizmi-nacionalist/>

<http://www.gazetama.net/2017/11/16/postkreta-si-verifikim-i-antialogut-qe-imponon-pseudoegoizmi-nacionalist/> ΤΕΜΑ και στην εκδοχή print της ίδιας εφημερίδας

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2017/12/26/shtetesia-shqiptare-e-kryepeshkopit-anastas-dhe-fundi-i-alibise-per-kundervenien-e-jo-ortodokseve-ndaj-ortodoksise/>

<https://www.javanews.al/shtetesia-shqiptare-e-kryepeshkopit-dhe-fundi-alibise/>

<http://time.ikub.al/Lajme/c5bdd63e19d3336f8e951919d2c85414/.aspx>

<https://www.facebook.com/666997616655477/posts/httpwwwjavanewsalshtetesia-shqiptare-e-kryepeshkopit-dhe-fundi-alibise/1683602354994993/>

### **Shtetësia shqiptare e Kryepeshkopit Anastas dhe fundi i alibisë për kundërvënien e jo ortodokseve ndaj ortodoksisë në Shqipëri.**

26.12.2017

Në ditën e madhe për Krishtërimin, Krishtlindjet, të gjitha medjat në Shqipëri kishin si lajm të parë vendimin e Presidentit të Republikës Ilir Meta për dheniën e shtetësisë shqiptare Kryepeshkopit të Kishes Ortodokse të Shqipërisë, fortlumturisë së tij Anastas!

Fillimisht u duk se lajmi meritonte përgëzime pasi ruajti të paktën “asnjanësinë profesionale”, dmth, nuk pati reagime, për më shumë negative. Kjo tërheq vëmendjen, pasi po ndodhte për herë të parë një qëndrim i tillë me adresë Kryepeshkopin Anastas dhe për një “lajm” që ai e priti për 25 vjet. U duk se ishte një zhvillim që e bënte të pavlefshme alibinë e pesë paraardhësve të presidentit Meta që ia mohuan këtë kërkesë të ligjshme Fortlumturisë së tij Anastas për gjithë ciklin e kontributit të tij në favor të KOASH, me preteksin se u trembëshin reagimeve negative të jo ortodokseve. E vërtet është se ky argument i bënte krerët e lartë të shtetit aq rezistentë sa që nuk pranonin as ndërhyrje të faktorëve ndërkombëtarë për këtë çështje, gjë që do të thotë se vendimi ishte ndërgjegje e brendshme e tyre. (Por, nëse Kryepeshkopi është grek dhe kjo përbënte pengësë, atëherë çfarë duhet menduar për ata mijra shqiptarë në Greqi që në respekt të ligjit kanë marrë, ose pritet të marrin nënshtetësinë greke ?!).

Fatkeqësisht, situata “e lajmit profesionist” për vendimin e Metës si hap në frymë evropiane dhe që po shkrinte akujt me Athinën, zgjati vetëm një ditë. Detachmentët e reagimeve negative jashtë ortodoksisë ia bëhen mënjëherë një ditë më pas me një egërsi cfilitese. Madje pati nga ata tribalë që fituan të drejtën për t’i kërkuar llogari Presidentit për arsyet e vendimit të tij!! Duke marrë parasysh aktin e Presidentit Meta si të tillë, (aspektin ligjor, kontributin e Kryepeshkopit në ringritjen nga hiri të KOASH dhe kapacitetin intelektual me spekter botëror të tij të venë në funksion të vendit, anën humane me dimesion kohën e pritjes dhe moshën e vet Kryepeshkopit, por edhe momentin politik në lidhje me marrëdhëniet me Greqinë dhe hapat e Shqipërisë drejt BE-së), këto reagime nuk mund të justifikojnë nivelin intelektual, kulturor dhe profesional të pretenduar të autoreve të tyre. Por, ajo që u vu re është se arsyeja e vërtetë e tyre për këto reagime mbetet e njëjtë. Ajo nuk ka të bëjë aq me figurën e Kryepeshkopit, se sa me atë që ai përfaqëson në Shqipëri, KOASH-in. Kat ë bëjë me mbylljen e çdo dritareje që mund të prodhojë marrëdhënie miqësore me Greqinë. Dhe fatkeqësisht, nuk shpreh thjesht komplekset e së kaluarës së largët, porse në këto komplekse gjejnë terren më të përshtatshme interes e të tretëve dhe zhbirimi i interesave të brendshme politike.

Pikërisht në këtë qasje duhet kërkuar dhe arsyeja se përse nuk pati edhe kësaj here as reagime pozitive, madje as nga elita ortodokse. (Perjashtojmë aktorin e madh Robert Ndrenika, i cili kësaj here nuk fshehu origjinën dhe përkatësinë e tij fetare midis emrit Robert dhe mbiemrit Ndrenika). Ky fakt num mund të lidhet me arsyetimin se është non sens të shprehesh konsiderata të larta, se më në fund u kapercye një refuzim absurd 25-vjecar duke shkelur ligjin shqiptar nga vet presidentët e Republikës. Aq më tepër

kur Kryepeshkopi tregoi se nuk i duhej fare nënshtetësia shqiptare për t'u përkushtuar me përgjegjësinë e një qytetari të devotshëm të këtij vendi, për të ndërmarrë veprën e tij të pamatë në shërbim të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe të shoqërisë shqiptare, apo të përdorte kredibilitetet personale që janë të një niveli ndërkombëtar për të promovuar Shqipërinë në botë, më shumë se çdo figure politike në vend.

Në këto rrethana kuptohet se nënshtetësia shqiptare ishte për Kryepeshkopin Anastas një mjet për të treguar se edhe shteti shqiptar e pranonte Kryepeshkopin si pjesë të vet, ashtu siç e konsideronin ortodokset shqiptarë dhe populli shqiptar, pavarësisht përkatësisë fetare, ose ashtu si vet Kryepeshkopi përjetonte si qëllim sublim përkushtimin ndaj kishës ortodokse të Shqipërisë!

Kuptohet që mungesa e reagimeve pozitive nga besimtarët Ortodoksë dhe elita ortodokse, nuk lidhet aq me mungesën e motiveve për t' u shprehur pozitivisht, se sa me faktin se këta faktorë e kuptojnë se vendimi i presidentit për t'i dhënë nënshtetësinë shqiptare Kryepeshkopit të tyre Anastas, nuk do ta shpetojë ortodoksinë shqiptare nga paragjykimet e njohura të pseudonacionalisteve shqiptarë me përkatësi fetare joortodokse. Për këtë nuk përbën garanci as deklarata e Kryepeshkopit Anastas se pasardhësi i tij në fronin e kreut të KOASH do të jetë me siguri një shqiptar. Një zhvillim i tillë do të krijojë garancinë se atëherë do të bjerë alibia e derisotshme që kësi paragjykimesh dhe qëndrimesh denigruese për ortodoksinë në Shqipëri lidhen me identifikimin e kreut të saj me "pretendimet armiqësore" greke ndaj Shqipërisë. (!!)

Kultivuesit e këtyre tezave të nxjerra nga mjedisi i shekullit XIX, nuk arriten kurre të shikojnë e të vlerësojnë veprën e Kryepeshkopit në krye të KOASH-it, që për nga përmasat konsiderohet totalisht e pamundur për një kohë kaq të shkurtër dhe nga një njeri i vetëm, qoftë ai edhe i perëndishëm dhe të realizuar pa asnjë kacidhe nga buxheti i shtetit shqiptar. Ata e neglizhojnë ose e mohojnë atë, jo për të mohuar figurën e Kryepeshkopit Anastas, por pikërisht për të neutralizuar veprën e tij, që tanimë është identifikuar me këtë Kishë në të gjitha drejtimit. Pra, i tremben kësaj vepre se u vështirëson kundërvënien ndaj Ortodoksisë Shqiptare, kontributi i personaliteteve të secilës, pavarësisht nga motivet, qëndron në themelet dhe në terësinë e konstruktit të shtetit shqiptar. E tregoi më së miri këtë censuri i vitit 2011 ku dhe vet shteti tregoi se i intereson që numri i ortodokseve në Shqipëri të jetë më i pakët se numri që japin analet statistikore të Perandorisë Otomane të fundit të shek XIX, ose përpjekjet e pafundme për të eliminuar trashëgiminë e pasur kulturore të këtij besimi, pasi kjo pasuri ka vulën e kulturës greke, qoftë të drejtpërdrejtë, qoftë si mishërim të perandorive byzantine dhe otomane !!! Ndodh kështu kur dihet se ajo nuk është pasuri kulturore e kryepeshkopit Anastas por e popullit shqiptar, kur dihet se vlerat e vetme aktive me akses perëndimor nga trashëgimia e së kaluarës lidhen me këtë besim dhe kulturën e vet shpirtërore dhe materiale.

Një gjykim i tillë lëjon vlerësimin se akti i presidentit I. Meta nuk u shpeton dozave të ironisë dhe të cinizmit, që evidentohet tek pyetja:-Përse i duhet nënshtetësia Shqiptare Kryepeshkopit Anastas në këto momente dhe kur për shkak të moshës i kërkohet të deklarojë se kush do të jetë pasardhësi i tij!? Apo mos vallë Kryepeshkopi Anastas do të shpresojë se një ditë të së ardhmës do të pohohet se ringritja nga themelet e Kishës Ortodokse Shqiptare është vepër e Kryepeshkopit me shtetësi shqiptare Anastas!?

Sado i vërtetë, ky argument ngjason i paqëndrueshëm po të kemi parasysh nivelin e lartë të institucioneve dhe të personaliteteve të involvuar në këtë çështje. Më i besueshëm duket argumenti që faktorët e këtij niveli e pranuan bashkarisht këtë sfidë ironie, për t'u shërbyer qëllimeve më të larta.



Kjo do të thotë se vendimi i Presidentit Meta i shkon përshtat rolit protagonist në sfidat kalimtare historike që ka përpara vendi, rol që atij i siguron një distancë nga vulgu politik në vend, ku nuk mbëtet pa përmendur edhe emri i tij. U duk kjo qartë në të gjitha qëndrimet e fundit të Presidentit, si ndaj zgjedhjes së Prokurorës së Përgjithshme me mandate të përkohshëm, ashtu dhe përsa i përket votës së qeverisë në OKB për çeshtjen e Jeruzalemit. Në këtë rrjedh shkon edhe vendimi për shtetësinë shqiptare të Kryepeshkopit Anastas, pasi Meta është njohës shumë i mirë i faktorit Greqi në skaqerën e politikës ndërkombëtare dhe rolin e saj gjeostrategjik me rendësi për aleatët perendimorë dhe akti i tij në spektrin human, tejkalon çdo ngerç që prodhojnë bisedimet për zgjidhje paketë të problemeve midis dy vendeve. (!!!)

Në këtë linjë, javët e fundit qëveria ndryshoi totalisht kursin e politikës së saj me Greqinë dhe jo aq thjeshtë për të përmirësuar marrëdhëniet midis dy vendeve, se sa paralelisht me këtë, për t'i hequr nga dora Greqisë të drejtën për mbajtur ose për të inspiruar qëndrime që mund të pengojnë hapjen e negociatave për integrimin e vendit në familjen evropiane. Në këtë prizëm duhen pare edhe dy vendimet e fundit të qeverisë, po në prag të Krishtlindjeve, për problemin 76vjeçar të eshtrave të ushtarëve grekë renë në token shqiptare në betejën e parë fituese ndaj fashizmit në luftën e dytë Botërore, aq i ndjeshëm në Greqi. Mirëpo pala greke, duke u nisur nga fakti se këto hapa të qeverisë shqiptare ngajnë si dy pika uji me situatën e vitit 2009, kur Athina dha çfarë kërkoi Tirana, por Tirana nuk iu përmbajt premtimeve, sidomos përsa i përket çeshtjes së eshtrave të ushtarëve grekë dhe marrëveshjes së detit, ka rezerva besueshmerie shumë të larta ndaj hapave të mirëkuptimint të qeverisë Shqiptare, deri në atë shkallë saqë takimi i pritshëm i Korçës mund të shenojë edhe kthim prapa krahasimisht me atë të Kretës. Aq më tepër që kërkesa e pales shqiptare për riabrogimin e dekretit të gjendjes së luftes gjithnjë e më shumë lidhet me kërkesa të tjera që s'kanë të bëjnë fare më të.

Në këto rrethana lëvizja e Metës me shtetësinë e mohuar Kryepeshkopit Anastas, përbën një lëvizje në një nivel tjetër për të shkuar drejt Athinës, kur dihet se Kryepeshkopi Anastas ishte bërë shpesh ndërmjetësi me rezultativ për të rregulluar marrëdhëniet me Athinën kur ato i minonte politika e ditës. Meta, nga posti i Presidentit të Republikës me vendimin e tij, është e sigurt se mendoj hapin e tij drejt Athinës, si kontribut për Shqipërinë, por edhe për vete. Reagimi pozitiv i niveleve të larta të politikës greke ndaj këtij vendimi e vërteton këtë kongliuzion. Aq më shumë që ai ka një shans tjetër më të rendësishëm, atë të rinovimit të Traktatit të Miqësisë me Greqinë që përbën ekskluzivitet të të dy presidenteve.

FUND

Per gazeten tema 26.12.2017

## **Nga Panajot Barka**

<https://www.javanews.al/sa-vertete-eshte-singeriteti-tiranes-ne-dialogun-athinen/>  
<http://time.ikub.al/18-02-02-Xhufi-Varrezat-greke-te-rrezikshme-Deti-12-miljet-i-njohu-edhe-Enveri/Sa-i-vertete-eshte-singeriteti-i-Tiranes-ne-dialogun-me-Athinen-.aspx>  
<https://perqasje.com/2018/02/sa-sinqerte-eshte-rama-ne-dialogun-athinen-nga-panajot-barka/>

### **Sa i vertet eshte sinqeriteti i Tiranes ne dialogun me Athinen**

02.02.2018

Bisedimet greko-shqiptare, ku palet pranojnë përmirësimin e admirueshëm të marrëdhënieve bilaterale, po shoqërohen ditët e fundit, vëçanërisht në Shqipëri me reagime të shumta dhe të ashpra. Lëximi i kujdesshëm i tyre lëjon të kuptosh se bëhet fjalë për një “shqetësim” bezdisës në disa plane dhe pavarësisht se nga pikëpamja parimore është non sens të kundërshtosh përmirësimin e marrëdhënieve.

Pika e ujit që shkaktoi derdhjen e gotës në këto zhvillime ishte deklarata e Kryeministrit grek A. Cipras pas takimit në Davos me Kryeministrin Rama për përparim të admirueshëm pozitiv në marrëdhëniet greko-shqiptare, duke lene hapur të kuptohet se Greqia nuk do të bëhet pengesë për Shqipërinë në hapjen e negociatave të vendit kandidat në BE. Duke njohur sado pak natyrën e kryeministrit grek, historinë e ballafaqimeve të tij epike me të fortet e BE-së, kupton se entuziazmi i tij me Ramën lidhet me ndërrimin e kursit të Ramës nga kryesues i nacionalizmit antigrek në bashkëbisedues për zgjidhjen e çeshtjeve të tilla si marrëveshja e detit, e cila kishte ngecur për arsye të nënshtrimit të logjikës së interesit të përbashkët tek nacionalizmi i semure, apo për interes të të tremeve !

Në fakt artikulimi nga ta dyja palët për një zgjidhje të marrëveshjes së detit, (qoftë edhe pse i paqartë, ashtu si mbajtja sekret i brendisë së të gjitha bisedimeve), i ka shndëruar dialogun dypalësh në ballafaqim të tensionuar të brendshëm.

Deklarata e Ministrit të Jashtëm Grek se gjeti gjuhën e përbashkët me Tiranën për zgjerimin e vijës së ujrave territoriale të Greqisë në 12 milje, konsiderohet në Shqipëri si një tradhëti më të madhe se ajo e 2009. (!) Në fakt zbatimi praktik i interpretimeve në Shqipëri, nuk mund të ndodh për shka të distancave më të vogla midis brigjeve të të dy vendeve. Ndersa, duket se egziston një konceptim tjetër, për të cilin Tirana hesht dhe Greqia nuk jep shpjegime.

Në qarqe të ndryshme greke kjo konsiderohet si një tërheqje pa takt të qeverisë greke. Argumentohet si marrëveshje e re, e cila do të kënaq pretendimet e Tiranës për “padrejtësitë ndaj saj” në marrëveshjen e 2009, ndërkohë që ajo nuk cenonte interesat shqiptare në asnjë drejtim; se kjo marrëveshje “e re”, mund t’i kalojë Shqipërisë sipërfaqe deti që i takojnë Greqisë; dhe ajo që ka më shumë rëndësi politike dhe kombëtare, thuhet në Greqi, pretendimet shqiptare ngjasojnë si dy pika uji me ato turke në detin Egje dhe një tërheqje e tillë nga pala greke do të krijojë precedentë të rrezikshëm edhe me Turqinë.

Në fakt, nëse pretendimet vërtetohen, kjo më shumë duhet konsideruar si një tërheqje greke për t’i krijuar mundësi Ramës për të shpetuar nga ngërçi që vet ia krijoi vetës me Gjykatën Kushtetuese, për marrëveshjen e 2009ës, pasi pavarësisht vendimit të kësaj Gjykate, i respektueshëm në parim, përmbajtja e tij nuk ka asnjë argument dhe fakt që të mundësojë marrjen e këtij vendimi.

Momenti i dytë që duhet dalluar në realitetin e bisedimeve, është ekspansioni medjatik i vet protagonistëve në bisedime, sidomos nga pala shqiptare, për të bindur publikun për drejtësinë e qëndrimeve të tyre, të cilat mbahen edhe sekret edhe publikohen. Është për të venë re këtu se pala shqiptare i mëshon argumentit të përfitimit

të Shqipërisë nga këto bisedime, duke anashkaluar ose shpërfillur parimin e interesit reciprok.

Elementi tjetër sfidues i këtyre bisedimeve është fakti që përpjekja për përmirësimin e marrëdhënieve midis dy vendeve po shëndërrohet reciprokisht në problem të brendshëm politik ose etnik të çdo vendi. Kjo i ka detyruar palët të bëjnë lëshime njera tjetrës, si fakte për të bindur kundërshtarët se ndryshku po shkundet.

Kjo tregon se ajo që deklarohet për dialog të sinqertë dhe përparim spektakolar në marrëdhëniet midis dy vendeve nuk përbën realitet. Dhe nuk mund të ndodh ndryshe kur dihet se pikënisjet e secilës palë në këtë dialog janë krejt e ndryshme nga njëra-tjetra, pikënisje që në fund të fundit, pavarësisht nga taktikat, derivojnë në strategji të ndryshme dhe të kundërta.

Pala greke u nis nga pozita e superioritetit që i jep statusi i vet në strukturat euroatlandike dhe me synimin që të zgjidh problemet me fqinjët cilatdo qofshin ato. Ajo shpreson se një lëvizje e tillë, së bashku me sinjalet pozitive për daljen nga kriza e stërgjatur ekonomike, do t'i sigurojnë një avantazh rolit të vet në Ballkan. Nga ana tjetër shpreson se me këtë mënyrë do t'i heq nga dora çdo armë fqinjëve, sidomos Shqipërisë, në lidhje me ambicjet dhe retorikën nacionaliste.

Pala shqiptare u nis nga pozita thellësisht nacionaliste, që kishte si frymëzim antihelenizmin, të inspiruar shpesh personalisht nga kryeministri. Kjo përbën për palën shqiptare një piruetë dhe nuk është e vështirë për të kuptuar se lidhet me qëllime afat shkurtëra politike të Tiranës, siç është hapja e negociatave të vendit kandidat për në BE, proces në të cilin edhe Rama e ka provuar se faktori Greqi është i rendësishëm. Në fakt bëhet fjalë për një qëllim strategjik të vendit, por që qeverisë i duhet me urgjencë si një kartë suksesi, të rritjes së kredibilitetit të renë në publik dhe çarmatosjës së opozitës në ashpërsimin e luftës politike. Këtu duhet kërkuar edhe një nga arsyet e ashpërsimit të debatit për rezultatet e bisedimeve dypalëshe.

Në këtë prizëm, Tirana, të paktën në ligjerim medjatik, përpiket nga njëra anë t'i tregojë palës greke se klima e mirëbesimit është e dhenë. Nga ana tjetër t'i mbush mendjen opinionit publik vendas se nuk bën asnjë lëshim apo devijim nga rruga e egocentrizmit nacionalist. Varësia nga kjo mendesi nuk është thjeshtë se e bën më të ndjeshme ndaj presionit të brendshëm. Por i imponojnë mashtrime të tilla që çuan palën greke, të arrijë brenda muajit të mjaltit midis tyre, të përgënjeshtrojë zyrtarisht Tiranën dha ta këshillojë atë të ketë kujdes .(!) (Rasti i pretendimit nga Tirana se pjesë e bisedimeve është edhe problemi çam).

Një qëndrim i tillë abuzues krijon nga ana tjetër një precedent jo pak të rrezikshëm. Vetë Kryeministri, ministri i EPJ, apo dhe faktorë të tjerë pranë tyre, po trumbëtojnë më të madhe se arritje të tilla siç është abrogimi i ligjit të luftës i palës greke, (pavarësisht nga formula që do të zgjidhet, që edhe për palën shqiptare të quhet i abroguar ligji i saj i luftës së qërshorit të 1940), do të çojë në përfitime të mëdha pasurore dhe monetare të qytetarëve shqiptarë që arrijnë në disa dhjetra miliardë dollarë. Po krijohet një situatë tjetër shprese për pasurim të shpejtë dhe të papritur të shqiptarëve, të shoqëruar me një ndjenjë në rritje revanshizmi pa arsye ndaj Greqisë. E thenë ndryshe kjo do të thotë se kur këto shpresa do të shuhen, pasi të jenë konsumuar dhe shumë energji, të ushqehet edhe më shumë nacionalizmi antihelenë.

Në Greqi flitet tashmë hapur se Tirana, për të fituar përkrahjen greke në arritjen e qëllimeve imedjate politike të saj, hapjen e negociatave të vendit kandidat për në BE, bën të njëjta lëshime si qeveria e saj parardhëse para dhe me 2009. Premton, bën ndonjë lëshim të cilin mund ta terheq sapo ta arrijë qëllimin e vet etj. (Flet për këtë fakti i përpjekjes për të minimizuar rendësinë që ka për Greqinë, çeshtja e prehjes së eshtrave të ushtarëve grek renë në luftën italo-greke me 1940-41 në tokën shqiptare) Në këto

kushte Athina tregon se nuk do të lejojë kësaj herë që të sfidohet. Që do të thotë akoma se në vija të përgjithshme përpjekja për të zgjidhur problemet e së kaluarës do të shoqërohet me krijimin e një zinxhiri të ri probemesh dypalëshe, të paralajmeruara qartazi që tani nga autoritetet shqiptare. FUND 31.01.2018

Nga Panajot Barka

<https://lapsi.al/2018/02/22/marreveshja-me-greqine-gabimi-i-detyruar-i-ilir-metes/>

**Marrëveshja me Greqinë/ Gabimi i detyruar i Ilir Metës**

22.02.2018



Realiteti mediatik dhe publik i përplasjes së fundit institucionale midis Presidentit të Republikës dhe Qeverisë (MEPJ), mendoj se përbën rastin më tipik të fshehjes së thelbit të kësaj përplasjeje me qëllim përdorimin e saj në shërbim të politikës së ditës dhe më shumë të mbajtjes gjallë të antihelenizmit, qoftë për të penguar përpjekjet dypalëshe për zgjidhjen e ngërçeve dhe klimën e acaruar (çdo zhvillim pozitiv në këtë drejtim u heq atyre objektin e “betejave nacionaliste”), qoftë për të imponuar “vullnet popullor” edhe në këto zhvillime të fundit shqiptaro- greke, (vullnet aq të dëshirueshëm nga pala shqiptare për ta përdorur si instrument imponimi ndaj palës greke).

Duke qenë se isha i pari që shpreha në publik shqetësimin se pala shqiptare po negocion me Athinën në shkelje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, (që do të thotë se në këto kushte çdo lloj marrëveshjeje e re për detin me Greqinë është lehtësisht e rrezueshme), duke patur një informacion më sferik që lejon edhe vëzhgimin prapa perdës, dua të theksoj që në fillim se ndryshe nga sa konsumohen përditë në lidhje me këtë çështje, problemet nuk janë ato që duken.

Këtu qëndron mësa duket edhe gabimi i detyruar i Metës, për të bërë publik një fakt që në kushte të tjera do të përbënte një procedurë rutinë protokollare. Pra, Meta kërkoi si dëshmitarë “publikun” dhe presionin e tij, jo aq për të mbrojtur kushtetutshmërinë, se sa për të krijuar mundësinë, nga njëra anë për të bërë korrigjime dhe, nga ana tjetër, për të lejuar vëzhgimin më të thellë dhe në interes së pari të Shqipërisë pastaj të të dy vendeve.

Në këtë këndvështrim, nuk do të ndaja mendimin se Ministria për Evropën dhe Punë të Jashtme, bëri më nxitim dhe shkel e shko një kërkesë Presidentit Meta për të marrë autorizimin e plotfuqishmërisë. Aspak! Kjo kërkesë përbën një vijimësi të negociimit të deritanishëm në shkelje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nga ana e qeverisë. Pra dhe kërkesa nga ana e saj, me përmbajtjen e konstatuar, pëbën një dukument në shkelje të kushtetutës dhe ligjshmerisë tjetër përkatëse shqiptare. Aq më tepër në kushtet e ekzistencës së një precedenti, që për nga motivet dhe vendin që zuri në egocentrizmin nationalist shqiptar dhe situatat politike ekzistuese, vështirë se mund të lejohet, të ripërsëritet apo të kapërcehet.

Më këtë logjikë, një autorizim plotfuqishmërie i cënueshëm ligjërish, do të përdorej si një “AS” në mëngë i qeverisë, qoftë për t’iu imponuar palës greke në arritjen e pikësynimeve të palës shqiptare, por më shumë të faktorëve të tretë, qoftë për të mos lejuar të kundërtën.

Kjo do të thotë se Greqia nga ana e vet do të vihej në të njëjtat pozita si me 2009. Do të arrinte, nëse po, një marrëveshje për detin, e cila do të kishte vlerë deri sa Tirana, të shmangte qëndrimin pengues të Athinës për hapjen e negociatave me BE, apo dhe realizimin e kërkesave të tjera të veta ndaj Greqisë dhe pastaj do të rishfaqej Gjykata Kushtetuese me vendim të parathënë për shkak të precedentit të 2010.

Ndryshimi është se në këtë rast, fajtor nuk do të ishte qeveria. Ajo, edhe pse me shumë vonesë, ndryshe nga qeveria Berisha, i kërkoi Presidentit autorizimin për plotfuqishmërinë. Që do të thotë se fajtor do të dilte Presidenti i Republikës, i cili, me argumentin “për të kënaqur Greqinë e keqe dhe kundër Ramës” e dha autorizimin pa e ballafaquar me kushtetutshmërinë. Sot Meta akuzohet për të kundërtën, sikur po pengon qeverinë të arrijë një marrëveshje shumë të dobishme për Shqipërinë. (Në fakt bëhet

fjalë për favorizim të lojrave të qeverisë që në vetvete përbëjnë një precedent të rrezikshëm për marrëdhëniet midis dy vendeve).

Vendimi i Metës për të kërkuar saktësime në tri nivele në kërkesën e qeverisë për autorizim plotfuqishmërie, u interpretua edhe në mediat greke me të njëjtat konotacione si në Tiranë. Që Meta hodhi në erë marrëveshjen e detit që ishte aq pranë. Edhe në Athinë nuk u kuptua se me qëndrimin e vet, Meta i bëri një shërbim të madh mundësisë së arritjes së një marrëveshjeje të qëndrueshme për detin në favor të të dy palëve.

Problemi do të ishte i manaxhueshëm nëse, nga ana tjetër, nuk do të vihej re, me një mënyrë ose në një tjetër, se marrëveshja e detit me Greqinë kërkon, me një impenjim shumë më të padukshëm por të nënvizuar dukshëm nga shumë analistë dhe politikanë në Shqipëri (çuditërisht, zbehtë në Greqi), të krijojë nga pala shqiptare precedentë lehtësisht të referueshëm nga Turqia në raportet e veta kufitare detare me Greqinë. Kjo situatë mund të interpretohet, pse jo, se nëse marrëveshja për kufirin detar në Jon nuk do të krijojë realitete të kësaj natyre, arritja e saj të jetë e diskutueshme deri dhe e pamundur.

Por, a është vetëm ky problem?

Ndryshe nga Greqia, ku qeveria i mban letrat të mbyllura dhe opozita respekton autoritetin e qeverisë duke pritur të shpreh gjykimin e vet në momentin e duhur dhe mediat greke konsumojnë më shumë lajme që prodhohen në Shqipëri; tek ne synimi i çdo marrëveshjeje me Greqinë (në këto bisedime) shpallet nga vetë autoritetet shqiptare, në formë verbale dhe veshur me një retorikë joshese për frymën nacionaliste antihelene (kjo bëhet më shumë me qëllim që nesër ta përdorë këtë qëndrim të opinionit si argument vijeje të kuqe në bisedimet me palën greke).

Në këtë kuadër, një ndjekës i kujdesshëm i daljeve të fundit publike të ministrit Bushati nuk mund të mos vërë re argumentin se në lidhje me marrëveshjen e detit bëhet fjalë për një marrëveshje të re, e cila, përveç të tjerave, do të arrihet duke respektuar vendimin korrespondues të Gjykatës Kushtetuese të prillit 2010.

Çfarë do të thotë kjo me terma të tjera? Që përveç se, pas tërheqjes së Greqisë do të kemi një marrëveshje të re, kjo marrëveshje do të duhet të respektojë pikat e përmbajtjes se vendimit të Gjykatës Kushtetuese, që faktikisht marrin vlerën juridike të ligjit.

Për palën greke kjo me siguri përbën një kafshatë që mbetet në çfarëdo lloj fyti. Së pari, pavarësisht se deri më sot pala greke negocioi me palën shqiptare jashtë kontrollit të opozitës, ajo do ta ketë shumë të vështirë të gjejë instrumentat argumentuese që motivuan ndërmarrjen e inisiativës për anashkalimin e marrëveshjes së 2009, të nënshkruar në nivel qeveritar dhe vetëm pa marrë miratimin e parlamenteve reciproke, duke respektuar kështu vendimin e Gjykatës Kushtetuese Shqiptare.

Aq më e vështirë bëhet situata në rastin konkret për vetë qeverinë greke, të negociojë duke respektuar vijat e kuqe të Gjykatës Kushtetuese shqiptare, të cilat në thelb janë të papranueshme për interesat greke dhe legjislacionin ndërkombëtar. Problemi bëhet akoma më i ndërlikuar dhe i mprehtë, kur përditë e më shumë po dalin në dukje detaje se të gjitha rezultatet e negociatave të palës shqiptare, kalojnë, sipas deklaratave zyrtare të qeverisë, nga filtra të treta, që duhet lexuar nga interesa të palëve të treta që shpesh, brenda dhe jashtë parlamentit shqiptar, në media e kudo, janë identifikuar me interesat e Turqisë në raport me Greqinë.

Ka edhe një moment të fundit. Në Greqi së fundmi shumë analistë kanë filluar të bëjnë bilancin e përfitimeve greke nga marrëveshja me palën shqiptare. Dhe përveç klimës së përmirësuar, nuk gjejnë ndonjë përfitim tjetër. Përkundrazi! Flasin me argumenta se Greqia i jep Shqipërisë gjithçka, madje duke e akuzuar qeverinë greke dhe për problemin çam dhe nuk merr asgjë. Dhe me këtë nuk është se harrojnë fillimin e proceseve për varret e ushtarëve grekë, pasi, këto procese të cilave për momentin u dihet vetëm fillimi,

përbëjnë një detyrim moral e human që rrjedh nga detyrim ligjor ndërkombëtar dhe se bëhet fjalë për ushtarët e fundit të luftës së dytë botërore pa një varr!  
Per gazeten tema 22.02.2018

**Nga Prof. Asoc. Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/author/mbaze/page/829/>

## **Ku po ngecin negociatat për detin me Greqinë dhe pse nuk konfirmohet vizita e Tsipras në Shqipëri?!**

23.03.2018



Presidenti i Republikës, bashkë me dhënien e autorizimit Ministrit për Evropën e Punët e Jashtme, D. Bushatit që legjitimon atë për dhënien e plotfuqishmerisë për grupin negociator për arritjen e marrëveshjes së detit me Greqinë, vuri theksin në nevojën e mënjanimin të protagonizmit nationalist në këtë proces, shoqëruar me idenë për një marrëveshje të drejtë e të ndërshme, mbështetur mbi vijëndarrje të arsyeshme. Kjo referencë sposto dhe vendosmerinë e vet Metës për vijën e kuqe që vendos, sipas tij, vendimi i Gjykatës Kushtetuese i prillit 2010 dhe për parimet kushtetuese. Ndërkohë, mirret në konsideratë se dalëngadalë fitoi të drejtën e qytetarisë në të gjithë ligjerimin zyrtar të vendit në lidhje me këtë çështje.

Por a mjaftojnë këto referenca për të krijuar bindjen se vërtet bëhet fjalë për një klimë të tillë në arritjen e marrëveshjes së detit midis dy vendeve?! Pyetja bëhet më intriguese për faktin se me dashje apo dashje kjo çështje, në “paketat” e të dy vendeve, për të arritur marrëdhënie të mira midis dy vendeve, tregon se përbën gravitetin bazë. Nga ana tjetër, pala shqiptare, nëpërmjet pohimit të egzistencës së filtrave të treta për çdo hap në negociatat e drejtpërdrejta për detin dhe përputhja e vijave të kuqe të saj me aspiratën e krijimit të precedenteve në raportet e Greqisë me të tretë, fqinjstrategjikë të Shqipërisë, risjell në skenë aksiomën historike se interesat e saj janë komplementarë me interesa të të treteve (të fortë) dhe kur ato i kundërvihen një pale tjetër.

Analiza e ftohtë edhe në këtë rast e vërteton këto aksiomë. Nëse nga pala shqiptare vihet re një tërheqje nga protagonizmi nationalist drejt një klime me retorikë të moderuar, kjo lidhet më shumë me faktin se Greqia ka filluar të marrë seriozisht “vijat e kuqe” të palës shqiptare dhe pa shumë vështirësi vë re se bien ndesh me deklaratat për një “marrëveshje të drejtë”, “të ndërshme”, “të arsyeshme”.

Pra, kemi një avancim me perimin e njohur se, në asnjë negociatë nuk shkohet me vija të kuqe. (!) Pikërisht, këtu duhet kërkuar shfaqja së fundmi e një psikologjie negative të lidërshipi shqiptar. Rama më shumë dhe Bushati më pak, deklaruan se marrëveshja mund edhe të mos arrihet. Duhet thenës e kjo psikologji negative nuk lidhet aq me vizitën ende të pankonfirmuar të kryeministrit grek Tsipras për Pashkët ortodokse në Korçë. (Pra, kjo vizitë aq e përfolur mund të mos ndodh. Mund të mos përsëritet ajo që ndodhi me Vuçiq për Krishtlindje). Nuk lidhe as aq me fatin e marrëveshjes së detit.

Më shumë lidhet me frikën e dështimit të klimës së kultivuar dhe që bën fjalë për një fitore historike të politikës së jashtme shqiptare mbo atë greke dhe me peshën e Greqisë në fatin e Shqipërisë për hapjen e negociatave me BE-në këtë fundpraneverë. (Rama në veçanti dhe politika shqiptare në përgjithësi, e di se këtë rol të Greqisë nuk e zvogëlon aspak “suksesi” i kryeministrit “me miqtë e Shqipërisë” në fillim të kësaj jave në kryeqendrën e BE-së, sukses që vet ai e sfumoi në maksimum me turavrapin e mënjehershëm të tij nga Brukseli drejt Erdoganit)



Kjo e bën më të vështirë fshirjen e vrages së thellë nacionaliste që kultivoi vet politika zyrtare e Tiranës në lidhje me këtë çështje, qoftë duke e kthyer atë në kalë të betejës së brendshme politike, qoftë duke shpalosur antihelenizmin (nga pozita revanshiste) si plate krenarie kombëtare për rritje të kredibilitetit popullor të qeverisë.

Në këtë kuptim, tërheqja e Athinës nga marrëveshja e 2009, u trajtua nga Tirana si dobësi dhe si pranim prej palës greke të padrejtësisë së pretenduar në dëm të palës shqiptare. Ndodhi kështu edhe pse Gjykata Kushtetuese e nulizoi atë marrëveshje për shkak të penaliteteve të vet palës shqiptare, (fatkeqësisht pa konfirmuar nga organi i akuzës asnjë fajtor). Ndërkohë, tërheqja e Greqisë nga marrëveshja e 2009 ndodhi kur egzistonin të gjitha instrumentat që Athina mund ta çonte çështjen në arbitrazh ndërkombëtar me fitues qartësisht të paracaktuar.

Pikërisht, kjo tërheqje greke ngazëlloi nacionalizmin apriori antihelen në Shqipëri, i shfaqur kësaj here si revanshizëm. (Ligjerimi i unifikuar, zyrtar e publik, se Greqia u detyrua të tërhiqet falë presionit qeveritar, se marrëveshja e re do të jetë me doemos në favor të Shqipërisë, se deti kësaj here fitohet nga Shqipëria etj, përbënin kredon e këtij lloj nacionalizmi që ngjante si dy pika uji me kohën e E. Hoxhës.

Mirëpo askush nuk po vinte re se zhurma ishte e tillë sa që zgjoi medjat dhe oponencën greke dhe bëri inisiativën e N. Kotzias, të linte mënjatë entuziazmin akademik dhe të ulej në terrenin e diplomacisë pragmatiste. Në fakt, zarët për këto zhvillime u hodhën që në vizitën e qërshorit 2016 të Kotzias në Tiranë. Në këtë vizitë Kotzias, me sinjeritet akademik, pse jo dhe pragmatist, i propozoi palës shqiptare një aksiomë bashkëpunimi grekoshqiptare ku përvoja dhe pesha politike greke në kombinim me vrullin shqiptar të përcaktonin ardhmërinë e Ballkanit.

Por fatkeqësisht, ose fatmirësisht për të, mori si përgjigje predispozicionin shqiptar për kthimin kthimin e kahut të marrëdhënieve shqiptaro-greke nga e shkuara, (një e shkuar që merr peng të ardhmën) ku në krye të kësaj axhende shqiptare u promovua mitingu i stisur i PDIU-së.

Fryma e protagonizmit nationalist, si fitore “historike” e diplomacisë shqiptare mbi atë greke, e cila konsumohej me tepriçë në mjedisin shqiptar, u ushqye edhe nga përbërësit e tjerë të paketës shqiptare përballë paketës greke.

E gjithë kjo klimë po fiton tanimë një natyrë konkrete në asetët dhe procedurat teknike të marrëveshjes për ndarjen e detit. Pala shqiptare shkon në negociata me vija të kuqe të imponuara nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese së 2010. Për t’i bërë ato sa më “të paprekshme” dhe “të detyrueshme” ka risjellë në skenë njerëz që e denoncuan marrëveshjen e 2009-s, (por që çuditërisht deri para pak kohësh kishin heshtur). Logjika thotë se “amplifikimi i asaj marrëveshjeje ndihmon sot në garantimin e paprekshmerisë së vijave të kuqe.

Mirëpo, sipas komenteve të njerëzve pranë Ministrisë të Jashtëm Grek, vijat e kuqe shqiptare, nga njera anë cenojnë rendë interesat e prekshme dhe të panegocueshme greke. Nga ana tjetër tentojnë të krijojnë një precedent, i cili do të hap rrugën për zbatimin e tij edhe në Egje, e që është në favor të interesave të Turqisë. Të njëjta burime theksojnë se përbërësit e vijave të kuqe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese janë propozime direkte të palës turke, ose që përputhen me kërkesat e Ankarasë ndaj Athinës në Detin Egje.

Kjo do të thotë se adoptimi nga ana e Ramës të mendimit për mundësinë e mosarritjes së marrëveshjes së detit me Greqinë, pohon se Tirana njeh tanimë hezitimin dhe rezervat reale të palës greke për perspektivën e negociatave në delimitimin e kufirit detar midis dy vendeve në Detin Jon. Po, ashtu, mungesa e nxitimit të Bushatit për aktin e plotëfuqishmerisë dhe nënkuptimi se fillimi i bisedimeve mund të vonojë, jo ditë, siç

pritej, por dhe javë, tregon se vonesat e Metës për autorizimin për plotfuqishmerinë ishin komplementare të kësaj situatë e klime.

Për situatë të njëjtë flet edhe fakti se tempë në vrullin e deritanishëm të bisedimeve dypaleshe për të gjithë gamën e problemeve ka renë, ose është përqëndruar kryesisht në probleme dytësore, apo të ditës. Dhe kjo kuptohet, nuk ka të bëjë fare me faktin se Greqia ka të hapura mjaft probleme të tjera.

Ndërkohë Tirana, në aspektin e komunikimit medjatik, përpiqet ta mbajë gjallë situatën duke i venë përballë mungesës së zhvillimeve të dëshiruara qëndrime antipode. D,m,th, herë duke lëshuar sinjale për riashpërsim të gjuhës ndaj Greqisë, herë duke lidhur gjithçka me vizitën e mundshme të Tsipras në Korçë pas gati dy javësh. Për sa i përket kahut të dytë, është fakt se lajmi aq shumë i anonçuar nga medjat tona për këtë vizitë, duke caktuar madje dhe datë e orë dhe menu të ngrenash, ky lajm pra nuk konfirmohet nga Athina. Por, as qeveritarët tanë e konfirmojnë atë. Dhe në fakt, po të nisemi nga misioni i vizitave të këtij niveli, vizita e Tsipras nuk ka kuptim, se në marrëdhëniet dypalëshe dialogu i deritanishëm nuk solli përparime që kryeministrat të konfirmojnë kodifikimin e tyre me nënshkrim marrëveshjes.

## **Nga Panajot Barka.**

<https://360grade.al/137292/analiza-kriza-turke-kriza-lindore-dhe-isemuri-i-bosforit/>  
<https://hashtag.al/index.php/2018/08/31/ndikimi-i-turqise-ne-ceshtjen-e-kufijve-dhe-rol-i-shqiperise/?fbclid=IwAR1Ab3EtP2r-TawoQ542Z-uJmNubfIBGZEroJ86HYgkYt5YZPGEJdSU1YZg>  
[https://www.facebook.com/permalink.php?id=369677120125365&story\\_fbid=519434348482974](https://www.facebook.com/permalink.php?id=369677120125365&story_fbid=519434348482974)

<https://lapsi.al/2018/09/01/si-ndikon-kriza-turke-ne-ballkan-ddhe-shqiperi/>

### **Kriza turke dhe rishfaqja e njëkohshme në Evropë të “Krizës Lindore” dhe të “Semurit te Bosforit”**

31.08.2018

Vendosmeria i Erdoganit për të ushqyer optimizmin se përshkallëzimi i krizës turke nuk do ta gjunjëzohë atë, nuk lidhet aq me referencat nacionaliste të brendshme në ligjerimin politik të Presidentit turk, se sa me taktikat e tij për ta eksportuar krizën, sidomos drejt Ballkanit dhe Evropës JL. Dallohen tre nivele kryesore.

Së pari. Kërcenimet dhe retorika luftarake ndaj Greqisë, anëtare e NATO-s dhe e BE-së. Konfliktualiteti turk fitoi një dimesion tjetër në pengësat në Mesdhe ndaj shoqërive shumëkombëshe nga më të fuqishme në botë në kërkimet e tyre për hidrokarbure. Me këtë sjellje Ankaraja dukej se kërkonte të baraspeshonte kërcenimet për cenimet e integritetit të vet territorial, sidomos nga ana e kufirit të luftës. Ndërkohë që kjo retorikë shkonte paralelisht me investimet shumëplanëshe të saj në vende të ndryshme të Ballkanit në funksion të idesë së neotomanizmit.

Së dyti. Kërcenimi i Evropës me eksportimin e numrit të madhë të refugjatëve dhe emigrantëve nga vendet ndërluftuese në kufinj të saj. Ky realitet nuk ka nëvojë për komente, pasi përbën prekshëm një minë njerëzore destabilizuese për vetë Evropën.

Së treti dhe ndoshta më i rëndësishëm. Turqia po shndërrohet në një pol, sidomos në Evropën JL, nëpërmjet të cilit demonstrohen se fundi interesat e kundërta, apo dhe të ndryshme midis fuqive vendimarrëse në botë, si SHBA, BE, Rusi, Angli. Këtë rol po ia afirmon Turqisë përplasja e saj me SHBA-në.

Analiza më e thjeshtë tregon se kemi një riciklim, kuptohet në kushte të tjera të të njëjtit realitet të fillimit të shekullit XIX, i njohur ndryshe në Kongresin e Veronës 1822 si Kriza Lindore. Për më shumë se gjysëm shekulli fuqitë e mëdha evropiane të kohës, Austrohungaria, Franca, Anglia dhe Rusia shmangnin përplasjen e interesave të tyre në lidhje me territorët evropiane të P. Otomane, në Mesdhe dhe Detin e zi, duke respektuar “integritetin territorial” të saj. Po ashtu në emër të këtyre interesave, ato u kundërviheshin përpjekjeve të popujve për çlirim nga zgjedha Otomane. (Spikatin qëndrimet e Ruisë, e cila për qëllimet e veta perandorake nxiste popujt me besim të homogjen në luftë kundër P. Otomane dhe sapo realizonte qëllimet e veta i braktiste në hakmarrjen e egër të sulltaneve. - rast i përsëritur ai i popullin grek madje edhe gjatë vendimit të tij për nisjen e revolucionit me 1821.

Nga ana tjetër, Fuqitë e Mëdha arrinin marrëveshje të njëanshme me Portën e Lartë, për të penguar ambicjet territoriale të ndonjëres prej tyre në kurriz të P. Otomane, ose hynin në luftë midis tyre për të garantuar status quo-n e P. Turke në pjesën e saj evropiane. Rastin më ekstrem përbën ndërhyrja angleze, në shkurt të 1878, për të penguar ushtritë ruse të pushtonin Konstandinopojën. Kur P. Otomane u bë i “semuri i Bosforit” Fuqitë e Mëdha nxitën shpërbërjen finale të P.Otomane dhe me flamur krishterimin skicuan hartën e shtëteve kombe sipas interesave të tyre, hartë që do ta ndryshonin sa herë që raportet dhe interesat midis tyre ndryshonin, por veç me luftë dhe shkatërrime të përmasave botërore.

Turqia, në vitet e ndryshimit të sisteve politike në Evropën JL, vitet 90' të shekullit të kaluar, tregoi se posedonte dhe ushtronte një strategji dhe taktikë perandorake. Që në këtë periudhë filloi të zgjojë, të rigjenorjë dhe bashkojë, në bazë të homogjenitetit fetar mysliman, segmentet e shthurura të ish Perandorisë Otomane, trashëgimtare e së cilës Turqia është. Këto segmente me shtrirje gati në të gjitha vendet e Evropës JL, i shërbyen në vijim strukturës së ideologjisë neotomane të Ankarasë me presidentin Erndogan të shpallë me 2015 bregdetin shqiptar të Adriatikut si skajin perendimor të perandorisë Neotomane. Njëkohësisht arriti të ruaj epersinë e dukshme ndaj faktorëve të tjerë të botës islame që treguan interes dhe investuan po këtu.

Burokracia evropiane e pushtuar nge euforizmi i globalizmit me bazë multikulturën dhe multireligjonizmin nuk tregoi ndonjë shqetësim ndaj këtyre zhvillimeve.

Sot, pavarësisht se nuk tregohen kuptohen qartazi arsyet e përplasjes së Shtëpisë së Bardhë me aletaten e kahërshme, Turqinë. Njëkohësisht në sfidat Erdogan ndaj SHBA duhet llogaritur prapavija e marrëdhënieve të tij me Moskën. Kuptohet, që për kthesen e madhe nga “armiq” në “miq”, Putin-Erdogan, nuk shërbeu sfida turke në rrezimin e avionit luftarak rus. Ajo, përbën një rast klasik i përsëritjes së historisë së marrëdhënieve të tyre. Brenda një shekulli zhvilluan dhjetë luftra epike dhe arriten po aq marrëveshje paqeje. Gjithëçka për të ruajtur dhe zgjeruar interesat e atëhershme perandorake ndaj të tremeve. Në kendveshtrimin e ri duhet venë re hapësira që Putin i krijoi Erdoganit në Beograd, ku ky i fundit nëpërmjet investimeve të premtuara shpreson në unifikimin e gjeografisë së ndikimit shumëplanesh në Ballkan nga Bullgaria në Bosnjë.

Me pikë referimi Turqinë, nisen së fundi të shfaqen dhe përplasjet apo diferencimet e heshtura, midis BE-së apo vendeve të fuqishme të saj nga njera anë dhe SHBA-ve nga ana tjetër, të cilat nuk janë thjeshtë të karakterit ekonomik, por edhe të aspektit gjeopolitik dhe ushtarak. Kohët e fundit presidenti Tramp p.sh i bëri më të dukshme pretendimet amerikane në fushën ekonomike dhe tregtare ndaj BE-së, duke provokuar veçanërisht Gjermaninë, ndërsa së fundmi, presidenti francez Makron i propozon Evropës së bashkuar një strategji sigurie autonome (me kuptimin që të mos mbështetet vetëm te SHBA). Njëkohësisht kërkoi një bashkëpunim strategjik me Rusinë, që flet për hapjen e parë evropiane që para fillimit të luftës së ftohtë.

Shtetet evropiane, të cilat nuk mund të injorojnë faktin se një Turqi e destabilizuar përbën rrezik për Evropën, apo rolin e Turqisë në problemin e refugjatëve, apo realitetin se në Turqi dhe nëpërmjet saj zhvillohen interesa ekonomike të rëndësishme të tyre, kërkojnë të ndihmojnë Turqinë për të kapërcyer krizën e vet të përkeqësuar kohët e fundit nga qëndrimi amerikan. E para u shpreh pro kësaj ndihme supërfuqia ekonomike evropiane, Gjermania, e cila herë pas herë u ndie e bezdisur nga qëndrimet amerikane. (Ministri gjerman i ekonomisë viziton në shtator Ankaranë) Në këtë kontekst vjen dhe zbutja e marrëdhënieve të Turqisë me Greqinë që u duk veçanërisht me lirimin e papritur të dy ushtarakeve grekë të arrestuar në kushte misterioze e të mbajtur në burgjet turke pa asnjë akuzë për muaj me radhë.

Problemi fiton një dimension më të mbrehtë në rastin e kërkesës “për rregullimin paqësor” të kufirit midis Kosovës dhe Serbisë, e trajtuar shpesh si një çështje lokale midis tyre. Terminologjia e përdorur përbën në esencë një indikator gjumëndjellës në përvojën e hidhur të Evropës së ndryshimi i kufijve kërkon gjak, dmth luftë, kur dihet se pasojat e këtyre luftrave historikisht i kanë paguar shumë shtrentjë popujt e Evropës. Ndërkohë, kur bëhet fjalë për Ballkanin, përveç faktit se historia ka mesazhet e veta të hidhura presupozon një reaksion zinjirë, shumë të ndërlikuar dhe të rrezikshëm, të cilën fuqitë evropiane njohin mirë pasi vetë e gatuan për herë të fundit para 70 vjetëve.

Pavarësisht kumteve në deklaratimet e Thaçit në Kosovë se vendimi diku është marrë, Evropa tregon vendosmeri kundër këtij hapi. SHBA tregon me qëndrimet e veta se është pro këtij procesi. Kërkesa e Thaçit për ta shtruar zyrtarisht çështjen në instancat e BE-së dhe për pjesëmarrjen e SHBA-ve në bisedimet e tij me Vuçiç me ndërmjetësinë e BE-së, vërteton më së miri qëndrimin e paleve për këtë problem. Nga ana tjetër në heshtjen e Ruisë duhet lëxuar pritja për krijimin e një precedenti të ri që do të justifikonte pretendimet e veta për ndryshim kufijsh në teritore të interesit rus. Ndërsa në heshtjen e Turqisë duhet parë endrra për krijimin e teritoreve të pastra të ndikimit të vet sipas dogmës së neotomanizmit. Pra kemi rishfaqjen bashkë të të Sëmurit të Bosforit në Krizën Lindore. Që do të thotë se Turqia, aq sa mund të përfitojë nga nëvoja e fuqive të mëdha për të shmangur nëpërmjet rolit të saj përplasjen e hapur të interesave të tyre (sipas logjikës së Krizës Lindore) aq mund të paguajë haraçin e ambicjeve të veta të ideve neotomaniste, sipas ndëshkimit të të Sëmurit të Bosforit.

Në këto zhvillime Shqipëria si shtet dhe faktori shqiptar në përgjithësi fitojnë një peshë specifike me rëndësi. Por ky rol, në kushtet e një ekulibri shumë të veshtirë, mund të shndërrohet në thikë me shumë presa. Tirana, duke lëjuar pa arsye të qenësishme një numër xhamish që tejkalojnë shumicën e periudhës Otomane, i dha Shqipërisë, në pamjen nga lart, identitetin e një vendi islamik. Bashkë me ndikimin e gjithanshëm turk në vend importoi dhe kontradiktat e brendshme të Turqisë dhe ndikimin tjetër arab, ndërsa në nivele të ndryshme, shpesh të rëndësishme, shfaqen dhe ndikime të tjera, duke përfshirë dhe ato ruse. Ndërkohë, ka shpallur partner strategjik SHBA, të cileve, përse i përket fatit historik të shqiptarëve u ka dhënë vend prioritar absolut. Njëkohësisht ka shpallur si prioritet parësor integrimin e vendit në BE.

Kuptohet lehtësisht veshtirësia, në kufijtë e së pamundurës të Shqipërisë për të manaxhuar në favor të një roli gjeopolitik me sens perendimor këto interesa aq pak konverguese. Aq me shumë kur megalidhea e qarqeve të saj nacionaliste ripërterrihet e përputhur me zotërime shqiptare në ish territorët e pushtuara nga P. Otomane dhe për pasojë sipas formatit të dogmës neotomane.

Nga P. Barka 31.8.2018 Për gazetën TEMA.

## **Nga Prof. asoc. Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2018/10/22/fondet-e-fshehta-te-huaja-ne-shqiperi-dhe-retorika-anti-greke-e-bertitngrenesve-te-tyre/>

<https://lapsi.al/2018/10/23/e-verteta-e-fondeve-te-fshehta-greke-ne-shqiperi/>

### **Fontet e fshehta të huaja në Shqipëri dhe retorika antigreke e bërtitngrenësve të tyre.**

22.10.2018

“Skandali” i financimit të medjave dhe gazetarëve shqiptarë, apo dhe të kishës ortodokse nga fondet e fshehta të Ministrisë së Jashtme greke, në rastin më të mirë përbën treguesin e qartë se në Shqipëri interesimi për patur me Greqinë një realitet marrëdhëniesh të acaruar është sfidues.

Së pari për “skandali” përbën lajm fakti i publikimit. Pra përbën një realitet të njohur që nga lashtësia në marrëdhënje dypaleshe dhe shumëpaleshe. Në këtë kuptim edhe në Shqipëri, ashtu si në Greqi, Itali, Turqi, akoma dhe në SHBA, Rusi, Kinë etj derdhen para të kësaj natyre nga vende apo institucione të tjera të huaja që duan të përmirësojnë apo të risin ndikimin e tyre me forma nga më rezultative për ta. Kuptohet që një nga kanalet më të preferuara e zenë medjat. Ky rrealitet dhe ky qëllim nënkupton dhe paratë e shumta që rrjedhin nga Shqipëria, drejt Greqisë e që me kalimin e kohës janë më të prekshme (sidomos në sektorë më të qenësishëm se medjat).

Së dyti, çuditërisht parët e ardhura nga Greqia “nga fondet e fshehta të Ministrisë së Jashtme greke” (institucion zyrtar shtetëror) u ngjajnë arrave që bëjnë zhurmë në enën e bakërt që ushqen ndjenjën e nacionalizmin në formën antihelenizmit në Shqipëri. Ndërsa po e njëjta formë parash që vijnë në Shqipëri nga Turqia, vendet arabe, Italia, SHBA etj u ngjajnë fiqve, që nuk bëjnë zhurmë. Nuk bëjnë zhurmë dhe as provokojnë thirrje patriotike apo për rreziqe permanente për integritetin e shqiptarëve paratë që vijnë nga organizata terroriste, ato që financojnë ekstremizmin fetar, armiqësinë me fqinjët etj. Në Shqipëri përbën sekret publik financimi i medjave të njohura në vend, i politikaneve, i ministrave, i universiteteve private, i sekteve fetare nga shtete të ndryshme apo dhe nga organizata të dyshimta dhe ato gëzojnë paprekshmeri absolute dhe respekt maksimal. Dëgjojen prej tyre teza dhe thirrje që venë në dyshim fontamentin e historisë së popullit shqiptar dhe po këto klane bërtitngrenës i kanë kardhashë e vellamër!

Së treti, zhurma nacionaliste në Shqipëri për financimet greke të kësaj forme, nuk duhet lidhur me publikimin e këtij fakti, pasi në një menyre apo një tjetër përbën, thamë, fenomen të njohur. Publikimi në përgjithësi (pa emra konkrete) i këtyre financimeve ishte pasojë e demokracisë pa kufi që manifestohet shpesh në Greqi, e cila kurse si nuk mund të justifikojë luftën dhe përplasjet e brendshme në qeverinë greke. Fakti që u publikuan financimet që lidhen me dy fronte të angazhimeve më të mëdha personale të ish ministrit të Jashtëm (Shqipërisë dhe ish R J të Maqedonisë) të konsideruara për të të suksesshme, e vërteton këtë kongluzion.

Nga ana e vet zhurma patriotike në Shqipëri mirret kryesisht me faktin e publikimit në Greqi të këtyre të dhenave dhe jo me kërkesën për emrat apo subjektet kongrete përfutuese në Shqipëri dhe si u përdorën ato. (Ashtu si në Greqi nuk bëhet fjalë se sa justifikuan qëllimin për të cilin u dhanë këto para, por mirren me faktin që pse u dhanë). Askund dhe prej askujt në Shqipëri nuk thuhet qoftë edhe një gjysëm fakt se si këto financime greke dëmtojnë interesat e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar! (Ndërkohë që ka me dhjetra fakte të tjera se si interesat e të tretëve e kanë marrë shpesh peng fatin e popullit shqiptar.)

Pra, megjulla përbën mundësinë më të mirë për një zhurmë patriotike sipas efektit të iluzionit optik dhe jo reralitetit konkret. Vetpërmbytjen për të mos kërkuar apo publikuar emra konkrete, kuptohet, lidhet me faktin se një gjë e tillë do të shkaktonte një reaksion zinxhirë pa kufi akuzash e kunderakuzash nga ku do të rezultonin fole të shumta të bëra pis nga financime të fshehta të vendeve dhe organizatave të ndryshme. Pavarësisht se pati nga ata që për të mbuluar vetën si konsumatorë të mëdhenj të fondeve të tilla veprojnë sipas fjalës së urtë që hajduti bërtet kapeni hajdutin

Së katërti. Mjegulla për të cilin flasim ka edhe një qëllim tjetër më të rrezikshëm. Duke u nisur nga imazhi i krijuar në Shqipëri lidhur me fonde të fshehta, para të pista, para që ushqejnë krimin etj dhe roli apo qëllimi i tyre, bërtitngrenësit e tyre duan të justifikojnë ose t'i japin “një argument të fortë” nacionalizmit të tyre të identifikuar si antihelenizëm. Ata kërkojnë të abuzojnë me paqartësinë e opinionit publik shqiptar, ose të intokrinuar nga sistemi komunist, për të indentifikuar tani shtetin grek (dhe jo sillogjet apo organizatat ekstremiste) me idetë aneksioniste ndaj Shqipërisë sipas modelit hoxhist.

Së pesti. Bërtingrenësit e financimeve të fshehta të huaja ngatërrojnë qëllimisht destinacionin e këtyre financimeve greke me ato të burimeve të tjera. Siç pohojnë dhe vet kundërshtuesit e financimeve “të fshehta” greke, qëllimi i tyre është përmirësimi i imazhit të Greqisë në Shqipëri. Kjo, aq sa është e vërtetë, aq është dhe e pranueshme dhe e ndërshme. Ky pohim zbulon nga ana tjetër faktin se dikush po financon struktura të ndryshme në Shqipëri për të prishur imazhin e Greqisë këtu. Të tretë paguajnë si për të forcuar praninë e tyre të paqenë në Shqipëri, ashtu dhe për të menjanuar dhe shkëputur marrëdhëniet diakronike kulturore midis dy popujve, shqiptarë dhe grekë. (Kush po e varferon dhe i prish identitetin monumenenteve kulturore në jug të vendit?) Paguajnë për mosarritje marrëdhënesh të interesit strategjikë midis dy vendeve, (flet qartë lufta epike e politizimit nationalist për marrëveshjen e detit). Paguajnë që të mbahet në këmbë një histori e shtrembëruar midis dy popujve. Paguajnë që të pengojnë integrimin e emigranteve shqiptarë në shoqërinë greke, paguajnë që të mbahen në këmbë histori nacionaliste të paqena....!

Në këtë ngatërresë të qëllimshme bërtingrenësit e financimeve të fshehta nuk arrijnë të venë re (nuk i lenë, ndoshta se janë pjesë e tyre) përmasat e financimeve të “fshehta” të tjerëve në krahasim me ato greke. Janë si bualli me milingonën. Dhe këtu qëndron paradoksi tjetër. Frika e buallit!!

Së gjashti. Mendoj se një e drejtë që u takon kritikuesve në Greqi të përdorimit të fondeve të fshehta të Ministrisë së Puneve të Jashtme të Greqisë, është fakti i efektivitetit të tyre në Shqipëri. Ka abuzim dhe korrupsion, apo frikë dhe ngurim përballë antihelenizmit ekstrem në medja dhe opinion publik të kultivuar nga bërtitngrenësit e fondeve nga kanale të fshehta?!

Është një fakt që flet shumë. Imazhi i Greqisë dhe i helemnizmit në sistemin medjatik, bibliografik dhe të rjetëve sociale, në mos është me shpatulla prej muri, është i mënjanuar, ndërkohë që ka një imazh tjetër, atë që ngrenë përditë kondaktet dhe marrëdhëniet e sotme njerëzore dhe historia midis dy popujve.

Çfarë do të ndodhte nëse shtohet dhe në këto struktura kondaktet në muzikë, në arte, në letërsi, midis dy popujve. Përse nuk përkrahen iniciatorët në këtë drejtim nga të dy anët? Çfarë do të ndodhte nëse do të kishim më shumë informacion pozitiv nga Greqia në të cilën banon një e treta e popullsisë aktive të Shqipërisë? A nuk do të ishte kjo një mundësi për integrimin e tyre më të mirë në shoqërinë greke dhe një mundësi me shumë për të ruajtur identitetin e tyre atje?

Nëse pranohet p.sh akuza se kisha ortodokse shqiptare financohet edhe nga Greqia, a nuk duhet duhet falenderuar populli grek se kontribuon për ngritjen e të gjithë infrastrukturës së kësaj kishe që nga themelet, si kishë e re ortodokse shqiptare, ndërkohë që trashëgimia fetare ortodoksenë vend që mban vulën greke lëjohet të shkatërrohet?

Përse nuk mbahet i njëjti qëndrim armiqësor edhe ndaj investimit të Ankarasë për xhaminë më të madhe në Ballkan në qendër të Tiranës, apo për qindra xhami të tjera anëkand vendit, apo për investimet e Vatikanit për kishën katolike?!

22.10.2018 FUND



## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2018/11/13/vrasja-e-k-kacifes-dhe-domethenia-e-ratheve-te-frikes-ne-minoritetin-etnik-grek/>

<https://blog.alpenews.al/panajot-braka-vrasja-e-k-kacifes-dhe-domethenia-e-ratheve-te-frikes-ne-minoritetin-etnik-grek/>

<http://time.ikub.al/Lajme/18-11-13-Vrasja-e-Kacifes-dhe-domethenia-e-ratheve-te-frikes-ne-minoritetin-etnik-grek.aspx>

<http://fax.al/news/18373588/vrasja-e-k-kacifes-dhe-domethenia-e-ratheve-te-frikes-ne-minoritetin-etnik-grek>

### **Vrasja e K. Kaçifës dhe domëthënia e rrateve të frikës në Minoritetin Etnik Grek**

13.11.2018

Fillimisht, falenderoj medja në Shqipëri që mirepresin shkrimet e mia. Vlerësoj qëndrimin e tyre si kontribut civilizues nëpërmjet mendimit ndryshe dhe si mundësi për ruajtjen e komunikimit ekuilibruar.

Së dyti, dua të distancohem nga ekstremizmi që cenon interesat që na bashkojnë, ashtu si edhe nga qëndrimet që shtrembërojnë të vërtetën në emër të nacionalizmit të rremë.

Së treti, Shpërthimi i furtunës së fundit në marrëdhëniet Shqipëri-Greqi kanë si pikënisje, në dukje, dy anë të kundërta të ditës së fundit të jetës së Kostandinos Kaçifës. E para, është akti i denueshëm i përdorimit prej tij të armës dhe e dyta vrasja e tij prej shtetit në kapërxim të ligjit (faktet tona këtë tregojnë), dhe për më tepër pa marrë parasysh provokimin e sensibiliteteve etnike deri në shpalljen e tij hero.

Së katërti, ndërhyrja ime në lidhje me këtë ngjarje synon një analizë më të gjerë, duke venë në qëndër të vemendjes frikën e shtuar që kaplon minoritetin etnik grek këto ditë, në raport me historinë, me realitetin dhe perspektivën e tij.

Ky minoritet përballet aktualisht nga njera anë me fashën solide dhe denuesë deri në kërcënim të opinionit publik shqiptar me element të dukshëm nacionalizmin antihelen. Në anën tjetër ndodhet nacionalizmi helen i provokuar nga vrasja i 35 vjeçarit Kaçifas, nënshtetas shqiptar e grek me kombësi greke. (Vrasja ndodhi në ditën e festës kombëtare të Greqisë, në fshatin e tij, në të cilin po hidhej hapi i parë serioz në raport me të renët grekë të luftës ndaj pushtuesve fashistë në 1940-41.)

Provokimi u shtua nga politika zyrtare në Shqipëri e cila në përpjekje për të veçuar Kaçifën nga pjesa tjetër e minoritetit shpejtoi për ta karakterizuar atë terrorist dhe të fantaksur dhe përkrahësit e tij me cilesime ekstreme dhe vulgare. U ushqye nga medja të caktuara shqiptare që në menyrë të papërgjegjshme, por më shumë të qëllimshme, emetonin lajme që i shkonin përshtat nxitjes së nacionalizmit grek.

Ardhja për varrimin e K. Kaçifës, shpallësja e qëndrimeve të tyre dhe ikja brenda ditës në Greqi, e bënë frikën e anëtarëve të komunitetit të etnisë greke në Shqipëri, më të frikshme. Nga njera anë se kontribuan në amplifikimin e retorikës nacionaliste antihelene të palës shqiptare. Nga ana tjetër, largimin e tyre po atë ditë dhe me peripecitë e njohuara, rriten ndjesinë e të qenurit peng të frikës tek bashkëkombësit të tyre banorë në territorin e shtetit shqiptar.

Këtë ndjesi e shton përpjekja e shtetit shqiptar për të marrë “në mbrojtje” minoritarët grekë në Shqipëri nga “ekstremistët” grekë të Greqisë, retorikë që të kujton periudhën e diktaturës komuniste.

Po e ndihmon edhe pala greke, e cila në përpjekjen e saj për të patur marrëdhënie të mira me Tiranën, harron dhe anashkalon realitetin e minoritetit të vet në Shqipëri.

Ndikojnë përvojat e hidhura të 1990, 93, 94-95, 97, 98-99, 2003 etj të cilat fituan një amblikim të dukshëm, pasi edhe në këtë vrasje u ricikluan episode të ngjashme.

Një argument shtesë në spektrin e gjerë të frikës, përbën fakti se kësaj here i është venë më shumë syri dëmtimit të marrëdhënieve midis popujve, shtetlëve dhe krijimit të terrenit për një zinxhir hakmarrës, pjesë e të cilit mund të jetë kushdo prej nesh.

Por më shumë ndikon ndërjegjësimi i pjesëtarëve të komunitetit të etnisë greke se shpërrthimet nacionaliste në formë mjegulle, kanë si themel mungesën e vullnetit për të thenë e zbulluar të vërtetën mbi ngjarjen, dhe krijimin në mënyrë artificiale dhe të qëllimshme të episodeve të përditshme të rënda, që të kujtojnë madje tragjeditë e lashta greke, siç ishte rasti i mbajtjes pa arsye bindese të trupit të Kaçifës për 12 ditë rresht.

Një rreth tjetër frike përbën vet ngjarja. Ditët që pasuan 28 tetorit krijuan gjithë mundësinë për të kuptuar se ngjarja ishte e parathënë. Ndoshta, nuk ishte parashikuar fundi tragjik i Kaçifës, - ashtu si me 1994 në Peshkopi. Është e vërtetë se nuk ka përgjigje për arsyet që e shtynë Kaçifën për të kryer aktin e denueshëm të përdorimit të armës, (madje dhe në drejtim të policisë, pavarësisht se nuk donte të vriste kend) në ditën e festës kombëtare të Greqisë, kontribues për të cilën ishte dhe vet ai. Por, ka një përgjigje që vjen nga rrethi i tij pjesë e të cilit abuzonte me ndjenjat dhe sinjeritetin e karakterit të tij. Nga njera duke e shtyrë dashurinë e tij për vendin dhe kombin e vet tej kufijve të normalës dhe nga ana tjetër duke e tradhëtuar si ekstremist.

Por dhe vet dinamika e ngjarjeve të asaj të dieleje shtrojnë pyetje gozhduese. Pse u vra 35 vjeçari? A u ezauruan dispozitat e ligjit për përdorimin e armës, dmth a u ezauruan të gjitha mundësitë për t'i shpetuar jetën Kaçifës? Mos vallë në gjyq ai do të fliste për gjera që nuk duhen mësuar kurrë? Nëse nuk është kështu, ku ndohet telefoni i tij, dëshmitari i fundit që mund të na tregojë shumë gjera? Trajektorja e dy plumbave që i morën jetën 35 vjeçarit tregojnë se ai u vra në këmbë. Distanca nga u qëllua, sipas një profesori mjekoligjor duhet të ishte rreth 15 metra. Persona që e panë të vdekur, thanë (pa dashje) se 35 vjeçari kishte renë me duar të hapura (!) Perse, ndryshe nga rregulli, nuk posedohet videoja për dinamikën e ngjarjes? Përse vrasja ndodhi, sapo ceremoniali ndërshtetëror për varrëzat e ushtarëve grekë kishte mbaruar? Mos vallë është vepruar me logjikën e gazetarit të njohur për investigimet e tij, se u vra për të përcjellë mesazhin se ky vend ka zot, dhe për këtë lë të qajnë nënat e tyre? Perse u hap kaq shumë loja me spiunë të shërbimeve sekrete këto ditë në minoritetin etnik grek?

Të gjitha këto pyetje dhe dyshime në subkoshienecën dhe koshiencën kolektive të minoritetit grek gjejnë përgjigje në imazhin e vrasjeve të bashkëkombasëve të tyre nga sistemi komunist për shkak të dashurisë së tyre për kombin am.

Një rreth tjetër frike përbën presioni shqiptar mbi minoritetin grek për të mohuar identitetin etnik, të drejtat dhe historinë e tij, duke përdorur si mjet paternalizmin nga njera anë dhe tejkallimin e masës, qoftë edhe në kufi të patolerueshme, për të drejta që minoritetit i takojnë nga ana tjetër. Rasti Kaçifa përbën shëmbullin më të ri dhe më tipik.

Ai kishte një armë por nuk e përdori për të vrarë njeri. Dontë shumë vendlindjen e vet, ndaj la Greqinë dhe erdhi për të jetuar në të, dontë identitetin e vet etnik dhe e shprehte këtë me shpalosjen e flamurit (ndoshta duke tejkalluar masën e së drejtës të njohur me ligj). Çdo gjë në territorin gjeografik të fshatit të vet. Çdo gjë si veprime individuale. Asgjë në dëm të shtetit shqiptar. Por u vra për t'u shpallur ekstremist, terrorist, iredentist nga njera anë dhe hero nga ana tjetër!

Lë të zhveshim sado pak patosin grek në ditën e varrimit të K. Kaçifës. Të parin gjë që do të shohim është se, ndërsa kishte prani greke me tepicë, por nuk kishte asgjë antishqiptare. (Madje çdo përpjekje e tillë ndalohej dhe denohej nga vet të pranishmit)

Tepria greke konsistonte në dy elementë bazë që në fakt nulizojnë çdo karakterizim për irredentizëm grek. Së pari u demonstruan standarte të dëgjuara në çdo miting me përmbajtje kombëtare greke, apo për çdo person që humb pa të drejtë jetën. Aq më tepër që në rastin konkret Kaçifas ishte identifikuar me flamurin grek dhe vonesa me ditë të tera të varrimit të tij nga shteti shqiptar kishte provokuar ndjenjat nacionaliste në Greqi. Së dyti në Bularat rimarrja e shabllonëve të njohura historike (dhe anakronike) pa asnjë “vizion” të ri “irredentismi kërcenues” për Shqipërinë, besoj se i la pa armë nacionalizmin ekstremist antihelen në Shqipëri.

Vet Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati konstatoi irredentizmin tek termi “Vorioepir” (!) Mendoj se ky fakt përbën abuzimin me të keq për t’i imponuar kohës, realitetin dhe minoritetit mohimin e historisë dhe ngjarjet historike në lidhje me të. Dihet së pari që vendosja e kufijve shtetërore midis Greqisë dhe Shqipërisë ndau unitetin mijravjeçar të Epirit në dy pjesë, në Epirin e Veriut (greqisht Vorioepir) dhe në atë të Jugut, pjesë reciprokisht të Shqipërisë dhe Greqisë. Dihet së dyti se autonomia e Vorioepirit është një fakt historik, me një protokoll të firmosur nga pala shqiptare (M. Frasheri), nga përfaqësuesit e Vorioepirit, nga fuqitë e mëdha dhe pala greke. Dihet historikisht se për autonominë e Vorioepirit ishin pro dhe luftuan bashkë popullsi të etnisë greke dhe shqiptare, myslimane dhe ortodokse në këtë territor, madje nën trysinë sabotuese të qeverisë së Athinës. Kështuqë, ta mohosh si ngjarje, apo më keq, ta identifikosh atë me minoritetin grek dhe t’ja faturosh atij sot si aktualitet irredentist, është e paprecedentë, aspak serioze dhe mjet i padenjë presioni.

Te tilla janë dhe përpjekjet për t’i imponuar këtij minoriteti historinë e stisur si i ardhur në trojet e veta diku nga shekulli i XVIII-XIX, ndaj duhet të pranojë mëshirën shqiptare. Deri na atë shkallë shkon ky presion saqë kushdo që nga ky minoritet deklaroi se jemi autokton, shpallet hero.

I paprecedentë mbëtet mohimi historik i faktit se tri batalionet partizane nga ky minoritet luftuan përkrah partizanëve shqiptarë në premtimin e Paktit të Atllandikut se pas luftës do të vendosnin vetë për fatin e tyre, dmth nëse donin apo jo bashkimin me Greqinë.

Po ashtu i demshëm mbetet paternalizmi shqiptar për të mohuar të gjitha figurat historike të minoritetit që nuk u bënë shërbyes të qeverive shqiptare, sidomos të Enver Hoxhës, apo për të pohuar në emrin e këtij minoriteti se ai vazhdimisht gëzonte dhe i gëzon të gjitha të drejtat, ndërkohë që nuk guxon të shkruajë emrin e vendbanimit të tij në gjuhën amtare.

Kjo do të thotë se ndërtimi i një profili bashkëjetese tradicionale si ndër shekuj nuk mund të arrihet as me kultivimin e frikës tek pakica dhe as me frikën e shumicës nga pakica. Aq më tepër kur raste të tiulla i kundërvihen totalisht historisë dhe realitetit të marrëdhënieve të njerëzve të thjeshtë.

P.Barka 13.11.2018 Prë gazetën TEMA

## **Nga Panajot Barka**

<https://www.javanews.al/barka-leter-publike-presidentit-meta-per-minoritetin/>

<http://www.gazetatema.net/2018/12/04/panajot-barka-i-shkruan-metes-moslejoni-pengmarrjen-e-minoritetit-grek/>

<http://argjirolajm.net/panajot-barka-i-shqetesuar-i-shkruan-leter-metes-po-behet-presion-ndaj-minoritetit-grek-ne-shqiperi/>

### **Moslëjimi i pengmarrjës së Minoriteti Etnik Grek, përbën obligim prioritar për perspektivën perendimore të Shqipërisë.**

#### **LETËR PUBLIKE**

#### **PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, ZOTIT ILIR META.**

04.12.2018

I nderuar Zoti President i Republikës,

E konsideroj përgjegjësi intelektuale t'ju drejtohem me këtë komunikim publik, pasi po ve re me shqetësim se zhvillimet e fundit në marrëdhëniet shqiptaro-greke po shenojnë një grupë të pazokontë pasigurie, frike dhe kërcënimi në kurbën e problematikës së respektimit të të drejtave kombëtare e të njeriut të Minoritetit Etnik Grek (MEG) në Shqipëri deri dhe të vet egzistencës së tij në trojet e veta. Dhe nuk do të që nëvoja t'ju drejtohesha Juve Zoti President, apo dhe homologut Tuaj grek, nëse do ta evidentoja problemin vetëm tek faktori ekstremist nga të dy anët.

Referenca parimore se Minoriteti Etnik Grek në Shqipëri përbën një faktor të rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve, rezulton të jetë shndërruar në një mundësi pengmarrjeje të këtij minoriteti, e shfaqur rëndom nëpërmjet klimës negative apo dhe pozitive të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Greqisë. (Kur marrëdhëniet midis tyre nuk janë pozitive provohet se të drejtat e minoritetit nuk respektohen dhe kur këto marrëdhënie "shkojnë mirë", atëherë për këto të drejta ose nuk flitet, faktikisht harrohen, ose deklarohet se respektohen.)

Kohët e fundit, është fakt se MEG është kthyer në objekt presioni të drejtëpërdrejtë i antihelenizmit në rritje në Shqipëri, shfaqur si nacionalizëm, në funksion të idesë së kombit të paafirmuar plotësisht për shkak të interesave të huaja. Me ngarkesa me negative dhe në funksion të kësaj ideje është ofensiva në plan medjatik, bibliografik dhe politik për të riparë politikisht historinë e aferme midis dy vendeve dhe për të rivlerësuar historinë e largët midis dy popujve. Kërkesa për rivlerësim të historisë së largët, jo vetëm merr si të vërteta të paverifikueshme konkluzionet romantike të shek. XIX të kultivuesve të ndërgjegjës kombëtare shqiptare, të servirura me së shumti bujarisht nga dijetarë dhe ideologë grek të kohës si mjet bashkimi me shqiptarët kundër pushtimit otoman, por shndërrohen tanimë në teza përvetësuese të kulturës greke që nga lashtësia dhe përdoren si ushqim për nacionalizmin antihelen në Shqipëri.

Akoma më i drejtëpërdrejtë bëhet ky presion ndaj integritetit të MEG nga përpjekja që manifestohet në disa qarqe opinionbërëse në vend, të cilët synojnë të konstruktojnë në mënyrë të njëanshme, të shtrembëruar, të pavartetë dhe jashtë çdo kuadri historik dhe ligjesie zhvillimi, por në funksion të aktualitetit antihelen, historinë e grekëve në trojet e tyre pas formimit të shtetit shqiptar. Kjo frymë, e shfaqur si frikë e shumicës nga pakica, jo vetëm kërkon të deligjimitojë dhe ta shvesh MEG nga historia e tij, nga personalitetet dhe heromnjtë e tij, nga memorja etnokulturore, por kërkon të ushqejë me të nacionalizmin antihelen në Shqipëri duke nxitur urrejtjen etnike të shumicës ndaj pakicës, (flet shumë qartë incidenti i djeshëm në Krane, i cili ndodhi vetëm disa orë pas një dokumentari televiziv në Tiranë po me këtë temë), të rrezojë

urrat e komunikimit midis popujve dhe të vejë në dyshim të ardhmën paqësore dhe në miqësi të tyre.

Me këtë rast nuk mund të mos shpreh shqetësimin tim se është hera e parë që kemi një situatë atakuese të marrëdhënieve midis dy vendeve në shumë plane dhe po për herë të parë konstatohet me dhimbje se ky atakim po përfshin, në një masë të madhe dhe popullin shqiptar, duke i bërë nxitesit e kësaj situatë të ferkojnë duart se shpresojne se adresojnë popullin shqiptar në një retorike fitimtare para një përplasjeje të madhe. (!)

Kuptohet, ky kendveshtrim nuk lë pa atakuar dhe qarqe ekstreme në Greqi, të cilët kërkojnë të drejtat e minoritetit me ide dhe realitete fikse të së kaluarës, të cilat marrin serish peng komunitetin e MEG. Duke i parë ekstremistët grekë si pjesë kompletare të palës respektive shqiptare, shtojnë me shumë frikën dhe pasigurinë në radhët e MEG, por pse jo dhe tek emigrantët shqiptarë në Greqi. Ndërsa, duke u mbështetur tek deklaramet Tuaja, ata mund të prodhojnë më shumë situata provokuese dhe destabilizuese.

Këtu, nuk mund të mos nënvizojmë një dallim që e bën më legjitim shqetësimin tonë. Këto fenomene në Shqipëri, ndryshe nga Greqia, kanë fituar a priori të drejtën e qytetarisë deri në atë shkallë sa që i imponohen edhe strukturave nga më serioze shtetërore, civile dhe publike. Aktivizohen me pretendimin se i shtojnë vlerë “patriotizmit” shqiptar, individë që abuzojnë me titujt akademikë, me të drejtën e të qenit gazetar etj. Shpesh politika u referohet këtyre “ndjeshmerive” në qëndrimet që mban me Greqinë, ose i ushqen ato për të patur argumentin e duhur në marrëdhëniet me fqinjët.

Zoti President

Historia midis dy popujve tanë është e ndërthurur. Kur lëxohet veçmas dhe nuk kihet parasysh perspektiva evropiane, përvoja e popujve të përparuar, kur nuk ka vullnet për të prodhuar vlera të reja, për bashkjetesë dhe përparim, ajo ndërlikohet dhe komplikohet dhe të mban me kokë të kthyer pas, të mban peng të së kaluarës së panevojshme dhe penguese për të ardhmen.

Kur lëxohet dhe shkruhet bashkë, me vullnet për të ecur përpara dhe për të gjetur zgjidhjet e së kaluarës në të ardhmën e përbashkët, në të ardhmën e gjerave që na bashkojnë, atëherë kjo histori prodhon energji zhvillimi dhe përparimi të përbashkët.

Minoriteti Etnik Grek në bashkjetesën me popullin shqiptar ka ndjekur pikërisht këtë rrugë. Ia ka besuar harrësës historike ngjarjet e frikshme të shkatërrimeve dhe shfarosjeve masive të fillim shekullit XX, të shkaktuara nga shqiptarë në emër të P. Otomane. Mbi 15 mijë njerëz u masakruan dhe u përdoqën dhe mbi 25 fshatra me banorë grekë u dogjën vetëm gjatë kalimit të vullnetarëve shqiptarë në ndihme të forcave turke në Janinë. Çetën e Ç. Topullit, MEG nuk e kujtoi kurrë si zjarrëvënëse të shkollave greke në të dy anë e kufirit të sotëm, por si mundësi për të shpetuar nga zgjedha turke. Minoriteti e çliroi vetën nga realiteti i persekucionit masiv, asimilues dhe gjithëplanesh i shtetit shqiptar i periudhës midis dy luftërave, sidomos me mbretin Zog. Dhe e bëri këtë për të parë, luftuar e shpresuar tek e ardhmja e përbashkët me popullin shqiptar. Por fatkeqësisht për të. Në burgjet e sistemit komunist gjuha greke konkuronte bindshëm shqipen dhe vuajtjet vinin për shkak të identitetit. Sistemi komunist përndoqi dhe zhduku njësoj, si kundërshtarët e tij, antikomunist si V. Shahinin e Th. Lolin, ashtu edhe përkrahësit e tij komunist që nuk hoqën dorë nga integriteti etnokulturor grek, si L. Talon apo M Jorgjin.

Mëgjithë zhgënjimin historik, komuniteti i MEG ishte në skalionin e parë të procesëve demokratike në vend të viteve 1990-91. Pavarësisht problemeve që kishte me respektimin e të drejtave të tij nga shteti, ai kurrë nuk u bë pengesënë proceset

integruese të vendit në strukturat evropiane e perendimore, ashtu si kurrë ndonjëherë nuk i ka shkaktuar ndonjë problem shtetit shqiptar dhe shqiptarëve, përkundrazi.

Por, të përdorësh këto vlera si dobësi të tij, të lejohen disa qarqe madje dhe struktura shtetërore, të përdorin ngjarjet historike që shenjuan historinë e tij apo dhe emra individesh që e nderuan atë, si mjet presioni ndaj tyre, në emër të frikës së shumicës nga pakica, kjo nuk mund të tolerohet.

Ka, i nderuar Zoti President dhe realitete të tjera që tregojnë pengëmarrjen e integritetit etnokulturor të këtij Minoriteti.

Përmendim këtu fiktivitetin i performancës zbatuese ligjore, deri në kufijnjtë e propagadës, siç është së fundi dhe ligji për minoritetet. Lidhet kjo me mentalitetin e shumicës se për nivelin e respektimit të të drejtave në lidhje me identitetin etnik, kulturor apo dhe historik të MEG, e di dhe vendos shumica dhe jo i zoti, minoriteti. Shumica merr përsipër të përcaktoj nivelin e respektimit të të drejtave të tij, të caktoj heronjtë dhe ngjarjet e tij historike etj. Në bazë të kësaj logjike, është minoritar i mirë dhe i pranueshëm nga shumica vetëm ai që pranon dhe tejkalon atë. Kjo në praktikën e përditshme do të thotë se, presioni i shtuar në këtë drejtim dhe nëvoja për mbijetesë, e detyron MEG të heq dorë nga ato të drejta që garantojnë dinjitetin dhe plotmerinë e identitetit të tij etnokulturor, si edhe të drejtën e manifestimit të këtij identiteti.

Produkt i skajshëm i kësaj logjike janë përfaqësuesit politikë të MEG për aq kohë sa ata përzgjidhen nga partitë e shumicës në raport me qeverisjen, dhe kur mbijetesën e tyre politike ata do ta shikojnë në raport me interesat e shumicës në lidhje me respektimin e të drejtave të MEG.

Shprehje e kësaj varësie vasale është heshtja dhe për më keq lëshimet, e këtyre përfaqësuesve politikë të MEG ndaj grabitjes së pronave të tij nga përfaqësues të shumicës, të cilët me ndihmën e strukturave shtetërore, u bënë pronarë duke abuzuar dhe me legjislacionin e P. Otomane për tokën, legjislacion i cili nuk u nihte shërbetorëve të saj të drejtën e pronësisë mbi tokën, por vetëm të drejtën e përdorimit (!) Me siguri, ky fenomen, që po na sjell në një stad më të avancuar statusin pronësor e shoqëror të P. Otomane, është një problem mbarë shqiptar, por për MEG ky fenomen, i alternuar me ofensiven për blerjen e tokës bujqësore me para të pista, nënkupton eliminimin e tij ekonomik dhe jo vetëm.

E ndihmon këtë proces dhe migrimi masiv i anëtarëve të MEG, por e rrezikon hapur shtimi demografik i shumicës në zonat me popullsi kombakte minoritare greke.

Zoti President,

Unë e shikoj me shumë dhimbje antkhin e deklaruar të bashkëkombasve të mi që shikojnë një ditë pasuritë e tyre në duart e anëtarëve të shumicës. Nuk mund ta shikoj me pasivitet faktin që gjithnjë e më shumë në komunikimet midis tyre përdoret termi “ata” për shqiptarët. Por më shumë shikoj me shqetësim se një situatë e tillë, prodhon reaksion, reagime të pakontrolluara, që fatkeqësisht na venë.... përballë!

Ndaj besoj se është në dorën e gjithsecilit që mendon dhe aspiroon vërtet vlerat e Perendimit, të kontribuojë për mosprecipitimin e situatës, por për shëndoshjen e saj.

Duke Ju falenderuar për mirkuptimin  
Prof. Asoc. **Panajot Barka**  
**Botuar tek gazeta Tema**

**Gjirokastër, 04.12.2018**

## **Η αποτροπή της ομηρίας της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας, αποτελεί υποχρέωση προτεραιότητας για τη δυτική προοπτική της Αλβανίας.**

ΔΗΜΟΣΙΑ ΕΠΙΣΤΟΛΗ ΠΡΟΣ ΤΟΝ ΠΡΟΕΔΡΟ ΤΗΣ ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑΣ  
ΚΥΡΙΟ ΙΑΙΡ ΜΕΤΑ

Αξιότιμε Κύριε Πρόεδρε της Δημοκρατίας,

Θεωρώ ευθύνη διανοουμένου να Σας απευθυνθώ με τη δημόσια αυτή επιστολή, διότι με ανησυχία διαπιστώνω ότι οι πρόσφατες εξελίξεις στις ελληνο-αλβανικές σχέσεις σημειώνουν ασυνήθης αγκύλωση ανασφάλειας, φόβου και απειλής στην καμπύλη του προβληματισμού όσον αφορά τον σεβασμό των εθνικών και ανθρωπίνων δικαιωμάτων της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας στην Αλβανία, μέχρι μάλιστα την ίδια την ύπαρξή της στα πατρώα της εδάφη της.

Δε θα έκρινα αναγκαίο να απευθυνθώ σε Σας Κύριε Πρόεδρε, ή στον Έλληνα ομόλογό Σας, σε περίπτωση που το πρόβλημα θα εντοπιζονταν μόνο στον εξτρεμιστικό παράγοντα από τις δύο πλευρές.

Η αρχή ότι η Εθνική Ελληνική Μειονότητα στην Αλβανία, αποτελεί σημαντικό παράγοντα στην ενίσχυση των σχέσεων μεταξύ των δύο χωρών, προκύπτει ότι έχει μετατραπεί σε δυνατότητα ομηρίας της ίδιας της μειονότητας, που εκδηλώνεται συνήθως στο θετικό ή αρνητικό κλίμα των σχέσεων μεταξύ Αλβανίας και Ελλάδας. (Όταν οι μεταξύ τους σχέσεις δεν είναι θετικές βεβαιώνεται ότι τα δικαιώματα της Εθνικής Ελληνικής μειονότητας δεν γίνονται σεβαστά και όταν οι σχέσεις αυτές «πηγαίνουν καλά», τότε για τα δικαιώματα αυτά ή δεν γίνονται αναφορές, στην ουσία λησμονούνται, ή δηλώνεται ότι γίνονται σεβαστά.)

Είναι γεγονός ότι τελευταία η Εθνική Ελληνική Μειονότητα έχει μετατραπεί σε αντικείμενο άμεσης πίεσης του ανοδικού ανθελληνισμού στην Αλβανία, εκδηλωμένου ως εθνικισμού, στην υπηρεσία της ιδέας του ανολοκλήρωτου έθνους εξαιτίας των ξένων συμφερόντων. Με περισσότερο αρνητικές εκφάνσεις και στην υπηρεσία της ιδέας αυτής αναπτύσσεται η εκστρατεία σε επίπεδο ΜΜΕ, βιβλιογραφίας και πολιτικής για την πολιτική επανεξέταση της κοντινής ιστορίας μεταξύ των χωρών και για την επανεκτίμηση της μακράς ιστορίας μεταξύ των λαών.

Το αίτημα για την επανεκτίμηση της μακράς ιστορίας, όχι μόνο λαμβάνει ως αλήθειες – ανεπιβεβαίωτες, τα ρομαντικά πρότυπα του 19<sup>ου</sup> αιώνα των καλλιεργητών της αλβανικής εθνικής συνείδησης, παραχωρημένα κυρίως απλόχερα από τους Έλληνες λόγιους της εποχής, ως μέσο ένωσης με τους Αλβανούς κατά της οθωμανικής κατοχής, αλλά τα μετατρέπει σε θέσεις ιδιοποίησης ως αλβανικό τον ελληνικό πολιτισμό από την αρχαιότητα και εκφέρεται ως τροφή για τον ανθελληνικό εθνικισμό στην Αλβανία.

Αμεσότερη γίνεται η πίεση αυτή κατά της ακεραιότητας της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας, λόγω των προσπαθειών που καταβάλλουν κύκλοι διαμορφωτών της κοινής γνώμης στη χώρα, οι οποίοι αποσκοπούν να οικοδομήσουν μονομερώς, διαστρεβλωμένα, αναληθώς και εκτός κάθε ιστορικού πλαισίου και νομιμότητας εξέλιξης, αλλά στην υπηρεσία της ανθελληνικής πραγματικότητας, την ιστορία των Ελλήνων στα εδάφη τους μετά την ίδρυση του αλβανικού κράτους.

Το κλίμα αυτό, εκδηλωμένο ως φόβο της πλειοψηφίας από την μειοψηφία, όχι μόνο απαιτεί να αφαιρέσει και να απαλλάξει την Εθνική Ελληνική Μειονότητα από

την ιστορία της, τις προσωπικότητές της, από την εθνοπολιτιστική της μνήμη, αλλά και να τροφοδοτήσει τον ανθελληνικό εθνικισμό στην Αλβανία, υποκινώντας εθνικά μίσση της πλειοψηφίας κατά της μειονότητας, (μιλάει εύγλωττα το χθεσινό επεισόδιο στην Κρανια, το οποίο σημειώθηκε μόλις μετά από μερικές ώρες από την μετάδοση μιας εκπομπής στα Τίρανα με το ίδιο θέμα), οδηγεί στην κατάργηση των διόδων επικοινωνίας μεταξύ των δύο λαών και θέτει σε υπονομεύει το ειρηνικό μέλλον και τη φιλία μεταξύ τους.

Επί της ευκαιρίας δεν μπορώ να μη εκφράσω την ανησυχία μου ότι πρόκειται για πρώτη φορά που οι σχέσεις μεταξύ των δύο χωρών αντιμετωπίζουν μια πολύπλευρη αντιπαράθεση και επίσης για πρώτη φορά διαπιστώνεται με θλίψη ότι το κλίμα αυτό συμπεριλαμβάνει σε μεγάλο ποσοστό τον αλβανικό λαό, κάνοντας τους υποκινητές της συγκεκριμένης κατάστασης να χαίρονται διότι ελπίζουν ότι οδηγούν τον αλβανικό λαό σε μια ρητορική νικητή πριν από μια μεγάλη αντιπαράθεση.(!)

Εννοείται, ότι από την οπτική αυτή γωνία δεν μπορεί να μη επιπλήξεις τους εξτρεμιστικούς κύκλους στην Ελλάδα, οι οποίοι απαιτούν τα δικαιώματα της μειονότητας μέσα από σταθερές ιδέες και πραγματικότητες του παρελθόντος, που καλλιεργούν ξανά κλίμα ομηρίας στην κοινότητα της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας.

Αντιμετωπίζοντας τους Έλληνες εξτρεμιστές ως συμπληρωματικό τμήμα της αντίστοιχης αλβανικής πλευράς, κρίνουμε ότι αυτό αυξάνει περισσότερο το φόβο και την ανασφάλεια στις γραμμές της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας, γιατί όχι και μεταξύ των Αλβανών μεταναστών στην Ελλάδα. Ενώ, στηριζόμενοι στις δηλώσεις Σας, εκείνοι μπορεί να δημιουργήσουν περισσότερες προκλητικές και αποσταθεροποιητικές καταστάσεις.

Στο σημείο αυτό δεν μπορούμε να μη υπογραμμίσουμε μια διαφορά που νομιμοποιεί περισσότερο την ανησυχία μας. Τα φαινόμενα αυτά στην Αλβανία, διαφορετικά από την Ελλάδα, έχουν αποκτήσει a priori υπεροχή στην κοινή γνώμη, μέχρι μάλιστα το σημείο που επιβάλλονται και στις πιο σοβαρές κρατικές, αστικές και δημόσιες δομές. Με την πεποίθηση ότι αυξάνουν τις αλβανικές «πατριωτικές» αξίες, δραστηριοποιούνται άτομα που κάνουν κατάχρηση τους ακαδημαϊκούς τίτλους, του δημοσιογραφικού λειτουργήματος κλπ. Συχνά, η πολιτική στις στάσεις της στις σχέσεις με την Ελλάδα επικαλείται αυτές «τις ευαισθησίες», ή τις τροφοδοτεί για να έχει το «κατάλληλο» επιχείρημα στις σχέσεις με τους γείτονες.

Κύριε Πρόεδρε

Η ιστορία μεταξύ των δύο λαών μας είναι συνυφασμένη. Όταν διαβάζεται χώρια και δεν λαμβάνεται υπόψη η ευρωπαϊκή προοπτική, η εμπειρία των προοδευμένων λαών, όταν δεν υφίσταται η βούληση για την δημιουργία νέων αξιών, για ειρηνική συνύπαρξη και πρόοδο, σε κρατάει με το κεφάλι γυρισμένο προς τα πίσω, όμηρο του αχρείαστου παρελθόντος και εμποδίου για το μέλλον.

Όταν διαβάζεται και γράφεται από κοινού με τη θέληση για να βαδίσουμε από κοινού προς το μέλλον, για να βρούμε τις λύσεις του παρελθόντος στον μέλλον των πραγμάτων που μας ενώνουν, τότε, η ιστορία αυτή παράγει ενέργειες ανάπτυξης και κοινή πρόοδο.

Η Εθνική Ελληνική Μειονότητα στη συμβίωσή της με τον Αλβανικό λαό, ακολούθησε ακριβώς την πορεία αυτή. Εμπιστεύτηκε στην ιστορική λησμονιά τα φρικτά γεγονότα των μαζικών καταστροφών και σφαγών στις αρχές του 20<sup>ου</sup> αιώνα που προκάλεσαν Αλβανοί εξ ονόματος της Ο. Αυτοκρατορίας. Περισσότερες από 15 χιλιάδες άνθρωποι σφαγιάστηκαν και εκδιώχτηκαν και 25 χωριά Ελλήνων πυρπολήθηκαν μόνο κατά τη διάβα των Αλβανών εθελοντών σε βοήθεια των τουρκικών δυνάμεων στα Ιωάννινα. Την τσέτα του Τσερτσίζι Τόπουλι, η Εθνική



Ελληνική Μειονότητα δεν την μνημόνευσε ποτέ για την πυρπόληση των ελληνικών σχολείων στις δύο πλευρές των σημερινών κρατικών συνόρων, αλλά ως τη δυνατότητα για την απαλλαγή από τον τουρκικό ζυγό.

Η Ελληνική Μειονότητα απελευθέρωσε τον εαυτόν της από την πραγματικότητα των μαζικών και ολόπλευρων αφομοιώσεων μέσω βιαιοπραγιών του αλβανικού κράτους στο Μεσοπόλεμο, κυρίως επί βασιλείας Ζόγου. Και το διέπραξε αυτό για να οραματιστεί, πολεμήσει και ελπίζει στο κοινό μέλλον με τον αλβανικό λαό. Δυστυχώς όμως γι' αυτή. Στις φυλακές του κομμουνιστικού καθεστώτος η ελληνική γλώσσα ανταγωνίζονταν επάξια την αλβανική και οι φυλακίσεις είχαν ως αιτία την εθνική ταυτότητα. Το κομμουνιστικό καθεστώς εκδίωξε και εξαφάνισε το ίδιο, τόσο τους ιδεολογικά αντιπάλους του, όπως τον Β. Σαχίνη και το Θ. Λώλη, έτσι και τους κομμουνιστές συμπαραστάτες τους, που δεν παραιτήθηκαν από την εθνοπολιτιστική τους ακεραιότητα, όπως τον Α. Τάλλιο, τον Μ. Γιώργη και πολλούς άλλους.

Παρόλη την ιστορική απογοήτευση η κοινότητα της Εθνικής Ελληνικής μειονότητας βρέθηκε στην πρώτη γραμμή των διαδικασιών εκδημοκρατισμού της χώρας του 1990-91. Ανεξαρτήτως των προβλημάτων που αντιμετώπιζε όσον αφορά το σεβασμό των θεμελιωδών δικαιωμάτων της από το κράτος, η Εθνική Ελληνική Μειονότητα δε στάθηκε ποτέ εμπόδιο στις ενταξιακές διαδικασίες της Αλβανίας στους ευρωπαϊκούς και διεθνείς οργανισμούς, όπως ποτέ δεν έχει προκαλέσει κάποιο πρόβλημα στο αλβανικό κράτος ή στους Αλβανούς. Απεναντίας!

Όμως, να αντιμετωπίσεις τις αξίες αυτές ως αδυναμία, να επιτρέψεις κάποιους κύκλους, μάλιστα και κρατικές δομές, να χρησιμοποιούν ιστορικά γεγονότα που σημάδεψαν την ιστορία της Ε.Ε. Μειονότητας, ή και ονόματα ατόμων που τίμησαν αυτή, ως μέσο πίεσης προς την ίδια, και στο όνομα του φόβου της πλειοψηφίας από την μειοψηφία, αυτό δεν μπορεί να γίνει ανεχτό.

Υπάρχουν, Κύριε Πρόεδρε και άλλες συνιστώσες που αποδεικνύουν την ομηρία της εθνοπολιτιστικής ακεραιότητας της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας.

Αναφέρουμε εδώ την όσο για τα μάτια εφαρμογή της νομοθεσίας, μέχρι τα όρια προπαγάνδας, όπως προσφάτως με τον νόμο για τις μειονότητες. Αφορά την νοοτροπία της πλειοψηφίας ότι για το επίπεδο σεβασμού των δικαιωμάτων που αφορούν την εθνική, πολιτιστική ή και ιστορική ταυτότητα της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας, θα αποφασίσει η πλειοψηφία και όχι ο νόμος και η ίδια η μειονότητα. Η πλειοψηφία αναλαμβάνει να ορίσει το επίπεδο σεβασμού των δικαιωμάτων της, τους ήρωες και τα ιστορικά της γεγονότα κλπ. Στη λογική αυτή είναι καλός Έλληνας μειονοτικός και αποδεχτός από την πλειοψηφία μόνο εκείνος που αποδέχεται και ξεπερνάει τη συγκεκριμένη νοοτροπία. Στην καθημερινή ζωή αυτό σημαίνει ότι η αυξημένη πίεση προς την κατεύθυνση αυτή και οι ανάγκες επιβίωσης, να υποχρεώνει την Εθνική Ελληνική Μειονότητα να παραιτείται από εκείνα τα δικαιώματα που εγγυούνται την αξιοπρέπεια και πληρότητα της εθνοπολιτιστικής της ταυτότητας, καθώς και από το δικαίωμα εκδήλωσης της ταυτότητας αυτής.

Ακραίο προϊόν της λογικής αυτής αποτελούν οι πολιτικοί εκπρόσωποι της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας, για όσον καιρό αυτοί επιλέγονται και εκλέγονται από τα κόμματα της πλειοψηφίας σε σχέση με την εξουσία, και για όσο καιρό εκείνοι θα δουν την πολιτική τους επιβίωση σε σχέση με τα συμφέροντα των κομμάτων αυτών για το πόσο σεβαστά πρέπει να γίνουν τα δικαιώματα της Εθνικής Ελληνικής μειονότητας.

Εκδήλωση αυτής της υπόδουλης εξάρτησης αυτών των εκπροσώπων της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας αποτελεί η σιωπή και πιο πολύ οι παραχωρήσεις στο θέμα υφαρπαγής των περιουσιών από εκπροσώπους της πλειοψηφίας, οι οποίοι με τη

στήριξη των κρατικών δομών, μετατράπηκαν σε ιδιοκτήτες ελληνικών μειονοτικών περιουσιών, κάνοντας κατάχρηση και με την νομοθεσία της Ο. Αυτοκρατορίας επί της γης. Η νομοθεσία αυτή δεν αναγνώριζε σε όσους την εξυπηρετούσαν τίτλους ιδιοκτησίας επί της γης, παρά μόνο τίτλους χρήσης της. (!) Ασφαλώς, το φαινόμενο αυτό, που μας παραπέμπει σε ένα πιο προχωρημένο στάδιο το ιδιοκτησιακό και κοινωνικό καθεστώς της Οθωμανικής Αυτοκρατορίας στην Αλβανία, αποτελεί ένα παναλβανικό θέμα, αλλά για την Εθνική Ελληνική Μειονότητα, το φαινόμενο αυτό σε συνδυασμό με την εκστρατεία εξαγοράς της καλλιεργήσιμης γης με μαύρο χρήμα, υπονοεί την οικονομική και όχι μόνο εξουδετέρωσή της.

Συμβάλλει στη διαδικασία αυτή η μαζική μετανάστευση των μελών της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας, αλλά αποτελεί ανοιχτό κίνδυνο η δημογραφική αλλοίωση σε όφελος της πλειοψηφίας στις περιοχές με αμιγή ελληνικό μειονοτικό πληθυσμό.

Κύριε Πρόεδρε

Θωρώ με μεγάλη θλίψη το δηλωμένο άγχος των συμπατριωτών μου που βλέπουν ότι μια μέρα οι περιουσίες τους θα καταλήξουν στα χέρια μελών της πλειοψηφίας. Δεν μπορώ δω με απάθεια το γεγονός που όλο και περισσότερο στις συνομιλίες τους χρησιμοποιούν τον όρο «αυτοί» για τους Αλβανούς. Αλλά περισσότερο διαπιστώνω με ανησυχία ότι μια τέτοια κατάσταση, καλλιεργεί αντίδραση, διαμαρτυρίες, ανεξέλεγκτες ενέργειες που δυστυχώς μας βάζουν .... απέναντι!

Γι αυτό πιστεύω ότι είναι στο χέρι του καθενός που σκέφτεται και προσδοκεί πραγματικά στις δυτικές αξίες, όχι απλώς να συμβάλλει για την μη επιδείνωση της κατάστασης, αλλά για την εξυγίανση της.

Σας ευχαριστώ για την κατανόηση  
Αναπ. Καθ. Παναγιώτης **Μπάρκας**

**Αργυρόκαστρο, 04.12.2018**

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gazetatema.net/2018/12/07/po-behet-e-veshtire-ulja-e-tensioneve-mes-dy-vendeve/>

<https://sh.time.mk/c/3481fde4ff/po-behet-e-veshtire-ulja-e-tensioneve-mes-dy-vendeve.html>

<https://sh.time.mk/c/a0c2818809/po-behet-e-veshtire-ulja-e-tensioneve-mes-dy-vendeve.html>

<http://time.ikub.al/Lajme/18-12-10-Po-behet-e-veshtire-ulja-e-tensioneve-mes-dy-vendeve469107.aspx>

<https://hashtag.al/index.php/2018/12/07/veshtiresia-per-te-ulur-tensionet/>

### **Po bëhet e vështirë ulja e tensioneve midis dy vendeve**

07.12.2018

U bashkova dhe une nismës për të ulur tensionet e kohëve të fundit midis dy vendeve të provokuara në dukje nga grupime ekstremiste nacionaliste. Distancimi dhe denimi është i thjeshtë. Ulja e tensioneve dhe adresimi i marrëdhënieve në traditën evropiane, po bëhet e vështirë. Nuk e vë në dyshim se në të dy anët këto fenomene janë të pranishme. Por, vura re se egzistojnë ndryshime përsa i përket qëndrimeve dhe klimës ndaj këtyre fenomenëve në të dy vendet, duke filluar madje nga qëndrimet zyrtare. Ndryshe nga Greqia, fenomenet nacionaliste në Shqipëri që kanë në thelb antihelenizmin kanë fituar a priori të drejtën e qytetarisë deri në atë shkallë sa që i imponohen edhe strukturave nga më serioze shtetërore, civile dhe publike. Dhe kjo përbën një realitet që duhet marrë seriozisht në konsideratë. Qëndrimi ndryshe në Greqi, po mirret si dobësi, aq me keq kur nga Tirana deklarohet se marrëdhëniet janë të mira

Po marr si pikë referimi deklaratën e MEPJ, të datës 05.12.2018, e cila merr shkas nga vrasja e një 18 vjeçari shqiptar në Kavalla të Greqisë, vlarë nga një bashkombas i tij. Deklarata vërteton se nuk është thjeshtë produkt i presioni nacionalist, por një tregues i instrumentalizimi të patetizmit nacionalist antihelen. Nxitimi për një deklaratë të tillë do të mund të pranohej si kapërxim të logjikës së ftohtë me të cilën vepron, sidomos në raste të tilla, makina shtetërore nëse po ky institucion do të zgjidhte nja nga mënyrat e shumta diplomatike për ta rikuperuar, apo për të shmangur efektet negative në të dy anët e kufirit. Heshtja, kur e vërteta është krejt ndryshe dhe përgënjeshtuese e kësaj deklarateje është shumë kompromentuese për të. Përshkallëzimi i klimës nacionaliste antihelene e bën me përgjegjësi politike MEPJ. Në linjën nxitese të kësaj klime u rreshtuan medja të ndryshme në vend të cilat anashkalojnë brutalisht të vërtetën, që përbën themelin e misionit të tyre.

Cili është kumti i deklaratës së MEPJ dhe ku stonon apo abuzon ajo. Deklarata flet për një seri vrasjesh shqiptarësh në Greqi që ndalon në numrin katër. Akuzon palën greke se vonon zbardhjen e tyre. Me një amatorizëm të qëllimshëm i trajton këto ngjarje pasojë “e sfondit të ekstremizmit dhe gjuhës së urrejtjes” në Greqi “për të cenuar sigurinë dhe dinjitetin e shqiptarëve që punojnë e kontribuojnë në vendin fqinj”, atakon hapur Agimin e Artë apo dhe segmente të tjera ekstremiste në Greqi, për të cilat kërkon nga autoritetet greke “të denojnë dhe t’u venë fre” përpjekjeve të tyre; duke shpërthyer se “nuk pranojmë kurrësi të mësohemi as me thirrjet e tyre ksenofobe në kanalet e komunikimit dhe as me viktimizimin patetik e nacionalist të ndonjërit syresh që nuk lë rast pa sulmuar Shqipërinë në instancat evropiane”.

Kuptohet, që nuk mund të mos shprehim keqardhjen tone për çdo humbje jete që ka si shkak dorën e njeriut, cilido qoftë ai. Nuk mund të mos denoncojmë çdo akt që kapërxën ligjin dhe logjikën humane për humbjen e jetës njerëzore, aq me tepër nëse ka një prapavijë të organizuar dhe cedon sigurinë shoqërore dhe në rastin tone

marrëdhëniet midis dy vendeve e popujve. Por kur shikon se me këto ngjarje abuzohet me synimin për t'i përdorur si mjet për situata të tjera më të renda, mendoj se kurajua civile dhe analizat dhe krahasimet objektive marrin rendësi primare. Diktohet kjo nga fakti se hapur ose si prapamendim trajtohen si paralele ose si kundërpesha me rastin Kaçifa në Bularat. Ose akoma me keq, synohet që ngjarjet e ndodhura së fundmi në Greqi me humbjen e jetës së katër shqiptarëve, të promovohen dhe të trajtohen si hakmarrje nacionaliste, duke çuar kështu ujë në logjikën fatkeqe se rasti Kaçifa ishte inskenuar për të ricikluar për qëllime të tjera incidente të ngjashme. Mobilizimet e fundit për protesta patriotike në Gjirokastër, në ditën e amëshuar të të 40-ve të të ndjerit Kaçifa, është një shëmbull i keq antihuman dhe precedent i rrezikshëm nderetnik.

Dhe prap nuk ka asnjë deklaratë apo denoncim. Atakimi i Agimit të Artë nga MEPJ dhe kërkesa e saj ndaj autoriteteve greke për të denuar aktet e Agimit të Artë, kur kjo po ndodh në të gjitha instancat në Greqi, i ngjan më shumë një ftese partisë politike të ekstremit të djathtë në Greqi, për të dalë në sheshin e mejdanit, atje tek po nisen nga ana tjetër “shoqatat patriotike” shqiptare.

Kuptohet, që jo vetëm distancohem por edhe denoj aktet ekstreme dhe të patolerueshme të Agimit të Artë, edhe kur ato lidhen me Minoritetin Etnik Grek. Por nuk e kuptoj kush ka interes që të kthejë objektivin këtij ekstremizimi kundër shqiptarëve në Greqi, apo dhe kundër marrëdhënieve midis vendeve e popujve tanë!!

Për të gjitha këto, publiku duhet sqaruar se ngjarjet e fundit në Greqi përgënjeshtrojnë totalisht si komunikatën e MEPJ, ashtu dhe përndezjen e shumë grupimeve nacionaliste. Aq me keq nëse kjo bëhet për të tërhequr vemendjen nga situata e brendshme politike. Dikush ka guxim të madhë nëse do që të marrë peng komunitetin e shqiptarëve emigrantë në Greqi.

Pra, vrasja e parë ndodhi kur viktimat, e sapo dale nga burgu, pjesë e një grupi shqiptarësh që deportonin lëndë narkotike në territorin grek, hapen zjarr kundër policisë ku mbeti i plagosur dhe një polic grek. Ngjarja u zbardh menjëherë dhe pala shqiptare nuk kishte asnjë pretendim dhe iu kthye në bumerang të gjithë atyreve që tentuan të bëjnë paralelizma.

Rasti i dytë nuk ishte vrasje, aq me tëpër nga policia apo shteti grek, por një vdekje në kushte të pazbardhura në burg. Pra, së pari, nuk mund të paragjykos, aq me tëpër zyrtarisht, një çeshtje të pazbardhur. Së dyti, vdekje për arsye të ndryshme në burgje ka në çdo vend. Vdesin, madje për shkaqe trajtimi të keq të autoriteteve të b urgjeve edhe në Shqipëri dhe nuk ka asnjë reagim të paktën të shoqërisë civile. Propabiliteti të ndodh në burgjet greke është i madhë, pasi edhe numri i shqiptarëve që vuajnë denimet të ndryshme në burgjet greke, qëndron në krye të të burgosurve të huaj në Greqi.

Rasti i tretë është vrasja e 62 vjeçarit shqiptar në Korfuz. Ngjarja u zbardhë menjëherë. Autori është një anëtarë i Agimit të Artë. Motivët janë nacionaliste. Akti u denua në Greqi zyrtarisht nga shteti, nga deputetë, ministra, medja, shoqëria civile. Madje e bënë këtë edhe në opinionin publik shqiptar. Në aspektin pak me juridik. Autori i vrasjës është vërtet anëtar i Agimit të Artë, por vrasjen nuk e kreu në emër të partisë ku aderon, aq me keq në emër të shtetit grek. Mëgjithatë, distancimi grek ishte i dukshëm, i prerë, pa asnjë prapamendim, prapavijë dhe ekuivok. Lind atëherë pyetja përse nuk e mori parasysh këtë realitet ministria jonë e Jashtme? Zbardhja e ngjarjës provoi se nuk egziston ndonjë prapavijë e organizuar nacionaliste, as nga Agimi i Artë e aq më pak nga shteti grek. Dihet se shqiptarët në Greqi përbëjnë një realitet prej disa qindar mijrash dhe ngjarje të kësaj natyre janë brenda logjikës së jetës dhe proceseve integruese të tyre në shoqërinë greke. Përse Ministria jonë nuk e trajton problemin në këtë kendveshtrim?!

Perse, shteti shqiptar dhe sidomos medjat nuk treguan pikën e gjakftohtësisë në gjykimin e rastit Kacifa, por nxituan me vrap, të parët shtetarët, për të bërë etiketime, dhenë kongluzione dhe orientime, për t'u paraprirë organëve kompetente, më saktë për të yshtur ndjenjën e nacionalizmit ekstrem, kur edhe pas 40 ditësh organet kompetente nuk "arrijnë" të kenë në dorë asnjë element zbardhjeje për shkaqet e vrasjes së Kaçifës?!

Lë të mos harrojmë se paralelisht me ngjarjen e Korfuzit në Greqi ndodhi një ngjarje tjetër shumë më e rëndë. Një 19 vjeçar shqiptar në bashkëveprim me një moshatar grek vranë në mënyrën më mizore dhe për arsye banale një studente 21 vjeçare. Në Shqipëri askush nuk e denoi këtë aktë të të riut shqiptar, ndërsa tonet denoncuese të shoqërisë greke ndaj shqiptarit të radhës të përzier në krime në Greqi ishte mëse të pandjeshme. Këto ditë Athina digjet nga demonstratat në kujtim të vrasjes së një djaloshi nga policia. Merret me mend se çmund të ndodh nëse në Greqi ngrihet një kauzë antishqiptare. Mos vallë synojmë apo duam të provokojmë situata të tilla në Greqi ndaj emigrantëve shqiptarë dhe paralelisht pengmarrjen e Minoritetit etnik Grek në Shqipëri?

Jetë të humbura në Shqipëri ka me dhjetra. Vrasje në familje, vrasje për një fjalë, për një gërvishje makine, për një femër, për interesa ekonomike, për gjakmarrje etj. Vetëm në Vlorë u zhduken këtë vit mbi 80 veta. Por, perse në këto raste nuk ka reagime patriotike. Përse qeveria dhe organët kompetente heshtin? A nuk janë edhe këta shqiptarë që i duhen Shqipërisë?

Nuk duam të flasim për rastin e katërt. Keqardhje për 18 vjeçarin që humbi aq mizorisht jetën e vet, ashtu si edhe për shokun e tij të armatosur një vit më të vogël, jeta e të cilit u deformua. Por përse MEPJ kërkon të abuzojë me këtë fatkeqësi dhe ta përdorë si ushqim për nacionalizimin ekstrem antihelen shqiptar?

Përse në këto momente nuk ka reflektim dhe thirrje për gjakftohtësi dhe vetpërmbytje, ose me thjesht për të thenë të vertetën!

Loja me nacionalizmin që po shikohet se fundit, përdorimi i Kosovës si kokë dashi për t'u imponuar Evropës dhe rindezja e makinave të antihelenizmit për të joshur urine e vërtetë me ushqim nationalist, është me rreziqe të mëdha.

Gjirokastër 07.12.2018 për gazetën TEMA

Nga Panajot Barka

<https://360grade.al/194407/ngerci-i-shpreses/>

<http://time.ikub.al/Lajme/18-12-18-Ngerci-i-shpreses-.aspx>

<https://sh.time.mk/c/cb27c506da/protesta-mash-jemi-ne-komunikim-me-te-gjitha-palet.html>

<https://sh.time.mk/c/02fc07036c/>

**Ngërçi i shpresës.**

18.12.2018

Kështu do të mund ta cilesonim greven e zgjatur të rinisë studentore.

Lë ta nisim nga deklarata e Ramës, se ajo i dha një shuplakë qeverisë dhe grusht opozitës. Mendoj se koncepti i Ramës pranon një të vërtetë, por jo të plotë, por gjithsesi të diferencuar. Dhe tek ky diferencim, të ngritur tek termat popullore “shuplakë” dhe “grusht”, kërkon të ndërtojë epersinë e luftës së vet politike në këto momente të vështira dhe deliklate. Në fakt, greva e studenteve tregon ditë për ditë se politika, ajo politikë rreth të cilës vërtiten punët e shtetit dhe përcaktohen fatet e njerëzve ka rrenë. Njëkohësisht greva studentore evidenton me forcë pamundësinë e gjetjes së rrugës që i duhet shpresës për zgjidhjen e krizës. Në këtë kuptim nuk është fare e mjaftueshme dorëheqja ta zëmë e qeverisë. Kjo se e njejta krizë ka vijimësinë në rrugën politike të opozitës dhe populli nuk është më i gatshëm të zgjedh midis dy të keqijave, të keqën më të vogël. Pra, situata është shumë më e rëndë se ajo që duket dhe e skicuar rëndom sipas parimit demokratik të ballafaqimit politik pozitë-opozitë.

Lë t’i analizojmë tre aktorët në skenën e kësaj situatë dhe të marrim në konsideratë dhe aktorin bazë, popullin e gjerë në heshtje.

Një nga këta aktorët, i sapo dalë në skenën publike, por që zotëron potenciale të mëdha në arenën politike, është rinia studentore. Ajo që mbeti në vend, por gjithmonë si derivat i asaj moshe që ka sjellë ndryshime cilësore në historinë e njerëzimit. (Shënojmë se ka rëndësi. Sipas përvojës historike këto ndryshime arrihen kur kauza e rinisë dhe elitës prijese kthehen në kauzë të popullit dhe të shoqërisë së civilizuar)

Rinia jonë studentore është vërtet në grevë. Por “Kauza” e saj përmbledhet në 8 pika të cilat, bashkë me qartësinë kanë paqartësinë, sipas rastit herë shtohen e herë pakësohen. Studentët ngulin këmbë se kërkesat e tyre nuk janë politike, pavarësisht se i drejtohen politikës. Studentët në “pavarësinë” dhe “distancimin” që duan nga politika tregojnë se janë të ndërgjegjshëm për “infeksionin” që mund të pesojnë ata dhe “kauza” e tyre nga infiltrimi politik në lëvizjen e tyre i gjithë spektrit të politikës.

Nuk është vetëm ky fakt që pengon evoluimin e kauzës studentore. Më shumë duhet kërkuar tek fakti se vet spektri politik ka frikë nga zhvillimi i kësaj kauze jashtë kornizës së lejuar nga politika e instaluar në vend. Kjo frikë bëhet më e evidente po të kemi parasysh falemntimin e kësaj politike që mbahet ende në këmbë për shkak se i duhet kriminit, korrupsionit, padresjtësisë dhe imoralitetit shoqëror e shtetëror. Duket qartë kjo dhe tek fakti se lëvizja jonë studentore, është ndoshta e para që jo vetëm nuk ka një kauzë të qartë, por nuk prodhon dot as edhe një udhëheqje solide që të mund të drejtojë apo të marrë përgjegjësi të mëdha, për gjithë shoqërinë

Kjo të kujton në fakt funksionin e Komiteteve të Shtimit Publik në krizën e shtetit të renë të 1997. Përsa kohë Komitetet i duheshin spektrit politik të opozitës për të eliminuar pushtetin e shtetit të Sali Berishës, veprimtaria e tyre inspirohej nga ky spektër opzitar deri në veprime ekstreme. Ama, po ky spektër nga ana tjetër nuk lejonte që Komitetet të unifikohehin. Ndërkohë dhe këto Komitete deklarorin se ishin jashtë ndikimit politik. Ndërkohë, kur erdhi momenti që faktori ndërkombëtar tentoi të provonte mundësinë e shndërrimit të Komiteteve në forcë politike pushteti, këto parti

dërguan në takimin e Komiteteve me faktorin ndërkombëtar nivelin më të ulët të mundshëm përfaqësimi, me pasojë, faktori ndërkombëtar konstatoi thjesht pamundësinë e mbështetjes tek Komitetet për të gjetur zgjidhjen e krizës shqiptare. Pas kësaj, kërkesa permanente e Komiteteve për eliminimin total të pushtetit të Berishës, u shndërrua në një kauzë vetasgjësuese për vetë ato deri sa erdhi në pushtet opozita dhe anëtarët e Komiteteve dhe aktivistë të tjerë pranë tyre fituan nga ndonjë post në shtetin e ri që nuk lindi dot.

Në këtë realitet, stanjacioni i kërkesave të studenteve, si shprehje e kembënguljës së tyre për t'i zgjidhur ato në total nga qeveria, has përditë qëndrimin statik të kryeministrit për t'u ulur në dialog. Në fakt kryeministri përballon rezistencën e studenteve për zgjidhjen e kërkesave të studenteve duke mbajtur në këmbë një taktikë kontradiktore. Ai pranon drejtësinë e 8 kërkesave të studenteve dhe është gati, siç thotë, për t'i zgjidhur ato. Por, duke iu referuar parimeve demokratike, ai i kërkon studentët për dialog dhe jo për të negociuar me ta. Kontradikta qëndron tek fakti se përderisa ai është gati për t'i zgjidhur kërkesat e studenteve, përse atëherë i kërkon për dialog? Përse nuk paraqet një platformë të vetin se si e mendon ai zgjidhjen? I fton për dialog kur e di që ata nuk i shkojnë. (Nuk kanë udhëheqje, qartësi perspektive dhe kanë frikë se “do të munden” nga bashkëbiseduesi i tyre). Nuk lejohen të shkojnë për dialog dhe ushqejnë stanjacionin gërryes për kërkesat e tyre për shkak të frikës së spektrit politik nga evoluimi politik i lëvizjës së studenteve, i të vetmës forcë që nuk kontrollohet nga krimi në çdo lloj formë të shfaqjes së tij.

Por ky stanjacion, krijon rrezikun se lëvizija aktuale studentore e cila po zhvillohet në kushtet e nevojës imediate për ndryshime radikale në sistemin politik, qeverisës e shtetëror në vend, do të degjenerojë para aleancës së qeverisë me faktorin kohë. Ajo ka rrezik të mbetet në histori si një ballafaqim dhe garë parullash dhe memesh, si një shpresë zhgënjyese që nuk zgjidhi dot as kërkesat e vet studenteve, as korrupsionin në universitete, as shndërrimin e tyre në institucione të dijës dhe të kërkimit shkencor, as në forume të mendimeve dhe ideve të lira, demokratike dhe garantuese të ardhmerisë së shoqërisë, as në reformime radikale të sistemit politik. Do të riciklojë për pak kohë të njëjtin spekter politik me po ato probleme, ose do t'u garantojë forcave të këtij spektri kohën për të bërë retushimet e duhura për të shtirë në kohë krizën e tyre të thellë.

Nga ana e vet kryeministri Rama, pranoi sfiden e studenteve. Hoqi nga pararoja e përballimit të studenteve Ministren, e cila në fakt, ndryshe nga Kryeministri, tregoi se ishte gati të përballlej me studentët në çdo formë (ajo shkoi në zëmër të grumbullimit studentor për të dialoguar me ta pavarësisht se nuk e pranuan) dhe mori përsipër personalisht çdo gjë. Memet, batutat, studiot televizive, rrjetet sociale, daljet publike, dialogun e tentuar apo të venë në dyshim. Asnjë faktor tjetër partiak apo qeverisës nuk mirret me çeshtjen. Arma e tij e vetme mbeti kërkesa për dialog. Edhe pse nuk e fsheh frikën ai tregon se ka besim se do t'ja dalë. Besimi mësa duket i buron nga pervoja e gjatë e ballafaqimeve politike të fituara, në parti, në bashki, në qeveri. Por duket që ai nuk ka parashikuar se kësaj here ka përballë, jo një forcë politike, jo kundërshtarë brenda partisë, por një forcë vitale. Në këtë kuptim Rama e shikon fitoren e tij në aleancën e interesave me opozitën të vena në rrezik nga lëvizja e studenteve. Lëvizja e cila mund të kthehet në një shpresë reale nëse del frontalisht kundër sistemit politik në terësi dhe imponon reformin total të tij. (Në këtë drejtim intelektualët duhet të ndihmojnë studentët të lenë në hije gjithë spektrin politik. Dhe kjo arrihet përmes një kauze që i intereson dhe shpreh gjithë shoqërinë).

Kjo, taktikë deligjitimiton në rolin e vet dhe opozitën, kauza e së cilës përmbledhet në synimin e pushtetit, por që është e ndërgjegjshme se nga mekatet e së

kaluarës dhe nga mungesa e një perspektive të qartë shtetërore nuk mund ta ndihmojë as lëvizja studentore.

E gjithë kjo vërtetohet nga fakti se faktori i katërt, masat e gjerë popullore, tej rinisë studentore, janë pasivë, pa pjesëmarrje dhe pa shpresë!

18.12.2018 Për gazetën TEMA



## **Nga Panajot Barka**

<http://www.bulevardionline.com/zgjidhja-e-krizes-reale-arrihet-me-fundin-e-krizes-se-sistemit-politik-dypartiak-ne-vend/>

<http://www.gsh.al/2019/03/16/zgjidhja-e-krizes-reale-arrihet-fundin-e-krizes-se-sistemit-politik-dypartiak-ne-vend/>

<https://www.facebook.com/432327753882023/posts/628847774230019/>

<http://time.ikub.al/Lajme/19-03-18-Kompleksiteti-i-krizes-politike-dhe-nje-propozim-modest-per-zgjidhje.aspx>

### **Zgjidhja e krizes reale arrihet me fundin e krizes së sistemit politik dypartiak ne vend.**

16.03.2019

Kriza e tanishme përbën një cikël të ri, të spiralës së krizave që shoqëron tranzicionin në vend. Por me densitet më të thellë dhe spekter më të gjerë. Në të duhet dalluar disa plane: - krizën ashtu siç shfaqet, thelbin real të saj dhe si përdoret ajo. Shfaqet si kërkesë për zgjidhjen e saj dhe ka promotor opoziten. Thelbi i krizës sipas Presidentit të Republikës është, kushtetues, institucional dhe parlamentar Pra, është krizë politike pozitive-opozitive; krizë e shtetit dhe institucioneve të tij, me kryesor parlamentin, shkaktuar nga forcat politike qeverisëse në emër të pushtetit; është njëkohësisht krizë e shoqërisë. Në fund të fundit është krizë e shkaktuar nga korrupsioni, krimi, trafiqet, pastrimi i parave, informaliteti i ekonomisë në strukturat e shtetit, katapultuar nga forcat politike qeverisëse, që çon drejt kaosit demokracinë dhe shoqërinë, shtetin ligjor dhe qytetarët e tij

Megjithatë, shpërthimin e krizës duhet kërkuar më shumë te dyshimi i radhës i lidhshëm opozitar se pozita nuk respekton rregullat e dakortësuara për rotacionin e pushtetit, si proces që garanton ruajtjen e sistemit politik bipartizan qeverisëse, por edhe mbulimin e aferave korruptive në kompetetive. Kështu ndodhi dhe në periudhën 1996-98, 2007-08, 2011-13, 2017. Kjo do të thotë se në thelb tensioni i shfaqur, si demonstrim krize, nuk konsiston në përpjekjen, as të pozitës e as të opozitës, aq më pak të dyjave së bashku, për të zgjidhur krizën reale. Por te përdorimi i saj në përplasjen për garantimin e marrjes apo e mbajtjes së pushtetit, prej tyre.

Cikli i ri i saj si përkeqësim dhe thellim në ekstrem të krizës diakronike në tranzicion, është pasojë e procesit ku pushteti politik përvalonte nevojën e ndërtimit të shtetit ligjor dhe demokratik. Nga ana tjetër, duke qenë se ky pushtet përdorej për pasurim dhe privilegje të pushtetarëve nëpërmjet korrupsionit dhe rritjes së kontrollit të krimit të organizuar mbi shtetin dhe shoqërinë, rotacioni qeverisëse “nëpërmjet zgjedhjeve” arrihej duke zgjedhur të keqën më të vogël, kur kjo e keqe rritej në progresion gjeometrik nga zgjedhje në zgjedhje. Me 2005 populli “harroi” Berishën e 1997 dhe i dha votën, pasi qeverisja 8vjeçare e socialisteve ishte bërë më e keqe se situata e trazirave të 1997. U vërtetua konstatimi se nëse Berisha ishte fajtor për shkatërrimin e shtetit, Nanua është më fajtor se nuk lejoi ndërtimin e tij. Në 2013 Rama ia hoqi pushtetin 8-vjeçar Berishës, pasi sistemi korruptiv dhe i kriminalizuar i instaluar prej tij kishte kaluar çdo cak. (Dhe të mos harrojmë deklaratën e Ramës se për t’ja marrë pushtetin Berishës duheshin përdorur të njëjta mjete që përdori ai për të ngritur sistemin e vet korruptiv, të cilat në vijim kërkuan pjesën në rritje në qeverisjen Rama)

Realiteti krijoi bindjen se vendi nuk ka dalë kurrë nga spirala e krizave dhe se shteti vazhdon përjetimin e 1997 me forma të tjera. Kjo spirale solli fenomene të reja, po në rritje. Përqindja e votuesve që humben besimin tek politika dhe nuk marrin pjesë në zgjedhje, përbën “partinë” më të madhe në vend me mbi 50% të votuesve. Pakënaqësia ndaj politikës të cilës i faturohen dhe pasojat e krizës së papërbalueshme në jetën e përditshme shprehet me braktisjen e vendit. Ndërkohë është rritur agresiviteti

në radhët e shoqërisë i cili kur manipulohet nga politika çon në destabilitet politik e shtetëror, ose në nacionalizëm ekstrem me pasoja të paparashikueshme.

Duhet shënuar se nuk pati kurrë tentativa për të zgjidhur krizën reale, që presupozon pastrimin e sistemit politik nga korrupsioni dhe krimi dhe nga bartësit e tyre politik, si edhe konsolidimin e shtetit ligjor e demokratik dhe të institucionëve të tij. Faktikisht, ndodh kapërcimi i çdo cikli të saj me akte jo legjitime, apo me vendime politike dhe në shkelje të ligjit dhe të kushtetutës, madje duke ruajtur në drejtim shkaktarët e krizave. Pra, duke ja faturuar të ardhmës së vendit një krizë me të thellë. Më 1991 Ramiz Alia u angazhua dhe ia arriti të ketë dorën e shtrirë mbi pluralizmin politik shqiptar. Me 1997 disa individë ringriten politikisht shtetin e renë me një akt informal (marrëveshjen e 9 marsit) duke u mbështetur tek përgjegjësi i rrenimit të tij, Sali Berisha. Me një marrëveshje po të dyshimtë, ilegjitime dhe politike u zgjidh kriza politike e 2017 (marrëveshja misterioze Basha-Rama 17 Maj 2017)

Ose, në “zgjidhjen” e krizave në vend ndërhyjnë faktorë të tretë, kryesisht të huaj, të cilët jo gjithmonë u përkasin institucioneve zyrtare ndërkombëtare dhe pothuaj asnjëherë nuk respektojnë kushtetutën dhe institucionet shtetërore. Njihet p.sh roli Sant Egidio-s në përcaktimin e rregullave të lojës qeverisëse afatgjatë midis Nanos dhe Berishës, (takimet 1992 dhe 1997). Apo roli i Soros sot në manaxhimin e lojës politike në Shqipëri midis partive qeverisëse dhe gjasëm shoqërisë civile. Duket se investimi i parë i këtyre faktorëve është ruajtja e sistemit politik dypartiak, me po ata aktorë, kuptohet si mundësi për arritjen e interesave të tyre, pavarësisht kompromentimit të tyre nga korrupsioni e krimi.

Në linjën e mospastrimit të politikës shqiptare, si instrument për zgjidhjen e krizave në vend, investohen dhe insticionet zyrtare perendimore. Zgjidhja e krizës për to është e barasvlefshme me rruajtje e stabilitetit në vend, qoftë dhe me një demokraci formale dhe të cunguar duke heshtur për kapjen e shtetit nga krimi, korrupsioni, abuzimi me ligjin etj. (Dhe qëndrimet e tanishme kanë për momentin këtë definicion)

Nuk befason as heshtja e tyre në riciklimin në politikën e vendit, të personazhëve dhe liderëve politikë të korruptuar dhe të penalizuar, dmth shkatarë të krizës. (Në historinë botërore të kompromentimit dhe kontrollit të politikanëve të ndryshëm për ushtrimin e ndikimit politik në jetën e një vendi, korruptimi i tyre me gjithëfarë formash përbën instrumentin më efektiv. Shqipëria ka një histori të gjatë dhe të hidhur në këtë drejtim, ku shpesh përplasja e interesave të huaja midis tyre ka çuar në destabilitet me kosto të lartë të brendshëm. Zhvillimet e sotshme në rajon dhe më gjerë, mungesa e një qëndrimi të unifikuar të faktorit perendimor –BE, SHBA- në krizën e tanishme shqiptare, inflitrimi i interesave të vendeve të caktuara, mbuluar shpesh me identitet fetar si dhe artikulimi i ndikimit të faktorit rus, përbëjnë indicje që duhen marrë shumë seriozisht në zhvillimet aktuale politike të brendshme të vendit).

Kriza e sotme, si vijim të spiralës së krizave në vend, demonstroi sot anë më të renda dhe më të vështira që pengojnë zgjidhjen. Në shpalosjen e vet kriza e tanishme ka për protagonist opozitën e cila me demaskimin e akteve të renda të korrupsionit shtetëror dhe krimin të organizuar, me shfaqjen e rezervave se reforma në drejtësi po shndërrohej në instrument në duart e qeverisë për përndjekjen e saj, po provokonte kufizimin nga pozita të rolit të vet. Pozita, nga ana tjetër i shteronte rrugët e reagimit dhe ndikimit opozitar. Situata krijonte tek opozita bindjen se po përjashtohej nga loja fituese e pushtetit në zgjedhjet e ardhshme lokale dhe parlamentare. Kjo do të thotë se në qëllimin strategjik të opozitës nuk evidentohet dalja nga kriza (në përgjithësi) nëpërmjet reformimit të sistemit pjesë e të cilit ajo është. Me argument krizën e thellë, të cilën ia faturon Ramës, opozita synon marrjen e pushtetit politik. Arritjen e këtij qëllimi opozita e shikon nëpërmjet një qeverie tranzicioni pa E. Ramën dhe zhvillimi i

zgjedhjeve të parakohshme. Kjo pra, nuk përbën asnjë garanci për të nxjerrë vendin nga kriza e thellë, pjesë e së cilës opozita është. Por dhe as përbën garanci për ardhjen e saj në pushtet pasi Rama, nëse pranon sfidën, pra pa qenë kryeministër, administron gjithçka që mund t'i sigurojnë dhe një fitore tjetër elektorale.

Ndërkohë mungesa e qëllimit strategjik nga opozita i ka zbehur asaj edhe perspektivën e luftës politike. Djegja e mandateve parlamentare ishte një akt i bëftë dhe erdhi si pasojë e kësaj zbehjeje, si hap për të shpëtuar kauzën opozitare pas dështimit të protestës së 16 shkurtit. Akti si i tillë pati efekte pozitive në motivimin e mbështetësve të opozitës për pjesëmarrje masive në protesta, të cilat opozita nuk i administron dot për arritjen e qëllimit të shpalur. Nga ana tjetër djegja e mandateve sigurisht që e thelloi krizën, por edhe pamundësinë për të zgjidhur atë. Në aspektin rigoroz juridik, opozita nuk mund të kthehet më në parlament, pavarësisht se këtë mund ta kërkojë edhe faktori ndërkombëtar. Nëse kjo ndodh atëherë do të kemi serish një antikap kushtetues që do të shërbëjë si investim në projeksionin e thellimit të krizave pasuese. Pra, u bë i pamundur çdo proces i rregullt dhe me moral juridik parlamentar-kushtetues për zgjidhje e krizës aktuale. Kjo është e vlefshme dhe për vetë kërkesat, ose për qëllimin strategjik opozitar. (Cili parlament do të votojë qeverinë teknike, që kërkon opozita?!!) Për opozitën është e pamundur dhe platforma e dialogut. E pamundësojnë precedenti i 17 majit 2017 dhe marrëdhëniet tejet e tensionuara me qeverinë aktuale, gjë që do të deligjimitonte politikisht opozitën para mbështetësve të vet. Rruga e mbetur për opozitën është radikalizimi i situatës, fakt që e kuptuan dhe perendimorët të cilët kërkojnë me çdo kusht pengimin e saj. (Madje duke i bërë presion deri në përjashtimin nga loja politike)

Por të njëjtën linjë, të përplasjes ekstreme, ndjek edhe opozita, e personalizuar totalisht nga Edi Rama. Në këtë duel janë ftuar për të marrë pjesë të gjitha llojet e arseneleve armesh që zotëron çdo palë. Nga ana e vet, përplasia, po funksionon si mjet për të nxjerr në selamet, si akt vetdemaskimi publik (por jo juridik), shumë nga të palarat, zullumet dhe mangësitë intelektuale të paleve qeverise.

Presioni i ushtruar nga Rama ndaj opozitës reale me referime ligjore jasht moralit politik për të krijuar një opozitë të re parlamentare, jo vetëm që e thellon krizën, por vërteton akuzat e opozitës për shitblerjen e votës. Po e kthen parlamentin nga tempull i demokracisë në tembull të imoralitetit politik dhe të pazarëve. Zbulon moralin e degraduar të politikanëve që partitë ftojnë dhe caktojnë për të përfaqësuar sovranin, si edhe rolin e parasë për blerjen akoma dhe të mandatit parlamentar. Rama tregon hapur se në këto momente më shumë ka frikë medjat e huaja se vet opozitën, ndaj ka thirrur në aleancë kohën dhe propagandën. Por të dyja janë presa që po i kthehen kundër vetës. E njëjta gjë vlen dhe për opozitën. Që do të thotë se kriza e tanishme përbën një rast të mirë për eliminimin e shkaktarëve të tyre që janë aktorët e politikës së vjetër. Por ky është një proces i vështirë. Kërkon sakrifica, angazhim shoqëror dhe intelektual, mbështetje të faktorit ndërkombëtar. Deri me sot sistemi dypartiak në aleancë me krimin e organizuar kanë dalë fitimtarë!

Fund Për gazetën Tema. 16.03.2019

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gsh.al/2019/04/07/vonesa-e-perendimoreve-ne-tirane-dhe-nervozizmi-dhe-frika-e-poltikaneve-tane/>

<http://time.ikub.al/Lajme/19-04-07-Vonesa-e-perendimoreve-ne-Tirane-dhe-nervozizmi-dhe-frika-e-poltikaneve-tane.aspx>

<http://fax.al/news/20119564/ndryshimi-i-sistemit-s-eshte-nje-sport-i-lehte>

<http://fax.al/news/20107462/strategji-okulte-nga-opozita-ish-deputeti-i-pd-se-tregon-pse-do-zhvillohet-pasdite-protesta-e-madhe>

### **Vonesa e perendimoreve në Tirane dhe nervozizmi dhe frika e politikanëve tanë.**

07.04.2019.

Perendimorët nuk po duken në Tiranë dhe qeveria me opoziten i presin. I presin që t'i pajtojnë në ciklin e ri të spirales së krizave në vend. I presin për të rregulluar raportet e tyre me pushtetin. Jo për të zgjidhur krizën. Kriza është për ta derrivat, ose mjet për tek raportet e tyre me pushtetin. Dhe vonesa e Perendimorëve i nervozon shumë politikanët tanë. Për vonesën e tyre nuk mund të pranohet teza se “u lodhen me ne”. Ose, se “u mërziten” nga që për herë të parë në Tiranë ka aq agresivitet, sidomos nga opozita, ndaj faktorit perendimor të akredituar në Shqipëri.

Perendimorët vonojnë të vijnë në Tiranë se qendrimet e tyre ndaj krizës së partive politike në vend kanë një ndryshim nga herët e tjera. Zgjidhjet kësaj here nuk synojnë vetëm stabilitetin, si qëllim në vetevete, sa për të “kapercyer” krizën e radhës. Dmth, një stabilitet duke ricikluar shkaktarët, me definicion një krizë të re më të rendë. Perendimorët mendojnë për një zgjidhje që t'u jap fund krizave që prodhon sistemi politik i partive qeverisëse. Dhe kjo kërkon kohën e vet. Të arrihet precitimi i pakthyeshem i situatës politike në vend. Drejt një zgjidhjeje, të natyrshme, por edhe me perspektivën e qartë dhe aktorët që do ta marrin përsipër këtë barë. Dhe pozita dhe opozita i kanë hyrë kësaj rruge pavarësisht nga qëllimet ndryshe të tyre. (Pozita, duke folur në emër të votës së popullit por duke mos parë situatën në zgrip në vend, ecën në rrugën e mbajtjes së pushtetit me çdo mjet, deri në autokraci. Opozita, e rrezuar nga pushteti për shkaqe të ngjshme me situatën e sotme në vend, kërkon të marrë pushtetin pa patur asnjë ide, plan dhe perspektivë për të shpetuar vendin) Duket se kësaj here Perendimorët e kanë seriozisht me këtë sistem, i cili ka marrë peng shtetin dhe funksionimin e tij, shoqërinë dhe vlerat e saj, demokracinë dhe parimet e saj. Ndaj politikanët tanë bashkë me nervozizmin nuk fshehin as frikën.

Ndhodh kjo se pozita dhe opozita, pavarësisht se Perendimorët flasin pak dhe parimisht, e ndjejnë shumë fortë praninë e Perendimorëve në çdo çapitje politike të tyre. Njohin dhe rolin determinues të Perendimit në hapat që ata hedhin. Njohin se Perendimorët, në “mefshtesinë” e treguar, kanë në tavolinë zgjidhjet për krizën. Ndaj dhe politika jonë harxhon shumë energji që të jete e pelqyeshme për Perendimorët.

Perendimorët e njohin mirë sistemin e degraduar politik të partive qeverisëse dhe aleateve të tyre, të cilët, pavarësisht degradimit, nuk heqin dorë për asnjë arsye nga status quo-ja e tyre në raport me pushtetin. Shpesh, vetë Perendimorët kanë lëjuar mekatet e tyre. Dhe e kanë bërë për qëllimet e tyre, apo për t'i patur ato litar në fyt të lidrshpit të këtij sistemi mekatesh. Kështu që partitë tona politike të pushtetit janë mësuar që këtë raport ua garantojnë Perendimorët. Mjaft që partitë tona të “shpallin” krizën e radhës. Por Perendimorët kësaj here vonojnë dhe lidrshpi i partive tona qeverisëse është i shqetësuar. Vonesat u prishin shumë punë. Lidrshpi e ndjen shenjestrën këmbëngulese të Perendimorëve mbi vete. Ndaj dhe duan t'i detyrojnë Perendimorët të ndërmjetësojë sa më parë. U imponohen duke demonstruar se jane të

pazevendësueshëm, duke kërcenuar me destabilitet politik ne vend dhe në rajon. Kërkojnë t'u imponohen me distancim skajor nga pika e konvergimit që është dialogu. Pavarësisht se ato i kanë asgjësuar dialogut çdo bazë ligjore. Pavarësisht se e dinë që dialog xhentelmentesh dhe zgjidhje politike mbi ligjin nuk ka më!

Distancimin ashpersues nga dialogu Partitë po e kthejnë në mjet për t'u treguar Perendimorëve forcën vitale të vetës si epersi ndaj kundërshtarit. Duke arritur madje deri në bindje për nevojën e eliminimit praktik të kundërshtarit opozitar politik. Por hapin menjëherë llagëme të fshehta komunikimi midis tyre sa herë u duhet të mbysin çdo krijesë që mbart frymën perendimore, si me rastin e studenteve, apo ta fusin nën kontrollin e tyre, si sistemin e drejtësisë, apo dhe të nxitojë secila për vete për të marrë nën sjetull "krijimin" e çdo force të re, ose "opoziten" se re.(!)

Distancimin nga dialogu e përdorin dhe për ruajtjen e supremacisë mbi njera tjetrën, me pikë referimi Perendimorët. Duke njetosur tek Perendimorët përkushtimin e kundërshtarit ndaj tyre! Opozita shpalos përfaqimin e qeverisë me krimin e organizuar, korrupsionin, paratë e pista, cenimin e demokracisë dhe shtetit ligjor, akte këto që e distancojnë nga parimet e Perendimit. Qeveria shpalos "flirtin" e opozitës me Rusinë, si rrezik për interesat e Perendimit në Ballkan. (!)

Por Perendimorët vonojnë ndërmjetësimin. Madje, duke shtuar përditë dozën e intiferentizmit. Si zakonisht, në shërbim të strategjisë së tyre, Perendimorët kanë zgjedhur për aleatë taktik, kohën dhe gjakftohtësinë diplomatike. Koha kontribuon në menyrë të pamëshirshme vetdemaskimin dhe defaktorizimin publik të partive politike shqiptare. Përditë, ato nxjerrin në shesh të palarat e tyre makabre. Ato të palara që deri tash përbënin garancinë për ruajtjen e status quos midis veti. Ndoshta vjelin pjesë shumë të vogla, por të mjaftueshme për humbjen e besueshmerisë në popull. Koha u duhet Perendimorëve për realizimin e projekteve të zgjidhjes së krizës pa dhunë dhe destabilitet. Gjakftohtësia diplomatike siguron mos lejimin e përsëritjes së gabimit me të njëjtët faktorë.

Perendimorët nuk vonojnë ndërmjetësimin për shkak se nuk kanë një qëndrim të unifikuar në detaje, pasi lexohet qartë unifikimi i qëndrimit strategjik të tyre. Perendimorët si gjithmonë për një problem kanë në tavolinë disa variante zgjidhjeje. Presupozojnë krijimin e vektorit të përfutur nga rezultatja e forcave vepruese në politikën tonë në respekt të parimeve demokratike dhe të shtetit ligjor. Egzistuese apo ato të dizenuara rishtazi. Evidente është se kërkohet ndryshimi. Liderhipi aktual gjithkrahesh nuk përbën asnjë garanci për ndryshimin e kërkuar. Se janë fajtorë, të cilët, në vend të fundit të një tranzicionit drejt demokracisë dhe shtetit ligjor, sollën një sistem krizash pa fund! Por për shkak të forcës së zotëruar me burim pushtetin, nuk është e lehtë të dalin nga sistemi. Pra, kriza në vend është diçaka me shumë se një nyje Gordiane dhe Demokleu nuk ka jetuar në kohë demokracie, aq me tepër moderne!

Në këtë kuptim Shqipëria me dashje ose pa dashje po hyn në një fazë kalimtare të demokracisë dhe shtetit ligjor. Fazë kalimtare do të thotë kalim nga një stad më i ulët në një stad më të lartë. Kushtet janë stërpjekur dhe kjo përbën rrezik. Kështu që garanti i vetëm për arritjen e suksesit janë Perendimorët! Për aq kohë sa edhe interesat e tyre përputhen me ato të popullit shqiptar.

Për fatet e këtij vendi gjithmonë kanë vendosur të Medhënjtë e Botës. Faktori i brendshëm ishte në rolin perunjës ndaj tyre deri në ngjitjen në karrigën e pushtetit. Më pas sillej sikur ajo karrige ishte qendra e Botës. Dhe gjenë e parë që i duhet të bente ishte të mendonte për vete, të çmononte e shkatërronte vlerat e paraardhësve si edhe kundërshtarët që mund t'i rrezikonin karrigën. Dhe me këto mendje vendi shkonte nga kriza në krizë.

FUND Për gazetën TEMA 07.04 2019

## **Nga Panajot Barka.**

<https://www.gazetatema.net/2019/05/05/heqja-e-tabelave-dygyjeheshe-ne-bashkine-finiq-akt-paprecedent-ne-70-vjetorin-e-keshillit-te-europes/>

<http://www.gsh.al/2019/05/05/heqja-e-tabelave-dygyjeheshe-ne-bashkine-finiq-akt-paprecedent-ne-70-vjetorin-e-keshillit-te-evropes/>

<http://time.ikub.al/Lajme/19-05-06-Heqja-e-tabelave-dygyjeheshe-ne-Bashkine-Finiq-akt-paprecedent-ne-70-vjetorin-e-Keshillit-te.aspx>

<https://sh.time.mk/c/62407b0b3a/finiq-dy-tabela-ne-vend-te-nje-kryebashkiaku-nje-ne-shqip-nje-ne-greqisht-arrsh-i-vendos-gjate-dites.html>

<http://fax.al/news/20439540/heqja-e-tabelave-dygyjeheshe-ne-bashkine-finiq-akt-paprecedent-ne-70-vjetorin-e-keshillit-te-europes>

<https://etleboro.org/g/d0d9186385c4a840216d6466b26e991asq/heqja-e-tabelave-dygyjuh%C3%ABshe-n%C3%AB-bashkin%C3%AB-finiq-akt-paprecedent-n%C3%AB-70-vjetorin-e-k%C3%ABshillit-t%C3%AB-europ%C3%ABs>

## **Heqja e tabelave dygyjeheshe në Bashkinë Finiq, akt paprecedent ne 70 vjetorin e Këshillit të Evropës.**

05.05.2019

Shmangim me qellim dhe me vullnet cilesimet “akt i mirëfillt politik me ngjyrimet nacionaliste” aksionin (operacionin) natës së ditës së shtunë, të Autoritetit Rrugor të suportuar nga forca të shumta policore, për të hequr me dhunë 35 tabelat treguese dygyjeheshe në fshatrat e Minoritetit Etnik Grek të bashkisë Finiq te prefekturës së Vlorës.

Por, fatkeqësisht për frymëzuesit dhe zbatuesit e këtij aksioni, operacioni u ndërmor ditën e 70vjetorit të themelimit të Këshillit të Evropës, anëtar i vonuar i të cilit është edhe Shqipëria. Në këtë kuptim ky aksion shkeli rendë frymën e këtij instrumenti themelor politik të Bashkimit Evropian në mbrojtje të drejtave të njeriut, aktet ligjore të këtij Këshilli të adoptuara nga vendi ynë me efekt ligjor të brenshëm, por edhe aktet ligjore të brendshme të vendit, në frymën e këtij instrumenti politik evropian, të cilësuar madje si pasaporta e Shqipërisë në rrugëtimin e saj për Evropën e Bashkuar. Fjala është për ligjin 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Ku konsistojnë këto shkelje.

Ta zemë për një moment se Autoriteti Rrugor është në të drejtën e tij. Por veprimet e kryera prej tij provokojnë disa pyetje që i kompromentojnë këto veprime. Përse zgjodhi mesnatën e një dite të shtunë për të ndërmarrë një operacion të tillë?! Përse i duheshin kaq shume forca policore në këtë ndërmarrje?! Përse (dhe kush) ndërpriste energjinë elektrike sipas zonave ku levizte ekipi civilopolicor i ARRSH për të prerë tabelat me troho që ushqeheshin me gjenberatorë?!

Ato tabela kishin një autor, Bashkinë e Finiqit. Përse ARRSH-ja nuk u mor me këtë autoritet bashkiak, por me tabelat?!

Nëse Bashkia Finiq shkeli ligjin, ajo është një insticion shtetëror dhe institucionet shtetërore në marrëdhëniet midis tyre kanë një kod mirëkuptimi, bashkëpunimi dhe luajaliteti në shërbim të ruajtjes së integritetit dhe autoritetit të shtetit dhe të vetin. Dhe nëse edhe në këtë fushë nuk gjendet gjuha e përbashkët, atëherë egzistojnë mekanizma të tjerë shtetërorë që i zgjidhin mosmarrëveshjet midis enteve shtetërore. Përse, atëherë ARRSH nuk ndoqi këto dy rrugë, por kërkoi ta zgjidhte “të drejtën e vet” duke përdorur mjete dhe menyra si ndaj një keqbërësi të rrezikshëm për shoqërinë dhe për shtetin?!

Nëse marrim për bazë pretendimin se u shkel ligji (!) veprimi i ARRSH-së nuk justifikohet në realitetin shqiptar të respektimit të ligjit nga vet shteti. Kemi këtu

parasysh faktet të tilla se si shteti nxjerr ligje për të legjitimuar shkelësit e ligjit dhe këtë e konsideron fitore, psh për legalizimin e ndërtimeve pa leje. Apo shkeljet e ligjit nga vet ARRSH ka bërë që akset rrugore në Shqipëri të kthehen në gijotona që marrin përditë jetë njerëzish. Apo shteti vetë lëjon pastrimin e parave duke abuzuar me ligjin, apo në këtë shtet trafikohen vota, debutetë, parti, diploma.... Dhe shteti akuzohet nga insticionet perendimore për mosvperim, ndaj korrupsionit, krimin të organizuar, evazionit fiskal... Këto 35 tabela të vendosura në zbatim të paragrafit 3 të nenit 15 të ligjit 96/2017 “Për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” qënkas shkelje kaq e rëndë dhe e rrezikshme sa u mobilizua shteti me më shumë forca dhe me më shumë seriozisht se sa për të arrësuar kriminelë që grabisin miliona evro të mbrojtura nga shteti. (!!?)

ARRSH-ja nuk na thotë ku qëndron rrezikshmeria shtetërore kaq e lartë e veprimit të Bashkisë së Finiqit. Por, po të vihet re, në opinionin publik konsumohet me inflacion të tepruar pretendimi i këtij autoriteti se nuk u respektua siraja e gjuhëve, pra u shkrua gjuha greke e para dhe me pas shqipja (!) por nuk na thotë cili ligj e thotë këtë dhe si konkretisht, apo nga buron e drejta e tij në këtë drejtim. Paragrafi 3 i nenit 15 të ligjit 96/2017 të përmendur më lart, thotë vetëm që krahas gjuhës zyrtare të përdorët dhe gjuha minoritare!!

Kuptohet, se brenda mirëkuptimit, duke pritur edhe disa orë për kthimin nga jashtë shtetit të kryetarit të Bashkisë edhe ky problem mund të zgjidhej. Por strukturat vepruese të ARRSH në këtë operacion, (përdoret nga vetë ky ent shtetëror një term policor), i zhduken këto tabela duke transmetuar mesazhin se tabela me mbishkrime në gjuhën greke nuk do të vendosen këtu pavarësisht nga ligji !!!

Po, mund të akuzohem se kjo nuk qëndron. Analiza ime është megjithatë shumë kokëforte. Kështu në Dropull, ku vet enti përgjegjës shtetëror u detyrua dhe vendosi sipas parametrave të tij tabela treguese dygjuhëshe në të gjithë aksin rrugor nga Derviciani në Kakavi, të nësermen dhe në vijim deri më sot, për gati 20 vjet mbi mbishkrimet në gjuhën greke të ketyre tabelave, veprojnë keqbërës që i munxorosin me bojë të zezë, i shkulin dhe dalin me to në video poshteruese për minoritetin grek, shkruajnë parulla fyese dhe nacionaliste etj. Askush nuk mban përgjegjësi, asnjë nuk kapet, askush nuk denohet, asnjë nuk merr përsipër (është detyrë e ARRSH-së) t'i ndreq, t'i rregulojë, t'i zevendosojë!! Besoj se komentet për këto akte, në rastin e Bashkisë së Finiqit janë të tepërta. Dhe fatkeqësisht opinionin publik në rastin më të mirë hesht!

Panajot Barka Për gazetën TemA 05.05.2019

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.gsh.al/2019/06/09/vendimi-presidentit-dhe-qendrimi-kryeministrit-nderlikojne-dhe-tellojne-krizen-ne-vend/>

### **Vendimi i presidentit dhe qendrimi i kryeministrit ndërlikojnë dhe tellojnë krizën në vend**

09.06.2019

Vendimi i Presidentit të Republikës Ilir Meta për të anuluar zgjedhjet për pushtetin vendor të 30 qershorit, kuptohet se përbën një kthesë të paparashikuar (edhe pse të paralajmëruar) dhe të paprecedent për zhvillimet politike në krizë të thellë në vend.

Më së shumti vendimi i presidentit u komentua si një akt që shpëtoi vendin nga skalioni i destabilizimit të vendit me datë të limituar, atë të 30 qershorit. Por, pati edhe komente se ai përbën një shkelje të kushtetutës dhe se Presidenti mbajti anën e opozitës që do të thotës se me këtë vendim Presidenti Meta mund të rrezikojë edhe postin e tij, (fakt i paralajmëruar po prej tij).

Në fakt vendimi i Presidentit për anulimin e zgjedhjeve vendore e komplikon krizën në vend dhe jo vetëm se në të u përfshi në menyrë shumë aktive institucioni i Presidentit të Republikës. Nuk lidhet kjo as me faktin se ndodh për herë të parë dhe në kushtet kur nuk ka përcaktime të qarta ligjore dhe kushtetuese për marrjen e tij. Por se vendimi i Metës mund të përfshijë në krizën e thellë politike në vend edhe institucionin e Presidentit, gjë që, në aspektin politik dhe institucional, vendi do të vihet në një situatë më të rëndë se më 1997. Parlamenti përjeton paralizë dhe vendimet e tij vihen lehtësisht në dyshim, gjykata kushtetuese nuk funksionon, qeveria është në pikëpyetje. (Mos harrojmë se më 1997 pikëmbështetja për të ringritur shtetin e shkatërruar u bë Presidenti i Republikës, personi ndaj të cilit ishte përmbledhur gjithë urrejtja popullore.) Deklarata dhe paralajmërimi i Ramës dje në Burel, se Meta e shkrojtji fatin e tin dhe se nuk e ka vendin më në atë zyrë, e vërteton më së miri këtë skenar.

Ajo që më siguri mund të thuhet është se Meta me këtë vendim spostoi totalisht në fushën e Kryeministrit topin e përgjegjësive për vijimin e krizës. Deklarata e tij e perseritur në harkun kohor të disa orëve se zgjedhjet do të zhvillohen normalisht më 30 qershor, nuk lidhet thjesht me vendosmerinë e tij si person (dhe kjo në këto momente ka rëndësinë e vet), por se tani përgjegjësitë për vazhdimin, me sakt për thellimin e krizës, do t'i faturohen kryeministrit. Aq me tëpër kur gjithnjë e më shumë rreth tij po shtohen akuzat dhe skandalet.

Ky zhvillim, denoncim skandalesh, do të fanatizojë dhe më shumë njerëzit e inkriminuar të cilët ose pasurimin e tyre e lidhin me pushtetin ose duan të mbrohen prej tij. Në këtë kuptim ata jo vetëm do të shtojnë presionin ndaj Ramës për të mos “u dorëzuar”, por do të gjejnë mundësi “të shkrihen” me masën popullore “socialiste”, masë tek e cila vetë Rama po përndeç dhe më fanatizmin, me argumentin se duan t’u marrin pushtetin në menyrë poshteruese. Kjo do të thotë se kjo masë, pavarësisht rezervave të shumta ndaj Ramës, do të rreshtohen në krah të tij në mbrojtje “të pushtetit të tyre të rrezikuar” dhe me mjete poshtëruese, “nga ata”. Kjo do të thotë se Rama, qëndrimet politike të të cilit (personale por si kryeministër) e kanë çuar atë shumë larg aq sa nuk lejojnë kthimin e tij pas në tavolinën e dialogut dhe të konsensusit, që nga ky moment po kthehet në udhëheqës masash me arsyen e vetme mbrojtjen e pushtetit “nga ata” dhe me çdo mjet. Kushtet e opozitës ndaj tij për dorëheqjen pa kushte, e bën dhe më të konturuar këtë tablo.

Duke parë në këtë pasqyrë realitetin e opozitës mund të thuhet hapur se vendimi i Presidentit vetëm sa e shpëtoi atë (për momentin) nga rruga e ballafaqimit ekstrem me



qeverisjen dhe nga frika e dilemës për mundësinë e prishjes së zgjedhjeve të 30 qershorit, të cilat megjithatë, pa opozitën dhe me destruktivitetin e deklaruar prej saj, do të ishin të pavlefshme dhe me pasoja të rënda në perspektivën e vendit.

Nga ana tjetër opozita e ka dhe më të rëndë problemin e raportit të vet me pasuesit e saj. Mijrat e tyre shkojnë në Tiranë pas premtimit të liderit të tyre se dita e protestës së radhës do të jetë dita e fundit për Ramën dhe se nëse ai nuk do të ik me hir ata do ta rrezojnë me dhunë. Ndërkohë që në ditën e çdo proteste ndodhte e kundërta. Vetë udhëheqja e opozitës u kërkonte protestuesve të kundërtën e premtimeve të mëparshme. Lulezim Basha nga ana tjetër në fund të çdo proteste nuk i shmanget dot nevojës për të falënderuar protestuesit për ardhjen dhe qëndrësën e tyre në protestë, në atë frymë se sakrifica e tyre ndodh për pushtetin e tij. Kjo ka bërë që në radhët e opozitës të forcohen radhët e mosbindjes ndaj udhëheqjes së vet opozitës.

Lë të mos harrojmë se dhe në strukturën sociale të pasuesve të opozitës ka dy grupime të rëndësishme. Janë të urriturit për pushtet që e shikojnë atë si mjet pasurimi dhe njerëzit që vuajnë për bukën e gojës, duan punë dhe shtet ligjor, apo janë kundërshtarë të qeverisë për bindje politike. Kuptohet që unifikimi i kërkesave në kampin opozitar është me i thjeshtë.

Nga ana tjetër pas “fitorës” së parë “të arritur” me vendimin e Metës, opozita nuk tregon motivimin për lëvizjen e metejshme politike. Dihet se në politikë mungesa e hapit pasues të veprimtimit apo të perspektivës politike, aq më tepër në momente krizash kaq të thella, është e barasvlefshme ose me paralizimin e aksionit opozitar, ose me orientimin e verbër të saj që do të thotë dhunë dhe përplasje.

Në planin opozitar flitet tani se Ramës i është ofruar çasti i zgjidhjes institucionale të krizës. Në fakt flitet për zgjidhje politike, dialog partiak dhe jo zgjidhje institucionale, pasi as rikthimi i opozitës reale në parlament është institucionalisht i mundur, për pasojë as reforma zgjedhore është e mundur dhe as pjesëmarrja e opozitës në zgjedhje është e mundur. Dialogu politik me derivat një kompromis për zgjidhjen e krizës do të thotë vijimi i saj në forma të tjera më të thella dhe më afatgjata. Por as dialogu nuk është i mundur se opozita, më shumë se pozita, ka shkuar aq larg në kërkesat e saj ndaj qeverisë sa që çdo kthim prapa, vë në pikëpyetje serioze legjitimitetin e moralit të vet politik dhe besimin opozitar. Pra, nuk lejojnë kthimin e opozitës në tavolinë dialogu qoftë edhe formalisht. Kjo do të thotë se kriza është thelluar, është ndërlikuar dhe po kthehet në rrezik për shtetin dhe shoqërinë.

Faktori ndërkombëtar duket se nuk mirret seriozisht me krizën në vend. Ndodh kjo edhe kur konstatohet se po vihet në rrezik dhe ruajtja e stabilitetit në vend. Dhe ky “intiferentizëm” nuk lidhet aq me faktin se tek faktori ndërkombëtar nuk ka një qëndrim të unifikuar, as me faktin se zhvillimet postelektorale në BE, nuk lejojnë kohën e mjaftueshme dhe aktivizimin e instrumentave të duhuara. Por me shumë me faktin se ata kuptojnë se ato që opozita thotë për qeverinë janë të drejta dhe e kundërta. Pra bëhet fjalë për një ekuacion me zgjidhje shumë të vështira dhe gati pa asnjë përvojë fikse, pavarësisht se mbi këtë bazë po mbarset konflikti si përshkallëzim në terren të krizës politike në vend, duke lenë pas instrumentat paqësore politike.

Fund për gazetën TEMA 09.06.2019

Home / Aktualitet / Cikli i ri "i rrezikut helen" për Shqipërinë dhe zhvillimet e brendshme politike dhe në rajon

## Cikli i ri "i rrezikut helen" për Shqipërinë dhe zhvillimet e brendshme politike dhe në rajon

Posted on 2 Shtator, 2020 17:55 by A in Aktualitet, Blogu Tema with 31 Comments



**Nga Panajot Barka**

Ishte e pritshme që vendimi i qeverisë greke për zgjerimin e ujrave territoriale të Greqisë në detin Jon nga 6 në 12 milje, të ngjallte interes në opinionin publik shqiptar. Por kursesi, nuk mund të pritej një riciklim në ekstrem të përpjekjes për manipulimin e tij, vetëm nëpërmjet retorikës bosh, dizinformimit e abuzimit. Vetëm nëpërmjet dhe në funksion të

ndjesisë antihelene që qarqe të njohura "akademiko-mediatike" por edhe politike në vend, mundohen t'i imponojnë opinionit shqiptar, në emër të nacionalizmit, të përfitimit të brendshëm politik dhe në interes të të tretëve.

Mjedisi i këtij cikli reagimesh, më mirë se çdo cikël të shkuar, nxori më në pah origjinën strukturore të tij, si edhe papërgjeshmerinë kulmore në marrëdhëniet me fqinjët .... (Në rastin "e rrezikut helen" promovohet si garant i sovranitetit kombëtar, populli dhe jo shteti dhe strukturat e tij...!!!)

**Nga Panajot Barka**

### Cikli i ri "i rrezikut helen" për detin dhe zhvillimet e brendshme politike dhe në rajon

02.09.2020

Ishte e pritshme që vendimi i qeverisë greke për zgjerimin e ujrave territoriale të Greqisë në detin Jon nga 6 në 12 milje, të ngjallte interes në opinionin publik shqiptar. Por kursesi, nuk mund të pritej një riciklim në ekstrem të përpjekjes për manipulimin e tij, vetëm nëpërmjet retorikës bosh, dizinformimit e abuzimit. Vetëm nëpërmjet dhe në funksion të ndjesisë antihelene që qarqe të njohura "akademiko-mediatike" por edhe politike në vend, mundohen t'i imponojnë opinionit shqiptar, në emër të nacionalizmit, të përfitimit të brendshëm politik dhe në interes të të tretëve.

Mjedisi i këtij cikli reagimesh, më mirë se çdo cikël të shkuar, nxori më në pah origjinën strukturore të tij, si edhe papërgjeshmerinë kulmore në marrëdhëniet me fqinjët .... (Në rastin "e rrezikut helen" promovohet si garant i sovranitetit kombëtar, populli dhe jo shteti dhe strukturat e tij...!!!)

**ABUZIMI DHE QELLIMI**

**Së pari**, zgjerimi i ujrave territoriale nga ana e Greqisë është e drejtë ekskluzive e saj, ashtu si e çdo vendi tjetër sovran, që rrjedh nga e drejta ndërkombëtare, UNCLOS-82,

Shqipëria bëri zgjerimin e ujrave të saj territoriale, nga 6 në 12 milje, që para viteve 90', madje pa njoftuar fare fqinjët. (Greqinë, Italinë, ish Jugosllavinë) (!!!)

**Së dyti**, qëllimisht, ngatërrohet koncepti dhe praktika e ujrave territoriale (Në këtë rast të Greqisë), me hapësirën e përbashkët të Zonave Ekskluzive Ekonomike detare midis dy vendeve. Gjeografikisht, e para ka të bëjë me hapësirën detare në perëndim të Korfuzit. Pra nuk ka asnjë lidhje me asnjë segment detar të Shqipërisë. Ndërsa realiteti i dytë, ka të bëjë me hapësirën detare midis brigjeve joniane të Shqipërisë dhe Greqisë, në kanalën e Korfuzit, (ana lindore e tij për Greqinë dhe kufiri kontinental i shtetit shqiptar). Kuptohet që vetëm për rastin e dytë kërkohen marrëveshje dypaleshe. Midis dy vendeve, pavarësisht nga pericepitë, procesi i negociimit për një marrëveshje të re të këtij deti, (pas asaj të 2009ës) është në fuqi dhe pritet të vijojë në bazë të të gjitha akteve ndërkombëtare. Ndërkohë askush nuk ka të drejtë as ta paragjykojë, as ta vë në dyshim, as të përpiqet ta manipulojë për interesa të tjera.

**Së treti**, motivimi “i reaksionit” ngrihet mbi të njëjtën bazë: - pretendimin e “rrezikut helen”, si shprehje e integritetit të nacionalizmit shqiptar, pavarësisht se sa iracional, i pabazë, dhe virtual është ky rrezik dhe çfarë e vërtete duan të fshehin kultivuesit e tij. Në rastin konkret po bëhen më të dukshme interesat e faktorit të tretë, për të cilat janë thirrur në skenë të njëjta qarqe medjatiko-politike shqiptare. Nuk synohet thjeshtë që në kushtet e tensioneve midis Greqisë dhe Turqisë të mbahet larg çdo mundësi afrimi e bashkëpunimi midis Tiranës dhe Athinës. (Intensiteti agresiv në rritje dhe kreh i pabazuar i reagimit të tanishëm në Shqipëri me “shkak” deklaratën mëse legjitime të qeverisë greke, duket se do t'i bëjë të vështira inisiativat komunikuese dhe bashkëpunuese me Tiranën të ndërmarra dhe kësaj here, ashtu si historikisht, nga Athina!). Por lëxohen qëllime më konkrete. Në interesat e Shqipërisë me Greqinë të krijohen precedentë të ngjashme me ato të pretenduara nga Turqia në raport me Greqinë në Mesdheun Lindor dhe Egje. (!!)

U vërtetua me pohime krenarie të drejtpërdrejta se prapa “zbulimeve” të faktorëve shqiptarë të 2010ës për “shitje interesash kombëtare” në marrëveshjen e detit të 2009-ës me Greqinë dhe materialit për Gj. Kushtetuese të PS-së për rezimin e saj, ishte dora e eksperteve ushtarakë turq. U vërtetua dhe qëllimi: Kërkohej që ishujt e vegjel Grekë pranë Korfuzit të mos kishin influencë detare të barabartë me kufirin kontinental. (Të njëjtën gjë që kërkon dhe Turqia ndaj Greqisë në Egje dhe Mesdheun Lindor).

Tani të njëjtët autorë flamurbajtës të 2010-ës (të ngritur medjatikisht në pjedestal heroit) na zbulojnë se statusi i përkatësisë shtetërore të ishujve të vegjel në veriperëndim të Korfuzit duhet të vihen në dyshim, se, pretendojnë ata, më shumë i takojnë Shqipërisë se sa Greqisë! (Pra, synohet krijimi i një precedenti të ngjashëm me ishullin grek Kastellorizo në skaj të detit Egje!). Ndërkohë, duke abuzuar me statusin e heroit medjatik, ata kërkojnë imponimin e vasalitetit të Greqisë ndaj Shqipërisë për ujrën territoriale greke. E dinë se nuk kanë asnjë të drejtë, por njëkohësisht e dinë se opinioni publik do t'i konsumoj “të vërtetat” e tyre të paverifikueshme, mjaft që lidhen me “rrezikun helen”.

Do të ishte gabim, sidomos sot, të mirrje përsipër, qoftë edhe me shfaqje mendimi, orientimin që duhet të kenë marrëdhëniet e Shqipërisë me Turqinë. Por besoj se është e domosdoshme të theksosh se do të jetë gabim nëse për interesat e Turqisë, Tirana do të sakrifikojë interesat me Greqinë. Kjo do të ishte sot gabim me kosto të lartë për interesat globale të Shqipërisë (!!)

Për ta kuptuar besoj se mjafton të mirret në konsideratë qëndrimi i BE-së, i SHBA-së dhe faktorit tjetër të rëndësishëm ndërkombëtar e fqinjësor i Shqipërisë, në tensionin Greqi-Turqi në M. Lindor.

**MITI I RREME I RREZIKUT HELENE**

Në këtë kuadër, nuk mund të mos shtohet shqetësimi që prodhon miti i rrëmë i anihelenizmit si mundësi efektive për të gjallëruar nacionalizmin shqiptar, sidomos për konsum të brendshëm. Kjo nuk është e dëmshme vetëm se të çon në mendësi të fundit të shekullit të 19të, por se këto mendësi shfaqen si piksynime etnike të palotësuar, që kanë për bazë realitete të krijuara në kuadër të pushtimeve të Perandorisë Otomane në rajon dhe lëxohen si pjesë e dogmave të reja që Turqia kërkon të krijojë në realitetet e sotme Ballkanike dhe në Mesdhe.

Shqipëria është vend fqinjë me Greqinë, prej të cilës ka marrë kulturë, gjuhë, mitologji, folklor, traditë, që përbëjnë edhe sot vlera aktive perendimore, kulturore e turistike. Për këto realitete duhej të shquhej vlera e mirënjohjes, e krenarisë dhe e fatit të madh për këtë fqinjësi. Ashtu siç bën Italia për kulturën grekoromake, apo vendet e tjera perendimore për kulturën greke.

Është e vështirë të kuptohet dhe të interpretohet energjia e harxhuar nga faktori shqiptar për të bërë gjënë më të pamundur, të shkulë nga vetja helenizmin, ose t'ja mohojë si trashëgimi popullit grek, si një mundësi përvetësimi prej tij, ose të vendos vetën në korsinë pararendëse të kulturës greke. Dhe ky proces, i mbështetur shpesh nga struktura shtetërore të kualifikuara, përndez antihelenizmin, që aktualizohet në politikën e ditës dhe kanalizohet në plazmimin e idesë dhe platformës kombëtare. Mekanizmi funksionon në bazë të intokrinimit të faktorit shqiptar, pa marrë parasysh firon e madhe në kredibilitetin akademik e shkencor të qasjes së historisë shqiptare nga faktori akademik perendimor.

#### ABUZIMI ANTIHELENE PER ABUZIM POLITIK TE DITES

Por ky tension ka marrë çuditërisht një dimesion të mbrehtë në zhvillimet politike të brendshme.

Ndryshe nga hërët e tjera që kryeministri Rama rrembënte flamurin e antihelenizmit, kësaj here ai u miqësua me asnjësinë e fshehur pas së drejtës juridike ndërkombëtare të Greqisë për zgjerimin e ujrave të veta trritoriale. Ndoshta ia imponoi këtë qëndrim përgjegjësia e madhe politike, që kërkon prej Shqipërisë të mos mplikset hapur në krah të njerës palë (Turqisë) në tensionin e Mesdheut Lindor. Por nuk përjashtohet dhe mundësia që Rama, ashtu si paraardhësit e tij, të ketë vlerësuar rolin e Greqisë në përcaktimin e fituesit zgjedhor në Shqipëri dhe të pranojë aleancën me të. Kjo provokoi merinë e kundërshtarëve të tij politikë, të cilët po shfaqen me antihelenë se Rama i dikurshëm dhe harrojnë, në emër “të sovranitetit kombëtar” veprimet e ngjashme të tyre.

Ndërkohë, Rama me qëndrimet e veta ushqen “zjarrin e ndezur”, zjarr të cilin ai mund të shfrytëzojë nëser për të pretenduar rolin e përcaktuesit të rregullave të lojës në bisedimet me Greqinë për kufirin e Zonës Ekskluzive Ekonomike midis dy vendeve. Për këtë ai më siguri do të përdorë si argument “pamundësinë për të anashkuar reagimin nationalist” antihelen të opinionit publik dhe faktorit politik. Njëkohësisht ai i ka kthyer paraprakisht përgjigje negative Athinës për pamundësinë e fillimit të negociatave për detin, për arsye teknike (grupi i paplotë negociator) që varen nga presidenti, i cili dikur akuzohej se pengonte qeverinë për negociatat për t'i ardhur në ndihmë Greqisë! Pra, Rama në lidhje me bisedimet për Zonën Ekskluzive Ekonomike me Greqinë, po therret për aleatë kohën, si mënyra më e mirë për t'i shërbyer edhe aleatit më të shtrenjtë të tij-Erdoganit. Nga ana tjetër me qëndrimet e tij dhe aleat kohën po tenton dha ia arrin për të tërhequr në qorsokak dhe konsum politik parazgjedhor pa bereqet opozitën dhe presidentin (Kjo për aq kohë sa ata e dinë që zgjerimi i ujrave territoriale në 12 milje nga ana e Greqisë është e drejtë ekskluzive e saj dhe nuk ka asnjë lidhje me Shqipërinë dhe interesat e saj, ndërkohë që e akuzojnë Ramën për “tradhëti kombëtare” dhe “mungesë transparence”) **FUND 01.09.2020 Për gaz TemA dhe Liberale**

## Nga Panajot Barka

Cenimi nga shumica i kontratës historike të bashkëjetesës me pakicën.

17.01.2021

<https://dosja.al/panajot-barka-sulmon-marin-memen-mund-te-shpallesh-hero-por-mos-ceno-identitetin-e-grekeve-te-dropullit-ke-frika-nga-pakica-dhe-gjen-armiq-e-plote/>

<https://www.facebook.com/511474372332073/posts/2455268207952670/>

<https://newsbomb.al/panajot-barka-i-kundervihet-marin-memes-ceno-identitetin-e-grekeve-te-dropullit-dhe-te-shqiperise-shkon-neper-fshatra-me-kamera-te-fshehta-dhe-provokon-disa-pleq-e-plaka/>

<https://lapsi.al/2021/01/18/marin-mema-ky-patriot-qe-veteshpallet-hero-i-kombit/>

Të shtunën me 16.01.2021, emisioni televiziv “Gjurmë shqiptare” me autor M. Mema në kanalën “Top Channel”, iu referua etnogjenezës dhe historisë së banorëve të Dropullit në rrethin e Gjirokastrës.

Nuk kam asgjë personalisht me autorin. Aq më tepër që prinderit e tij i kam miq shumë të mirë. Dhe jemi miq të mirë se ata reflektojnë një kulturë kulturë perendimore, tolerance, respekti, bashkëjetese e bashkëpunuese, pavarësisht dallimeve cilatdo qofsin. Një karakteristikë që e dalloi dhe e dallon këtë pjesë të jugut të sotëm të Shqipërisë shekuj me radhë dhe para të cilit jemi të detyruar të përulemi me respekt të thellë.

### **Emisioni cenon kontratën historike të bashkëjetesës, të barazisë, të të drejtës së identitetit.**

Autori Mema, mund të shpallet “hero” në mbrojtje të ideve të veta kombëtare. Nuk përbën asnjë problem. Përkundrazi! Është në të drejtën e tij! Por është e patolerueshme që ai të abuzojë në emër të këtij misioni dhe të trazojë në menyrë të njëanshme të vërteta shekullore, të cenojë integritetin e historisë dhe të identitetit të banorëve grekë në zonën e Dropullit dhe të grekëve në përgjithësi në Shqipëri.

**Në planin e përgjithshëm.** Mema edhe një herë manifeston frikën e shumicës nga pakica dhe angazhimin e madh për të gjetur “armiç” nga kundërvenia me të cilët të mund të evidentojë vetën dhe ata që përfaqëson.

**Në planin etik dhe profesional.** Për një temë të tillë të rëndësishëm, autori është i detruar t’i referohet edhe palës tjetër. Aq më tepër kur ajo përbën pakicë dhe detyrimi për të promovuar mendimin e saj, përbën normë të civilizimit perendimor. Pra, autori duhet të ballafaqonte idetë e tij me ato të përfaqësuesve të vërtetë të historisë dhe kulturës së Minoritetit Komëbtar në Dropull. Dhe të tillë Dropulli ka më shumë se çdo krahinë tjetër e Shqipërisë. (Nëse me 1927 Gjirokastra kishte më shumë të diplomuar me universitet se e gjithë Shqipëria së bashku, rezulton se në masën 70% ata i përkisnin identitetit grek. Ndërsa në kohën e diktaturës nga krahina e Dropullit kontribonin në pjesët e ndryshme të vendit mbi 1830 kuadro me shkollë të lartë.) Pra, në një zonë me një kulturë kaq të lartë dhe të njohur brenda dhe jasht vendit, autori nuk kërkon mendimin e tyre të kualifikuar, por në menyrë fyese, denigruese dhe të ulët, shkon nëpër fshatra malore me një kamerë të fshehtë dhe tinëzisht regjistron duke provokuar disa pleq e plaka, pa u prezantuar dhe pa treguar qellimin!!! Në vijim shkeput gjysëm

deklarimet e tyre dhe i përdorë në menyrë abuzive si argumente shkencore e historike në favor të idesë së tij. (!!)

**Së dyti. Abuzimi me faktet historike.** Shtrembërimi i realiteteve historike e shoqërore dhe përdorimi i “titujve akademikë” për të qenë bindes, nuk përbën thjesht propagandë denigruese, por edhe shkelje të të drejtave identare dhe akt i denueshëm ligjerisht (!)

P.sh. Argumentin e vetëm që përdorë autori i emisionit për të vërtetuar se grekët janë të ardhur në Dropull shumë vonë, (pas shekullit XVIII) e servir nëpërmjet Pëllumb Xhufit. Ky, duke abuzuar me titullin e vet, shtrembëron në mënyrë absurde dokumentin e Kronikës së Dropullit. Sipas referencës së Xhufit, kronika thotë se Dropullitet erdhën në trojet e veta aty nga shek XVIII-XIX.

### **E vërteta e historisë që fsheh Kronika e Dropullit**

Në fakt, kronika, është shkruar nga dropullitet në fillim të shek. XVIII. Qëllimi ishte, që në kuadrin e ideologjisë neo-ilumniniste helene, të shkruanin e të përcaktonin historinë e gjenezës së tyre dhe ngjarjet historike që pasuan, deri në pushtimin otoman. Kronika e vlerësuar nga Pouqueville si dokument me shumë saktësi, tregon se Dropullitet janë pasardhës të dy fiseve të mëdha athiniote. Këto dy fise me nga dy mijë anëtarë se cila, u dëbuan nga Athina pas Luftës së Trojsë, me akuzën se ndihmuan Thisean për rrembimin e parë të Helenës së bukur. U vendosen në luginën e këtueshëm të pabanuar të cilës i dhanë emrin Dhriinopolis, për shkak të pyjeve të shumtë me vallanidhja. Dhe lumin që e përshkonte, Dhrinos. Kryeqendrat e parë të tyre, përcakton kronika, ishin aty ku bashkohet edhe sot Vjosa me Drinon, mbi i Leklin e sotëm. Aty ku në shekullin IV m.Kr. u themelua peshkopata e parë e perandorisë romake lindore të krishterimit, më vonë bizantit. Më vonë u shtrinë drejt Jugut duke arritur deri në liqenin e sotëm të Zharavinës dhe Pogonin.

Me vperimtarinë zhvilluese të tyre që me themelimin e në vijim lidhen shumë toponime që arrijnë deri në ditët tona si Zoillos-Zhulati i sotëm, Homili-Humelitsa, Gardhion – (G)Kardhiqi, Sohakos – Suha, Ariskon – Arinista. Litavonion-si ndërtoi qytetin me të njëjtin emër, diku pranë Labovës së sotme dhe Saronas ndërtoi për nder të të atit të vet Gorani qytetin Goranopolis Vrahogoranxinë e sotme. Tre pasardhes nga fisi Litavonion, Argjyri, Hrysodhallo dhe Kolloris, ndërtuann në shek VI m.Kr tri qendrat –qytete të tyre: Argjyrokastron Hrysodolin dhe Kolloritsinë që egzistojnë ende me të njëjtin emër.

Në Luginën e Dropullit, sidomos në qendrën e saj i vestuan mbreter e perandorë. Pirrua në Jerma dhe themeloi Antgoneian, Jul Çezari që ndërtoi në trekendeshin Sofratikë, Antigoneia, Melani, Adriani mbi qytetin e lashtë helen të Sofratikës që pas viteve 1980, kur qyteti u zbulua rastesisht, mori emrin Hadrianopolis, Justiniani që investoi po në të njëjtin trekendesh. Tiverios Konstantinos, (574-582), Kostandinos Pogonatos (641-668), që pagëzoi me emrin e tij Pogonin e sotëm, Andronikos, Aleksios Komninos (1081-1118), Andronikos B’, (1282-1328) etj.

Në luginë e Dropullit gjenden ende të pazbuluara rreth 15 qytete antike helene, ashtu si edhe toponimi SELEIO, emri i fshatit sot, i cili rruan me fanatizëm dhe me ortografi emrin nga e ka prajardhjen emri i Elladhes-Greqisë!

Mashtrimi i dytë i madh i Xhufit lidhet me referencën (në mendjen e tij) të një letre që gjoja aty nga mesi i shekullit të XIX banorët e Pogonit i kërkonin Patriarkanës të dërgonte aty një prift shqiptar pasi nuk e donin priftin grek që u kishte dërguar !!!

Pak seriozitet profesor edhe kur mashtron! Së pari priftërinjtë shuguroheshin nga Peshkopata (e Dhriinopolit për Pogonin) dhe ishte çeshtje e enorisë dhe jo e episkopatës aq me keq e Patriarkanës. Së dyti, dihet se në këtë kohë që flet profesori, Kurt pasha që ndiqte Ali Pashën, varri tetë profëtërinj grekë të Pogonit se fshehën Ali Pashën dhe ai,

kur u bë pasha u fali si shpërblim toka dhe kishën e famshme të Sopikut. Së treti, Mesha e parë në gjuhën shqipe shenohet në vitet 20 të shek XX dhe nuk ka asnjë lidhje me Dropullin e Pogonin e as me Zagorinë.

### **Problemi i “origjines” arbnore të mbiemrave dhe emrave në Dropull.**

Autori Mema therret për këtë në nmdihmë profesorin e nderuar dhe studiuesin e njohur të P. Otomane Ferit Dukën. Por edhe profesori, megjithë respektin e madh që kam personalisht dhe bashkëpunimin e ngushtë, kur është dashur, bën disa lapsuse.

**Së pari.** Me 1431 që u bë regjistrimi i parë otoman, i cili përcakton sipas autorit të emisionit aktin përfundimtar të pushtimit, Dropulli vazhdonte rezistencën që zgjati deri me 1456 dhe sipas disa burimeve të tjera deri dhe pas vdekjes së Skendërbeut.

**Së dyti.** Regjistruesit turq, bënin regjistrimin duke i përshtatur emrat menyrës së vet të shqiptimit, që presupozon së paku heqjen e s-së fundore. (Këtë kanë bërë dhe në të gjithë Greqinë, apo dhe në Bullgari, Vllahi etj. Çfarë ndodhi në Shqipëri?! U ruajtën deri sot trajtat e P. Otomane në onomatologji dhe ato u konsideruan në vijim si identitet shqiptar. Për analogji. Personalisht në gjendjen civile emri im i regjistruar sipas kësaj tradite është “Panajot” dhe jo “Panajotis”. Kjo nuk do të thotë se unë i përkas kombësisë “arbërore” madje edhe pse flas e shkruaj shumë mirë shqip.

**Së treti.** Dihet përgjatë pushtimit Otoman kishte lëvizje të shumta njerëzish, grupesh komunitetesh nga njëri cep te tjetri. Kjo ishte e theksuar sidomos në zonën e Epirit. Dihet gjithashtu se pas vdekjes së Skendërbeut dhe me inspirimit e Venedikut me mijra të krishterë katolikë erdhen në bregdet dhe në Dropull për t’i bërë rezistencë pushtimit otoman. Më vonë Ali Pashë Tepelena mburej se ushtria e tij përbëhej kryesisht nga ushtarë të ardhur nga veriu. Nga këta, të gjithë ata që mbeten këtu, u asimiluan fillimisht nga pikëpamja fetare dhe pastaj, kur erdhi momenti i ngjizjes etnike, edhe etnikisht, në grekë, ashtu siç ndodhi edhe e kundërta.

### **Paraardhësit tanë ishin më të civilizuar se ne sot.**

Pra, paraardhësit tanë, që në atë kohë ishin me botkuptim civil me të zhvilluar dhe më të paparagjykuar se ata që kërkojnë t’u bëjnë historinë sot.

Po ashtu, nuk duhet abuzuar me raste emrash me prejardhje sidomos fetare, të cilat paraqesin të njejtin formë në të dy komunitetet, të konsiderohen ato apriori me logjikjën e shumicës. Ose të shtrembërohet realiteti si në rastin e Martinit, Nikës etj.

Këto zotërinj bashkëpjesëmarrës në prodhimin e një dokumentari denigrues për pakicën etnikisht greke, janë fakte dhe realitete të cilat kërkojnë thjeshtë integritet shkencor, moral, etik dhe kulturor brenda logjikës së bashkëjetesës harmonike në këto rajone, se vetëm kështu ndihmojmë përparimin tonë. **FUND**

**Nga prof.asoc. Panajot Barka      07.02.2021**  
**Angazhimi i mangët intelektual në lidhje me marrëdhëniet greko-shqiptare në Epir shtrëmbërojnë historinë dhe vrasin të ardhmën.**

<https://www.gazetatema.net/2021/02/08/civilizimi-nuk-perben-kurre-rrezik-asimilimi/>

E konsiderova detyrim ndaj vetës dhe lexuesve tuaj të ndërhyj në raport me dabatin e hapur në revistën tuaj lidhur me raportin dhe marrëdhëniet greko-shqiptare, sidomos në Epir, që mori shkas nga një emision televiziv mbi identitetin etnik të Dropulliteve.

Së pari, duke u nisur nga fakti se nga autorë të ndryshëm në këtë debat u abuzua me emrin tim për shkrime me pseudonim, dua të theksoj se kjo bie ndesh me natyrën dhe integritetin tim dhe konkluzionet e kësaj natyre janë abuzive, ose nisen nga vetja e atyreve që konkludojnë kështu. Në medjat shqiptare, të shkruara apo eleketronike kam mbi 600 shkrime të natyrave të ndryshme dhe që të gjitha mbajnë vetëm emrin tim, pavarësisht nga problematika dhe pasojat e mundshme. (Me këtë rast vlerësoj dhe falenderoj të gjitha ata që bashkëpunuan me mua në këtë drejtim)

Së dyti. Pa dashur të bëjë unë konkluzionet, mendoj se debati, pavarësisht nga titujt akademikë dhe referencat e protagonistëve, i kundërvihet, deri në antagonizma të njëanshme me synime për ndryshim raportesh, apo dhe eliminim realitësh, të lidhuira me relaitetin e vërtet historik dhe diakronik të Epirit. Bëhet fjalë për një njësi gjeografike me kontribute fontamentale paraprirëse e vijuese në kulturën greke, e cila i dha dritën horizontet kulturës dhe civilizimit botëror. Bëhet fjalë për një trevë që ruan diakronikisht natyrën specifike të këtij civilizimi, atë të bashkëjetesës, të multikulturës, unitetit dhe të të kundërtave, të tolerancës, të humanizmit, si mundësi që promovon dhe zhvillon konsistencë, identitet të veçantë, një trashëgimi kulturore mbështetur mbi raportët e njeriut të këtueshëm me natyrën dhe raportët e tij me vetën dhe botën. Në natyrën e vet civilizuese, kjo kulturë nuk interesohet për bartësit si të tillë por për produktin e vet (veti që dallon akoma edhe sot “perandorinë” e Aleksandrit të Madh me origjinë po nga Epiri, nga të gjitha llojet e perandorive që u përpoqen ta imitonin apo dhe nga vet globalizmi i sotëm)

Shikoni, akoma edhe sot në Epir (si unitet dhe pavarësisht kufijve politikë, Epir i Veriut apo i Jugut) mënyra e organizimit të strukturave shoqërore tradicionale, pavarësisht nga identiteti etnik, mbështet në traditën e orakullit të Dodonës. Ka në qendër një pemë, në krahë objektet e kultit, institucionet e tjera të kulturës apo të administratës dhe në vijim, kryesisht në formë gjysëm rrethore, janë banesat. Vërtetohet se që nga koha e formësimit të orakullit ka zanafillën edhe kënga polifonike etj.

Së treti. Debati, si i tillë dhe pjesëmarrja në të dhe i zërave të tjerë përveç monopolisteve abuzues, provoi tronditjen që pesoi establishmenti i ideologjisë nacionaliste i kultivuar që në kohën e rrënies së Perandorisë Otomane dhe kristalizuar nga sistemi komunist, që ka të bëjë me rimarrjen dhe evidentimin e armiqve të Perandorisë Otomane për të përcaktuar dhe për të evidentuar më mirë identitetin tonë; për të paraqitur cilësinë më domëthenëse të helenizmit, që është civilizimi, si bashkëjetësë, multikulturë, unitet të kundërtash etj, si rrezik asimilimi. Dhe për këtë tentohet kompensimi (por vetëm për konsum të brendshëm) me përvetësim të kulturës së tjetrit deri në mohim vlerash unikalë, në nivle të tilla që një ballafaqim sado i thjeshtë me bibliografinë dhe mendimin ndërkombëtar do të na klasifikonte qesharakë!)



Në këtë frymë, në debat u perserit p.sh argumenti për “frymën nacionaliste” të bibliografisë greke, ndërkohë, që edhe ato pak dokumenta që serviren në favor të shqiptarizmit rrjedhin nga bibliografia helene.

Së katërti. Në këtë kontekst, u përdor një taktikë më e kohës për të dalë te një rezultat sigurisht më të rrezikshme se sa deklamimet e hapura nacionaliste me argumente propagandistike. Kjo për faktin se dokumente të veçanta dhe të shkeputura nga realiteti (dhe me burim grek) u fetishizuan. Ose, në debat, në emër të të qenit i pranueshëm nga audjenca shqiptare të cilës i drejtohen dhe duke abuzuar me titullin shkencor u thanë disa gjysëm të vërteta që janë më të rrezikshme se mashtrimet. U bënë lëshime të tilla shkencore e bibliografike që jo vetëm shtrembërojnë realitetin historik, por venë në dyshim dhe të ardhmën. P.sh, për konfortabilitetin “e palëve”, këta studjues u heqin banorëve të Epirit, helenëve, vazhdimësinë që nga lashtësia dhe i spositojnë fillesat e tyre në Epir në kohën e Mesjetës kur evidentohet dhe prania e elementit alban. Ndërkohë, hedhin posht pretendimet se grekët e sotëm janë të ardhur në trojet e tyre shumë vonë, aty nga shekulli XVIII, si çifçinj të varfër dhe pa kulturë të cilën ua huazuan vendasit shqiptarë, të cilët fatkeqësisht u asimiluan prej ardhësve !! Ndërkohë u shtua terminologjia me konotacion negativ ndaj grekëve, ose me marifete nuk dilet në asnjë konkluzion, për oarigjinë e së cilës palë dhe hidhet me shumë mjegull si ushqime i qarqeve nacionalistë me nivel kulturor të ulët dhe pa mundësi gjykimi e vlerësimi.

Së pesti. U vu re gjithashtu një fakt me remineshenca dyfishtë demshme. Në emër të parimeve të drejta shkencore u kërkua në debat një qasje adekuate. P.sh, është e vërtetë se duhet të evidentohen dhe të konsumohen burime të ndryshme informacioni. Realisht, institucionet zyrtare me integritet dhe përgjegjësi shkencore në vend nuk promovojnë burime të ndryshme për këtë problem, por nuk dalin as vetë në konkluzione përkatese (veçse konsumojnë përtzpjjet e sistemit komunist). Për pasojë, përpjekjet individuale derivojnë shpesh në dorë të kaosit dhe abuzimit, apo destruktivitetit akademik. Nga ana tjetër, ky mendim shkencor gjithmon e më shumë tenton vetëm opinionin publik shqiptar dhe me motiv përgjithësisht atë nacionalist. Mendoj gjithashtu se kjo kërkesë mbëtet inefficente për opinionin publik shqiptar, në kushtet kur ai, ashtu si edhe vet mendimi shkencor, ka renë pre i sundimit e emocionit nacionalist i shfaqur si antihelenizëm. Këtë realitet nuk e justifikon as heshtja e palës greke, që vjen kryesisht për shkak të nënvleftësimit të argumentit shkencor shqiptar. Këtë realitet, mungesën e ballafaqimit të mendimit shkencor shqiptar, qoftë me atë të fqinjët apo dhe me atë evropian dhe botëror, si shprehje e mangësisë së objektivitetit shkencor, e kanë venë re shumë institucione shkencore perendimore, me në krye akademikët austriakë dhe gjermanë. Pra, në kushtet kur të paktën ka një mungësë serioziteti shkencor dhe një ekspansion nacionalist të rendit ideologjik si edhe nëse vërtet duam të vërtetën dhe prosperitetin që na servir historia e gjatë dhe e përbashkët, duhet të organizohen ballafaqime të vërteta shkencore dypaleshe dhe globale, ashtu siç bëri me 2016 Akademia e Shkencave për Voskopojën.

Së gjashti. Me këtë qasje lidhet edhe fakti tjetër. Në argumentin teorik të debatit u përdor shpesh një fakt i vetëm, i shkëputur nga mjedisi historiko-kulturor që e prodhoi, aq më tepër kur dihet se një fakt i vetëm nuk mund të përgjithësohet dhe të shërbejë për rezultate shkencore shtëruese. Apo, me keq ta përdoresh atë për të justifikuar politika dhe qëndrime të ndryshme.

P.sh. Në debat u kthye në strumbullar prove në favor të argumentit të pranisë së elementit shqipfolës në trevat e komunitetit të sotëm të minoritetit etnik grek, një dokument e vitit 1856 që lidhet me një përgjigje pozitive të Patriarkanës së Konstandinopojës ndaj kërkesës së një komuniteti shqipfolës që nuk ka lidhje me

elementin helen ortodoks në jugun e sotëm të Shqipërisë. Madje, hidhet dhe teza se kjo përgjigje ashtu si edhe ajo ndaj Mihal Gramenos me 1909, ishin produkt i presionit politik të P. Otomane në favor të elementit shqiptar.

Intërpretimi i faktit apo i fakteve në fjalë nuk i përgjigjen realitetit, ose është së paku i njëanshëm. Dihet se interesi i Perendimit për krijimin e komb-shteteve në pjesën evropiane të P. Otomane, pas revolucionit grek të 1821) kishte si premisë kryesore identitetin e tyre të krishterë. Pionieri i këtij interesimi për shqiptarët me shumicë myslimane ishte *British and Foreign Bible Society* e cila që në dhjetëvjeçarin e tretë të sh. XIX i kërkoi lejën e Patriarkanës për përkthimin e librave të shënjta në gjuhën shqipe. Patriarkana, nisur nga parimi i Bizantit, “një fe shumë gjuhë” dha pëlqimin e kësaj inisiativë. Qëllimi ishte i qartë. Në aspektin fetar shikohej mundësia e rikrishtërimit të elementit të myslimanizuar shqiptar dhe së dyti, në kuadrin e idesë së hedhur nga Kollokotroni me 1823, i cili, duke u nisur nga pesha e madhe e shqiptarëve në krah të P. Otomane, synoi një alenancë të mundshme me ta duke propozuar një shtet dualist Greko-shqiptar. Në këtë kuadër personalitete të kohës së shqiptarësisë, si Veqilharxhi, Meksi, Argjirokastriti, të cilët ishin dhe anëtarë të Philiqi Etairias (krahu politik dhe ushtarak i revolucionit grek), u angzhuar në këtë proces, që u kulmua me kërkesën zyrtare të Gjolekës, ndaj mbretit të Greqisë për çlirimin e Epirit nga pushtuesit otoman dhe bashkimin e tij me Greqinë, mjaft që të respektohej gjuha dhe besimi.

Në këtë logjikë me 22 prill 1845, Veqilharxhi mori një letër nga sekretari i Mitropolitë së Korçës ku i transmetonte qëndrimin pozitiv të Mitropolitit për abetarën e tij.

Në këtë klimë helenizmi dhe ideologjia e re greke, sh. XVIII-XIX shërbeu si shtrat për ideologjinë kombëtare shqiptare, që sipas balkanologës N. Clayer, nisi si pjesë e helenizmit dhe vijoi e lidhur ngusht me të, ndaç si komplementare, ndaç si kundërshtarë. Literatura greke dhe mjedisi grek u bë për më shumë se gjysëm shekulli (1860-1905) mjeti për promovimin e problemit shqiptar. Gjithë plejada i rilindasve shqiptarë, ortodoksë apo myslimanë, njihnin greqishtë, shkruan dhe botuan greqisht.

Është e vërtetë se me reformat e Tanzimatit dhe veçanërisht me ardhjen e xhonturqve interesi i P. Lartë për elementin shqiptar ishte i madh dhe lidhet me nevojën e saj për të patur aleanca të qëndrueshme këtu, pasi, pas Krizës së Lindjës, fundi i saj këtu ishte i dukshëm. Këtij qëllimi i shërbëu edhe zëvendësimi në analet zyrtare të Perandorisë me 1892 të etnonimit “arnaut” me etnonimin “albanët- shqiptarët” dhe prodhimi i një serë dokumentash të natyrave të ndryshme për të provuar indentitetin shqiptar, sidomos në Epir. Për herë të parë P. Otomane kujtohet të hap shkolla në gjuhën turke për të konkuruar shkollat greke, (si në rastin e Janinës) dhe jep leje për legalizimin e veprimtarive në gjuhën shqipe.

Po ashtu dihet se konfodimi i interesave të fuqive adriatike me ato të P. Otomane në fillim të shek XX, bëri që komuniteti shqiptar t’i kundërvihet helenizmit me objekt kryesisht fenë ortodokse, fenomen që për defektet e vet kishës ortodokse dhe politikës së saj, u evidentua dhe në proceset e formimit të kombështeteve të tjera në Ballkan.

Solla këtë shëmbull, në kuadrin e gjithë ndërhyrjes time në dabat për të thenë se realiteti diakronik i natyrshëm i marrëdhënieve midis grekëve dhe shqiptarëve në këtë rajon identifikohet plotësisht me frymën evropiane sot dhe se politika dhe interesat e ndryshme ushqëjnë, sidomos në disa elementë dhe nivele të shoqërisë shqiptare, ndasinë, konfliktualitetin, gjuhën e urrejtjes! Besoj se impenjimi intelektual duhet t’i kundërvihet këtij lloj ushqimi.

